
بسم الله الرحمن الرحیم

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i njëzetetretë)

Nga ajeti 28 i sures "Jasin" e deri ajeti 31 i sures "Zumer"

Titulli: ***KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT***

(Xhuzi i njëzetetretë)

Autori: ***Eruditi, juristi dhe komentuesi***

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: ***Vullnet MERJA***

E përktheu nga arabishtja: ***H. Selim STAFA*** *(Allahu e mëshiroftë!)*

E redaktoi: ***Viktor SHARRA***

Korrektura teknike: ***Vjollca KARAJ***

Përkujdesja grafike: ***Sabrie FEZA***

Kapaku: ***Sabrie FEZA***

Botoi: ***Shoqata "FLLADI"***

Copyright: ***Shoqata "FLLADI"***

Shtypshkronja e shtëpisë botuese ***LILO***

Ajetet: 28 – 32

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

۞ وَمَآ أَنزَلۡنَا عَلَىٰ قَوۡمِهِۦ مِنۢ بَعۡدِهِۦ مِن جُندٖ مِّنَ ٱلسَّمَآءِ وَمَا كُنَّا
مُنزِلِينَ ﴿٢٨﴾ إِن كَانَتۡ إِلَّا صَيۡحَةٗ وَٰحِدَةٗ فَإِذَا هُمۡ خَٰمِدُونَ ﴿٢٩﴾
يَٰحَسۡرَةً عَلَى ٱلۡعِبَادِۚ مَا يَأۡتِيهِم مِّن رَّسُولٍ إِلَّا كَانُواْ بِهِۦ يَسۡتَهۡزِءُونَ ﴿٣٠﴾
أَلَمۡ يَرَوۡاْ كَمۡ أَهۡلَكۡنَا قَبۡلَهُم مِّنَ ٱلۡقُرُونِ أَنَّهُمۡ إِلَيۡهِمۡ لَا يَرۡجِعُونَ ﴿٣١﴾ وَإِن
كُلٞ لَّمَّا جَمِيعٞ لَّدَيۡنَا مُحۡضَرُونَ ﴿٣٢﴾

"Pas tij ne nuk zbritëm ndonjë ushtri prej Qiellit kundër popullit të tij dhe as nuk është vendimi Ynë të zbresim tjetër."

"Ajo ishte vetëm një britmë tmerruese dhe ata të gjithë mbetën të vdekur."

"Sa humbje e madhe për ata njerëz, të cilëve sa herë u vinte një Profet, nuk lanë pa u tallur me atë."

"A nuk e panë ata se sa prej brezave kemi zhdukur para tyre dhe ata nuk u kthyen?"

"Dhe të gjithë të mbledhur do të kthehen te Ne."

Komentimi

Shkujdesje e përhershme

Në ajetet e mëparshme pamë këmbnguljen e banorëve të Entàkijes (Antiokisë) për të kundërshtuar të Dërguarit e All'llahut dhe tani le të shikojmë rezultatin e punës së atyre mizorëve.

Në lidhje me këtë çështje, Kur'àni Famëlartë njofton: **"Pas tij ne nuk zbritëm ndonjë ushtri prej Qiellit kundër popullit të tij dhe as nuk është vendimi Ynë të zbresim tjetër."**.

Ne s'kemi nevojë për të këtilla punë dhe si rregull bazë nuk është prej rrugës Sonë të përdorim ushtritë e Qiellit për të asgjësuar mizorët, sepse edhe një shenjë e vetme nga ana Jonë do të ishte e mjaftueshme për t'i asgjësuar ata të gjithë njëherësh; një shenjë e vetme do të ishte e mjaftueshme që elementet e jetës e të mjeteve të jetesës së tyre, të kthehen në elemente të vdekjes e të asgjësimit të plotë, madje kjo ndodh brenda një kohe sa të shkelësh syrin dhe Ne e përmbysim jetën e tyre.

Pastaj i Larti shton: **"Ajo ishte vetëm një britmë tmerruese dhe ata të gjithë mbetën të vdekur."**.

Vallë a ishte kjo britmë jehona e një rrufeja që zbriti prej reve në Tokë dhe ajo britmë e fuqishme lëkundi çdo send, shkatërroi të gjitha ndërtesat që gjendeshin në atë vend dhe bëri që njerëzit nga frika e madhe të vdesin?

Ose ajo mund të ketë qenë një britmë e shkaktuar prej ndonjë shpërthimi të dalë nga thellësitë e Tokës, pastaj zhurma e

fuqishme e atij shpërthimi është përhapur në atmosferë dhe valët e shpërthimit kanë bërë të vdesin të gjithë.

Apo ajo ishte vetëm një britmë që ndodhi brenda një çasti fare të shkurtër, sa të lëvizësh syrin; mos vallë ajo ishte një britmë e atillë që bëri të shuhen të gjitha britmat e tjera, ose ishte një lëkundje toke aq e fuqishme sa ndaloi çdo lëvizje. E këtillë është fuqia e All'llahut dhe e këtillë është e ardhmja e atyre që kanë shkarë në rrugën e humbjes dhe prej të cilëve nuk vjen asnjë dobi.

Ajeti vijues, shpalos rrugën që kanë ndjekur gjatë gjithë historisë kundërshtarët ndaj thirrjeve hyjnore që kanë bërë Profetët e dërguar prej All'llahut të Lartësuar dhe ajeti, me një gjuhë shumë të bukur, që i robëron zemrat, thotë: **"Sa humbje e madhe për robërit, të cilët sa herë u vinte një Profet, nuk lanë pa u tallur me atë."**.

Sa keq, për ata që e mbyllën dritaren e mëshirës kundër vetvetes! Sa keq, për ata që e thyen llampën e udhëzimit në rrugën e drejtë! Nga që ishin në rrugën e humbjes, ata ishin të privuar prej lumturisë; por ata, jo vetëm që nuk deshën të dëgjojnë me veshët e zemrave të tyre thirrjen e udhëheqësve të mëdhenj të Njerëzisë, por vazhduan t'i vënë në lojë e të tallen me udhëheqësit e nderuar hyjnorë dhe më pas i vranë, megjithëse kishin dijeni sa keq kishin përfunduar tiranët mohues që kishin jetuar para tyre; gjithashtu, ata kishin dëgjuar dhe kishin lexuar nëpër faqet e historisë në lidhje me përfundimin e dhimbshëm të mohuesve mizorë; megjithëkëtë, ata, jo vetëm që nuk nxorën mësim nga pësimet e mohuesve të përparshëm, por ndoqën të njëjtën rrugë që kishin ndjekur të përparshmit, prandaj edhe patën të njëjtin përfundim.

Është e qartë se kjo fjali është fjalë e All'llahut të Lartësuar dhe të gjitha këto ajete janë shpjegim nga ana e All'llahut të Gjithëfuqishëm, prandaj është e natyrshme që humbja këtu - në kuptimin e saj të njohur - është brengosje e hidhërim për të mirat që ata humbën, por kjo humbje nuk ka të bëjë aspak me All'llahun e Lartësuar; gjithashtu edhe zemërimi dhe të ngjashëm me zemërimin - në kuptimin e tij të njohur – kurrë nuk del prej All'llahut të Lartësuar, por këtu qëllimi është për të treguar se e liga te ajo shtresë idhujtarësh kishte arritur deri aty, sa kur njeriu mëson për gjendjen e tyre, pyet me keqardhje: përse u zhytën në atë vorbull thithëse, kur i kishin të gjitha mjetet e shpëtimit?

Fjala e ajetit *"ibàd"* - *"robtë"* - në kuptimin njerëzit – tregon se me të vërtetë është çudi me ata njerëz, që jetonin në mesin e mirësive të shumta të All'llahut dhe në të njëjtën kohë kryenin të këtilla punë të liga e krime të shëmtuara.

Në vijim të bisedës që trajtonin ajetet e përparme edhe këto dy ajete flasin për shkujdesjen e vazhdueshme të një grupi të madh njerëzish, gjatë gjithë shekujve e kohërave dhe për këtë ajeti thotë: **"A nuk e panë ata se sa prej brezave kemi zhdukur para tyre?"**.[1]

Këta mohues, nuk ishin të parët që nuk besuan, pasi ka pasur popuj të tjerë që kanë jetuar në këtë botë para tyre, të cilët e

[1] Pyetja **"ĩ"** - *"a"* në ajetin objekt studimi është germë pyetje pohuese, kurse fjala *"kem"* – *"sa"* është fjalë njoftuese, por që këtu është në kuptimin shumicë dhe është në pozitën e kundrinorit të drejtë në lidhje me foljen *"jereu"* – *"panë"*; ndërsa fjala *"minel kurùni"* – *"prej brezave"* e shpjegon më qartë këtë kuptim. Më sipër, kemi shpjeguar se fjala *"kurùn"* është në kuptimin e shekujve dhe njëjësi i kësaj fjalë *"karnun"* është i barabrtë me 100 vjet, ose është në kuptimin e një brezi që jeton në një kohë të caktuar.

kundërshtuan të vërtetën dhe faqet e historisë janë të mbushura me të ardhmen e tyre të dhimbshme dhe me fundin e tyre tmerrues. Këtë të vërtetë e dëshmojnë edhe rrënojat që kanë mbetur prej qyteteve të tyre të shkatërruara dhe të gjitha këto shihen me sytë e ballit. Vallë, a nuk mjaftojnë kaq shumë argumente që njerëzit duhet të nxjerrin mësim nga pësimi i të përparshmëve?

Tani shtrohet pyetja: kujt i adresohet përemri *"ata"* në frazën *"elem jereu"*, **"A nuk e panë ata?"**.

Në lidhje me këtë çështje, interpretuesit e Kur'ànit kanë përmendur disa opsione:

I pari: u adresohet "banorëve të vendbanimit", rreth të cilëve flasin ajetet e përparme.

I dyti: u adresohet "banorëve të Mekës", te të cilët zbritën këto ajete që t'u tërhiqnin atyre vëmendjen.

Por, kur shikojmë në ajetin e përparshëm **"Sa humbje e madhe për robërit"**, arrijmë në përfundimin se qëllimi me fjalën *"robërit"* janë të gjithë njerëzit, sepse fjala e ajetit *"el ibàd"* – *"robtë"* përfshin të gjithë njerëzit, gjatë gjithë historisë, të cilëve sapo u vinin Profetët, ata menjëherë hidheshin dhe i kundërshtonin, i përgënjeshtronin, i quanin gënjeshtarë dhe i tallnin. Në të gjitha gjendjet, kjo thirrje u adresohet të gjithë njerëzve dhe u thotë që të mendojnë rreth historisë së të përparshmëve dhe le të nxjerrin mësim prej rrënojave që ata kanë lënë pas vetes; gjithashtu, kjo thirrje i fton njerëzit të hapin zemrat dhe sytë.

Në fundin e këtij ajeti, All'llahu i Lartësuar shton: **"dhe ata nuk u kthyen"**.[1]

Domethënë: pësimi i rëndë qëndron në pamundësinë që ata të rikthehen në jetën e kësaj bote, për të bërë punët që lanë pa i bërë, gjithashtu edhe shndërrimi i fajeve të tyre në punë të mira, mbetet krejtësisht i pamundur, për shkak se ata vetë i shkatërruan të gjitha urat që lanë pas vetes, për rrjedhojë, për ata kurrë nuk mund të ketë më rrugë kthimi në jetën e kësaj bote.

Ky interpretim është plotësisht i ngjashëm me atë që ka thënë Prijësi i besimtarëve, Ali bin Ebù Tàlibi *(Paqja qoftë mbi të!)*, gjatë bisedës për nxjerrjen e mësimit prej të vdekurve: *"Nuk keni mundësi as të pakësoni të keqen e as të shtoni të mirën."*.[2]

Ajeti i fundit prej ajeteve në fjalë shton: **"Dhe të gjithë të mbledhur do të kthehen te Ne."**.[3]

---

[1] Kjo fjali tregon: Ne kemi shkatërruar shumë breza dhe është kriter vlerësues për ajetin e parë të këtij grupi ajetesh: **"A nuk e panë ata se ata nuk u kthyen."**. Disa interpretues të Kur'ànit, janë shprehur se ky ajet tregon gjendjen e atyre që u shkatërruan.

[2] "Nehxhul Belàga", hutbeja 188.

[3] Në mesin e interpretuesve të Kur'ànit, pohohet se dygermëshi *"in"*, në konstruktin e këtij ajeti është në kuptimin e mohores; disa të tjerë kanë thënë është në kuptimin e thjeshtësimit dhe për këtë shkak, fjala që vjen pas dygermëshit *"in"* nuk mund të jetë as kundrinor e as plotësor; kurse fjala *"lem'mà"* është në kuptimin *"përveçse, me përjashtim"*, duke pasur parasysh se kështu përdoret kjo fjalë në të folmen e arabëve. Fjala tjetër e ajetit *"xhemij'un"*, është në kuptimin e grupit dhe është kallzues për fjalën *"kul'lun"* – *"të gjithë"* e cila, e lexuar me diftogun *"un"* në fund, tregon se është një ndajshtesë e hequr dhe një vlerësues për fjalën tjetër të ajetit *"hum"* – *"ata"*. Në origjinë, kjo fjalë është në kuptimin: të gjithë ata; kurse fjala e fundit e ajetit *"muhdarùne"* – *"të mbledhur"* ose është kallzues pas kallzuesi, ose është cilësor për fjalën *"të gjithë"*. Bazuar mbi këtë shpjegim, vlerësimi i kuptimit të ajetit do të ishte: "Të gjithë ata, Ditën e Kiametit patjetër do të jenë të mbledhur para Nesh.".

Domethënë se çështja nuk mbaron me vdekjen e tyre dhe në mospasjen e mundësisë për rikthim në jetën e kësaj bote, megjithëse e dinë që rikthim për ata kurrë nuk do të ketë dhe se vdekja është vetëm hapi i parë dhe jo hapi i fundit; veç kësaj, shumë shpejt, të gjithë do të jenë të mbledhur në sheshin e gjykimit, për të dhënë llogari për punët që kanë bërë dhe më pas ata i pret ndëshkimi hyjnor, i vazhdueshëm e i përhershëm.

Kur puna qëndron kështu, a nuk do të ishte më mirë për ata të nxirrnin mësim nga fundi i mohuesve që jetuan para tyre dhe të përfitonin nga rasti, para se t'u vijë vdekja, që të mos përballen me një të ardhme kaq të tmerrshme?

Sikur vdekja të ishte vula mbyllëse e të gjitha punëve, ishte e mundur që ata të thoshin se vdekja është fillimi i qetësisë për ata. Por, fatkeqësisht nuk është kështu! Këtë kuptim poeti e ka shprehur me vargjet e tij:

Sikur të vdisnim e të liheshim

Patjetër vdekja do të ishte qetësi për çdo të gjallë

Porse pas vdekjes ne do të ringjallemi

Dhe pastaj do të pyetemi për çdo send.

Ajetet: 33 – 36

وَءَايَةٌ لَّهُمُ ٱلۡأَرۡضُ ٱلۡمَيۡتَةُ أَحۡيَيۡنَٰهَا وَأَخۡرَجۡنَا مِنۡهَا حَبّٗا فَمِنۡهُ يَأۡكُلُونَ ﴿٣٣﴾ وَجَعَلۡنَا فِيهَا جَنَّٰتٖ مِّن نَّخِيلٖ وَأَعۡنَٰبٖ وَفَجَّرۡنَا فِيهَا مِنَ ٱلۡعُيُونِ ﴿٣٤﴾ لِيَأۡكُلُواْ مِن ثَمَرِهِۦ وَمَا عَمِلَتۡهُ أَيۡدِيهِمۡۖ أَفَلَا يَشۡكُرُونَ ﴿٣٥﴾ سُبۡحَٰنَ ٱلَّذِي خَلَقَ ٱلۡأَزۡوَٰجَ كُلَّهَا مِمَّا تُنۢبِتُ ٱلۡأَرۡضُ وَمِنۡ أَنفُسِهِمۡ وَمِمَّا لَا يَعۡلَمُونَ ﴿٣٦﴾

"Dhe argument për ata (për fuqinë e All'llahut) **është toka e vdekur, të cilën Ne e ngjallim dhe prej saj Ne nxjerrim drithëra, prej të cilave ata hanë."**

"Në tokë Ne kemi bërë kopshte prej hurmash e rrushi dhe në të Ne kemi shpërthyer burime uji."

"Që ata të hanë prej frutave dhe prej asaj që prodhojnë me duart e tyre; përse nuk falënderojnë?"

"I pastër nga të metat është Ai që krijoi çiftet nga ato që mbijnë në tokë, nga vetë ata dhe nga ato që ata nuk i dine."

Komentimi

Argumente të tjerë

Në ajetet e përparme, pamë luftën që bënë të Dërguarit kundër adhurimit të idhujve; gjithashtu, në ajetin e fundit të ajetit të grupit të ajeteve të përparme, u shpalos edhe çështja e ringjalljes pas vdekjes, ndërsa ajetet objekt studimi shpjegojnë qartë njëherësh çështjen e Njëtimit të All'llahut (All'llahu është Zoti Një e i Vetëm) dhe çështjen e ringjalljes pas vdekjes, me qëllim për të zgjuar prej gjumit të shkujdesjes ata njerëz që i mohojnë këto dy të vërteta absolute, si dhe për t'i ndërgjegjësur ata që të kthejnë sytë e zemrën drejt besimit.

Ajeti i parë flet për dukurinë e ngjalljes së tokës së vdekur dhe për begatitë që i vijnë njeriut prej ringjalljes së saj: **"Dhe argument për ata** (për fuqinë e All'llahut) **është toka e vdekur, të cilën Ne e ngjallim dhe prej saj Ne nxjerrim drithëra, prej të cilave ata hanë."**.

Çështja e jetës dhe çështja e përjetësisë, janë argumentet më të rëndësishëm që vërtetojnë Njëtimin e All'llahut (Teuhid). Në realitetin e saj, çështja e jetës dhe çështja e përjetësisë janë çështje komplekse, të mbushura me nënkuptime e motive mahnitëse dhe të gjitha këto kanë hutuar mendjet e dijetarëve, pavarësisht nga zhvillimi e përparimi i arritur në mjetet e në metodat e studimit në të gjitha shkencat; megjithëkëtë, shumë sekrete janë në pritje të gjetjes së një zgjidhjeje! Deri tani, nuk dihet se nën efektin e çfarë faktorësh, trupat e ngurtë e pa jetë shndërrohen në qeliza të gjalla.

Deri tani, nuk dihet si formohen shtresat e qelizave të farërave. Nuk dihet se ç'ligje komplekse i administrojnë ato. Shihet se vetëm me plotësimin e kushteve ndihmëse, menjëherë fillon lëvizja, merr udhë rritja e udhëzimit dhe ekzistenca e këtyre gjallesave që vijnë njëra pas tjetrës, prej grimcave të tokës së vdekur. Me këtë rrugë, trupat e ngurtë e pa jetë shndërrohen në trupa të gjallë, që pasqyrojnë çdo ditë dukuri të jetës e të rritjes së tyre.

Çështja e jetës në bimët e në kafshët, si dhe ngjallja e tokës, nga njëra anë konsiderohen argument që vërteton ekzistencën e diturive dhe të ligjeve të hollësishme të vëna në dispozicion të krijimit të kësaj bote, nga ana tjetër, të gjitha këto konsiderohen edhe argument që vërteton ringjalljen pas vdekjes.

Është e qartë se përemri *"hum"* – *"ata"* në shprehjen *"lehum"* – *"për ata"* i adresohet fjalës *"el ibàd"* – *"njerëzit"* të përmendur në ajetet e përparme dhe me fjalën *"el ibàd"* është qëllimi: të gjithë njerëzit që gabuan në vlerësimin e çështjes së fillimit të krijimit dhe të ringjalljes. Kur'àni Famëlartë e konsideron gjendjen e këtyre njerëzve motiv për humbje e keqardhje.

Ardhja e fjalës *"àjetun"* – *"argument"* në trajtën e pashquar, tregon rëndësinë e madhe dhe qartësinë e këtij argumenti, që vërteton Njëtimin e All'llahut (All'llahu është Zoti Një e i Vetëm).

Fraza e fundit e këtij ajeti **"prej të cilave ata hanë"**, nga njëra anë tregon se njeriu përfiton prej farërave të disa bimëve për t'u ushqyer me ato, ndërsa një pjesë e farërave nuk janë të përshtatshme për ushqimin e njeriut, por edhe në ato ka dobi të tjera, pasi përdoren si ushqim për kafshët, ose përdoren për

nxjerrjen e vajrave, ose në industrinë e përgatitjes së medikamenteve, ose për përgatitjen e sendeve të tjera, të cilat, gjithashtu, janë shumë të rëndësishme për jetën e njeriut.

Nga ana tjetër, vënia e fjalës *"minhu"* – *"prej të cilave"* para foljes *"je'kulùne"* – *"ushqehen"* zakonisht tregon kufizim, çka shpjegon sa të mira e sa të dobishme janë lëndët bimore për ushqimin e njeriut, madje janë aq të rëndësishme, sa natyrshëm mund të thuhet se të gjitha lëndët ushqimore që konsumon njeriu, vijnë prej bimëve.

Ajeti vijues në këtë grup ajetesh, qartëson dhe shpjegon ajetin e parë, shpjegon qartë mënyrën si ngjallet toka e vdekur dhe thotë: **"Në tokë Ne kemi bërë kopshte prej hurmash e rrushi dhe në të Ne kemi shpërthyer burime uji."**.

Në ajetin e parë flitej për farërat ushqyese, kurse këtu flitet për frutat, që janë ushqim dhe forcuese të trupit. Ajeti përmend hurmën e rrushin, pasi të dy këto lloje frutash konsiderohen prej llojeve më të mira për ushqimin e njeriut, pasi, qoftë hurma, qoftë rrushi, konsiderohen ushqim i plotë, me të gjithë përbërësit e duhur.

Më sipër, kemi thënë se studimet e shkencëtarëve kanë treguar se këto dy fruta përmbajnë vitamina dhe lëndë të tjera jetësore të domosdoshme për trupin e njeriut; përveç kësaj, këto dy lloje frutash është e mundur të konservohen, ose mund të konsumohen të freskëta, por ato mund të ruhen të thara në diell dhe kështu mund të përdoren gjatë gjithë vitit.

Disa mendojnë se ndryshimi mes shprehjeve për këto dy lloje frutash, tregon dobinë që vjen prej pemës dhe dobinë që vjen

prej frutit. Dihet se, e gjithë pema e hurmës, ka dobi të shumta: përfitohet prej trungut të pemës së hurmës, prej degëve, prej gjetheve dhe prej frutave të kësaj peme, në një kohë që nga pema e hardhisë, më shumë prej saj përfitohen vetëm fruta, pasi degët dhe gjethet e hardhisë kanë përdorim të vogël.

Përsa i përket faktit që këto dy lloje frutash janë përmendur në këtë ajet në numrin shumës, kjo tregon se ka varietete të shumta të këtyre dy lloje frutash, pasi, qoftë hurma, qoftë rrushi, janë në disa dhjetëra varietete, që ndryshojnë në formë, në shije dhe në cilësi të tjera karakteristike për secilin lloj fruti.

Vlen të theksohet se, në këtë ajet flitet për ngjalljen e tokës së vdekur, por gjallërimi i tokës këtu nuk është shoqëruar me përmendjen e shiut, i cili zakonisht përmendet në ajetet e Kur'ànit që flasin për këtë çështje; por, në këtë ajet janë përmendur "burimet e ujit". Dihet që shiu është i mjaftueshëm për të siguruar mbjelljen e rritjen e shumë të mbjellave e bimëve, në një kohë që pemët frutore kanë nevojë të ujiten herë pas here me ujë të rrjedhshëm.

Fjala e ajetit *"fexh'xhernà"* – *"Ne kemi shpërthyer"*, në rrënjën e saj tregon një çarje të gjerë dhe nga ky kuptim, kjo fjalë është përdorur për të treguar burimet e ujërave, sepse burimet e ujit e çajnë tokën dhe e shtyjnë ujin drejt sipërfaqes së tokës.

Ajeti vijues shpjegon akoma më qartë qëllimin për krijimin e këtyre drufrutorëve të bekuar dhe thotë: qëllimi i krijimit të këtyre drufrutorëve është që njerëzit të hanë prej frutave të këtyre drurëve, pa qenë nevoja të derdhin mund e djersë dhe pa ndërhyrë njeriu me punën e tij në bërjen e frutave që japin këto pemë, ashtu siç njofton ajeti: **"Që ata të hanë prej frutave dhe**

prej asaj që prodhojnë me duart e tyre; përse nuk falenderojnë?".

Po frutat janë të gatshme të merren si ushqim sapo të këputen nga dega dhe nuk kanë nevojë as të gatuhen e as të përpunohen, s'kanë nevojë as për ndonjë tjetër mënyrë shndërrimi. Ky fakt tregon se sa me dashamirësi e me sa respekt e trajton All'llahu i Lartësuar njeriun.

Veç kësaj, ky ushqim i gatshëm e i shijshëm, mund të mblidhet e të ambalazhohet, me qëllim që të ruhet për një kohë të gjatë, pa iu pakësuar asgjë nga vlerat e tij ushqyese, çka do të thotë se ky ushqim është e kundërta e ushqimeve që përpunon njeriu prej lëndëve natyrore që i ka dhënë All'llahu i Lartësuar. Dihet se ushqimet e përpunuara prej njeriut, në shumicën e rasteve kalben e prishen shumë shpejt.

Ka edhe një interpretim tjetër të këtij ajeti dhe që meriton të shikohet me kujdes: me këtë ajet, Kur'àni Famëlartë ka qëllim të theksojë se, prej frutave, jo vetëm që është e mundur të përfitohet pa u bërë atyre ndonjë ndryshim të madh, por prej frutave mund të merren edhe lloje të ndryshme ushqimesh, që përgatiten me këto fruta vetëm me disa punë të thjeshta.

Në të gjitha këto mirësi të shumta e të rëndësishme që u përmendën në këtë ajet, qëllimi është që në njeriun të vihet në lëvizje ndjenja për të specifikuar të vërtetën dhe për të falënderuar, sepse rruga e parë për njohjen e All'llahut fillon me falënderimin e All'llahut të Lartësuar; me fjalë të tjera, falënderimi për Mirësidhënësin, është hapi i parë i hedhur në rrugën e njohjes së Tij.

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve objekt studimi, flet për madhërimin e All'llahut dhe dëlirjen e Tij nga të gjitha llojet e mangësive e nevojave; gjithashtu, në këtë ajet hidhet poshtë vënia shok All'llahut në adhurim (shirku), ashtu siç bëjnë adhuruesit e idhujve, që u përmend në ajetet e përparme; njëkohësisht, në këtë ajet shpjegohet qartë e gjithë rruga e Njëtimit të All'llahut (Teuhidit), domethënë rruga e adhurimit kushtuar vetëm All'llahut, Zotit Një e të Vetëm, Absolutit, të Cilit i luten të gjitha krijesat për nevojat që kanë dhe ajeti thotë: **"I pastër nga të metat është Ai që krijoi çiftet nga ato që mbijnë në tokë, nga vetë ata dhe nga ato që ata nuk i dine."**.[1]

Po, All'llahu i Lartësuar i ka krijuar të gjitha llojet e çifteve në këtë botë kaq të gjerë; dituria e fuqia e Tij s'ka kufi, vetëm Ai është i pastër nga çdo e metë e nevojë, prandaj, për All'llahun s'mund të ketë as shok e as të ngjashëm me Atë, pavarësisht se disa njerëz e konsiderojnë gurin apo dërrasën, që janë trupa të ngurtë e pa jetë, të barabartë me All'llahun e Lartësuar; megjithatë, ky besim krejtësisht i gabuar nuk i pakëson asgjë pozitës së madhështisë së Tij.

---

[1] Fjala e parë e këtij ajeti *"subhàne"* – *"i pastër nga të metat"* sipas thënies së disa interpretuesve të Kur'ànit Famëlartë dhe letrarëve, është emër i përveçëm, por emri i përveçëm herë thuhet për njerëz dhe në këtë rast quhet emër i njeriut, herë tjetër thuhet për llojin dhe quhet emër i llojit, herë tjetër thuhet për kuptimin dhe në këtë rast quhet emër kuptimi. Bazuar mbi këtë shpjegim gjuhësor, rezulton se fjala *"subhàne"* është në kuptimin e dëlirjes së All'llahut të Lartësuar nga çdo e metë e nevojë, gjithashtu është në kuptimin e madhërimit të Tij; është në kuptimin e dëlirjes prej të metave e prej nevojave dhe që është në përshtatje të thuhet vetëm për Krijuesin. Sipas rregullave të gjuhës arabe, emri i përveçëm i bashkëngjitet vetëm emrit të kuptimit. Disa të tjerë, kanë thënë se fjala *"subhàne"* ka edhe një kuptim rrënjë foljeje dhe konsiderohet kundrinor i drejtë vlerësues në të gjitha mënyrat, çka shpjegon qartë dëlirjen e All'llahut nga të gjitha të metat e nevojat dhe e përforcon kuptimin e dëlirjes me të gjitha anët e rrugët e përforcimit.

Patjetër që All'llahu i Lartësuar s'ka nevojë ta dëlirë askush nga të metat e nga mangësitë, por kjo dëlirje e Tij me fjalën *"subhàne"*, është vetëm një mësimdhënie për njerëzit dhe që të jetë për ata program pune që i fut ata në rrugën e plotësimit.

Në lidhje me qëllimin e fjalës *"ezvàxh"* – *"çifte"* në këtë ajet, në mesin e interpretuesve të Kur'ànit ka shumë thënie:

Por thënia që është pranuar në lidhje me këtë qëllim, është se fjala *"ezvàxh"* – *"çifte"* është shumësi i fjalës *"zeuxh"* – *"çift"*. Zakonisht, fjala *"zeuxh"* – *"çift"* thuhet për gjininë mashkullore dhe për gjininë femërore të çdo lloji, qoftë lloji prej botës së kafshëve, ose prej llojeve të tjera. Më pas, në këtë kuptim janë përfshirë të gjitha llojet që janë të krahasueshëm me njëri-tjetrin, qoftë edhe kur janë të kundërta, madje edhe dy dhomave në një shtëpi u thuhet *"zeuxh"* – *"çift"* gjithashtu, kjo fjalë përdoret për të treguar dy fletët e portës dhe të sendeve të tjera çift; me një fjalë, të gjitha krijesave u thuhet *"zeuxh"* – *"çift"*.

Në të gjitha gjendjet, nuk mund të përjashtohet që me këtë koncept, qëllimi këtu të jetë për një kuptim të veçantë, domethënë për gjininë mashkullore dhe për gjininë femërore. Kur'àni Famëlartë, me këtë ajet njofton për ekzistencën e dukurisë së çiftit në botën e bimësisë, në njeriun dhe në qeniet e tjera për të cilat njeriu nuk ka dijeni.

Këto qenie mund të jenë bimësia dhe dihet sa të shumta janë çiftet në llojet e ndryshme të bimëve, aq sa është e pamundur të dihet prej njeriut, madje në kuptimin e çiftit përfshihen edhe kafshët detare, që jetojnë në thellësi të detrave. Kjo e vërtetë,

patjetër që nuk dihej në të kaluarën, madje edhe në kohën e sotme, prej këtyre qenieve njihen fare pak lloje.

Gjithashtu, ka mundësi që me këtë fjalë të jenë qëllim edhe qenie të tjera, që banojnë në planete e në yje të tjerë që janë në këtë Gjithësi pa anë e pa fund, ose mund të jetë qëllimi për qenie të cilat nuk mund të shihen me sy pa mjetet zmadhuese edhe pse shkencëtarët në ditët tona shprehen se ka lloje qeniesh të gjalla që s'janë as mashkull e as femër; por bota e këtye qenieve të gjalla nuk është e qartë dhe është aq komplekse, sa dituria njerëzore deri tani nuk i ka zgjidhur të gjitha gjërat e paqarta dhe përbërësit e këtyre qenieve.

Edhe ekzistenca e çiftit në botën e bimëve - siç thamë - nuk njihej në kohën e zbritjes së Kur'ànit, përveçse në disa gjendje të kufizuara, si, për shembull, në pemën e hurmës e të ngjashme me hurmën. Kur'àni Famëlartë e ngriti këtë perde padituriе dhe në kohët e fundit, studimet shkencore kanë vërtetuar se çifti është një çështje e përgjithshme në botën bimore.

Gjithashtu, ka mundësi që çështja e çiftit të jetë një shenjë edhe për ekzistencën e protoneve me ngarkesë pozitive dhe të elekroneve me ngarkesë negative në atom, i cili konsiderohet baza për formimin e trupave në botën e materies; mirëpo njeriu nuk kishte asnjë dijeni për të vërtetën e ekzistencës së çiftit para ndarjes të atomit, por, pasi u realizua ndarja e atomit, u vërtetua shkencërisht ekzistenca e çiftit negativ-pozitiv edhe në atom: bërthama dhe elektronet që rrotullohen rreth bërthamës së atomit.

Të tjerë e konsiderojnë çiftin si një tregues të përbërjes së sendeve prej "materies" dhe "formës", ose "thelbit", ose "rastësisë"; të tjerë, kanë thënë se çifti është metaforë, që tregon

“speciet dhe llojet e ndryshme” të bimëve, njerëzve, kafshëve dhe të gjitha qenieve të Botës.

Është e qartë se, kur s’kemi mundësi t’i mbartim këto fjalë në kuptimin e vërtetë (gjinia mashkull e gjinia femër), nuk gjejmë dot shembull krahasues për të kundërshtuar këtë mendim, prandaj s’ka asnjë motiv që t’u përgjigjemi kuptimeve metaforike. Shpesh e kemi theksuar në disa komentime të bukura çështjen e çiftit, në kuptimin e vërtetë që ka kjo fjalë.

Si do që të jetë edhe vetëm ky ajet i Kur’ànit, pa përmendur ajete të tjera, shpjegon qartë kufirin e dijes njerëzore dhe argumenton se ka edhe shumë të vërteta që deri tani janë të panjohura për dituritë tona.

Ajetet: 37 - 40

وَءَايَةٌ لَّهُمُ ٱلَّيۡلُ نَسۡلَخُ مِنۡهُ ٱلنَّهَارَ فَإِذَا هُم مُّظۡلِمُونَ ﴿٣٧﴾ وَٱلشَّمۡسُ
تَجۡرِى لِمُسۡتَقَرٍّ لَّهَا ۚ ذَٰلِكَ تَقۡدِيرُ ٱلۡعَزِيزِ ٱلۡعَلِيمِ ﴿٣٨﴾ وَٱلۡقَمَرَ قَدَّرۡنَٰهُ
مَنَازِلَ حَتَّىٰ عَادَ كَٱلۡعُرۡجُونِ ٱلۡقَدِيمِ ﴿٣٩﴾ لَا ٱلشَّمۡسُ يَنۢبَغِى لَهَآ أَن
تُدۡرِكَ ٱلۡقَمَرَ وَلَا ٱلَّيۡلُ سَابِقُ ٱلنَّهَارِ ۚ وَكُلٌّ فِى فَلَكٍ يَسۡبَحُونَ ﴿٤٠﴾

"Argument për ata është edhe nata, prej të cilës Ne nxjerrim ditën dhe ata mbesin në errësirë."

"Edhe Dielli ecën nëpër rrugën e caktuar për atë, ky është caktimi i Fuqiplotit, të Gjithëditurit."

"Edhe për Hënën Ne kemi caktuar pozicione (faza)**, deri sa bëhet në formën e harkut** (si bistaku i tharë i frutit të hurmës)**."**

"As Dielli nuk e arrin Hënën dhe as nata nuk e parakalon ditën; çdo gjë në Gjithësi noton."

Komentimi

Ajetet objekt studimi flasin për pjesën e fundit të argumenteve që dëshmojnë madhështinë e fuqisë së All'llahut në botën e ekzistencës; njëkohësisht, në këto ajete flitet për argumente që vërtetojnë Njëtimin e All'llahut (Teuhidin), që u shpalosën edhe në ajetet e mëparshme në lidhje me ngjalljen e tokës së vdekur dhe rritjen e bimëve e të pemëve.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, thotë: **"Argument për ata është edhe nata, prej të cilës Ne nxjerrim ditën dhe ata mbesin në errësirë."**.

Fjala e ajetit *"neslekhu"*, në rrënjën e saj *"selekha"*, do të thotë: *"rjepja e lëkurës së kafshës"*. Kjo shprehje, në vetvete në këtë ajet vjen në një mënyrë të zbukuruar, që tregon se drita e ditës është si një rrobë e bardhë mbi trupin e natës, por kjo rrobë e bardhë hiqet me perëndimin e Diellit, çka bën që të merret vesh ngjyra vetiake e dritës. Nëse do të mendojmë me kujdes në këtë shprehje, do të shikojmë se këtu bëhet e qartë e vërteta se errësira është natyra bazë e globit të Tokës dhe se drita e ndriçimi janë cilësi të ardhura që vijnë mbi Tokë prej një vendburimi tjetër dhe nga kjo pikëpamje, dita është si rroba që vishet dhe kur kjo rrobë hiqet prej trupit, atëherë del sheshit ngjyra natyrore e trupit.

Në këtë ajet, Kur'àni Famëlartë, duke e vënë theksin mbi errësirën e natës, thotë se, pas shpalosjes në ajetet e mëparshme të argumentit të ngjalljes së tokës së vdekur, si njërin prej argumenteve që vërtetojnë fuqinë e All'llahut të Lartësuar, tani

shpalos një model të vdekjes pas jetës nëpërmjet dukurisë së ndërrimit të ditës me errësirën e natës.

Në të gjitha gjendjet, kur njeriu vazhdon të jetë në errësirën e natës dhe kujton dritën, në këtë gjendje ai mendon për begatitë që vijnë për atë prej dritës, mendon për veprimtarinë që zhvillohet ditën, mendon edhe për burimin e dritës dhe me një përsiatje të thjeshtë, njeriu mëson se kush është Krijuesi i dritës dhe i errësirës.

Ajeti vijues i grupit të ajeteve objekt studimi, troket në çështjen e dritës e të ndriçimit, duke përmendur Diellin dhe thotë: **"Edhe Dielli ecën nëpër rrugën e caktuar për atë."**.

Ky ajet shpjegon qartë lëvizjen e vazhdueshme të Diellit, por cili është qëllimi me këtë lëvizje? Në mesin e interpretuesve të Kur'ànit, në lidhje me çështjen e lëvizjes së Diellit, qarkullojnë disa thënie:

Disa kanë thënë se kjo lëvizje e përmendur në ajet tregon lëvizjen e dukshme të Diellit rreth Tokës dhe kjo lëvizje e Diellit do të vazhdojë deri në fundin e Botës, që shënon edhe fundin e jetës së vetë Diellit.

Të tjerë, kanë thënë se "lëvizja" tregon animin e Diellit në verë e në dimër në drejtim të veriut e të jugut, në mënyrë të gërshetuar. Ne dimë se Dielli anohet nga vija e lëvizjes së tij nga ana e veriut në fillim të pranverës, për të hyrë në rrethin e 23 gradëve në veri dhe me fillimin e gjysmës së verës, kthehet pak dhe hyn përsëri në orbitën e tij normale në fillim të vjeshtës, por duke e vazhduar orbitën e lëvizjes së tij në drejtim të jugut, deri në fillimin e stinës së dimrit dhe pas dimrit, Dielli hyn në linjën e

lëvizjes së tij ekuatoriale, deri në fillim të pranverës. Është interesante se të gjitha këto lëvizje rrjedhin prej rrotullimit të Tokës rreth Diellit dhe nga animi i boshtit të rrotullimit të Tokës gjatë rrotullimit të saj, por neve na duket se lëviz Dielli.

Të tjerë e kanë konsideruar këtë ajet një shenjë që tregon lëvizjen lokale të Diellit në rrotullimin e tij rreth vetes. Studimet e dijetarëve, kanë vërtetuar në mënyrë taksative se Dielli rrotullohet rreth vetes së tij.

Interpretimi më i fundit e më i ri që i është bërë këtij ajeti, është përfundimi në të cilin kanë arritur dijetarët gjatë kohëve të fundit: Dielli, së bashku me sistemin e tij, lëviz në një drejtim të përcaktuar në kuadrin e lëvizjes së galaktikës. Dijetarët kanë shpjeguar se sistemi diellor është vetëm një pjesëz e galaktikës sonë, madje është thënë se Dielli ecën në drejtim të një yllësie shumë të largët, të cilën e kanë emërtuar me emrin yllësia "Vega".

Të gjitha këto kuptime që u theksuan, nuk janë në kundërshtim njëri me tjetrin dhe ka mundësi që fjala e ajetit "*texhrij*" – "*ecën*" tregon të gjitha këto kuptime, madje edhe kuptime të tjera, që shkenca ende nuk ka arritur t'i zbulojë, por që do të zbulohen në të ardhmen.

Në të gjitha gjendjet, lëvizja e rruzullit të Diellit, vëllimi i të cilit është dyqind mijë herë më i madh se vëllimi i rruzullit të Tokës, bën një lëvizje të përpiktë e të organizuar në hapësirën pa anë e pa fund dhe këtë lëvizje kaq të përpiktë nuk e përcakton dot askush, përveç All'llahut të Gjithëfuqishëm, sepse fuqia dhe dituria e All'llahut qëndron mbi të gjitha fuqitë dhe mbi të gjitha

dituritë; pikërisht për të theksuar këtë të vërtetë, ajeti, në fundin e tij, shton: **"ky është caktimi i Fuqiplotit, të Gjithëditurit"**.

Në interpretimin e fundit të bërë mbi këtë ajet, thuhet: ky ajet tregon rrugën e Diellit nëpër yllësitë e ndryshme yjore dhe ky sistem, nga ana e tij, i jep jetës së njeriut një ligj e një program të përcaktuar, që rezulton në organizimin e në sistemimin e jetës së tij nga të gjitha anët.

Ajeti vijues flet për lëvizjen e Hënës dhe për fazat e Hënës, të cilat mundësojnë përcaktimin e ditëve e të muajit. Me këtë shpjegim, ajeti plotëson studimin e sipërm dhe thotë: **"Edhe për Hënën Ne kemi caktuar pozicione** (faza)**, deri sa bëhet në formën e harkut** (si bistaku i tharë i frutit të hurmës)**."**.

Qëllimi me fjalën e ajetit *"menàzile"*- "pozicione" janë njëzet e tetë nivelet (fazat) nëpër të cilat kalon Hëna para se të hyjë në errësirë të plotë, pasi Hëna mund të shihet në kupën e Qiellit deri ditën e njëzet e tetë, megjithëse edhe në këtë ditë shohim vetëm një disk të zbehur, shumë të hollë, të Hënës dhe me ngjyrë të verdhë. Ditën e njëzet e tetë, drita e Hënës është e pakët dhe me ndiçim shumë të dobët, kurse në natën e njëzet e nëntë dhe në natën e tridhjetë, Hëna nuk shihet fare, prandaj këtyre dy netëve u thuhet pozicioni i errët. Kur muaji hënor është me njëzet e nëntë ditë, kjo renditje fillon qysh natën e njëzet e shtatë, që më pas Hëna do të hyjë në errësirën e plotë.

Këto pozicione (faza) të Hënës, janë të llogaritura me hollësi, çka u ka mundësuar astronomëve, qysh prej qindra vitesh, të kenë mundësi të llogarisin me përpikmëri fazat e Hënës.

Ky sistem mahnitës, nga njëra anë sistemon jetën e njeriut dhe nga ana tjetër është një kalendar qiellor natyror, për të cilin njeriu nuk ka nevojë të mësojë shkrim e lexim që të ketë mundësi të ndjekë këtë kalendar; kjo do të thotë se çdo njeri, me pak intuitë e me pak përqendrim të vëmendjes, ka mundësi të marrë vesh gjendjen e Hënës gjatë netëve të ndryshme dhe vetëm me një shikim, ka mundësi të caktojë me përpikmëri, ose afërsisht, se në cilën natë të muajit është Hëna.

Natën e parë, Hëna e re del me dritë të dobët dhe me majat e harkut të drejtuara lart; me kalimin e netëve, disku i Hënës vjen duke u zmadhuar natë pas nate dhe në natën e shtatë plotësohet gjysma e diskut të Hënës së re; pastaj vazhdon shtimi apo mbushja e Hënës, derisa, natën e katërmbëdhjetë, plotësohet disku i plotë i Hënës; në këtë natë Hëna quhet "Hënë e plotë", pastaj gradualisht fillon "ngrënia" e diskut të plotë dhe kjo "ngrënie" e dytë e Hënës vazhdon deri natën e njëzet e tetë. Në këtë natë, Hëna është "ngrënë" deri sa ka marrë formën e një disku shumë të hollë, por kësaj here majat e diskut të Hënës janë të kthyera nga poshtë.

Po, këto sisteme formojnë bazën e jetës së njeriut. Në të vërtetë, sisteme pa përcaktim të përpiktë është e pamundur të ketë, prandaj All'llahu i Lartësuar e ka vënë në kupën e Qiellit këtë kalendar të përpiktë për muajt e për vitet.

Pasi ajeti shpalosi format dhe pozicionet e Hënës, bëhet fare i qartë edhe kuptimi i fjalisë së fundit të këtij ajeti, në të cilin i Larti njofton gjendjen e Hënës: **"deri sa bëhet në formën e harkut** (si bistaku i tharë i frutit të hurmës)**."**.[1]

[1] Në lidhje me fjalën e ajetit *"urxhùn"*, interpretuesit e Kur'ànit dhe gjuhëtarët kanë thënë se kjo fjalë, në rrënjën e saj do të thotë: harkim dhe kthesë lakore; të

Në të vërtetë, bistaku i hurmës së pjekur ngjan nga disa anë me Hënën e vjetër: ngjan nga forma harkore dhe nga ngjyra e verdhë e venitur, me dy majat e ulura nga poshtë, si dhe nga qenia e bistakut të hurmës në mes një errësire të shkaktuar prej degëve të gjelbra e të dendura të drurit të hurmës dhe nga kjo pikëpamje, ngjan me Hënën në qiellin e errët.

Cilësimi i bistakut të hurmës me fjalën *"el kadijm"* – *"tregon bistakun e vjetër"*, i cili, sa më shumë kohë të kalojë, aq më i dobët bëhet dhe aq më e zbehtë bëhet ngjyra e tij e verdhë; po kështu ndodh edhe me Hënën, kur ajo hyn në zonën e errët.

I Gjithëfuqishmi, të Cilit nuk i mungon asgjë dhe s'ka nevojë për asgjë, vetëm në një shprehje kaq të shkurtër ka futur këtë dukuri astronomike me bukuri mahnitëse.

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve objekt studimi, flet për qëndrueshmërinë dhe për vazhdimësinë e këtij sistemi, me muajt, me vitet, me ditën e me natën dhe i Gjithëfuqishmi, për të gjitha këto dukuri, ka vënë një sistem e program që nuk lejon të ndodhë në të as çartjen e as shmangien më të vogël në gjendjen e në lëvizjen e të gjithë elementeve të këtij sistemi të përkryer dhe me këtë i Larti e ka bërë historinë e Njerëzimit të qëndrueshme, në formën më të plotë, ashtu siç njofton ajeti: **"As Dielli nuk e arrin Hënën dhe as nata nuk e parakalon ditën; çdo gjë në Gjithësi noton."**.

---

tjerë mendojnë se kjo fjalë, në rrënjën e saj *"arxhene"*, do të thotë: bistaku që mban frutat e pjekur të hurmës dhe që bashkohet me degën e drurit të hurmës. Ky kuptim krahasues thuhet për Hënën për shkak se bistaku i hurmës së pjekur ka formë të harkuar, ka ngjyrë të verdhë dhe qëndron i varur në pemën e hurmës; kurse fjala tjetër e ajetit *"kadijm"*, është në kuptimin i vjetër, domethënë bistakut që i ka mbaruar koha.

Dihet se Dielli, gjatë ecjes në orbitën e tij vjetore, kalon nëpër dymbëdhjetë yllësi, në një kohë që Hëna të gjitha fazat e saj i përshkon brenda një muaji dhe bazuar mbi këtë shpjegim, rezulton se shpejtësia e lëvizjes së Hënës është më e madhe se shpejtësia e lëvizjes së Diellit, të cilit i duhet të përshkojë nëpër dymbëdhjetë yllësitë, prandaj ajeti thotë se Dielli me lëvizjen e tij s'ka mundësi të arrijë Hënën në lëvizjen e saj, që ajo bën brenda një muaji, kurse Dielli rrugën e tij e përshkon gjatë një viti të plotë.

Gjithashtu, as nata nuk e parakalon ditën, domethënë që një pjesë e natës nuk mund të hyjë në ditën, ndryshe do të prishej sistemi ekzistues, prandaj nata e dita, gjatë miliona vitesh, vijnë njëra pas tjetrës, në mënyrë të gërshetuar, pa as më të voglin ndryshim.

Këtu bëhet e qartë ajo që thamë në këtë studim, se ne e kuptojmë lëvizjen e Diellit me anë të shqisës së shikimit, por këtu tërheq vëmendjen fakti se kjo shprehje kur'anore në lidhje me lëvizjen e Diellit vazhdon të përdoret edhe pasi është vërtetuar për të gjithë se Dielli është qendra rreth të cilës rrotullohet Toka; për shembull, thuhet: Dielli është në yllësinë e Dashit; ose thuhet: Dielli arriti në rrethin e gjysmës së ditës; ose thuhet: Dielli u anua plotësisht, pasi kaloi në pikën më të lartë veriore të gjysmës së globit tokësor në fillim të verës, ose thuhet e kundërta për uljen e Diellit deri në pikën më të ulët në fillim të dimrit.

Të gjitha këto shprehje, vazhdojnë të përdoren edhe pas zbulimit të bërë në lidhje me rrotullimin e Tokës rreth Diellit, megjithëkëtë, këto shprehje për lëvizjen e Diellit vazhdojnë të qarkullojnë ndër njerëzit, sepse shqisa jonë e shikimit kap lëvizjen

e Diellit, kurse në tokën mbi të cilin njeriu shkel, i krijohet ndjenja se toka nuk lëviz dhe ka stabilitet; pikërisht për shkak të kësaj cilësie që kanë njerëzit, vazhdojnë të përdoren këto shprehje në lidhje me lëvizjen e Diellit, por All'llahu i Lartësuar, me fjalën e Tij njofton se: **"çdo gjë në Gjithësi noton"**.

Ka mundësi që, me fjalën *"jesbehùne"* - *"noton"*, qëllimi të jetë lëvizja e Diellit në orbitën e tij, ose lëvizja që bën Dielli së bashku me planetet e tij në galaktikën tonë. Shkenca e ditëve tona, ka vërtetuar se sistemi diellor, në të cilin ne jetojmë, është një pjesëz e galaktikës së madhe, e cila, nga ana e saj, gjithashtu rrotullohet. Fjala e ajetit *"felekin"*, siç thonë gjuhëtarët më në zë, është në kuptimin: rritja dhe rrumbullakosja e gjirit të vajzës; më pas kjo fjalë është përdorur për të treguar pjesët e lakuara të Tokës si dhe për të treguar sendet e tjera me formë të rrumbullakët dhe nga ky këndvështrim, kjo fjalë është përdorur për të treguar udhëtimin orbital të trupave qiellorë.

Në lidhje me fjalinë: **"çdo gjë në Gjithësi noton"**, shumë interpretues të Kur'ànit besojnë se me këtë shprehje, qëllimi është Dielli, Hëna dhe yjet e tjerë. Të gjithë këta trupa qiellorë, përveç rrotullimit në orbitën e vet, kanë edhe rrotullim rreth vetvetes edhe pse në fjalët e ajetit nuk janë përmendur yjet e tjerë, por, duke vështruar me kujdes, do të shikojmë se fjala *"el lejl"* – *"nata"* është përmendur pranë Hënës e Diellit, prandaj nuk është larg as kuptimi i lartpërmendur, sidomos kur vetë fjala *"jesbehùne"* ka ardhur në numrin shumës.

Gjithashtu, ka mundësi që kjo fjali të tregojë Diellin, Hënën, natën dhe ditën, sepse edhe nata e dita kanë rrotullim specifik dhe rrotullohen rreth Tokës me përpikmëri: errësira

gjithmonë mbulon gjysmën e globit tokësor, ndërsa drita mbulon gjysmën tjetër të globit, domethënë se nata e dita ndërrojnë vendet njëra me tjetrën gjatë njëzet e katër orëve dhe kështu, të dyja plotësojnë rrotullimin e plotë rreth Tokës.

Fjala e ajetit *"jesbehùn"*, në rrënjën e saj *"sebahatun"*, siç thotë Ràgibi në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", është në kuptimin: ecje e shpejtë në ujë e në ajër dhe me këtë kuptim është huazuar si fjalë, për të treguar lëvizjen e yjeve në Gjithësi, por kuptimi origjinal i fjalës mbetet gjithnjë: ecje e shpejtë, nxitim për të adhuruar All'llahun, prandaj në këtë ajet kemi një shenjë për lëvizjen e shpejtë të trupave qiellorë; madje ajeti i përngjason trupat qiellorë me qeniet me arsye, të cilat vazhdimisht janë në lëvizje. Tani është vërtetuar se trupat qiellorë lëvizin në hapësirë me shpejtësi shumë të madhe.

Hulumtime

1- Lëvizja rrotulluese dhe lëvizja e gjatë e Diellit

Fjala *"ed'deveràn"* thuhet për lëvizjen rrotulluese, ndërsa fjala *"el xherejàn"* thuhet për lëvizjen lineare; thuhet edhe për rrjedhën e lumit. Këtu të tërheq vëmendjen fakti se në ajetet objekt studimi flitet për të dyja llojet e lëvizjeve të Diellit dhe ajeti njofton: **"Edhe Dielli ecën"** dhe pastaj thotë: **"çdo gjë në Gjithësi noton"**.

Në kohën e zbritjes së ajeteve të Kur'ànit, rrethet shkencore i përmbaheshin teorisë së Ptolemeut, që thotë se trupat qiellorë nuk kanë lëvizje rrotulluese dhe se brendësia e trupave qiellorë përbëhet prej porcelani të grumbulluar në shtresa të qëndrueshme, njëra shtresë mbi shtresën tjetër dhe se lëvizja e tyre ndjek lëvizjen e yjeve të veta; me fjalë të tjera, në atë kohë nuk kishte kuptim të flitej fare për lëvizjen e gjatë të Diellit (lëvizja e Diellit në orbitën e vet).

Më pas, nën dritën e zbulimeve të realizuara gjatë shekujve të fundit, kur u shembën themelet mbi të cilat ishte ndërtuar supozimi i Ptolemeut, atëherë trupat qiellorë u "çliruan" nga prangat e përbërjes së tyre prej "porcelani" dhe nën dritën e këtyre zbulimeve, u vërtetua teoria se Dielli është qendra e sistemit diellor, se ky sistem është i qëndrueshëm dhe se të gjithë planetet e sistemit diellor rrotullohen rreth Diellit.

Gjithashtu, ajetet e këtij grupi ajetesh, në kohën e zbritjes nuk ishin të kuptueshme as në lidhje me lëvizjen e Diellit nëpër rrugën e tij të gjatë dhe as në lidhje me lëvizjen e tij rrotulluese, derisa këtë të vërtetë kur'anore e vërtetoi shkenca me përparimin e arritur gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, kur u vërtetua se Dielli bën disa lëvizje:

Lëvizja lokale e Diellit, domethënë lëvizja e Diellit rreth vetes.

Lëvizja e gjatë e Diellit është lëvizja që bën Dielli së bashku me sistemin diellor në drejtim të një pike të përcaktuar në Qiell.

Dielli bën lëvizje rrotulluese së bashku me galaktikën tonë dhe me këtë vërtetohet edhe një mrekulli tjetër shkencore e Kur'ànit.

Për të shpjeguar më qartë këtë çështje, do të citojmë atë që është shkruar në njërën prej enciklopedive rreth lëvizjes së Diellit:

"Dielli ka një lëvizje të dukshme dhe një tjetër reale. Dielli bën lëvizjen e tij të dukshme të përditshme: Dielli lind në anën lindore të gjysmës së globit të Tokës, ku ne jetojmë dhe vazhdon "ecjen" në drejtim të anës jugore, deri në gjysmën e ditës dhe pastaj perëndon në anën perëndimore. Ecja e Diellit pas fillimit të mesit të ditës, shënon kohën e vërtetë të mesditës, që vazhdon derisa Dielli fillon të anohet në kupën e Qiellit.

Dielli gjithashtu ka edhe një lëvizje tjetër të dukshme, ka lëvizjen e tij vjetore rreth Tokës, duke u afruar nga ana lindore nga një gradë për çdo ditë. Në këtë lëvizje, Dielli kalon në çdonjërën prej yllësive, vetëm një herë çdo vit, domethënë se rrugën e kësaj lëvizjeje Dielli e shkruan mbi "fletën" e yllësive. Kjo lëvizje është me rëndësi shumë të madhe për shkencën e astronomisë, pasi dukuria e ekuinokseve, dukuria e solsticit dhe dukuria e animit të përgjithshëm të Diellit, të gjitha këto dukuri të Diellit janë objekt i punës së shkencës së astronomisë dhe pasi në bazë të këtyre dukurive bëhet llogaritja e vitit diellor".

Përveç kësaj lëvizjeje të dukshme, Dielli bën edhe një lëvizje rrotulluese në galaktikë. Shpejtësia rrotulluese e Diellit në hapësirë është e barabartë me një milion e njëqind e tridhjetë mijë kilometër në orë! Por kjo lëvizje e Diellit në galaktikë nuk është statike, pasi Dielli rrotullohet edhe me shpejtësi të barabartë

afërsisht me shtatëdhjetë e dy mijë kilometër në orë, kur kalon pranë yllësisë së quajtur "burri i përkulur në gjunjë"[1].

Padituria jonë për këtë lloj lëvizjeje të Diellit, ka të bëjë me largësinë e madhe të trupave qiellorë dhe është kjo largësi që na pengon të specifikojmë këto lëvizje të Diellit.

Lëvizja rrotulluese e Diellit rreth vetes zgjat afërsisht njëzet e pesë ditë, së bashku me netët[2].

2- Dy shprehjet "texhrij" - "ecën" dhe "sabiku" - "parakalon"

Shprehjet kur'anore janë përdorur me hollësinë më të madhe, aq sa është e pamundur të dihen të gjitha përmasat e kuptimeve të shprehjeve kur'anore. Ajetet objekt studimi flasin për lëvizjen e dukshme të Hënës e të Diellit, gjatë "ecjes" së tyre mujore dhe vjetore, ashtu siç e lexojmë në ajetin vijues: **"As Dielli nuk e arrin Hënën"**; domethënë se Hëna e përfundon ecjen në orbitën e saj gjatë një muaji, kurse Dielli e përfundon ecjen në orbitën e tij brenda një viti të plotë.

Ndërsa, kur ajeti flet për natën, thotë: **"dhe as nata nuk e parakalon ditën"**, nuk e parakalon, për shkak se mes natës e ditës s'ka kohë ndarëse, por nata e dita gërshetohen njëra me tjetrën.

---

[1] "Burri i përkulur në gjunjë" është një grup yjesh (yllësi), që kanë formën e një burri të përkulur në gjunjë dhe pikërisht prej kësaj forme ka marrë këtë emër.

[2] Dielli, brenda njëzet e pesë ditëve tona bën vetëm një rrotullim rreth vetes. Kjo çështje është specifikuar në saje të vrojtimeve që kanë bërë dijetarët nëpër sektorë të ndryshëm të sipërfaqes qiellore. Në saje të këtyre vrojtimeve, është vënë re ndërrimi i pozicioneve të Diellit dhe brenda kësaj kohe Dielli rikthehet në pozicionin fillestar.

Siç shihet, shprehjet kur'anore tregojnë shkallën më të lartë të hollësive.

3- Sistemi i dritës dhe errësirës në jetën e njerëzve

Ajetet objekt studimi shpalosin dy prej çështjeve më të rëndësishme që kanë lidhje me jetën e njerëzve dhe që në fakt janë dy argumente prej argumenteve të All'llahut të Lartësuar; këto dy argumente janë: errësira e natës dhe Dielli me dritën e tij.

Më sipër, kemi thënë se drita e Diellit është dhurata më e madhe e me më shumë begati për qeniet e botës lëndore, jo vetëm për ndriçimin e për jetën tonë, por edhe çdo lëvizje e çdo veprimtari ka lidhje me dritën e Diellit; rënia e pikave të shiut, rritja e bimëve, çelja e gonxheve, pjekja e frutave, fëshfërima e degëve, shtrimi i tryezës së ngrënies me llojet e ndryshme të ushqimeve, madje deri lëvizja e mekanizmave të makinave të mëdha nëpër fabrika, prodhimi i energjisë elektrike dhe llojet e prodhimeve industriale, të gjitha këto në origjinën e tyre kanë si bazë këtë burim të madh energjie, dritën e Diellit.

Me fjalë të shkurtëra, të gjitha energjitë në sipërfaqen e Tokës, me përjashtim të energjisë që përftohet nga zbërthimi i atomit, të gjitha energjitë e tjera ekzistojnë në saje të dritës së Diellit dhe sikur të mos ekzistonte kjo e fundit, në çdo vend do të kishte vetëm heshtje e vdekje.

Megjithëse errësira e natës të kujton vdekjen dhe asgjësimin, në të vërtetë errësira konsiderohet prej dukurive jetësore më të rëndësishme në jetën e njeriut, sepse errësira e natës

rregullon dritën e Diellit dhe ka ndikim të thellë në qetësimin e trupit e të shpirtit të njeriut, ndalon rrezet e shumta që vijnë nga drita e vazhdueshme dhe e pandërprerë e rrezeve të Diellit; nëse nata nuk do të vinte pas ditës, patjetër që shkalla e nxehtësisë do të ngrihej shumë në sipërfaqen e Tokës, madje do të ngrihej aq shumë, sa të gjitha sendet do të merrnin flakë e do të digjeshin. Kështu ndodh edhe me dritën e Hënës, me natën e ditët e saj të gjata (çdo natë atje është afërsisht pesëmbëdhjetë ditë e net që janë në Tokë, e njëjtë është gjendja në raport edhe me ditën); pra, nëse nuk do të ishte ndërthurja ditë-natë, do të kishim ose nxehtësi vrastare, ose ngricë të plotë.

Bazuar mbi këtë shpjegim, rezulton se, qoftë drita, qoftë errësira, çdonjëra në vetvete është një argument i madh hyjnor.

Veç kësaj, sistemi kaq i hollësishëm e i përpiktë natë-ditë, ka çuar në sistemimin e historisë njerëzore. Nëse nuk do të ekzistonte kjo histori, patjetër do të ishte asgjësuar lidhja shoqërore dhe jeta njerëzore do të ishte e ngjashme me të pamundurën; prandaj, si drita, ashtu edhe errësira, janë dy argumente hyjnorë.

Gjithashtu, këtu tërheq vëmendjen fakti se Kur'àni Famëlartë thotë: **"dhe as nata nuk parakalon ditën"**. Kjo shprehje kur'anore tregon se dita është krijuar para natës dhe nata është krijuar plotësisht pas ditës. Nëse dikush do të vrojtonte jashtë globit tokësor, patjetër do të shihte dy dukuri bardhë e zi që rrotullohen në mënyrë të sistemuar rreth Tokës; veç kësaj, në këtë lëvizje rrethore natë-ditë, nuk është e mundur të përfytyrohet as para e as prapa; por, nëse marrim në konsideratë se Toka në të cilën ne jetojmë, ka qenë një pjesë prej Diellit, rezulton se në atë

kohë kishte vetëm ditë dhe nata nuk ekzistonte. Pas shkëputjes së globit tokësor prej Diellit dhe pasi Toka u largua prej tij, në Tokë u formua një hije në formë konike, nga ana e kundërt e Diellit dhe kështu nata filloi të lëvizë pas ditës. Po, sikur ne të shikojmë në të gjitha këto dukuri, patjetër do të bëhej edhe më e qartë lartësia e kësaj shprehjeje kur'anore.

Siç kemi thënë edhe më sipër, nuk janë vetëm vetëm Dielli e Hëna që lëvizin në Gjithësinë pa anë e pa fund, por janë edhe nata e dita që lëvizin rreth globit tokësor dhe qoftë Dielli, qoftë Hëna, kanë orbitën përkatëse të rrotullimit.

Në disa transmetime të ardhura me rrugët e Ehli Bejtit, thuhet se All'llahu i Lartësuar e krijoi ditën para natës. Në një transmetim të gjatë të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojnë se ai, në përgjigje të një pyetjeje, ka thënë: "*Po, dita është krijuar para natës dhe Dielli, Hëna e Toka janë krijuar para Qiellit.*".[1]

Në një transmetim të ardhur prej Imamit Rizait *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë se ai ka thënë: "*dita u krijua para natës*" dhe në fjalën e të Lartit: **"As Dielli nuk e arrin Hënën dhe as nata nuk parakalon ditën"**, tregohet qartë se dita e ka parakaluar natën.[2]

Një transmetim tjetër, me të njëjtin kuptim, ka ardhur prej Imam Bàkirit *(Paqja qoftë mbi të!)*, në të cilin lexojmë se ai ka thënë: "*All'llahu i Gjithëfuqishëm e krijoi Diellin para Hënës dhe krijoi dritën para errësirës.*".[3]

---

[1] Tefsiri "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 387.
[2] Burimi i sipërm.
[3] Burimi i sipërm.

Ajetet: 41 - 44

وَءَايَةٌ لَّهُمْ أَنَّا حَمَلْنَا ذُرِّيَّتَهُمْ فِى ٱلْفُلْكِ ٱلْمَشْحُونِ ﴿٤١﴾ وَخَلَقْنَا لَهُم مِّن
مِّثْلِهِۦ مَا يَرْكَبُونَ ﴿٤٢﴾ وَإِن نَّشَأْ نُغْرِقْهُمْ فَلَا صَرِيخَ لَهُمْ وَلَا هُمْ يُنقَذُونَ
﴿٤٣﴾ إِلَّا رَحْمَةً مِّنَّا وَمَتَٰعًا إِلَىٰ حِينٍ ﴿٤٤﴾

"Argument për ata është se Ne i mbartëm pasardhësit e tyre (pasardhësit e Ademit) **në anijen e mbushur."**

"Dhe për ata Ne krijuam një të ngjashme që ata i hipin."

"Sikur të duam, Ne i mbysim ata dhe për ata s'ka as ndihmues e as nuk shpëtojnë."

"Përveçse mëshirë nga ana Jonë dhe të gëzojnë të mira deri në një kohë të caktuar."

Komentimi

Lëvizja e anijeve në detra, është një argument hyjnor

Megjithëse disa interpretues të Kur'ànit si Kurtubij'ji, e kanë konsideruar ajetin e parë të ajeteve objekt studimi si ajetin më të ndërlikuar e më të vështirë të ajeteve të kësaj sureje, duhet thënë se, vetëm me një shikim të vëmendshëm e të hollësishëm në lidhjen e këtyre ajeteve me ajetet e përparme, bëhet plotësisht e qartë se në këto ajete s'ka asnjë ndërlikim. Ajetet e përparme flisnin për argumentet që vërtetojnë fuqinë e Filluesit të çdo krijese, flisnin për krijimin e Diellit, Hënës, natës e ditës, si dhe për krijimin e Tokës, me të gjitha begatitë që jep Toka; kurse në ajetet objekt studimi, Filluesi i çdo krijese flet për detrat dhe për një pjesë të mirësive të mëdha që vijnë prej detrave, flet për lëvizjen e anijeve tregtare, turistike etj., mbi sipërfaqen e detrave.

Veç kësaj, lëvizja e anijeve nëpër oqeane, nuk është larg të ngjasohet me lëvizjen e trupave qiellorë në hapësirën e Gjithësisë.

Për të gjitha këto, ajeti i parë i këtij grupi ajetesh thotë: **"Argument për ata është se Ne i mbartëm pasardhësit e tyre** (pasardhësit e Ademit) **në anijen e mbushur."**.

Përemri *"lehum"* – *"për ata"*, nuk u adresohet vetëm idhujtarëve të Mekës, por u adresohet të gjithë njerëzve për të cilët flitet në ajetet e përparme.

Fjala e ajetit *"dhurr'rrij'jetun"* – *"pasardhës"* ashtu siç shpjegon Ràgibi në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", se kjo fjalë në rrënjën e saj është në kuptimin e

fëmijëve të vegjël, por zakonisht përdoret njëherësh për të vegjël e për të mëdhenj, përdoret për numrin njëjës e për numrin shumës.

Ajeti përmend mbartjen e pasardhësve të tyre dhe ka mundësi që, përmendja e pasardhësve ka të bëjë me faktin se fëmijët kanë më shumë nevojë se të tjerët për të hipur mbi këtë mjet hipjeje të shpejtë, duke ditur se të rriturit janë më të përgatitur për të ecur më këmbë gjatë brigjeve të detrave dhe nëpër rrugë, për të shkuar nga njëri vend në një vend tjetër.

Veç kësaj, kjo shprehje është më afër për të vënë në lëvizje ndjenjat e tyre.

Fjala e ajetit *"mesh'hùn"* – *"e mbushur"* tregon se anija nuk mbart vetëm ata, por mbart edhe mallrat që ata tregtojnë, sendet e tyre vetiake dhe çdo gjë tjetër që atyre u intereson.

Ajo që kanë thënë disa interpretues të Kur'ànit se fjala e ajetit *"el fulku"* – *"anija"*, tregon anijen e Nùhut *(Paqja e All'llahut qofshin mbi të!)* si dhe për fjalën *"dhurr'rrij'jetun"* – *"pasardhës"* thonë se kjo fjalë në rrënjën e saj *"dhere'e"* është në kuptimin *"Ai (All'llahu) krijoi"*, duket një thënie shumë e largët.

Në të gjitha gjendjet, lëvizjet e anijeve të të gjitha llojeve, tregojnë se anijet janë mjetet më të mëdha e më të rëndësishme për transport që ka në përdorim njeriu, ose tregon anijet që njeriu mund të ndërtojë në të ardhmen. Dihet se kapaciteti mbartës i anijeve është mijërafish më i madh se barra që mund të mbartin mjetet e tjera të transportit; por duhet theksuar se, energjia që i vë në lëvizje anijet, qoftë era, qoftë avulli, karburantet, apo energjia atomike, të gjitha llojet e energjive All'llahu i Lartësuar i ka vënë në dispozicion të njeriut, secilën më vete, ose të gjitha së bashku,

por edhe kjo është një argument prej argumenteve të All'llahut, që vërteton se të Gjithëfuqishmit nuk i mungon asgjë e nuk ka nevojë për asgjë.

Dhe që të mos mendohet se anija është i vetmi mjet mbartës që i ka dhënë All'llahu njeriut, ajeti vijues shton: **"Dhe për ata Ne krijuam një të ngjashme që ata i hipin."**.

Mjetet e hipjes që ecin në Tokë, det dhe ajër, mbartin njerëzit dhe sendet e tyre.

Disa interpretues të Kur'ànit, **"mjetin e hipjes"** që përmendet në këtë ajet e kanë kanë reduktuar vetëm në devenë, e cila është quajtur "anija e shkretëtirës"; të tjerë kanë thënë se kjo fjalë e ajetit përfshin të gjitha kafshët e hipjes e të ngarkesës; të tjerë e kanë interpretuar me aeroplanin dhe me anijet hapësinore të shpikura në kohën tonë dhe kanë thënë se fjala e ajetit *"khaleknà"* – *"Ne krijuam"* i përfshin të gjitha mjetet e hipjes, duke marrë në konsideratë se, materialet me të cilat janë punuar këto mjete, janë krijuar më përpara. Gjithësesi, forma e pakushtëzuar me të cilën ka ardhur kjo fjalë, i jep këtij ajeti një kuptim shumë të gjerë dhe nga ky këndvështrim, kuptimi i këtij ajeti përfshin të gjitha llojet e mjeteve të hipjes e të transportit, madje edhe ato që deri tani akoma nuk janë ndërtuar.

Në disa ajete të Kur'ànit, shpeshherë ka ardhur lidhja në mes fjalës *"el en'àm"* - *"kafshë shtëpiake"* dhe *"el fulk"* - *"anije"*, si, për shembull, në fjalën e të Lartit në ajetin 12 të sures "Ez Zukhruf": **"Dhe Ai bëri për ju anijet e kafshët që ju i hipni"**; si dhe në ajetin 80 të sures "Gàfir": **"dhe mbi ato** (kafshët) **e mbi anijet ju ngarkoni"**.

Gjithësesi, këto ajete nuk e mohojnë kuptimin përgjithësues të ajetit objekt studimi.

Për të shpjeguar më qartë këtë mirësi kaq të madhe, ajeti vijues, duke përmendur gjendjen që do të krijohej nga ndryshimi i kësaj mirësie, thotë: **"Sikur të duam, Ne i mbysim ata dhe për ata s'ka as ndihmues e as nuk shpëtojnë."**.

Domethënë: Ne nxjerrim urdhërin Tonë të lëshohet një dallgë e madhe dhe ajo e përmbys anijen e tyre; ose Ne urdhërojmë vetëm një vorbull deti dhe ajo i përpin ata; ose me urdhërin Tonë tufani i qëllon ata me dallgë nga të gjitha anët; kur Ne duam, kemi mundësi të heqim cilësinë e veçantë të ujit, prishim rregullin e fryrjes së erës, qetësimin e detit, apo gjëra të tjera me të cilat Ne e bëjmë trazimin cilësi të përgjithshme që çon në shkatërrimin e çdo sendi; por Ne e ruajmë këtë sistem ekzistues, që ata të përfitojnë prej tij. Nëse, herë pas here, ndodhin ngjarje të kësaj natyre, kjo është që atyre t'u tërhiqet vëmendja për rëndësinë e madhe që ka për njerëzit kjo mirësi kaq e rëndësishme.

Fjala e ajetit *"sarijkh"*, në rrënjën e saj *"sarkh"* është në kuptimin e thirrjes për të kërkuar ndihmë, kurse fjala tjetër e ajetit *"junkadhùne"*, në rrënjën e saj *"nekadhe"*, është në kuptimin e shpëtimit nga vorbulla e ujit.

Dhe për të plotësuar bisedën, ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh shton: **"Përveçse mëshirë nga ana Jonë dhe të gëzojnë të mira deri në një kohë të caktuar."**.

Patjetër, ata nuk mund të shpëtojnë me çfarëdo mjeti, përveçse me mëshirën e me dashamirësinë Tonë ndaj atyre.

Në lidhje me fjalën e ajetit *"hijnin"*, disa kanë thënë: Kjo fjalë është në kuptimin kohë dhe ajeti i sipërm tregon se erdhi koha e mbarimit të jetës së njeriut; të tjerë kanë thënë se kjo fjalë tregon fundin e të gjithë Botës.

Njerëzit që kanë hipur në anije, pavarësisht nga lloji e përmasat e anijes, e kuptojnë thellësinë e kuptimit të këtij ajeti, pasi edhe anija më e madhe në Botë, në mesin e dallgëve të mëdha të detit dhe furisë së tufanit që shpërthen nëpër oqeane, është si një fije kashte dhe sikur të mos ishte mëshira Gjithëpërfshirëse e All'llahut, në mënyrë absolute për asnjërin prej atyre nuk do të kishte rrugë shpëtimi.

All'llahu i Lartësuar, me këtë fije peri të hollë që është në mes vdekjes e jetës, ka qëllim të shfaqë fuqinë e Tij të madhe për të mirën e njeriut, pasi mbase edhe ata që kanë hequr dorë prej udhëzimit në rrugën e të vërtetës, mund të kthehen te e vërteta, mund të kthehen te All'llahu dhe të ecin në rrugën e drejtë të Kur'ànit.

Ajetet: 45 – 47

وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ ٱتَّقُواْ مَا بَيۡنَ أَيۡدِيكُمۡ وَمَا خَلۡفَكُمۡ لَعَلَّكُمۡ تُرۡحَمُونَ ﴿٤٥﴾ وَمَا تَأۡتِيهِم مِّنۡ ءَايَةٖ مِّنۡ ءَايَٰتِ رَبِّهِمۡ إِلَّا كَانُواْ عَنۡهَا مُعۡرِضِينَ ﴿٤٦﴾ وَإِذَا قِيلَ لَهُمۡ أَنفِقُواْ مِمَّا رَزَقَكُمُ ٱللَّهُ قَالَ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ لِلَّذِينَ ءَامَنُوٓاْ أَنُطۡعِمُ مَن لَّوۡ يَشَآءُ ٱللَّهُ أَطۡعَمَهُۥٓ إِنۡ أَنتُمۡ إِلَّا فِي ضَلَٰلٖ مُّبِينٖ ﴿٤٧﴾

"Dhe kur atyre u thuhej ruhuni prej asaj që ngjet para syve tuaj e prej asaj që do të ngjasë me ju, pasi kështu do të mëshiroheni."

"S'ka ndonjë argument që u erdhi atyre prej Zotit të tyre dhe që ata të mos i kenë kthyer shpinën."

"Dhe kur atyre u thuhej shpenzoni prej asaj që u ka dhënë All'llahu, jobesimtarët u thoshin besimtarëve: mos duhet të ushqejmë njeriun të cilin sikur të donte All'llahu e ushqente atë; me të vërtetë ju jeni në një humbje të qartë."

Komentimi

Kundërshtimi i të gjitha argumenteve të All'llahut

Ajetet e përparme flisnin për argumentet hyjnorë në botën e ekzistencës, kurse ajetet objekt studimi flasin për kundërpërgjigjen e mohuesve, të cilët i kundërshtuan me kokëfortësi e ashpërsi të hapur argumentet e All'llahut; gjithashtu, këto ajete shpjegojnë qartë se Profeti *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* jo vetëm që u bënte atyre thirrjen që të besonin në kumtin që ai kumtonte, por njëkohësisht edhe i paralajmëronte për dënimin e dhimbshëm të All'llahut.

Ky grup ajetesh fillon me fjalën e të Lartit: **"Dhe kur atyre u thuhej ruhuni prej asaj që ngjet para syve tuaj e prej asaj që do të ngjasë me ju, pasi kështu do të mëshiroheni."**.[1]

Në mesin e interpretuesve të Kur'ànit, qarkullojnë disa thënie në lidhje me kuptimin e frazës së ajetit *"mà bejne ejdijkum"* – *"prej asaj që ngjet para syve tuaj"* dhe të frazës vijuese të këtij ajeti *"ue mà khalfekum"* – *"prej asaj që do të ngjasë me ju"*. Prej këtyre thënieve rendisim: qëllimi me frazën e parë janë dënimet në këtë botë dhe modele të këtyre dënimeve u përmendën në ajetet e përparme; kurse qëllimi me frazën e dytë janë dënimet në Botën e Ardhshme. Duket sikur ajeti u thotë atyre: dënimet i keni nga pas dhe që ende nuk kanë rënë mbi ju, por shumë shpejt do të vijë

[1] Fraza e ajetit **"Dhe kur atyre u thuhej…"**, siç mësohet prej ajetit vijues, është fjali kushtore me kushtin e hequr dhe vlerësimi është: "dhe kur atyre u thuhej… ata i kthenin shpinën argumentit që u vinte".

dita kur do të gjendeni të rrethuar prej këtyre dënimeve. Përsa i përket qëllimit me fjalën e ajetit *"it'tekù"* – *"ruhuni"* do të thotë ruhuni prej këtyre dënimeve, ruhuni që të mos bëni të atilla punë që e bëjnë të detyrueshme që mbi ju të bien këto dënime. Argumenti për këtë është se fjala *"it'tekù"* – *"ruhuni"* në ajetet e Kur'ànit ka ardhur kur përmendet All'llahu i Gjithëfuqishëm, ose kur përmenden Dita e Kiametit dhe dënimet hyjnore.

Përmendja e fjalës *"it'tekù"* – *"ruhuni"* në dy rastet që u thanë, janë dy anët e një të vërtete të vetme, atëherë kuptimi është: ruajtja prej zemërimit të All'llahut është ruajtje prej dënimeve të Tij.

Ky argument, vë në dukje se ky ajet e vë theksin mbi ruajtjen prej dënimit të All'llahut në këtë botë dhe prej dënimit të Tij në Botën e Ardhshme.

Këto interpretime janë e kundërta e asaj që është thënë në interpretimin e parë, pasi fraza **"prej asaj që ngjet para syve tuaj"**, do të thotë: "dënimet në Botën e Ardhshme", sepse Bota e Ardhshme është ajo që e kemi përpara; kurse fraza tjetër: **"prej asaj që do të ngjasë me ju"**, do të thotë: dënimi në këtë botë (Ky interpretim nuk ndryshon shumë nga interpretimi i parë nga ana e rezultateve).

Të tjerë kanë thënë se qëllimi me frazën **"para syve tuaj"**, janë fajet e bëra më përpara dhe ruajtja prej atyre fajeve realizohet duke bërë teube e duke vënë në vend dëmet e bëra prej atyre fajeve; kurse me frazën **"prej asaj që do të ngjasë me ju"**, qëllimi është për fajet që bëhen në vijimësi.

Të tjerë mendojnë se me frazën **"para syve tuaj"**, qëllimi është për fajet që bëhen sheshit, kurse me frazën **"ajo që do të ngjasë me ju"**, qëllimi janë fajet që sjellin mendimet e brendshme dhe fajet që bëhen në fshehtësi.

Të tjerë kanë thënë se fraza **"para syve tuaj"**, tregon llojet e dënimeve në këtë botë dhe fraza **"ajo që do të ngjasë me ju"**, tregon vdekjen, por dihet se prej vdekjes askush nuk mund të ruhet.

Të tjerë, si autori i tefsirit "Fij Dhilàlil Kur'àn", këto dy fraza i konsiderojnë të barazvlershme të punëve që e bëjnë të detyrueshme zbritjen e zemërimit e të dënimit të All'llahut, që do të rrethojë mohuesit nga të gjitha anët.

Kurse El Alùsij'ji, në tefsirin e tij "Ruhul Meanij" dhe Fakhru Ràzij në tefsirin "El Kebijr", kanë përmendur disa mundësi interpretimi, një pjesë prej të cilave ne i përmendëm më sipër.

Dijetari poliedrik Et Tàbàtàbaij, në tefsirin e tij "El Mijzàn", mendon se fraza **"para syve tuaj"**, tregon vënien shok All'llahut në adhurim (shirk) dhe mëkatet e bëra në jetën e kësaj bote; kurse fraza **"ajo që do të ngjasë me ju"**, tregon dënimin në Botën e Ardhshme,[1] në një kohë që fjalët e ajetit tregojnë se të dyja frazat janë të njëllojta dhe në mes tyre ka vetëm një ndryshim kohor dhe jo se njëra frazë bën shenjë për vënien shok All'llahut në adhurim (shirk) dhe fraza tjetër bën shenjë për dënimet që do të bien mbi idhujtarët e mohuesit si rezultat i shirkut dhe fajeve.

[1] Tefsiri "El Mijzàn", vëll. 17, f. 66, fundi i ajeteve objekt studimi.

Në të gjitha gjendjet, interpretimi më i mirë i kësaj fjalie të ajetit, mbetet ajo që kemi thënë në fillim, pasi ajete të ndryshme të Kur'ànit dëshmojnë se, qëllimi me frazën **"para syve tuaj"**, janë dënimet në këtë botë dhe qëllimi me frazën **"prej asaj që do të ngjasë me ju"**, janë dënimet në Botën e Ardhshme.

Ajeti vijues e përforcon këtë kuptim, kur e vë theksin mbi kokëfortësinë e mohuesve dhe kundërshtimin që ata u kanë bërë e u bëjnë argumenteve të All'llahut dhe mësimeve të Profetëve *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*. Për këtë ajeti i nderuar thotë: **"S'ka ndonjë argument që u erdhi atyre prej Zotit të tyre dhe që ata të mos i kenë kthyer shpinën."**.

Te mohuesit nuk ndikojnë as argumentet shpirtërorë, as argumentet që shihen në botën e jashtme, as kërcënimi, as paralajmërimi dhe as përgëzimi për mëshirën hyjnore; mohuesit nuk e pranojnë mendimin logjik, nuk pranojnë as çështjen e ndjenjave, nuk pranojnë as natyrën e pastër të krijimit; me kundërshtimin e tyre, mohuesit e kanë vënë veten në sprovë me një verbëri të plotë, madje aq e madhe është verbëria e tyre, sa nuk kanë mundësi të shohin as sendet që kanë afër vetes dhe nga kjo verbëri mohuesit nuk bëjnë dot dallim as në mes errësirës së natës dhe Diellit të mesditës.

Në vijim, Kur'àni Famëlartë klasifikon burimet e mllefit e të kundërshtimit të tyre dhe thotë: **"Dhe kur atyre u thuhej shpenzoni prej asaj që ju ka dhënë All'llahu, jobesimtarët u thoshin besimtarëve: mos duhet të ushqejmë njeriun të cilin sikur të donte All'llahu e ushqente atë; me të vërtetë ju jeni në një humbje të qartë."**.

Pas kësaj logjike të dobët janë kapur e kapen egoistët e kopracët, në të gjitha kohët e shekujt dhe thonë: filani u bë i varfër për shkak të një pune që bëri dhe ajo punë e çoi atë në varfëri, ashtu siç jemi ne të pasur për shkak të një pune që kemi bërë, prandaj ne jemi të përfshirë në butësinë e në mëshirën e All'llahut dhe shtojnë se as varfëria e atij filanit, as fakti që ne jemi të pasur, nuk është pa ndonjë urtësi; por ata e anashkalojnë faktin se kjo botë, në të vërtetë është vendi ku njerëzit vihen në sprovë e merren në provim; All'llahu i Gjithëfuqishëm disa i sprovon me varfëri, disa të tjerë i provon me pasuri; mbase All'llahu i Lartësuar e vë njeriun në dy kohë të ndryshme në bankën e provimit: me pasurimin dhe me varfërinë, pastaj shikon nëse në gjendje varfërie a e kreu njeriu amanetin që i është lënë, a ndihet i kënaqur e me karakter të fortë dhe a kalon nëpër etapat e falënderimit, që duhet të bëjë në të gjitha gjendjet, apo i nëpërkëmb të gjitha këto, pa menduar fare? Edhe në gjendje pasurimi, i Larti e vë në provë njeriun dhe sheh nëse është bujar dhe jep prej asaj që atij i ka dhënë All'llahu, apo është koprac dhe nuk jep?

Disa interpretues të Kur'ànit, e kanë reduktuar kuptimin e këtij ajeti dhe kanë thënë se ky ajet gjen zbatim vetëm për një bashkësi të vetme, si, për shembull, në jehuditë, ose në idhujtarët e Mekës, ose në të gjithë ateistët, që kanë mohuar të gjitha fetë hyjnore; por duket se ajeti ka një kuptim përgjithësues dhe është kriter vërtetues në çdo shekull e në gjitha kohët edhe nëse në kohën e zbritjes së ajetit kuptimi i ajetit vërtetohej vetëm në jehuditë e në idhujtarët. Në të vërtetë, ajeti është një kriter i përgjithshëm, me të cilin përngjasohen të gjithë jobesimtarët, e të gjitha kohërave, të cilët thoshin: kur All'llahu është furnizuesi me

ushqim, përse doni që ne të ushqejmë të varfërit me pasurinë tonë? Nëse All'llahu do t'i shohë të varfërit të privuar, përse doni prej nesh që të pasurojmë njeriun të cilin All'llahu ka dashur që ai të jetë i varfër? Këta të pasur, janë krejtësisht të shkujdesur për të menduar se sistemi i krijimit mund të bëjë të detyrueshëm një send, në një kohë që sistemi ligjor bën të detyrueshëm një send tjetër, të ndryshëm nga i pari.

Me vullnetin e All'llahut, sistemi i krijimit bëri që Toka, me të gjitha begatitë e saj, të jetë në dispozicion të njerëzve; gjithashtu, ishte vullneti i All'llahut që t'u japë njerëzve lirinë e zgjedhjes së punëve që bëjnë në rrugën e plotësimit të tyre; në të njëjtën kohë, All'llahu i Lartësuar krijoi në njeriun edhe instinktet, që i kundërvihen njeriut nga të gjitha anët.

Sistemi ligjor bën të detyrueshëm zbatimin e ligjeve të veçanta; këto ligje kërkojnë që njeriu të sundojë mbi instinktet; njëkohësisht, ky sistem ligjor shërben për të edukuar shpirtrat e njerëzve, për të edukuar njeriun nëse ai do të ndjekë rrugën e përvetësimit, apo do të ndjekë rrugën e sakrificës, të tolerancës dhe të dhënies nga pasuria që ka. Njeriu ka kapacitet dhe përgatitje për të qenë mëkëmbësi i All'llahut në Tokë, por këtë pozitë të lartë, njeriu e arrin me anën e rrugës që urdhëron sistemi ligjor: me dhënien e zekatit pastrohen shpirtrat, me shpenzimin për të varfërit, prej zemrave hiqet kopracia, realizohet barazia dhe pakësohen ndarjet klasore, të cilat sjellin mijëra punë të liga e shkatërrime, në të gjitha shoqëritë.

Kjo është plotësisht sikur dikush të thotë: përse studiojmë? Ose: përse ne të mësojmë dikë tjetër? Sikur të donte All'llahu i Lartësuar, patjetër që do t'u kishte dhënë dituri të gjithëve dhe

kështu nuk do të ishte nevoja që ne të mësojmë, apo të mësojmë të tjerët. A mund të pranohet kjo logjikë?![1]

Fraza e ajetit **"jobesimtarët thoshin",** ka ardhur për të theksuar në mënyrë të veçantë cilësinë e mohimit, në një kohë që ishte e mjaftueshme kjo frazë të vinte edhe me përemër, por, me këtë mënyrë ardhjeje, ajeti tregon se burimi i kësaj logjike mitike dhe të gabuar të mohuesve, në të vërtetë është mohimi i tyre.

Ndërsa gjendja reale e besimtarëve, shprehet me fjalët që ata u thonë jobesimtarëve: **"shpenzoni prej asaj që ju ka dhënë All'llahu"**. Kjo fjalë e besimtarëve tregon se Zotëruesi origjinal është vetëm All'llahu i Gjithëfuqishëm, është Ai që s'ka nevojë për asnjë send e që nuk i mungon asgjë, por dijeni se këto pasuri janë lënë amanet në duart tona e në duart tuaja vetëm për fare pak kohë. Sa kopracë u treguan e tregohen ata që nuk ishin e nuk janë të gatshëm të zbatojnë urdhërin e Zotëruesit të pasurisë për të transferuar te të tjerët një pjesë fare të vogël të pasurisë që u është dhuruar?!

Në lidhje me frazën e ajetit: **"me të vërtetë ju jeni në një humbje të qartë"**, janë shtruar tri mundësi interpretimi:

[1] Disa interpretues të Kur'ànit, janë shprehur edhe për mundësinë vijuese të interpretimit të këtij ajeti: "arabët e asaj kohe ishin të përmendur për mikpritjen e tyre dhe nuk ngurronin të shpenzonin për mikpritjen; por mohuesit kishin qëllim të vinin në lojë besimtarët, të cilët besojnë se të gjitha punët janë vetëm prej All'llahut, prandaj mohuesit, për t'u talluar me besimtarët, u thoshin atyre: kur All'llahu i Lartësuar do që të bëjë të pasur të varfërit, përse duhet të shpenzojmë ne?! Duket se, interpretimi që sollëm më sipër, është më i përshtatshëm (Referohu në tefsirin "Et Tibjàn; në tefsirin e Kurtubij'jit dhe në tefsirin "Rùhul Meànij").

E para: është plotësim i fjalës që u thanë mohuesit besimtarëve.

E dyta: është fjala me të cilën All'llahu i Lartësuar u drejtohet mohuesve.

E treta: është plotësim i fjalës që besimtarët u thanë mohuesve.

Por interpretimi i parë, është më në përshtatje me kuptimin e fjalëve të ajetit dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me fjalën e mëparshme të mohuesve. Në të vërtetë, jobesimtarët duan t'i trajtojnë besimtarët me të njëjtën mënyrë dhe t'i fusin ata në rrugën e humbjes së qartë.

Ajetet: 48 - 53

وَيَقُولُونَ مَتَىٰ هَٰذَا ٱلْوَعْدُ إِن كُنتُمْ صَٰدِقِينَ ﴿٤٨﴾ مَا يَنظُرُونَ إِلَّا
صَيْحَةً وَٰحِدَةً تَأْخُذُهُمْ وَهُمْ يَخِصِّمُونَ ﴿٤٩﴾ فَلَا يَسْتَطِيعُونَ تَوْصِيَةً
وَلَآ إِلَىٰٓ أَهْلِهِمْ يَرْجِعُونَ ﴿٥٠﴾ وَنُفِخَ فِى ٱلصُّورِ فَإِذَا هُم مِّنَ ٱلْأَجْدَاثِ
إِلَىٰ رَبِّهِمْ يَنسِلُونَ ﴿٥١﴾ قَالُوا۟ يَٰوَيْلَنَا مَنۢ بَعَثَنَا مِن مَّرْقَدِنَا ۜ هَٰذَا مَا
وَعَدَ ٱلرَّحْمَٰنُ وَصَدَقَ ٱلْمُرْسَلُونَ ﴿٥٢﴾ إِن كَانَتْ إِلَّا صَيْحَةً
وَٰحِدَةً فَإِذَا هُمْ جَمِيعٌ لَّدَيْنَا مُحْضَرُونَ ﴿٥٣﴾

“Dhe ata thonë: nëse jeni të vërtetë, kur do të ndodhë ky premtim?”

“Ata nuk janë në pritje të ndonjë gjëje tjetër veçse të një britme të vetme, e cila i asgjëson ata kur janë duke u grindur në mes tyre.”

“Dhe ata nuk do të kenë mundësi as të lënë ndonjë porosi e as të kthehen në familjet e tyre.”

“Dhe kur i fryhet ‘Surit’, ata menjëherë ngrihen prej varreve dhe nisen me shpejtësi për te Zoti i tyre.”

"Ata (mohuesit) **thonë: të mjerët ne, kush na ngriti prej aty ku ishim shtrirë? Kjo është ajo që kishte premtuar i Gjithëmëshirshmi dhe kishin vërtetuar të Dërguarit."**

"Ajo nuk është gjë tjetër, veçse një britmë e vetme dhe ata të gjithë menjëherë janë para Nesh."

Komentimi

Britma e Ringjalljes

Në ajetet e përparme u përmend logjika e zbrazët dhe pretekstet e sajuara që nxirrnin mohuesit në lidhje me çështjen e shpenzimit, kurse ajetet objekt studimi njoftojnë si talleshin mohuesit me Ditën e Kiametit, kur, me logjikën e tyre të gabuar e të pabazuar në argumente, përgjigjeshin në formë të prerë për të mohuar ringjalljen pas vdekjes.

Gjithashtu, në këto ajete plotësohen studimet rreth Njëtimit të All'llahut (Teuhidit) dhe pastaj kalohet në studimin rreth çështjes së ringjalljes pas vdekjes.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh të nderuara, thotë: **"Dhe ata thonë: nëse jeni të vërtetë, kur do të jetë ky premtim?"**; me këtë pyetje provokuese, ata duan të thonë: kur ju s'keni mundësi të përcaktoni me saktësi kohën kur do të ndodhë Kiameti, kjo do të thotë se fjalët tuaja janë vetëm gënjeshtra.

Ajeti vijues i përgjigjet kësaj pyetjeje shpotitëse me një fjalë të prerë e të padiskutueshme dhe i njofton mohuesit se çështja e

Kiametit, për All'llahun e Lartësuar nuk është aspak një çështje e ndërlikuar apo problematike dhe ajeti thotë: **"Nuk janë në pritje të ndonjë gjëje tjetër veçse të një britme të vetme, e cila i asgjëson ata kur janë duke u grindur në mes tyre."**.

E gjitha ajo që do të ndodhë, është vetëm një britmë qiellore dhe është e mjaftueshme që vetëm kjo britmë të marrë shpirtrat e të gjithë njerëzve që kanë mbetur mbi sipërfaqen e Tokës dhe ata të mbeten aty ku janë, kështu merr fund jeta e tyre e mbushur me zhurma, me mëtime, me beteja e me luftëra. Pas kësaj britme dhe pas vdekjes së tyre, do të jetë një heshtje e plotë dhe në Tokë nuk do të dëgjohet as zë e as ndonjë shqetësim.

Në një hadith të ardhur prej të Dërguarit më të nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë fjalën e tij: *"Kiameti bëhet kur dy burra kanë hapur rrobat që kanë për të shitur dhe nuk arrijnë t'i palosin, për shkak se ndodh Kiameti; burri çon lugën e ushqimit pranë gojës së vet, por ushqimi nuk arrin në gojën e tij, për shkak se ndodh Kiameti; burri çon bagëtitë e tij pranë pellgut që të pinë ujë, por bagëtia nuk pinë dot, për shkak se ndodh Kiameti."*.[1]

Fraza e ajetit *"mà jendhurùne"*, këtu është në kuptimin: *"nuk do të presin"*. Ràgibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", shpjegon se fjala *"jendhurùne"*, në rrënjën e saj do të thotë: *"përqendrim i shikimit për të kuptuar e për të parë një send"*. Por, me këtë fjalë, qëllimi mund të jetë edhe mendimi rreth një sendi e shikimi me hollësi në atë send.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 4, f. 427. Ky hadith është përmendur me shumë pak ndryshim në fjalë edhe në tefsirin e Kurtubij'jit, në tefsirin "Rùhul Meànij", si dhe në tefsire të tjerë.

Gjithashtu, me këtë fjalë, qëllimi mund të jetë edhe dituria e marrë rreth një sendi, pas verifikimit e diagnostikimit të atij sendi dhe nga kjo pikëpamje, shikimi me vëmendje është pritje.

Fjala e ajetit *"sajhaten"*, është në kuptimin e ngritjes së zërit. Në rrënjën e saj kjo fjalë është në kuptimin e zërit të ngritur e të çjerrë dhe arabët këtë fjalë e përdorin për të treguar zërin që del kur çahet dërrasa, ose kur griset rroba; veç kësaj, arabët, në shprehjet e tyre thonë: në tokën e filanit lëshoi zë një pemë, kur pema zgjatet dhe ky "zë i pemës" duket kur shikuesi vëren gjatësinë e pemës, por në të vërtetë shikuesi këtë zë e ka nxjerrë vetë prej gojës së tij.

Fjala e ajetit *"jekhis'simùne"*, në rrënjën e saj *"khas'same"*, është në kuptimin: *"grindje"*.

Por, për çfarë grindeshin ata në mes tyre? Këtë çështje, ajeti nuk e përmend fare; megjithëkëtë, është e qartë se qëllimi me **"grinden në mes tyre"**, tregon grindjet e armiqësitë që njerëzit kanë në mesin e tyre për çështjet e kësaj bote dhe për çështje të tjera të jetesës. Disa të tjerë, mendojnë se grindja e tyre ka lidhje me çështjen e ringjalljes pas vdekjes. Mesa duket, kuptimi i parë është më i drejtë dhe është në përshtatje me fjalët e ajetit. Gjithësesi, mund të merret në konsideratë fakti që ajeti i përfshin të dy kuptimet, domethënë se nuk është larg që kuptimi të jetë për çdo lloj grindjeje e armiqësie në mes njerëzve.

Këtu duhet mbajtur shënim, se të gjithë përemrat në këtë ajet u referohen idhujtarëve të Mekës, të cilët, jo vetëm që dyshonin në lidhje me çështjen e Ringjalljes, por edhe talleshin me këtë çështje kur pyesnin: **"kur do të ndodhë ky premtim?"**.

Është pranuar se ajeti nuk ka qëllim vetëm ata idhujtarë, por kategorinë e tyre, kategorinë e njerëzve që nuk i kushtojnë vëmendje çështjes së Ringjalljes dhe nga kjo shkujdesje e plotë, ata në të vërtetë kanë vdekur, prandaj kurrë nuk do ta dëgjojnë atë britmë të fuqishme qiellore. (Mendo mirë në këtë çështje!)

Në të gjitha gjendjet, Kur'àni Famëlartë, me këtë shprehje të shkurtër e të vendosur, në të vërtetë ka qëllim të tërheqë vëmendjen e tyre dhe t'i njoftojë ata: në radhë të parë se ndodhja e Kiametit as nuk mund të parashikohet e as nuk mund të parandalohet, pasi do të ndodhë befasisht, në të ardhmen e afërt; së dyti, ndodhja e Kiametit nuk është ndonjë problem i koklavitur, që ata të grinden e të armiqësohen në mes tyre për këtë problem, pasi Kiameti do të jetë thjesht një britmë e vetme, prej të cilës ata vdesin në vend dhe çdo gjë në mbarë Botën merr fund.

Për të shpjeguar më qartë gjendjen e njerëzve që do të shohin Kiametin, i Larti, në ajetin vijues shton: **"Dhe ata nuk do të kenë mundësi as të lënë ndonjë porosi e as të kthehen në familjet e tyre."**.

Zakonisht, njeriu, kur pëson ndonjë aksident, ose kur e ndjen se po i afrohet vdekja, mundohet të arrijë në shtëpinë e tij që të jetë në mes njerëzve të familjes së vet dhe nxiton të bëjë punët që i ka lënë varur, u lë porosi fëmijëve të tij, ose atyre me të cilët ka lidhje, ose i lë porosi njeriut tek i cili ka besim, njëkohësisht miraton kryerjen e disa punëve të tjera.

Por, a i lë rast britma e fuqishme qiellore njeriut për të këtilla punë? Edhe sikur të hamendsojmë se dikujt i lë rast, a ka

mbetur ndokush gjallë që të dëgjojë porosinë e tij, ose të mblidhen fëmijët së bashku me nënën mbi shtratin e babait të tyre, që ta rrethojnë atë me ngohtësinë e zemrave dhe që ai të japë shpirt në qetësi e në siguri të plotë? Jo, kurrë, asnjëra nga këto që u përmendën nuk është e mundur të ndodhë pas asaj britme.

Në fjalët e këtij ajeti, vëmë re se pamundësia për të lënë porosi, në të vërtetë theksohet për të treguar se nuk do të ketë më kohë as edhe për porosinë më të vogël.

Në vijim, ajetet e këtij grupi ajetesh e vënë theksin mbi një fazë tjetër të jetës pas vdekjes dhe për këtë ajeti thotë: **"Dhe kur i fryhet 'Surit', ata menjëherë ngrihen prej varreve dhe nisen me shpejtësi për te Zoti i tyre."**.

Kockat e shkërmoqura, të bëra pluhur, riveshin rrobën e jetës, të gjithë njerëzit ngrihen prej varreve me formën njerëzore të plotë, që të jenë të pranishëm për të dhënë llogari në atë gjykatë frikësuese; ashtu siç vdiqën të gjithë vetëm nga një britmë e vetme, po ashtu do të ringjallen prej një britme të vetme. Vdekja e shpërbërja e trupave të tyre nuk janë pengesë para fuqisë së All'llahut të Lartësuar për të ringjallur njerëzit. Grumbullimi i njerëzve Ditën e Kiametit është i ngjashëm me grumbullimin e një njësie ushtarake me anë të rënies së një borie dhe të gjithë ushtarët ngrihen prej shtretërve ku janë shtrirë në gjumë; vetëm me një të rënë borieje, forcat ushtarake rreshtohen në formacionet përkatëse; po kaq e thjeshtë, por shumë e shumë më e shpejtë, do të jetë edhe ringjallja e njerëzve Ditën e Kiametit në raport me fuqinë e All'llahut të Lartësuar.

Fjala e ajetit *"exhdàth"*, është shumësi i fjalës *"xhedth"*, që do të thotë *"varr"*. Kjo shprehje e ajetit tregon qartë se ringjallja do

të jetë jo vetëm trupore, por edhe shpirtërore, gjithashtu, tregon se trupi i njeriut do të rindërtohet prej lëndëve që ishte ndërtuar në botën e Tokës.

Përdorimi i foljes *"nufikha" – "i fryhet"* në kohën e shkuar, tregon se kjo "fryrje" do të ndodhë pa asnjë dyshim; gjithashtu, tregon se rindërtimi i njeriut trup e shpirt, ka ndodhur realisht.

Fjala tjetër e ajetit *"jensilùne"*, në rrënjën e saj *"nesele"*, është në kuptimin e *"ndarjes prej një sendi"*. Ràgibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", shpjegon se fjala *"nesele"*, thuhet në kuptimin: u hoq qimja prej devesë, ose u hoq këmisha prej njeriut; gjithnjë prej fjalës *"nesele"*, është marrë edhe fjala *"neslun"*, - *"pasardhës"*, që i thuhet fëmijës, për shkak se fëmija është shkëputur prej babait të tij.

Fjala e të Lartit *"rab'bihim" – "Zoti i tyre"* u tërheq vëmendjen njerëzve dhe u thotë se përshkrimi i All'llahut me cilësitë e larta: Krijuesi, Sunduesi, Edukuesi janë pikërisht këto cilësi të larta të All'llahut të Lartësuar, të cilat e bëjnë të detyrueshme që, në Botën e Ardhshme, të ketë dhënie llogarie, të ketë libër të punëve dhe Ringjallje.

Në të gjitha gjendjet, prej ajeteve kur'anore mësohet se fundi i kësaj bote dhe fillimi i Botës së Ardhshme do të ndodhë me një lëvizje të ashpër dhe të paparashikueshme. Këtë çështje, me lejen e All'llahut, do ta trajtojmë në mënyrë të hollësishme gjatë komentimit të ajetit 68 të sures "Ez Zumer".

Ajeti vijues shton: **"Ata** (mohuesit) **thonë: të mjerët ne, kush na ngriti prej aty ku ishim shtrirë? Kjo është ajo që kishte**

premtuar i Gjithëmëshirshmi dhe kishin vërtetuar të Dërguarit.".

Patjetër që Dita e Kiametit është një ndodhi tmerruese, nga tmerri i ndodhive të Ditës së Kiametit njeriu trulloset deri në atë shkallë, sa i harron të gjitha mitet dhe gjërat e gabuara në të cilat ka besuar; në atë Ditë për njeriun s'ka asnjë mundësi veçse të pohojë të vërtetat qartë e saktë. Ajeti i nderuar i përshkruan varret si vende fjetjeje dhe ngritjen prej varreve, domethënë Ringjalljen, e përshkruan si ngjarje që do të ndodhë menjëherë pas **"fryrjes"**, ashtu siç e lexojmë në hadithin mjaft të përhapur: *"Ashtu siç flini do të vdisni dhe ashtu siç zgjoheni prej gjumit do të ringjalleni."*.

Në fillim, ata habiten që u ringjallën dhe pyesin njëritjetrin: kush na ngriti prej vendit ku ishim shtrirë? Por ata shumë shpejt kujtohen se Profetët e All'llahut kishin thënë vetëm të vërtetën kur u kishin premtuar për ardhjen e kësaj Dite, prandaj i përgjigjen vetvetes dhe thonë: **"Kjo është ajo që kishte premtuar i Gjithëmëshirshmi dhe kishin vërtetuar të Dërguarit"**; por, ah, për të zezën tonë, ne talleshim me të gjitha këto punë!

Kjo fjali është fundi i fjalës që do të thonë ndërmjet tyre mendjemëdhenjtë mohues për ringjalljen pas vdekjes. Disa interpretues të Kur'ànit, kanë thënë se kjo fjali është fjala e engjëjve, ose e besimtarëve, por kjo është në kundërshtim me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit dhe s'ka as pretekst e as domosdoshmëri për këtë interpretim, sepse në lidhje me pohimin e jobesimtarëve dhe atyre që mohojnë ringjalljen pas vdekjes në atë Ditë, nuk njoftohet vetëm në këtë ajet, pasi për këtë çështje flet edhe ajeti 97 i sures "El Enbijà": **"U afrua premtimi i vërtetë** (Dita e Kiametit) **dhe sytë e mohuesve mbetën të shtangur,** (dhe

ata thonë) **të mjerët ne, jo vetëm që kësaj nuk i kushtuam asnjë vëmendje, por ishim mizorë."**.

Në të gjitha gjendjet, fjala e ajetit *"merkad"* [1] – *"vendi ku shtrihet njeriu"* bën të qartë se, në botën e "Berzakhut", njerëzit ishin në një gjendje të ngjashme me gjumin e thellë; gjithashtu, në komentin e ajetit 100 të sures "El Mu'minùn" kemi thënë se gjendja në botën e "Berzakhut", për njerëzit që janë në mes besimit e mosbesimit, është e ngjashme me gjumin, ndërkohë që besimtarët, në botën e "Berzakhut" janë në pozita të larta dhe gëzojnë të gjitha mirësitë e All'llahut, kurse jobesimtarët dhe ata që e shpërfillnin Botën e Ardhshme dhe Ringjalljen, në botën e "Berzakhut" do ta shohin veten të flakur në zjarr.

Disa interpretues të Kur'ànit, kanë thënë se habia e madhe që shkakton Dita e Kiametit me ashpërsinë e saj, është aq e madhe, sa jobesimtarëve dënimi në botën e "Berzakhut" u duket i ngjashëm me gjumin, kundrejt asaj që u shohin sytë Ditën e Kiametit.

Pastaj, ajeti, për të shpjeguar më qartë se sa e shpejtë do të jetë "fryrja", thotë: **"Ajo nuk është gjë tjetër veçse një britmë e vetme dhe ata të gjithë menjëherë janë para Nesh."**.

Ringjallja e të vdekurve, ngritja e tyre prej varreve dhe dalja e tyre para gjykatës së drejtësisë së All'llahut, s'ka nevojë për më shumë kohë, ashtu siç nuk qe nevoja të kishte më shumë kohë pas "fryrjes" për vdekjen e tyre: britma e "fryrjes" së parë qe për

[1] Fjala *"merkad"*, herë vjen në kuptimin e emrit të vendit, herë tjetër na vjen në kuptimin e gjumit, domethënë vjen në kuptimin e rrënjës së fjalës.

vdekjen dhe britma e "fryrjes" së dytë është për Ringjalljen dhe sjelljen para gjykatës së drejtësisë hyjnore.

Përdorimi i shprehjes *"sajhaten"* – *"britmë"* dhe përforcimi i saj me shprehjen: **"e vetme"**, si dhe shprehja *"idhà"* - *"menjëherë"* në të tilla ajete, tregojnë se ndodhja do të jetë e menjëhershme dhe e paparashikueshme; kurse fraza e ajetit pas shprehjes *"idhà"* – *"menjëherë"*: **"ata të gjithë menjëherë janë para Nesh"**, që ka ardhur në trajtën e fjalisë emërore, është një argument që vërteton ndodhjen e shpejtë të kësaj pjese prej ngjarjeve të përgjithshme të Ditës së Kiametit.

Gjuha e vendosur që është përdorur në këto ajete, lë gjurmë të thella në zemrat e njerëzve dhe është sikur ajo britmë thotë: o njerëz, o ju kokrriza dheu të shpërndara, o ju kocka të bëra pluhur! Ngrihuni, ngrihuni dhe përgatituni për të dhënë llogari e për të marrë atë që keni merituar me punën tuaj! Sa fjalë të bukuara janë këto shprehje kur'anore dhe sa domethënëse janë paralajmërimet që shprehin fjalët e ajetit!

Ajetet: 54 – 58

فَٱلۡيَوۡمَ لَا تُظۡلَمُ نَفۡسٞ شَيۡـٔٗا وَلَا تُجۡزَوۡنَ إِلَّا مَا كُنتُمۡ تَعۡمَلُونَ ﴿٥٤﴾
إِنَّ أَصۡحَٰبَ ٱلۡجَنَّةِ ٱلۡيَوۡمَ فِي شُغُلٖ فَٰكِهُونَ ﴿٥٥﴾ هُمۡ وَأَزۡوَٰجُهُمۡ فِي ظِلَٰلٍ
عَلَى ٱلۡأَرَآئِكِ مُتَّكِـُٔونَ ﴿٥٦﴾ لَهُمۡ فِيهَا فَٰكِهَةٞ وَلَهُم مَّا يَدَّعُونَ ﴿٥٧﴾ سَلَٰمٞ
قَوۡلٗا مِّن رَّبّٖ رَّحِيمٖ ﴿٥٨﴾

“Sot askujt nuk i bëhet padrejtësi në asgjë dhe shpërblehen vetëm me ato që kanë punuar.”

“Banorët e Xhennetit sot përjetojnë gëzim.”

“Ata dhe bashkëshortet e tyre janë nën hije, të mbështetur në kolltukë.”

“Për ata në Xhennet ka fruta dhe për ata ka çfarë të kërkojnë.”

“Përshëndetje me ‘selam’, fjalë prej Zotit Mëshirëplotë.”

Komentimi

Banorët e Xhennetit përjetojnë gëzim

Me këto ajete, fillon studimi rreth mënyrës së llogaridhënies në sheshin e gjykimit dhe mbyllet me shkoqitjen e gjendjes së besimtarëve punëmirë dhe të gjendjes së mohuesve punëkëqij. Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, në frazën e tij të parë njofton: **"Sot askujt nuk i bëhet padrejtësi në asgjë."**.

Askujt nuk i pakësohet asgjë prej shpërblimit, gjithashtu askujt nuk i shtohet asgjë prej dënimit; atë Ditë, askujt nuk do t'i bëhet as padrejtësia më e vogël dhe mbi asnjë nuk do të ushtrohet asnjë lloj dhune, qoftë e vogël sa maja e gjilpërës.

Në vijim, ajeti, për të shpjeguar më qartë këtë të vërtetë, sjell një argument të gjallë për të vërtetuar atë që u tha në frazën e parë dhe thotë: **"…dhe shpërblehen vetëm me ato që kanë punuar."**.

Nga fjalët e ajetit, pa shikuar në ndonjë vlerësim të brendshëm, del qartë se ajeti ka qëllim t'u thotë njerëzve se shpërblimi për ju të gjithë është aq sa është shpërblimi për punët tuaja. A mund të ketë drejtësi më të mirë e më të lartë se kjo drejtësi?!

Thënë ndryshe, punët e mira dhe punët e këqija që ju keni bërë në këtë botë, do t`ju shoqërojnë edhe në Botën e Ardhshme; punët tuaja atje do të trupëzohen dhe do të jenë shoqërueset tuaja në të gjitha etapat e Botës së Ardhshme: do të jenë shoqërueset tuaja në sheshin e gjykimit dhe pas përfundimit të llogaridhënies.

Vallë, a mund të ketë ndonjë punë që ka bërë njeriu dhe ajo të kundërshtojë drejtësinë?

Vallë, a mund të jetë padrejtësi trupëzimi i punëve dhe shoqërimi që ato punë i bëjnë njeriut që i ka bërë ato punë?

Këtu kuptohet se s'ka kuptim të flitet për padrejtësi Ditën e Kiametit. Nëse në këtë botë është arritur që drejtësia të jetë realizuar për një farë kohe, padrejtësia ka ndodhur në më të shumtën e herëve dhe kjo ka ndodhur për shkak se punët në këtë botë nuk e shoqërojnë njeriun që i ka bërë.

Një grup interpretuesish të Kur'ànit, kanë thënë: fjalia e fundit e ajetit objekt studimi flet për mohuesit punëkëqij, për të cilët masa e dënimit do të jetë vetëm aq sa është e keqja e punëve që ata kanë bërë; por ky rregull nuk përfshin besimtarët, sepse All'llahu i Gjithëfuqishëm i shpërblen besimtarët me shumëfishin e shpërblimit që kanë punët e tyre të mira.

Duke mbajtur në shënim ato që do të vijnë më poshtë, ky përngjasim gjen zgjidhjen përkatëse; këtu flitet për drejtësi në marrjen e shpërblimit dhe për dënim vetëm aq sa është e keqja e punës që ai ka bërë. Gjithësesi, në gjykimin e All'llahut, për marrjen e shpërblimit sipas punës së bërë, s'ka asnjë kundërthënie; kur vullneti i All'llahut të Lartësuar është që t'u japë besimtarëve më shumë prej mirësive të Tij, domethënë se këtu kemi të bëjmë me çështjen: "kini mirësinë dhe merrni", kurse për dënimin kemi të bëjmë me çështjen: "kjo të takon".

Më pas, ajetet në vijim shpalosin njërën anë të shpërblimeve të mëdha për besimtarët dhe para çdo gjëje

theksojnë çështjen e sigurisë dhe të qetësisë që ata gëzojnë; për këtë, ajeti njofton: **"Banorët e Xhennetit sot përjetojnë gëzim."**.

Fjala e ajetit *"shugulin"* është në kuptimin e një gjëje nga e cila njeriu habitet dhe nuk i largon dot sytë prej asaj gjëje. Kjo habi njeriut i shkaktohet në çaste gëzimi dhe në çaste hidhërimi e brenge; por në ajetin objekt studimi, pas kësaj fjale menjëherë vjen fjala *"fàkihùne"*, që është shumësi i fjalës *"fàkihun"*, që do të thotë *"gëzim me të qeshura"*. Ky shpjegim na mundëson të përfundojmë se njeriu është i preokupuar me gëzimin e tij dhe asgjë nuk e largon nga ky gëzim; në ato çaste, njeriu nuk mendon as për ndonjë lloj shqetësimi, është krejtësisht i zhytur në gëzimin më të madh dhe përjeton lumturinë më të madhe, prandaj për atë nuk ka më vend për asgjë që mund të turbullojë sado pak gëzimin e tij, madje nga ky gëzim ai e harron edhe tmerrin që kaloi mbi njerëzinë Ditën e Kiametit dhe tmerrin që përfshiu njerëzit para gjykatës së drejtësisë së All'llahut, megjithëse njeriu e ka të pamundur t'i harrojë ato ndodhi, për faktin se ndodhitë e mëdha si ato që kaloi, patjetër që kanë lënë hijen e rëndë të brengës e të shqetësimit në zemrat e njerëzve; megjithëkëtë, fakti se tani ai është në mesin e mirësive të mëdha, bën që të harrohen edhe tmerret e Ditës së Gjykimit.[1]

Pas kësaj shpalosjeje të mirësisë së madhe, sigurisë e të qetësisë që në të vërtetë janë baza e të gjitha mirësive të tjera dhe kushti që mundëson të përfitohet prej të gjitha dhuratave e mirësive të All'llahut, ajeti kalon në përmendjen e mirësive të

[1] Ràgibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu el fàdil Kur'àn", shpreh mendimin se fjala *"fàkihetun"* thuhet për të gjitha llojet e frutave, kurse fjala *"fàkihun"* do të thotë: fjala më e dashur për njeriun dhe që ai nuk do gjë tjetër përveç asaj; kurse Ibni Mendhuri, në fjalorin e tij "Lisànul Arab", shpjegon se fjala *"fàkihun"* thuhet për njeriun e gëzuar.

tjera dhe i Larti, me fjalën e Tij njofton: **"Ata dhe bashkëshortet e tyre janë nën hije, të mbështetur në kolltukë."**.

Fjala e ajetit *"ezvàxh"* – *"bashkëshorte"* tregon për gruan që All'llahu do t'i japë besimtarit në Xhennet, ose për gruan besimtare që ishte bashkëshortja e tij në botën e Tokës.

Disa të tjerë, janë shprehur se fjala *"ezvàxh"* – *"bashkëshorte"* është në kuptimin: të ngjashme, ashtu siç thuhet në ajetin 22 të sures s"Es Sàffàt": **"Mblidhi ata që bënë padrejtësi dhe të ngjashmit me ata"**, por ky interpretim duket shumë i largët, për më tepër fjala e ajetit *"eràiki"*, që është shumësi i fjalës *"erijketun"*, ashtu siç shpjegojnë gjuhëtarët më në zë, do të thotë: atllaz i shtruar mbi krevatin.[1]

Fjala e ajetit *"dhilàl"* – *"hije"* tregon se pemët e Xhennetit bëjnë hije mbi kolltuqet dhe ndenjëset mbi të cilat rrinë besimtarët në Xhennet; ose tregon për hijet e pallateve të banorëve të Xhennetit. Të gjitha këto dukuri tregojnë për ekzistencën e Diellit edhe në Xhennet, por Dielli i Xhennetit nuk është diell që sjell mundim. Hijet që bëjnë pemët e Xhennetit mbi vendet ku rrinë banorët e Xhennetit, për ata janë më shumë gëzim dhe më shumë veprimtari.

Përveç kësaj, për banorët e Xhennetit ka edhe: **"Për ata në Xhennet ka fruta dhe për ata ka çfarë të kërkojnë."**.

Prej ajeteve të tjera të Kur'ànit, mësohet se frutat nuk janë ushqimi i vetëm për banorët e Xhennetit dhe kjo fjalë e ajetit tregon se frutat e Xhennetit kanë karaktersitika të veçanta dhe

[1] Fjalori "Lisànul Arab", fjalori "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", tefsiri i Kurtubij'jit, tefsiri "Rùhul Meànij" dhe tefsire të tjerë.

nuk janë si frutat e kësaj bote; gjithësesi, frutat janë ushqim me cilësitë më të larta për banorët e Xhennetit. Sipas specialistëve, frutat në botën e Tokës janë ushqimi me vlera më të larta ushqyese për njeriun.

Fjala e ajetit *"jed'deùne"- "kërkojnë"* domethënë se banorët e Xhennetit çdo gjë që kërkojnë, ose çdo gjë që duan të kenë, menjëherë e kanë atë gjë.

Dijetari poliedrik Et Tabrasij, në tefsirin "Mexhmaul Bejàn", shpjegon se arabi e përdor këtë fjalë kur do të shfaqë dashamirësinë ndaj mikut e shokut të tij dhe thotë: "kërko prej meje çfarë të duash".

Bazuar mbi këtë kuptim të fjalës *"jed'deùne"* – *"kërkojnë"* rezulton se për çdo gjë që i shkon mendja njeriut, si dhe për çdo gjë që nuk i shkon mendja, ndonjë mirësi prej mirësive e dhuratave të All'llahut, në Xhennet të gjitha ekzistojnë të gatshme dhe me këtë konkretizohet shprehja se te All'llahu i Lartësuar është shpërblimi më i madh e më i mirë.

Por më e rëndësishme se të gjitha mirësitë materiale të Xhennetit, janë mirësitë morale, për të cilat tregon ajeti i fundit i ajeteve objekt studimi: **"Përshëndetje me 'selam', fjalë prej Zotit Mëshirëplotë."**.[1]

Kjo fjalë/thirrje, jo vetëm që nuk rëndon mbi shpirtrat, por i mbush ata me gjallëri; kjo thirrje e mbushur me dashurinë e All'llahut, bën që shpirtrat e njerëzve të ngjiten në majat më të

[1] Në lidhje me fjalën e ajetit *"kaulen"* – *"fjalë"* ka mendime të ndryshme, por thënia më e matur është ajo që e konsideron këtë fjalë të ajetit kundrinor të një foljeje të hequr dhe me këtë, kuptimi rezulton: "Ai thotë fjalë.".

larta të një gëzimi të brendshëm të atillë, që nuk mund të krahasohet me asnjërën prej mirësive të tjera të Xhennetit. Patjetër, dëgjimi i thirrjes së të Dashurit, dëgjimi i asaj thirrjeje në të cilën ndihet ëmbëlsia e dashurisë së parfumuar me butësi, kjo thirrje i mbush të gjithë banorët e Xhennetit me ngazëllim të atillë, që e kalon çdo ngazëllim që ndjen njeriu në këtë botë.

Në një transmetim të ardhur prej Profetit të Islamit *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë se ai ka thënë: *"Ndërsa banorët e Xhennetit përjetojnë mirësitë, para tyre shkëlqen një dritë dhe ata ngrenë kokat, sipër tyre qëndron All'llahu dhe thotë: 'selam' – 'paqe', për ju o banorë të Xhennetit.* Kjo është fjala e All'llahut të Lartësuar: **"'selam', fjalë prej Zotit mëshirëplotë"***; banorët e Xhennetit shikojnë në drejtim të Tij dhe nuk e kthejnë kokën të shikojnë asnjërën prej mirësive të tjera, por vazhdojnë ta fiksojnë shikimin në Atë, deri sa u fshihet dhe mbi banesat e tyre mbeten vetëm drita dhe mirësitë e Tij."*[1].

Kjo është fuqia tërheqëse që shkakton shikimi i të Dashurit me butësinë e Tij; shikimi në Atë ngjall në shpirt një shije e një dashuri sa edhe vetëm një çast nga këto pamje madhështore nuk mund të krahasohet me asnjërën prej mirësive, madje as me të gjithë Botën. Të dashuruarit janë aq të mahnitur nga shikimi në të Dashurin, aq sa kur atyre u ndërpritet ky udhëtim shpirtëror, ata menjëherë ndjejnë dhimbje të fortë për këtë humbje. Në një transmetim të ardhur prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë fjalën e tij: *"Sikur të mos e shikoj Atë vetëm një orë, me siguri do të vdisja."*.[2]

---

[1] Tefsiri "Rùhul Meànij", vëll. 23, f. 35.
[2] Tefsiri "Rùhul Bejàn", vëll. 7, f. 416.

Këtu të tërheq vëmendjen fakti se fjalët e ajetit tregojnë se **"selami"** që All'llahu i Lartësuar u drejton besimtarëve në Xhennet, është "selam" pa ndërmjetës, është "selam" i drejtpërdrejtë prej të Lartit. Sa përshëndetje e madhe; kjo përshëndetje përfaqëson mëshirën e Tij të veçantë! Ky "selam" del prej pozitës së Burimit të mëshirës, del prej butësisë dhe bujarisë së Tij si një e plotë, e vetme. Nuk mund të ketë mirësi më të madhe se kjo!

Hulumtim

Llojet e "selamit" që marrin banorët e Xhennetit

Xhenneti është "shtëpia e paqes" (dàrus selàm), ashtu siç ka ardhur në ajetin 25 të sures "Jùnus", në të cilin lexojmë: **"All'llahu thërret për në shtëpinë e paqes."**.

Ata që do të banojnë në Xhennet, priten me "selam" prej engjëjve në çastin kur hyjnë në Xhennet: **"…ata i vizitojnë engjëjt duke hyrë në çdo derë. Paqe për ju** (selàmun alejkum) **për durimin tuaj, sa përfundim i bukur është kjo shtëpi."**.[1]

Banorëve të Xhennetit u flasin banorët e "A'ràfit" dhe i përshëndesin ata me "selam": **"…ata i përshëndesin banorët e Xhennetit: 'selàmun alejkum'** (paqe e shpëtim për ju)**."**.[2]

[1] Sure "Err Rra'ad", ajeti 23 dhe ajeti 24.
[2] Sure "El A'ràf", ajeti 46.

Në kohën e marrjes së shpirtit, besimtarët përshëndeten me "selam" prej engjëjve të vdekjes, ashtu siç njofton ajeti: **"Kur engjëjt u marrin shpirtin të mirëve, u thonë: 'selamun alejkum'** (paqe e shpëtim për ju)**, hyni në Xhennet** (si shpërblim) **të punëve që keni bërë."**.[1]

Banorët e Xhennetit përshëndesin me "selam" njëri-tjetrin, ashtu siç e pamë në ajetin objekt studimi: **"…përshëndetja e tyre në atë** (Xhennet) **është: 'selàm'** (paqe)**."**.[2]

Dhe "selami" më i lartë e më i madh që u drejtohet banorëve të Xhennetit, është fjala e All'llahut të Lartësuar: **"Në atë** (Xhennet) **ata** (banorët e Xhennetit) **nuk dëgjojnë as fjalë të kota e as fjalë mëkati. U thuhet vetëm 'selam', 'selam.'"**.[3]

Dhe ky "selam" prej All'llahut të Lartësuar, nuk është vetëm fjalë, por është "selam" që përcjell qetësi e shpëtim, është "selam" që depërton në thellësi të shpirtrave të njerëzve dhe i mbështjell njerëzit me qetësi e siguri.

[1] Sure "En Nahl", ajeti 32.
[2] Sure "Ibràhijm", ajeti 23.
[3] Sure "El Uàkiah, ajeti 25 dhe ajeti 26.

Ajetet: 59 – 62

وَٱمۡتَٰزُواْ ٱلۡيَوۡمَ أَيُّهَا ٱلۡمُجۡرِمُونَ ﴿٥٩﴾ ۞ أَلَمۡ أَعۡهَدۡ إِلَيۡكُمۡ يَٰبَنِيٓ ءَادَمَ أَن لَّا تَعۡبُدُواْ ٱلشَّيۡطَٰنَۖ إِنَّهُۥ لَكُمۡ عَدُوّٞ مُّبِينٞ ﴿٦٠﴾ وَأَنِ ٱعۡبُدُونِيۚ هَٰذَا صِرَٰطٞ مُّسۡتَقِيمٞ ﴿٦١﴾ وَلَقَدۡ أَضَلَّ مِنكُمۡ جِبِلّٗا كَثِيرًاۖ أَفَلَمۡ تَكُونُواْ تَعۡقِلُونَ ﴿٦٢﴾

"Sot ju o kriminelë ndahuni (prej besimtarëve)**."**

"A nuk ju porosita o bij të Ademit të mos adhuroni djallin; me të vërtetë ai për ju është armik i hapur."

"Dhe të më adhuroni Mua, ja kjo është Rruga e Drejtë."

"Në të vërtetë, ai (djalli) **ka futur në rrugën e humbjes shumë prej jush; a nuk e mblodhët mendjen?"**

Komentimi

Përse adhuruat djallin?

Në ajetet e përparme, pamë një anë të të ardhmes së gëzuar të banorëve të Xhennetit, kurse në ajetet objekt studimi do të shikojmë anën e mjeruar të të ardhmes së banorëve të zjarrit dhe të adhuruesve të djallit.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, u flet me përçmim banorëve të zjarrit dhe u thotë: **"Sot ju o kriminelë ndahuni** (prej besimtarëve)**."**.

Ndodh që ju o kriminelë të hyni në radhët e besimtarëve në botën e Tokës dhe jeni hequr se keni besuar si ata, madje keni përfituar prej rangut e prej pozitave të besimtarëve, kurse sot, ndahuni prej besimtarëve dhe shfaquni në formën tuaj origjinale, të vërtetë.

Ky realitet është realizimi i premtimit të All'llahut të ardhur në ajetin 28 të sures "Sàd", ku Filluesi i çdo sendi thotë: **"A mos do t'i barazojmë ata që besuan dhe bënë punë të mira me ata që bëjnë shkatërrime në Tokë, apo të konsiderojmë të ruajturit si ata që janë mëkatarë?"**.

Në të gjitha gjendjet, fjalët e këtij ajeti tregojnë qartë dallimin e kriminelëve prej besimtarëve edhe pse disa interpretues të Kur'ànit, për këtë "dallim" kanë shprehur mendime të ndryshme dhe që në tërësinë e tyre përfundojnë në kuptimin: ndarja në mes radhëve të kriminelëve në grupe, ose

ndarja e kriminelëve prej ndërmjetësuesve dhe të adhuruarve të tyre, ose ndarja e kriminelëve secili prej tyre më vete, që të jetë dënim më shumë për ata, përveç dënimit të djegies në zjarrin e Xhehennemit.

Fakti që kuptimi i ajetit përfshin të gjithë kriminelët, fjala e ajetit *"uemtàzù"* - *"dhe ndahuni"* e përforcon kuptimin e parë që theksuam në fillim.

Ajeti vijues tregon qortimin që u bën All'llahu i Lartësuar kriminelëve Ditën e Kiametit dhe thotë: **"A nuk ju porosita o bij të Ademit që të mos adhuroni djallin; me të vërtetë ai për ju është armik i hapur."**.

Këtë porosi të All'llahut, njeriu e ka marrë me rrugë të ndryshme; njerëzit e kanë dëgjuar dhe u është përsëritur shumë herë, ashtu siç e lexojmë në ajetin 27 të sures "El A'ràf": **"O bij të Ademit, kurrë të mos ju mashtrojë djalli, ashtu siç i nxori prindërit tuaj prej Xhennetit dhe bëri që atyre t'u zhvishen rrobat, që ai t'i shihte ata të dy lakuriq; me të vërtetë ai** (djalli) **dhe bashkëpunëtorët e tij ju shohin ju, kurse ju nuk i shihni ata; djajtë Ne i kemi bërë miq të atyre që nuk besojnë."**.

Ky paralajmërim është përsëritur vazhdimisht në fjalët e Profetëve dhe të Dërguarve, ashtu siç e lexojmë në ajetin 62 të sures "Ez Zukhruf": **"Dhe të mos ju pengojë djalli, me të vërtetë për ju ai është armik i hapur."**.

Edhe në ajetin 168 të sures "El Bekare", lexojmë: **"Dhe mos shkoni pas hapave të djallit, me të vërtetë për ju ai është armik i hapur."**.

Nga një anë tjetër, njeriu këtë porosi e merr edhe nga natyra e pastër e krijimit. Njeriut i është dhënë mendja. Bazuar në argumentet logjikë njeriu nuk duhet t'i bindet atij që e ka shpallur hapur armiqësinë e tij ndaj njeriut, qysh ditën e parë kur All'llahu e nxori atë prej Xhennetit, qysh atëherë kur ai u betua se do t'i mashtrojë njerëzit në çdo kohë e vend.

Nga një anë e tretë, njeriu këtë porosi të All'llahut e merr edhe në saje të fesë së pastër hyjnore me të cilën është krijuar, fesë së vërtetë të Njëtimit të All'llahut (Teuhidit) dhe prej urdhërit për t'iu bindur vetëm All'llahut të Gjithëfuqishëm. Me këtë, plotësohet porosia e All'llahut jo vetëm me një gjuhë, por me disa gjuhë dhe me disa mënyra, duke shtuar se porosia për t'iu bindur vetëm All'llahut dhe për të mos iu bindur djallit, njeriut i është dhënë qysh në fillim të jetës njerëzore.

Këtu meriton të mbahet shënim se fjala *"el ibàdetu"* – *"adhurim"*, që ka ardhur në frazën **"mos adhuroni djallin"**, është në kuptimin e bindjes ndaj djallit, sepse adhurimi nuk reduktohet vetëm në përuljen në ruku apo duke rënë në sexhde, pasi bindja vërtetohet edhe në veprime të tjera, ashtu siç e lexojmë në ajetin 47 të sures "El Mu'minùn": **"...si mund t'u besojmë dy njerëzve që janë si ne, kur populli i tyre janë robërit tanë."**. Gjithashtu, edhe në ajetin 31 të sures "Ez Zukhruf", lexojmë: **"Ata** (jehuditë e të krishterët) **i konsideruan rabinët e murgjit e tyre dhe Mesihun, të birin e Merjemes, zota dhe jo All'llahun, megjithëse nuk janë urdhëruar për ndonjë gjë tjetër përveçse të adhurojnë një Zot të Vetëm."**.

Një shprehje të bukur në lidhje me këtë çështje, e lexojmë edhe në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë*

mbi të!), gjatë komentit që ai i bën ajetit objekt studimi: *"Pasha All'llahun, ata nuk u kanë bërë thirrje atyre që t'i adhurojnë ata, por edhe sikur t'u bënin thirrje, ata nuk do t'u përgjigjeshin atyre, porse ata haramin e bënë hallall dhe hallallin e bënë haram, kështu që i adhuruan ata pa e kuptuar se po i adhurojnë."*.[1]

Gjithashtu, prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë se ai ka thënë: *"Ai që i bindet një burri në mëkat, në të vërtetë e ka adhuruar atë."*.[2]

Në një transmetim të ardhur prej Imam Bàkirit *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë se ai ka thënë: *"Kush dëgjon me vëmendje një folës, në të vërtetë e ka adhuruar atë; nëse folësi, me fjalën e tij, çon në rrugën e All'llahut, atëherë dëgjuesi ka adhuruar All'llahun; nëse folësi, me fjalën e tij, çon në rrugën e djallit, atëherë dëgjuesi ka adhuruar djallin."*.[3]

Ajeti vijues e vë theksin mbi detyrën parësorë të bijve të Ademit dhe për këtë i Larti, me fjalën e Tij urdhëron: **"Dhe të më adhuroni Mua, ja kjo është Rruga e Drejtë."**.

Njeriu është porositur të mos i bindet djallit, sepse, siç u tha edhe më sipër, djalli e ka shpallur armiqësinë e tij kundër njeriut qysh ditën e parë; vallë a mund të ketë ndonjë të mençur që u bindet urdhërave të armikut të tij?! Kjo është njëra anë.

Nga ana tjetër, njeriu është urdhëruar t'i bindet vetëm All'llahut të Lartësuar, sepse vetëm rruga që çon te All'llahu është rruga e drejtë dhe se kjo rrugë është "motorri" më i madh që vë

[1] "Uesàilu Shij'ah",vëll. 18. f. 89; pjesa: "cilësitë e gjykatësit", kapitulli 10.
[2] "Uesàilu Shij'ah",vëll. 18. f. 91, pjesa: "cilësitë e gjykatësit", kapitulli 10.
[3] Burimi i sipërm.

në lëvizje njerëzit. Për të ilustruar këtë që u tha, po marrim një shembull: le të hamendsojmë një njeri që gjendet në mesin e shkretëtirës së thatë e përvëluese; në këtë gjendje, jeta e tij dhe jeta e njerëzve të familjes së tij janë para rrezikut të hajdutëve, që u presin rrugën njerëzve për t'i grabitur; gjithashtu, ai është edhe para rrezikut se mund të bëhet pre e egërsirave, prandaj gjëja e parë që i shkon në mendje këtij njeriu është gjetja e një rrugë të drejtë e të sigurtë, që do ta çojë aty ku ka qëllim të arrijë, kërkon një rrugë të shpejtë e të lehtë, që të arrijë në shtëpinë e tij shëndoshë e mirë.

Nga përmbajtja e kësaj shprehjeje kur'anore, kuptohet se kjo botë nuk është "shtëpia e qetësisë" dhe në rrugën që ai do të përshkojë, askush nuk e di se si do t'i shkojë udhëtimi, përveç atij që i vë vetes qëllim të shkojë në një vend të njohur.

Me qëllim që njerëzit të njohin sa më mirë këtë armik të vjetër, i Larti shton: **"Në të vërtetë, ai** (djalli) **ka futur në rrugën e humbjes shumë prej jush; a nuk e mblodhët mendjen?"**.

A nuk e shihni sa shumë pësime kanë rënë mbi ata që kanë ndjekur djallin?!

A nuk e keni lexuar historinë e atyre që kanë jetuar para jush, që të shihni me sytë tuaj sa i keq qe përfundimi i tyre dhe se ku i çoi ata adhurimi që i bënin djallit? Mbetjet e gjurmët të qyteteve të tyre i keni para syve tuaj; fundi i dhimbshëm ku ata arritën është shumë i qartë, për cilindo që mendon qoftë edhe fare pak.

Atëherë, përse ju nuk jeni kaq seriozë që të njihni armiqësinë e atij që e ka vërtetur shumë herë se ai për ju është armik i betuar? Megjithëkëtë, ju vazhdoni ta keni mik, madje e

bëni atë udhëheqës, e thërrisni për ndihmë dhe e bëni deri prijës në punët e fesë suaj.

Fjala e ajetit "*xhibil'len*", siç shpjegon Ràgibi në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", do të thotë: grup i madh njerëzish, i ngjashëm me një mal të madh.

Fjala vijuese "*kethiiren*", në këtë ajet përforcon kuptimin se ndjekësit e djallit janë shumë dhe nga të gjitha nivelet shoqërore, në çdo shoqëri.

Disa të tjerë, kanë thënë se fjala "*xhibil'len*", është në kuptimin afërsisht dhjetë mijë vetë, ose edhe më shumë, por nëse është më pak, atëherë nuk hyn në kuptimin e fjalës "*xhibil'len*";[1] disa të tjerë nuk janë marrë me punë numrash.[2]

Në të gjitha gjendjet, një mendje e shëndoshë, e detyron njeriun që ai të ruhet me kujdesin më të madh prej këtij armiku kaq të rrezikshëm, i cili nuk ngurron në asgjë dhe kurrë s'ka mëshirë për asnjë njeri; veç kësaj, ndjekësit e djallit janë në çdo skutë e në të gjitha vendet, prandaj për asnjë çast njeriut nuk i lejohet të jetë i shkujdesur ndaj këtij armiku dinak. Le të lexojmë atë që ka thënë "*Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!): "O robër të All'llahut, ruhuni prej armikut të All'llahut që të mos ju ngjisë sëmundjen e tij, të mos ju provokojë me thirrjen e tij, të mos ju tërheqë kundër vetes suaj me forcat e tij të kalorësve e këmbësorëve; betohem për jetën time, kundër jush ai e ka lëshuar shigjetën kërcënuese, ai ka hedhur në mesin tuaj grindje të ashpra, ai qëllon mbi ju nga afër; ai ka thënë: o Zoti im, me qenë se Ti më sprovove, unë do të bëj që ata çdo gjë në Tokë ta shikojnë të bukur dhe të gjithë do t'i mashtroj."*.[3]

---

[1] Referohu në: tefsirin "Rùhul Meànij dhe në Tefsirin "El Kebijr", fundi i ajeteve objekt studimi.

[2] Burimi i sipërm.

[3] "Nehxhul Belàga", hutbeja 193 (El Kkàsiatu).

Ajetet: 63 – 68

هَـٰذِهِۦ جَهَنَّمُ ٱلَّتِى كُنتُمْ تُوعَدُونَ ﴿٦٣﴾ ٱصْلَوْهَا ٱلْيَوْمَ بِمَا كُنتُمْ
تَكْفُرُونَ ﴿٦٤﴾ ٱلْيَوْمَ نَخْتِمُ عَلَىٰٓ أَفْوَٰهِهِمْ وَتُكَلِّمُنَآ أَيْدِيهِمْ وَتَشْهَدُ
أَرْجُلُهُم بِمَا كَانُوا۟ يَكْسِبُونَ ﴿٦٥﴾ وَلَوْ نَشَآءُ لَطَمَسْنَا عَلَىٰٓ أَعْيُنِهِمْ
فَٱسْتَبَقُوا۟ ٱلصِّرَٰطَ فَأَنَّىٰ يُبْصِرُونَ ﴿٦٦﴾ وَلَوْ نَشَآءُ لَمَسَخْنَٰهُمْ عَلَىٰ
مَكَانَتِهِمْ فَمَا ٱسْتَطَٰعُوا۟ مُضِيًّا وَلَا يَرْجِعُونَ ﴿٦٧﴾ وَمَن نُّعَمِّرْهُ
نُنَكِّسْهُ فِى ٱلْخَلْقِ ۖ أَفَلَا يَعْقِلُونَ ﴿٦٨﴾

“Ky është Xhehennemi që ju është premtuar.”

“Sot hyni në atë (Xhehennem) **për shkak të mohimit tuaj.”**

”Sot Ne i mbyllim gojët e tyre dhe do të flasin duart e tyre e do të dëshmojnë këmbët e tyre, për punët që ata kanë bërë.”

“Sikur Ne të duam, atyre ua verbojmë sytë dhe ata do të dilnin në rrugë, por si do të shihnin?”

“Sikur Ne të duam, i gjymtojmë ata në vend dhe ata nuk do të kenë mundësi as të ecin përpara e as të kthehen.”

"Atë që Ne e lëmë të jetojë gjatë, e kthejmë prapa në krijimin e tij; a nuk po mendojnë?"

Komentimi

Dita kur heshtin gojët dhe dëshmojnë gjymtyrët

Ajetet e përparme shpalosën një pjesë prej qortimve hyjnore dhe fjalën që i Larti u drejton kriminelëve Ditën e Kiametit.

Edhe në këtë grup ajetesh, trajtohet e njëjta temë.

Po, atë Ditë, kur para kriminelëve mohues do të shfaqet Xhehennemi, All'llahu i Lartësuar do t'u kujtojë atyre premtimin e Tij dhe për këtë të vërtetë njofton i Larti në ajetin e nderuar: **"Ky është Xhehennemi që ju është premtuar."**.

Te ju dërguam Profetët njëri pas tjetrit, të cilët ju paralajmëruan për këtë Ditë e për këtë zjarr, porse ju u tallët me fjalët e tyre dhe i vutë ata në lojë, prandaj: **"Sot hyni në atë** (Xhehennem)**, për shkak të mohimit tuaj."**.

Pastaj i Larti njofton se dëshmitarët që do të dëshmojnë kundër njerëzve Ditën e Kiametit do të jenë gjymtyrët e trupit të tyre, prandaj nuk mbetet më vend që ata të mohojnë dëshminë e atyre dëshmitarëve dhe për këtë i Larti njofton: **"Sot Ne i**

mbyllim gojët e tyre dhe do të flasin duart e tyre e do të dëshmojnë këmbët e tyre, për punët që ata kanë bërë.”.

Po, atë Ditë gjymtyrët e trupit të njeriut nuk do t’u binden vullnetit e prirjeve të tij; të gjitha gjymtyrët në atë Ditë nuk do të pranojnë urdhërat e tij, por do të dorëzohen para urdhërit të All’llahut. Sa e habitshme është gjykata e Ditës së Kiametit! Në atë gjykatë, dëshmitarët do të jenë vetë gjymtyrët e trupit të njeriut, ato gjymtyrë me të cilat ai mëkatoi e bëri faje.

Ka mundësi që dëshmia e gjymtyrëve të jetë për shkak se mohuesit kriminelë, kur të shohin se ata do të futen në Xhehennem, si dënim për punët që kanë bërë, do të mundohen të mohojnë krimet e fajet që kanë bërë, pasi ata mendojnë se, duke fshehur të vërtetat, mund të shpëtojnë, por pikërisht atëherë, gjymtyrët do të fillojnë të dëshmojnë. Vetëkuptohet që dëshmia e gjymtyrëve për çdo gjë shkakton çudinë më të madhe te mohuesit kriminelë, të cilët në atë Ditë do të shohin se të gjitha rrugët për t’u larguar e për të shpëtuar, janë të bllokuara për ata.

Përsa i përket mënyrës se si do të flasin gjymtyrët e trupit të njeriut kundër vetë njeriut, ka disa interpretime:

1- All’llahu i Lartësuar, çdo gjymtyre i jep fuqinë të flasë e të ketë ndjenja dhe gjymtyrët do të pohojnë të vërtetëm me sinqeritet. A mund të ketë gjë më të çuditshme se kjo? All’llahu i Lartësuar, në një copë mishi të quajtur “gjuhë” dhe në “trurin e njeriut”, ka krijuar mundësinë që njerëzit të flasin, patjetër që Ai ka mundësi që këtë fuqi ta bëjë për të gjithë gjymtyrët e trupit të njeriut.

2- Këtyre gjymtyrëve nuk u jepet aftësia për të kuptuar e për të ndjerë, por i Gjithëfuqishmi bën që ato të flasin. Në të vërtetë, këto gjymtyrë të trupit do të jenë vendi prej nga do të dalin fjalët dhe kështu, me lejen e All'llahut të Lartësuar, realizohet zbulimi i të vërtetave.

3- Gjymtyrët e trupit të njeriut ruajnë gjurmët e punëve që ai ka bërë në këtë botë. Asnjë punë e bërë në këtë botë nuk zhduket, gjurmët e asaj pune do të mbeten në çdo gjymtyrë të trupit e në mjedisin rrethues dhe në atë Ditë, dalja sheshit e gjurmëve të atyre punëve është në pozitën e dëshmisë. Ky fakt është plotësisht i ngjashëm edhe me të folurën tonë të zakonshme, kur, për shembull, themi: "sytë e tu tregojnë se ti nuk ke fjetur", ose kur themi: "muret qajnë për të zotin e shtëpisë".

Në të gjitha gjendjet, dëshmia e gjymtyrëve Ditën e Kiametit, është prej çështjeve të padiskutueshme, por a do të zbulojë çdo gjymtyrë punën që ka bërë, apo gjymtyra do të nxjerrë sheshit të gjitha punët? S'ka dyshim se mundësia e parë është mundësia më e përshtatshme, prandaj në ajetet e tjera kur'anore përmenden edhe dëshmitë e veshit, syrit dhe lëkurës, ashtu siç njofton i Larti në ajetin 20 të sures "Fus'silet": **"Derisa ato u afrohen, kundër tyre** (mohuesve) **do të dëshmojnë sytë, veshët dhe lëkurat e tyre, për çdo punë që ata kanë bërë."**; gjithashtu edhe në ajetin 24 të sures "En Nùr", lexojmë fjalën e të Lartit: **"Atë Ditë do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre, për punët që ata kanë bërë."**.

Meriton të mbahet shënim fakti se i Gjithëfuqishmi, në ajetin 24 të sures "En Nùr", thotë: **"dëshmojnë kundër atyre gjuhët e tyre"** dhe në ajetin objekt studimi thotë: **"Sot Ne i**

mbyllim gojët e tyre.". Nga këto ajete, përfundohet se në fillim mohuesit kriminel i mbyllet goja, që të dëshmojnë gjymtyrët e tij dhe pasi ai të shohë e të dëgjojë dëshminë e gjymtyrëve të tij, për atë s'ka më vend që të mohojë, sepse tanimë vetë gjuha e tij dëshmoi të vërtetën.

Gjithashtu, qëllimi me "fjalën e gjuhës" mund të jetë për fjalën e brendshme, që del prej gjuhës së tij, ashtu siç del prej të gjithë gjymtyrëve të tjera, domethënë se gjuha me të cilën do të flasin gjymtyrët e trupit, nuk është si e folura e tij e zakonshme.

Çështja e fundit mbi të cilën do të trokasim në lidhje me të folurën e gjymtyrëve, është se e folura e gjymtyrëve do të jetë e veçantë vetëm për mohuesit kriminelë, pasi llogaridhënia për besimtarët është e qartë, ashtu siç e lexojmë në një transmetim të ardhur prej Imam Bàkirit *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"gjymtyrët nuk dëshmojnë kundër besimtarit, gjymtyrët do të dëshmojnë vetëm kundër atyre që e kanë merituar dënimin; besimtarit do t'i jepet libri i punëve të tij në dorën e djathtë"*, ashtu siç njofton All'llahu i Lartësuar me fjalën e Tij në ajetin 7 të sures "El Isrà": **"Atij që i jepet libri i tij në dorën e djathtë, ata e lexojnë librin e tyre dhe atyre nuk u bëhet as padrejtësia më e vogël."**.[1]

Ajeti vijues tregon për njërin prej llojeve të dënimeve me të cilat All'llahu i Lartësuar do të vërë në sprovë kriminelët mohues në këtë botë dhe për këtë, ajeti i nderuar njofton: **"Sikur Ne të duam, atyre ua verbojmë sytë."**.[2]

---

[1] Tefsiri "Es Sàfij", vëll. 4. f. 258; fundi i ajetit objekt studimi.

[2] Fjala e ajetit *"tamesnà"* është në kuptimin e shuarjes apo të fshirjes së efektit dhe është një shenjë që tregon shuarjen e dritës së syrit ose të asgjësimit të syrit plotësisht, në atë mënyrë që prej tij të mos mbetet asnjë gjurmë.

Në një gjendje të këtillë, tmerri tek ata arrin kulmin, ashtu siç njofton ajeti: **"…dhe ata do të dilnin në rrugë, por si do të shihnin?"**; në këtë gjendje, ata nuk kanë mundësi të gjejnë as rrugën për të shkuar nëpër shtëpitë e veta, pa thënë se s'kanë mundësi të gjejnë drejtimin që i çon te Rruga e Vërtetë, apo që ata të ecin në Rrugën e Drejtë!

Një dënim tjetër i dhimbshëm për mohuesit është ai që All'llahu i Lartësuar njofton me fjalën e Tij: kur Ne duam, i ngrijmë ata si të ishin monumente prej guri, pa shpirt e të paaftë për të lëvizur, ose do t'i bënim në formën e kafshëve dhe nuk do të kishin mundësi as të ecnin përpara e as të ktheheshin mbrapsht, ashtu siç e lexojmë në ajetin e nderuar: **"Sikur Ne të duam, i gjymtojmë ata në vend dhe ata nuk do të kenë mundësi as të ecin përpara e as të kthehen."**.[1]

Fraza e ajetit **"dhe ata do të dilnin në rrugë"**, mund të jetë edhe në kuptimin e garimit ndërmjet tyre, për të gjetur rrugën nëpër të cilën ata kalojnë zakonisht; ose, sipas shpjegimit të disa gjuhëtarëve më në zë, mund të jetë në kuptimin e shmangies prej rrugës, ose mund të jetë në kuptimin e pamundësisë për të gjetur rrugën dhe në këtë kuptim, fraza e ajetit **"dhe ata do të dilnin në rrugë"**, do të thotë: "ata e kapërcyen rrugën", ose "ata e lanë rrugën" dhe për rrjedhojë, ranë në rrugën e humbjes.[2]

Në të gjitha gjendjet, në përputhje me interpretimin e pranuar prej shumicës së interpretuesve myslimanë të Kur'ànit,

[1] Fjala e ajetit *"mekànetihim"*, do të thotë: aty ku kanë qëndruar dhe kjo fjalë tregon se All'llahu është Fuqiplotë t'i nxjerrë ata prej qenies së tyre njerëzore aty ku janë, ua ndërron formën, u heq mundësinë për të lëvizur dhe i bën plotësisht si shtatoret prej guri, që janë pa shpirt.

[2] Fjalorët: "Lisànul Arab", "Kutrul Muhijt" dhe "El Munxhid", lënda *"sebeka"*.

dy ajetet e mësipërm flasin për dënimin në këtë botë dhe për kërcënimin drejtuar mohuesve kriminelë, në të njëjtën kohë tregojnë se All'llahu i Lartësuar është Fuqiplotë t'i vërë ata para një dënimi të këtillë në këtë botë, por, në saje të butësisë e të mëshirës së Tij, All'llahu i Lartësuar nuk e lëshon këtë lloj dënimi mbi ata në këtë botë; nga ana tjetër, ajeti u tërheq vëmendjen mohuesve kokëngjeshur dhe i paralajmëron që të heqin dorë prej mashtrimit të tyre e të kthehen në rrugën e të vërtetës.

Ka edhe një mundësi tjetër imterpretimi të këtyre ajeteve: këto dënime hyjnore do të ndodhin Ditën e Kiametit dhe jo në këtë këtë botë. Në të vërtetë i Larti, në ajetin e sipërm thotë: **"Ne u mbyllim atyre gojët"**, kurse në këtë ajet flitet edhe për dy dënime të tjera që kanë ardhur me frazën kushtore: **"sikur Ne të duam"**; me këtë frazë, i Larti njofton: sikur Ne të duam, patjetër që do t'i lëshonim edhe këto dy dënime mbi ata.

Dënimi i parë: mbyllja e syve të tyre në atë mënyrë që ata nuk do të kishin mundësi të gjenin "rrugën", të gjenin rrugën e Xhennetit.

Dënimi i dytë: këta individë, pasi humbën mundësinë për të lëvizur në rrugën e lumturisë, Ditën e Kiametit do të shndërrohen në shtatore të vdekura dhe do të qëndrojnë si të hutuar në fushën e llogaridhënies e për ata s'ka as rrugë që të ecin përpara e as rrugë që të kthehen prapa. Është e qartë se, ngjashmëria në mes ajeteve, përforcon interpretimin e fundit edhe pse shumica e

interpretuesve të Kur'ànit kanë rënë në një fjalë të përbashkët për të pranuar interpretimin e sipërm.[1]

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve objekt studimi, tregon gjendjen e njeriut në fundin e jetës së tij dhe thekson pafuqinë e tij mendore e trupore. Kjo gjendje, në të vërtetë është një paralajmërim për njerëzit që ata të zgjedhin sa më shpejt që të ndjekin udhëzimin për në rrugën e drejtë, njëkohësisht është edhe një përgjigje për ata që përgjegjësinë për lënien mangut të detyrimeve që kanë, mundohen ta justifikojnë me jetën e tyre të shkurtër; gjithashtu, kjo gjendje e njeriut në moshë të thyer është edhe një argument tjetër që vërteton fuqinë e All'llahut të Lartësuar, argument që i tregon njeriut se All'llahu është i Gjithëfuqishëm të kthejë njeriun e fortë e të fuqishëm në të pafuqishëm, si të ishte një fëmijë i vogël, njëkohësisht e njofton njeriun se All'llahu është i Gjithëfuqishmëm të ringjallë njeriun pas vdekjes, ashtu siç është i Gjithëfuqishëm të mbyllë sytë e mohuesve dhe t'u heqë atyre mundësinë për të lëvizur. Të gjitha këto gjendje të mundshme për njeriun, shpjegohen qartë në fjalët e ajetit të nderuar: **"Atë që Ne e lëmë të jetojë gjatë, e kthejmë prapa në krijimin e tij; a nuk po mendojnë?"**.

Fjala e ajetit *"nunek'kis'hu"*, do të thotë: përmbysje e sendit kokëposhtë, por kjo fjalë këtu është sinonim për kthimin e plotë të njeriut të rritur në gjendjen e fëmijërisë. Në fillim të krijimit të tij, njeriu është i pafuqishëm, por gradualisht plotësohet, duke filluar me shndërrimet e shumta që ndodhin në njeriun çdo ditë, gjatë

[1] Autori i tefsirit "Fij Dhilàlil Kur'àn", ka përmendur vetëm këtë interpretim, në një kohë që interpretimin e sipërm e kanë parapëlqyer tefsiret: "Mexhmaul Bejàn", "El Mijzàn", "Es Sàfij", "Rùhul Meànij", tefsiri i Kurtubijjit dhe tefsiri "El Kebijr".

gjithë kohës që është në barkun e nënës së tij; çdo ditë në të dëshmohet një cikël i ri zhvillimi dhe pas lindjes, vazhdon me shpejtësi cikli i plotësimit të tij trupor e shpirtëror; më pas njeriu fiton fuqinë dhe gatishmëritë të cilat All'llahu i Lartësuar i ka depozituar në qenien e tij. Më pas, All'llahu i Lartësuar bën që kjo fuqi e kjo gatishmëri të shfaqen te njeriu njëra pas tjetrës, në mënyrë graduale, duke kaluar nëpër etapën e rinisë, pastaj në etapën e pjekjes, deri sa njeriu arrin kulmin e plotësimit të tij trupor e shpirtëror.

Këtu duhet të bëjmë dallimin e shpirtit prej trupit; nga ana e plotësimit dhe zhvillimit, shpirti vazhdon rrugën e plotësimit, kurse trupi fillon regresin, rrëgjohet dhe e fundit që fillon këtë regres e këtë rrëgjim në mënyrë graduale, ose edhe me shpejtësi, është mendja dhe nga ana e fuqisë, njeriu kthehet në gjendjen e fëmijërisë; por, patjetër që ka dallime edhe në këtë këtë kthim në mes individëve. Efektet që lënë lëvizjet dhe gëzimet në shpirtrat e fëmijëve janë qetësia, bukuria dhe shpresa, prandaj këto dukuri janë të pranueshme te fëmijët, por këto gjendje në fazën e pleqërisë janë dukuri të këqija, që sjellin neveri; gjithashtu, ndodh që, në disa raste, këto dukuri shkaktojnë mëshirë. Nga ky këndvështrim, pleqëria është, pa dyshim, një gjendje e rënduar dhe është e pamundur të përfytyrohet thellësia e dhimbjeve që kalon njeriu në moshën e thyer.

Në ajetin 5 të sures "El Haxhxh", Kur'àni Famëlartë e thekson këtë kuptim, kur thotë: **"...dhe prej jush ka që jetojnë deri në pleqëri të thellë, aq sa nuk i mbetet asgjë nga diturìa që kishte..."**. Për të ilustruar këtë gjendje të njeriut, në disa

transmetime thuhet: "kush i kapërcen të shtatëdhjetat, ai është rob lufte i All'llahut në këtë botë".[1]

Në të gjitha gjendjet, fraza e fundit e ajetit objekt studimi **"a nuk po mendojnë"**, është një sinjalizues mahnitës për të tërhequr vëmendjen e njeriut, për t'i kujtuar atij mplakjen dhe ajeti u thotë njerëzve se forca e fuqia që ju keni është kalimtare dhe ju nuk e kuptoni si ju hiqet kjo fuqi e forcë, prandaj dijeni se fuqia e forca juaj është në dorën e të Gjithëfuqishmit, në dorën e Atij që është i Fuqishëm mbi të gjitha sendet; prandaj, para se të arrini në këtë fazë të jetës suaj, pastrojeni shpirtin tuaj, para se kjo gjallëri e bukuri të shndërrohet në fishkje e vdekje, mblidhni trandafilat prej këtij kopshti dhe merrni furnizim në këtë botë për rrugën e gjatë e të largët që do të bëni për në Botën Tjetër; sepse kur të thinjeni, kur të jeni të sëmurë e të pafuqishëm, nuk do të keni mundësi të bëni asnjë punë me vlerë. Për të gjitha këto, ndër këshillat që Profeti *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij)* i dha Ebù Dherr'rrit, lexojmë fjalën e tij: "shfrytëzo rastin prej pesëve para pesëve: rininë tënde para pleqërisë, shëndetit tënd para sëmundjes, pasurinë tënde para varfërisë, kohës tënde të lirë para kohës kur je i zënë me punë dhe jetën tënde para se të vijë vdekja.".[2]

[1] Ky transmetim ka ardhur në librin "Sefijnetul Bihàr".
[2] "Bihàrul Enuàr", vëll. 77, f. 75.

Ajetet: 69 – 70

وَمَا عَلَّمْنَٰهُ ٱلشِّعْرَ وَمَا يَنۢبَغِى لَهُۥٓ ۚ إِنْ هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ وَقُرْءَانٌ مُّبِينٌ ﴿٦٩﴾ لِّيُنذِرَ
مَن كَانَ حَيًّا وَيَحِقَّ ٱلْقَوْلُ عَلَى ٱلْكَٰفِرِينَ ﴿٧٠﴾

"Ne as nuk i mësuam atij (Muhammedit) **poezinë dhe as ajo nuk i takon atij, porse ai** (Kur'àni) **nuk është gjë tjetër veçse këshillë dhe Kur'àn i qartë."**

"Për të paralajmëruar atë që është i gjallë (me mendje e me zemër) **dhe që dënimi të bëhet i merituesshëm për mohuesit."**

Komentimi

Ai nuk është poet, por është paralajmërues!

Në fillim të kësaj sureje, kemi thënë se në këtë sure ka studime gjallëruese e përgjithësuese rreth bazave të besimit, Njëtimit të All'llahut (All'llahu është Zoti Një e i Vetëm), ringjalljes pas vdekjes dhe profetnisë; gjithashtu, kemi parë se ajetet e kësaj sureje kalojnë nga njëri studim në një studim tjetër, të përmbledhur në grupe ajetesh.

Në ajetet e sipërme u shpalosën studime të ndryshme rreth Njëtimit të All'llahut dhe ringjalljes pas vdekjes; kurse në dy ajetet objekt studimi, flitet për çështjen e profetnisë, duke e vënë theksin mbi akuzat e shumta që qarkullonin kundër të Dërguarit më të nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe u japin këtyre akuzave një përgjigje të prerë e të fuqishme. Ndër akuzat e shumta ishte edhe ajo se Profeti *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është poet, ashtu siç thotë ajeti: **"Ne as nuk i mësuam atij** (Muhammedit) **poezinë dhe as ajo nuk i takon atij."**.

Përse hidhej kjo akuzë mbi Profetin *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ndërkohë që ai kurrë s'ka lakuar me gjuhën e tij ndonjë poezi?

Kjo akuzë bëhej për shkak të fuqisë tërheqëse të veçantë që ka Kur'àni për të depërtuar në zemrat e njerëzve dhe këtë depërtim ata e ndjenin të gjithë, duke shtuar edhe pamundësinë për të mohuar bukurinë e fjalëve të Kur'anit, si dhe kuptimet e larta të shprehura me një gjuhë letrare në shkallën më të lartë. Është fakt se, forca e veçantë tërheqëse e Kur'ànit Famëlartë kishte depërtuar edhe në shpirtrat e mohuesve, të cilët shpesh herë shkonin natën fshehurazi pranë shtëpisë së Profetit *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që të dëgjonin atë kur lexonte Kur'ànin në orët e vona të natës.

Janë të shumtë individët që u dashuruan me Islamin vetëm nga dëgjimi i leximit të Kur'ànit Famëlartë, madje puna me këta individë arrinte deri aty, sa ata të shpallnin pranimin e Islamit në të njëjtin vend ku ata dëgjuan të këndoheshin ajetet e Kur'ànit Famëlartë.

Pikërisht për këtë, mohuesit u munduan të paktën të minimizojnë madhështinë e Kur'ànit, me qëllim që njerëzit të anashkalojnë me indiferencë faktin se fjalët e Kur'ànit janë Revelatë hyjnore, prandaj përhapën akuzën në të gjitha anët se Kur'àni është poezi, megjithëse edhe në këtë akuzë të idhujtarëve ka një pohim të brendshëm që e vërteton fjalën e Kur'ànit Famëlartë.

Çështja përse nuk mund të thuhet që Profeti më i nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është poet, shpjegohet me faktin se karakteri i poezisë është krejtësisht i ndryshën nga Revelata hyjnore, për shkaqet vijuese:

1- Zakonisht, baza e poezisë janë mbresat, përfytyrimi dhe fantazia. Poeti, në shumicën e rasteve, i thur vargjet e poezisë nën ndikimin e përfytyrimit, kurse Revelata hyjnore e ka bazën e vet prej parimit të fillimit të ekzistencës dhe ka si bosht rrotullimi të vërtetën.

2- Poezia merr udhë prej ndjenjave njerëzore të ndryshueshme; veç kësaj, poezia e ndryshon gjendjen vazhdimisht, kurse Revelata hyjnore pasqyron të vërtetat e qëndrueshme të botës së ekzistencës.

3- Në shumicën e herëve, bukuria e poezisë buron prej zhytjes në intimitet, në përngjasimin e në zbukurimet e fjalëve, deri në atë shkallë sa thuhet: "poezia më e bukur është ajo që është më shumë gënjeshtare", kurse Revelata hyjnore është vetëm fjalë e vërtetë dhe e sinqertë.

4- Poeti, në shumicën e herëve shikon të zgjedhë fjalë të bukura dhe është i detyruar të ecë sipas rimimit të vargjeve dhe

nga kjo mënyrë të shprehuri, poeti i vë në thonjëza shumë prej të vërtetave.

5- Dhe e fundit, njëri prej interpretuesve të Kur'ànit Famëlartë, thotë se poezia është një tubë ndjenjash që e nisin fluturimin prej Tokës për t'u ngjitur në Qiell, kurse Revelata hyjnore janë të vërteta që zbresin prej Qiellit në Tokë. Vetëm nga ky përshkrim krahasues, bëhet i qartë ndryshimi në mes poezisë e Revelatës hyjnore.

Këtu nuk duhet të harrojmë pozitën e atyre poetëve, të cilët, me poezinë e tyre ndjekin qëllime të shenjta dhe poezitë e tyre janë të ruajtura prej fjalëve me të cilat nuk fitohet kënaqësia e All'llahut. Por është fakt që, shumica e poetëve janë ashtu siç u përshkruan në lart.

Për të gjitha këto, Kur'àni Famëlartë, në ajetet e fundit të sures "Esh Shuarà", thotë: **"Poetëve u shkojnë prapa të humburit. A nuk e sheh se ata** (poetët) **hidhen nga njëra** (degë) **në tjetrën** (thurin lavde, ose ironizojnë)**. Në të vërtetë, ata** (poetët) **thonë atë çka nuk e bëjnë."**.[1]

Natyrisht që po këto ajete theksojnë se poetët besimtarë e vënë artin e tyre në shërbim të rrugës së qëllimeve të tyre të larta, prandaj janë të përjashtuar prej këtij përkufizimi përgjithësues dhe për ata ka një llogari tjetër.

Në të gjitha gjendjet, Profeti *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk mund të jetë poet dhe kur All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ne as nuk i mësuam atij** (Muhammedit) **poezinë"**; kjo frazë e ajetit është në kuptimin se ai

[1] Sure "Esh Shuarà", ajetet 24-26.

është larg poezisë dhe se të gjitha udhëzimet, mësimet e direktivat, atij i zbresin prej All'llahut të Lartësuar.

Tërheq vëmendjen fakti se në historitë e në transmetimet, citohen njoftime të shumta, që tregojnë se i Dërguari *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kur ka qëllim të vërtetojë një çështje me anën e ndonjë poezie, zakonisht fjalët e poezisë ai i shqiptonte pa rimë.

Prej Aishes transmetohet se ajo ka thënë: "I Dërguari i All'llahut edhe kur citonte poezinë e vëllait tim të Benij Kajsit, thoshte:

Për ty do të duken ditët deri sa vazhdon të jesh injorant

Te ti do të vijë dikush që nuk të sjell njoftime."

Ndërkaq, Ebù Bekri thoshte: "Nuk është kështu, o i Dërguar i All'llahut dhe pastaj shtonte: "në të vërtetë unë nuk jam poet dhe as që më shkon mua të jem poet.".[1]

Për të mohuar në mënyrë të prerë poezinë prej Profetit, në fundin e ajetit të parë të këtij grupi ajetesh, i Larti thotë: **"Porse ai** (Kur'àni) **nuk është gjë tjetër veçse këshillë dhe Kur'àn i qartë."**.

Dhe qëllimi me zbritjen e Kur'ànit është që me të të plotësohet argumenti i paralajmërimit. **"Për të paralajmëruar atë që është i gjallë** (me mendje e me zemër) **dhe që dënimi të bëhet i merituesëm për mohuesit."**.

Po, këto ajete janë "këshillë" dhe mjet për të tërhequr vëmendjen, por janë edhe "Kur'àn i qartë", që e shpjegon të

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 4, f. 433, fundi i ajetit objekt studimi.

vërtetën qartë e pa asnjë lloj mbulese, prandaj Kur'àni është faktor për të tërhequr vëmendjen, është faktor jete dhe qëndrueshmërie.

Në ajete të tjera vërejmë se Kur'àni "besimin" (ijmànin) e cilëson jetë dhe "besimtarët" i cilëson të "gjallët", kurse "mohuesit" i cilëson të "vdekurit"; për besimtarët përmend fjalën të "gjallë" kundrejt "mohuesve". Kjo është jeta dhe vdekja morale, që në të vërtetë janë në shkallë më të lartë se vdekja e jeta reale, pasi gjurmët dhe efektet e jetës e të vdekjes morale janë shumë më të gjera e gjithëpërfshirëse. Nëse jeta e gjallë është në kuptimin e frymëmarrjes, ngrënies së ushqimit e lëvizjes, këto dukuri janë edhe te kafshët, por kjo nuk është jeta njerëzore. Jeta njerëzore është ajo që bën të lulëzojnë gonxhet e mendjes, të logjikës dhe të shpalosen kapacitetet e holla të depozituara në shpirtin e njeriut; gjithashtu, në jetën njerëzore është pjesë e pandarë edhe frika ndaj All'llahut, frenimi i prirjes për të përvetësuar sa më shumë, sakrifica, zotërimi i vetes, zbukurimi me virtytet e moraleve të larta dhe Kur'àni e zhvillon këtë jetë në qenien e njeriut.

Me fjalë të përmbledhura, njerëzit, në thirrjen e Kur'ànit Famëlartë ndahen në dy kategori: kategoria e të "gjallëve", të ndërgjegjshëm që i përgjigjen thirrjes së Kur'ànit dhe që u kushtojnë vëmendje paralajmërimeve që bën Kur'àni; nga ana tjetër qëndron kategoria e mohuesve, zemrat e të cilëve janë të vdekura, prandaj prej tyre kurrë nuk shpresohet se ata mund t'i përgjigjen thirrjes së Kur'ànit. Në të vërtetë, këto paralajmërime janë shkak që kundër mohuesve të plotësohen argumentet, për rrjedhojë edhe dënimi për ata bëhet plotësisht i merituesheëm.

Hulumtim

Jeta dhe vdekja e zemrave

Në njeriun ka disa lloje jete e vdekjeje:

E para: Jetë dhe vdekje bimore, që manifestohen në rritjen, zhvillimin, orientimin, ushqimin dhe në lënien e pasardhësve; nga kjo pikëpamje, njeriu është i ngjashëm me të gjitha bimët.

E dyta: Jetë dhe vdekje kafshërore; dukuria më e dallueshme e kësaj jete janë të ndenjurit dhe lëvizja, por këto janë cilësi të përbashkëta për të gjitha kafshët.

Lloji i tretë i jetës është i veçantë vetëm për njeriun dhe është jeta njerëzore e shpirtërore; pikërisht për këtë jetë flasin transmetimet kur thonë "jeta e zemrave" dhe qëllimi me zemrën janë shpirti, mendja dhe ndjenjat njerëzore.

Në një transmetim të ardhur prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, rreth vlerave të Kur'ànit, ai ka thënë: "*Mësojeni Kur'ànin, sepse Kur'àni është fjala më e bukur dhe studiojeni Kur'ànin, sepse në Kur'àn është pranvera e zemrave.*".[1]

Në një transmetim tjetër të ardhur prej Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, ai flet për urtësinë dhe të mësuarit dhe thotë: "*Dijeni se nuk ka asnjë send me të cilin njeriu të mos ngopet e të mos velet prej tij, me përjashtim të jetës, pasi edhe me vdekjen njeriu nuk gjen qetësi;*

[1] "Nehxhul Belàga", hutbeja 110.

në të vërtetë, kjo është në pozitën e urtësisë, është gjallërim për zemrën e vdekur dhe shikim për syrin e verbuar.".[1]

Në një tjetër transmetim të ardhur prej Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë se ai ka thënë: "*Dëgjoni, prej sprovave është varfëria, por më e rëndë se varfëria është sëmundja në trup dhe më e rëndë se sëmundja e trupit është sëmundja e zemrës; dëgjoni me vëmendje, prej shëndetit të trupit është përkushtimi i zemrave."*.[2]

Gjithashtu, në një transmetim tjetër të ardhur prej tij, lexojmë: "*Kush flet shumë, ka shtuar gabimet e veta, kujt shton gabimet e veta i pakësohet turpi dhe kujt i pakësohet turpi, atij i pakësohet nderi, atij i vdes zemra."*.[3]

Nga ana tjetër, Kur'àni Famëlartë specifikon për njeriun një lloj të veçantë shikimi, dëgjimi, kuptimi e ndijimi, përveç shikimit, dëgjimit e ndijimit të zakonshëm, ashtu siç e lexojmë në ajetin 171 të sures "El Bekare": **"...ata janë të shurdhër, memecë e të verbër, ata nuk kuptojnë."**.

Dhe në ajetin 10 të sures "El Bekare", lexojmë: **"Në zemrat e tyre ka sëmundje dhe All'llahu ua shton atyre sëmundjen."**.

Gjithashtu, në suren "El Bekare", ajeti 74, i Larti thotë: **"Pastaj zemrat tuaja u bënë të forta si gur, ose edhe më të forta."**.

Në lidhje me grupin e mohuesve, i Larti, në ajetin 41 të sures "El Màide", shprehet me një fjalë të veçantë: **"...ata janë prej atyre që All'llahu nuk deshi t'ua pastrojë zemrat."**.

---

[1] Burimi i sipërm, hutbeja 133.
[2] "Nehxhul Belàga", fjalët e shkurtëra, 388.
[3] Burimi i sipërm, hutbeja 349.

Dhe në ajetin 36 të sures "El En'àm", lexojmë fjalën e të Lartit: **"Në të vërtetë i përgjigjen** (thirrjes) **ata që dëgjojnë, kurse të vdekurit** (ata që nuk besojnë) **All'llahu i ringjall dhe pastaj ata te Ai do të kthehen."**.

Prej këtyre shprehjeve kur'anore dhe prej shprehjeve të tjera të shumta të ngjashme me këto që kanë ardhur në Kur'ànin Famëlartë, bëhet e qartë se Kur'àni, si boshtin rreth të cilit rrotullohet jeta e vdekja, konsideron logjikën njerëzore, pasi vlera e njeriut qëndron vetëm në logjikën e tij.

Në të vërtetë, jeta, kuptimi, shikimi, dëgjimi e të ngjashme me këto, në këtë ajet përmblidhen në vetë qenien e njeriut, pavarësisht se disa interpretues të Kur'ànit janë shprehur se këto janë shprehje alegorike, por ky mendim i tyre këtu nuk është në harmoni me fjalët e Kur'ànit, sepse, në këndvështrimin e Kur'ànit, të vërtetat janë vetëm ato që janë përmendur tekstualisht, kurse alegori janë vetëm jeta e vdekja kafshërore dhe asgjë tjetër veç kësaj.

Shkaqet e vdekjes e të jetës shpirtërore janë të shumta, por është pranuar se hipokrizia, mendjemadhësia, fanatizmi, injoranca dhe mëkatet e rënda, të gjitha këto e vdesin zemrën.

Në përsiatjet e të penduarve që tregohen prej Imam Sexhadit *(Paqja qoftë mbi të!)* në "Es Sahijfetus Sexhàdij'jetu", lexojmë: *"Dhe e vdiqën zemrën time mëkatet e mia të mëdha."*.

Ajetet objekt studimi e përforcojnë këtë të vërtetë.

A ka ndonjë që është i kënaqur prej jetës së tij, kur jeton në këtë botë pa ditur asgjë dhe kalon një jetë gjithmonë rutinë e në

mirëqenie ekonomike, të mos e ndjejë padrejtësinë që i bëhet të dhunuarit dhe të mos i përgjigjet thirrjes së vërtetë, por të mendojë vetëm për veten e tij, të konsiderojë veten të huaj, madje edhe ndaj më të afërmëve të vet; një njeri i këtillë a mund të konsiderohet njeri i gjallë?

Në një jetë të këtillë, a mund të jetë rezultantja e saj sasia e ushqimeve të konsumuara, përdorimi i disa veshjeve dhe gjumi e zgjimi në mënyrë monotone? Nëse kjo është jeta, atëherë ku qëndron dallimi në mes kësaj jete dhe jetës së kafshës?

Patjetër duhet të pohojmë se, prapa kësaj jete sipërfaqësore është mendja dhe kjo është ajo e vërtetë për të cilën flet Kur'àni Famëlartë në lidhje me jetën e njeriut.

Është me kuptim shumë të bukur fakti që, Kur'àni i konsideron të vdekur të gjithë ata individë te të cilët kanë vdekur shenjat e gjurmët e jetës njerëzore, megjithëse ata janë të gjallë, por në të vërtetë në ata s'ka asnjë shenjë prej jetës njerëzore. Në logjikën e Kur'ànit Famëlartë, individë të këtillë janë të vdekur e të poshtëruar.

Ajetet: 71 – 76

أَوَلَمۡ يَرَوۡاْ أَنَّا خَلَقۡنَا لَهُم مِّمَّا عَمِلَتۡ أَيۡدِينَآ أَنۡعَٰمٗا فَهُمۡ لَهَا مَٰلِكُونَ ٧١ وَذَلَّلۡنَٰهَا لَهُمۡ فَمِنۡهَا رَكُوبُهُمۡ وَمِنۡهَا يَأۡكُلُونَ ٧٢ وَلَهُمۡ فِيهَا مَنَٰفِعُ وَمَشَارِبُۖ أَفَلَا يَشۡكُرُونَ ٧٣ وَٱتَّخَذُواْ مِن دُونِ ٱللَّهِ ءَالِهَةٗ لَّعَلَّهُمۡ يُنصَرُونَ ٧٤ لَا يَسۡتَطِيعُونَ نَصۡرَهُمۡ وَهُمۡ لَهُمۡ جُندٞ مُّحۡضَرُونَ ٧٥ فَلَا يَحۡزُنكَ قَوۡلُهُمۡۘ إِنَّا نَعۡلَمُ مَا يُسِرُّونَ وَمَا يُعۡلِنُونَ ٧٦

“A nuk e shohin se për ata Ne me fuqinë Tonë krijuam kafshë që ata i kanë në pronësi?”

“Ne i bëmë ato (kafshët) **të nënshtruara ndaj tyre, disa ata i përdorin për hipje dhe prej disa të tjerave ushqehen.”**

“Prej kafshëve ata kanë edhe dobi të tjera e pije (qumësht)**; a nuk duhet të falenderojnë?”**

“Por, ata në vend të All’llahut adhurojnë zota të tjerë, me shpresë se do të ndihmohen prej tyre.”

“Ata (zotat e rremë) **nuk mund t’i ndihmojnë ata, megjithëkëtë, ata** (idhujtarët) **janë bërë ushtri e gatshme për ata** (idhujt)**.”**

"Ti mos u brengos për fjalët që ata thonë, Ne dimë çka ata e mbajnë të fshehtë dhe atë çka ata e bëjnë sheshit."

Komentimi

Dobitë që ka njeriu prej kafshëve

Në këto ajete, Kur'àni Famëlartë i kthehet edhe një herë çështjes së Njëtimit të All'llahut (Teuhidit) dhe idhujtarisë (shirkut). Në këto ajete, Kur'àni numëron një pjesë prej dukurive të madhështisë së All'llahut të Lartësuar në jetën e njerëzve, në zgjidhjen e problemeve të tyre dhe në plotësimin e nevojave që ata kanë, duke e vënë këtë madhështi hyjnore kundrejt pafuqisë e pamundësisë së idhujve. Vetëm nga një krahasim i thjeshtë, bëhet e qartë se sa gabim i madh e pa asnjë vlerë është idhujtaria; në të njëjtën kohë, ajetet objekt studimi vërtetojnë drejtësinë e besimit në Njëtimin e All'llahut (Teuhid).

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, thotë: **"A nuk e shohin se për ata Ne krijuam kafshë, që ata i kanë në pronësi?"**.

Dhe që të përfitojnë në mënyrën sa më të mirë prej këtyre kafshëve: **"Ne i bëmë ato** (kafshët) **të nënshtruara ndaj tyre, disa ata i përdorin për hipje dhe prej disa të tjerave ushqehen."**.

Por dobitë prej kafshëve për njerëzit nuk mbarojnë vetëm me kaq, pasi: **"Prej kafshëve ata kanë edhe dobi të tjera e pije** (qumësht)**"** dhe për të gjitha këto: **"A nuk duhet të**

falenderojnë?"; sepse falënderimi është mjeti për të njohur All'llahun dhe për të specifikuar Atë që i ka në dorë mirësitë.

Në lidhje me mirësitë që All'llahu i Lartësuar i ka dhënë njeriut, këtu duhet të sqarohen disa çështje:

1- Prej mirësive të shumta e të ndryshme që gëzon njeriu, ajeti thekson mirësinë e ekzistencës së kafshëve, të cilat gjithmonë janë të pranishme në jetën e përditshme të njeriut, madje deri në atë shkallë sa jeta e njeriut është bërë e pandarë prej kafshëve dhe nëse kafshët do të hiqeshin prej jetës së njeriut, patjetër që kjo do të formonte një ngërç e një problem shumë të madh në jetën e në punët e njeriut, megjithëse njeriu nuk i kushton ndonjë rëndësi të madhe këtij fakti, sepse është mësuar t'i shohë kafshët pranë tij ditë për ditë.

2- Fraza e ajetit **"punuan duart Tona"** - me fuqinë tonë Ne krijuam - në tekstin e Kur'ànit, fraza **"punuan duart Tona"**, është e barazvlershme që tregon fuqinë hyjnore dhe janë përmendur duart, pasi gjymtyrët më të rëndësishme me të cilat njeriu tregon fuqinë e forcën e tij, janë dy duart; për këtë shkak, dora është marrë si barazvlerë e fuqisë, ashtu siç mund të thotë dikush: "filan zonë është në dorën time", në kuptimin që kjo zonë është nën sundimin e tij dhe është ai që e udhëheq atë zonë. Një kuptim të ngjashëm Kur'àni e shpreh edhe në ajetin 10 të sures "El Fet'h", ku lexojmë: **"Dora e All'llahut është mbi duart e tyre."**.

Përmendja e **"duarve"** këtu në numrin shumës, tregon dukuri të ndryshme të fuqisë së All'llahut të Gjithëfuqishëm.

3- Fraza e ajetit **"që ata i kanë në pronësi"**, është kryefjalë, nga e cila dalin degëzime kuptimesh, që tregojnë se krijimi është i

lidhur vetëm me fuqinë e All'llahut, kurse pasja në pronësi e kafshëve, vjen për shkak se Ne i vumë ato në dispozicion të njeriut. Me këtë shpjegim, del qartë sa e madhe është dashamirësia e mëshira e All'llahut për njeriun. Bazuar mbi këtë të vërtetë, nuk ka më vend për problemin e ngritur prej disa interpretuesve të Kur'ànit, të cilët, në komentin e tyre të këtij ajeti, janë bazuar në vënien e germës *"f"* në fillim të përemrit *"hum"*, që tregon për disa, por kjo shprehje, nga ana gjuhësore është e ngjashme me shprehjen sikur ne t'i themi një njeriu: këtë kopsht e kemi punuar dhe e kemi mbjellë ne, por ti përfito prej këtij kopshti. Në vetvete, kjo shprehje tregon dashurinë në shkallën më të lartë dhe mosinteresimin për përfitim vetiak.

4- Fraza e ajetit **"Ne i bëmë ato** (kafshët) **të nënshtruara ndaj tyre"**, tregon se kjo çështje është e një rëndësie shumë të madhe, pasi ka të bëjë me përuljen e këtyre kafshëve ndaj njeriut, megjithëse disa kafshë janë shumë më të fuqishme se njeriu, por kafshët u bënë të nështruara në saje të nënshtrimit hyjnor. Ndodh që kafshët revoltohen, zemërohen dhe bëhen agresive, deri në atë shkallë sa as dhjetëra njerëz s'kanë mundësi t'i bëjnë ballë ndërkryerjes së tyre, kurse në gjendje të zakonshme, një karvan të tërë me deve e drejton edhe një fëmijë që s'ka arritur moshën e adoleshencës dhe i shtyn të ecin në rrugën që ai ka zgjedhur.

Me të vërtetë, ky nënshtrim i kafshëve ndaj njeriut është një punë shumë e çuditshme; njeriu që s'ka fuqi të krijojë as edhe një mizë, madje s'ka mundësi as të vërë mizën në shërbim të tij, All'llahu, Dhuruesi i mirësive të shumta, Krijuesi i miliona e miliona kafshëve të ndryshme, ka bërë që kafshët të jenë të bindura e të nënshtruara ndaj njeriut dhe gjithmonë të jenë në shërbim të tij.

5- Fraza e ajetit **"disa ata i përdorin për hipje dhe prej disa të tjerave ushqehen"** - duke pasur parasysh se fraza *"rekùbuhum"* – *"për hipje"* në sintaksën e gjuhës arabe është plotësor krahasimi për "mjetet e hipjes", tregon se njeriu zgjedh që një pjesë prej kafshëve t'i përdorë për hipje dhe një pjesë tjetër i zgjedh që me ato të ushqehet edhe pse në këndvështrimin e Islamit, mishi i shumicës së kafshëve është hallall të hahet, përsëri njeriu praktikisht përfiton vetëm prej disa kafshëve që t'i përdorë si ushqim; për shembull, njeriu përfiton prej mishit të gomarit vetëm në rastet e domosdoshmërisë së tejskajshme.

Për ne është e qartë se fjala e ajetit *"minhà"* – *"disa prej tyre"* që përmendet në të dyja frazat, tregon pjesë të ndara, por nëse të parën e konsiderojmë për "pjesë të ndara" dhe të dytën e konsiderojmë për "disa pjesë", kuptimi i ajetit do të ishte: (disa kafshë njeriu i zgjedh për hipje, gjithashtu zgjedh që një pjesë prej trupit të këtyre kafshëve t'i përdorë për ushqim), pasi, për shembull, kockat e të ngjashme me kockat nuk mund të hahen.

6- Fraza e ajetit: **"Prej kafshëve ata kanë edhe dobi"**, tregon se dobitë e ndryshme që vijnë prej kafshëve janë të shumta, me mundësi të shumta përpunimi dhe që njeriu i përdor për të mirën e vet; për shembull, prej leshit e prej fijeve të kafshëve punohen rroba të ndryshme, tenda, shtroje e mbuloje, me lëkurët e kafshëve punohen këpucë, çanta, veshje dhe sende të tjera, madje edhe në ditët tona, punimet artizanale tradicionale, dallohen si prodhime natyrore dhe kështu njeriu vazhdon të ketë nevojë të madhe për kafshët, për të plotësuar nevojat e tij jetike, përfshirë ushqimin dhe dobitë e tjera që vijnë prej kafshëve, si rroba e mjete të tjera të domosdoshme për jetën; madje edhe disa lloje serumesh e vaksinash kundër sëmundjeve, përfitohen prej

gjakut të disa kafshëve; gjithashtu, prej kafshëve përfitohet edhe prej gjërave më të rëndomta, siç janë jashtëqitjet e kafshëve, të cilat njeriu gjithmonë i ka përdorur për të plehëruar bimët e mbjella dhe pemët frutore.

7- Fjala e ajetit *"meshàribu"* – *"pije"* tregon për qumështin që merret prej kafshëve. Dihet se, prej qumështit sigurohet një pjesë e rëndësishme e prodhimeve ushqimore nga më të domosdoshmet, që janë në menunë e zakonshme të njeriut; madje, për prodhimet e qumështit është ndërtuar një industri e plotë përpunuese dhe prodhimet e qumështit përbëjnë një pjesë të rëndësishme të eksporteve të disa vendeve, duke siguruar të ardhura të shumta. Qumështi, që është ndër ushqimet bazë të njeriut, del prej gjakut e prej limfës së kafshëve, por është një pije aq e shijshme dhe me vlera të pakrahasueshme ushqyese; gjithashtu, qumështi është edhe një element forcues për të pafuqishmit.

8- Fraza e ajetit **"A nuk duhet të falenderojnë?"**, që ka ardhur si fjali pyetëse, ka qëllim të vërë në lëvizje natyrën e pastër të krijimit të njeriut dhe ndjenjat e tij për të falënderuar për këto mirësi të panumërta, një pjesë prej të cilave u përmendën në ajetet objekt studimi. Në dimë se aksioma "domosdoshmëria për të falënderuar Mirësidhënësin" është baza për njohjen e All'llahut, pasi falënderimi mund të ndodhë vetëm duke njohur Mirësidhënësin, duke shtuar se mendimi rreth këtyre mirësive dhe ndërgjegjësimi se idhujt s'kanë as edhe ndikimin më të vogël në këto mirësi, është rruga që çon në zhvlerësimin e idhujtarisë.

Për të gjitha këto, ajeti vijues, duke përshkruar gjendjen e idhujtarëve, thotë: **"Por ata, në vend të All'llahut adhurojnë zota të tjerë, me shpresë se do të ndihmohen prej tyre."**.

Shiko sa fantazi e gabuar dhe sa mendim i dobët! Kush beson në të këtilla sende të ngurta e të rëndomta, që nuk janë në gjendje të bëjnë asgjë për veten e vet, si ka mundësi që idhujtarët shpresojnë të ndihmohen prej këtyre sendeve të ngurta! Shtatoret idhuj që ata adhurojnë s'kanë fuqi të dëmtojnë ata që i adhurojnë dhe as të sjellin për ata ndonjë gjë; megjithëkëtë, idhujtarët i bëjnë idhujt të barabartë me All'llahun e Lartësur dhe kërkojnë mbështetjen e idhujve për të zgjidhur problemet e jetës së tyre! Po, idhujtarët kërkojnë ndihmë prej idhujve, ata vihen krejtësisht në shërbim të idhujve dhe krenohen me idhujt, ashtu siç njofton ajeti 81 i sures "Merjem": **"Në vend të All'llahut, ata adhuruan zota të tjerë dhe krenohen me ata."**.

I Larti, në ajetin 18 të sures "Jùnus", njofton se idhujtarët pandehin se idhujt do të ndërmjetësojnë për ata te All'llahu: **"Ata nuk adhurojnë All'llahun, por adhurojnë gjëra prej të cilave atyre as nuk u vjen ndonjë dëm e as nuk sjellin për ata ndonjë dobi dhe thonë: ata janë ndërmjetësues për ne te All'llahu."**.

Në të gjitha gjendjet, iluzionet e rreme të idhujtarëve, që presin ndihmë prej idhujve, s'janë gjë tjetër veçse skalitje mbi ujë, sepse idhujt, ashtu siç njoftohet në Kur'ànin Famëlartë, në ajetin 192 të sures "El A'ràf": **"Ata** (idhujt) **nuk mund t'u sjellin atyre ndonjë ndihmë e as veten e tyre nuk e ndihmojnë."**.

Për të gjitha këto, ajeti vijues i ajeteve objekt studimi, shton se idhujt që idhujtarët i adhurojnë me aq përkushtim, nuk u sjellin

atyre asnjë ndihmë; megjithëkëtë, idhujtarët janë ushtri e mobilizuar në shërbim të idhujve, por për këtë, idhujtarët do të ecin në pararojë të idhujve drejt Xhehennemit. Për gjendjen e këtyre idhujtarëve, ajeti njofton: **"Ata** (zotat e rremë) **nuk mund t'i ndihmojnë ata, megjithëkëtë ata** (idhujtarët) **janë bërë ushtri e gatshme për ata."**.

Sa e dhimbshme është që idhujtarët, në Ditën e madhe të Llogaridhënies e të Gjykimit, do të ecin të rreshtuar para idhujve që të hyjnë në Xhehennem grupe-grupe, pa pasur mundësi të zgjidhin qoftë edhe nyjen e një problemi të vetëm prej problemeve që kanë idhujtarët në atë vendqëndrim rrënqethës.

Shprehja e ajetit *"muhdarùne"*, zakonisht përdoret për të treguar përçmim, sepse sjellja e individëve para një tjetri pa miratimin e tyre, tregon sa të poshtëruar janë ata dhe mbështetur mbi këtë interpretim, përemri i parë *"hum"* – *"ata"* në fjalinë **"ata** (idhujtarët) **janë bërë ushtri e gatshme për ata"** u adresohet idhujtarëve, kurse përemri i dytë *"ata"* u adresohet idhujve, megjithëse disa interpretues të Kur'ànit janë shprehur për një interpretim të kundërt dhe thonë se idhujt e shtatoret që adhurohen, Ditën e Kiametit do të shkojnë pas idhujtarëve; në të njëjtën kohë, idhujtarët nuk kanë as edhe shpresën më të vogël që idhujt të ndërmjetësojnë në të mirë të tyre. Është e qartë se interpretimi i parë është më në përshtatje me kuptimin e fjalëve të ajetit.

Në të gjitha gjendjet, këto shprehje vërtetohen vetëm për të adhuruarit e gjallë, si djajtë e mëkatarët xhind e njerëz; gjithashtu, ka mundësi që All'llahu i Lartësuar u jep shpirt, ndjenja e mendje edhe shtatoreve të ngurta idhuj, që ata të qortojnë rëndë ata që i

adhuronin këto shtatore në këtë botë dhe nga ky këndvështrim, shtatoret e punuara prej guri ose prej druri, do të jenë lëndë djegëse për zjarrin e Xhehennemit, ku do të digjen idhujtarët, ashtu siç e lexojmë në ajetin 98 të sures "El Enbijà": **"Ju dhe ata që ju i adhuronit në vend të All'llahut, do të jeni lëndë djegëse e Xhehennemit dhe ju do të hyni në atë** (në Xhehennem)**."**.

Ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh është inkurajim për Profetin *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* njëkohësisht, me butësinë hyjnore, forcon zemrën e tij kundrejt dredhive që kurdisnin idhujtarët dhe ngatërresave që ata mbillnin me paragjykimet e tyre, ashtu siç e lexojmë në fjalën që ajeti i nderuar i drejton atij: **"Ti mos u brengos për fjalët që ata thonë"**, ata herë thonë se ti je poet, herë tjetër thonë se je magjistar, herë tjetër stisin kundër teje akuza të tjera të ngjashme, porse Ne: **"Ne dimë çka ata e mbajnë të fshehtë dhe atë çka ata e bëjnë sheshit."**.

Asgjë prej qëllimeve të tyre nuk mbetet e panjohur prej Nesh, as komplotet që ata thurin në fshehtësi, as përpjekjet që ata bëjnë sheshit për të përgënjeshtruar argumentet Tona; të gjitha këto Ne i dimë dhe i ruajmë që të jenë dënim për ata Ditën e Gjykimit e Llogaridhënies, kurse në këtë botë, ti do të jesh në siguri të plotë prej sherreve të tyre.

Gjithashtu, nga kjo bisedë e ngrohtë hyjnore, mund të inkurajohet çdo besimtar, duke shtuar se jo vetëm i Dërguari më i nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* por edhe çdo besimtar, është i sigurtë se të gjitha gjërat në këtë botë janë nën shikimin e All'llahut dhe se atë nuk e prek asgjë prej kurtheve që kurdisin armiqtë, sepse All'llahu i

Lartësuar nuk i lë vetëm robtë e Tij të sinqertë në çastet e rënda që ata kalojnë dhe gjithmonë është në mbrojtje e në ruajtje të tyre.

Hulumtim

Kultura e Njëtimit të All'llahut (besimi se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm), u jep robve të All'llahut besimtarë një rrugë të veçantë në jetën e tyre, i largon ata prej rrugëve të ndotura me idhujtarinë që konsiston në adhurimin kushtuar idhujve dhe në kërkimin e mbrojtjes e ndihmës prej njerëzve, që janë aq të pafuqishëm.

Me fjalë më të qarta themi: Në botën e sotme, ku arbritariteti është zotërues në perëndim e në lindje, zakonisht shtetet e vogla, me përjashtim të superfuqive, mendojnë e punojnë si të ruajnë veten dhe të sigurojnë stabilitetin e vendit të tyre, duke u mbështetur në njërën prej superfuqive, të cilat, në të vërtetë, për shtetet e tjera janë bërë idhuj. Ato kërkojnë mbrojtje prej superfuqive dhe synojnë të përfitojnë prej fuqisë së madhe që ato zotërojnë, ndërkohë që përvoja ka vërtetuar se superfuqitë, në rastet kur lindin probleme e incidente të rënda, apo trazira, s'kanë mundësi të zgjidhin problemet e veta.

Sa bukur e përshkruan Kur'àni këtë gjendje, kur thotë: **"Ata** (idhujt) **nuk mund t'u sjellin atyre ndonjë ndihmë e as veten e tyre nuk e ndihmojnë."**. Ky është një paralajmërim për të gjithë myslimanët që të ecin në rrugën e sinqertë të Njëtimit të

All'llahut; ajeti u thotë hapur myslimanëve: qëndroni sa më larg idhujve dhe kërkojeni mbrojtjen e ndihmën vetëm nën hijen e dashamirësisë hyjnore. Ky ajet u thotë myslimanëve: mbështetuni në forcat tuaja, mbështetuni në forcën e besimit dhe mos u hapni asnjë rrugë të ashtuquajturave ide shoqërore që ju shërbehen të sheqerosura dhe mos lejoni që këto ide të rreme të depërtojnë në mendimet tuaja, ndryshe do të bëheni prej atyre që kërkojnë mbrojtje e ndihmë prej këtyre idhujve superfuqi dhe nuk kërkojnë ndihmë e mbrojtje prej All'llahut të Lartësuar; gjithashtu, ajeti u bën thirrje besimtarëve të mbajnë të pastër kulturën islame në të gjitha shoqëritë myslimane dhe të jenë të vetëdijshëm se myslimanët do të realizojnë të gjitha punët e domosdoshme që kanë përpara, kundër qëllimeve gllabëruese të armiqve. Sikur kjo bazë hyjnore të ishte sunduese në jetën e myslimanëve, me siguri që myslimanët nuk do të pësonin kaq e kaq disfata; megjithëkëtë, ajeti u thotë myslimanëve që të mos e humbin shpresën se do të vijë dita kur parimet kur'anore do të jenë sunduese në vendet e tyre, prandaj le të vazhdojnë të mbështeten në dashamirësinë e në mëshirën hyjnore, pasi vetëm kështu, me lejen e All'llahut, do të jenë të nderuar, do të jetojnë të lirë e me krye lart.

Ajetet: 77 – 79

أَوَلَمۡ يَرَ ٱلۡإِنسَٰنُ أَنَّا خَلَقۡنَٰهُ مِن نُّطۡفَةٖ فَإِذَا هُوَ خَصِيمٞ مُّبِينٞ ﴿٧٧﴾
وَضَرَبَ لَنَا مَثَلٗا وَنَسِيَ خَلۡقَهُۥۖ قَالَ مَن يُحۡيِ ٱلۡعِظَٰمَ وَهِيَ رَمِيمٞ ﴿٧٨﴾
قُلۡ يُحۡيِيهَا ٱلَّذِيٓ أَنشَأَهَآ أَوَّلَ مَرَّةٖۖ وَهُوَ بِكُلِّ خَلۡقٍ عَلِيمٌ ﴿٧٩﴾

"A nuk e shikon njeriu se Ne e krijuam atë prej një pike spermatozoidi, porse ai bëhet kundërshtar i rreptë?"

"Sjell shembuj për Ne, harron krijimin e vet dhe thotë: kush i ringjall kockat e bëra pluhur?"

"Thuaj, ato i ringjall Ai që i krijoi ato herën e parë; Ai ka dijeni të plotë për çdo krijim."

Shkaku i zbritjes

Shumica e librave të tefsireve citojnë një transmetim të ardhur prej Ebù Abdullàh Es Sàdik *(Paqja qoftë mbi të!)*, i cili ka thënë: "Erdhi Ubej ibn Khalef, ose (El Às ibn Vàil), duke mbajtur në dorë një kockë të kalbur, që e kishte marrë prej një muri dhe

pasi e thërmoi kockën me dorë, tha: 'kur ne të jemi kocka të bëra pluhur, qysh do të ringjallemi përsëri?!' Menjëherë, i Larti zbriti ajetin:'**Thuaj, ato i ringjall Ai që i krijoi ato herën e parë; Ai ka dijeni të plotë për çdo krijim.'**".

Komentimi

Më sipër kemi thënë se studimet e ndryshme rreth çështjeve të fillimit të krijimit, ringjalljes pas vdekjes dhe profetnisë, që trajtohen në suren "Jàsijn", përbëjnë "zemrën" e Kur'ànit dhe të gjitha këto çështje, në këtë sure kanë ardhur në grupe ajetesh. Surja "Jàsijn" fillon me çështjen e profetnisë dhe mbyllet me shtatë ajete që janë argumentet më të fuqishëm që shpjegojnë çështjen e ringjalljes pas vdekjes.

Në fillim, këto ajete, të vëna në dorën e njeriut, i tregojnë atij fillimin e jetës së tij dhe i shpjegojnë se fillimi i tij ishte vetëm një spermatozoid i thjeshtë dhe asgjë më shumë, por që ky spermatozoid është i përgatitur dhe i përshtatur për fillimin e një jete njerëzore; prandaj, ajeti i parë i këtij grupi ajetesh i bën thirrje njeriut të mendojë thellë dhe thotë: **"A nuk mendon njeriu se Ne e krijuam atë prej një pike spermatozoidi, porse ai bëhet kundërshtar i rreptë?"**.[1] A mund të ketë shprehje më të gjallë se

[1] Fjala e ajetit *"khasijmun"* është në kuptimin e këmbënguljes në armiqësi e në polemikë; kurse fraza *"euelem jera"* - **"A nuk e shikon?"**, është në kuptimin: "A nuk e di?".

kjo? Ajeti i nderuar i flet njeriut drejtpërdrejt dhe në atë mënyrë që ai ka mundësi të kuptojë këtë të vërtetë, pavarësisht nga besimi që ai ka dhe pavarësisht nga niveli i tij kulturor.

Në vijim, ajeti flet për "spermatozoidin", me qëllim që ky njeri mendjemadh edhe sikur të mendojë fare pak, do të mësojë se fillimi i tij është prej një uji të ndenjur me erë të keqe; gjithashtu, ajeti i thotë njeriut se ky "ujë me erë të keqe" nuk është shkaku për krijimin e për daljen tënde në këtë botë, por është ajo qeliza e vockël, që nuk mund të shihet pa mjete zmadhuese në mesin e mijërave e miliona qelizave të tjera që notonin në ata ujë me erë të keqe; por kjo qelizë ka aftësinë të gjenerojë në mitrën e nënës qeliza të tjera dhe të bashkohet me ato, deri sa në këtë proces formohet qeliza e parë njerëzore dhe kështu njeriu hyn në botën e ekzistencës!

Ky fetus vazhdon të plotësohet etapë pas etape dhe ashtu siç shpjegon Kur'àni Famëlartë, fomimi i njeriut në barkun e nënës kalon nëpër gjashtë etapa, të cilat në Kur'ànin Famëlartë emërtohen si vijon: spermatozoidi (en'nutfeh), masa e ngjitur (el alekah), gjaku i mpiksur (el mudgah), kockat, veshja e kockave me mish dhe formimi i plotë. Pas lindjes, njeriu është i pafuqishëm dhe s'ka fuqi për asgjë; më pas vijnë etapat e rritjes së tij të shpejtë, deri sa arrin moshën e formimit të plotë trupor e mendor.

Po, kjo qenie e pafuqishme dhe që s'ka fuqi të bëjë asnjë send, bëhet i fortë deri në atë shkallë, sa i lejon vetes të ngrihet e të luftojë thirrjet hyjnore dhe harron të kaluarën e të ardhmen e tij, ashtu siç përshkruhet në fjalën e të Lartit: **"porse ai bëhet kundërshtar i rreptë"**. Kjo shprehje kur'anore ka një kuptim

shumë të gjerë dhe në brendinë e saj flet për dy fetuse, njëri përfaqëson anën e fuqisë dhe tjetri përfaqëson anën e pafuqisë. Është e qartë se Kur'àni Famëlartë flet njëherësh për këto dy fetuse.

I gjithë ky proces realizohet vetëm në njeriun, i cili është i pajisur me mendje dhe me aftësinë për të menduar, është pajisur me ndjenja dhe me vullnet e pavarësi veprimi. Ne dimë se, çështja më e rëndësishme në jetën e njeriut, është të folurit, që gjendet i gatshëm në trurin e tij; më pas e folura e tij derdhet në kallëpe shprehjesh që lëshohen në adresë të objektivit, ashtu siç lëshohet fisheku prej tytës së pushkës. Natyrisht që ky proces nuk ndodh në asnjë qenie tjetër të gjallë, përveçse në njeriun.

Ndodh kështu, për shkak se All'llahu, me fuqinë e Tij, i jep këtij uji me erë të keqe një fuqi kaq të madhe. Kjo është njëra anë.

Nga ana tjetër, njeriu është një krijesë mendjemadhe dhe që harron shumë; veç kësaj, njeriu, të gjitha mirësitë që i ka vënë në dispozicion Zotëruesi i mirësive, i përdor kundër Krijuesit në polemikat e tij dhe e shpall hapur armiqësinë e tij kundër All'llahut të Lartësuar. Shiko sa i shkujdesur e sa mendjelehtë është njeriu!

Për të mësuar se deri ku shkon shkujdesja, mendjelehtësia e njeriut, ajeti vijues shpjegon: **"Sjell shembuj për Ne, harron krijimin e vet dhe thotë: kush i ringjall kockat e bëra pluhur?"**.

Qëllimi me sjelljen e shembujve, ka të njëjtin kuptim që shprehin fjalët e ajetit, pa asnjë formë alegorie dhe qëllimi është kërkimi i argumenteve, si dhe përmendja e kritereve për të vërtetuar një kërkesë të përcaktuar. Po, (Ubej ibn Khalf, ose

Umej'jeh ibn Khalef, ose El'Às ibn Vàil) gjeti një kockë të vjetër që nuk dihej se e kujt ishte dhe nuk dihej nëse kishte pasur një vdekje natyrore apo ishte vrarë në njërën prej luftërave të zhvilluara gjatë kohës së injorancës, para Islamit, ose mund të ketë vdekur nga uria; ai mendoi se, me këtë copë kockë të kalbur, gjeti një argument të fuqishëm për të mohuar ringjalljen pas vdekjes dhe me këtë mendim në kokë e me kockën në dorë u nis me mendjemadhësi e me gëzim, duke thënë: do ta mposht Muhammedin.

Ai shkoi me nxitim te i Dërguari më i nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që t'i thoshte: cili është ai që mund të riveshë me rrobën e jetës këtë kockë të kalbur; ndërkaq e shtrëngoi dorën që mbante kockën dhe një pjesë e kockës ra për tokë në formë pluhuri; duke besuar se i Dërguari do të hutohej dhe nuk do të kishte si t'i përgjigjej atij!

Por, e bukura në këtë çështje qëndron në faktin se Kur'àni Famëlartë i përgjigjet atij vetëm me një frazë të shkurtër: **"harron krijimin e vet"** dhe më pas vazhdon të japë shpjegime të tjera.

Sikur thotë: sikur ti o njeri të mos e harroje krijimin tënd, kurrë nuk do të kërkoje të mblidhje argumente kaq pa vlerë.

O njeri që harron kaq shumë, ktheje kokën prapa dhe shiko në krijimin tënd, mendo se ishe një pikë ujë pa asnjë vlerë dhe se çdo ditë merrje një formë të re gjatë etapave të jetës; ti o njeri je në një gjendje vdekjeje dhe ringjalljeje të vazhdueshme; me një sasi lënde prej botës së ngurtë bimore, u bëre njeri i plotësuar, gjithashtu edhe me një sasi prej botës së vdekshme të kafshëve, ti u bëre njeri; por të gjitha këto ti i harrove dhe fillove të pyesësh:

kush do t'i ringjallë kockat e kalbura të bëra pluhur? A nuk ishe ti, o njeri, në fillim baltë, ashtu siç janë këto kocka të kalbura?!

Për të gjitha këto, All'llahu i Lartësuar e urdhëron të Dërguarin *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që t'i thotë këtij mendjemadhi mendjelehtë dhe që harron kaq shumë: **"Thuaj, ato i ringjall Ai që i krijoi ato herën e parë."**.

Nëse ti sot mban në dorë atë pjesë që ka mbetur prej kockës së kalbur, por ajo të kujton se edhe ti nuk ishe asgjë, madje nuk ishe as pluhur, a nuk të bën ty kjo kockë e kalbur të mendosh se sa punë e lehtë është për Atë që të krijoi ty të kthejë jetën në kockat e kalbura e të bëra pluhur?!

Nëse ti beson se këto kocka, pasi janë kalbur do të bëhen pluhur dhe do të shpërndahen në të gjitha anët, ti pyet: Kush do t'i mbledhë copëzat e këtyre kockave nëpër qoshet e vrimat ku janë shpërndarë? Edhe përgjigja për këtë pyetje gjithashtu është shumë e qartë: **"Ai ka dijeni të plotë për çdo krijim."**.

Për Atë që ka këtë (dituri) dhe që zotëron këtë (fuqi), çështja e ringjalljes së të vdekurve nuk është aspak problem. Me një copë magneti, ne kemi mundësi që, brenda një çasti, të mbledhim grimcat e hekurit që bien në tokë gjatë punimit me limë edhe pse është i përzier me pluhurin e tokës; po All'llahu, i Gjithëfuqishmi, i Gjithëdituri, patjetër ka mundësi që me një urdhër të vetëm të mbledhë të gjitha grimcat e trupit të njeriut, kudo që ato të gjenden në globin e Tokës; sepse All'llahu ka dijeni jo vetëm për krijimin e njeriut, por Ai ka dijeni edhe për të gjitha qëllimet e për të gjitha punët e njeriut. Dituria e All'llahut ka

rrethuar të gjitha sendet dhe mbi të gjitha sendet Ai është Fuqiplotë.

Bazuar mbi këtë shpjegim, llogaridhënia për punët, për qëllimet dhe mitet e besimet e kota dëmsjellëse, për All'llahun e Lartësuar nuk përbëjnë asnjë lloj problemi, ashtu siç shpjegohet në ajetin 284 të sures "El Bekare": **"… nëse e nxirrni sheshit atë që keni në shpirtin tuaj ose e mbani të fshehur, për këtë All'llahu do t'ju marrë në llogari…"**.

Edhe kur Faraoni shfaqi dyshimin e tij në fuqinë e All'llahut në lidhje me ringjalljen e brezave të përparshëm, Musai *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* iu përgjigj: **"Ai** (Musai) **tha: dituria për atë është te Zoti im e shkruar në një libër; Zoti im as nuk gabon e as nuk harron."**.[1]

[1] Surja "Tà Hà", ajeti 52.

Ajeti: 80

ٱلَّذِى جَعَلَ لَكُم مِّنَ ٱلشَّجَرِ ٱلۡأَخۡضَرِ نَارًا فَإِذَآ أَنتُم مِّنۡهُ تُوقِدُونَ ﴿٨٠﴾

"Ai që prej drurit të gjelbër për ju bëri zjarrin dhe prej tij ju ndizni."

Komentimi

Edhe këto ajete ndjekin studimet e ndryshme rreth ringjalljes pas vdekjes, shpalosin kuptime të thella rreth çështjes së ringjalljes pas vdekjes dhe heqin çdo mundësi për të dyshuar në këtë çështje. Ajeti objekt studimi e shpjegon këtë çështje më qartë e më gjerë dhe thotë: **"Ai që prej drurit të gjelbër për ju bëri zjarrin dhe prej tij ju ndizni."**. Sa shprehje e mrekullueshme, sa herë që ne shikojmë me hollësi në këtë shprehje, aq më shumë marrim dituri më të thella e gjithnjë më të hollësishme!

Siç e dimë, ajetet kur'anore kanë kuptime të shumta dhe me horizonte të ndryshme. Disa prej kuptimeve të ajeteve kur'anore janë për njerëzit aq të qarta, sa nuk mund të ketë qartësi më të madhe në të gjitha kohët e në çdo vend; disa ajete të tjera

kanë kuptime të thella, prandaj ato janë disi të veçanta, prandaj ato i kuptojnë vetëm disa njerëz dhe pjesa tjetër e ajeteve kur'anore përfaqëson një thellësi kuptimi të atillë, sa vetëm disa të përzgjedhur mund të depërtojnë në thellësitë e kuptimeve të këtyre ajeteve; por, këto ajete, në të njejtën kohë, nuk janë në kundërthënie njëri me tjetrin, të gjithë futen në një shabllon të vetëm dhe në një kohë të vetme. Ajeti objekt studimi është vetëm njëri prej ajeteve të këtij grupi.

Interpretimi i parë për të cilin janë shprehur shumë prej intrepretuesve të përparshëm të Kur'ànit, është i thjeshtë dhe i qartë, prandaj shumica e masës së njerëzve kanë mundësi të kuptojnë qëllimin me fjalën e këtij ajeti me *"shexheri"* - *"druri"* dhe e dinë se qëllimi është për drurin e quajtur *"elimerekhu uel af'fàr"*, prej të cilit arabët e kohëve të hershme ndiznin zjarrin, pasi, me lejen e All'llahut, kur pjesa e poshtme e këtij druri shtypej dhe përzihej me pjesën e shtypur të majës së këtij druri, ndizej zjarr. Në të vërtetë, kjo mënyrë e ndezjes së zjarrit është si puna e shkrepses në ditët tona. Me këtë fjalë, All'llahu i Lartësuar shpjegon se Ai që ka fuqi të bëjë që prej drurit të gjelbër të ndizet zjarr, patjetër që ka fuqi të riveshë të vdekurit me rrobën e jetës.

Uji dhe zjarri janë dy gjëra të kundërta, por Ai që ka mundësi t'i bashkojë këto të dyja në të njëjtin vend, patjetër që ka mundësi të bëjë së bashku, në të njëjtin vend edhe jetën e vdekjen; Ai që krijon zjarrin në mesin e ujit dhe ujin në mesin e zjarrit, pa diskutim ka fuqi të ngjallë trupin e njeriut të vdekur, pa asnjë problem e pa asnjë vështirësi.

Në se hedhim një hap përtej këtij interpretimi, do të arrijmë në një interpretim edhe më të hollësishëm dhe do të shohin se e

veçanta e ndezjes së zjarrit me anën e drurëve, nuk reduktohet vetëm në drurin e lartpërmendur *"elimerekhu uel af'fâr"*, pasi kjo veçanti është në të gjithë drurët dhe në të gjithë trupat që gjenden në këtë botë edhe pse në drurin e sipërpërmendur kjo e veçantë është më shumë e dallueshme; thënë ndryshe, ky lloj druri ka më shumë përgatitje vetiake për të ndezur zjarr në krahasim me drurët e tjerë.

Me një fjalë, të gjitha drutë, kur fërkohen njëra me tjetrën në mënyrë të vazhdueshme, do të lëshojnë shkëndija zjarri, madje edhe drutë e marra prej pemëve të njoma.

Për këtë shkak, disa herë ndodhin zjarre të mëdha në pyjet me drurë të njomë, madje njeriu as nuk e di shkakun se si ndizen këto zjarre në pyjet, pa ndërhyrje të çfarëdoshme nga ana e vetë njeriut, apo edhe nga faktorët atmosferikë. Ka mundësi që erërat e fuqishme të përplasin degët e pemëve njëra me tjetrën aq fuqishëm, sa kjo përplasje çon në daljen e shkëndijave dhe janë këto shkëndija që çojnë në ndezjen e zjarrit në pyjet e gjelbra, ndërsa era e fortë ndihmon që zjarri të përhapet me shpejtësi; pra, faktori origjinal që shkaktoi këto shkëndija të dala nga fërkimi i degëve të drurëve njëri me tjetrin, është vetëm era e fortë.

Ky interpretim i zgjeruar, shpjegon qartë procesin e mbledhjes së të kundërtave në krijimin, njëkohësisht shpjegon ekzistencën e (qëndrueshmërisë) në (asgjësimin) dhe e kundërta.

Ka edhe një interpretim të tretë, që konsiderohet më i thellë se dy interpretimet e para dhe që realisht ka dalë si rezultat i punës së dijetarëve të kohës së sotme. Këtë interpretim, ne kemi parapëlqyer ta emërtojmë "ringjallja e energjisë".

E gjitha kjo, për ne shpjegon qartë si vijon: prej detyrave më të rëndësishme që kryejnë bimët në procesin e "asimilimit të dritës", që konsiston në thithjen e dioksidit të karbonit prej ajrit, i cili në saje të klorofilit që gjendet në gjethet e pemëve e në bimët e njoma, me ndihmën e ujit dhe të dritës së Diellit përpunohet në ushqim për pemën. Ky ushqim çon në formimin e fibrave të celulozës në bimët dhe rezultati i procesit të "asimilimit të dritës" është oksigjeni, që çlirohet në ajër gjatë reaksionit kimik të ndarjes së dioksidit të karbonit në karbon dhe në oksigjen.

Në teorinë e këtij procesi shpjegohet se bimët e marrin dioksidin e karbonit dhe e ndajnë këtë gaz, duke ruajtur për vete vetëm karbonin, si përbërës krahas përbërësve të tjerë që bima i merr prej ujit dhe kështu formohet lënda drusore, kurse oksigjeni i ndarë prej dioksidit të karbonit, lëshohet në ajër.

Është me shumë rëndësi ajo që thonë shkencëtarët se, që të realizohet një reaksion kimik, patjetër ka nevojë për një lloj energjie, ndryshe reaksioni kimik nuk mund të realizohet; por ndodh që energjia e duhur mund të çlirohet si rezultat i këtij reaksioni. Bazuar mbi këtë shpjegim, reaksioni kimik që realizohet si rezultat i "asimilimit të dritës" prej pemëve të gjelbra, këtë energji pema e bima e merr prej Diellit, për të plotësuar të gjithë reaksionin.

Në saje të këtij procesi, bima e pema e depoziton këtë energji në drurin që formohet si rezultat i këtij procesi dhe kur ne e djegim drurin, në të vërtetë i heqim "frerin" kësaj energjie të depozituar në drurin dhe duke përfituar prej oksigjenit të ajrit, ne bëjmë riformimin e dioksidit të karbonit, i cili del si rezultat i

djegies dhe rikthehet në ajër; natyrisht që me djegien e drurit çlirohen edhe avujt e ujit që përmban druri.

Sikur të flisnim me një gjuhë tjetër, me siguri do të thoshim: nxehtësia e dalë prej ndezjes së drurëve në vatrat e shtëpive të fshatarëve, ose kur ne përdorim qymyrin për ngrohje nëpër shtëpitë tona gjatë stinës së dimrit, nxehtësia që del nga djegia e qymyrit, në të vërtetë është nxehtësia dhe drita e Diellit që ishin të depozituara në drurët gjatë viteve dhe këtë energji që druri e ka mbledhur prej Diellit gjatë jetës së tij, gjatë procesit të djegies kjo energji kthehet pa asnjë pakësim.

Thuhet se, të gjitha energjitë në globin tokësor e kanë origjinën te Dielli dhe ne deri tani kemi përmendur vetëm njërën prej dukurive të kësaj energjie diellore të depozituar.

Tani që arritëm në "ringjalljen e energjisë", vëmë re se drita dhe nxehtësia që gjenden të shpërndara në atmosferë dhe që drurët i mbledhin në degët e në trungjet e veta për të siguruar rritjen, në të vërtetë kjo nxehtësi dhe kjo energji kurrë nuk zhduken, por vetëm ndërrojnë formë; pavarësisht se kanë qenë fshehur larg syve tanë, ato kanë qenë në çdo grimcë prej grimcave të drurit dhe kur ne ndezim një copë druri, menjëherë fillon ringjallja e energjisë dhe e gjithë drita, nxehtësia dhe energjia që ishin akumuluar në grimcat e drurit, atë kohë, në kohën e grumbullimit të përgjithshëm në sheshin e llogaridhënies, do të dalin përsëri pa u pakësuar asgjë si sasi edhe pse dalin vetëm me një ndriçim (Mendo mirë në këtë pike!).

Pa dyshim që ky kuptim nuk njihej prej masës së njerëzve në kohën e zbritjes së këtij ajeti, por, ashtu si kemi thënë, kjo nuk

përbën as problemin më të vogël, sepse ajetet e Kur'ànit kanë shumë kuptime, janë me nivele të ndryshme, gjithashtu janë me përgatitje të ndryshme; në një ditë prej një ajeti arrihet të merret një kuptim, kurse sot, ne prej të njëjtit ajet, marrim një kuptim shumë më të gjerë; prandaj edhe brezat e ardhshëm do të arrijnë të marrin një kuptim edhe më të gjerë e më të thellë po prej këtij ajeti; në të njëjtën kohë, të gjitha kuptimet e marra janë të sakta, janë të pranueshme në mënyrë të plotë dhe si tërësi, të gjitha janë në kuptimin që shprehin fjalët e ajetit.

Dy hulumtime

1- Përse dru i gjelbër?

Mund të shkojë në mendje pyetja: përse këtu Kur'àni është shprehur për drurin e gjelbër, në një kohë që ndezja e zjarrit prej drurit të njomë realizohet me shumë vështirësi; sa bukur do të ishte sikur, në vend të kësaj fraze, Kur'àni të kishte përdorur frazën: "prej drurit të thatë", pasi kështu edhe kuptimi do të ishte plotësisht në harmoni me realitetin!?

Kjo shprehje me kuptim të thellë, tregon se vetëm druri i njomë, thënë ndryshe druri i gjallë, mund të kryejë procesin e "asimilimit të dritës" dhe të depozitojë dritën e nxehtësinë e Diellit; kurse druri i tharë edhe sikur të mbetet për qindra vite nën rrezet e Diellit, s'ka asnjë mundësi të shtojë depozitimin e dritës e

të nxehtësisë së Diellit që është bërë në atë pemë kur ajo ishte e njomë.

Bazuar mbi këtë shpjegim, druri i gjelbër, druri i njomë, ka mundësi të "fabrikojë" për ne lëndë djegëse; vetëm druri i njomë ka mundësi të ruajë e të depozitojë nxehtësinë e dritën dhe t'i shtojë këto të dyja në mënyrë ciklike, por, sapo druri thahet, procesi i "asimilimit të dritës" ndërpritet dhe bashkë me ndërprerjen e këtij procesi, ndalon edhe procesi i depozitimit të energjisë diellore në drurin.

Bazuar mbi këtë fakt, shprehja e sipërme **"druri i gjelbër"** konsiderohet konkretizim shumë i bukur i procesit të "asimilimit të dritës" dhe një mrekulli e përjetshme e Kur'ànit Famëlartë!

Veç kësaj, nëse do t'i referohemi librave të tefsireve të tjerë të Kur'ànit që ne i kemi përmendur më sipër, shprehja kur'anore **"druri i gjelbër"** mbetet shprehje më e bukur dhe plotësisht e përshtatshme, sepse drurët e gjelbër, kur fërkohen njëri me tjetrin, prej këtij fërkimi del një shkëndijë që mund të jetë burim për një zjarr të përmasave të mëdha; pikërisht këtu ne ndalojmë para fuqisë së All'llahut, që e ruan zjarrin në mes të ujit dhe ujin e ruan në mes të zjarrit.

2- Dallimi në mes fjalës "el vukùdu" dhe fjalës "el vekùdu"

Fjala e ajetit *"tùkidùne"* – *"ndizni"* në rrënjën e saj *"el vukùdu"*, është në kuptimin e vetëndezjes së zjarrit, ose në

kuptimin dikush e ndezi zjarrin, kurse fjala *"el vekùdu"*, është në kuptimin e drurit të përgatitur për djegie.

Në bazë të këtij shpjegimi, fraza e ajetit **"dhe prej tij ju ndizni"**, tregon për drurin me të cilin ndizet zjarri dhe jo se zjarri fillon me ndezjen, si, për shembull, me anë të shkrepses, ose me anë të ndonjë mjeti tjetër ndezës.

Bazuar mbi këtë shpjegim, Kur'àni Famëlartë thotë: "All'llahu i Gjithëfuqishëm ka bërë për ju prej pemës së gjelbër dru që ju me atë të ndizni zjarr, patjetër që All'llahu është i fuqishëm të rikthejë në jetë të vdekurit dhe kjo shprehje është në harmoni të plotë me shprehjen "ringjallja e energjisë"! (Mendo thellë në këtë çështje!)

Në të gjitha gjendjet, çështja e ndezjes së zjarrit në drurët e pemëve, megjithëse na duket një çështje e thjeshtë, por vetëm me pak vëmendje do të mësojmë se kjo është prej çështjeve më të çuditshme, për faktin se pjesa më e madhe e lëndëve prej të cilave janë të përbërë drurët, janë uji e dheu, por që të dy janë lëndë që nuk ndizen e nuk marrin zjarr; atëherë, cila është kjo "Fuqi" që krijoi prej ujit, prej dheut dhe prej ajrit, energji, pa të cilën jeta e njerëzve jo vetëm që nuk mund të vazhdojë, por jeta e tyre është e lidhur me këtë energji në mënyrë të fuqishme gjatë mijëra e mijëra viteve!

Ajetet: 81 – 83

أَوَلَيْسَ ٱلَّذِى خَلَقَ ٱلسَّمَـٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضَ بِقَـٰدِرٍ عَلَىٰٓ أَن يَخْلُقَ مِثْلَهُم ۚ بَلَىٰ وَهُوَ ٱلْخَلَّـٰقُ ٱلْعَلِيمُ ﴿٨١﴾ إِنَّمَآ أَمْرُهُۥٓ إِذَآ أَرَادَ شَيْـًٔا أَن يَقُولَ لَهُۥ كُن فَيَكُونُ ﴿٨٢﴾ فَسُبْحَـٰنَ ٱلَّذِى بِيَدِهِۦ مَلَكُوتُ كُلِّ شَىْءٍ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٨٣﴾

"Ai që krijoi qiejt dhe Tokën, a nuk ka fuqi të krijojë të ngjashëm me ata? Po, Ai është Krijuesi, i Dituri."

"Kur Ai dëshiron një send, urdhëri i Tij është: 'Bëhu!' dhe ai (sendi) **bëhet menjëherë."**

"I lartë është vetëm Ai, në dorën e të Cilit është pushteti mbi çdo send dhe te Ai do të ktheheni."

Komentimi

Vetëm All'llahu është Sunduesi e Gjykuesi mbi të gjitha sendet

Në ajetet e sipërme u përmendën argumentet që vërtetojnë ringjalljen, u tërhoq vëmendja rreth zanafillës së krijimit të parë

dhe daljes së zjarrit prej drurit të gjelbër. Ajeti i parë i grupit të ajeteve objekt studimi, e vazhdon këtë temë nga një rrugë e tretë dhe vërteton fuqinë e pamatur të All'llahut të Lartësuar dhe këtë çështje ajeti e shtron në formë pyetjeje: **"Ai që krijoi qiejt dhe Tokën, a nuk ka fuqi të krijojë të ngjashëm me ata? Po, Ai është Krijuesi, i Dituri."**.

Fjalia e parë, që fillon me pyetjen në formë mohuese, çështjen e ndërgjegjësimit dhe mendjes së shëndoshë e stigmatizon në formë pyetjeje, duke u thënë njerëzve: a nuk e shihni hapësirën e pamatur të Qiellit, diejt e yjet e çuditshme që lëvizin në hapësirat e Qiellit me shumë sisteme yjore e me kometa të madhësive të ndryshme, të cilat përbëjnë vetëm një qoshe prej kësaj bote kaq të gjerë e kaq të madhe? Patjetër, Ai që ka fuqi të krijojë të gjitha botët, që s'kanë anë e fund dhe për të cilat Ai ka vënë ligje e sisteme të hollësishme, si nuk paska fuqi Ai të ringjallë të vdekurit?

Përgjigja për këtë pyetje të qartë, në të vërtetë është në brendësi të çdo zemre e shpirti; prandaj ajeti i nderuar nuk pret të kthehet përgjigje për pyetjen që u shtrua, pasi vetë ajeti shton fjalën *"belà"* – *"posi jo"* dhe menjëherë thekson dy cilësi të All'llahut të Lartësuar, cilësinë e krijimit dhe cilësinë e diturisë absolute. Në të vërtetë, kjo mënyrë paraqitjeje është një argument për fjalën e përparshme dhe që u thotë njerëzve: nëse ju dyshoni në fuqinë e Tij për të krijuar, dijeni se vetëm Ai është Krijuesi dhe këtu fjala "Krijuesi" ka ardhur në trajtën e mbiemrit cilësor të shkallës sipërore, domethënë se nuk mund të ketë krijues tjetër përveç Tij.

Në qoftë se mbledhja e të gjitha grimcave të trupave të njerëzve paska nevojë për dituri e për njohje, atëherë dijeni se vetëm Ai është i Dituri Absolut.

Përsa i përket çështjes se kujt i referohet përemri i vetës së tretë i gjinisë mashkullore *"hum"* – *"ata"* në fjalën *"mithlehum"* – *"të ngjashëm me ata"* interpretuesit e Kur'ànit janë shprehur për disa mundësi, por fjala që ka më shumë përhapje është se ky përemër u referohet njerëzve dhe sipas kësaj mundësie interpretimi, kuptimi i fjalisë është: "Krijuesi i Qiellit e i Tokës ka fuqi të krijojë njerëz si ata.".

Këtu del pyetja vijuese: përse ajeti nuk thotë: Ai është i fuqishëm që t'i krijojë ata përsëri, por thotë: **"ka fuqi të krijojë të ngjashëm me ata?"**.

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, janë dhënë përgjigje të shumta dhe përgjigja më e afërt për t`u pranuar është: kur trupi i njeriut shpërbëhet, thënë ndryshe kur trupi i njeriut shkërmoqet e bëhet njësh me dheun, humb përfundimisht formën që kishte, por Ditën e Kiametit, ky njeri do të krijohet përsëri dhe do të krijohet prej të njëjtave lëndë, por do të krijohet me një figurë të re, të ngjashme me figurën e vjetër. Nëse marrim parasysh kushtin kohë për kthimin e të njëjtës figurë të vjetër, në pikëpamjen tonë kjo është e pamundur, veçanërisht kur ne dimë se njerëzit nuk do të ringjallen në formën që kishin në botën e Tokës, pasi, të moshuarit, për shembull, do të ringjallen në moshë të re, invalidët dhe të lindurit me të meta fizike të ndryshme, të gjithë do të ringjallen të shëndetshëm.

Thënë ndryshe, trupi i njeriut ngjan me një qerpiç balte të papjekur, i cili, me kalimin e viteve, shkatërrohet e bëhet përsëri baltë, pastaj kjo baltë mblidhet, punohet dhe bëhet e gatshme për t'u vënë edhe një herë tjetër në një kallëp për të bërë, prej të njëjtës baltë, një qerpiç të ri. Ky qerpiç i ri, nga njëra anë është i njëjti qerpiç i vjetër, nga një anë tjetër, qerpiçi i ri është i ngjashëm me qerpiçin e vjetër, sepse lënda e qerpiçit të ri është e njëjta lëndë e qerpiçit të vjetër, gjithashtu edhe forma e figura e të riut është si forma e figura e të përparshmit.[1] (Mendoje mirë këtë çështje!)

Ajeti vijues përforcon ato që u thanë në ajetet e sipërme, përforcon të vërtetën se krijimi dhe bërja e një sendi, për All'llahun e Lartësuar dhe për fuqinë e Tij, është një çështje fare e lehtë dhe fare e thjeshtë. Krijimi i qiejve pa anë e pa fund, si dhe krijimi i globit të Tokës ku jetojmë, për fuqinë e All'llahut është prej punëve të thjeshta dhe nga ana e lehtësisë janë të barabartë me lehtësinë që ka për All'llahun edhe krijimi i një insekti të vogël.

[1] Disa interpretues të Kur'ànit, përemrin *"hum"* – *"ata"* në fjalën *"mithlehum"* – *"të ngjashëm me ata"* ia referojnë qiejve e Tokës dhe kanë thënë: përdorimi i përemrit në numrin shumës për qeniet me arsye, është për shkak se në Tokë e në Qiell, qeniet me arsye janë të shumta. Të tjerë kanë përfunduar se përdorimi i fjalës *"mithlehum"* – *"të ngjashëm me ata"* nuk e bën domosdoshmëri rikthimin e vetë trupit me lëndët me të cilat ishte formuar në këtë botë, sepse personaliteti i njeriut është i kushtëzuar prej shpirtit të tij, por këtu lind pyetja: ky shpirt, prej cilës lëndë është i varur, që të jetë si njeriu përkatës? Këtu patjetër duhet të kemi në vëmendje se kjo thënie nuk është në harmoni me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit, madje nuk është në harmoni as me kuptimin e jashtëm që shprehin ajetet objekt studimi, sepse Kur'àni Famëlartë thotë qartë e hapur: All'llahu do të krijojë të njëjtat kocka të shkërmoqura e të bëra pluhur përsëri dhe mbi ata do të veshë rrobën e jetës. (Mendo thellë në këtë çështje!)

Në ajetin vijues lexojmë fjalën e të Lartit: **"Kur Ai dëshiron një send, urdhëri i Tij është: 'Bëhu!' dhe ai** (sendi) **bëhet menjëherë."**; çdo send ka lidhje vetëm me urdhërin e me shenjën që Ai bën. Si mund të dyshohet për Zotëruesin e kësaj fuqie kaq të madhe se Ai s'paska mundësi të ngjallë të vdekurit?!

Kuptohet se urdhëri hyjnor këtu nuk është urdhër që shqiptohet me fjalë; gjithashtu edhe fjalën *"kun"* – *"bëhu"* All'llahu i Lartësuar nuk e shpreh me fjalë, sepse i Larti, që s'ka nevojë për asgjë dhe që nuk i mungon asgjë, s'ka nevojë për fjalë, por këtu qëllimi me fjalën *"kun"* – *"bëhu"* është shprehja e vullnetit të All'llahut për të bërë një send apo një qenie, kurse përdorimi i fjalës *"kun"* – *"bëhu"* tregon se kjo është shprehja më e shkurtër, më e vogël dhe më e shpejtë që mund të përfytyrohet, për të shprehur këtë të vërtetë.

Patjetër që vullneti i All'llahut për të bërë një send dhe për t'i dhënë trup këtij sendi, është një proces i vetëm.

Thënë ndryshe, All'llahu i Gjithëfuqishëm, sapo të shfaqë vullnetin për një send, ai send realizohet menjëherë dhe s'ka ndarje në kohë në mes vullnetit të Tij dhe bërjes me trup të atij sendi. Bazuar mbi këtë të vërtetë, urdhëri i Tij dhe fjala e Tij *"kun"* – *"bëhu"* të gjitha këto shpjegojnë shumë qartë çështjen e krijimit dhe të bërjes së një sendi, që ai të ekzistojë kurdo dhe sa herë që i Gjithëfuqishmi shfaq vullnetin e Tij.

Me një shpjegim edhe më të qartë, do të mësojmë edhe më mirë se, punët e All'llahut të Lartësuar, në të vërtetë kalojnë vetëm nëpër dy etapa, pa pasur një të tretë në mes këtyre dy etapave: etapa e shfaqjes së vullnetit hyjnor dhe etapa e bërjes së

sendit. Pikërisht këtë kuptim shpreh ajeti me foljen urdhërore të vetës së dytë: *"kun" – "bëhu"*.

Disa prej interpretuesve të hershëm të Kur'ànit, kanë thënë: kuptimi i kësaj fjale tregon se fjala *"kun" – "bëhu"* është urdhër i shprehur me fjalë dhe këtë e kanë konsideruar prej sekreteve të panjohura të krijimit, mirëpo ata në të vërtetë kanë rënë në ngërçin e fjalës dhe kanë mbetur larg kuptimit të vërtetë, pasi punët e All'llahut të Lartësuar ata i kanë matur me të njëjtin metër që maten punët e njerëzve.

Sa bukur e ka shprehur Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, këtë të vërtetë në njërën prej hytbeve të tij që kanë ardhur në "Nehxhul Belàga": *"kur shfaq vullnetin e Tij që një send të ekzistojë Ai thotë "bëhu", pa zë me tingull, pa thirrje që dëgjohet; "bëhu" është fjalë e të Gjithëfuqishmit, është punë e dalë prej Tij kur Ai krijon sendin; një shembull i këtillë nuk mund të gjendet në asnjë qenie, madje edhe sikur ajo të jetë e hershme, patjetër që ajo do të jetë e dyta."*.[1]

Sikur ne të hamendsojmë ekzistencën e një shqiptimi të një fjale në procesin e krijimit, menjëherë do të ndeshemi me dy probleme themelore:

I pari: vetë fjala e shqiptuar është njëra prej krijesave të All'llahut dhe Ai ka bërë të ekzistojë fjala e shqiptuar; All'llahu i Lartësuar nuk ka nevojë të thotë *"kun" – "bëhu"* por kjo përputhet me faktin se krijimi i njerëzve është një proces zinxhir, pa fund.

I dyti: çdo fjalë e thënë ka nevojë për një bashkëbisedues dhe kur nuk gjendet asnjë send, atëherë si ka mundësi që All'llahu i Lartësuar të thotë fjalën *"kun" – "bëhu"* kur sendi nuk

[1] "Nehxhul Belàga", hytbeja 186.

ekziston? A është e mundur të bashkëbisedohet më atë që nuk ekziston?!

Fjala *"kun"* – *"bëhu"* me këtë kuptim ka ardhur edhe në ajete të tjera të Kur'ànit Famëlartë, si, për shembull, në ajetin 117 të sures "El Bekare": **"…dhe kur Ai vendos për diçka, Ai vetëm i thotë asaj 'Bëhu!' dhe ajo menjëherë bëhet"**; gjithashtu, edhe në ajetin 40 të sures "En Nahl", i Larti thotë: **"Kur Ne dëshirojmë një send, vetëm i themi atij 'Bëhu!' dhe ai menjëherë bëhet."**.[1]

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve objekt studimi, që është edhe ajeti i fundit i sures "Jàsijn", mbyllet nëpërmjet një përfundimi përgjithësues mbi studimin rreth çështjes së fillimit të krijimit dhe të ringjalljes pas vdekjes, me një mënyrë shumë të bukur dhe për këtë ajeti thotë: **"I Lartë është vetëm Ai, në dorën e të Cilit është pushteti mbi çdo send dhe te Ai do të ktheheni."**.

Duke marrë në konsideratë se fjala e ajetit *"melekùtu"* në rrënjën e saj *"mulk"* është në kuptimin e qeverisjes e të sundimit, germa *"u"* dhe germa *"t"* të shtuara në këtë fjalë janë për të theksuar sundimin e qeverisjen absolute. Me këtë shpjegim, kuptimi i ajetit është: "qeverisja dhe sundimi absolut, pa asnjë kusht, është vetëm në dorën e fuqisë së Tij absolute, por All'llahu i Lartësuar është krejtësisht i dëlirë e i pastër nga mangësitë e pamundësitë në fuqinë e Tij". Në këtë këndvështrim, ngjallja e të vdekurve dhe veshja e rrobës së jetës mbi kockat e kalbura e të bëra pluhur edhe një herë tjetër, të gjitha këto për All'llahun e Lartësuar nuk përbëjnë asnjë problem, prandaj dijeni mirë se ju të

[1] Në lidhje me shprehjen *"kun fejekùnu"* – **"'Bëhu!' dhe ai menjëherë bëhet"** kemi vënë një studim tjetër në komentin e ajetit 117 të sures "El Bekare".

gjithë do të ktheheni te Ai; gjithashtu, dijeni mirë se çështja e ringjalljes është plotësisht e vërtetë.

Hulumtime

Më sipër kemi premtuar se, në fundin e komentimit të sures "Jàsijn", do të shpalosim një studim të përmbledhur në lidhje me çështjen e Ringjalljes dhe tani po e mbajmë këtë premtim, duke trajtuar këtë çështje për lexuesit e nderuar nëpërmjet gjashtë studimeve, si vijon:

1- Besimi në Ringjalljen është çështje e lidhur me natyrën e krijimit të njeriut

Me qenë se njeriu është krijuar për të vdekur, atëherë patjetër njeriu duhet të ketë dëshirë të vdesë dhe duhet të ndjejë kënaqësi që po i merr fund jeta; mirëpo ne shikojmë se në të gjitha kohërat, vdekja, në kuptimin e zhdukjes, nuk është diçka që sjell gëzim në njeriun, prandaj njeriu bën aq sa mundet, me tërë qenien e tij, që t'i largohet vdekjes.

Puna e mundimshme për ruajtjen e trupave të të vdekurve pa u prishur nëpërmjet mumizimit, apo ndërtimit të varreve monumentale si piramidat në Egjipt, apo rendja e përhershme e njeriut për të gjetur atë që quhet "uji i jetës dhe ilaçit të rinisë" dhe i gjithçkaje tjetër që zgjat jetën, të gjitha këto janë argumente që

vërtetojnë dashurinë e madhe që ka njeriu për konceptin e qëndrueshmërisë së përhershme. Kur ne jemi krijuar për t'u zhdukur, atëherë ç'kuptim ka dashuria për të qëndruar përgjithmonë, veç asaj që kjo dashuri është një preokupim pa kuptim e pa dobi.

Në të vërtetë, ne po ndjekim studimin rreth çështjes së Ringjalljes dhe mos harroni se kemi rënë në një fjalë të përbashkët për domosdoshmërinë e besimit në ekzistencën e All'llahut, të Urtit, të Gjithëditurit. Ne besojmë se çdo gjë që ka krijuar All'llahu i Gjithëfuqishëm në qenien tonë, patjetër është në përputhje të plotë me një llogaritje të përpiktë e me një qëllim të caktuar dhe bazuar mbi këtë besim, dëshira e madhe që ka njeriu për të qëndruar përgjithmonë, patjetër që edhe për këtë dëshirë të njeriut ka një llogaritje të veçantë, që patjetër është në harmoni të plotë me krijimin dhe me jetën në botën pas jetës në botën e Tokës.

Thënë ndryshe, sistemi i krijimit ka bërë tek ne njerëzit etjen, por ky fakt në vetvete është një argument që vërteton ekzistencën e ujit në mjedisin e jashtëm; gjithashtu edhe ekzistenca e instiktit seksual dhe prirja ndaj gjinisë tjetër në njeriun, është argument që vërteton ekzistencën e gjinisë tjetër në mjedisin e jashtëm, ndryshe, kjo tërheqje, pa pasur një qëllim dhe një subjekt të jashtëm, nuk përputhet me urtësinë e krijimit.

Nga ana tjetër, kur ne studiojmë historinë e Njerëzimit, qysh nga koha kur fillon historia, do të gjejmë argumente të shumtë që vërtetojnë besimin e patundur të njeriut në jetën pas vdekjes. Prej përmendoreve arkeologjike që kanë arritur deri te ne, mësojmë rreth jetës së njerëzve të hershëm, madje edhe rreth

jetës së njeriut prehistorik dhe sidomos nga mënyra e varrosjes së të vdekurve dhe nga mënyra e ndërtimit të varreve, madje nga fakti i vënies në varr të sendeve të ndryshme së bashku me të vdekurin, ne mësojmë për besimin që kishin njerëzit e hershëm në jetën pas vdekjes. Të gjitha objektet arkeologjike janë një argument shumë domethënës, që vërteton besimin e rrënjosur në qenien e njerëzve për ekzistencën e jetës pas vdekjes.

Samuel Knik, njëri prej psikologëve të njohur, thotë: studimet e hollësishme vërtetojnë se grupimet e para njerëzore mbi sipërfaqen e Tokës, kishin besime të caktuara, ata i varrosnin të vdekurit e tyre në tokë me një mënyrë të përcaktuar dhe së bashku me të vdekurin, vinin në varrin e tij edhe mjete e vegla pune, me të cilat i vdekuri kishte punuar para vdekjes. Me këtë rrugë varrimi, ata vërtetojnë besimin e tyre për ekzistencën e botës pas vdekjes.[1]

Pra, njerëzit e hershëm kanë besuar në jetën pas vdekjes edhe pse ata kanë ndjekur rrugë të gabuara në besimin e tyre, si, për shembull, ata pandehnin se jeta pas vdekjes është plotësisht e ngjashme me jetën që bëjnë njerëzit në këtë botë.

Si do që të jetë, nuk mund të pranohet se ky besim i vjetër ishte thjesht një iluzion, ose rezultat i ardhur prej zakonit.

Nga një anë e tretë, vetë qenia njerëzore është një argument tjetër që vërteton se besimi në ringjalljen është në natyrën e krijimit të çdo njeriu. Kur njeriu bën një punë të mirë, në thellësi të qenies së tij njeriu ndjen atë siguri që ai nuk është në gjendje ta shpjegojë e ta përshkruajë me fjalë.

[1] Sociologji, (Samuel Knik), f. 192; me pak përmbledhje.

Por ndodh e kundërta, kur njeriu bën faje, veçanërisht kur bën faje që janë penalitete të mëdha; në këtë gjendje, ky njeri nuk ndihet i qetë, madje në disa gjendje ky fajtor arrin deri aty sa kryen aktin e vetëvrasjes, ose vetëdorëzohet në organet e drejtësisë që të marrë dënimin e merituar edhe pse e di që do të përfundojë i varur në trekëndëshin e ekzekutimit.

Të gjitha këto janë argumente që vërtetojnë ndëshkimin e shpirtit dhe të trupit.

Njeriu le të pyesë veten: si është e mundur që, një botë kaq e vogël, siç është bota e shpirtit, të jetë për atë gjykatë dhe të mos ketë gykatë për këtë botë kaq të madhe, siç është bota e ekzistencës?!

Me këtë mënyrë shpjegohet qartë se besimi në çështjen e ringjalljes e në jetën pas vdekjes, është një çështje e natyrës së krijimit të njeriut dhe që shfaqet në disa rrugë:

Me rrugën e dashurisë së Njerëzimit për të jetuar përgjithmonë.

Me rrugën e ekzistencës së besimit në jetën pas vdekjes gjatë gjithë historisë së Njerëzimit.

Me rrugën e ekzistencës së një minimodeli në brendësi të njeriut për jetën pas vdekjes.

2- Ndikimi i besimit në Ringjalljen mbi jetën e njerëzve

Besimi në ekzistencën e një bote pas vdekjes dhe se punët e njerëzve, punë të mira ose punë të këqija, në mënyrë të barabartë nuk zhduken, ky besim lë gjurmën e tij të thellë në mendimin, në nervat e në gjithë trupin e njeriut; njëkohësisht, është një faktor me ndikim shumë të madh për nxitjen e njeriut që ai të bëjë punë të mira.

Në të vërtetë, ndikimi që ka besimi në jetën pas vdekjes në përmirësimin e individëve të degjeneruar, ose në nxitjen e individëve për të sakrfikuar dhe për të luftuar në rrugën e së vërtetës, është shumë herë më i madh se ndikimi i vendimeve të gjykatave dhe i dënimeve që praktikohen zakonisht në këtë botë. Veçoritë e besimit në jetën pas vdekjes janë të dukshme dhe shumë të dallueshme në gjykatat e zakonshme, prandaj në gjykatat e apelit nuk lind nevoja për rishikimn e çështjes; gjithashtu, nuk është i nevojshëm as ushtrimi i presionit psikologjik mbi fajtorin; gjithashtu, s'ka asnjë dobi prej dhënies së dokumenteve të rremë e të falsifikuar, sepse, gjatë shikimit të atyre dokumenteve, mashtrimi nuk mund të vazhdojë për një kohë të gjatë.

Këtë të vërtetë, Kur'àni Famëlartë e shpreh në ajetin 48 të sures "El Bekare": **"Dhe kijeni frikë Ditën në të cilën askush nuk mund të bëjë asgjë për tjetrin dhe për atë** (jobesimtarin) **nuk pranohet as ndonjë ndërmjetësim, nuk merret as ndonjë kompensim dhe as nuk do të ndihmohen."**.

Gjithashtu, në ajetin 54 të sures "Junus", i Larti thotë: **"Sikur çdo njeri që i ka bërë padrejtësi vetes** (me mosbesimin e tij) **të kishte çdo gjë që ka në Tokë, ai do t'i jepte të gjitha** (që të

shpëtonte)**; kur ata do të shohin dënimin e fshehin dëshpërimin; atyre u bëhet gjykimi i drejtë dhe nuk u bëhet asnjë padrejtësi.”**.

Kurse në ajetin 51 të sures “Ibràhim”, i Larti thotë: **“Që All’llahu të shpërblejë çdo njeri me punën që ai ka bërë; me të vërtetë All’llahu është i shpejtë në llogari.”**.

All’llahu i Lartësuar është shumë i shpejtë dhe i prerë në marrjen e njerëzve në llogari, ashtu siç e lexojmë në disa transmetime: “All’llahu i Lartësuar i merr në llogari të gjitha krijesat, aq shpejt sa të lëvizësh syrin”.[1]

Ky është shkaku që Kur’àni Famëlartë thotë se shkaku i shumë prej fajeve është harrimi i Ditës së Llogaridhënies, ashtu siç e lexojmë në fjalën e të Lartit në ajetin 14, të sures “Es Sexhde”: **“Prandaj shijojeni këtë** (dënimin) **për shkak se ju e harruat takimin tuaj me këtë Ditë.”**.

Prej disa ajeteve kur’anore, mësohet se kur njeriu beson në Ditën e Gjykimit, ai menjëherë frenohet dhe heq dorë prej shumë punëve që janë kundërvajtje, ashtu siç e lexojmë në fjalën e të Lartit në ajetet 4 dhe 5 të sures “El Mutaf’fifijn”, në të cilat përshkruhet gjendja e atyre që peshojnë e masin mangut: **“A nuk mendojnë ata se patjetër do të ringjallen, në Ditën e Madhe?”**.

Entuziazmi i përjetshëm i luftëtarëve që luftuan në të kaluarën dhe që luftojnë në ditët e sotme në mbrojtje të Islamit në fushat e ndryshme të betejave, sakrificat dhe vetëflijimi që manifestohet në shumë myslimanë që luftojnë me të gjitha rrugët

[1] Tefsiri “Mexhmaul Bejàn”, vëll. 1. F. 298, sure “El Bekare”, fundi i ajetit 202 të kësaj sureje.

në mbrojtje të vendeve islame dhe në mbrojtje të të pafuqishmëve, të privuar nga liritë, të gjitha këto janë argument që pasqyron gjendjen e besimit në Jetën e Përjetshme dhe të besimit në Botën Tjetër. Studimet e bëra prej mendimtarëve, si dhe eksperimentet e ndryshme, kanë treguar se këto dukuri nuk mund të vlerësohen me metrin me të cilin maten punët në përgjithësi, por ato janë të matshme vetëm me rrugën e besimit në jetën pas vdekjes.

Në ajetin 52 të sures "Et Teube", lexojmë se në logjikën e luftëtarit në rrugën e mbrojtjes së fesë së All'llahut, është vendimtare: **"Thuaj: ç'prisni për ne përveç njërës prej dy të mirave"**, domethënë: arritjen e njërës prej dy lumturive, ose fitoren ose rënien dëshmor. Ky është luftëtari i vendosur, që nuk e pranon disfatën në luftën e tij në mbrojtje të fesë së All'llahut.

Vdekja shkakton egërsi në shumë njerëz, madje kanë frikë thjesht nga përmendja e fjalës vdekje, ose nga përmendja e punëve që kanë lidhje me vdekjen; kurse në ata që besojnë në jetën pas vdekjes, fjala vdekje nuk shkakton asnjë lloj egërsie apo ndjenje të keqe; në të kundërt, për ata që besojnë në jetën pas vdekjes, vdekja është një dritare për të parë një botë të gjerë; për besimtarin vdekja e shemb kafazin e kësaj bote në të cilin ai është mbyllur, thyen prangat materiale që i kanë robëruar shpirtin dhe me Jetën Tjetër ai arrin lirinë absolute.

Çështja e Ringjalljes konsiderohet vija ndarëse në mes deistëve dhe materialistëve, për shkak se për këtë çështje ka dy teori të kundërta.

Materialisti mendon se vdekja është asgjësim i plotë, prandaj ai mundohet t'i largohet vdekjes me të gjithë qenien e tij, pasi, për materialistin, me vdekjen mbaron çdo gjë.

Deisti beson se vdekja për atë është lindje e re, është një portë hyrjeje në një botë të gjerë, të madhe e rrezatuese, është një startim në drejtim të Qiellit të pakufishëm. Për ata që besojnë në jetën pas vdekjes, është e natyrshme që ata nuk u lënë vend frikës e ashpërsisë të futen në shpirtin e tyre, sepse ata ecin me vendosmëri në rrugën e vdekjes e të rënies dëshmor; ky besimtar e gjen frymëzimin në përshkrimin që i ka bërë vetes Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Pasha All'llahun, Ibni Ebù Tàlibi kënaqet me vdekjen më shumë se fëmija me gjirin e nënës së tij.*".[1]

Rënien dëshmor në rrugën e realizimit të qëllimit për të mbrojtur fenë e All'llahut dhe vendin e tyre, besimtarët e presin me zemër të hapur, ashtu siç e priti Prijësi i besimtarëve Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* kur e goditi shpata e tradhëtisë e lyer me helm prej kriminelit Abdurrahman Ibni Mulxhem; në atë çast ai nuk tha asnjë fjalë tjetër veçse: "*Betohem për Zotin e Qabesë, unë fitova.*".

Si përfundim, besimi në ringjalljen pas vdekjes, bën që, prej njeriut të frikësuar e të humbur, të dalë një njeri trim e i vendosur në qëllimin e tij; besimi në jetën pas vdekjes e mbush jetën e tij me entuziazëm, e bën atë të gatshëm për çdo sakrificë, e bën të sinqertë dhe njeri të përkushtuar.

[1] "Nehxhul Belàga", hytbeja 5.

3- Argumentet logjike që vërtetojnë Ringjalljen

Përveç argumenteve të shumtë tekst, që kanë ardhur në Kur'ànin Famëlartë, madje janë qindra ajete Kur'anore që flasin në mënyrë të veçantë për çështjen e Ringjalljes, ka edhe argumente logjike shumë të qarta që vërtetojnë çështjen e Ringjalljes. Në vijim, do të përpiqemi të rendisim këto argumente logjike, në mënyrë të përmbledhur.

a) Argumaneti i urtësisë:

Kur ne e mendojmë këtë botë pa Botën Tjetër, kjo botë do të jetë e zbrazët dhe plotësisht pa kuptim; është sikur të supozojmë etapat e jetës së fëmijës në mitrën e nënës pa daljen e tij në jetën e kësaj bote.

Sikur ligji i krijimit të ishte se të gjithë të lindurit e rinj do të mbyteshin sapo të dilnin prej barqeve të nënave të tyre, etapa e zhvillimit të fëmijës në mitrën e nënës do të ishte pa asnjë kuptim. Sikur jeta në këtë botë të ishte e ndërprerë prej jetës në Botën Tjetër, menjëherë do të përballeshim me të njëjtin trazim e hutim dhe menjëherë do të shtrohej pyetja: përse qenka e domosdoshme të jetojmë në këtë botë, në mes kaq e kaq problemesh, shtatëdhjetë vjet, ose më shumë, ose më pak? Kur fillojmë jetën, s'kemi asnjë përvojë të caktuar e të njohur dhe kur arrijmë të njohim e të fitojmë përvojë, ne na sulmon vdekja dhe jeta jonë merr fund; për shumë kohë përpiqemi të fitojmë dituri e të mësojmë dhe kur arrijmë në një gradë të dijes e të njohjes, atëherë na është zbardhur koka dhe na pret vdekja.

Pastaj, përse duhet të jetojmë?! Për të ngrënë, për të veshur rroba e stoli, për të fjetur e për t'u zgjuar prej gjumit në mënyrë të

përsëritur, ditë për ditë dhe kjo rutinë lodhëse vazhdon për dhjetëra vjet, përse vlen kjo jetë?!

Ky Qiell pa anë e pa fund, kjo Tokë e gjerë, këto veprime paraprake e veprime derivate, gjithë këta mësues, profesorë dhe edukues, këto biblioteka të mëdha dhe të gjitha këto punë të imta e të hollësishme, mos vallë të gjitha këto kanë ndonjë lloj ndikimi në krijimin tonë dhe në krijimin e qenieve të tjera, thjesht për të ngrënë, për të pirë, për të veshur rroba e stoli dhe për të bërë këtë jetë materiale?

Ata që nuk besojnë në Ringjalljen, me veprimet e tyre pohojnë kotësinë e kësaj bote dhe disa prej tyre jo vetëm që arrijnë deri aty sa kryejnë vetëvrasje, me qëllim që të shpëtojnë prej kësaj bote të zbrazët, por edhe krenohen me aktin e vetëvrasjes!

Si ka mundësi, për atë që beson në All'llahun dhe në urtësinë e punëve të Tij, ta konsiderojë këtë botë pa lidhje me Botën Tjetër, e cila për atë është me vlera të mëdha dhe shumë e rëndësishme?

Në ajetin 115 të sure "El Mu'minùn", i Larti thotë: **"Mos vallë mendoni se Ne u kemi krijuar kot dhe se ju nuk do të ktheheni te Ne?"**, domethënë: sikur të mos ishte kthimi juaj te All'llahu i Lartësuar pas jetës në këtë botë, jeta juaj në këtë botë do të ishte një gjë pa kuptim dhe fare e kotë.

Po, jeta në këtë botë e gjen kuptimin e saj dhe është në harmoni me urtësinë e All'llahut të Lartësuar, kur ju e konsideromi këtë botë "një fermë të mbjellë në Botën Tjetër", "urë kalimi", vend për të mësuar, universitet për t'u përgatitur për Botën Tjetër dhe një tregtore për të fituar Botën Tjetër, ashtu siç e

ka shprehur këtë çështje Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* në njërën prej fjalëve të tij me kuptim shumë të thellë: *"Kjo botë është shtëpia e të vërtetës për atë që beson në të vërtetën, është shtëpia e përfundimit për atë që e kupton atë, është shtëpia e pasurimit për atë që merr furnizim në të, është shtëpia e këshillimit për atë që këshillohet me të, është vendi ku bëjnë adhurim të dashurit e All'llahut, është vendi ku falin namaz engjëjt e All'llahut, është vendzbritja e Revelatës së All'llahut dhe tregtorja ku fitojnë miqtë e All'llahut."*.[1]

Dhe thelbi i fjalës: vështrimi me kujdes, mësimi e marrja informacion për gjendjen në këtë botë, çon në besimin në Botën Tjetër, në botën përtej botës së Tokës, ashtu siç e lexojmë këtë të vërtetë në ajetin 62 të sures "El Uàkiah": **"Ju e keni njohur zanafillën e parë, përse nuk mendoni?"**.

b) *Argumenti i drejtësisë:*

Nga një vështrim me imtësi në sistemin e ekzistencës dhe në ligjet e krijimit, rezulton se të gjitha sendet në Gjithësi janë sipas një llogaritjeje shumë të përcaktuar. Në sistemin e trupit të njeriut është zotërues një sistem shumë i drejtë dhe i hollësishëm; sikur në trupin e njeriut të ndodhë edhe ndryshimi më i vogël, ose kur, rastësisht, mbi trupin e njeriut të bjerë diçka e jashtme, këto bëjnë që trupi i njeriut të preket nga sëmundje, ose bëjnë që njeriu të vdesë: rrahjet e zemrës, qarkullimi i gjakut, zgavrat e syve, çdo pjesë prej qelizave të trupit të njeriut është e përfshirë në këtë sistem të hollësishëm, që është sistemi që sundon të gjithë botën: me drejtësi qëndrojnë qiejt dhe Toka".[2] A ka mundësi që vetëm njeriu të jetë "nota më e lartë" në këtë botë të gjerë?!

[1] "Nehxhul Belàga", fjalët e shkurtëra, fjala 131.
[2] Tefsiri "Es Sàfij", vëll. 5, f. 107, fundi i ajetit 7, sure "Err Rrahmàn".

Është e vërtetë që All'llahu i Lartësuar i ka dhënë njeriut lirinë e veprimit dhe që të vendosë me vullnetin e me zgjedhjen e tij, por këtë liri All'llahu ia ka dhënë njeriut me qëllim që ta provojë atë dhe me qëllim që njeriu të plotësohet nën hijen e kësaj lirie veprimi të vullnetshëm dhe që të vazhdojë rrugëtimin drejt plotësimit; por, ç'ndodh kur njeriu e keqpërdoron këtë liri veprimi? Sikur mizorët që kanë rënë në rrugën e humbjes, të punojnë që të çojnë edhe të tjerët në rrugën e humbjes, sikur ata, në saje të keqpërdorimit të kësaj dhurate të madhe të All'llahut, të vazhdonin në rrugën e tyre të gabuar, çfarë presupozon drejtësia hyjnore për këtë kategori keqbërësish?

Është e vërtetë se, disa keqbërës dënohen e ndëshkohen në këtë botë dhe marrin dënimin për fajet që kanë bërë, ose të paktën vetëm një pakicë prej keqbërësve dënohen; por është pranuar se jo të gjithë keqbërësit marrin dënimin që meritojnë në këtë botë; gjithashtu edhe të gjithë punëmirët nuk e marrin shpërblimin në këtë botë për punët e tyre të mira; a ka mundësi që këto dy kategori njerëzish të jenë të barabartë në peshoren e drejtësisë së All'llahut?!

Kur'àni Famëlartë, në ajetin 35 dhe në ajetin 36 të sures "El Kalem", thotë: **"Mos vallë do të bëjmë myslimanët të barabartë me kriminelët. Ç'është me ju, si gjykoni ashtu?"**.

Në ajetin 28 të sures "Sàd", Kur'àni thotë: **"Mos vallë do të konsiderojmë të devotshmit si mëkatarët?"**.

Në të gjitha gjendjet, pa dyshim që ka ndryshim në mes njerëzve në lidhje me shkallën e nënshtrimit e të bindjes që ata kanë ndaj urdhërave të All'llahut të Lartësuar; gjithashtu edhe

gjykatat që nxjerrin vendime në këtë botë për "ndëshkime fizike dhe dënime të ndryshme", si dhe "gjykatat që vërtetojnë gjurmët konkrete të fajeve", mesa duket, të gjitha këto nuk janë të mjaftueshme për të vendosur drejtësinë. Bazuar mbi këtë pranim të faktit, rezulton se, për të vënë në vend drejtësinë hyjnore, patjetër duhet të ekzistojë një gjykatë e përgjithshme drejtësie, gjykatë e cila trajton me imtësi të mirën e të keqen, ndryshe baza e drejtësisë kurrë nuk mund të sigurohet.

Mbështetur mbi këtë që u tha, duhet të pohohet se pranimi i drejtësisë është i barabartë me domosdoshmërinë për të pranuar Ringjalljen dhe Ditën e Llogaridhënies. Për këtë, Kur'àni Famëlartë, në ajetin 47 të sures "El Enbijà", thotë: **"Ne do të vemë peshoren e drejtë Ditën e Gjykimit"** dhe në ajetin 54 të sures "Junus", thotë: **"Gjykimi në mes tyre bëhet me drejtësi dhe atyre nuk u bëhet padrejtësi."**.

c) Argumenti i qëllimit:

Në kundërshtim me atë që pandehin materialistët, deistët besojnë se, me krijimin e njeriut, ka një qëllim, të cilin filozofët e kanë emërtuar me termin "plotësim", kurse në gjuhën e Kur'ànit dhe të hadithit, ky qëllim është "afrimi te All'llahu", ose "adhurimi kushtuar vetëm All'llahut", ashtu siç njofton Kur'àni për këtë të vërtetë, në ajetin 56 të sures "Edh Dhàrijàt: **"Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për ndonjë gjë tjetër, përveçse që të më adhurojnë Mua."**.

Vallë, a mund të realizohet ky qëllim, nëse vdekja është fundi i çdo gjëje?!

Patjetër, pas botës së Tokës duhet të ketë një botë tjetër, në të cilën të vazhdojë ecuria e njeriut të plotësuar dhe në të cilën njeriu do të korrë atë çka mbolli në botën e Tokës. Në një vend tjetër, kemi thënë se ecuria e njeriut të plotësuar do të vazhdojë në Botën Tjetër, që të arrihet qëllimi i tij përfundimtar.

Si përmbledhje të kësaj, themi: realizimi i qëllimit prej njerëzve nuk është i mundur pa besimin në Ringjalljen. Kur ne bëjmë ndërprerjen në mes botës së Tokës dhe botës pas vdekjes, çdo gjë kthehet në enigmë dhe shumë shpejt nuk do të kishte përgjigje për shumë pyetje.

d) Argumenti i mohimit të ndryshimit:

Pa dyshim që ne vuajmë shumë prej ndryshimeve e kundërthënieve që vërehen në mes shkollave juridike dhe doktrinave që ekzistojnë në këtë botë; prandaj të gjithë ne urojmë që këto ndryshime e kundërthënie të gjejnë zgjidhje, në një kohë kur të gjitha ligjet tregojnë se këto ndryshime e kundërthënie janë në vetë karakterin e jetës në botën e Tokës. Prej disa argumenteve, mësohet se edhe pasi Mehdiu *(Paqja qoftë mbi të!)* të vendosë qeverinë e drejtësisë së përbotshme, në të cilën do të shuhen shumë prej mosmarrëveshjeve e kundërthënieve, përsëri disa mosmarrëveshje doktrinale do të mbeten pa marrë zgjidhje të plotë. Kur'àni Famëlartë, në ajetin 14 të sures "El Màide", shpjegon se të krishterët dhe jehuditë do të vazhdojnë të mbeten në mosmarrëveshjet e tyre deri Ditën e Kiametit, ashtu siç njofton ajeti i nderuar: **"Ne kemi nxitur në mes tyre armiqësi e urrejtje deri Ditën e Kiametit."**.

Por All'llahu i Lartësuar udhëheq të gjitha sendet në drejtim të unitetit dhe këto ndryshime e kundërthënie patjetër që do të marrin fund, por, për shkak të ekzistencës së perdeve të trasha në botën e materies, është e pamundur zgjidhja e kësaj pune në mënyrë të plotë në këtë botë; gjithashtu, ne dimë se Bota Tjetër është Bota në të cilën gjërat janë të dukshme e të zbuluara; atëherë, fundi i kësaj çështjeje do të jetë fund praktikisht dhe të vërtetat do të jenë të qarta e të dukshme, deri në atë shkallë sa ndryshimet në doktrinat do të zgjidhen në mënyrë të plotë dhe përfundimisht.

Është me kuptim shumë të bukur që kjo çështje, në disa ajete të Kur'ànit Famëlartë, theksohet në mënyrë të veçantë dhe për këtë, i Larti, në ajetin 113 të sures "El Bekare", thotë: **"All'llahu do të gjykojë në mes tyre Ditën e Kiametit për ato që ata kishin kundërshtime."** dhe në ajetet 38-39 të sures "En Nahl", i Larti thotë: **"Ata u betuan në All'llahun me betimin e tyre të fortë se All'llahu nuk e ringjall atë që vdes; patjetër** (Ringjallja) **është premtimi i Tij i vërtetë, por shumica e njerëzve nuk dinë;** (i ringjall) **që t'ua bëjë atyre të qartë atë për të cilën ata kishin kundërshtim dhe që mohuesit të marrin vesh se ata ishin gënjeshtarë."**.

4- Kur'àni dhe çështja e Ringjalljes

Çështja e Ringjalljes konsiderohet çështja e dytë pas çështjes së Njëtimit të All'llahut dhe konsiderohet çështje themelore në mësimet e Profetëve *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)* me të gjitha veçantitë dhe ndikimet e saj edukuese; prandaj, në Kur'ànin Famëlartë gjejmë se shumica e ajeteve e trajtojnë çështjen

e ringjalljes pas vdekjes në mënyrë të veçantë, menjëherë pas ajeteve të shumta që trajtojnë çështjen e Njëtimit të All'llahut.

Studimet kur'anore rreth ringjalljes pas vdekjes, herë janë të konkretizuara në formën e nxjerrjes së argumenteve logjike, herë të tjera janë të kontretizuara në formën e leksioneve studimore dhe udhëzuese, me ndikim shumë të fuqishëm, në atë mënyrë që dëgjimi i këtyre studimeve, në disa raste shkakton rrënqethje të lëkurës në të gjithë trupin. Fjala e vërtetë është si kërkimi i argumenteve logjike depërton në thellësi të shpirtit njerëzor.

Në pjesën e parë, domethënë në argumentet logjike, Kur'àni Famëlartë e thekson fuqishëm problemin e mundësisë së ringjalljes pas vdekjes, kurse ata që e mohojnë ringjalljen pas vdekjes, në të shumtën e herës kanë iluzione për pamundësinë e ndodhjes së ringjalljes dhe janë të bindur për pamundësinë e ringjalljes trupore; ata thonë se ringjallja trupore kërkon kthimin e trupave të shkërmoqur e të bërë njësh me dheun edhe një herë tjetër në jetë.

Çështja e ringjalljes trupore, në Kur'ànin Famëlartë trajtohet me rrugë të shumëllojshme e të ndryshme, të cilat të gjitha takohen në një pikë të vetme, takohen në çështjen e "mundësisë logjike të ringjalljes".

Për njeriun, zanafilla e krijimit të tij herë konkretizohet me një frazë të shkurtër por shumë shprehëse dhe të qartë; për këtë Kur'àni Famëlartë flet në ajetin 29 të sures "El A'ràf": **"…ashtu siç ju krijoi për herë të parë, ashtu do të ktheheni."**.

Herë tjetër e konkretizon jetën me vdekjen me ringjalljen e bimëve, fakt që ne e shohim me sytë tanë çdo vit, duke i thënë njeriut me këtë konkretizim se edhe vdekja juaj, në të vërtetë është plotësisht si vdekja e ringjallja e bimëve dhe për këtë Kur'àni Famëlartë, në ajetin 9 dhe në ajetin 11 të sures "Kàf", thotë: **"Ne prej Qielli zbritëm ujin e begatë, me të cilin bëmë të kultivohen kopshte dhe drithëra që korren…** (me ujin) **Ne e ringjallëm tokën e vdekur, kështu do të jetë edhe Ringjallja."**.

Në ajetin 9 të sures "Fàtir", i Larti thotë: **"All'llahu është Ai që i lëshon erërat, të cilat lëvizin retë, Ne i drejtojmë ato për në një vend të thatë dhe me atë** (ujin e reve) **Ne ngjallim tokën pasi ajo kishte vdekur; kështu është edhe Ringjallja."**.

Herë tjetër shtrohet çështja e fuqisë së All'llahut të Lartësuar në krijimin e qiejve e të Tokës dhe për këtë Kur'àni Famëlartë, në ajetin 33 të sures "El Ahkàf", thotë: **"A nuk mendojnë ata se All'llahu që krijoi qiejt e Tokën dhe nuk u lodh për krijimin e tyre, ka fuqi të ngjallë të vdekurit; patjetër, vetëm Ai ka fuqi të plotë për të gjitha sendet."**.

Herë tjetër, Kur'àni shpalos ringjalljen e energjisë dhe ndezjen e drurëve të gjelbër, si model që vërteton fuqinë e Tij dhe që tregon se Ai ka bërë që zjarri të jetë në "zemrën" e ujit, ashtu siç e lexojmë këtë të vërtetë në ajetin 80 të sures "Jàsijn": **"Ai bëri zjarr për ju prej drurit të gjelbër."**.

Herë tjetër, Kur'àni konkretizon Ringjalljen para syve të lexuesve e të dëgjuesve, me etapat e zhvillimit të njeriut në barkun e nënës së tij, ashtu siç njoftohet në ajetin 5 të sures "El Haxhxh": **"O njerëz, nëse keni dyshim për Ringjalljen, atëherë** (mendoni fillimin e krijimit tuaj) **Ne ju krijuam prej dheut, pastaj**

prej një pike uji (spermatozidit)**, pastaj prej një gjaku të ngjizur, pastaj prej cope mishi që është një krijesë e formuar ose e paformuar, në mënyrë që t'jua bëjmë të qartë; ndërsa për atë që ne dëshirojmë, e lëmë në mitër deri në një afat të caktuar dhe pastaj Ne ju nxjerrin foshnje."**.

Më në fund, Kur'àni e ngjason vdekjen me gjumin e gjatë, gjumin që është i ngjashëm me vdekjen dhe që është vëllai i vdekjes. Në të vërtetë, vdekja ngjan me gjumin nga shumë anë, siç ishte gjumi i djemve të shpellës (As'hàbul Kehf), të cilët qëndruan në gjumë treqind e nëntë vjet dhe pas një shkoqitjeje të bukur të gjendjes së tyre në mes gjumit dhe zgjimit, Kur'àni Famëlartë njofton për këtë në ajetin 21 të sures "El Kehf": **"Kështu Ne i zbuluam ata** (i zgjuam prej gjumit të gjatë) **që të kuptojnë se premtimi i All'llahut** (për Ringjalljen) **është plotësisht i vërtetë dhe se për Kiametin s'ka asnjë dyshim…"**.

Këto janë gjashtë mënyrat e ndryshme që shpalosin ajetet e Kur'ànit Famëlartë për të shpjeguar mundësinë e Ringjalljes, por këtu duhet shtuar edhe tregimi në lidhje me katër shpendët që u urdhërua të therte Profeti i All'llahut Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe që përmendet në ajetin 260 të sures "El Bekare", ose tregimi në lidhje me Profetin e All'llahut Uzejrin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* që përmendet në ajetin 259 të sures "El Bekare", apo tregimi që flet për dëshminë që u arrit në mesin e Beni Israilëve, për të cilin flet ajeti 73 i sures "El Bekare". Çdonjëri prej këtyre tregimeve është një model historik që vërteton çështjen e Ringjalljes, përfshirë edhe argumente e dëshmi të tjera që janë përmendur në Kur'ànin Famëlartë në lidhje me argumentimin e çështjes së Ringjalljes.

Me një fjalë, ajo që Kur'àni Famëlartë përmend në lidhje me Ringjalljen dhe dukuritë e ndryshme të saj, përfshirë edhe njoftimet që e vërtetojnë Ringjalljen, duke shtuar edhe argumentet që shtrohen për këtë çështje, të gjitha këto janë argumente të gjalla e bindëse, aq sa çdo njeri që ka edhe një grimcë ndërgjegjeje, në thellësi të tij do të ndikohet nga këto fakte që shpalos Kur'àni Famëlartë.

Disa interpretues të Kur'ànit, kanë thënë se njëmijë e dyqind ajete të Kur'ànit trajtojnë çështjen e Ringjalljes dhe sikur këto ajete të mblidheshin së bashku dhe të komentoheshin, patjetër që do të formonin një libër më vete, me mijëra faqe.

5- Ringjallja trupore

Qëllimi me ringjalljen trupore nuk është rikthimi i trupit të njeriut në Botën Tjetër, por qëllimi është ringjallja e shpirtit dhe e trupit së bashku. Në të vërtetë, kthimi i shpirtit është një çështje e pranuar, prandaj këtu do të flasim për ringjalljen e trupit.

Një grup prej filozofëve të vjetër, besonin vetëm në ringjalljen e shpirtit dhe mendonin se trupi, si diçka e përbërë, është së bashku me njeriun vetëm në botën e Tokës dhe pas vdekjes njeriu s'ka më nevojë për trupin, prandaj, me vdekjen, njeriu zhvishet prej trupit dhe nis udhëtimin drejt botës së shpirtrave.

Por dijetarët e mëdhenj myslimanë, besojnë se ringjallja përfshin shpirtin dhe trupin. Ringjalljen shpirtërisht e trupërisht; disa nuk e kushtëzojnë që njeriu të ringjallet me trupin që kishte në botën e Tokës dhe thonë se All'llahu i Lartësuar, për njeriun ka

paracaktuar një trup, porse personaliteti i njeriut qëndron me shpirtin e tij, prandaj edhe ky trup konsiderohet trupi i tij.

Ndërsa studiuesit e specializuar besojnë se trupi i kalbur e i bërë njësh me dheun, me urdhërin e All'llahut do të vishet me rrobën e jetës edhe një herë tjetër dhe është All'llahu Ai që i mbledh grimcat e trupit e i vesh ato me jetë. Ky besim i tyre ka dalë prej vetë tekstit të ajeteve të Kur'ànit Famëlartë.

Dëshmitë që vërtetojnë ringjalljen trupore në ajetet e Kur'ànit, janë të shumta, aq sa mund të thuhet se ata që e reduktojnë çështjen e ringjalljes vetëm në ringjalljen shpirtërore, nuk kanë as njohjen më të vogël me ajetet e Kur'ànit që trajtojnë çështjen e ringjalljes, sepse ringjallja trupore në ajetet e Kur'ànit është shprehur fare e qartë, madje deri në atë shkallë sa, pa asnjë dyshim, e hedh poshtë mëtimin e atyre që besojnë vetëm në ringjalljen shpirtërore.

Ajetet që ne trajtuam në fundin e sures "Jàsin", e shpjegojnë qartë këtë të vërtetë; në këto ajete ne lexojmë se njeriu pyet: **"kush i ringjall kockat e bëra njësh me dheun?"** (ajeti nr. 78), Kur'àni Famëlartë i përgjigjet kësaj pyetjeje hapur dhe qartë: **"Thuaj, i ringjall Ai që i krijoi ato herën e pare."** (ajeti 79).

Çudia e idhujtarëve dhe e atyre që e kundërshtojnë çështjen e ringjalljes, është e përqendruar vetëm në problemin: si ka mundësi që ne të ringjallemi pas vdekjes, pasi jemi bërë njësh me dheun dhe grimcat e trupave tanë janë të shpërndarë nëpër tokë, ashtu siç njofton Kur'àni Famëlartë në ajetin 10 të sures "Es Sexhde": **"Ata thanë: vallë, pasi të jemi tretur në tokë, do të krijohemi përsëri?"**.

Në ajetin 35 të sures "El Mu'minùn", njoftohet se ata thonë: **"A u premton ai se pasi ju të vdisni e të bëheni pluhur e eshtra, do të ringjalleni?"**.

Jobesimtarët janë të habitur prej çështjes së ringjalljes pas vdekjes, deri në atë shkallë sa shpalosjen e argumentit që vërteton ringjalljen, e konsiderojnë argument që vërteton çmendurinë, ose thonë se kjo është gënjeshtër që i vishet All'llahut, ashtu siç njofton Kur'àni për këtë në ajetin 7 të sures "Es Sebe": **"Ata që mohuan thanë: a doni t`ju tregojmë për një njeri që ju thotë se ju, pasi të jeni shkërmoqur plotësisht** (pas vdekjes)**, ju do të krijoheni përsëri?"**.

Për këtë shkak, argumentet e Kur'ànit Famëlartë që flasin rreth ringjalljes, në përgjithësi kanë si bosht rrotullimi temën e "ringjalljes trupore"; kurse ajo që ne shpalosëm më sipër me ato gjashtë rrugët, ishte një argument e dëshmues më i lartë kundër këtij mëtimi të mohuesve.

Veç kësaj, Kur'àni Famëlartë përmend shpeshherë dhe përsërit thënien drejtuar njerëzve: **"Ditën e Kiametit ju do të nxirreni prej varreve tuaja"** (sure "Jàsin" ajeti 51 dhe sure "El Kamer", ajeti 7) dhe se varret kanë lidhje me ringjalljen trupore.

Përshkrimet e dhuntive materiale e morale të Xhennetit që përmenden në Kur'àn, të gjitha argumentojnë se Ringjallja është njëherësh ringjallje trupore dhe ringjallje shpirtërore, ndryshe s'ka kuptim që Kur'àni flet për huritë, për llojet e ushqimeve dhe mirësive të tjera materiale, krahas kënaqësive të mëdha shpirtërore.

Në të gjitha gjendjet, njeriu që ka qoftë edhe fare pak logjikë dhe fare pak kulturë kur'anore, s'ka mundësi të mohojë ringjalljen trupore; me fjalë të tjera, mohimi i ringjalljes trupore në Kur'ànin Famëlartë, konsiderohet i barabartë me mohimin e plotë të Ringjalljes.

Përveç këtyre argumenteve tekst, në lidhje me çështjen e Ringjalljes ka edhe argumente logjike dhe sikur ne t'i rendisnim këtu, studimi do të zgjerohej shumë. Pa dyshim që besimi në ringjalljen trupore ngre pyetje e probleme të shumta, prej të cilave dyshimi për llojet e ushqimeve, për të cilat dijetarët myslimanë kanë dhënë përgjigje, ne i kemi paraqitur në mënyrë të hollësishme kur bëmë komentin e ajetit 260 të sures "El Bekare".

6- Xhenneti dhe zjarri

Janë të shumtë ata që pandehin se bota e pasvdekjes është plotësisht e ngjashme me botën tonë në Tokë, por ne kemi disa shembuj krahasues që argumentojnë se ka dallime të shumta në mes dy botëve, nga ana cilësore e sasiore dhe sikur të duam të bëjmë përngjasimin në mes botës, qysh kur njeriu është fetus në mitrën e nënës dhe të kësaj bote që ne jetojmë, përsëri krahasimi do të mbetej jo i plotë.

Në përputhje të plotë me atë që ajetet kur'anore e shprehin hapur në lidhje me çështjen se si është bota pas vdekjes, duhet të dimë se ajo është e atillë që asnjë sy nuk e ka parë, asnjë vesh nuk e ka dëgjuar dhe asnjë njeri nuk e mendon dot; për këtë, Kur'àni Famëlartë, në ajetin 17 të sures "Es Sexhde" thotë: **"Askush nuk ka dijeni për kënaqësinë që është caktuar për atë."**.

Edhe sistemet gjyqësore në këtë botë janë krejtësisht të ndryshme nga gjykata në Botën Tjetër. Në këtë botë, për të vërtetuar një çështje gjyqësore, në gjykata sillen individë që u thuhet dëshmitarë, kurse në gjykatën e Botës Tjetër, dëshmitarët do të jenë duart, këmbët dhe lëkura e vetë njeriut të marrë në gjykim, ashtu siç njofton Kur'àni Famëlartë për këtë në ajetin 65 të sures "Jàsin": **"Sot Ne atyre ua mbyllim gojët dhe do të flasin duart e tyre, kurse këmbët e tyre do të dëshmojnë për atë që ata punuan."**. Edhe në ajetin 21 të sures "Fussilet", i Larti thotë: **"Ata u thonë lëkurëve të tyre, përse dëshmuat kundër nesh? Ato** (lëkurët) **thonë: All'llahu që u ka dhënë të folurën të gjitha sendeve, bëri që edhe ne të flasim…"**.

Në të gjitha gjendjet, ajo që thuhet për Botën e Ardhshme në ajetet e Kur'ànit, na jep vetëm një përshkrim të vagullt të saj. Zakonisht, është gjuha ajo që flet për Botën e Ardhshme, por kultura e të folurit ndër ne është e pafuqishme të përshkruajë të vërtetën e plotë të Botës së Ardhshme. Në të gjitha gjendjet, nuk mund të lihet ajo që është e lehtë për atë që është e rëndësishme, sepse sasia e dijes sonë arrin vetëm kaq: Xhenneti është vendi i mirësive dhe i të gjitha dhuntive hyjnore materiale e shpirtërore, në mënyrë të barabartë; kurse Xhehennemi është vendi i të gjitha llojeve të ndëshkimeve të dhimbshme materiale e shpirtërore.

Përsa u përket hollësive në lidhje me këtë çështje, Kur'àni Famëlartë njofton vetëm për disa pjesë fare të vogla prej mirësive e prej dënimeve në Botën Tjetër dhe ne, patjetër, besojmë në ato që thuhen në Kur'àn, pasi shkoqitja e hollësishme në lidhje me mirësitë e Botës së Ardhshme, për ne është krejtësisht e pamundur derisa, me lejen e me mëshirën e All'llahut, t'i shohim

konkretisht, me sytë tanë. Në lidhje me këtë temë, kemi vënë një studim në komentin e ajetit nr. 33 të sures "Àli Imràn".

O Zoti im, na siguro në Ditën e frikës më të madhe!

O Zoti im, mos na merr në llogari me drejtësinë Tënde, por na merr në llogari me butësinë e me bamirësinë Tënde, sepse ne nuk kemi punë të atilla me të cilat fitohet kënaqësia Jote!

O Zoti im, bëj që ne të bëjmë punë me të cilat Ti je i kënaqur prej nesh dhe na bëj prej të shpëtuarve; pranoje lutjen tonë, o Zot i botëve!

FUNDI I SURES "JÀSIN"

Sure Es Sàffàt

zbritur në Mekë, numri i ajeteve 182

Përmbajtja e sures "Es Sàffàt"

Edhe kjo sure është zbritur në Mekë, prandaj ka të gjitha veçantitë e sureve "Mekij'jeh", të zbritura në Mekë. Në këtë sure, zotërojnë bazat e dijeve e të besimit islam dhe trajtohen në mënyrë të veçantë çështje të këtilla si: fillimi i krijimit, Ringjallja kërcënimi i idhujtarëve me dënimet më të rënda. Të gjitha këto çështje, në ajetet e kësaj sureje shpalosen nëpërmjet shprehjeve taksative, me fraza të shkurtëra, por me gjuhë të ashpër; njëkohësisht, në ajetet e kësaj sureje shpjegohet qartë dhe me argumente të formës së prerë, pavlefshmëria e miteve që besonin idhujtarët.

Në përgjithësi, përmbajtjen e sures "Es Sàffàt" mund ta klasifikojmë në pesë pjesë:

Pjesa e parë flet rreth grupeve të engjëjve të Gjithëmëshirshmit, për grupin e djajve kundërshtarë të urdhrave të All'llahut dhe për të ardhmen që i pret djajtë.

Pjesa e dytë flet për mohuesit. Ajo tregon se mohuesit nuk besojnë as në Profetsinë e as në Ringjalljen. Flet edhe për dënimin që i pret mohuesit Ditën e Kiametit. Në këtë pjesë, shpaloset edhe diskutimi që do të zhvillohet në mesin e mohuesve Ditën e Kiametit, kur të gjithë janë të ngarkuar me barrën e fajeve dhe ku do të shohin se shumë shpejt do të përfshihen në ndëshkimin hyjnor; gjithashtu, në këtë pjesë shpjegohen anë të shumta prej mirësive që janë në Xhennet dhe përshkruhet kënaqësia që sjellin këto mirësi, me bukurinë e veçantë që kanë, njëkohësisht flitet edhe për gëzimin e madh të banorëve të Xhennetit.

Pjesa e tretë, shpjegon shkurtimisht historitë me ndikim të fuqishëm të Profetëve Nuh, Ibrahim, Is'hak, Musa, Harun, Iljas, Lut dhe Junus *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*. Në këtë pjesë, flitet në mënyrë të hollësishme për Ibrahimin, thyesin e idhujve dhe për disa anë të tjera të jetës së tij *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Qëllimi kryesor me shpalosjen e tregimeve të Profetëve, krahas përmendjes së dëshmive konkrete të historisë së tyre, është që këto tregime të paraqiten të konkretizuara dhe të përshkruara në atë mënyrë, që të prekin ndjenjat.

Pjesa e katërt, trajton një formë të veçantë të vënies shok All'llahut në adhurim (idhujtarinë) dhe që konsiderohet forma më e zezë e idhujtarisë. Në këtë pjesë tregohet se ata besonin në ekzistencën e lidhjeve të afërsisë në mes All'llahut të Lartësuar dhe xhindëve e engjëjve. Thënë ndryshe, në këtë pjesë shpjegohet qartë sa të gabuara janë të këtilla besime të kota.

Në pjesën e pestë e të fundit, në disa ajete të shkurtëra trajtohet fitorja e ushtrive të rrugës së vërtetë mbi ushtritë e mohimit, idhujtarisë e hipokrizisë. Pra, fitorja mbi mohuesit, idhujtarët e hipokritët. Po ashtu, në këto ajete flitet edhe për zbritjen e dënimit të All'llahut mbi ata. Gjithashtu, në ajetet e kësaj pjese flitet për dëlirjen e All'llahut të Lartësuar prej të gjitha mangësive e nevojave që i vishnin Atij idhujtarët. Kjo sure përfundon me falënderimin e lavdërimin kushtuar vetëm Krijuesit të të gjitha krijesave.

Mirësia e leximit të sures "Es Sàffàt"

Në një hadith të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Kush lexon suren "Es Sàffàt", i jepen dhjetë të mira, aq sa është numri i xhindëve e i djajve. Prej tij largohen djajtë kryengritës, është i ruajtur prej idhujtarisë dhe në Ditën e Gjykimit, dy 'ruajtësit' e tij do të dëshmojnë se ai ka besuar në të Dërguarit."*.[1]

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Kush lexon suren "Es Sàffàt" çdo të premte, ai do të vazhdojë të jetë i ruajtur prej çdo sëmundjeje, prej tij largohet çdo fatkeqësi dhe ka furnizimin më të mirë që mund të jetë në këtë botë. All'llahu nuk do të lejojë që mbi pasurinë e tij, fëmijën e tij dhe trupin e tij, të bjerë ndonjë e keqe prej djallit të përzënë prej mëshirës së All'llahut, ose të bjerë mbi atë dhuna e ndonjë tirani mizor. Nëse ai vdes ditën e premte ose natën e ditës së premtes, All'llahu e vdes dhe e ringjall atë në pozitën e dëshmorit dhe do ta fusë në njërën prej gradave të Xhennetit."*.[2]

Shpërblimi i madh që arrihet me leximin e sures "Es Sàffàt", patjetër vjen për shkak të përmbajtjes së kësaj sureje të bekuar. Ne jemi të vetëdijshëm se, qëllimi me leximin është të menduarit mbi përmbajtjen e kësaj sureje, pastaj besimi dhe pastaj puna sipas përmbajtjes së kësaj sureje. Pa dyshim, kush e lexon këtë sure sipas mënyrës së përshkruar në radhët e sipërme, është i ruajtur prej të keqes së djajve, është i pastruar prej idhujtarisë, ka besim të plotë, të saktë e të patundur, ai bën vetëm punë të mira,

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", fillimi i sures "Es Sàffàt".
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", fillimi i sures "Es Sàffàt". Ky hadith ka ardhur edhe në tefsirin "El Burhàn", i cituar prej shejh Sadùkut, me një ndryshim të vogël.

këshillohet e nxjerr mësim prej tregimeve që flasin për ngjarjet që u kanë ndodhur Profetëve e popujve të përparshëm dhe ai do të merret në llogari së bashku me dëshmorët.

Nga thëniet e shumta, mësohet se emërtimi i kësaj sureje "Es Sàffàt", ka ardhur për shkak se ajeti i parë i kësaj sureje fillon me fjalën "Es Sàffàt".

Ajetet: 1 – 5

وَٱلصَّٰٓفَّٰتِ صَفًّا ﴿١﴾ فَٱلزَّٰجِرَٰتِ زَجْرًا ﴿٢﴾ فَٱلتَّٰلِيَٰتِ ذِكْرًا ﴿٣﴾ إِنَّ إِلَٰهَكُمْ لَوَٰحِدٌ ﴿٤﴾ رَّبُّ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا وَرَبُّ ٱلْمَشَٰرِقِ ﴿٥﴾

"Betohem në të radhiturit (engjëjt) **që në rreshta qëndrojnë."**

"Betohem në ndaluesit që ndalojnë."

"Betohem në lexuesit që lexojnë Këshillën."

"Pa dyshim që Zoti juaj është vetëm Një."

"Zot i qiejve e i Tokës dhe Zoti i vendlindjeve."

Komentimi

Engjëjt janë të gatshën të zbatojnë detyrat

Surja "Es Sàffàt", është surja e parë prej sureve të Kur'ànit Famëlartë që fillon me betime. Ajo është e mbushur me kuptime që kanë ndikim të madh për të nxitur mendimin e njeriut, që ai të vështrojë në argumentet që janë në horizontet e në hapësirat e

Gjithësisë, sepse këto argumente bëjnë që njeriu të pranojë të vërtetat.

Nuk ka dyshim se vetëm All'llahu thotë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, prandaj Ai s'ka nevojë të betohet dhe nëse betimi i Tij është për besimtarët, ata besojnë në All'llahun pa betim; nëse betimi është për mohuesit, ata nuk besojnë në betimin hyjnor.

Për të shpjeguar problemin e betimit, që përsëritet edhe në ajetet e sureve të tjera të Kur'ànit, do të përqendrohemi në dy pika:

E para: betimi gjithmonë bëhet për punë shumë të rëndësishme dhe me vlera të mëdha, prandaj betimet në Kur'ànin Famëlartë tregojnë rëndësinë e madhe të sendeve në të cilat bëhet betimi. Pikërisht ky fakt, bën thirrje për më shumë mendim në sendin në të cilin bëhet betimi, kurse mendimi nga ana e tij zbulon për njeriun të vërteta të reja.

E dyta: betimi vjen për të theksuar më shumë dhe për të argumentuar se, punët për të cilat bëhet betimi, janë punë të një rëndësie shumë të madhe.

Përveç kësaj, nëse ligjëruesi flet në mënyrë të prerë, ndikimi i fjalës së tij nga ana shpirtërore, shumë shpejt do të zërë vend në zemrën e dëgjuesit. Veç kësaj, mënyra e bisedimit me betim, i forcon besimtarët dhe i dobëson mohuesit. Kjo sure fillon

me përmendjen e tre emrave të grupeve mbi të cilët betohet All'llahu i Lartësuar[1]:

I pari: **"Betohem në të radhiturit** (engjëjt) **që në rreshta qëndrojnë."**

I dyti: **"Betohem në ndaluesit që ndalojnë."**

I treti: **"Betohem në lexuesit që lexojnë Këshillën."**

Cilët janë këta tre grupe? Cilit i adresohen këto cilësi? Cili është qëllimi i fundit me këta tre grupe?

Interpretuesit e Kur'ànit kanë thënë shumë fjalë në lidhje me këtë çështje, por fjala më në zë dhe që ka më shumë përhapje, është: këto cilësi janë të veçanta për grupe engjëjsh.

Grupe prej engjëjsh janë radhitur në botën e ekzistencës në rreshta të rregullt dhe janë të gatshëm për të zbatuar urdhërin hyjnor.

Grupe prej engjëjsh që i ndalojnë njerëzit të mos mëkatojnë e të mos bëjnë faje dhe bëjnë të dështojnë cytjet e djajve në zemrat e njerëzve; ose është fjala për engjëjt e ngarkuar me detyrën e adminstrimit të erërave dhe për t'i drejtuar erërat në tokat e thara, që ato të gjallërohen.

Dhe së fundi, grupe engjëjsh që u lexojnë Profetëve ajetet e librave qiellorë në kohën e zbritjes së revelatës.[2]

---

[1] Këto tri shprehje, nga njëra anë tregojnë tri kategori dhe nga ana tjetër tregojnë vetëm një grup që ka tri cilësi.

[2] Natyrisht që për interpretimin e ajeteve të sipërme janë dhënë edhe opsione të tjera, prej të cilave: rreshtat e ushtarëve të Islamit të rreshtuar në fushat e

Tërheq vëmendjen fakti që fjala *"es sàffàti"* – *"të radhiturit"* është shumës i fjalës *"saffetun"*, e cila gjithashtu mbart në vetvete cilësinë e shumësit dhe tregon një grup të rreshtuar në rreshta të rregullt, atëherë rezulton se *"es sàffàti"* do të thotë: disa rreshta.[1]

Fjala *"ez zàxhiràti"*, në rrënjën e saj *"ez zexhru"* do të thotë: largimi i një sendi me anë të frikësimit e të britmave me zë të lartë dhe në një kuptim më të gjerë, përfshin sprapsjen e të keqes prej të tjerëve.

Nga ky këndvështrim, rezulton se fjala *"ez zàxhiràti"*, është në kuptimin e grupeve detyra e të cilëve është largimi me forcë i të keqes prej të tjerëve.

Fjala e ajetit *"et tàlijàti"*, në rrënjën e saj *"et tilàveh"*, që është shumës i fjalës *"tàlin"* – *"lexues"* është në kuptimin: grupe, detyra e të cilëve është leximi i diçkaje.[2]

---

betejave që u turren armiqve me të thirrura me zë të lartë dhe i ndalojnë armiqtë që të mos sulmojnë shenjtërinë e Islamit e të Kur'ànit, gjithashtu ata vazhdimisht lexojnë librin e All'llahut dhe ndriçojnë zemrat e shpirtrat e tyre me dritën e leximit të Kur'ànit. Një opsion tjetër është: njëra pjesë prej këtyre cilësive tregojnë engjëjt e radhitur në rreshta të rregullt; pjesa tjetër tregon për ato ajete të Kur'ànit që i ndalojnë njerëzit të bëjnë punë të liga, kurse pjesa tjetër e cilësive tregon besimtarët të cilët lexojnë Kur'ànin në kohët e faljes së namazit dhe në kohët jashtë faljes së namazeve; gjithësesi, përjashtohet mundësia që këto cilësi të jenë të ndara, sepse ato janë të rrethuara njëra me tjetrën dhe sipas rregullave të gjuhës arabe, vënia e germës *"f"* si lidhëse, shpjegon qartë se ato janë cilësi të një grupi të vetëm.

[1] Nuk është problem që engjëjt në këto fjalë janë përmendur në gjininë femërore, pasi fjalët: *"es sàffàti"*, *"ez zàxhiràti"*, *"et tàlijàti"*, tregojnë se ata që janë përshkruar me këto cilësi, janë grup dhe sipas rregullave të gramatikës së gjuhës arabe, grupi konsiderohet i gjinisë femërore.

[2] Disa gjuhëtarë kanë thënë se shumësi i fjalës *"tàlin"* – *"lexues"* është *"tàlijàtin"* dhe shumësi i fjalës *"tàlijetin"* – *"lexuese"* është*"tevàlin"*.

Duke pasur në konsideratë gjerësinë e madhe të kuptimeve të këtyre fjalëve, nuk është çudi që interpretuesit e Kur'ànit kanë shkruar interpretime të ndryshme rreth këtyre fjalëve, por që nuk e kundërshtojnë njëri-tjetrin dhe që është e mundur të bashkohen të gjithë për të shpjeguar kuptimin e këtyre ajeteve. Për shembull, qëllimi me fjalën *"es sàffàti"*, janë rreshtat e engjëjve të gatshëm për të zbatuar urdhërat hyjnore në botën e njerëzve, ose të engjëjve të ngarkuar për t'u zbritur Revelatën Profetëve në botën e legjislacionit; gjithashtu, qëllimi me këtë shprehje mund të jenë radhët e besimtarëve që luftojnë në rrugën e All'llahut, ose me fjalën "radhët" qëllimi është për radhët e robve të All'llahut të rreshtuar për të falur namaz.

Përveç shembujve krahasues që janë në ajetet e Kur'ànit, që, siç u tha më sipër, theksojnë se qëllimi me fjalën *"es sàffàti"* janë engjëjt, ka edhe disa transmetime që e theksojnë këtë kuptim.[1]

Nuk ka asnjë ndalues që fjala *"ez zàxhiràti"* të përfshijë engjëjt që largojnë cytjet e djajve prej zemrave të njerëzve, ose me këtë fjalë të jetë qëllim një besimtar, i cili kryen urdhërin për të ndaluar punën e keqe.

Fjala e ajetit *"et tàlijàti"*, tregon të gjithë engjëjt dhe grupet e besimtarëve që lexojnë ajetet e librit të All'llahut dhe që kanë dëshirë të përmendin (të bëjnë ziqër) vazhdimisht All'llahun e Lartësuar.

Këtu shtrohet pyetja: siç shihet, këto tri fjali lidhen me njëra-tjetrën me lidhësen *"fe"* dhe sipas rregullave të sintaksës së

[1] Tefsiri "El Burhàn", vëll. 4, f. 15; tefsiri "Ed Durr'rrul Menthùr", vëll. 7, f. 77.

gjuhës arabe, kjo lidhëse tregon se këto grupe kanë ardhur njëri pas tjetrit, pa ndarje në kohë; vallë, kjo renditje ka ardhur për shkak se ashtu ishte urtësia, që secili grup të vinte sipas kësaj renditjeje? Apo renditja është sipas pozitës që ka çdo grup? Apo kjo renditje është për të dy shkaqet së bashku?

Është e qartë se rreshtimi dhe gatishmëria janë faza e parë, pastaj si fazë e dytë vjen procesi i zhdukjes së pengesave prej rrugës, kurse shpallja e zbatimi i urdhërave janë në pozitën e fazës së tretë.

Nga një anë tjetër edhe të përgatiturit për zbatimin e urdhërave hyjnore kanë gradë: asgjësuesit e pengesave kanë një shkallë të lartë, kurse ata që lexojnë urdhërat dhe i zbatojnë ato, kanë një gradë më të lartë se të gjithë të tjerët.

Në të gjitha gjendjet, betimi i All'llahut të Lartësuar në ato grupe, shpjegon sa e madhe është pozita e atyre grupeve te Filluesi i krijimit dhe thekson të vërtetën se, ata që ndjekin rrugën e vërtetë, kanë detyrim të arrijnë në objektivin e caktuar dhe të kapërcejnë të tria fazat, duke filluar me sistemimin e rreshtave, qëndrimin e çdo grupi në rreshtin e caktuar, pastaj kalohet në asgjësimin e pengesave prej rrugës dhe largimin e ndaluesve me zë të lartë, në përpjestim me rëndësinë e cytjes për punën e keqe. Pastaj, vjen radha e leximit të ajeteve të Librit të All'llahut dhe e kumtimit të urdhrave të Tij për zemrat që kanë përgatitjen për të zbatuar përmbajtjen e atyre urdhrave.

Ata që ecin e që luftojnë në rrugën e të vërtetës, nuk kanë zgjedhje tjetër, veçse të kalojnë nëpër këto tri etapa. Të njëjtën detyrë kanë edhe dijetarët veprimtarë, të cilët, në zbatim të këtij

programi, kanë detyrë të frymëzohen prej përpjekjeve të tyre kolektive.

Këtu, duhet vënë në dukje se disa interpretues të Kur'ànit, kanë thënë se këto ajete u adresohen luftëtarëve në rrugën e të vërtetës; disa të tjerë kanë thënë se u adresohen dijetarëve; por reduktimi i adresimit të kuptimit të këtyre ajeteve vetëm në ata që luftojnë në rrugën e të vërtetës, ose vetëm në dijetarët, është disi larg karakterit të kuptimit përgjithësues që kanë ajetet e Kur'ànit Famëlartë. Kur ajeteve të Kur'ànit u jepet karakteri përgjithësues, ata janë më afër realitetit, por edhe kur ne marrim në konsideratë se këto ajete janë të veçanta, vetëm për engjëjt, përsëri të tjerët kanë mundësi të sistemojnë jetën e tyre në përputhje me programet e engjëjve.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, në njërën prej hytbeve të tij, kur përshkruan engjëjt sipas grupeve të ndryshme, thotë: *"Janë të rreshtuar, nuk shpërndahen, madhërojnë All'llahun e nuk lodhen, nuk iu mbyllen sytë prej gjumit, nuk iu trulloset mendja, nuk iu dobësohen trupat, nuk harrojnë nga shkujdesja, prej engjëjve ka të besuar për zbritjen e Shpalljes së Tij dhe janë gjuha për tek të Dërguarit e Tij."*.[1]

E fundit që duam të themi në lidhje me këta tre ajete, ka të bëjë me faktin që disa besojnë se betimi në këta tre ajete i adresohet vetë All'llahut të Lartësuar dhe se fjala *"rab'bun"* – *"Zot"* supozohet në të tre këta ajete dhe nga ky këndvështrim, kuptimi është: "Zot i të radhiturve në rreshta; Zot i ndaluesve që ndalojnë; Zot i lexuesve që lexojnë Këshillën".

[1] "Nehxhul Belàga", hytbeja 1.

Duket qartë se, ata që i kanë interpretuar këta ajete në këtë mënyrë, janë prej atyre që besojnë se njerëzit nuk kanë të drejtë të betohen në gjëra të tjera, përveçse në All'llahun, prandaj edhe All'llahu betohet në veten e Tij; veç kësaj, betimi patjetër duhet të bëhet në sendin më të rëndësishëm, por a ka send më të rëndësishëm se Qenia e Madhëruar e All'llahut.

Megjithëkëtë, i duhet kushtuar kujdes të vërtetës se betimi i All'llahut në këto ajete ka lidhje me njerëzit e me krijesat e tjera. All'llahu i Lartësuar, për të udhëzuar njeriun, betohet në sendet që janë në horizontet, betohet në shpirtrat, betohet në argumentet që vërtetojnë fuqinë e Tij në Tokë e në Qiell. Patjetër që kjo mënyrë betimi është me qëllim që njeriu të mendojë rreth këtyre argumenteve, pasi, nëpërmjet kësaj rruge, njeriu njeh Zotin e tij.

Meriton të përmendet fakti se, disa ajete të Kur'ànit Famëlartë, ndër to ajetet e sures "Esh Shems", i Larti betohet në qeniet e Gjithësisë, krahas betimit në Vetën e Madhëruar të Tij, ashtu siç njofton Kur'àni Famëlartë: **"Betohem në Qiellin dhe në Atë që e ndërtoi atë** (Qiellin)**. Betohem në Tokën dhe në Atë që e sheshoi atë** (Tokën)**. Betohem në Njeriun dhe në Atë që e krijoi atë** (Njeriun)**."**.[1]

Gjithësesi, ajetet objekt studimi tregojnë qartë se tre grupet janë ata në të cilët bëhet betimi dhe se çdo vlerësim tjetër, është në kundërshtim me kuptimin që shprehin fjalët e ajeteve objekt studimi, prandaj, asnjë lloj interpretimi tjetër nuk mund të pranohet pa argument.

[1] Sure "Esh Shems" ajetet: 5-7.

Tani do të shikojmë se cili është qëllimi me këto betime të mbushura me kuptime, domethënë betimi në engjëjt dhe në njerëzit?

Ajeti vijues e shpjegon qartë këtë dhe thotë: **"Pa dyshim që Zoti juaj është vetëm Një."**.

Betimi në të këtilla gjëra të shenjta, që ne i përmendëm më sipër, i hedh poshtë idhujt dhe vërteton se All'llahu i Lartësuar nuk ka as shok e as të ngjashëm.

Në ajetin e fundit të këtij grupi ajetesh, lexojmë: **"Zot i qiejve e i Tokës dhe Zoti i vendlindjeve** (të yjeve)**."**.

Këtu do të shtrojmë dy pyetje:

1- Ku qëndron domosdoshmëria e përmendjes së fjalës *"el meshàrik"* – *"vendlindjeve"* pas përmendjes së qiejve e të Tokës dhe ç`ka në mes qiejve e Tokës, në një kohë që vendet ku lindin yjet janë pjesë e qiejve?

Përgjigje: Përgjigja bëhet e qartë, nëse shikojmë me vëmendje do të vëmë re se qëllimi me fjalën *"el meshàrik"* – *"vendlindjeve"* tregon pozicionet e lindjes së Diellit gjatë ditëve të vitit, ose tregon pozicionet e lindjes së yjeve të ndryshëm në kupën e Qiellit, duke ditur se për këto punë ka një sistem me program të veçantë; veç kësaj, duhet shtuar se vetë sistemi qiellor e tokësor, shpjegon qartë diturinë e fuqinë sistemuese absolute të Krijuesit.

Dielli çdo ditë lind në një vend tjetër nga vendi ku lindi dje ose para një dite tjetër, por largësitë ndërmjet këtyre vendeve të lindjes së Diellit, janë të llogaritura në shkallën më të hollësishme

dhe nuk janë as më shumë e as më pak se një e mijta e sekondës, duke shtuar se ky sistem i përpiktë ekziston qysh prej miliona vjetësh.

Gjithashtu, ky sistem i hollësishëm është në përputhje të plotë edhe me daljen e me perëndimin e yjeve.

Sikur Dielli të mos lëvizte në orbitën e tij në mënyrë graduale gjatë vitit, nuk do të kishim katër stinët e vitit, për rrjedhojë nuk do të kishim as mirësitë e mëdha që dalin në secilën prej katër stinëve. Edhe kjo dukuri, është një argument tjetër që vërteton madhështinë e sistemimit të Krijuesit të Lartësuar.

Prej kuptimeve të tjera të fjalës *"el meshàrik"* – *"vendlindjeve"* është forma sferike e Tokës, prandaj çdo pikë në Tokë konsiderohet ose vendlindje ose vendperëndim; kështu e thekson ajeti ekzistencën e shumë vendlindjeve dhe të shumë vendperëndimeve (S'ka asnjë pengesë që të dy këto kuptime të vërtetohen në ajetin e lartpërmendur).

2- Pyetja e dytë është: Përse në ajet nuk ka ardhur fjala*"el megàrib"* – *"vendperëndimet"* kundrejt fjalës *"el meshàrik"* – *"vendlindjet"* ashtu siç ka ardhur në ajetin 40 të sures "El Meàrixh": **"Betohem në Zotin e lindjeve e të perëndimeve?"**.

Përgjigje: përgjigja për këtë pyetje është: një pjesë e fjalisë anulon pjesën tjetër, për shkak se ekziston shembulli krahasues, por në disa ajete këto dy fjalë vijnë së bashku dhe në këtë ajet fjala *"el meshàrik"* – *"vendlindjet"* është shembull krahasues me fjalë *"el megàrib"* - *"vendperëndimet"*; pikërisht kjo shumëllojshmëri në shprehje, shpjegon qartësinë e gjuhës së Kur'ànit dhe retorikën e tij të lartë.

Disa interpretues të Kur'ànit kanë thënë: përmendja e mirësisë së "vendlindjeve", është në përshtatje të plotë me "lindjen" e revelatës në zemrën e pastër të Profetit *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me ndërmjetësinë e engjëjve të grupit **"Betohem në lexuesit që lexojnë Këshillën."**.[1]

[1] Tefsiri "El Mijzàn", vëll. 17, f. 122.

Ajetet: 6 – 10

إِنَّا زَيَّنَّا ٱلسَّمَآءَ ٱلدُّنْيَا بِزِينَةٍ ٱلْكَوَاكِبِ ۝٦ وَحِفْظًا مِّن كُلِّ شَيْطَٰنٍ
مَّارِدٍ ۝٧ لَّا يَسَّمَّعُونَ إِلَى ٱلْمَلَإِ ٱلْأَعْلَىٰ وَيُقْذَفُونَ مِن كُلِّ جَانِبٍ ۝٨
دُحُورًا ۖ وَلَهُمْ عَذَابٌ وَاصِبٌ ۝٩ إِلَّا مَنْ خَطِفَ ٱلْخَطْفَةَ فَأَتْبَعَهُۥ شِهَابٌ
ثَاقِبٌ ۝١٠

"Ne e kemi zbukuruar qiellin e kësaj bote me bukurinë e yjeve."

"Dhe e ruajmë prej çdo djalli rebel." "Ata (djajtë) **nuk mund të dëgjojnë parinë më të lartë** (engjëjt e përzgjedhur)**, pasi qëllohen nga të gjitha anët."**

"Ata (djajtë) **janë të përzënë dhe për ata ka dënim të përhershëm."**

"Edhe ai (djall) **që rrëmben rastësisht** (ndonjë lajm)**, menjëherë atë e ndjek një yll që e djeg."**

Komentimi

Ruajtja e Qiellit prej depërtimit të djajve

Ajetet e sipërme flisnin për grupet e engjëjve të ngarkuar me zbatimin e detyrave shumë të rëndësishme, kurse ajetet objekt studimi flasin për grupin kundërshtar të engjëjve, flasin për djajtë dhe për atë çka i pret djajtë. Këto ajete janë një parathënie për të hedhur poshtë bestytnitë e një grupi idhujtarësh, të cilët adhuronin djajtë e xhindët; gjithashtu, këto ajete, në brendinë e tyre kanë një mësim në lidhje me Njëtimin e All'llahut (All'llahu është Zoti Një e i Vetëm).

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, fillon me njoftimin: **"Ne e kemi zbukuruar Qiellin e kësaj bote me bukurinë e yjeve"**;[1] sikur ndonjëri prej nesh të vështronte në drejtim të Qiellit, në një natë të errët, para syve të tij do të shpalosej një pamje aq e bukur, sa njeriu do të magjepsej.

Duket sikur yjet na flasin me gjuhën e tyre të heshtur, për të zbuluar për ne sekretet e krijimit; herë tjetër, yjet janë poetë që thurin për ne poemat më të bukura lirike; me vezullimin e tyre,

[1] Në këtë ajet, fjala *"el keuàkib"* – *"yjet"* është përdoruar në vend të zbukurimit dhe sipas rregullave të sintaksës së gjuhës arabe, mund të jetë plotësor shpjegues; kurse fjala *"zijnenetun"* – *"zbukurim"* është emër dhe jo rrënjë foljeje, pasi, në literaturën letrare thuhet: kudo që fjala e pashquar është vënë në vend të fjalës së shquar, detyrimisht duhet të jetë e shoqëruar me një cilësor, kurse në rastin e kundërt, shoqërimi me cilësor nuk është detyrë.

yjet përshkruajnë për ne sekretet për të cilat flasin vargjet e poezisë që ekziston në mes të dashuruarit dhe të dashurit.

Është e vërtetë se pamja e yjeve në Qiell është një panoramë e mrekullueshme dhe asnjë sy nuk lodhet duke shikur gjatë në këtë panoramë, madje shikimi në këtë panoramë heq lodhjen e preokupimet në brendësi të njeriut. Kjo dukuri, na kujton se banorët e kohës së sotme, që banojnë në qytetet e mbuluara prej tymit të fabrikave, nuk e kanë kënaqësinë të shikojnë Qiellin e zbukuruar me yje, ashtu siç i shikojnë banorët e fshatrave, të cilët e kuptojnë më mirë thënien kur'anore: zbukurimi i qiejve me yje.

Meriton t'i kushtohet rëndësi faktit se ajeti njofton zbukurimin e qiejve me yje, në një kohë kur në mendjet e dijetarëve të asaj kohe ishin shumë të përhapura hamendsimet se yjet janë në qiellin më të lartë dhe sipas hamendsimit të Ptolemeut, yjet janë në qiellin e tetë.

Tani dihet se shkenca moderne i ka hedhur poshtë të këtilla hamendsime, por që në atë kohë konsideroheshin shkencë e mirëfilltë dhe ishin mjaft të përhapur; njëkohësisht, përmbajtja e këtij ajeti është një mrekulli e gjallë, që tregon madhështinë e këtij Libri qiellor.

Është e vërtetë se vështruesit i tërheq vëmendjen fakti i dridhjes së yjeve dhe drita vezulluese me shkëputje që vjen në syrin e tij, prandaj shikuesit i duket sikur yjet i shkelin syrin, por dihet se kjo dukuri ndodh për shkak të shtresës së atmosferës që rrethon Tokën. Ky kuptim është në përshtatje të plotë me frazën e këtij ajeti: "qiellin e kësaj bote", ose "qiellin më të ulët".

Jashtë atmosferës së Tokës, yjet duken si pika ndriçuese me një shpeshësi të njëjtë dhe nuk e kanë atë ndriçim me vezullime të shkëputura, siç i shohim ne që jemi brenda atmosferës së Tokës.

Kurse ajeti vijues **"Dhe e ruajmë prej çdo djalli rebel"**, tregon ruajtjen e Qiellit, që në Qiell të mos depërtojnë djajtë.[1]

Fjala *"màrid"* – *"rebel"* është marrë prej rrënjës *"meride"* që do të thotë: tokë e ngritur, pa bimësi; edhe pemës që i kanë rënë gjethet, në arabisht i thuhet *"emred"*; kjo fjalë thuhet edhe për djalin e ri të cilit ende nuk i kanë dalë qimet në faqe, kurse në këtë ajet qëllimi me fjalën *"màrid"* – *"rebel"* është për njeriun e keq, prej të cilit nuk vjen asnjë e mirë.

Ruajtja e Qiellit prej depërtimit të djajve, bëhet me anën e një lloji yjesh që janë emërtuar "meteor, yll që bie", për të cilët do të flitet në ajetet vijuese.

Në vijim, Kur'àni Famëlartë shton: djajtë s'kanë mundësi të dëgjojnë bisedat e engjëjve të shtresës së lartë dhe të mësojnë sekretet që dinë engjëjt dhe sa herë që djajtë orvaten të dëgjojnë bisedën e engjëjve, ata gjuhen me meteor nga të gjitha anët, ashtu siç e lexojmë në ajetin e nderuar: **"Ata** (djajtë) **nuk mund të dëgjojnë parinë më të lartë** (engjëjt e përzgjedhur)**, pasi qëllohen nga të gjitha anët."**.

---

[1] Fjala e ajetit *"hifdhan"*, sipas thënies së shumë interpretuesve të Kur'ànit, nga ana e sintaksës së gjuhës arabe, këtu është kundrinor i drejtë për një folje të hequr dhe kuptimi i ajetit, sipas këtij opsioni, është: "Ne e kemi ruajtur atë me një ruajtje të fuqishme"; të tjerë kanë thënë se kjo fjalë ka lidhje me fjalën *"bi zijneti"* – *"me bukurinë"* e cila, gjithashtu, është kundrinor i drejtë për këtë fjalë dhe kuptimi, sipas këtij opsioni, është: "Ne i kemi krijuar yjet zbukurim për Qiellin e ruajtur.".

Po, djajtë përzihen prej Qiellit me ashpërsi dhe për ata është përgatitur një ndëshkim i përhershëm, ashtu siç njoftohet në ajetin vijues: **"Ata** (djajtë) **janë të përzënë dhe për ata ka dënim të përhershëm."**.

Prej fjalës së ajetit *"là jesem'meùne"* – *"nuk mund të dëgjojnë"* kuptohet se djajtë orvaten të dëgjojnë lajmet që dinë "engjëjt e përzgjedhur", por kjo atyre nuk u lejohet.

Fraza e ajetit *"el meleil a'là"* – *"engjëjt e përzgjedhur"* do të thotë: engjëjt që janë në qiejt më të lartë. Në rrënjën e saj, fjala *"meleun"* thuhet për një grup, pjestarët e të cilit kanë një pikëpamje të njëjtë dhe që në këndvështrimin e të tjerëve është një grup i bashkuar e në harmoni me njëri-tjetrin; gjithashtu, fjala *"meleun"* thuhet për parinë, për qarqet e larta dhe për ata që rrethojnë të fuqishmit, sepse ata, në këndvështrimin e të tjerëve gjithashtu janë të bashkuar dhe kanë të njëjtën pikëpamje; por këtu, me fjalën *"meleun"* – *"pari e përzgjedhur"* qëllimi është për engjëjt që janë në pozitat më të larta.

Edhe fjala *"jukdhefùne"* – *"qëllohen"* është në kuptimin gjuajtje mbi një send prej një largësie të madhe, kurse këtu qëllimi është: përzënia e djajve me anë të meteorëve, që i godasin djajtë dhe kjo tregon se Filluesi i Lartësuar nuk lejon që djajtë t'u afrohen engjëjve të përzgjedhur.

Fjala *"duhùren"*, në rrënjën e saj *"dehare"*, do të thotë: përzënia e sprapsja e sendit; kurse fjala *"uàsibun"* është në kuptimin e sëmundjes kronike dhe në kuptimin e saj të

përgjithshëm do të thotë: i përhershëm dhe i vazhdueshëm, kurse në disa raste është në kuptimin: shumë.[1]

Kjo shprehje e ajetit tregon se djajtë, jo vetëm që nuk lejohen t'i afrohen Qiellit, por, përveç këtij moslejimi, për djajtë ka një ndëshkim të përhershëm.

Ajeti tregon për një grup djajsh sherrxhindj që mundohen të ngjiten në qiejt e lartë, për të përgjuar që të dëgjojnë ndonjë fjalë; gjithashtu, ajeti njofton edhe për dënimin e menjëhershëm që i pret djajtë kur ata orvaten të ngjiten në Qiell: **"Edhe ai** (djall) **që rrëmben rastësisht** (ndonjë lajm)**, menjëherë atë e ndjek një yll që e djeg."**.

Fjala *"el khatfetu"*, do të thotë: rrëmbimi i sendit me shpejtësi.

Fjala *"shihàbun"*, do të thotë: ndriçues i lindur prej zjarrit, drita e të cilit shihet në Qiell si një vijë e drejtë.

Dihet se meteorët nuk janë yje, por ngjajnë me yjet. Në të vërtetë, meteorët janë copa guri të vogla të shpërndara në hapësirë dhe kur futen në fushën e tërheqjes së Tokës, ajo i tërheq në drejtim të saj, por nga shpejtësia me të cilën ata futen në atmosferën e Tokës dhe si rezultat i fërkimit të tyre të fuqishëm me ajrin që rrethon globin tokësor, meteorët ndizen zjarr dhe digjen.

Fjala e ajetit *"thàkibun"*, do të thotë: ylli shpues, sikur e shpon syrin me dritën e tij të fortë dhe kjo tregon se meteori shpon çdo send që takon dhe depërton në brendësi të atij sendi.

[1] Për fjalën*"uàsibun"*, kemi vënë një studim në fundin e ajetit 52 të sures "En Nahl".

Në këtë interpretim, dallojmë dy pengues që i ndalojnë djajtë të mos ngjiten në qiejt e lartë:

Penguesi i parë: gjuajtja mbi djajtë nga të gjitha anët dhe përzënia e tyre, sipas kuptimit të fjalëve të ajetit, bëhet me anën e meteorëve.

Penguesi i dytë: gjuajtja e djajve me një lloj të veçantë meteorësh, që janë emërtuar meteorë shpues dhe që janë në pritje të çdo djalli që mundohet të depërtojë fshehtas në lartësitë e qiejve, ku janë engjëjt e përzgjedhur, me qëllim që të përgjojnë për të dëgjuar ndonjë fjalë. Këtë kuptim për ruajtjen e qiejve dhe për gjuajtjen e djajve, e gjejmë edhe në ajetet 17-18 të sures "El Hixhr": **"Dhe atë** (Qiellin) **e kemi ruajtur prej çdo djalli të mallkuar**. **Por edhe atë** (djall) **që përgjon të dëgjojë ndonjë fjalë, atë e qëllon një meteor i zjarrtë** (që e djeg)**."**.

Gjithashtu, edhe në ajetin 5 të sures "El Mulk", lexojmë: **"Qiellin e kësaj bote e kemi zbukuruar me llampa** (yje ndriçues)**, të cilat i kemi bërë gjuajtës të djajve."**.

Por, a duhet që patjetër të marrim kuptimin e jashtëm që shprehin fjalët e këtyre ajeteve, apo ka ajete të tjera krahasuese, që na detyrojnë t'i interpretojmë ndryshe nga ajo që shprehin fjalët e ajeteve dhe të themi se fjalët e këtyre ajeteve mund të jenë përdorur si përngjasim, ose si metaforë?

Në lidhje me këtë çështje, në mesin e interpretuesve të Kur'ànit ka mendime të ndryshme. Disa kanë thënë se patjetër duhet t'i përmbahemi kuptimit të drejtpërdrejtë që shprehin fjalët e ajeteve, domethënë të merren të njëjtat kuptime që u shpalosën më lart. Gjithashtu, ata kanë thënë se ka grupe engjëjsh që

banojnë në Qiellin e Afërt dhe në Qiellin e Largët. Këta engjëj kanë dijeni për njoftimet e ngjarjet që do të ndodhin në botën e Tokës para se ato të bëhen realitet, prandaj, një grup djajsh mundohet të ngjiten në Qiell, me qëllim që të përgjojnë e të dëgjojnë ndonjë fjalë dhe kështu të marrin vesh disa lajme, pastaj këto lajme djajtë ua komunikojnë agjentëve të tyre në Tokë, domethënë ua transmetojnë atyre djajve që jetojnë në mesin e njerëzve, por sapo këta djaj orvaten të ngjiten në Qiell, ata goditen prej meteorëve, që përshkruhen si yje që lëvizin me shpejtësi shumë të madhe dhe i detyrojnë djajtë të kthehen, ose i qëllojnë dhe i vrasin.

Gjithashtu, disa interpretues të Kur'ànit, kanë thënë: ka mundësi që, në kohën e sotme, të mos e kuptojmë në hollësi kuptimin e këtyre ajeteve, prandaj ne jemi të detyruar të ruajmë kuptimin e jashtëm që shprehin fjalët e ajeteve, kurse hollësitë le të kuptohen në të ardhmen.

Këtë opsion interpretimi e kanë zgjedhur dijetarët: Et Tabrasij, në "Mexhmaul Bejàn"; El Alùsij, në "Rùhul Meànij" dhe Sej'jid Kutub, në "Fij Dhilàlil Kur'àn", si edhe interpretues të tjerë të Ku'ànit Famëlartë.

Në të njëjtën kohë, disa interpretues të tjerë të Ku'ànit, janë shprehur se ajetet objekt studimi në të vërtetë janë sjellë si shembuj që përshkruajnë të vërtetat e jashtme, që nuk i kapin shqisat tona, por, në saje të këtyre shembujve, të vërtetat bëhen të kapshme prej shqisave tona, ashtu siç ka ardhur në ajetin 43 të sures "El Ankebùt": **"Këta shembuj Ne i sjellim për njerëzit, porse ato nuk i kupton askush përveç dijetarëve."**.

Interpretuesitt e Kur'ànit Famëlartë kanë shtuar se me fjalën "Qielli", në këtë ajet qëllimi është vendi ku qëndrojnë engjëjt, bota e shpirtrave që banojnë në horizonte më të larta se bota që kapin shqisat tona; kurse qëllimi me ngjitjen e djajve në drejtim të Qiellit, mundimi i djajve për të dëgjuar ndonjë lajm dhe gjuajtja e djajve me meteorët, do të thotë: sa herë që djajtë tentojnë t'i afrohen botës së engjëjve, me qëllim që të mësojnë fshehurazi ndonjë gjë prej sekreteve të krijimit dhe të ngjarjeve që do të ndodhin në të ardhmen, përzihen prej aty ku duan të ngjiten, me anë të dritës e fuqisë hyjnore, të cilën djajtë nuk e përballojnë dot. Domethënë se engjëjt i qëllojnë djajtë me të vërtetën, që zhvlerëson dokrrat e djajve.

Fakti që All'llahu i Lartësuar ka sjellë dëgjimin e ndonjë lajmi fshehtaz prej djajve dhe gjuajtjen e djajve me meteorët pas tre betimeve në engjëjt përcjellës të Revelatës dhe ruajtjen e engjëjve nga ana e Tij prej depërtimit të djajve, nuk mund të mos mbështesë atë që thamë më sipër.[1]

Një opsion tjetër interpretimi, mund të jetë se fjala "Qiell" këtu është metaforë për besimin dhe moralet në të cilët djajtë mundohen të ndikojnë në zemrat e besimtarëve nëpërmjet pështpëritjeve që djajtë hedhin në zemrat e besimtarëve. Djajtë mundohen që pështpëritjet e tyre të zënë vend në zemrat e besimtarëve. Por Profetët *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!,)* njerëzit e mirë e të ruajtur prej mëkateve dhe të gjithë ata që ecin në linjën e tyre ideore e praktike, i sulmojnë djajtë me "meteorin depërtues" që ata zotërojnë, i sulmojnë me diturinë e me përkushtimin dhe i ndalojnë djajtë t'i afrohen këtij "qielli".

[1] Përmbledhje e shkurtër e marrë prej tefsirit "El Mijzàn", vëll. 17, f. 125.

Në lidhje me interpretimin që ne sollëm këtu si opsion, disa argumente dhe dëshmues për këtë opsion ne i kemi përmendur edhe në fundin e komentit të ajetit 18 të sures "El Huxhuràt".

Këto ishin tre intrepretimet në lidhje me ajetet objekt studimi dhe për ajetet e ngjashme me këto.

Ajetet: 11 – 15

فَٱسْتَفْتِهِمْ أَهُمْ أَشَدُّ خَلْقًا أَم مَّنْ خَلَقْنَآ ۚ إِنَّا خَلَقْنَـٰهُم مِّن طِينٍ لَّازِبٍ ﴿١١﴾
بَلْ عَجِبْتَ وَيَسْخَرُونَ ﴿١٢﴾ وَإِذَا ذُكِّرُوا۟ لَا يَذْكُرُونَ ﴿١٣﴾ وَإِذَا رَأَوْا۟ ءَايَةً
يَسْتَسْخِرُونَ ﴿١٤﴾ وَقَالُوٓا۟ إِنْ هَـٰذَآ إِلَّا سِحْرٌ مُّبِينٌ ﴿١٥﴾

"Pyeti ata (idhujtarët) **a janë ata krijesa më e fortë, apo janë ata që Ne kemi krijuar; Ne i krijuam ata** (njerëzit) **prej një balte ngjitëse."**

"Ti (o Muhammed) **çuditesh që ata** (idhujtarët) **tallen."**

"Kur ata këshillohen, ata nuk e pranojnë këshillën."

"Edhe kur shohin ndonjë mrekulli, ata tallen."

"Dhe thanë: ky (Kur'àni) **s'është gjë tjetër veçse magji e mirëfilltë."**

Komentimi

Ata që kurrë nuk e pranojnë të vërtetën

Këto ajete trajtojnë çështjen e atyre që mohojnë Ringjalljen; njëkohësisht, në këto ajete vijon studimi rreth fuqisë së Filluesit të Madhëruar, Krijuesit të qiejve e të Tokës dhe ajeti i parë fillon me pyetjen drejtuar atyre mohuesve dhe thotë: pyeti ata, nëse Ringjallja dhe krijimi i tyre për herë të dytë është më i vështirë e më i rëndë se krijimi i engjëjve, qiejve dhe Tokës: **"Pyeti ata** (idhujtarët) **a janë ata krijesa më e fortë, apo janë ata që Ne kemi krijuar?"**.

Po, Ne i krijuam ata prej një lënde të rëndomtë, i krijuam prej një balte ngjitëse: **"Ne i krijuam ata** (njerëzit) **prej një balte ngjitëse."**.

Idhujtarët mohuan Ringjalljen dhe pasi dëgjuan ajetet e sipërme që flasin për krijimin e qiejve, Tokës dhe engjëjve, thanë: krijimi i njeriut është më i vështirë se krijimi i qiejve, Tokës dhe engjëjve, por Kur'àni Famëlartë u përgjigjet atyre dhe u thotë: në të vërtetë, krijimi i njeriut nuk është asgjë kundrejt krijimit të Tokës, Qiellit dhe engjëjve, që gjenden në të gjitha botët, sepse origjina e njeriut nuk është më shumë se një grusht balte ngjitëse.

Fjala *"festeftihim"*, në rrënjën e saj *"istiftàu"*, do të thotë: arritja e marrjes së njoftimeve të reja.

Kjo shprehje e ajetit tregon: sikur idhujtarët të thoshin të vërtetën se krijimi i tyre është më i rëndësishëm e më i vështirë se

krijimi i qiejve e i engjëjve, në të vërtetë ata kanë ardhur me një temë të re, që kurrë nuk është shtruar më përpara.

Në lidhje me fjalën e ajetit *"làzibin"* – *"ngjitës"* disa kanë thënë se në rrënjën e saj kjo fjalë ishte *"làzimin"*, por germa *"m"* e kësaj fjalë u zëvendësua me germën *"b"* dhe tani përdoret në formën *"làzibin"*. Porse në të gjitha gjendjet do të thotë: baltë e ngjeshur ngushtë njëra me tjetrën, në kuptimin e ngjitur, sepse origjina e njeriut është prej dheu të përzier me ujë, që, pas një kohe, u bë baltë e mbledhur, me erë të qelbur, pastaj u shndërrua në baltë kompakte (Kjo formë është shumësi i gjendjeve të shumta të përmendura në disa ajete të Kur'ànit Famëlartë).

Në vijim, Kur'àni Famëlartë shton: **"Ti** (o Muhammed) **çuditesh që ata** (idhujtarët) **tallen."**.

Po, ti çuditesh që ata mohojnë Ringjalljen, sepse ti, me zemrën tënde të pastër, e shikon çështjen me qartësi të plotë, kurse zemërzinjtë e konsiderojnë Ringjalljen krejtësisht të pamundur, deri në atë shkallë sa edhe tallen kur mohojnë Ringjalljen.

Prapa këtyre veprimeve të liga të idhujtarëve, nuk qëndron vetëm injoranca e mospasja dijeni, por është kryeneçësia e mllefi që ata kanë dhe sa herë që shpalosen argumentet që vërtetojnë Ringjalljen dhe dënimet hyjnore për mohuesit, ata nuk e pranojnë këshillën dhe për këtë ajeti njofton: **"Edhe kur shohin ndonjë mrekulli, ata tallen. Dhe thanë: ky** (Kur'àni) **s'është gjë tjetër veçse magji e mirëfilltë."**.

Qëllimi me fjalën e idhujtarëve *"hàdhà"* - *"ky"* këtu tregon përçmimin e idhujtarëve ndaj mrekullive dhe argumenteve

hyjnore, të cilët, nga mllefi që kishin, mundoheshin t'i paraqisnin këto mrekulli si gjëra fare të vogla, pa ndonjë rëndësi, megjithëse e dinin mirë që ato ishin punë të jashtëzakonshme dhe që nuk mund të mohoheshin; nga ana tjetër, idhujtarët nuk kishin dëshirë të dorëzoheshin ndaj këtyre mrekullive, prandaj tallja ishte sjellja e ulët, që pasqyronte ligësinë e tyre dhe kënaqësinë që ata ndjenin kur plotësonin dëshirat e tyre vetiake; në të njëjtëm kohë, shpjegon qartë pohimin e tyre për ndikimin e madh të Kur'ànit dhe të mrekullive me të cilat kishte ardhur Profeti më i nderuar, Muhammedi *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Dy hulumtime

1- Disa interpretues të Kur'ànit, janë shprehur se fjala e ajetit *"jesteskhirùne"* – *"tallen"* shpreh të njëjtin kuptim me foljen *"jeskharùne"* – *"tallen"* dhe nuk ka asnjë dallim në mes dy shprehjeve; megjithëkëtë, disa interpretues të tjerë të Kur'ànit, janë shprehur për ekzistencën e ndryshimit në mes dy foljeve dhe kanë thënë se ardhja e foljes së parë në formën *"jesteskhirùne"*, do të thotë: thirrja e të tjerëve që të bashkëpunojnë në talljen, njëkohësisht, prej kësaj mënyre foljeje, mësohet se ata nuk u mjaftuan që të tallen vetë me ajetet e Kur'ànit Famëlartë, por ftonin edhe të tjerët të merrnin pjesë në talljen e tyre dhe këtë e bënin me qëllim që çështja të merrte karakter të përgjithshëm në shoqërinë e tyre.

Disa interpretues të tjerë të Kur'ànit, e konsiderojnë këtë ndryshim në kuptim si forcim të shprehjes "*jesteskhirùne*".

Disa të tjerë, e kanë interpretuar këtë shprehje në kuptimin: "besimi se ai send është objekt talljeje" dhe kjo shpjegon shmangien e madhe që ata kishin në thellësinë e zemrave të tyre, megjithëse ishin të bindur se ato mrekulli nuk mund të ishin objekt për tallje; megjithëkëtë, kuptimi i dytë duket se është më në harmoni me përmasat e kuptimit që shprehin fjalët e ajetit të nderuar.

2- Disa interpretues të tjerë të Kur'ànit Famëlartë, thonë se shkaku i zbritjes së këtij ajeti, ka të bëjë me rastin kur njëri prej idhujtarëve të Mekës, i quajtur Rekàneh dhe që konsiderohej prej burrave më të fuqishëm, një ditë, duke kullotur dhentë e tij, u takua në një mal, ku s'kishte asnjë njeri tjetër, me të Dërguarin më të nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i Dërguari i tha: o Rekàneh, si thua, a do të më besosh mua nëse bëjmë mundje dhe unë të hedh ty për tokë? Ai tha po; u mundën dhe e hodhi tri herë për tokë; pastaj, ai *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, demonstroi para tij disa mrekulli: i thirri një peme dhe pema erdhi pranë tyre menjëherë; por ai jo vetëm që nuk i besoi, por, pasi u kthye në Mekë, iu drejtua fisit të të Dërguarit *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duke u thënë atyre: "ju të fisit beni Hashim me atë njeriun tuaj magjepsët banorët e Tokës". Në lidhje me këtë idhujtar dhe me të ngjashëm me atë, zbriti ky ajet.[1]

[1] Tefsiri "Rùhul Meànij", vëll. 23, f. 71.

Ajetet: 16 – 23

أَءِذَا مِتْنَا وَكُنَّا تُرَابًا وَعِظَـٰمًا أَءِنَّا لَمَبْعُوثُونَ ﴿١٦﴾ أَوَءَابَآؤُنَا ٱلْأَوَّلُونَ ﴿١٧﴾
قُلْ نَعَمْ وَأَنتُمْ دَٰخِرُونَ ﴿١٨﴾ فَإِنَّمَا هِىَ زَجْرَةٌ وَٰحِدَةٌ فَإِذَا هُمْ يَنظُرُونَ ﴿١٩﴾
وَقَالُوا۟ يَـٰوَيْلَنَا هَـٰذَا يَوْمُ ٱلدِّينِ ﴿٢٠﴾ هَـٰذَا يَوْمُ ٱلْفَصْلِ ٱلَّذِى كُنتُم بِهِۦ
تُكَذِّبُونَ ﴿٢١﴾ ۞ ٱحْشُرُوا۟ ٱلَّذِينَ ظَلَمُوا۟ وَأَزْوَٰجَهُمْ وَمَا كَانُوا۟ يَعْبُدُونَ
﴿٢٢﴾ مِن دُونِ ٱللَّهِ فَٱهْدُوهُمْ إِلَىٰ صِرَٰطِ ٱلْجَحِيمِ ﴿٢٣﴾

“A pasi ne të vdesim e të bëhemi dhê e kocka, a me të vërtetë ne do të ringjallemi?”

“A edhe të parët tanë të hershëm?”

“Thuaj: po dhe ju do të jeni të përçmuar.”

“Ajo do të jetë një britmë e vetme dhe ja ata shikojnë.”

“Dhe thonë: të mjerët ne, kjo është Dita e Gjykimit.”

“Kjo është Dita e Ndarjes, për të cilën ju thoshit se është gënjeshtërt.”

“Tuboni mizorët, të ngjashmit me ata dhe ata që ata adhuruan.”

"Në vend që të adhuronin All'llahun dhe i drejtoni ata për në rrugën e Xhehennemit."

Komentimi

A do të ngjallemi përsëri?

Këto ajete janë në vazhdën e fjalëve që lakonin lart e poshtë mohuesit e Ringjalljes dhe vazhdojnë t'u përgjigjen fjalëve të tyre. Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, e pasqyron qartë dyshimin në pamundësinë e Ringjalljes te ata idhujtarë dhe njofton fjalët me të cilat ata shprehnin hapur mohimin e Ringjalljes dhe habinë e tyre në lidhje me çështjen e Ringjalljes: **"A pasi ne të vdesim e të bëhemi dhê e kocka, a me të vërtetë ne do të ringjallemi?**[1]**"**[2].

Ata thoshin: Vallë, do të ringjallen edhe të parët tanë të hershëm: **"A edhe të parët tanë të hershëm?"**. Kush do t'i mbledhë ato kocka të kalbura dhe ato pirgje dheu të shpërndara andej-këndej, që kanë mbetur prej njeriut? Dhe cili ka mundësi të rikthejë jetën në ato kocka të kalbura?

[1] Tefsiri "Rùhul Meànij", vëll. 23, f.77.

[2] Ky ajet, sipas sintaksës së gjuhës arabe, është fjali kushtore dhe kushti i saj është fraza **"A pasi ne të vdesim"**, por plotësimi i kushtit është hequr; gjithashtu edhe fraza **"A me të vërtetë ne do të ringjallemi?"**, është e ngjashme me frazën e parë kushtore, sepse e njëjta frazë, në përputhje me rregullat letrare, nuk mund të jetë përgjigje për kushtin.

Ata zemërverbuar harruan se ditën e parë ishin baltë, harruan se prej baltës u krijuan; ata dyshojnë në fuqinë e All'llahut, por duhet të dinë se All'llahu ka bërë që ata të shohin fuqinë e Tij, pavarësisht se ata dyshojnë dhe thonë se është e pamundur që balta të bëhet me jetë, megjithëse veshja e baltës me rrobën e jetës është vërtetuar edhe më parë; veç kësaj, krijimi i qiejve e i Tokës me këtë madhësi të pamatshme, nuk lë vend për dyshim në asnjë njeri në lidhje me fuqinë absolute të Krijuesit të të gjitha sendeve.

Këtu duhet vënë në dukje se mohuesit e Ringjalljes, i formulonin fjalët e tyre me shprehje që përforconin mendimin e tyre - siç e pamë në frazën **"A me të vërtetë ne do të ringjallemi?"**. Sipas rregullave të sintaksës së gjuhës arabe, kjo frazë është fjali emërore, në të cilën, në krye të fjalës është përdorur shprehja *"ein"* dhe germa *"Le"*, që përforcon kuptimin e fjalës së tyre për pamundësinë e Ringjalljes. Pa dyshim që, ky mohim i tyre, vinte për shkak të injorancës së tyre.

Në këtë ajet, bie në sy se fjala *"turàb"* – *"dhê"* është përmendur para fjalës *"idhàm"* – *"kocka"* por kjo mënyrë rreshtimi e fjalëve ka mundësi të tregojë njërën prej tri pikave të mëposhtme:

E para: Pas vdekjes, prej trupit të njeriut në fillim mbeten vetëm kockat dhe më pas edhe kockat kalben e bëhen njësh me dheun; por, meqenëse rikthimi i dheut në jetë konsiderohet një punë e çuditshme dhe për të përforcur pohimin se Ringjallja patjetër do të bëhet, fjala "baltë", në këtë ajet ka ardhur para fjalës "kocka".

E dyta: Gjatë shpërbërjes së trupave të të vdekurve, në fillim mishi shndërrohet në baltë, por mbetet pranë kockave dhe për shpjeguar këtë gjendje shndërrimi, në këtë ajet, dheu dhe kockat janë përmendur në të njëjtën kohë.

E treta: Dheu tregon trupat e gjyshërve të hershëm, kurse kockat tregojnë trupat e prindërve, që ende nuk janë kalbur sa të bëhen njësh me dheun.

Pastaj, Kur'àni u përgjigjet pyetjeve të atyre që e mohojnë Ringjalljen, me një gjuhë të ashpër, duke e urdhëruar të Dërguarin më të nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me fjalët: u thuaj atyre: po, po, ju dhe gjyshërit tuaj shumë shpejt do të Ringjalleni, të përulur e të poshtëruar: **"Thuaj: po dhe ju do të jeni të përçmuar."**.[1]

Mos vallë ju, o mohues, mendoni se procesi i ngjalljes suaj dhe të parëve tuaj është i pamundur, ose është një punë shumë e vështirë për All'llahun e Lartësuar, Fuqiplotin? Jo dhe jo, vetëm ajo britma e fuqishme që do të dalë prej atyre që do të detyrojë All'llahu i Lartësuar me këtë detyrë, është e mjaftueshme të kthejë në jetë menjëherë të gjithë të vdekurit, pa asnjë parapërgatitje; të gjithë do të lënë varret dhe me sytë e tyre do të shikojnë veten në sheshin e madh të llogaridhënies, që ata e përgënjeshtronin, ashtu siç njofton ajeti vijues: **"Ajo do të jetë një britmë e vetme dhe ja, ata shikojnë."**.

[1] Fjala e fundit e ajetit "*dàkhirùne*", në rrënjën e saj "*dekhare*", tregon përçmim e poshtërim, ndërsa ajeti i përparshëm, në raport me këtë ajet është fjali vlerësuese në përgjigjen e dhënë fjalisë së parë, prandaj, në vlerësimin analitik, kuptimi i ajetit është: "po, ju do të ringjalleni, por do të ringjalleni të poshtëruar e të përçmuar".

Fjala *"zexhretun"*, në rrënjën e saj *"zexhere"*, siç kemi shpjeguar më sipër, do të thotë: përzënie me forcë, por disa herë vjen edhe në kuptimin e britmës, ashtu siç ka ardhur në ajetin objekt studimi dhe tregon për fryrjen, apo për britmën e dytë që do të lëshojë Isràfijli. Në lidhje me këtë fryrje, me lejen e All'llahut, do të flasim në ajetet e fundit të sures "Ez Zumer".

Fjala*"jendhurùne"*, tregon se mohuesit e Ringjalljes do të habiten, kur të shikojnë sheshin e grumbullimit të madh të llogaridhënies, ose kjo fjalë tregon se ata janë në pritje të ndëshkimit; gjithësesi, në të dy kuptimet, qëllimi nuk është vetëm kthimi i tyre në jetë, por atyre u kthehen edhe ndjenjat e shikimi, menjëherë sapo të dëgjojnë atë britmë.

Fraza **"një britmë e vetme"**, duke parë në kuptimet e të dyja fjalëve të kësaj fraze, tregon se Ringjallja do të jetë shumë e shpejtë dhe e menjëhershme, çka tregon se sa punë e lehtë është Ringjallja në raport me fuqinë e Krijuesit të Lartësuar, aq sa vetëm me një britmë të engjëllit të ringjalljes, të urdhëruar të lëshojë këtë britmë, jeta rikthehet në gjendjen e saj të parë.

Pikërisht këtu do të dëgjohen të thirrurat me zë të lartë të idhujtarëve mendjemëdhenj dhe pikërisht këtu do të bëhet e qartë sa të pafuqishëm janë ata, në të gjitha mundësitë me të cilat mburreshin dhe do të thonë: të mjerët ne, kjo është Dita e Gjykimit: **"Dhe thonë: të mjerët ne, kjo është Dita e Gjykimit."**.

Po, kur sytë e atyre që e mohonin Ringjalljen, do të shohin gjykatën e drejtësisë hyjnore, dëshmitarët që do të dëshmojnë kundër atyre dhe kur të marrin vendimin e asaj gjykate, atëherë ata do të shohin shenjat e ndëshkimit dhe nga tmerri që shikojnë,

do të thërrasin me të madhe e do të qajnë për gjendjen e tyre; ata do të pohojnë se Ringjallja është e vërtetë, por, ky pohim, ata as nuk i shpëton prej ndëshkimit e as nuk ua lehtëson dënimin që i pret.

Në këtë gjendje, atyre u flitet nga ana e All'llahut të Lartësuar ose prej engjëjve dhe u thuhet: po, sot është Dita e Ndarjes së vërtetë, që ju e përgënjeshtronit, sot është Dita e Ndarjes së të vërtetës nga e gabuara, sot është Dita e Ndarjes së mohuesve prej të përkushtuarve, sot është Dita e Gjykatës së madhe Hyjnore, ashtu siç njofton ajeti: **"Kjo është Dita e Ndarjes, që ju thoshit se është gënjeshtërt."**.[1]

Shprehje të ngjashme kanë ardhur edhe në ajete të tjera të Kur'ànit Famëlartë, të cilat trajtojnë Ditën e Gjykimit. Në këto ajete, Dita e Gjykimit është quajtur edhe dita e ndarjes. Pa dyshim që këto shprehje Kur'anore shkaktojnë çudi te mohuesit, sepse me të vërtetë janë shprehje jo vetëm të çuditshme, por janë edhe shumë frikësuese.

Vlen të theksohet se mohuesit, Ditën e Kiametit do ta quajnë Dita e Dënimit dhe ajeti njofton gjendjen e tyre: **"Të mjerët ne, kjo është Dita e Gjykimit."**.

Kurse All'llahu i Lartësuar, në Librin e mbushur vetëm me urtësi, e quan këtë ditë: Dita e Ndarjes: **"Kjo është Dita e Ndarjes."**.

Ndryshimi në mes dy shprehjeve ka mundësi të jetë për shkak se mohuesit mendojnë vetëm për dënimin që do të marrin,

[1] Suret: "Ed Dukhàn", ajeti 40; "El Murselàt", ajetet 13,14 dhe 38 dhe surja "El Ankebut", ajeti17.

kurse All'llahu i Lartësuar njofton për një kuptim shumë më të gjerë se dënimi; me këtë shprehje, i Larti njofton se dënimi është vetëm njëra prej përmasave të tmerreve të asaj Dite dhe e quan këtë ditë: Dita e Ndarjes; Dita e Ndarjes së radhëve të mohuesve prej të përkushtuarve, ashtu siç njoftohet edhe në ajetin 59 të sures "Jàsin": **"Dhe sot ju, o mohues, ndahuni"**; ky urdhër, në atë Ditë, u drejtohet mohuesve, që të ndahen veçmas prej besimtarëve, sepse këtu nuk jeni në botën e Tokës, në të cilën ishin së bashku mohuesit dhe të përkushtuarit.

Sa frikësuese do të jetë ajo pamje, kur mohuesit të shohin të afërmit e fëmijët e vet, që besuan në All'llahun, të ndahen prej tyre dhe të drejtohen për në Xhennetet e përhershme.

Veç kësaj, kjo është dita e ndarjes së të vërtetës nga e gabuara, Dita në të cilën bëhet detyrim dallimi i të gjitha linjave të kundërta; atë Ditë bëhet dallimi i programeve të vërteta prej programeve të gabuara e mashtruese, pasi, në botën e Tokës, të dy llojet e programeve ishin të përziera, por në atë Ditë të gjitha do të vihen në vendin përkatës.

Në të gjitha gjendjet, kjo Ditë, Dita e Ndarjes, do të thotë edhe Dita e Gjykimit; në atë Ditë, All'llahu i Lartësuar, Gjykatësi i drejtë, do të gjykojë në mes robve të Tij, do të nxjerrë vendime shumë të hollësishme për të gjitha sa ata kanë merituar me punën e tyre, pa i bërë asnjë lloj padrejtësie askujt; pikërisht në atë Ditë e në atë Vend do të turpërohen idhujtarët.

Bota e Tokës karakterizohet nga përzierja e të vërtetës me të gabuarën, kurse karakteristika e Botës pas Ringjalljes, është ndarja e të vërtetës nga e gabuara dhe ky është shkaku që Dita e

Kiametit, në Kur'ànin Famëlartë është quajtur edhe me emrin "Dita e Ndarjes", madje fjala "Dita e Ndarjes" është përsëritur shumë herë; është Dita në të cilën do të dalin sheshit të gjitha të fshehtat e sekretet; në atë Ditë është krejtësisht e pamundur të mënjanohet procesi i ndarjes së radhëve.

Më pas, Krijuesi i Lartësuar urdhëron engjëjt e ngarkuar me detyrën për të drejtuar mohuesit në rrugëm që i çon ata në Xhehennem, ashtu siç e lexojmë në ajetin e nderuar: **"Tuboni mizorët, të ngjashmit me ata dhe ato që ata adhuruan."**.

Po, i tuboni ata dhe ato që ata adhuronin: **"Në vend që të adhuronin All'llahun dhe i drejtoni ata për në rrugën e Xhehennemit."**.

Në lidhje me fjalën *"uhshurù"* – *"tuboni"* Ràgibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu El Fàdhil Kur'àn", shpjegon se kjo fjalë, në rrënjën e saj *"hashere"*, do të thotë: nxjerrja e grupit prej vendit ku janë dhe dëbimi i tyre prej luftës, ose prej ndonjë pune të rëndësishme të ngjashme me luftën.

Në shumicën e herëve, fjala *"uhshurù"* vjen në kuptimin: *tuboni*.

Në të gjitha gjendjet, këtu urdhëri "tuboni" mund të jetë ose nga ana e All'llahut të Lartësuar, ose nga ana e një grupi engjëjsh drejtuar një grupi tjetër engjëjsh, të ngarkuar me detyrën për të çuar mohuesit në Xhehennem, por në të dyja rastet rezultati është vetëm një.

Fjala *"ezvàxh"*, tregon ose për gratë e mohuesve dhe të idhujtarëve, ose për ata që besojnë siç besojnë mohuesit e idhujtarët dhe që bëjnë punë si punët e mohuesve dhe të

idhujtarëve, ose për ata që janë të njëjtë me ata, sepse fjala *"ezvàxh"* i përfshin të dy kuptimet, ashtu siç e lexojmë në ajetin 7 të sures "El Uàkia": **"Dhe ju ishit tre grupe."**.

Kjo do të thotë se idhujtarët do të tubohen së bashku me idhujtarët e njerëzit e ligj, ata që i kanë të verbuara zemrat, do të tubohen së bashku me të ngjashmit me ata dhe pastaj çohen për në Xhehennem.

Ose, qëllimi me fjalën *"ezvàxh"*, janë djajtë, sepse djajtë janë të ngjashëm me mohuesit, në formë e në punë.

Eshtë me shumë rëndësi, që në tre kuptimet s'ka asnjë kundërthënie dhe është e mundur që të tre kuptimet të mblidhen në kuptimin e ajetit.

Fraza **"dhe ata që ata adhuruan"**, tregon për zotat e idhujtarëve, siç ishin idhujt, djajtë, tiranët, arrogantët, faraonët e nemrùdët dhe që në këtë ajet të gjithë ata janë shprehur me frazën **"dhe ata që ata adhuruan"**. Dihet që shumica e të adhuruarve të mohuesve ishin trupa të ngurtë, pa jetë e pa mendje dhe janë përmendur me këtë shprehje për shkak se kështu kuptimi i të adhuruarve të rremë merr karakter përgjithësues.

Fjala *"el xhehijm"*, do të thotë: *"Xhehennem"* dhe në rrënjën e saj *"xhahmetun"*, është në kuptimin: *rritja e ashpërsisë së fuqisë djegëse të zjarrit*.

Në këtë ajet, bie në sy fakti se përdorimi i shprehjes **"dhe i drejtoni ata për në rrugën e Xhehennemit"**, me të vërtetë është një shprehje shumë e çuditshme. Në botën e Tokës, ata u udhëzuan të ecin në rrugën e drejtë, por ata nuk e pranuan

udhëzimin për të ecur në rrugën e drejtë, prandaj sot është bërë e detyrueshme që ata të drejtohen në rrugën që çon në Xhehennem, por këtu ata janë të detyruar të pranojnë që të shkojnë në këtë rrugë. Fakti i çuarjes së tyre drejt Xhehennemit, është një qortim shumë i ashpër për ata dhe i bën që të ndjejnë dhimbjen e ndëshkimit në zjarr, deri në thellësi të zemrave të tyre.

Ajetet: 24 – 32

وَقِفُوهُمۡۖ إِنَّهُم مَّسۡـُٔولُونَ ﴿٢٤﴾ مَا لَكُمۡ لَا تَنَاصَرُونَ ﴿٢٥﴾ بَلۡ هُمُ ٱلۡيَوۡمَ
مُسۡتَسۡلِمُونَ ﴿٢٦﴾ وَأَقۡبَلَ بَعۡضُهُمۡ عَلَىٰ بَعۡضٖ يَتَسَآءَلُونَ ﴿٢٧﴾ قَالُوٓاْ إِنَّكُمۡ
كُنتُمۡ تَأۡتُونَنَا عَنِ ٱلۡيَمِينِ ﴿٢٨﴾ قَالُواْ بَل لَّمۡ تَكُونُواْ مُؤۡمِنِينَ ﴿٢٩﴾ وَمَا كَانَ
لَنَا عَلَيۡكُم مِّن سُلۡطَٰنٖۖ بَلۡ كُنتُمۡ قَوۡمٗا طَٰغِينَ ﴿٣٠﴾ فَحَقَّ عَلَيۡنَا قَوۡلُ رَبِّنَآۖ
إِنَّا لَذَآئِقُونَ ﴿٣١﴾ فَأَغۡوَيۡنَٰكُمۡ إِنَّا كُنَّا غَٰوِينَ ﴿٣٢﴾

“Ndalni ata, sepse do të merren në përgjegjësi.”

“Përse nuk e ndihmoni njëri-tjetrin?”

“Por ata sot janë dorëzuar.”

“Ata bëjnë fajtor njëri-tjetrin.”

“(Të shtypurit) **i thonë** (parisë)**: ju ishit ata që na vinit ne nga ana e djathtë** (na ndalonit prej të vërtetës)**.”**

“Ata (paria) **i thonë: jo, ju vetë nuk ishit besimtarë.”**

“Ne s’kishim ndonjë pushtet mbi ju, porse ju vetë ishit në rrugën e humbjes.”

"U bë realitet fjala e Zotit tonë, pa dyshim ne po e shijojmë (dënimin)**."**

"Ne ju mashtruam, pasi në të vërtetë edhe vetë ne ishim në rrugën e humbjes."

Komentimi

Dialogu në mes parisë dhe masës që ishin në rrugën e humbjes

Ajetet e përparme shpalosën mënyrën se si engjëjt e ndëshkimit i çojnë në një vend të caktuar mohuesit dhe të tjerët që besojnë si ata, së bashku me idhujt e me zotat e rremë që ata adhuronin në vend që të adhuronin All'llahun dhe pastaj i drejtojnë ata në rrugën që çon në Xhehennem.

Në vazhdën e shpalosjes së asaj që do të ndodhë Ditën e Kiametit, ajeti i parë i grupit të ajeteve objekt studimi, njofton urdhërin e të Lartit: **"Ndalni ata, sepse do të merren në përgjegjësi."**.[1]

Po, ata duhet të ndalen që t'u përgjigjen pyetjeve të ndryshme që do t'u bëhen. Por, për çka do të pyeten ata?

---

[1] Fjala*"kifùhum"* herë vjen si folje kalimtare, në kuptimin: *"ndalim e arrestim"*; herë tjetër vjen si folje jokalimtare, në kuptimin: *"vetëndalim, qëndrim në vend"*, por me dallimin se rrënja e të parës është; *"vakfetun"* – *"ndalesë"* kurse rrënja e të dytës është: *"vukùf"* – "qëndrim në vend".

Disa kanë thënë se ata do të pyeten për rrenat që stisnin.

Disa të tjerë kanë thënë: ata do të pyeten për punët e tyre të liga dhe për fajet që kanë bërë.

Të tjerë kanë thënë: ata do të pyeten në lidhje me Njëtimin e All'llahut dhe për fjalën "Là ilàhe il'lell'llàh" – "S'ka zot tjetër përveç All'llahut".

Një grup i katërt kanë thënë: ata do të pyeten për mirësitë që u ishin dhënë, do të pyeten si e konsumuan rininë, shëndetin, jetën dhe pasurinë e tyre etj.

Natyrisht që në mes këtyre interpretimeve s'ka asnjë kundërthënie, sepse atë Ditë ata do të pyeten për çdo gjë: për besimet, për Njëtimin e All'llahut, për fjalët që kanë thënë e për punët që kanë bërë, do të pyeten për mirësitë e për dhuntitë e shumta që All'llahu i Lartësuar ka vënë t'i zgjedhë vetë njeriu, me vullnetin e me dashjen e tij.

Këtu del pyetja: përse ata në fillim çohen në rrugën për në Xhehennem dhe pastaj urdhërohen të ndalojnë që të merren në pyetje?

A nuk duhej që procesi i ndalimit dhe i marrjes në pyetje të ishte para çuarjes së tyre në rrugën për në Xhehennem?

Për këtë pyetje, ka dy përgjigje:

E para: që ata janë banorë të Xhehennemit, kjo është qartë për të gjithë, madje edhe ata vetë tani e dinë këtë të vërtetë, kurse marrja e tyre në pyetje bëhet me qëllim që ata të informohen për sasinë e për masën e fajeve e të krimeve që kanë bërë.

E dyta: këto pyetje u bëhen atyre që të gjykohen; në të njëjtën kohë, këto pyetje për ata janë qortim dhe ndëshkim shpirtëror.

Natyrisht që është kështu kur pyetjet kanë lidhje me ato që u thanë më sipër, por kur biseda ka lidhje me ajetin vijues, që i pyet ata përse nuk e ndihmojnë njëri-tjetrin, atëherë këtu nuk mbetet më asnjë problem në interpretimin e këtij ajeti, por ky interpretim nuk është në përputhje me ato që kanë ardhur në disa transmetime që flasin në lidhje me këtë çështje, me përjashtim të rastit kur kjo pyetje është pjesë prej pyetjeve të ndryshme.

Kur mohuesit drejtohen për në rrugën që çon në Xhehennem, duart e tyre janë si të prera dhe ata s'kanë mundësi që, me duart e veta, të arrijnë ndonjë lloj ndihme; në këtë gjendje, atyre u thuhet: ju ishit ata që mbështeteshit te tjetri për problemet që kishit dhe kërkonit ndihmë prej tij, përse tani nuk e ndihmoni njëri-tjerin dhe ajeti njofton: **"Përse nuk e ndihmoni njëri-tjetrin?"**.

Të gjitha kolonat që ju në botën e Tokës i konsideronit kolona të sigurta, tani janë zhdukur e nuk i keni më. Tani as ju s'keni mundësi të ndihmoni njëri-tjetrin e as zotat tuaj s'kanë fuqi t`ju japin ndonjë ndihmë, sepse ata jo vetëm që s'kanë fuqi të japin ndihmë, por janë të preokupuar për veten e tyre.

Tregohet se Ebù Xhehli, ditën e luftës së Bedrit, tha me zë të lartë: "ne të gjithë jemi ngadhënjyes" dhe Kur'àni Famëlartë e ka përsëritur thënien e këtij kryemohuesi në ajetin 44 të sures "El Kamer", ku lexojmë fjalën e të Lartit: **"A mos po thonë: ne jemi një grup ngadhënjyes tok të bashkuar?"**, por, Ditën e Kiametit, Ebù Xhehli dhe të ngjashmit me atë, do të pyeten: përse nuk

nxitoni të ndihmoni njëri-tjetrin? Por ata s'kanë mundësi t'i japin kësaj pyetjeje asnjë përgjigje; ata qëndrojnë në heshtje të plotë dhe kjo gjendje e thekson edhe më qartë poshtërimin e nënshtrimin e tyre.

Ajeti vijues shton: atë Ditë ata janë dorëzuar ndaj urdhërave të All'llahut dhe janë të përulur para Tij, por ai nënshtrim e ajo përulje nuk u jep atyre asnjë mundësi të kundërshtojnë, ashtu siç njofton ajeti: **"Por ata sot janë dorëzuar."**.

Në këtë gjendje, çdonjëri prej tyre fillon të qortojë tjetrin dhe nxiton që barrën e fajeve të veta ta hedhë mbi tjetrin; të sunduarit i konsiderojnë krerët e tyre të dështuar, u kundërvihen ballë për ballë dhe çdonjëri prej tyre fillon e pyet tjetrin, ashtu siç njofton ajeti: **"Ata bëjnë fajtor njëri-tjetrin."**.

Të sunduarit u thonë krerëve të tyre: ju jeni djaj, ju hiqeshit se na këshillonit, ju na thoshit se dëshira juaj ishte të na udhëzoni në rrugën e drejtë dhe se ju doni vetëm të mirën e lumturinë tonë, por, pas këshillës suaj, nuk kishte gjë tjetër përveç mashtrimit, kurtheve e humbjes së plotë dhe ajeti njofton: **"**(Të shtypurit) **i thonë** (parisë)**: ju ishit ata që na vinit ne nga ana e djathtë** (na ndalonit prej të vërtetës)**."**.

Ju na vinit e na pështpërisnit në një kohë kur ne, në saje të natyrës së pastër të krijimit, nxitonim drejt të mirës e lumturisë, por fjalët tuaja mashtruese u bënë shkak që ne iu përgjegjëm thirrjes suaj, por ne nuk e dinim se ju, prapa fytyrave tuaja të mira në dukje, kishit edhe një fytyrë tjetër djallëzore, kishit edhe një fytyrë të keqe, me të cilën bëtë që ne të biem në gabime e të bëjmë

faje; po, po, për të gjitha fajet që ne kemi bërë, përgjegjës jeni ju dhe vetëm ju, sepse ne nuk kishin asgjë tjetër, përveç qëllimit të mirë dhe zemrës së pastër; kurse ju, djajtë gënjeshtarë, nuk kishit asgjë tjetër, përveç mashtrimit, kurtheve e pabesisë.

Fjala *"jemijn"*, do të thotë: dora e djathtë, ose ana e djathtë, por arabët, këtë fjalë disa herë e përdorin si metaforë, për të treguar të mirën, begatinë, këshillën; çdo gjë që atyre u vinte nga ana e djathtë, e quanin ogur të mirë dhe ky është shkaku që, disa interpretues të Kur'ànit, frazën **"ju ishit ata që na vinit ne nga ana e djathtë"**, e kanë interpretuar në kuptimin se ana e djathtë vë në dukje të mirën dhe këshillën, ashtu siç thamë edhe më sipër.

Në të gjitha gjendjet, kultura e përgjithshme e konsideron gjymtyrën e djathtë, ose palën e djathtë, të ndershme, të lartë, kurse të majtën e konsideron jo të ndershme dhe ky është shkaku që dora e djathtë përdoret për dhënie bamirësie dhe për punë të mira e të nderuara.

Një grup tjetër interpretuesish të Kur'ànit Famëlartë, kanë thënë se qëllimi me frazën: **"ju ishit ata që na vinit ne nga ana e djathtë"** është: ju na erdhët të na mbështesni me fuqi, sepse ana e djathtë zakonisht është më e fuqishme dhe bazuar mbi këtë shpjegim, dihet se shumica e njerëzve i realizojnë punët e tyre të rëndësishme e të vështira me dorën e djathtë, prandaj kjo shprehje përdoret edhe si metaforë që tregon fuqinë.

Përveç dy interpretimeve të sipërme, në lidhje me këtë shprehje të ajetit objekt studimi ka edhe interpretime të tjera, por, pa asnjë dyshim, interpretimi i parë është më i përshtatshëm.

Kundrejt fjalëve të atyre që i ndiqnin, udhëheqësit nuk heshtin, por u përgjigjen pasuesve të tyre duke u thënë: **"Ata** (paria) **u thonë: jo, ju vetë nuk ishit besimtarë."**.

Sikur dëshirat tuaja të mos ishin të shmangura dhe sikur ju të mos ishit prej atyre që kërkojnë vetëm sherre djallëzore, ju kurrë nuk do të na ndiqnit ne për shkak të një shenje të vetme që ju bëmë; përse ju nuk iu përgjigjët thirrjes së Profetëve e njerëzve të mirë? Siç shihet, të keqen e keni në veten tuaj, prandaj shkoni e qortoni dhe mallkoni veten tuaj; argumenti ynë është shumë i qartë: ne nuk kishim asnjë pushtet mbi ju, nuk ju kemi bërë asnjë presion dhe nuk ju kemi detyruar të bëni asnjë punë, ashtu siç e lexojnë në ajetin vijues: **"Ne s'kishim ndonjë pushtet mbi ju."**.

Në të vërtetë, ju vetë jeni njerëz mizorë, jeni prej atyre që sulmojnë të tjerët; sot ju jeni në këtë gjendje për shkak të moraleve tuaja të shprishura dhe karakterit tuaj mizor: **"...porse ju vetë ishit në rrugën e humbjes."**.

Sa e dhimbshme është për njeriun kur të shohë udhëheqësin e prijësin e tij, me të cilin kishte lidhje zemre gjatë gjithë jetës së vet, të bëhet shkak që ai është në këtë gjendje të mjeruar, prandaj ai menjëherë heq dorë prej tij dhe të gjitha fajet e veta mundohet t'ia hedhë mbi kurriz prijësit e udhëheqësit të vet.

Në të vërtetë, të dy grupet kanë të drejtë në fjalët që thonë; asnjëra palë nuk është e pafajshme. Mashtrimi e djallëzia ishte prej parisë, kurse pranimi i mashtrimit e i djallëzive ishte prej atyre që ndiqnin parinë.

Gjithësesi, polemika në mes jush nuk çon në asnjë rezultat; këtu krerët e mohuesve do të pohojnë këtë të vërtetë dhe do të

thonë: kundër nesh, me këtë argument u vërtetua urdhëri i All'llahut, për të gjithë ne doli urdhëri i drejtë i dënimit dhe shumë shpejt, të gjithë do të "shijojmë" ndëshkimin e All'llahut dhe për këtë ndëshkim, ajeti vijues njofton: **"U bë realitet fjala e Zotit tonë, pa dyshim ne po e shijojmë** (dënimin)**."**.

Ju ishit despotë dhe kjo është e ardhmja e despotëve, kurse ne jo vetëm që ishim në rrugën e humbjes, por punonim që të fusnim edhe të tjerët në rrugën e humbjes.

Paria u thotë pasuesve: ne ishim vetë në rrugën e humbjes, prandaj ju çuam edhe ju në rrugën e humbjes, ashtu siç njofton ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh: **"Ne ju mashtruam, pasi në të vërtetë edhe vetë ne ishim në rrugën e humbjes."**.

Bazuar mbi këtë shpjegim, atëherë cili është problemi që shkakton çudi se ata të gjithë janë ortakë në këto vështirësi dhe në këtë ndëshkim?

Hulumtim

1- Paria dhe pasuesit e tyre janë në rrugën e humbjes

Në ajetet objekt studimi dhe në ajete të tjera të Kur'ànit Famëlartë, flitet për grindjen në mes parisë dhe atyre që ndjekin parinë Ditën e Kiametit ose në Xhehennem. Në të vërtetë, ky ajet është një paralajmërim për cilindo që e ka lënë mendjen dhe fenë e tij në dorën e udhëheqësve që kanë shkarë në rrugën e humbjes.

Në atë Ditë, çdonjëri prej tyre, pari e pasues, do të përpiqen të shfajësohen, madje mundohen që edhe fajin që kanë bërë ta hedhin mbi tjetrin, por, në këtë gjendje, asnjëri prej tyre s'ka mundësi të vërtetojë pafajësinë e tij.

Në këto ajete, ne pamë se krerët e mashtrimit e të rrugës së humbjes, u thonë qartë pasuesve të tyre: shkaku që ne ndikuam mbi ju është se në brendësinë tuaj ekzistonte shpirti i mizorisë, ashtu siç e lexuam në ajetin: **"Porse ju vetë ishit në rrugën e humbjes."**.

Dhe ky despotizmi juaj përgatiti terrenin që të ndikojë në ju mashtrimi ynë, nëpër këtë rrugë ne mundëm të transportojmë mitet në mesin tuaj, sepse ne: **"Ne ju mashtruam, pasi në të vërtetë edhe vetë ne ishim në rrugën e humbjes."**.

Nëse do të thellohemi në kuptimin e fjalës *"agvà"* – *"mashtroi"*problemi do të dilte fare i qartë, sepse kjo fjalë, ashtu siç e shpjegon Ragibi në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu El Fàdhil Kur'àni", do të thotë: injorancë e ardhur prej bestytnive

dhe shkaku ishte se vetë krerët e rrugës së humbjes kanë mbetur shumë larg njohjes së të vërtetave të ekzistencës e të jetës dhe injorancën e bestytnitë e tyre dëmtuese, i transportuan në pasuesit e tyre, të cilët, nga ana e tyre, në brendësi mbartnin shpirtin e despotizmit e të mendjemadhësisë kundrejt urdhërit të Krijuesit të Lartësuar.

Me këtë argument, paria pohon se ata dhe pasuesit e tyre e meritojnë ndëshkimin, ashtu siç njofton ajeti: **"U bë realitet fjala e Zotit tonë, pa dyshim ne po e shijojmë** (dënimin)**."**.

Fjala *"rab'bun"* – *"Zot"* në ajetin e sipërm, ka një qëllim shumë të lartë, All'llahu bën që njeriu të arrijë deri në shkallë të larta, sepse All'llahu është Pronari i njeriut dhe Edukuesi i tij; për njeriun All'llahu nuk dëshiron asgjë tjetër përveçse të mirës e lumturisë dhe është po Ai që urdhëron që njeriu të flaket në ndëshkimin më të ashpër! Patjetër që kjo është prej punëve të veçanta të Tij.

Në të gjitha gjendjet, Dita e Gjykimit është Dita e hidhërimit; në atë Ditë do të pendohen krerët e rrugës së humbjes dhe pasuesit e parisë për punët që ata kanë bërë, por ky pendim tani nuk sjell për ata asnjë dobi dhe për ata s'ka më asnjë rrugë për kthim.

Ajetet: 33 – 40

فَإِنَّهُمْ يَوْمَئِذٍ فِى ٱلْعَذَابِ مُشْتَرِكُونَ ﴿٣٣﴾ إِنَّا كَذَٰلِكَ نَفْعَلُ بِٱلْمُجْرِمِينَ ﴿٣٤﴾ إِنَّهُمْ كَانُوٓاْ إِذَا قِيلَ لَهُمْ لَآ إِلَـٰهَ إِلَّا ٱللَّهُ يَسْتَكْبِرُونَ ﴿٣٥﴾ وَيَقُولُونَ أَئِنَّا لَتَارِكُوٓاْ ءَالِهَتِنَا لِشَاعِرٍ مَّجْنُونٍ ﴿٣٦﴾ بَلْ جَآءَ بِٱلْحَقِّ وَصَدَّقَ ٱلْمُرْسَلِينَ ﴿٣٧﴾ إِنَّكُمْ لَذَآئِقُواْ ٱلْعَذَابِ ٱلْأَلِيمِ ﴿٣٨﴾ وَمَا تُجْزَوْنَ إِلَّا مَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٣٩﴾ إِلَّا عِبَادَ ٱللَّهِ ٱلْمُخْلَصِينَ ﴿٤٠﴾

“Atë Ditë ata do të jenë së bashku në dënim.”

“Ne kështu veprojmë me kriminelët.”

“Kur atyre u thuhej: s’ka zot tjetër përveç All’llahut, ata e mbanin veten lart.”

“Dhe thoshin: qysh do të lemë zotat tanë për një poet të çmendur?”

“Jo, (nuk është si thonë ata) **ai erdhi me të drejtën dhe vërtetoi të Dërguarit** (e përparshëm)**.”**

"Ju pa tjetër do të provoni dënimin e dhimbshëm."

"Dhe do të ndëshkoheni vetëm për punët që keni bërë."

"Me përjashtim të robve të sinqertë të All'llahut."

Komentimi

E ardhmja e krerëve të rrugës së humbjes dhe e pasuesve të tyre

Ajetet e përparme flisnin për grindjen në mes krerëve të rrugës së humbjes dhe pasuesve të tyre Ditën e Kiametit, pranë Xhehennemit, kurse ajetet objekt studimi trokasin në çështjen e të ardhmes që i pret të dy grupet, krerë dhe pasues, njëkohësisht këto ajete shpjegojnë shkaqet e brengosjes së tyre, në atë mënyrë që jo vetëm e diagnostikon sëmundjen, por jep edhe ilaçin për mjekimin e asaj sëmundjeje.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, thotë se pasuesi dhe i pasuari, prijësi dhe ai që ndjek prijësin, atë Ditë janë së bashku në ndëshkimin hyjnor: **"Atë Ditë ata do të jenë së bashku në dënim."**.

Fakti që ata janë së bashku në ndëshkim, nuk është pengesë që të ketë ndryshim në vendin ku ata flaken në Xhehennem, duke shtuar se edhe ndëshkimi hyjnor nuk do të jetë i njëllojtë për të gjithë. Është normale që, njeriu i cili bëhet shkak

për shmangien e mijërave njerëzve, ndëshkimi për atë nuk mund të jetë i barabartë me një individ të zakonshëm të rënë në rrugën e humbjes. Ajeti objekt studimi është i ngjashëm me ajetin 48 të sures "Gàfir", ku shpjegohet se mendjemëdhenjtë u thonë atyre me besim të dobët pas grindjes e akuzave të ndërsjella në mes tyre: në Xhehennem do të jemi së bashku, sepse All'llahu i Lartësuar gjykoi me drejtësi në mes njerëzve: **"Ata që mbaheshin me të madh thonë: ne të gjithë jemi brenda në të; All'llahu gjykoi në mes njerëzve."**.

Ky ajet nuk është në kundërshtim me ajetin 13 të sures "El Ankebùt", në të cilin Krijuesi thotë: **"Ata patjetër do të mbajnë edhe barrën e atyre krahas barrës së vet"**, domethënë: Ditën e Kiametit ata do të mbajnë jo vetem barrën e vet, por do të mbajnë edhe një barrë tjetër të rëndë të shtuar mbi barrën e tyre, për shkak se ata mashtruan dhe çuan të tjerët në rrugën e humbjes, madje edhe i nxisnin të mashtruarit që të bënin sa më shumë faje.

Për të përforcuar edhe më shumë se ndëshkimi do të ndodhë patjetër, ajeti vijues njofton: **"Ne kështu veprojmë me kriminelët"**; ky është ligji Ynë, ligj i bazuar në drejtësinë.

Ajeti vijues sqaron shkakun kryesor që gjendet prapa brengosjes së tyre dhe thotë: **"Kur atyre u thuhej: s'ka zot tjetër përveç All'llahut, ata e mbanin veten lart."**.

Po, mendjemadhësia e krekosja, mosnënshtrimi para të vërtetës, këmbëngulja për të punuar sipas zakoneve e traditave të gabuara, si dhe shikimi i çdo sendi me përçmim, të gjitha këto çojnë në shmangien e njeriut.

Por, përballë frymës së mendjemadhësisë qëndron nënshtrimi e dorëzimi ndaj të vërtetës dhe kjo e vërtetë është Islami. Mendjemadhësia është baza e padrejtësisë dhe errësirës, kurse nënshtrimi dhe dorëzimi ndaj ajeteve të Kur'ànit, janë baza e lumturisë dhe e kënaqësisë.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se, Kur'àni Famëlartë, në disa ajete, u shpjegon mendjemëdhenjve, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndëshkimin hyjnor që do të bjerë mbi ata, ashtu siç njoftohet në ajetin 20 të sures "El Ahkàf": **"Sot do të dënoheni me ndëshkimin poshtërues, për shkak të mendjemadhësisë që treguat mbi Tokë, pa të drejtë."**.

Ndërkaq, ata mundohen të përligjin fajet e tyre të rënda me justifikime edhe më të zinj se sa vetë mëkatet e tyre, siç është fjala e tyre: mos vallë do të lemë zotat tanë për një poet të çmendur, ashtu siç njofton ajeti vijues: **"Dhe thoshin: qysh do të lemë zotat tanë për një poet të çmendur?"**.

Ata e etiketuan Profetin më të nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me emrin poet, sepse fjala e tij depërtonte në zemrat e tyre dhe vinte në lëvizje ndjenjat e tyre; disa herë, ai u fliste atyre me fjalë të rimuara, të cilat, nga ana letrare qëndronin shumë më lart se poezia më e mirë, në një kohë që fjala e tij nuk ishte poezi, prandaj ata e quanin atë të çmendur, për shkak se ai nuk ishte i ngjyrosur me ngjyrën e mjedisit në të cilin jetonte dhe mbante qëndrim të hekurt kundër miteve në të cilat besonin fanatikët e asaj kohe. Qëndrimin e tij, shoqëria e konsideroi qëndrim të shmangur nga rruga e zakonshme e shoqërisë së kohës; gjithashtu, qëndrimin e tij ata e konsideronin një lloj çmendurie vetëvrasëse, në një kohë që ky

qëndrim, për të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte krenari, sepse qëndrimi i tij ishte mosdorëzim ndaj gjendjes zotëruese të asaj kohe.

Këtu Kur'àni ndërhyn për t'iu përgjigjur mëtimeve të tyre mjerane dhe për të mbrojtur pozitën e lartë të Revelatës e të kumtit të Profetit të Islamit *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe thotë: **"Jo,** (nuk është si thonë ata) **ai erdhi me të drejtën dhe vërtetoi të Dërguarit** (e përparshëm)**."**.

Nga njëra anë, libri me të cilin ai erdhi dhe nga ana tjetër përputhja e thirrjes që ai bënte me thirrjet që kanë bërë Profetët e përparshëm, janë argumenti më i mirë që vërteton drejtësinë e fjalës së tij.

Kurse ju, o mendjemëdhenj, do të provoni ndëshkimin e dhimbshëm të All'llahut, për shkak se vetë deshët e ratë në rrugën e humbjes, ashtu siç njofton ajeti vijues: **"Ju pa tjetër do të provoni dënimin e dhimbshëm."**.

Dhe mos mendoni se All'llahu i Lartësuar është hakmarrës, apo do të hakmerret kundër jush për Profetin e Tij *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Jo, kurrë nuk është kështu dhe ajeti vijues u shpjegon atyre përse do të dënohen: **"Dhe do të ndëshkoheni vetëm për punët që keni bërë."**.

Në të vërtetë, punët tuaja do të paraqiten para jush të trupëzuara dhe do të mbeten së bashku me ju, që me ato të ndëshkoheni, por dijeni se ky dënim është rezultat i punëve tuaja, i mohimit tuaj e i mosbesimit tuaj në All'llahun e Lartësuar, është rezultat i mëtimit tuaj të rremë se ajetet e Kur'ànit janë vjersha

dhe se i Dërguari i Tij *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është i çmendur, duke shtuar edhe padrejtësinë e mizorinë tuaj dhe fajet e rënda e punët e liga që ju keni bërë.

Ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh, që në të vërtetë është parathënie për studimin që vjen më poshtë, përjashton prej ndëshkimit një grup njerëzish, përjashton robtë e sinqertë të All'llahut: **"Me përjashtim të robve të sinqertë të All'llahut."**.

Fraza *"ibàdell'llàh"* – *"robërit e All'llahut"* shpjegon qartë lidhjen e këtij grupi njerëzish me All'llahun e Lartësuar. Por, kur kësaj fraze i shtohet edhe fjala *"mukhlesijn"*, kjo fjalë, i jep kësaj fraze thellësi e jetë. Sipas rregullave të sintaksës së gjuhës arabe, fjala *"mukhlesijn"* në këtë ajet është në pozitën e cilësorit dhe do të thotë: njeriu të cilin e ka pastruar All'llahu i Lartësuar për Veten e Tij, e ka pastruar atë prej të gjitha formave të idhujtarisë, hipokrizisë, cytjeve të djajve dhe prej dëshirave të ulta.

Po, ky grup nuk do të merret në llogari për punët e tij; këtë grup All'llahu i Lartësuar e trajton me mirësinë e me respektin e Tij dhe u jep atyre shpërblime të pallogaritshme.

Hulumtim

Vështrimi me kujdes në ajetet e Kur'ànit, bën të qartë se fjala *"mukhlis",* është përdorur në shumë vende dhe flet për gjendjen e një njeriu që përjeton etapat e ndërtimit të vetvetes, por që nuk ka arritur plotësimin. Kurse fjala e ajetit *"mukhlas",* thuhet për etapën në të cilën njeriu ka arritur shkallën në të cilën ai është i ruajtur prej cytjeve që hedh djalli në zemrën e tij. Natyrisht që këtë shkallë, njeriu e arrin pas kapërcimit të etapës së luftës me unin e tij dhe pas kapërcimit të etapave të njohjes e të besimit. Rëndësia e "robve të sinqertë të All'llahut", në Kur'ànin Famëlartë theksohet edhe prej fjalës që djalli i tha All'llahut të Lartësuar: **"Betohem në madhërinë Tënde, të gjithë do t'i shmang prej rrugës së drejtë. Me përjashtim të atyre që janë prej robve të Tu të sinqertë."** (sure "Sàd", ajetet nr. 82-83).

Ky ajet është përsëritur disa herë në Kur'ànin Famëlartë dhe në të vërtetë shpjegon pozitën e lartë të të sinqertëve. Besimi i sinqertë është pozita me të cilën është përshkruar Jusufi i drejtë *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe ai e arriti këtë pozitë vetëm pasi kaloi me sukses të gjitha fushat e provës. Në lidhje me pozitën e tij të lartë, Kur'àni njofton: **"...që të largojmë prej tij të keqen dhe të ndyrën; me të vërtetë ai ishte prej robve Tanë të sinqertë."**,[1] domethënë: Ne i shfaqëm Jusufit argumentet Tona që të largojmë prej tij të ndyrën e të keqen, sepse ai ishte prej robve Tanë të sinqertë.

[1] Sure "Jùsuf" ajeti 24.

Patjetër që pozitën e të "sinqertit" e arrin vetëm ai që triumfon në luftën e madhe, në luftën me unin e tij; atëherë atë e përfshin butësia hyjnore, e cila asgjëson në qenien e tij çdo gjë të papastër dhe në atë njeri mbetet vetëm shpirti i pastër e i kulluar, i pastër si floriri qind për qind, i përftuar gjatë shkrirjes në furrat e ngjarjeve dhe sprovave. Edhe shpërblimi i kësaj kategorie, nuk bëhet sipas punëve që ata kanë bërë; kriteri për shpërblimin e tyre është mirësia dhe mëshira hyjnore.

Në lidhje me këtë çështje, dijetari i nderuar Et Tàbàtàbaij, thotë:

"Në këtë ajet, All'llahu i Lartësuar thotë: të gjithë njerëzit do të shpërblehen sipas punëve që kanë bërë, me përjashtin të robve të sinqertë të All'llahut, të cilët e kuptojnë se ata me të vërtetë janë robër të All'llahut dhe rob është njeriu që nuk zotëron asnjë send, nuk zotëron as vullnet e as punë; njerëz të këtillë nuk dëshirojnë gjë tjetër përveç asaj që dëshiron All'llahu dhe çdo punë e bëjnë që të fitojnë kënaqësinë e Tij. Meqenëse ata janë prej robve të sinqertë, All'llahu i ka pastruar ata për Veten e Tij; këta rob të sinqertë të All'llahut nuk kanë lidhje me asnjë send, ata janë të lidhur vetëm në Personin e lartë të All'llahut të Madhëruar; në zemrat e tyre nuk ka vend dashuria për këtë botë e për gjërat e bukura që janë në këtë botë dhe në zemrat e tyre nuk gjendet asgjë tjetër, përveç All'llahut të Lartësuar".

Dihet se kush e ka këtë cilësi, kënaqësia dhe mirësitë që ai do të gëzojë janë ndryshe nga kënaqësitë e mirësitë që do të gëzojnë të tjerët. Edhe furnizimi i tij me ushqim do të jetë i ndryshëm nga furnizimi i të tjerëve edhe pse si ushqime kanë të përbashkët cilësinë që hahen e pihen. Nga të gjitha këto, përforcohet qëllimi me fjalën e All'llahut **"Për të këtillë ka një**

furnizim të dalluar.”.[1] Ajeti i nderuar tregon se furnizimi i tyre në Xhennet është i veçantë dhe nuk përngjan me furnizimin e të tjerëve (ata furnizohen me pamjen e Qenies së pastër të All’llahut, zemrat e tyre janë të mbushura me siguri dhe dashuri të pakufishme për All’llahun, ata janë të zhytur në dashurinë për të arritur te All’llahu i Madhëruar)[2].

[1] Sure “Es Sàf’fàt”, ajeti 41.
[2] Tefsiri “El Mijzàn”, vëll. 17, f. 141.

Ajetet: 41 – 4

أُوْلَٰٓئِكَ لَهُمۡ رِزۡقٞ مَّعۡلُومٞ ﴿٤١﴾ فَوَٰكِهُۖ وَهُم مُّكۡرَمُونَ ﴿٤٢﴾ فِي جَنَّٰتِ ٱلنَّعِيمِ
﴿٤٣﴾ عَلَىٰ سُرُرٖ مُّتَقَٰبِلِينَ ﴿٤٤﴾ يُطَافُ عَلَيۡهِم بِكَأۡسٖ مِّن مَّعِينٖ ﴿٤٥﴾
بَيۡضَآءَ لَذَّةٖ لِّلشَّٰرِبِينَ ﴿٤٦﴾ لَا فِيهَا غَوۡلٞ وَلَا هُمۡ عَنۡهَا يُنزَفُونَ ﴿٤٧﴾
وَعِندَهُمۡ قَٰصِرَٰتُ ٱلطَّرۡفِ عِينٞ ﴿٤٨﴾ كَأَنَّهُنَّ بَيۡضٞ مَّكۡنُونٞ ﴿٤٩﴾

"Të këtillë kanë një furnizim të dalluar."

"Fruta, ata janë të nderuar."

"Ne Xhennetet e mirësive të mëdha."

"Të mbështetur mbi poltrona përballë njëri-tjetrit."

"Atyre u serviren gota (të mbushura me pije) **prej burimit."**

"Të bardha dhe që i sjellin kënaqësi atyre që pinë (në ato gota)**."**

"Nuk shkakton dhimbje koke dhe ata nuk dehen prej saj."

"Pranë tyre janë (bukuroshet) **symëdhatë me shikim të përulur."**

"Sikur ato janë vezë të ruajtura."

Komentimi

Mirësitë e dhuratat për banorët e Xhennetit

Ajetet e përparme flisnin për robtë e sinqertë të All'llahut, kurse ajetet objekt studimi flasin për mirësitë e për dhuratat e pallogaritshme që All'llahu i Lartësuar do t'u dhurojë banorëve të Xhennetit dhe këto mirësi e dhurata mund të klasifikohen në shtatë kategori:

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, njofton se për ata do të ketë një furnizim me ushqim të njohur e të veçantë: **"Të këtillë kanë një furnizim të dalluar."**.

Vallë, a është ky *"furnizim i dalluar"* një ekstrat i mirësive që do të shpjegohen në ajetet vijuese dhe që do të derdhen mbi ata me shumicë, në mënyrë të padukshme?

Apo tregojnë për mirësitë morale të panjohura, që nuk mund të përshkruhen, të cilat do t'i gëzojnë banorët e Xhennetit?

Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, i kanë komentur mirësitë e Xhennetit sipas formës së parë, disa të tjerë i kanë komentuar sipas formës së dytë, por edhe komentimi sipas formës së parë është në harmoni të plotë, si të ishte binjak i ngjashëm me kuptimin e komentit sipas formës së dytë; sepse shtatë mirësitë që kanë ardhur në ajetet objekt studimi, të gjitha janë dhurata morale, kënaqësi shpirtërore, deri tek arritja e shikimit në Qenien hyjnore, marrja e pijes së pastër dhe zhytja në dashurinë për All'llahun, të gjitha janë kënaqësi që njeriu nuk i

arrin dot deri sa nuk i ka shijuar dhe nuk ka jetuar në hapësirat e gjera të kësaj dashurie.

Mirësitë materiale që do të jepen në Xhennet janë përmendur në Kur'ànin Famëlartë në mënyrë të hollësishme, në një kohë që dhuratat morale dhe kënaqësitë shpirtërore paraqiten në formë të fshehur. Natyrisht që kjo është për shkak se të parat mund të përshkruhen, kurse dhuratat morale nuk mund të përshkruhen.

Përsa i përket kuptimit të frazës **"furnizim i dalluar"**, prej shumë interpretuesve të Kur'ànit është thënë: a është kjo shprehje në kuptimin "kohë e njohur", apo është në kuptimin: "furnizim i qëndrueshëm e i vazhdueshëm", apo është në kuptimin e të gjitha veçorive të këtij furnizimi? Por, ashtu siç thamë pak më sipër, fjala *"ma'lùmun"* – *"i dalluar, i njohur"* është shprehje me kuptin të fshehur dhe përfshin të gjitha dhuratat e All'llahut, të cilat, natyrisht, nuk mund të përshkruhen me fjalët tona.

Në ajetin vijues, vjen shpjegimi i mirësive të tjera dhe në radhë të parë ajeti rreshton disa prej mirësive të Xhennetit, që do t'u jepen banorëve të Xhennetit me respektin më të madh, ashtu siç respektohen miqtë shumë të dashur: **"Fruta, ata janë të nderuar."**.

Por nuk do t'u serviren në atë formë që u vihet ushqimi para kafshëve; ushqimi atyre u serviret si të ishin miq shumë të nderuar.

Këtu do të lemë llojet e frutave që u serviren banorëve të Xhennetit me respektin më të madh dhe le të shikojnë vendet ku ata janë në Xhennet, vende për të cilat Kur'àni

Famëlartë njofton: ata janë në lulishte, në mes të gjelbërimit dhe të mbushura me mirësitë e Xhennetit: **"Në Xhennetet e mirësive të mëdha."**.

Çdo mirësi që ata dëshirojnë, ajo gjendet atje dhe çdo gjë që ata kërkojnë e gjejnë para tyre.

Ajeti vijues e vë theksin mbi mirësinë e katërt që do të gëzojnë banorët e Xhennetit dhe që është ngrohtësia njerëzore që ndjejnë banorët e Xhennetit, kur mblidhen në shoqërinë e miqve të tyre, në një mjedis të mbushur me pastërtinë e kulluar, duke qëndruar përballë njëri-tjetrit të mbështetur mbi poltrona dhe duke parë njëri-tjetrin: **"Të mbështetur mbi poltrona përballë njëri-tjetrit."**.

Ata kujtojnë në mes tyre çdo gjë: herë i sheh të bisedojnë për të kaluarën e tyre në botën e Tokës, herë tjetër ata bisedojnë për mirësitë e mëdha me të cilat ata i ka mbuluar Krijuesi i Lartësuar në Xhennet, herë tjetër ata shpalosin në mes tyre cilësitë e bukurisë e të madhështisë së All'llahut të Lartësuar; herë të tjera ata bisedojnë për pozitën e lartë të miqve të All'llahut (eulijatë) dhe për punët e tyre të jashtëzakonshme; herë tjetër ata rrahin në mes tyre probleme të cilat nuk arrijmë t'i kuptojmë ne që jemi të burgosur në këtë botë.

Fjala"*sururin*", tregon poltronat mbi të cilat ulen njerëzit kur mblidhen në raste gëzimesh, por kjo fjalë ka një kuptim shumë më të gjerë, madje kjo fjalë përdoret edhe në kuptimin e arkivolit ku është vënë i vdekurit dhe ka mundësi që emërtimi i arkivolit të të vdekurit me emrin poltronë, është bërë me shpresë që arkivoli të jetë për të vdekurin një mjet hipjeje i gëzueshëm, që

ecën së bashku me të vdekurin drejt mëshirës së All'llahut dhe lulishteve të përjetshme të Xhennetit.

Kategoria e pestë flet për mirësi të tjera prej mirësive të shumta që u janë dhënë banorëve të Xhennetit dhe në veçanti në ajetin vijues vihet theksi mbi pijen e pastër që u serviret atyre, me gota të mbushura me llojet e ndryshme të pijeve të pastra dhe sa herë ata dëshirojnë, mund të pinë prej kësaj pijeje, që të futen sa më thellë në botën e veprimtarisë dhe në botën shpirtërore: **"Atyre u serviren gota** (të mbushura me pije) **prej burimit."**.

Këto gota nuk gjenden në një vend të caktuar, ku ata shkojnë e i marrin atje; jo, ajeti njofton se pijet atyre u serviren: **"Atyre u serviren."**.

Gjuhëtarët thonë se fjala *"ke'sun"*, në gjuhën arabe tregon gotën e mbushut plot me pije, kurse për gotën e zbrazët përdoret fjala*"kadehun"*. Ràgibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Muferdàtu El Fàdhil Kur'àn", shpjegon se fjala *"ke'sun"* do të thotë: *"gota së bashku me pijen që ka Brenda"*.

Fjala tjetër *"meijn"*, do të thotë *"i rrjedhshëm"* dhe kjo tregon se atje ka burime të rrjedhshme me pije të pastër, ku ata (të ngarkuarit për shërbim), në çdo kohë mbushin gotat dhe pastaj gotat e mbushura ua servirin banorëve të Xhennetit. Pija e këtyre burimeve të pastra, as nuk mbaron e as nuk prishet, duke shtuar se marrja e asaj pijeje nuk paraqet asnjë lloj vështirësie dhe nuk shkakton asnjë lodhje.

Në ajetin vijues, biseda kalon në përshkrimin e gotave të pijes dhe ajeti njofton se janë gota me ngjyrë të bardhë e të

shndritshme dhe ai që pi në ato gota, ndjen kënaqësi: **"Të bardha dhe që u sjellin kënaqësi atyre që pinë** (në ato gota)**."**.

Në lidhje me fjalën *"bejdàe"* – *"të bardha"* disa interpretues të Kur'ànit kanë thënë: kjo fjalë është cilësor për gotat e pijes, kurse disa të tjerë prej tyre kanë thënë: Është cilësor për pijet e pastra, pa asnjë lloj ngjyrimi djallëzor dhe nuk janë si pijet me ngjyra të botës së Tokës, por, ashtu siç u tha, janë pije të pastra, pa ngjyra djallëzore dhe janë aq të bardha sa duken të tejdukshme.

Natyrisht që kuptimi më në harmoni i kësaj fraze është ashtu siç e shprehin fjalët e ajetit: **"që u sjellin kënaqësi atyre që pinë"**.

Ajeti që pamë, fliste për pijet e për gotat, por ky ajet mbase sjell në mendjet edhe kuptime të tjera në lidhje me cilësitë e pijeve, kurse ajeti vijues, me një frazë të shkurtër, i largon prej mendjes të këtilla kuptime dhe njofton: **"Nuk shkakton dhimbje koke dhe ata nuk dehen prej saj."**.

Domethenë se ajo pije, ose thuaj ajo verë, është pije e pastër, që nuk e prish mendjen dhe nuk shkakton as dehje e as shkujdesje, në të kundërt çon në ndërgjegjësim, nxit veprimtari dhe në atë pije të Xhennetit ka kënaqësi për shpirtin.

Fjala e ajetit *"gaulun"*, do të thotë prishja që depërton në një send pa u ndjerë.

Kurse fjala tjetër e ajetit *"junzefùne"*, do të thotë: *"humbja e sendit në mënyrë graduale"*. Në këtë kuptim, kur kjo fjalë përdoret në lidhje me puset e ujit, është në kuptimin e nxjerrjes së ujit prej pusit në mënyrë graduale, deri sa pusi shteron.

Në të gjitha gjendjet, qëllimi me këtë ajet është që të tregohet largimi i mendjes gradualisht, ose arritja e një gjendjeje dehjeje e shkaktuar prej pirjes së verës, kurse vera e pastër e Xhennetit nuk shkakton dehje në mënyrë absolute, nuk heq mendjen dhe nuk sjell asnjë dëm.

Të dyja këto shprehje Kur'anore, trokasin në të njëjtën kohë, me një mënyrë shumë të hollë, në cilësinë e pijes në botën e Tokës, e cila ndikon në jetën e njeriut në mënyrë graduale e të fshehtë dhe shkakton humbje të vetëdijes, në atë mënyrë që jo vetëm i çon mendjen e nervat e njeriut në një gjendje shkatërrimi, por nuk mund të mohohet se ndikimi negativ i pijes dehëse shtrihet në të gjithë trupin e njeriut, përfshirë zemrën, arteriet, stomakun, veshkat dhe mëlçinë e zezë, madje disa herë rrezikon edhe jetën e njeriut në formën e një vrasjeje pa u ndjerë; gjithashtu, efekti dëmtues i pijes dehëse në botën e Tokës është shumë i dukshëm në mendjen e në inteligjencën e njeriut dhe ngjason shumë me thithjen e ujit prej pusit në mënyrë graduale, deri sa pusi thahet krejtësisht.

Por pija e pastër hyjnore në Botën e Ardhshme, nuk i ka këto cilësi dëmtuese[1].

---

[1] Fjalët *"fijhà"* – *"në të"* dhe *"anhà"* – *"prej saj"* i referohen verës, e cila në këtë ajet nuk është përmendur në mënyrë të drejtpërdrejtë, por kjo bëhet e qartë nga rrjedha e fjalës. Siç dihet, fjala verë nënkuptohet në mënyrë alegorike në fjalën *"anhà"* – *"prej saj"* në të cilën ka ardhur në gjininë femërore, për të shpjeguar cilësinë e saj dehëse, por në këtë ajet do të thotë se vera e Xhennetit as nuk i deh banorët e Xhennetit e as nuk bëhet shkak që ata të humbin mendjen e ndjenjat. Këtu duhet theksuar se për verën ka dy kuptime të përbashkëta: fjala verë, herë thuhet për pijen që shkakton dehjen, ashtu siç ka ardhur në ajetin 90 të sures "El Màide": **"me të vërtetë vera, bixhozi…"**; herë tjetër fjala verë në Kur'àn është përdorur për të treguar pijen e pastër që do t'u jepet robve të sinqertë të All'llahut në Xhennetet e përjetshme, ashtu siç ka ardhur në ajetin

Kategoria e gjashtë e mirësive që përmenden në këto ajete për banorët e Xhennetit, janë bukuroshet e Xhenneteve, ashtu siç njofton ajeti i parafundit i këtij grupi ajetesh: **"Pranë tyre janë** (bukuroshet) **symëdhatë me shikim të përulur"**, domethënë All'llahu do të bëjë për ata gra, të cilat nuk duan asnjë tjetër përveç burrave të vet dhe që e hedhin shikimin vetëm mbi ata; këto gra kanë sy të mëdhenj e të bukur.

Fjala*"tarfun"*, në rrënjën e saj do të thotë: *"kapakët e syrit"*, por kjo fjalë këtu është metaforë që tregon shikimin, pasi njeriu, kur shikon në një send, kapakët e syve të tij lëvizin dhe në këtë kuptim fraza e ajetit **"me shikim të përulur"**, do të thotë: gra të cilat hedhin vetëm një shikim të shkurtër. Në lidhje me këtë çështje, kanë ardhur edhe interpretime të tjera, që mund të rreshtohen si vijon:

Interpretimi i parë: ato shikojnë vetëm në burrat e tyre dhe nuk i hedhin shikimet e tyre në asnjë tjetër.

Interpretimi i dytë: kjo shprehje është metaforë, që tregon se ato nuk dashurojnë asnjë tjetër, përveç burrave të vet, ato i kanë zemrat të mbushura me dashuri vetëm për ata dhe në zemrat e atyre grave nuk gjendet asnjë dashuri tjetër. Kjo është karakteristikë dalluese për gruan e cila dashuron burrin e saj dhe mendon vetëm për atë.

Interpretimi i tretë: ato kanë sy mahnitës dhe ky përshkrim është i ngjashëm me përshkrimin e poetëve, kur ata i thurin

---

15 të sures "Muhammed": **"...dhe lumenj prej vere të shijshme për ata që e pinë..."**.

vargjet e poezisë së tyre kur duan të shprehin bukurinë e syrit që e ka mahnitur atë.[1]

Natyrisht që vetëm interpretimi i parë dhe i dytë duket se janë më shumë në përshtatje me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit; megjithëkëtë, s'ka asnjë pengim që e ndalon bashkimin e këtyre kuptimeve.

Fjala *ijnun"*, do të thotë: *"grua symadhe"*.

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve objekt studimi, na jep një përshkrin tjetër për gratë e Xhennetit dhe shpjegon pastërtinë e shenjtërinë e tyre, me anë të shprehjes: **"Sikur ato janë vezë të ruajtura"**, domethënë: ato janë të pastra e origjinale, trupat e atyre grave janë qartësisht të bardhë si e bardha që vezullon prej pendës së shpendit në fole, atë bardhësi nuk e ka prekur asnjë dorë dhe mbi atë nuk ka rënë asnjë lloj pluhuri.

Fjala *"bejdun"*, është shumësi i fjalës *"bejdatun"* – *"vezë e bardhë"*.

Fjala *"meknùnun"*, në rrënjën e saj do të thotë: e mbuluar për t'u ruajtur për në të ardhmen.

Ky përngjasim kur'anor për njeriun, bëhet shumë i qartë kur ai shikon vezën në çastin kur ajo ndahet prej pulës, pa e prekur ende dora e njeriut për ta vënë atë nën pendët e pulës, sepse, vetëm në atë çast, bardhësia e vezës duket me tërë qartësinë që shpreh fjala e bardhë.

Të tjerë interpretues të Kur'ànit Famëlartë, mendojnë se fjala *"meknùnun"*, do të thotë: e bardha e vezës e fshehur nën

[1] Tefsiri "Nùruth Thekalejn", vëll. 33, f. 81.

lëvozhgën e jashtme të vezës. Në të vërtetë, ky përngjasim tregon vezën e zier, të zhveshur prej lëvozhgës së jashtme, në të cilën ngjyra e bardhë dallohet me të gjithë njomësinë e shkëlqimin e saj të butë.

Duhet theksuar se shprehjet e Kur'ànit Famëlartë që shpjegojnë të vërtetat, janë me shumë kuptime të thella, aq sa edhe vetëm një frazë e shkurtër shpjegon qartë, me një mënyrë shumë tërheqëse, të vërteta të shumta.

Hulumtim

Shikim i përgjithshëm mbi ato që kanë ardhur në ajetet e sipërme

Dhuratat që All'llahu i Lartësuar jep me mirësinë e Tij për banorët e Xhennetit dhe që u përmendën në ajetet objekt studimi, janë vetëm një grup dhuratash materiale e morale dhe prej shprehjes së ajetit: **"Të këtillë kanë një furnizim të dalluar"**, ne mësojmë se dhurata e parë që ka lidhje me dhuratat hyjnore morale e shpirtërore, është e atillë sa gjuha e ka të pamundur ta përshkruajë.

Përsa u përket gjashtë kategorive të tjera prej dhuratave të All'llahut, që ishin: frutat, pija e pastër, gratë e mira, repekti i plotë, banesa e bukur dhe miqtë e mirë në Xhennet, të gjitha këto mirësi shprehin përmasa të ndryshme të mirësive të Xhennetit, të

cilat zakonisht janë të përziera me dhënien e dhuratave materiale e morale.

Gjithçka që kemi thënë në lidhje me këto mirësi e dhurata hyjnore, është shprehur me fjalët tona, por dihet se, me fjalët që ne lakojmë, është e pamundur të pasqyrohen të gjitha anët e mirësive të Xhennetit. Natyrisht, që të arrijmë të kuptojmë, ne kemi nevojë për shqisat e dëgjimit e të shikimit; gjithashtu, kemi nevojë për fjalë, për shprehje dhe për fjali, ndryshe s'kemi mundësi të shpjegojmë këto punë.

Me një shprehje tjetër, e vërteta e mirësive të shumta që vërshojnë për banorët e Xhennetit, është e panjohur për banorët e Tokës, por do t'i marrin vesh se si janë ato mirësi vetëm atëherë kur të shkojnë atje dhe t'i shohin me sytë e tyre.

Në të gjitha gjendjet, shprehja **"robtë e sinqertë të All'llahut"**[1] tregon ata individë, të cilët, në saje të dijes dhe të besimit të tyre, kanë arritur fazën e plotësimit, prandaj janë të vlerësuar te All'llahu dhe janë të përfshirë në mëshirën e në dashamirësinë hyjnore të pakufizuar. Pavarësisht nga fjalët e bukura me të cilat ne do ta përshkruajmë pozitën e banorëve të Xhennetit, s'ka dyshim që pozita e tyre është shumë më e mirë dhe shumë më e lartë nga ajo që ne përshkruajmë me fjalët tona.

[1] Sure "Es Sàffàt", ajetet: 40, 74, 128, 160 dhe 169.

Ajetet: 50 – 61

فَأَقْبَلَ بَعْضُهُمْ عَلَىٰ بَعْضٍ يَتَسَآءَلُونَ ﴿٥٠﴾ قَالَ قَآئِلٌ مِّنْهُمْ إِنِّى كَانَ لِى
قَرِينٌ ﴿٥١﴾ يَقُولُ أَءِنَّكَ لَمِنَ ٱلْمُصَدِّقِينَ ﴿٥٢﴾ أَءِذَا مِتْنَا وَكُنَّا تُرَابًا
وَعِظَـٰمًا أَءِنَّا لَمَدِينُونَ ﴿٥٣﴾ قَالَ هَلْ أَنتُم مُّطَّلِعُونَ ﴿٥٤﴾ فَٱطَّلَعَ فَرَءَاهُ
فِى سَوَآءِ ٱلْجَحِيمِ ﴿٥٥﴾ قَالَ تَٱللَّهِ إِن كِدتَّ لَتُرْدِينِ ﴿٥٦﴾ وَلَوْلَا نِعْمَةُ رَبِّى
لَكُنتُ مِنَ ٱلْمُحْضَرِينَ ﴿٥٧﴾ أَفَمَا نَحْنُ بِمَيِّتِينَ ﴿٥٨﴾ إِلَّا مَوْتَتَنَا ٱلْأُولَىٰ
وَمَا نَحْنُ بِمُعَذَّبِينَ ﴿٥٩﴾ إِنَّ هَـٰذَا لَهُوَ ٱلْفَوْزُ ٱلْعَظِيمُ ﴿٦٠﴾ لِمِثْلِ هَـٰذَا
فَلْيَعْمَلِ ٱلْعَـٰمِلُونَ ﴿٦١﴾

“I afrohen njëri-tjetrit dhe bisedojnë.”

“Njëri prej tyre thotë: unë kisha një shok.”

“Ai thoshte: a je ti prej atyre që besojnë (në Ringjalljen)**.”**

“Mos vallë, pasi të vdesim dhe të jemi baltë e kocka të kalbura, do të dënohemi?” “Ai tha: a do të vini të kërkoni?.”

“Ai vështron dhe e sheh atë në mesin e Xhehennemit.”

"Ai thotë: betohem në All'llahun, ti për pak më hodhe në Xhehennem edhe mua." "Dhe sikur të mos ishte mirësia e Zotit tim, pa dyshim që edhe unë do të isha së bashku me ty (në zjarr)**."**

"Dhe a nuk do të vdesim."

"Përveç vdekjes sonë të parë dhe ne nuk do të dënohemi."

"Pa dyshim, ky është suksesi i madh."

"Për një të këtillë (sukses) **le të punojnë vepruesit."**

Komentimi

Studim mbi shokun e keq

Robtë e sinqertë të All'llahut, për të cilët flisnin ajetet e përparme, do të jenë të mbuluar me mirësi të shumta materiale e morale, si fruta, hyritë, gota që u serviren të mbushura në burim, poltronat mbi të cilat ata ulen përballë njëri-tjetrit, shokët e mirë me të cilët rrinë e bisedojnë; por gjatë këtyre kuvendeve të këndshme në Xhennet, papritur atyre u kujtohen shokët që kishin në botën e Tokës, të cilët u ndanë prej tyre gjatë rrugës; banorët e Xhennetit pyesin njëri-tjetrin: përse nuk po gjejnë asnjë gjurmë prej tyre në Xhennet? Ne duam të mësojmë si qe e ardhmja e tyre.

Për kohën kur ata bisedojnë në mes tyre dhe pyesin njëri-tjetrin, të preokupuar se si do të jetë e ardhmja e ish-shokëve të tyre, ajeti njofton: **"I afrohen njëri-tjetrit dhe bisedojnë."**.

Gjatë bisedës, papritur dikujt i shkon në mendje një punë dhe ai kthehet në drejtim të shokëve të vet e u thotë: unë kisha një shok në botën e Tokës: **"Njëri prej tyre thotë: unë kisha një shok."**.

Me keqardhje u them se ai u shmang nga rruga e drejtë dhe u bë prej atyre që e mohonin Ditën e Ringjalljes; ai vazhdimisht më thoshte mua: A e vërteton atë fjalë dhe a i beson asaj fjale (Ringjalljes)? Ashtu siç e lexojmë në ajetin vijues: **"Ai thoshte: a je ti prej atyre që besojnë** (në Ringjalljen)**?"**.

Ai thoshte: vallë, pasi ne të vdesim e të bëhemi baltë e kocka të kalbura, do të bëhemi me jetë edhe një herë tjetër, që të shkojmë për të dhënë llogari dhe për të marrë dënimin për punët që kemi bërë? Kjo është prej atyre punëve që nuk duhen besuar: **"Mos vallë, pasi të vdesim dhe të jemi baltë e kocka të kalbura, do të dënohemi?"**.[1]

Ai prej banorëve të Xhennetit vazhdon bisedën me shokët e tij dhe thotë: ah sikur të dija se ku është ai tani? Në ç'kushte jeton? Vendi i tij në mesin tonë është i zbrazët.

[1] Fjala*"medijnùne"*, në rrënjën e saj është në kuptimin: dënim, por këtu do të thotë: a me të vërtetë ne do të dënohemi?

Pastaj shton: O shokë, a kemi mundësi të mësojmë rreth tij dhe të marrim vesh në ç'gjendje është: **"Ai tha: a do të vini të kërkoni?"**.[1]

Gjatë kërkimit të shokut të tij, ai shikon në drejtim të Xhehennemit dhe krejt rastësisht e shikon shokun e tij në mesin e Xhehennemit: **"Ai vështron dhe e sheh atë në mesin e Xhehennemit."**.[2]

Ai vazhdon të bisedojë me atë dhe thotë: betohem në All'llahun, edhe për pak sa nuk më shkatërrove e më hodhe brenda në zjarr: **"Ai thotë: betohem në All'llahun, ti për pak më hodhe në Xhehennem edhe mua."**.[3]

Me pëshpëshet e tua gati sa nuk ndikove në pastërtinë e zemrës sime, me cytjet e tua më shtyje në rrugën e shmangur ku ishte ti; por ishte butësia, mëshira e mirësia e All'llahut ajo që më ndaloi mua të bija në rrugën e shmangur; ti u mundove shumë gjoja të më ndihmoje që edhe unë të hyja në rrugën e shmangur, për rrjedhojë patjetër sot edhe unë do të isha prej atyre që janë duke u ndëshkuar në zjarrin e Xhehennemit, ashtu siç po ndëshkohesh edhe ti: **"Dhe sikur të mos ishte mirësia e Zotit tim, pa dyshim që edhe unë do të isha së bashku me ty** (në zjarr)**."**.

Por mbarësia hyjnore qe shoqëruesja ime në rrugën time dhe mëshira e butësia e udhëzimi i Tij qenë orientuese për mua.

---

[1] Fjala *"mut'taliùne"*, në rrënjën e saj do të thotë: kontrollim, studim dhe mbikqyrje mbi një send prej një vendi të lartë, ose do të thotë: marrje të dhënash.

[2] Fjala*"sevài"*, do të thotë: në mesin e një vendi.

[3] Fjala *"turdijni"*, në rrënjën e saj është në kuptimin: rrëzim prej një vendi të lartë dhe vdekja e të rrëzuarit.

Në këto çaste, ai hedh edhe një shikim tjetër mbi ish-shokun e tij në Xhehennem dhe duke e qortuar atë i thotë atij: A nuk ishe ti ai që më thoshe mua në botën e Tokës, se ne nuk do të vdesim: **"Dhe a nuk do të vdesim"**, ti më thoshe: nuk do të kemi vdekje tjetër, ka vetëm një vdekje dhe pas vdekjes s'ka më as jetë tjetër e as ndëshkim: **"Përveç vdekjes sonë të parë dhe ne nuk do të dënohemi."**.

Tani shiko dhe mësoje gabimin e madh që bëre! Pas vdekjes erdhi kjo jetë dhe ky shpërblim për mua e ky ndëshkim për ty; tani të gjitha të vërtetat u bënë shumë të qarta, por ç'dobi vjen prej kësaj, këtu s'ka më rrugë për kthim në botën e Tokës.

Në përputhje me interpretimin e dy ajeteve të fundit, biseda e besimtarit në Xhennet me ish-shokun e tij në Xhehennem, u përqendrua në mohimin që ai i bënte Ringjalljes gjatë kohës kur të dy ishin në botën e Tokës.

Disa interpretues të tjerë të Kur'ànit Famëlartë, janë shprehur për mundësinë e një interpretimi tjetër të dy ajeteve të lartpërmendura dhe kanë thënë: pas bisedës së banorit të Xhennetit me ish-shokun e tij në Xhehennem, ai i Xhennetit u kthehet shokëve të vet të Xhennetit, me të cilët po kënaqeshin në shoqëri të njëri-tjetrit dhe nga gëzimi i madh që ndjen thotë: a është e vërtetë që ne nuk do të kemi edhe një vdekje tjetër dhe se ne do të jetojmë këtu përgjithmonë? A është e vërtetë se pas vdekjes së parë nuk ka më vdekje të dytë, se këto mirësi të mëdha do të mbesin me ne dhe se ne nuk do të dënohemi?

Natyrisht që këto fjalë nuk burojnë prej dyshimit e ngurrimit; jo, në të vërtetë, ato fjalë janë rezultat i gëzimit. Ky

banor i Xhennetit përngjan me një njeri i cili, pas një pritjeje shumë të gjatë, arrin të ketë një shtëpi të madhe e luksoze dhe i çuditur thotë: a e gjitha kjo është e imja? O Zoti im! Ç'është kjo mirësi kaq e madhe? A do të më mbetet kjo mua?

Këtu biseda mbyllet, me një fjali me kuptime të thella e shumë mbresëlënëse; veç kësaj, kjo fjali ka ardhur me shumë elemente gjuhësorë që e përforcojnë kuptimin e saj: **"Pa dyshim, ky është suksesi i madh."**.

A mund të ketë gëzim më të madh se sa kur njeriu e sheh veten të mbuluar me mirësinë e madhe të përjetësisë, Jetës së Përhershme dhe të përfshirë në mëshirën hyjnore; a mund të përfytyrojë njeriu gëzim më të madh e më të mirë se ky?

Në mbyllje të studimit, i Larti, me një fjali të shkurtër, zgjon zemrat dhe i lëkund thellësitë e zemrave me fjalën e Tij: **"Për një të këtillë** (sukses) **le të punojnë vepruesit"**, domethënë: për këtë le të punojnë njerëzit, madje le të nxitojnë për të arritur këto mirësi të mëdha.

Në lidhje me ajetin e fundit, disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë kanë thënë: ky ajet është fjala e banorëve të Xhennetit, por kjo mundësi interpretimi është shumë larg, sepse për njeriun në atë ditë nuk ka më detyrime; me fjalë të tjera, atë ditë nuk ka asnjë detyrim që njerëzit duhet ta plotësojnë, apo që me këto fjalë të nxiten të tjerët që të punojnë; veç kësaj, kuptimi i jashtëm i fjalëve të ajetit, shpjegon qartë se ky ajet është rezultati i ajeteve të sipërme, njëkohësisht, ky ajet i nxit njerëzit të besojnë dhe të punojnë e të veprojnë sipas udhëzimit në rrugën e drejtë, prandaj ishte plotësisht e përshtatshme që Krijuesi i Lartësuar të sillte këtë bisedë në fundin e këtij studimi.

Hulumtime

1- Komunikimi në mes banorëve të Xhennetit dhe banorëve të Xhehennemit

Prej ajeteve të sipërme, del qartë ekzistenca e një lloji komunikimi në mes banorëve të Xhennetit dhe banorëve të Xhehennemit. Banorët e Xhennetit janë në një shkallë të lartë dhe i shikojnë banorët e Xhehennemit që janë poshtë tyre dhe kjo e vërtetë mësohet prej fjalës *"fet'talea"*, që do të thotë: mbikqyrje e kontroll nga lart poshtë.

Natyrisht që kjo nuk është argument që vërteton se largësia ndarëse në mes Xhennetit e Xhehennemit, është e vogël. Mbase atyre u jepet një fuqi shikimi e jashtëzakonshme dhe kështu nuk ka më vend të flitet për problemin, gjatësinë e largësisë në mes Xhennetit e Xhehennemit.

Në shpjegimet e disa interpretuesve të Kur'ànit Famëlartë, thuhet se në Xhennet ka një vend të hapur dhe prej aty banorët e Xhennetit shohin banorët e Xhehennemit.

Ajeti 44 i sures "El A'ràf" e shpjegon shumë qartë komunikimin në mes banorëve të Xhennetit dhe banorëve të zjarrit: **"Banorët e Xhennetit u bëjnë zë banorëve të Xhehennemit: ne e gjetëm të vërtetë atë çka na kishte premtuar Zoti ynë, po ju a e gjetët të vërtetë atë me çka u kishte kërcënuar Zoti juaj? Ata** (banorët e Xhehennemit) **thonë: 'Po'; atëherë në mes tyre dëgjohet një zë: mallkimi i All'llahut qoftë mbi**

mohuesit", domethënë se në mes banorëve të Xhennetit dhe banorëve të Xhehennemit ka një "perde ndarëse".

Fjalën *"nàdà"* – *"thirri"* në kushte normale thirrësi e përdor kur thërret dikë që është në largësi të madhe prej tij. Kjo fjalë, në këtë ajet e shpjegon qartë vendin dhe pozitën e të dy grupeve.

Shpesh kemi përsëritur se gjendjet e Ditës së Kiametit ndryshojnë shumë prej gjendjeve të botës tonë të tanishme, prandaj ne e kemi krejtësisht të pamundur që, me parametrat e botës sonë, këtu në Tokë, të vlerësojmë si do të jenë gjendjet në Botën e Ardhshme.

2- Për cilët njerëz kanë zbritur këto ajete?

Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, janë shprehur se shkaku i zbritjes së këtij grupi ajetesh është ai që përmendet në ajetet 32 dhe 43 të sures "El Kehf": **"Sillu atyre si shembull dy burra, njërit prej atyre të dyve Ne i dhamë dy kopshte me rrush, ato** (kopshtet) **Ne i rrethuan me hurma dhe në mes tyre Ne bëmë edhe bimë të tjera" "…dhe përveç All'llahut ai nuk pati asnjë që ta ndihmonte."**.

Në këto dy ajete tregohet se njëri prej këtyre dy burrave ishte mendjemadh dhe ngrefosej shumë, veç kësaj, ai e mohonte Ringjalljen, kurse burri tjetër besonte në Ditën e Gjykimit. Më pas, në këto ajete tregohet se ndëshkimi i All'llahut zbriti mbi burrin mendjemadh e mohues qysh në këtë botë dhe ai jo vetëm që e

humbi pasurinë e tij, por e pa veten të rrethuar nga të gjitha anët prej pësimesh të rënda.[1]

Por vazhdimi i ajeteve objekt i studimit tonë, ndryshon nga ngjarja për të cilën flasin ajetet e sures "El Kehf". Në ajetet e sures "El Kehf", shpjegohet ekzistenca e një ndarësi në mes banorëve të Xhennetit dhe banorëve të Xhehennemit.

Të tjerë interpretues të Kur'ànit kanë thënë: këto ajete kanë të bëjnë me dy ortakë, ose me dy shokë, të cilët kishin në pronësi një pasuri të madhe; njëri prej atyre ishte dorëhapur kur shpenzonte në rrugën e All'llahut, kurse tjetri nuk besonte në asgjë dhe ishte koprac; por, pas një farë kohe, njeriu që shpenzonte e humbi pasurinë, çka bëri që të ishte objekt talljeje i shokut të tij, i cili, për ta vënë në lojë, i tha: **"A je ti prej atyre që besojnë** (në Ringjalljen)**?"**.[2]

Nëse shkaku i zbritjes së ajeteve objekt studimi ka të bëjë me atë ndodhinë që mëtojnë ky grup interpretuesish të Kur'ànit, atëherë ne, fjalën "*musad'dikijne*" duhet ta lexojmë "*musad'dekijne*", që do të thotë: "*jep sadeka dhe shpenzon*".

Në mesin e lexuesve të Kur'ànit (kurr'rràtë), mbizotëron mendimi se kjo fjalë duhet lexuar "*musad'dikijne*" dhe nga kjo rezulton se, shkaku i zbritjes që u tha këtu më sipër, nuk është në përshtatje me mënyrën e leximit të Kur'ànit që ka më shumë përhapje.

[1] Tefsiri "Rùhul Meànij", vëll. 23, f. 83.
[2] Tefsiri "El Kebijr", vëll. 26, f. 139.

3- Arritja e këtyre mirësive kërkon prej nesh vendosmëri

A është e drejtë që njeriu të shpenzojë kapitalin më të madh, jetën e tij, si dhe mundësitë e tjera e dhuratat e All'llahut, në vende të panevojshme, si të ishin flluska që vazhdojnë vetëm fare pak çaste mbi sipërfaqen e ujit? Mall i lirë dhe jo i përhershëm, mall i mbushur me sëmundje e probleme!

Apo njeriu duhet t'i shfrytëzojë këto forca të mëdha në fusha që çojnë drejt Jetës së Përhershme dhe në mirësitë e qëndrueshme, në vende ku fitohet kënaqësia e All'llahut të Lartësuar?

Nuk mund të ketë formulim më të mirë se sa fjalët e këtyre ajeteve kur'anore, të cilët i ftojnë besimtarët që të synojnë këtë objektiv, domethënë të synojnë arritjen e Xhenneteve të mbushura me kënaqësi e shijime shpirtërore e trupore, përfshirë pije të pastra, të cilat e zhysin njeriun në kënaqësitë e bukurisë hyjnore, shoqërimi me shokë të mirë, me zemra plotësisht të pastra. Dihet se ndenjja në kuvend me shokë të këtillë, largon të gjitha llojet e brengave, megjithëse në këto Xhennete s'ka as brenga e as probleme.

Po, ai që i vë vetes qëllim që të fitojë Xhennetet, patjetër ka detyrë të punojë shumë.

Ajetet: 62 – 70

أَذَٰلِكَ خَيۡرٞ نُّزُلًا أَمۡ شَجَرَةُ ٱلزَّقُّومِ ﴿٦٢﴾ إِنَّا جَعَلۡنَٰهَا فِتۡنَةٗ لِّلظَّٰلِمِينَ ﴿٦٣﴾
إِنَّهَا شَجَرَةٞ تَخۡرُجُ فِيٓ أَصۡلِ ٱلۡجَحِيمِ ﴿٦٤﴾ طَلۡعُهَا كَأَنَّهُۥ رُءُوسُ ٱلشَّيَٰطِينِ
﴿٦٥﴾ فَإِنَّهُمۡ لَأٓكِلُونَ مِنۡهَا فَمَالِـُٔونَ مِنۡهَا ٱلۡبُطُونَ ﴿٦٦﴾ ثُمَّ إِنَّ لَهُمۡ عَلَيۡهَا
لَشَوۡبٗا مِّنۡ حَمِيمٖ ﴿٦٧﴾ ثُمَّ إِنَّ مَرۡجِعَهُمۡ لَإِلَى ٱلۡجَحِيمِ ﴿٦٨﴾ إِنَّهُمۡ أَلۡفَوۡاْ
ءَابَآءَهُمۡ ضَآلِّينَ ﴿٦٩﴾ فَهُمۡ عَلَىٰٓ ءَاثَٰرِهِمۡ يُهۡرَعُونَ ﴿٧٠﴾

“A kjo pritje është më e mirë, apo është pema zek’kùm?”

“Atë (pemën zek’kùm) **Ne e kemi bërë provë për mohuesit.”**

“Ajo është një pemë që del prej tabanit të Xhehennemit.”

“Frutat e saj ngjajnë si koka djajsh.”

“Ata pa dyshim do të hanë prej saj (frutave të saj) **dhe me ato do të mbushin barqet.” “Pastaj, përveç kësaj, ata do të kenë** (do të pinë) **ujë të valuar.”**

“Pastaj, rrugëtimi i tyre patjetër është drejt Xhehennemit.”

"Në të vërtetë, ata ndoqën prindërit e tyre, që ishin në rrugën e humbjes."

"Dhe mbi gjurmët e tyre, ata nguten të ecin."

Komentimi

Lloje prej ndëshkimit të dhimbshëm për banorët e Xhehennemit

Pasi u shpjeguan mirësitë e shumta e të përjetshme, me të cilat All'llahu i Lartësuar do të dhurojë për banorët e Xhennetit, ajetet objekt studimi shpalosin ndëshkimin e dhimbshëm që All'llahu i Lartësuar ka përgatitur për banorët e Xhehennemit dhe këto ndëshkime, ajetet objekt studimi i vënë përballë mirësive të mëdha e të shumta të përgatitura për banorët e Xhennetit. Natyrisht që shpalosja e llojeve të ndëshkimeve të mëdha e të dhimbshme, ndikojnë në shpirtrat e i frenojnë njerëzit, që të mos bëjnë punë të këqija dhe punë të ndaluara, punë harram.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, njofton: **"A kjo pritje është më e mirë, apo është pema zek'kùm?"**.

Fjala *"nuzulen"*, do të thotë: sendi i përgatitur për t'ia servirur mikut që të vjen në shtëpi; të tjerë kanë thënë se kjo fjalë është në kuptimin: sendi i parë që i serviret mikut sapo ai vjen, thënë ndryshe, kjo fjalë tregon mirësitë e përgatitura për ardhjen e miqve të shtrenjtë e të respektuar në Xhennet.

Për këtë, Kur'àni Famëlartë thotë: a kjo është më e mirë, apo më e mirë është pema zek'kùm? Fjala tjetër e këtij ajeti *"khajrun"* – *"më i mirë"* nuk është argument që vërteton se pema zek'kùm është një send i mirë. Patjetër që mirësitë e mëdha e të shumta që ka përgatitur All'llahu i Lartësuar për banorët e Xhennetit, janë nga më të mirat. Në të folurën e arabëve, disa herë përdoren fjalë të këtilla për të treguar sende prej të cilave nuk mund të ketë asnjë dobi, madje ka mundësi që këto fjalë të jenë një lloj metonimie. Një shembull i ngjashëm është rasti kur një njeri me shumë faje të rënda është diskreditуar para njerëzve dhe ata i thonë: A ky diskreditim është më i mirë, apo më të mirë janë krenaria, respekti e nderi?

Në lidhje me fjalën *"zek'kùm"*, gjuhëtarët shpjegojnë: Është një bimë me shije të hidhur dhe me erë të keqe.

Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, kanë thënë se fjala *"zek'kùm"* është emri i një bime me gjethe të vogla, me shije të hidhur e me erë të keqe; kjo bimë gjendet në toka të thata dhe idhujtarët e asaj kohe e njihnin këtë bimë;[1] kurse autori i tefsirit "Rùhul Meànij" ka shtuar: Bima "zek'kùm" është bimë qumështore dhe kur qumështi i saj prek trupin e njeriut, shkakton plagë.[2],[3]

Ràgibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu el Fadhil Kur'àn", shpjegon: "zek'kùm" do të thotë çdo ushqim që u shkakton neveri banorëve të Xhehennemit.

---

[1] Tefsiri "Rùhul Bejàn", vëll. 7, f. 464.
[2] Tefsiri "Rùhul Meànij", vëll. 23, f. 85.
[3] Tefsiri "Muxhmeul Bahrejn", lënda **"زقم"** *"zekame"*.

Kurse autori i fjalorit "Lisànul Areb", thotë: kjo fjalë, si bazë vjen në kuptimin e gëlltitjes së një sendi dhe pastaj shton: kur zbriti ky ajet, Ebù Xhehli tha: një pemë e këtillë nuk gjendet në Tokën tonë dhe i pyeti të pranishmit: cili prej jush e di kuptimin e fjalës *"zek'kùm"*?

Atij iu përgjigj një afrikan dhe i tha: Fjala *"zek'kùm"*, në gjuhën e banorëve të Afrikës do të thotë gjalpë e hurma. Sapo Ebù Xhehli e dëgjoi përgjigjen e afrikanit, thirri njërën prej robëreshave të tij dhe me tallje, i tha asaj: na e hidhëro gojën me hurma e me gjalpë dhe ndërsa hanin hurmat, filluan të tallen e të thonë: Muhammedi me këto po na frikëson në Botën Tjetër; atëherë zbritën ajetet kur'anore që i dhanë përgjigje të formës së prerë Ebù Xhehlit dhe idhujtarëve të tjerë, por në këto ajete do të trokasim në vijim.

Përsa i përket fjalës tjetër të ajetit *"shexheretu"*, duhet të sqarojmë se kjo fjalë nuk vjen gjithmonë në kuptimin e saj të njohur (pemë); kjo fjalë disa herë vjen edhe në kuptimin (bimë), në numrin shumës. Ajetet krahasuese tregojnë se këtu kuptimi me fjalën (pemë) është në kuptimin e bimëve.

Në vijim, Kur'àni Famëlartë shpalos disa veçanti të kësaj bime dhe thotë: **"Atë** (pemën zek'kùm) **Ne e kemi bërë provë për mohuesit."**.

Fjala *"fitneten"*, do të thotë: sprovë dhe ndëshkim, gjithashtu do të thotë edhe provim, por në shumicën e ajeteve të Kur'ànit Famëlartë ku përmendet kjo fjalë, ajo nuk ka ardhur në këtë kuptim dhe kjo tregon se idhujtarët, kur e dëgjuan fjalën *"zek'kùm"*, filluan të tallen e të ironizojnë se qysh do të ishte kjo pemë provim për ata tiranë mizorë!

Për këtë, Kur'àni Famëlartë shton: **"Ajo është një pemë që del prej tabanit të Xhehennemit."**.

Por mohuesit mendjemëdhenj vazhduan të tallen dhe thanë: si është e mundur që një bimë ose një pemë të mbijë në gropën më të thellë të Xhehennemit? Ku është zjarri dhe ku janë pema e bimët! Në vazhdën e kuptimit të kësaj fjale, vetë emri i kësaj peme dhe cilësitë e saj, janë një provim për ata në këtë botë dhe do të jetë shkak për ndëshkimin e për sprovimin e tyre në Botën Tjetër.

Ata ishin aq të shkujdesur, sa nuk e kuptonin që ligjet rregulluese të punëve në Botën Tjetër, janë krejtësisht ndryshe prej ligjeve rregulluese në botën e Tokës. Pemët e bimët që mbijnë në tabanin e Xhehennemit dhe që rriten në ato kushte, patjetër që edhe ngjyrën do ta kenë si zjarri dhe jo si ngjyra e pemëve dhe e bimëve që rriten në kopshtet e në lulishtet e kësaj bote. Ka mundësi që ata të mos kishin asnjë dijeni në lidhje me këtë çështje; megjithëkëtë, qëllimi i tyre kur lakonin këtë fjalë, ishte tallja e vënia në lojë.

Në vijim, Kur'àni Famëlartë shton: **"Frutat e saj ngjajnë si koka djajsh."**.

Fjala *"tal'un"*, thuhet për fillimin e lidhjes së frutit të hurmës dhe është marrë prej fjalës *"tulù'un"*, që do të thotë dalje prej diçkaje dhe në këtë kuptim thuhet për daljen e frutit të hurmës në fillim të lidhjes së frutit.

Pyetje: A i kanë parë njerëzit kokat e djajve, me të cilat Kur'àni Famëlartë përngjason frutat e pemës zek'kùm?

Përgjigje: Kësaj pyetjeje, interpretuesit e Kur'ànit Famëlartë i kanë dhënë disa përgjigje:

Disa kanë thënë: njëri prej kuptimeve të fjalës *"shejtàn"* – *"djall"* është: gjarpër me pamje të neveritshme dhe me këtë fjalë janë përngjasuar frutat e pemës zek'kùm.

Disa të tjerë, kanë thënë: është një lloj bime me formë të keqe, ashtu siç thuhet në librin "Muntehel Irbi" dhe se "koka e djallit", ose "kokat e djajve", është bimë.

Por mendimi më i saktë thotë se përngjasimi këtu është përdorur për të shpjeguar sa i keq është fruti i zek'kùmit dhe është i atillë që ngjall neveri, sepse njeriu, në të vërtetë, kur ndjen neveri prej ndonjë sendi, në trurin e tij ai send merr formën më të keqe e më frikësuese, ashtu siç merr në trurin e tij formën më të mirë e më të bukur një send i dashur për njeriun.

Ky është edhe shkaku që njerëzit i përfytyrojnë engjëjt në formë të bukur, kurse djajtë e xhindët e ndërkryer i përfytyrojnë në formën më të keqe, në një kohë që asnjë njeri nuk i ka parë, as engjëjt e as djajtë. Përdorimin e këtij përfytyrimi e shikojmë dendur edhe në të folurën ndërmjet njerëzve, për shembull, kur thuhet: filani është xhind i ndërkryer (në tekstin arabisht fjala xhind i ndërkryer ka ardhur me fjalën "ifrijt"), ose kur thuhet: filani i ngjan djallit.

Të gjitha këto përngjasime, janë të ndërtuara mbi bazën e pasqyrimeve logjike të kuptimeve të ndryshme, por që, në të vërtetë, janë përngjasime të gjalla dhe shumë domethënëse.

Kur'àni Famëlartë vazhdon të shpalosë llojet e ndëshkimit hyjnor që i pret mohuesit e idhujtarët dhe për këtë njofton: **"Ata**

pa dyshim do të hanë prej saj (frutave të saj) **dhe me ato do të mbushin barqet.”**.[1]

Ky është ndëshkimi dhe kjo është sprova që u theksua në ajetet e para të këtij grupi ajetesh, pasi ngrënia e bimës “zek’kùm”, që mbin në tabanin e Xhehennemit, ka erë të keqe dhe është shumë e hidhur kur hahet, apo ai qumështi i saj, që shkakton plagë e i djeg trupat e njerëzve sapo të bjerë mbi ta, pa harruar se banorët e Xhehennemit do të hanë sasi të mëdha prej frutave të kësaj peme, apo të asaj bime, por ngrënia e frutave të asaj peme, ose ngrënia e atyre bimëve, në të vërtetë është një ndëshkim shumë i dhimbshëm.

Është normale për njeriun që ha këtë ushqim të keq e shumë të hidhur, që do të ketë etje të madhe, por çfarë do të pijë ai që të shuajë këtë etje të madhe? Edhe kësaj pyetjeje, Kur’àni Famëlartë i përgjigjet: **“Pastaj, përveç kësaj, ata do të kenë** (do të pinë) **ujë të valuar.”**.

Fjala *“sheub”*, do të thotë: sendi i përzier me një send tjetër, kurse fjala tjetër e këtij ajeti *“hemijm”*, do të thotë: ujë i mbinxehur. Bazuar mbi këtë shpjegim, mësojmë se edhe uji i mbinxehur, që do të pinë mohuesit në Xhehennem, nuk do të jetë ujë i pastër; jo, do të jetë ujë i ndotur.

Ky është ushqimi i banorëve të Xhehennemit dhe ky është uji që ata do të pinë; por, pas kësaj “mikpritjeje”, ku do të shkojnë ata? Edhe kësaj pyetjeje, Kur’àni Famëlartë i përgjigjet me fjalët

[1] Përemri *“hà”* – *“asaj”* i bashkuar me parafjalën *“min”* - *“prej”* në fjalën *“minhà”* – *“prej asaj”* i referohet “pemës” dhe që në vetvete është përngjasim, sepse, qëllimi me fjalën “pemë”, këtu është bima dhe jo pema, sepse bima hahet, kurse pema, domethënë druri i pemës, nuk hahet.

vijuese: **"Pastaj rrugëtimi i tyre patjetër është drejt Xhehennemit."**.

Disa interpretues të Kur'ànit, e kanë komentuar këtë frazë: uji i mbinxehur e i ndotur buron prej një burimi jashtë Xhehennemit dhe banorët e Xhehennemit do të përçohen, ashtu siç përçohen bagëtitë, në vendet e caktuara për të pirë ujë dhe pasi pinë prej atij uji, ata kthehen në Xhehennem, aty ku ishin.

Të tjerë interpretues të Kur'ànit Famëlartë, kanë thënë: kjo frazë tregon ekzistencën e vendqëndrimeve të ndryshme në Xhehennem; në ato vende çohen idhujtarët e mohuesit për të pirë ujë të mbinxehur dhe pasi pinë ujë, i kthejnë në Xhehennem, në vendin e përparshëm, ku ishin.

Duhet theksuar se interpretimi i parë është më në përshtatje me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit.

Siç kemi thënë më sipër, është e pamundur të përfytyrohen mirësitë e shumta që All'llahu i Lartësuar do të derdhë mbi banorët e Xhennetit; gjithashtu, është e pamundur të përfytyrohet se sa i ashpër e i dhimbshëm do të jetë edhe ndëshkimi që i pret banorët e Xhehennemit, pasi, prej këtyre frazave të shkurtëra kur'anore, ne kemi mundësi të marrim vetëm një pamje sipërfaqësore dhe asgjë më shumë, prej asaj që formohet para syve tanë (O All'llah, me butësinë Tënde kërkojmë prej Teje mbrojtje dhe na ruaj prej ndëshkimit!).

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve objekt studimi, trajton shkakun kryesor që i çoi ata në Xhehennem dhe bëri që ata të kenë atë ndëshkim të ashpër e shumë të dhimbshëm dhe kjo trajtohet vetëm në dy ajete të shkurtëra, por të mbushura me

shumë kuptime e me të vërteta: **"Në të vërtetë, ata ndoqën prindërit e tyre, që ishin në rrugën e humbjes."**.

Ata nxitonin shumë që të ecnin në gjurmët e të parëve të tyre, pa vullnetin e tyre: **"Dhe mbi gjurmët e tyre, ata nguten të ecin."**.

Këtu bie në sy se fjala *"juhreùne"* – *"nguten të ecin"* ka ardhur në numrin shumës, por nuk tregon sa shumë janë ata. Kjo frazë tregon se ata ndiqnin traditën e të parëve të tyre me zemër e me fe; gjithashtu, ata këmbëngulnin shumë që të ecnin në gjurmët e tyre, aq shumë, sa dukej sikur dikush nga jashtë i shtynte të nguteshin për të ndjekur pikë për pikë të parët e tyre, pa vullnetin e tyre vetiak dhe pa asnjë lloj zgjedhjeje vetiake. Ky veprim i tyre, tregon sa fanatikë ishin ata në ndjekjen e miteve në të cilat besonin gjyshërit e tyre, që kishin rënë në rrugën e humbjes.

Ajetet: 71 – 74

وَلَقَدۡ ضَلَّ قَبۡلَهُمۡ أَكۡثَرُ ٱلۡأَوَّلِينَ ﴿٧١﴾ وَلَقَدۡ أَرۡسَلۡنَا فِيهِم مُّنذِرِينَ ﴿٧٢﴾
فَٱنظُرۡ كَيۡفَ كَانَ عَٰقِبَةُ ٱلۡمُنذَرِينَ ﴿٧٣﴾ إِلَّا عِبَادَ ٱللَّهِ ٱلۡمُخۡلَصِينَ
﴿٧٤﴾

"Po, para atyre (populllit tënd, o Muhammed) **shumica e të përparshmëve ishin në rrugën e humbjes."**
"Te ata Ne dërguam paralajmërues (Profetë)**."**
"Shikoje si qe përfundimi i të paralajmëruarve."
"Me përjashtim të robve të sinqertë të All'llahut."

Komentimi

Popujt e kaluar që ishin në rrugën e humbjes

Është e qartë se çështjet e humbjes së udhëzimit në rrugën e drejtë, që u trajtuan më sipër, në lidhje me mohuesit e me idhujtarët, nuk janë të veçanta, për një kohë apo për një vend të caktuar. Në ajetet e këtij grupi ajetesh që kemi në studim, këto çështje marrin një kuptim shumë të gjerë dhe shpjegohen me hollësi. Gjithashtu, me anë të këtyre ajeteve të shkurtëra, përgatitet terreni për të shpjeguar punë shumë të mëdha të popujve të përparshëm. Veç kësaj, njohja me punët e popujve të

përparshëm është trajtuar edhe në ajetet e përparme dhe ndër popujt e kaluar që e humbën udhëzimin për në rrugën e drejtë, përmendim popullin e Nùhut, popullin e Ibràhimit, popullin e Musait e të Hàrùnit, popullin e Lùtit, popullin e Jùnusit dhe popuj të tjerë, për cilët ajeti njofton: **"Po, para atyre** (popullit tënd, o Muhammed) **shumica e të përparshmëve ishin në rrugën e humbjes."**.

Nuk ishin vetëm idhujtarët e Mekës, që u sprovuan me humbjen e udhëzimit në rrugën e drejtë, për shkak se ndoqën rrugën e gjyshërve të tyre të përparshëm; jo, me humbjen e udhëzimit në rrugën e drejtë janë sprovuar edhe shumë prej popujve të përparshëm.

Përmendja e këtyre të vërtetave që sillnin këto jetë, ishte qetësim për të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe për atë grup të vogël besimtarësh që gjendeshin në Mekë së bashku me Profetin, të rrethuar prej armiqve nga të gjitha anët.

Në vijim, Kur'àni Famëlartë shton se humbja e udhëzimit në rrugën e drejtë, atyre nuk u erdhi për shkak se atyre u kishin munguar udhëheqësit e kështillat e tyre: **"Te ata Ne dërguam paralajmërues** (Profetë)**."**.

Te ata, Ne dërguam Profetë, që t'i paralajmëronin për rreziqet që vinin për shkak të idhujtarisë, mohimit, padrejtësisë, mizorisë, sulmit mbi të tjerë dhe për shkak të ndjekjes verbërisht të traditës që kanë lënë të tjerët; në të njëjtën kohë, Profetët ua bënë atyre të njohura përgjegjësitë që kishin.

Është e vërtetë se Profetët *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)* me kumtin e tyre, nga njëra anë paralajmëronin e frikësonin me dënime të ashpra dhe nga ana tjetër përgëzonin për shpërblime të mëdha. Është fakt se paralajmërimi e frikësimi zënë vendin më të madh në këshillat e tyre, të Profetëve, për popujt, sidomos për popujt kundërshtues, që e kishin humbur udhëzimin për në rrugën e drejtë. Për këtë shkak, në këtë ajet theksohet fakti se atyre u ishin dërguar Profetë.

Në vijim, me një frazë të shkurtër, por të mbushur me kuptime të thella, Kur'àni thotë: **"Shikoje si qe përfundimi i të paralajmëruarve."**.

Bashkëbiseduesi në foljen urdhërore: "shiko", mund të jetë i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ose mund të jetë çdo njeri me mendje në kokë dhe që mendon. Në të vërtetë, ky ajet i nderuar njofton fundin e atyre popujve, gjendjen e të cilëve ne do ta trajtojmë në mënyrë të hollësishme gjatë studimit mbi ajetet e tjera të kësaj sureje.

Ndërkaq, ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh, përjashton një grup njerëzish prej ndëshkimit të All'llahut dhe për këtë njofton: **"Me përjashtim të robve të sinqertë të All'llahut."**.

Këtu duhet theksuar se, ky ajet i nderuar, tregon përfundimin që patën popujt e përparshëm, tregon se All'llahu i Lartësuar i sprovoi ata me ndëshkimin e dhimbshëm, ndëshkim që i shkatërroi ata të gjithë, me përjashtim të besimtarëve që janë robtë e sinqertë të All'llahut; ajeti i nderuar shpjegon se vetëm ata që besojnë me sinqeritet në All'llahun e Lartësuar, do të shpëtojnë prej ndëshkimit.

Gjithashtu, duhet theksuar se fjala *"mukhlesijn"* në ajetet e kësaj sureje është përsëritur pesë herë dhe kjo shpjegon qartë pozitën e lartë që gëzojnë robtë e sinqertë të All'llahut. Më sipër, kemi thënë se robtë e sinqertë të All'llahut, janë ata zemërkulluar të armatosur me dituri e me besim dhe që kanë fituar mbi unin e tyre, natyrisht pasi e luftuan atë me ngulm. Njerëz të këtillë, All'llahu i Lartësuar i ka pastruar për veten e Tij. Ai ka zhdukur tek ata të gjitha ferrat e gjembat, prandaj ata janë të sinqertë dhe janë të imunizuar plotësisht ndaj shmangieve e shkarjeve dhe është shkaku që djalli e ndjen veten shumë ngushtë, nga që s'ka mundësi të depërtojë në brendësi të atyre të sinqertëve. Për djallin, është prerë çdo rrugë që çon për te ata, qysh ditën e parë, madje vetë djalli e ka pohuar pamundësinë e pafuqinë e tij për të depërtuar në zemrat e robve të sinqertë të All'llahut.

Mbi robtë e sinqertë të All'llahut nuk ndikojnë fare, as sprovat e shoqërisë ku ata jetojnë, as ngacmimet e djallit e as cytjet e mashtruesve, as prania e atyre që ndjekin traditat e gjyshërve të tyre të hershëm dhe as kultura e gabuar e djallëzore; të gjitha këto, nuk i shmangin dot robtë e sinqertë të All'llahut prej rrugës së tyre.

Pa dyshim që, ky ajet i nderuar është një dëshmi sigurie për besimtarët e Mekës të asaj kohe, të cilët rezistonin me vendosmëri, në të njëjtën kohë, është një thirrje drejtuar myslimanëve të ditëve të sotme të mbushura me sprova të shumta; ajeti u bën thirrje myslimanëve të ndahen prej radhëve të armiqve të All'llahut dhe të bashkohen me robtë e sinqertë të All'llahut.

Ajetet: 75 – 82

وَلَقَدْ نَادَىٰنَا نُوحٌ فَلَنِعْمَ ٱلْمُجِيبُونَ ﴿٧٥﴾ وَنَجَّيْنَٰهُ وَأَهْلَهُۥ مِنَ ٱلْكَرْبِ
ٱلْعَظِيمِ ﴿٧٦﴾ وَجَعَلْنَا ذُرِّيَّتَهُۥ هُمُ ٱلْبَاقِينَ ﴿٧٧﴾ وَتَرَكْنَا عَلَيْهِ فِى ٱلْءَاخِرِينَ
﴿٧٨﴾ سَلَٰمٌ عَلَىٰ نُوحٍ فِى ٱلْعَٰلَمِينَ ﴿٧٩﴾ إِنَّا كَذَٰلِكَ نَجْزِى ٱلْمُحْسِنِينَ ﴿٨٠﴾
إِنَّهُۥ مِنْ عِبَادِنَا ٱلْمُؤْمِنِينَ ﴿٨١﴾ ثُمَّ أَغْرَقْنَا ٱلْءَاخَرِينَ ﴿٨٢﴾

"Nùhu na bëri thirrje (për ndihmë) **dhe askush nuk i përgjigjet thirrjes më mirë se Ne."**

"Ne e shpëtuam atë dhe familjen e tij prej brengosjes së madhe."

"Ne bëmë që pasardhësit e tij të vazhdojnë jetën."

"Ne e lamë atë (kujtim) **për të mëvonshmit."**

"Paqe e shpëtim për Nùhun në të gjitha botët."

"Ne kështu i shpërblejmë punëmirët."

"Me të vërtetë ai (Nùhu) **ishte prej robve Tanë besimtarë."**

"Pastaj të tjerët Ne i mbytëm (në ujë) **."**

Komentimi

Pjesë prej tregimit të Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*

Qysh në ajetin e parë të këtij grupi ajetesh, fillojnë të shpalosen pjesë prej tregimeve të nëntë prej Profetëve të mëdhenj të All'llahut. Edhe ajetet e përparme kanë trokitur lehtë mbi tregimet e tyre. Ky grup ajetesh fillon me Nùhun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* më të moshuarin e Profetëve të përshkruar në Kur'ànin Famëlartë me cilësorin "të vendosurit" (ulul-azmi) dhe Nùhu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* është i pari prej atyre Profetëve të cilësuar "të vendosurit" (ulul-azmi).

Ajeti i parë fillon me tregimin për lutjen e Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* për dënimin e rëndë që kërkoi kundër popullit të tij, pas hidhërimit që pësoi për shkak se ata nuk e pranuan udhëzimin në rrugën e drejtë dhe këtë ngjarje ajeti e njofton me frazën: **"Nùhu na bëri thirrje** (për ndihmë) **dhe askush nuk i përgjigjet thirrjes më mirë se Ne."**.[1]

Ky mallkim mund të jetë një shenjë për mallkimin që ka ardhur në ajetet 26 dhe 27 të sures "Nùh": **"Nùhu tha: mos lër mbi Tokë asnjërin prej mohuesve. Në se Ti i lë ata, ata do të çojnë robtë e Tu në rrugën e humbjes dhe prej tyre do të lindin veçse mëkatarë e mohues."**.

[1] Fjala *"muxhijbùne"* – *"ata që i përgjigjen"* ka ardhur në numrin shumës, në një kohë kur qëllimi me ata **"që i përgjigjen thirrjes"** së Nùhut është All'llahu i Lartësuar; kjo fjalë ka ardhur në numrin shumës, për shkak se shumësi disa herë vjen për të treguar madhështi; gjithashtu edhe përemri i vetës së parë *"nà"* – *"Ne"* në fjalën *"nàdànà"* ka ardhur në numrin shumës, për të njëjtin qëllim.

Ose është një shenjë që tregon për lutjen që Nùhu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i drejtoi All'llahut të Lartësuar gjatë kohës që hipte në anije, ashtu siç ka ardhur në ajetin 29 të sures "El Mu'minùn": **"Zoti im, më zbrit në një vend të bekuar; askush nuk mund të zbresë më mirë se Ti."**.

Ose bën shenjë për lutjen e Nùhut, për të cilën tregohet në ajetin 10 të sures "El Kamer": **"Ai** (Nùhu) **iu drejtua Zotit të tij me lutjen: jam i mposhtur, prandaj më ndihmo."**.

Natyrisht, asgjë nuk e ndalon që ky ajet të bëjë shenjë për të gjitha këto lutje të Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mi të!)* dhe që All'llahu i Lartësuar iu përgjegj lutjeve të tij në mënyrën më të bukur.

Prandaj, All'llahu i Lartësuar njofton në ajetin vijues të ajeteve objekt studimi: **"Ne e shpëtuam atë dhe familjen e tij prej brengosjes së madhe."**.[1]

Ç'ishte ajo brengosje e madhe që përmendet në këtë ajet të nderuar dhe që e bëri Nùhun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të ndjente kaq shumë dhimbje?

Ajo brengosje e madhe mund të ishte rezultat i talljeve poshtëruese të popullit të tij mohues e mendjemadh, ose fjalët me thumba që ata i hidhnin atij me qëllim për ta tallur e për ta fyer e poshtëruar atë dhe besimtarët që ndiqnin Nùhun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* apo ajo brengosje e tij ishte rezultat i përgënjeshtrimit të egër që atij i bënte populli i vet, të cilët, në disa

[1] Ragibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", shpjegon se fjala e ajetit *"kerbun"*, do të thotë: *"brengosje shumë e rëndë"* dhe cilësimi me shprehjen *"shumë e rëndë"*, është për të theksuar më shumë këtë kuptim.

raste i thoshin: **“Dhe ne po shohin se ty nuk të ndjek kush, përveç atyre që janë më të fundit ndër ne.”**.[1]

Herë tjetër, ata i thoshin atij: **“Ata** (mohuesit) **i thanë: o Nùh, në të vërtetë ke polemizuar me ne, madje e zgjate shumë polemikën me ne; nëse thua të vërtetën, pa hë, sille atë me të cilën na frikëson.”**.[2]

Ose kur ai u urdhërua prej All’llahut të Lartësuar për të ndërtuar anijen; sa herë që ata mohues kalonin pranë tij, e tallnin: **“Kur ai ndërtonte anijen, sa herë që paria kalonte pranë tij, talleshin me të.”**.[3]

Aq zët e kishin marrë ata Profetin e All’llahut, Nùhun *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)* të njohur për durimin e tij të madh, saqë arritën deri aty sa thoshin: Ai është i çmendur. Fyerjet e vazhdueshme dhe trysnia e gjithanshme që ushtronin mohuesit ndaj Nùhut dhe ndaj asaj pakice që kishte besuar në thirrjen e Nùhut kishin arritur deri në atë shkallë, sa ai nuk e përballonte dot, prandaj Nùhu *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)* i lutet Zotit të vet me këto fjalë: **“Zoti im, më ndihmo; ata më përgënjeshtruan.”**.[4]

Të gjitha këto gjendje jo të mira për Nùhun *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)* dhe fyerjet e shumta që ata i bënin atij, bënë që zemra e tij e pastër të hidhërohej deri në thellësi dhe kjo gjendje fyerjesh e talljesh vazhdoi deri ditën kur shpërtheu tufani, deri ditën kur All’llahu i Lartësuar e shpëtoi Nùhun prej

[1] Sure “Hùd”, ajeti 27.
[2] Sure “Hùd”, ajeti 32.
[3] Sure “Hùd”, ajeti 38.
[4] Sure “El Mu’minù”, ajeti 26.

paudhësive të popullit të tij mizor dhe ia hoqi atij trishtimin e rëndë dhe brengosjen e madhe që ai ndjente.

Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, kanë thënë se qëllimi me frazën *"el kerbul adhijmu"* – *"brengosja e madhe"* është tufani i madh prej të cilit nuk shpëtoi askush përveç Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe pasuesve të tij besimtarë, por duket qartë se kjo mundësi interpretimi mbetet shumë e largët.

Ajeti vijues i grupit të ajeteve objekt studimi, shton: **"Ne bëmë që pasardhësit e tij të vazhdojnë jetën."**.

A është e vërtetë se të gjithë njerëzit që jetojnë sot në Botë, janë prej pasardhësve të Nùhut? Ky ajet i nderuar e deklaron hapur këtë.

Apo me shprehjen **"pasardhësit e tij"**, qëllimi është se vetëm Profetët, njerëzit e zgjedhur (eulijatë) dhe njerëzit e mirë, janë prej pasardhësve të tij dhe jo të gjithë njerëzit? Këtë çështje, me ndihmën e All'llahut, do ta trajtojmë në veçanti.

Përveç kësaj, Kur'àni Famëlartë shton: Ne bëmë që Nùhu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të lavdërohet e të përmendet me fjalët më të mira ndër brezat e ndër popujt e ardhshëm: **"Ne e lamë atë** (kujtim) **për të mëvonshmit."**.

Kur'àni Famëlartë e përshkruan Nùhun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* me cilësitë: Profeti qëndrestar, trim, i durueshëm, i mëshirshëm e i dashur. Historia e këtij Profeti të madh, është epopeja e një qëndrese dhe vendosmërie të madhe; prej programit të tij mund të frymëzohen ata që ndjekin programin e rrugës së vërtetë. Gjithashtu, prej programit të tij mund të merren këshilla e

të nxirren mësime që u mundësojnë njerëzve si të kapërcejnë pengesat që vënë para tyre armiqtë e injorantët.

Nuhù *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* mbajti e përballoi kaq shumë vështirësi, fyerje e dhimbje të mëdha, por ai të gjitha këto i përballoi me durim. Për të gjitha këto, All'llahu i Lartësuar i dha atij një dekoratë të përjetshme, me të cilën do të ishte krenar në të gjitha botët dhe ajeti njofton: **"Paqe e shpëtim për Nùhun në të gjitha botët."**.

Po, a mund të ketë krenari më të madhe se sa kur All'llahu i Lartësuar përshëndet me fjalën "selam" paqe - Profetin e Tij Nùhun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe është një përshëndetje që do t'i drejtohet atij prej të gjithë kombeve e popujve, deri Ditën e Kiametit. Këtu, tërheq vëmendjen fakti se rrallë gjendet ne Kur'ànin Famëlartë që dikush të jetë përshëndetur me selam me përmasa kaq të mëdha, sidomos kur marrim në konsideratë se qëllimi me fjalën *"el àlemijne"* – *"botët"* të gjitha botët, por këtu duhet shtuar fakti se në rastin e Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* fjala *"el àlemijne"* - *"botët"* ka ardhur e shquar me parafjalën *"el"* dhe sipas rregullave të sintaksës së gjuhës arabe, kur fjala shquhet me këtë mënyrë, ajo tregon përgjithësim dhe kuptimi zgjerohet dhe përfshin botën e njerëzve, të kombeve, popujve dhe grupimeve të ndryshme njerëzore, deri Ditën e Kiametit, madje përfshin edhe botën e engjëjve dhe të qenieve hyjnore.

Që karakteristikat e Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të jenë burim rrezatimi për të tjerët, Kur'àni Famëlartë shton: **"Ne kështu i shpërblejmë punëmirët"** dhe **"Me të vërtetë ai** (Nùhu) **ishte prej robve Tanë besimtarë."**.

Po, shkalla e lartë e robërisë së Nùhut ndaj All'llahut, besimi i tij i palëkundur në All'llahun e Lartësuar dhe puna e tij e mirë, ashtu siç u përshkrua në dy ajetet e sipërme, ishin shkaku kryesor që Nùhu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u përfshi në butësinë hyjnore, që e shpëtoi atë prej brengosjes së madhe; gjithashtu, ishte shkak që All'llahu i Lartësuar i dërgonte atij "selam" dhe kjo përshëndetje mund të përfshijë cilindo që punon ashtu siç punoi Nùhu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* sepse kriteret e meritimit të mëshirës hyjnore janë të pandryshueshme dhe nuk është se janë vepruese vetëm për një njeri e për një njeri tjetër nuk janë vepruese.

Ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh, me një frazë shumë të shkurtër, por me një gjuhë të ashpër, shpjegon qartë përfundimin e atij populli idhujtar, mizor e të urryer: **"Pastaj, të tjerët Ne i mbytëm** (në ujë)**."**.

Rrebeshet e shumta të shiut dhe shpërthimi i burimeve të Tokës ishte aq i madh, sa Toka u mbulua e gjitha me ujë dhe u bë si një det i madh e i trazuar nga dallgë të larta e të fuqishme, që shkatërruan fronat e despotëve dhe vetë despotët e mizorët e tjerë mbetën trupa pa jetë e pa shpirt.

Në këtë grup ajetesh, tërheq vëmendjen fakti se All'llahu i Lartësuar e shpalos dashamirësinë e Tij ndaj Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në disa ajete, në të cilat shpjegon dënimin që Ai ka përgatitur për popullin kundërshtues të Nùhut dhe vetëm me një frazë të shkurtër që e shoqëron këtë shpjegim, tregohet përbuzja e mosinteresimi për atë popull; sepse gjendja e ndihmës për besimtarët dhe për lartësimin e tyre, si dhe përkrahja e Krijuesit të Lartësuar për ata besimtarë, është tepër e lartë që të

ketë nevojë për shpjegime të zgjeruara, kurse shpjegimi i gjendjes së armiqve kokëngjeshur e mëkatarë, nuk meriton asnjë lloj interesimi e përkujdesjeje.

Hulumtim

A janë prej pasardhësve të Nùhut njerëzit që gjenden në Tokë?

Një grup prej interpretuesve të mëdhenj të Kur'ànit Famëlartë, e kanë interpretuar ajetin

"Ne bëmë që pasardhësit e tij (Nùhut) **të vazhdojnë jetën"**, në kuptimin se të gjithë brezat e Njerëzimit që kanë ardhur pas Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* janë prej pasardhësve të tij.

Gjithashtu, shumë historianë kanë cituar se, pas tufanit, vetëm tre djem jetuan prej pasardhësve të Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe ata janë: Sàmi, Hàmi dhe Jàfethi; gjithashtu, ata kanë thënë se, të gjithë kombet e popujt që gjenden sot në Tokë, origjina e tyre përfundon te ata të tre.

Për racën arabe, persiane e romake, thonë se janë pasardhës të Sàmit, ndërsa për ata që njihen si të racës turke dhe për disa grupe të tjera thonë se janë prej pasardhëve të Jàfethit, kurse pasardhësit e Hàmit janë të shpërndarë në Sudan, Sind,

Hindi, Nubi e Abisini. Gjithashtu, edhe koptët e berberët janë prej pasardhësve të Hàmit.

Studimi mbi këtë çështje, nuk ka qëllim që të mësohet se cilit prej djemve të Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i përket secila racë, sepse vetë kjo çështje është objekt kundërshtimesh të shumta në mesin e shumë historianëve dhe intepretuesve të Kur'ànit Famëlartë, por qëllimi kryesor që kërkohet në këtë studim, është: A është origjina e të gjithë kombeve e popujve prej tre djemve të Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)?*

Këtu shtrohet pyetja: si qe e ardhmja e besimtarëve që hipën, së bashku me Nùhun, në anije gjatë tufanit? A vdiqën ata të gjithë dhe a lanë ata pasardhës djem, apo ata lanë pasardhëse vetëm vajza, të cilat u martuan me djemtë e Nùhut?

Ky problem, nga ana historike vazhdon të mbetet i paqartë.

Megjithëkëtë, në lidhje me këtë problem, kanë ardhur transmetime dhe ajete kur'anore që tregojnë për ekzistencën e kombeve e të popujve në globin e Tokës, origjina e të cilëve nuk përfundon te djemtë e Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Në tefsirin e Ali bin Ibrahimit, citohet një transmetim i ardhur prej Imam Bàkirit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe që shpjegon ajetin e sipërm. Në këtë transmetim thuhet: "E vërteta, profetnia, libri dhe besimi janë në gjurmët e tij (Nùhut) dhe jo se të gjithë njerëzit që gjenden në Tokë janë prej djemve të Nùhut, sepse All'llahu i Lartësuar njofton në librin e Tij: **"…ngarko në atë** (anijen) **nga një çift prej çdo krijese dhe familjen tënde, me përjashtim të atyre për të cilët është marrë vendimi kundër atyre dhe** (ngarko në anije) **edhe ata që kanë besuar; por, përveç**

një pakice që kishte besuar së bashku me atë (Nùhun)**, të tjerët nuk i besuan atij."** (Sure "Hùd", ajeti 40); gjithashtu, i Larti thotë: **"pasardhës të atyre që Ne i mbartëm** (i shpëtuam) **së bashku me Nùhun."** (Sure "El Isrà", ajeti 3).[1]

Bazuar mbi këto shpjegime, rezulton se origjina e të gjitha racave që ekzistojnë në globin e Tokës, përfundon te djemtë e Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Por kjo çështje vazhdon të jetë e pavërtetuar.

[1] Ky transmetim është cituar në tefsirin "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 405; gjithashtu është cituar edhe në tefsirin "Es Sàfij", në fundin e ajeteve objekt i studimit tonë.

Ajetet: 83 – 94

۞ وَإِنَّ مِن شِيعَتِهِۦ لَإِبۡرَٰهِيمَ ﴿٨٣﴾ إِذۡ جَآءَ رَبَّهُۥ بِقَلۡبٖ سَلِيمٍ ﴿٨٤﴾ إِذۡ
قَالَ لِأَبِيهِ وَقَوۡمِهِۦ مَاذَا تَعۡبُدُونَ ﴿٨٥﴾ أَئِفۡكًا ءَالِهَةٗ دُونَ ٱللَّهِ تُرِيدُونَ ﴿٨٦﴾
فَمَا ظَنُّكُم بِرَبِّ ٱلۡعَٰلَمِينَ ﴿٨٧﴾ فَنَظَرَ نَظۡرَةٗ فِي ٱلنُّجُومِ ﴿٨٨﴾ فَقَالَ إِنِّي
سَقِيمٞ ﴿٨٩﴾ فَتَوَلَّوۡاْ عَنۡهُ مُدۡبِرِينَ ﴿٩٠﴾ فَرَاغَ إِلَىٰٓ ءَالِهَتِهِمۡ فَقَالَ أَلَا تَأۡكُلُونَ
﴿٩١﴾ مَا لَكُمۡ لَا تَنطِقُونَ ﴿٩٢﴾ فَرَاغَ عَلَيۡهِمۡ ضَرۡبَۢا بِٱلۡيَمِينِ ﴿٩٣﴾ فَأَقۡبَلُوٓاْ
إِلَيۡهِ يَزِفُّونَ ﴿٩٤﴾

“ Prej atyre që ndiqnin rrugën e tij (Nùhut)**, patjetër ishte edhe Ibrahimi.”**

“Kur ai (Ibrahimi) **erdhi te Zoti i tij me zemër të pastër.”**

“Kur ai i tha babait dhe popullit të tij: ç’janë këta që ju i adhuroni?”

“A në vend të All’llahut doni të sajoni zota të tjerë?”

“Ç`mendim keni për Zotin e botëve?”

“Ai (Ibrahimi) **hodhi një shikim mbi yjet.”**

"Dhe tha: unë jam i sëmurë."

"Ata menjëherë u larguan prej tij."

"Ai (Ibrahimi) **shkoi te zotat e tyre dhe u tha: a nuk po hani?"**

"Ç'keni që nuk flisni?"

"U afrua pranë atyre (idhujve) **me ngadalë dhe i goditi ata me të djathtën."**

"Ata (populli) **shkuan te ai me të shpejtë."**

Komentimi

Plani i zgjuar i Ibrahimit për shkatërrimin e idhujve

Pas ajeteve të sipërme, në të cilët u shpalosën disa anë të historisë së mbushur me shumë ngjarje të Profetit Nùh *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ajetet objekt studimi flasin për disa anë të jetës së shkatërruesit të idhujve, Profetit Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Gjithashtu, flasin edhe për qëndrimin e ashpër që mbajtën adhuruesit e idhujve ndaj Ibrahimit. Ndërsa ajetet e tjera, që trajtojnë pjesë të tjera të këtij tregimi, shpalosin një panoramë të madhe të këtij tregimi, që përfaqësohet në sakrificat e mikut të All'llahut, Profetit Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Në këto ajete, flitet edhe për çështjen e bërjes kurban të djalit të tij, Ismailit. Në këtë tregim në lidhje me Ibrahimin është prekur me hollësi,

kurse në ajete të tjerë, tregimi në lidhje me këtë Profet të nderuar nuk trajtohet me kaq shumë hollësi.

Ajeti i parë i ajeteve objekt studimi, bën lidhjen në mes Nùhut dhe Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)* ku thotë: **"Prej atyre që ndiqnin rrugën e tij** (Nùhut)**, patjetër ishte edhe Ibrahimi."**.

Domethënë: Ibrahimi ecte në gjurmët e Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të dy kanë ecur në rrugën e Njëtimit të All'llahut, në rrugën e drejtësisë, përkushtimit e sinqeritetit; kjo do të thotë se të gjithë Profetët kanë kumtuar një fe të vetme dhe se Profetët janë profesorët e të njëjtit universitet; çdonjëri prej Profetëve ka vazhduar të zbatojë e të plotësojë programet e Profetit para tij.

Sa e bukur është fraza e këtij ajeti! Ibrahimi është prej atyre që ndjekin Nùhun pavarësisht se në mes të dyve ka një ndarje kohore shumë të gjatë (Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, kanë thënë se ndarja kohore në mes këtyre dy Profetëve vlerësohet të jetë 2600 vjet.);[1] por në lidhjet e besimit, siç dihet, ndarja kohore nuk ka as më të voglin ndikim.

[1] Disa interpretues të Kur'ànit, përemrin vetor *"atij" - "hi"* në fjalën e ajetit *"shii'atihi" – "ndjekësve të tij"* ia adresojnë të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në disa ajete të Kur'ànit Famëlartë, njoftohet se i Dërguari i All'llahut ka ndjekur fenë e Ibrahimit; por duhet theksuar se ky adresim nuk është për atë, pasi në ajetet e përparme dhe në ajetet që vijnë më pas, përemri nuk tregon se fjala *"shii'atihi" – "ndjekësve të tij"* i adresohet të Dërguarit të All'llahut prandaj ka mundësi që ata kanë menduar se shprehja *"shii'atihi" – "ndjekësve të tij"* është argument që tregon se Nùhu ka më përparësi se Ibrahimi. Kur Kur'àni Famëlartë flet për personin e lartë të Ibrahimit shprehja *"shii'atihi" – "ndjekësve të tij"* nuk është argument që e vërteton këtë mëtim. Në të vërtetë, qëllimi me shprehjen *"ndjekës"*, është

Pas kësaj parathënieje të shkurtër, le të hyjmë në hollësi dhe të shohim atë që na njofton All'llahu i Lartësuar: **"Kur ai** (Ibrahimi) **erdhi te Zoti i tij me zemër të pastër."**.

Interpretuesit e Kur'ànit Famëlartë, e kanë shpjeguar frazën e ajetit **"بِقَلْبٍ سَلِيْمٍ"** *"bi kalbin selijmin"* - me zemër të pastër - në disa mënyra dhe kanë thënë se çdonjëra nga këto mënyra shpjegimi, tregon njërën prej përmasave të çështjes së zemrës së pastër:

- Zemër e pastër prej idhujtarisë (shirkut).

- Zemër e pastër prej mëkateve, padrejtësisë e hipokrizisë.

- Zemër e pastër prej dashurisë për këtë botë, sepse dashuria për këtë botë është burimi i të gjitha gabimeve.

- Zemër në të cilën s'ka asgjë tjetër përveç All'llahut.

Në të vërtetë, fjala e ajetit *"selijm"*, në rrënjën e saj *"es selàmetu"* – *"pastërti"* tregon se kur kjo fjalë përdoret e pakushtëzuar, përfshin edhe pastërtinë prej të gjitha sëmundjeve morale dhe besimin e shëndoshë larg çdo dyshimi.

Kur'àni Famëlartë, në lidhje me hipokritët thotë: **"Në zemrat e tyre ka sëmundje dhe All'llahu ua shton atyre sëmundjen"**;[1] domethënë se zemrat e tyre janë të prekura nga njëra prej llojeve të sëmundjeve dhe All'llahu i Lartësuar bën

---

vijimësia e linjës ideore e fetare; gjithashtu edhe përparësia e të Dërguarit të All'llahut ndaj të gjithë Profetëve, nuk është në kundërthënie me fenë monoteiste të Ibrahimit pasi Kur'àni Famëlartë, në ajetin 90 të sures "El En'àm", për rrugën e Profetëve thotë: **"ti merri shembull ata në udhëzimin"**.

[1] Sure "El Bekare", ajeti 10.

shtesa të tjera mbi atë sëmundje të zemrës së tyre, për shkak se ata vazhdojnë me këmbëngulje të bëjnë sa më shumë faje.

Edhe Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka dhënë një shpjegim shumë të bukur për frazën e ajetit *"bikalbin selijmin"* – *"me zemër të pastër"* dhe lexojmë fjalën e tij: *"zemra e pastër është ajo që e takon Zotin e saj; në atë zemër s'ka asnjë tjetër përveç Atij"*.[1] Me këtë fjalë, Imami ka bashkuar të gjitha cilësitë e përmendura më sipër për zemrën e pastër.

Në një transmetim tjetër të ardhur nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"ai që ka qëllimin e sinqertë, ka zemër të pastër, sepse pastërtia e zemrës prej shqetësimeve të kota, e pastron qëllimin dhe e bën qëllimin të jetë i kushtuar vetëm për All'llahun e Lartësuar, në të gjitha punët."*.[2]

Kur'àni Famëlartë, e konsideron *"zemrën e pastër"* kapitalin më të madh për njeriun Ditën e Gjykimit, ashtu siç e lexojmë këtë në fjalën e Profetit të madh Ibrahim në ajetet 88-89 të sures "Esh Shuarà": **"Dita kur nuk sjell dobi as pasuria e as fëmijët* Vetëm ai që vjen te Zoti i tij me zemër të pastër."**.[3]

Po, qysh në këtë ajet të nderuar, fillon tregimi për Ibrahimin me zemër e me shpirt të pastër, burrin e drejtë e me vullnet të hekurt dhe me vendosmëri të patundur në komunikimin e tij me popullin e vet. Kur ai u ngarkua me misionin e rëndësishëm për të luftuar në rrugën e All'llahut

[1] "Usùlul Kàfij", vëll. 2, f. 16. Gjithashtu e ka cituar edhe autori i tefsirit "Es Sàfij", në fundin e komentit të ajetit 89 të sures "Esh Shuarà".
[2] "Bihàrul Enuàr", vëll. 7, f. 21.
[3] Rreth zemrës së pastër gjendet hulumtim në komëntimin e ajeteve 88 dhe 89 të sures "Shuara" në këtë komentim me titullin: "Zemra e pastër, kapitali i shpëtimit".

kundër adhuruesve të idhujve, këtë luftë ai e filloi me babanë e vet dhe me të afërmit e tij: **"Kur ai i tha babait dhe popullit të tij: ç'janë këto që ju i adhuroni?"**, çfarë adhuroni, si ka mundësi të adhuroni sende kaq të zakonshme e kaq pa vlerë?

A nuk është për të ardhur keq për njeriun, të cilin All'llahu i Lartësuar e ka nderuar mbi të gjitha krijesat; mos vallë All'llahu i dha njeriut mendjen që të adhurojë një copë guri, ose një copë druri pa asnjë vlerë dhe prej të cilave nuk vjen asnjë dobi? Ku i keni mendjet?!

Në vijim Ibrahimi *(Paqja qoftë mbi të!)* e plotëson frazën e sipërme, që shprehte përçmimin më të qartë për idhujt dhe duke iu drejtuar babait të vet e popullit të tij, u thotë atyre: **"A në vend të All'llahut doni të sajoni zota të tjerë?"**.

Fjala e këtij ajeti *"ifkun"*, do të thotë: *"gënjeshtër e madhe, ose gënjeshtër e keqe"*. Kjo fjalë shpjegon qartë sa i vendosur e sa i prerë ishte Ibrahimi *(Paqja qoftë mbi të!)* në luftën e tij kundër idhujve.

Në këtë pjesë të fjalës së tij, ai e mbyll bisedën me një shprehje me ton të ashpër, kur u drejtohet atyre: **"Ç'mendim keni për Zotin e botëve?"**; ju çdo ditë hani prej furnizimit që Ai ka bërë për ju, a nuk e shihni se jeni të rrethuar prej mirësive të Tij nga të gjitha anët, megjithëkëtë ju i vini vetes qëllim të adhuroni trupa pa asnjë vlerë dhe nuk adhuroni All'llahun; vallë, a mendoni se Ai do t'ju mëshirojë dhe nuk do t'ju dënojë me ndëshkimin më të ashpër? Sa i madh është ky gabimi juaj dhe sa rrezik dëmtues është humbja e udhëzimit në rrugën e drejtë?!

Fraza e ajetit *"rab'bil àlemijne"* – *"Zoti i botëve"* thekson se Gjithësia rrotullohet nën hijen e sundimit të All'llahut të

Lartësuar, por ju e latë All'llahun dhe e drejtuat qëllimin tuaj në mitet e në iluzionet e zbrazëta.

Në librat e historisë dhe në librat e tefsireve të Kur'ànit Famëlartë, shkruhet se adhuruesit e idhujve në qytetin Babil, kishin një ditë feste të përvitshme; atë ditë ata sillnin ushqime brenda tempujve të tyre dhe i gatuanin ushqimet para zotave të tyre, me qëllim që ata të bekonin ushqimin. Pastaj, dilnin jashtë qytetit dhe nga fundi i ditës ktheheshin përsëri në tempujt e tyre, që të hanin e të pinin aty ushqimin që kishin përgatitur.

Ky ishte rasti kur në qytet nuk kishte më njerëz dhe këtë rast të mirë e shfrytëzoi Ibrahimi për të vënë në zbatim planin e tij për të shkatërruar idhujt. Në të vërtetë, Ibrahimi ishte në pritje të këtij rasti qysh prej një kohe të gjatë, prandaj nuk donte që këtë rast ta humbte.

Kur atë e thirrën njerëzit e tij, natën, për të marrë pjesë në programin e tyre festiv, Kur'àni Famëlartë njofton se ai vështroi në drejtim të yjeve: **"Ai** (Ibrahimi) **hodhi një shikim mbi yjet**. **Dhe tha: unë jam i sëmurë."**.

Ai nxori si justifikim sëmundjen, që të mos merrte pjesë në festimet e idhujtarëve.

Pas këtij justifikimi, ajeti vijues njofton se ata u larguan prej tij dhe nxituan të kryenin ritualet e veta: **"Ata menjëherë u larguan prej tij."**.

Këtu dalin dy pyetje:

E para: Përse Ibrahimi shikoi në yjet dhe cili ishte qëllimi i tij me këtë vështrim në drejtim të yjeve?

E dyta: Vallë, vërtetë ishte i sëmurë kur tha: unë jam i sëmurë dhe ç'sëmundje kishte?

Përgjigje: Nëse marrim në konsideratë bestytnitë dhe zakonet e banorëve të Babilit, bëhet e qartë se ata besonin që, duke shikuar në yjet, mund të lexonin fatin e tyre, madje ata thoshin se idhujt që ata adhuronin ishin skelete të yjeve të Tokës dhe për këtë shkak ata besonin se yjet kishin ndikim në fatin e tyre, prandaj kërkonin prej yjeve mirësi e begati; gjithashtu, duke shikuar në yjet, besonin se mund të nxirrnin përfundime për ngjarjet që do të ndodhnin në të ardhmen.

Me qëllim që ata të pandehnin se Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* thotë të njëjtat fjalë si ata, ai shikoi në drejtim të Qiellit dhe ndërkaq tha: unë jam i sëmurë; pas kësaj fjale, ata e lanë e u larguan prej tij, duke menduar se ylli i tij e njoftoi atë për sëmundjen që kishte.

Disa prej interpretuesve të mëdhenj të Kur'ànit Famëlartë, janë shprehur se kjo frazë është në kuptimin se ai, me anën e lëvizjes së yjeve, kishte qëllim të caktonte kohën e saktë të sëmundjes së tij, pasi vuante prej etheve që i përsëriteshin në periudha kohore të caktuara; megjithëkëtë, mundësia e parë është më shumë në harmoni me hapësirat e përmasave të ajetit, gjithnjë nëse marrim në konsideratë bestytnitë që ishin zotëruese në atë kohë ndër banorët e Babilit.

Të tjerë interpretues të Kur'ànit Famëlartë, kanë thënë se shikimi i Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në drejtim të Qiellit, është në kuptimin e të menduarit në sekretet e krijimit, kurse banorët e Babilit mendonin se shikimi i tij në drejtim të

Qiellit është vështrim i një astrologu, i cili, duke parë lëvizjen e yjeve, ka qëllim të parashikojë ngjarjet që do të ndodhin në të ardhmen.

Përsa i përket pyetjes së dytë, interpretuesit e Kur'ànit Famëlartë, kanë përmendur disa përgjigje, prej të cilave:

- Ai me të vërtetë ishte i sëmurë; por edhe nëse nuk do të ishte i sëmurë, ai kurrë nuk do të merrte pjesë në ceremonitë e tyre festive dhe sëmundja e tij ishte thjesht një justifikim shumë i mirë për të mos marrë pjesë në festimet e idhujtarëve. Në të njëjtën kohë, qëndrimi në qytet gjatë kohës kur banorët ishin jashtë qytetit, ishte një rast i artë për të shkatërruar idhujt e tyre. Ne nuk kemi argument që të na mundësojë të themi se Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* përdori aludimet, mirëpo përdorimi i aludimeve nga ana e Profetëve numërohet punë jo e përshtatshme me pozitën e Profetit.

Të tjerë kanë thënë se Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* nuk ishte prekur nga ndonjë sëmundje trupore, por shpirti i tij ishte i lodhur, për shkak të praktikave të kota që ndiqte populli i tij, si dhe për shkak se ata ishin mohues, bënin padrejtësi të shumta dhe ishin të degjeneruar. Me këtë shpjegim, e vërteta e sëmundjes së Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* për ata ishte shumë e qartë; megjithëse ata mendonin diçka tjetër, ata besonin se ai me të vërtetë vuante prej disa sëmundjeve trupore.

Të tjerë janë shprehur se Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!* në bisedën e tij me idhujtarët përdori aludimin dhe kanë thënë se fjala e tij është e ngjashme me shembullin kur dikush troket në portën e shtëpisë dhe pyet nëse filani ndodhet në shtëpi, ndërkaq atij i vjen përgjigja nga prapa portës: ai nuk është këtu.

Qëllimi me fjalën nuk është këtu, është: filani nuk është prapa portës dhe jo se filani që ai kërkon nuk gjendet fare në shtëpi, mirëpo dëgjuesi, nga kjo përgjigje kupton se njeriu që ai kërkon me të vërtetë nuk gjendet në shtëpi. Shprehje të këtilla, që nuk janë rrena dhe nga jashtë japin një kuptim tjetër, në terminologjinë e jurisprudencës fetare (fik'h) quhen aludime (teurijeh), por qëllimi me këtë shprehje është se Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* me atë fjalë që tha, kishte qëllim se është e mundur të sëmurem në të ardhmen dhe se këtë fjalë ai e tha që të shpëtonte prej tyre dhe që ata të largoheshin e ta linin vetëm.

Sipas kuptimit që shprehin fjalët e ajeteve, duket se interpretimi i parë dhe i dytë janë më të përshtatshëm.

Me këtë rrugë manovrimi, Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* mbeti vetëm në qytet dhe pasi adhuruesit e idhujve dolën jashtë qytetit, ai vështroi rreth e rrotull, ndërkaq në sytë e tij shndriste fuqishëm dëshira e tij e madhe për të shkatërruar idhujt; kishin ardhur çastet që i priste dhe tani detyra e tij ishte të niste "luftën" me idhujt dhe të lëshonte mbi idhujt goditjen e tij të fuqishme, atë goditje që do të lëkundte mendjet e shkurtëra të adhuruesve të idhujve, që besonin në të këtilla mite dhe që do t'i zgjonte ata prej gjumit të shkujdesjes.

Ai shkoi në tempullin e idhujve, u hodhi një sy pjatave dhe enëve me gjellëra të shpërndara në të gjithë tempullin, pastaj pa në drejtim të idhujve dhe me zë të lartë e me një sarkazëm therëse, tha: A nuk po hani prej gjellëve që kanë sjellë për ju adhuruesit tuaj, është ushqim me shumë yndyrë, i shijshëm dhe ka nga të

gjitha llojet e gjellëve, ç'keni që nuk hani? **"Ai** (Ibrahimi) **shkoi te zotat e tyre dhe u tha: a nuk po hani ju?"**.[1]

Pastaj shtoi: përse nuk flisni? Mos nuk kanë fuqi gjuhët tuaja të lakojnë fjalët? **"Ç'keni që nuk flisni?"**.

Me këtë gjuhë, Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* tallet me të gjitha besimet mitike të idhujtarëve. Pa dyshim që ai e dinte se idhujt as nuk hanë e as nuk flasin, ai e dinte se idhujt janë trupa të ngurtë, por prapa kësaj talljeje, ai kishte qëllim që, me fjalë të ëmbla e të bukura, të tregonte atë që do të ndodhte pasi ai të shkatërronte idhujt.

Ai përveshi krahët, mori sopatën në dorë dhe u vërsul mbi idhujt, duke i goditur me të gjithë fuqinë e forcën që kishte: **"U afrua pranë atyre** (idhujve) **me ngadalë dhe i goditi ata me të djathtën."**.

Me fjalën *"bil jemijni"* – *"me të djathtën"* qëllimi është dora e djathtë e njeriut, pasi njeriu, me dorën e djathtë kryen më të shumtën e punëve të tij, ose kjo fjalë është metaforë që tregon fuqinë e forcën, por është e mundur që të bashkohen të dy kuptimet.

Shkatërrimi i idhujve prej Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e shndërroi tempullin e sistemuar të idhujve në një gërmadhë dhe dukej që ishte shkaktuar prej një veprimi shumë të egërsuar; në tempull nuk mbeti asnjë idhull në gjendjen që ishte, duart e këmbët e shtatoreve të thyera ishin të shpërndara sa andej

[1] Fjala *"ràga"*, në rrënjën e saj *"reuega"*, do të thotë: *shkuarja në drejtim të një sendi, ose animi drejt atij sendi në mënyrë të fshehur, ose në mënyrë të kamufluar, me qëllim për ta shkatërruar sendin*.

këndej brenda tempullit, në të njëjtën kohë kjo pamje e tempullit për adhuruesit e idhujve do të kishte ndikim shumë të fuqishëm dhe do të shkaktonte në ata dhimbje të mëdha dhe hidhërim të thellë.

Pasi mbaroi punë me shkatërrimin e idhujve, Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!* me qetësi të plotë u largua prej tempullit dhe shkoi në shtëpinë e tij, që të përgatiste veten për ngjarjet e ardhshme. Ai e dinte mirë se puna që ai bëri ishte e ngjashme me një shpërthim të fuqishëm, që do të trondiste jo vetëm qytetin, por edhe të gjithë mbretërinë e Babilit; ai e dinte mirë se shkatërrimi i idhujve do të shkaktonte një valë të fuqishme zemërimi dhe Ibrahimi do të ishte i vetëm në mesin e asaj vale të fuqishme, por ai kishte një Zot që e ruante atë dhe kjo i mjaftonte atij.

Nga fundi i ditës, adhuruesit e idhujve u kthyen në qytet dhe menjëherë nxituan të shkojnë në tempullin e tyre, por ajo që u panë sytë ishte një panoramë e frikshme dhe e errët dhe nga egërsia e asaj që u panë sytë, disa ngrinë në vend, disa të tjerëve u iku mendja, një heshtje e plotë e mbuloi tempullin, ata shikonin me habi, si të hutuar, copat e zotave të tyre të shpërndara këtu e atje; ata shihnin idhujt e tyre me pikëllim të thellë në zemër, sepse ata ishin mësuar që çdo ditë të shkonin e të kërkonin ndihmën e idhujve që t'u plotësoheshin nevojat e tyre, por sot e gjetën veten pa ndihmues.

Kjo atmosferë heshtjeje, nuk vazhdoi gjatë; shumë shpejt kjo pamje frikësues e tempullit të tyre, bëri që ata të ngrenë zërat lart dhe të kërkojnë shpjegim se kush është ai që e bëri këtë me zotat e tyre?

Nuk kaloi shumë kohë dhe ata u kujtuan se ishte një djalë në qytetin e tyre, ai adhuronte All'llahun, ai quhej Ibrahim dhe tallej me idhujt e tyre, madje ai kishte kërcënuar se kishte përgatitur një plan të rrezikshëm për idhujt e tyre.

Ata përfunduan se Ibrahimi ishte ai që kishte thyer idhujt dhe të gjithë shkuan tek ai të zemëruar: **"Ata** (populli) **shkuan te ai me të shpejtë."**.

Fjala *"jezif'fùne"*, në rrënjën e saj *"zef'fe"*, përdoret veçanërisht për të treguar fryrjen e erërave dhe për lëvizjen e shpejtë të atyre kafshëve që, gjatë vrapit me kërcime të gjata, duken sikur fluturojnë; pastaj kjo fjalë është përdorur edhe për të treguar dasmën, në kuptimin e çuarjes së nuses me shpejtësi në shtëpinë e burrit të saj.

Në të gjitha gjendjet, këtu qëllimi është se adhuruesit e idhujve shkuan me shumë nxitim te Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* por plotësimin e ngjarjeve ne do ta shikojmë në ajetet vijuese.

Dy Hulumtime

1- A e përdorin Profetët aludimin?

Fjala *"et teurijetu"*, disa herë ka kuptimin: njeriu thotë një fjalë, por prej fjalës së tij kuptohet diçka tjetër, që nuk ishte qëllimi i tij. Le ta ilustrojmë me një shembull: Një njeri pyet një njeri tjetër: kur u ktheve prej udhëtimit? Ai i përgjigjet: para perëndimit të

Diellit, në një kohë që ai është kthyer prej udhëtimit para mesditës. Nga kuptimi që kanë në gjuhën arabe fjalët e kësaj përgjigjeje, pyetësi kupton se ai është kthyer pak para perëndimit të Diellit, në një kohë që ai kishte qëllim kohën para mesditës, sepse edhe koha para mesditës, në gjuhën arabe gjithashtu konsiderohet kohë para perëndimit të Diellit. Ose, marrin një shembull tjetër: një burrë pyet një tjetër: a e hëngre ushqimin dhe ai i përgjigjet: po. Nga përgjigja e tij, pyetësi kupton se ai sot e ka ngrënë ushqimin, kurse njeriu që u përgjigj kishte qëllim të thoshte se ai ushqimin e sotshëm e ka ngrënë dje.

Çështja nëse aludimi është rrenë ose jo, është shtruar në librat e jurisprudencës islame (fik'h); një grup prej dijetarëve të mëdhenj, ndër të cilët edhe shejhu El Ensàrij *(All'llahu e mëshiroftë!)* besojnë se aludimi nuk është rrenë, pasi as në traditën e as në transmetimet islame, aludimi nuk konsiderohet rrenë; madje, në lidhje me aludimin, kanë ardhur transmetime që e mohojnë cilësinë e rrenës prej aludimit. Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, në lidhje me aludimin është pyetur: pyesin nëse burri është në shtëpi dhe ai i thotë gruas: thuaj që nuk është këtu. Imami *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"S'ka problem, kjo nuk është rrenë."*.[1]

E vërteta është se kjo çështje patjetër duhet trajtuar me imtësi dhe patjetër duhet vënë një rregullore e përgjithshme, pasi fjala nga ana gjuhësore dhe nga ana e zakonit, ka dy kuptime; biseduesi mendon që me atë fjalë të shprehë një kuptim të veçantë, në një kohë që bashkëbiseduesi ka qëllim një kuptim tjetër; një gjë e këtillë konsiderohet aludim dhe jo rrenë, pasi është përdorur një fjalë me kuptime të përbashkëta, nga e cila folësi

[1] "Uesàilu Shij'ah", vëll. 8, f. 580; pjesa 141 në dhjetë kapitujt.

kupton një send, ndërsa bashkëbiseduesi merr prej asaj fjale një kuptim tjetër.

Një shembull tjetër; në lidhje me shpjegimin e gjendjes së Sejid ibn Xhubejrit, thuhet se tirani Haxhàxh ibn Jùsuf Eth Thekafij, e pyeti Sejidin: Cili është vlerësimi yt për mua? Sejidi iu përgjegj: Ti je njeri i drejtë. Kjo përgjigje i gëzoi policët e Haxhàxhit, në një kohë që Haxhaxhi tha: Ai me këtë fjalë më vlerësoi se unë jam mohues, sepse në gjuhën arabe, njëri prej kuptimeve të fjalës *"i drejtë"* - *"adilun"* është: heqja dorë nga e vërteta dhe tregon gjendjen e gabuar.

Por, kur fjala nga ana gjuhësore dhe e zakonit është e njëjtë nga ana e kuptimit, atëherë bashkëbiseduesi heq dorë prej kuptimit të vërtetë të asaj fjale dhe e përdor atë në kuptimin metaforik, pa përmendur shembujt krahasues të metaforës. Një aludim i këtillë, pa dyshim që është veprim rreptësisht i ndaluar (haram). Këto shpjegime të hollësishme të fjalës aludim, na mundësojnë të bashkojmë opinionet e ndryshme të juristëve të ligjit të fesë (fukaha).

Por, patjetër duhet tërhequr vëmendja, se edhe në rastet kur aludimi nuk është rrenë, prej aludimit në disa raste mund të vijnë dëme, punë të liga ose për shkak të aludimit njerëzit bien në gabime; madje, në këto raste, aludimi mund arrijë deri aty, sa të jetë punë e ndaluar rreptësisht (haram); por, kur në aludimin nuk përfshihen punë të liga dhe nuk është rrenë, në këtë rast s'ka argument që të thuhet se aludimi është veprim haram dhe transmetimi i mësipërm i ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, vërteton se aludimi në këto raste nuk është rrenë.

Mbështetja mbi aludimin edhe kur në aludimin nuk ka vend për rrenën, përsëri nuk është i mjaftueshëm, sepse që aludimi të jetë veprim i ndaluar (haram), patjetër duhet të përfshijë kuptime dëmtuese e punë të liga. Natyrisht, në rastet kur njeriu e ka të domosdoshme të thotë një rrenë, kuptohet që lejohet përdorimi i aludimit, deri sa ka vend ku aludimi mund të përdoret, domethënë që fjala e tij nuk vërtetohet se është rrenë.

A është i lejuar aludimi për Profetët?

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, është detyrë të thuhet: kur aludimi, në mënyrë absolute është shkak për tronditjen e besueshmërisë së njerëzve në Profetët, patjetër që nuk është veprim i lejuar, sepse besueshmëria pa kushte, është kapitali i Profetëve në rrugën e kumtimit të kumtit; por kur bëhet fjalë për raste siç ishte rasti kur Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* hiqej si i sëmurë, shikimi i tij në yjet dhe qëllimi shumë i rëndësishëm që ai kishte me këto veprime, nuk shkaktojnë tronditje në kolonat e besueshmërisë te ata që, me sinqeritet, kanë qëllim të vërtetën; në këto raste, aludimi nuk ka në brendinë e tij asnjë problem.

2- Ibrahimi dhe zemra e pastër

Në terminologjinë e Kur'ànit Famëlartë, fjala "zemër" do të thotë: shpirt dhe mendje, prandaj edhe shprehja "zemra e pastër", do të thotë: shpirti i pastër, në të cilin s'ka as edhe gjurmën më të vogël të idhujtarisë (shirkut), dyshimit dhe degjenerimit.

Kur'àni Famëlartë, disa zemra i ka cilësuar "të ashpra", ashtu siç e lexojmë në ajetin 13 të sures "El Màide": **"Për shkak se ata e thyen premtimin e tyre, Ne i mallkuam ata; edhe zemrat e tyre Ne i bëmë të ashpra; si dhe** (për shkak) **se ata i deformojnë fjalët nga domethënia e tyre, gjithashtu ata nuk i kryen disa punë që ishin urdhëruar…"**.

Herë tjetër, Kur'àni Famëlartë i cilëson zemrat se ato nuk janë të pastra, ashtu siç thuhet në ajetin 41 të sures "El Màide".

Herë tjetër i cilëson ato të sëmura, ashtu siç e lexojmë në ajetin 6 të sures "El Bekare".

Herë tjetër i konsideron me frazën "zemra mbi të cilat është vënë vula e mbylljes", ashtu siç e lexojmë në ajetin 87 të sures "Et Teube".

Përballë këtyre zemrave, Kur'àni Famëlartë vë zemrën e pastër nga të metat e lartpërmendura, zemrën e kulluar, zemrën e shoqërueshme, zemrën e mbushur me ndjenjën e solidaritetit për të tjerët, zemrën e pastër që kurrë nuk shmanget nga rruga e vërtetë; madje kjo zemër e pastër, në disa transmetime është cilësuar "shtëpia e shenjtë e All'llahut", ashtu siç e lexojmë në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Zemra është shtëpia e shenjtë e All'llahut dhe në shtëpinë e shenjtë të All'llahut nuk mund të banojë askush përveç All'llahut."*.[1]

Një zemër e këtillë, ka mundësi të shohë të vërtetat e fshehura dhe kjo zemër e pastër shikon qeniet e larta hyjnore, ashtu siç thuhet në një hadith të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen*

[1] "Bihàrul Enuàr", vëll. 7, f. 25, kapitulli: "Dashuria për All'llahun".

e tij!): "*Sikur djajtë të mos ndiznin zjarr në zemrat e njerëzve, me siguri që njerëzit do të shihnin qeniet hyjnore.*".[1]

Këtu duhet theksuar se "zemra e pastër është kapitali më i mirë për të shpëtuar Ditën e Kiametit". Me zemrën e pastër, Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u bashkua me qeniet hyjnore të Zotit të tij dhe me zemrën e tij të pastër, ai mori në dorëzim kumtin hyjnor.

Këtë studim, po e mbyllim me një transmetim tjetër, në të cilin lexojmë: "All'llahu i Lartësuar ka vënë në robtë e Tij një enë dhe kjo enë është zemra, ai e ka pastruar atë, e ka forcuar dhe e ka zbutur, e ka bërë të fortë si çeliku në punët e fesë së All'llahut, e ka pastruar prej fajeve dhe ka bërë që ajo të jetë e butë ndaj vëllezërve.".[2]

[1] Burimi i sipërm, f. 59, kapitulli: "Zemra dhe përmirësimi i saj".
[2] Burimi i sipërm, f. 56, kapitulli: "Zemra dhe përmirësimi i saj".

Ajetet: 95 – 100

قَالَ أَتَعۡبُدُونَ مَا تَنۡحِتُونَ ﴿٩٥﴾ وَٱللَّهُ خَلَقَكُمۡ وَمَا تَعۡمَلُونَ ﴿٩٦﴾ قَالُواْ
ٱبۡنُواْ لَهُۥ بُنۡيَٰنٗا فَأَلۡقُوهُ فِي ٱلۡجَحِيمِ ﴿٩٧﴾ فَأَرَادُواْ بِهِۦ كَيۡدٗا فَجَعَلۡنَٰهُمُ
ٱلۡأَسۡفَلِينَ ﴿٩٨﴾ وَقَالَ إِنِّي ذَاهِبٌ إِلَىٰ رَبِّي سَيَهۡدِينِ ﴿٩٩﴾ رَبِّ هَبۡ لِي مِنَ
ٱلصَّٰلِحِينَ ﴿١٠٠﴾

"Ai (Ibrahimi) **tha: qysh adhuroni ato që i keni gdhendur vetë?!"**

"All'llahu ju ka krijuar ju dhe ato që ju vetë i punoni."

"Ata (idhujtarët) **thanë: ndërtoni një ndërtesë dhe prej saj flakeni atë** (Ibrahimin) **në zjarr."**

"Ata (idhujtarët) **kurdisën kundër tij** (Ibrahimit) **një kurth, porse Ne i mposhtën ata të përçmuar."**

"Ai (Ibrahimi) **tha: unë po shkoj te Zoti im, Ai do të më udhëzojë në Rrugën e Drejtë."**

"Zoti im, më dhuro mua një (fëmijë) **prej** (njerëzve) **të mirëve."**

Komentimi

Prishja e planeve të idhujtarëve

Pasi Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* shkatërroi idhujt, ai u thirr në gjykatë me këtë akuzë. Në gjykatë, ai u pyet dhe iu kërkua të përgjigjej se cila ishte dora që bëri këtë batërdi në tempullin e tyre. Kur'àni Famëlartë e shpjegon ngjarjen e thyerjes së idhujve me hollësi në suren "El Enbijà", kurse në ajetet objekt studimi, Kur'àni Famëlartë na njofton vetëm njërën anë prej qëndrimeve të Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe shpjegon se fjala e fundit që ai u tha atyre idhujtarëve ishte: adhurimi që ju u bëni idhujve, është besim shumë i gabuar e dëmtues, ashtu siç e lexojmë këtë në ajetin e parë të këtij grupi ajetesh: **"Ai** (Ibrahimi) **tha: qysh adhuroni ato që i keni gdhendur vetë?!"**.

A ka këtu ndonjë burrë që të adhurojë për zot diçka që ai e ka gdhendur me duart e veta? Cili është motivi që e shtyn çdo njeri me ndjenja të madhërojë një send të cilin ai e ka punuar vetë? Cila mendje e cila logjikë lejon të bëhet një veprim i këtillë?!

I adhuruari patjetër duhet të jetë vetëm Krijuesi i njeriut dhe jo të jetë i punuar prej duarve të njeriut, qysh tani mendoni dhe dijeni se i adhuruari juaj i vërtetë është:

"All'llahu ju ka krijuar ju dhe ato që ju punoni.".

Ai është Krijuesi i Tokës e i Qiellit, është Sunduesi i kohës dhe i hapësirës, prandaj duhet madhëruar e adhuruar vetëm ky Krijues.

Ky argument ishte aq i qartë e aq i fuqishëm, sa i bëri idhujtarët të kuptojnë se ishin gënjeshtarë dhe nuk kishin fuqi as t'i përgjigjeshin e as ta hidhnin poshtë këtë argument.

Parafjala *"mà"* – *"çka"* në shprehjen e ajetit *"mà ta'melùne"* – **"ato që ju vetë i punoni"** është parafjalë lidhëse dhe nuk është rrënjë foljeje, prandaj, qëllimi me këtë parafjalë është që të thuhet: All'llahu ju ka krijuar, All'llahu ka krijuar edhe ato materiale që ju i punoni me duart tuaja dhe kur thuhet se idhujt janë sende të punuara, ose janë punë e njeriut, kjo do të thotë se njeriu u ka dhënë idhujve formën dhe vetëm kaq, pasi edhe lënda nga e cila janë punuar idhujt, është prej krijesave të All'llahut.

Është e vërtetë që, në gjuhën e përditshme, thuhet se kjo sexhade, kjo shtëpi, ose kjo makinë, të gjitha këto janë punuar prej njeriut, por qëllimi me këtë pohim nuk është se ishte njeriu ai që krijoi lëndët e para me të cilat punohen këto sende; jo, në të vërtetë, njeriu vetëm u dha një formë të caktuar këtyre lëndëve të para.

Por, nëse parafjalën *"mà"* – *"çka"* sipas rregullave të gramatikës së gjuhës arabe e konsiderojmë rrënjë foljeje, atëherë kuptimi i ajetit është: "me të vërtetë All'llahu ju ka krijuar ju dhe punët tuaja".

Natyrisht që edhe kuptimi i dytë as nuk është gabim e as nuk është ashtu siç mendojnë disa se në atë ka argument që vërteton se njeriu është i imponuar. Është e vërtetë se punët që ne

bëjmë i plotësojmë me vullnetin tonë, por vullneti, aftësia planifikuese dhe të tjera kapacitete në saje të cilave ne realizojmë punët tona, të gjitha këto i kemi prej All'llahut të Lartësuar dhe nga ky këndvështrim, ajeti nuk ka qëllim punët që bën njeriu, por qëllimi i ajetit janë vetëm idhujt dhe prandaj thotë: All'llahu ju krijoi ju, si edhe idhujt që ju i gdhendni e i skalitni dhe e bukura e kësaj bisede këtu konkretizohet në faktin që studimi është specifik, për të vënë theksin mbi idhujt dhe jo që të tregojë punët që bëjnë njerëzit.

Në vërtetë, tema e këtij ajeti është e ngjashme me temën që trajtohet në ajetin 117 të sures "El A'ràf" në lidhje me Mùsànë e magjistarët: **"…dhe ja ai** (shkopi) **menjëherë gëlltiti ato** (magjitë) **që ata sajuan"**; në këtë ajet, qëllimi me përemrin **"ato"** janë magjitë që magjistarët përgatitën me anë të litarëve që lëshuan për tokë, por që, në saje të magjisë, litarët u dukeshin njerëzve si gjarpërinj që lëviznin.

Dihet se, despotët e mizorët nuk e kuptojnë gjuhën e logjikës dhe argumentin, prandaj edhe argumentet aq të qarta e aq të fuqishme që atyre u shtroi Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* nuk ndikuan aaspak në zemrat e sundimtarëve tiranë të Babilit të asaj kohe, por në grupe të bijve të popullit të thjeshtë, fjalët e tij patën ndikim të fuqishëm, i zgjuan ata prej gjumit të shkujdesjes dhe ata besuan në thirrjen e Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Për të ndaluar përhapjen e logjikës së Njëtimit të All'llahut në mesin e popullatës së Babilit, tiranët shtypës e ndjenë rrezikun e përhapjes së kësaj logjike dhe e kuptuan se ishte kundër interesave të tyre private, prandaj ata përdorën logjikën e forcës e

të zjarrit kundër Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Tiranët nuk kuptonin logjikë tjetër veç shtypjes e dhunës së hapur, ata mbështeteshin në fuqinë e tyre që kishin në këtë botë dhe e pritën me brohoritje frenetike vendimin për të ndërtuar një ndërtesë të lartë, pastaj në mesin e asaj ndërtese ata ndezën zjarrin dhe e flakën Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* brenda në zjarr, ashtu siç njofton ajeti i nderuar: **"Ata** (idhujtarët) **thanë: ndërtoni një ndërtesë dhe prej saj flakeni atë** (Ibrahimin) **në zjarr."**.

Prej kësaj fraze të ajetit, mësohet se kishin dalë urdhërat për ndërtimin e katër mureve të mëdha dhe pastaj brenda atyre mureve u ndez zjarri. Ndërtimi i atyre mureve të trasha ka mundësi të jetë bërë me qëllim për të penguar përhapjen e zjarrit jashtë mureve dhe për të parandaluar rreziqet e mundshme që mund të vinin nga përhapja e zjarrit; njëkohësisht, me këtë mënyrë, ata mendonin se kanë ndërtuar një Xhehennem konkret si Xhehennemi me të cilin i kërcënonte e i frikësonte adhuruesit e idhujve Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Natyrisht që për të djegur një njeri, ishte e mjaftueshme të mblidhej një sasi e vogël lënde drusore, por ata e ndërtuan atë "furrë" të madhe me qëllim që, me flakët e mëdha të atij zjarri, të shuanin zemërimin që u ishte shkaktuar në zemrat e tyre prej shkatërimit të idhujve; me fjalë të tjera, ata kishin qëllim të hakmerreshin kundër Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* me mënyrën më të egër të mundshme. Veç kësaj, këtë mënyrë barbare dënimi, ata e zbatonin me qëllim që një ngjarje e këtillë të mos përsëritej herë tjetër në historinë e Babilit dhe për këtë qëllim, ata ndezën një zjarr shumë të madh.

Fjala *"el xhehijm"*, nga ana gjuhësore do të thotë: zjarri mbi zjarr.

Disa, fjalën *"bun'jàn"* – *"ndërtesë"* e kanë komentuar në kuptimin e katapultës, që, siç dihet, ishte një mjet për hedhjen e sendeve të rënda në largësi të mëdha, por shumica e interpretuesve të Kur'ànit kanë parapëlqyer interpretimin e parë, domethënë se fjala e ajetit *"bun'jàn"* – *"ndërtesë"* shpreh pikërisht atë ndërtesën me katër mure të mëdha, që ata ndërtuan për të ndezur në të zjarrin ku do të hidhnin Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Në ajetet e sures "El Enbijà" të Kur'ànit Famëlartë, shpjegohen hollësi të imta të asaj ngjarjeje dhe përfundimin e asaj ngjarjeje, ajeti vijues i këtij grupi ajetesh e njofton në mënyrë të përmbledhur me një frazë shumë domethënëse: **"Ata** (idhujtarët) **kurdisën kundër tij** (Ibrahimit) **një kurth, porse Ne i mposhtën ata të përçmuar."**.

Fjala *"kejden"*, në rrënjën e saj do të thotë: *"dinakëri, mashtrim"*, qoftë kur mashtrimi është me qëllim, qoftë kur mashtrimi është gabimisht; por, sido që të jetë, kjo fjalë, në shumicën e rasteve përdoret për të treguar poshtërimin dhe meqenëse në këtë ajet kjo fjalë ka ardhur e pashquar, kjo tregon sa i madh e sa i rrezikshëm ishte kurthi që ata kurdisën. Thënë ndryshe: prej kësaj fjale mësohet plani i gjerë që kishin bërë tiranët shtypës të Babilit me qëllim që të zhduknin një herë e mirë thirrjen që Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u kishte drejtuar njerëzve me fjalën e me punën e tij. Prandaj, me këtë plan, ata synonin të zhduknin çdo gjurmë të kësaj thirrjeje.

Po, All'llahu i Lartësuar ata i ka vënë të përçmuar, në fundin e të poshtëruarve, ndërsa Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e ngriti në lartësitë më të mëdha të shpirtrave të pastër. Ai (Ibrahimi) ishte i pajisur me logjikën më të lartë. Me flakjen e tij në zjarr, All'llahu e bëri atë më të lartin në mesin e asaj shoqërie të degjeneruar, kurse armiqtë e tij të fuqishëm, All'llahu i Lartësuar i bëri të pësojnë humbjen më të rëndë. Zjarri për Ibrahimin, u bë vendi ku ai gjeti fresk, shpëtim e qetësi. Në atë zjarr atij nuk iu dogj as edhe një fije floku dhe ai doli shëndoshë e mirë prej atij deti zjarri të përmasave të mëdha.

Vullneti i All'llahut ishte që një ditë të shpëtonte prej mbytjes në ujë Nùhun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe një ditë tjetër All'llahu kishte vendosur të shpëtonte prej djegies në zjarr Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Me këtë, All'llahu i Lartësuar bënte të qartë për të gjithë se edhe uji e zjarri janë dy robër të bindur të të Gjithëfuqishmit dhe menjëherë zbatojnë urdhërin e Tij.

Ishte vullneti i All'llahut të Lartësuar, që Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të shpëtonte prej asaj ngjarjeje makabre e prej atij komploti të rrezikshëm që kishin kurdisur armiqtë kundër tij, por ai doli me kokën lart prej zjarrit dhe plotësisht i vendosur që të emigronte në tokat e Shamit, pasi misioni i tij në Babil tanimë kishte përfunduar dhe për këtë, ajeti vijues njofton: **"Ai** (Ibrahimi) **tha: unë po shkoj te Zoti im, Ai do të më udhëzojë në Rrugën e Drejtë."**.

Është shumë interesant fakti që, All'llahu i Lartësuar, nuk i caktoi atij ndonjë vend ku të shkonte, por emigrimi që bëhet në rrugën e Tij me qëllim për t'u larguar prej shoqërisë së shthurur e

të ndotur me ndyrësinë e idhujtarisë dhe për të shkuar në një shoqëri të pastër, patjetër që është emigrim për të shkuar te All'llahu i Lartësuar.

Emigrimi në tokën ku kanë jetuar Profetët, që janë njerëzit e zgjedhur të All'llahut, emigrimi në vendin ku është zbritur Shpallja e All'llahut, pa dyshim që është emigrim te All'llahu i Lartësuar, ashtu siç është udhëtimi për në Mekën e nderuar udhëtim për te All'llahu i Lartësuar. Emigrimi i Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kishte qëllim për të vënë në zbatim një detyrë të kumtit hyjnor, duke shtuar se All'llahu i Lartësuar ishte Udhëzuesi e Drejtuesi i tij gjatë atij udhëtimi.

Në ajetin e fundit të këtij grupi ajetesh, gjen pasqyrim edhe kërkesa që Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i drejton të Gjithëfuqishmit. Ai i kërkon Atij t'i japë një djalë të mirë, një djalë që të kishte mundësi të vazhdonte linjën e kumtit të tij dhe të plotësonte atë çka kishte mbetur prej rrugëtimit të tij dhe ajeti njofton: **"Zoti im, më dhuro mua një** (fëmijë) **prej** (njerëzve) **të mirë."**.

Sa shprehje e lartë, ai kërkon një djalë që të ishte i merituar për atë, djalë të mirë nga ana e besimit, djalë të mirë nga ana e fjalëve dhe e punëve, i kërkonte All'llahut të Lartësuar një djalë të mirë nga të gjitha anët!

Këtu duhet theksuar se Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* më përpara kishte kërkuar prej All'llahut të Lartësuar që ta bënte atë prej njerëzve të mirë, ashtu siç e lexojmë këtë kërkesë të tij në ajetin 83 të sures "Esh Shuaràu": **"Zoti im, dhuro për mua urtësi dhe më bashko me të mirët."**.

Kësaj here, ai kërkon prej All'llahut të Lartësuar t'i dhurojë atij një djalë të mirë. Fjala **"i mirë"**, ka në vetvete gjithçka që është e mirë dhe e merituesshme në njeriun e plotësuar.

All'llahu i Lartësuar iu përgjegj lutjes së Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe me bujarinë e Tij, i dhuroi atij dy djem të mirë, i dhuroi Ismailin e Is'hàkun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)* ashtu siç do ta shikojnë në ajetin 112 të sures që kemi në studim, sures "Es Saf'fàt": **"Dhe Ne e përgëzuam atë** (Ibrahimin) **me Is'hàkun, Profet prej të mirëve."**.

Kurse në lidhje me Ismailin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* Kur'àni Famëlartë njofton në lidhje me këtë Profet e të Dërguar të lartë në ajetet 85-86 të sures "El Enbijà": **"Dhe Ismaili, Idrijsi e Dhulkifli, çdonjëri prej tyre ishte prej të durueshmëve. Ata Ne i përfshimë në mëshirën Tonë, ata me të vërtetë ishin prej të mirëve."**.

Dy hulumtime

1- Krijuesi i çdo sendi

Në ajetet objekt studimi, pamë se Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u foli adhuruesve të idhujve me këto fjalë: **"All'llahu ju ka krijuar ju dhe ato që ju vetë i punoni."**.

Disa kanë mëtuar, pa të drejtë, se këto ajete tregojnë atë që thuhet në shkollën e gabuar juridike të imponimit (el xheberij'jeh), pasi ata parafjalën *"mà"* – *"ato që"* në shprehjen *"mà ta'melùne"* –

“ato që ju vetë i punoni” e kanë konsideruar rrënjë foljeje, prandaj kanë thënë që ky ajet është në kuptimin: All’llahu i Lartësuar ju ka krijuar ju dhe punët tuaja dhe meqenëse punët tona janë prej krijesave të All’llahut, përzgjedhja nuk është në dorën tonë dhe kjo do të thotë se ne jemi të imponuar.

Patjetër që kjo thënie nuk ka asnjë bazë të vërtetë, për disa shkaqe:

E para: Siç kemi thënë më sipër, qëllimi me shprehjen *“mà ta’melùne”* – *“ato që ju vetë i punoni”* këtu është për idhujt që ata i punonin me duart e tyre dhe nuk është qëllimi për punët që bën njeriu. Pa dyshim që ata idhujtarë, materialet me të cilat punonin idhujt, i merrnin prej kësaj Toke, të cilën e ka krijuar All’llahu i Lartësuar; me ato materiale i gdhendnin e i skalitnin deri sa u jepnin formën që atyre u pëlqente, prandaj parafjala *“mà”*, është lidhëse dhe nuk është rrënjë foljeje.

E dyta: Nëse kuptimi i ajetit është ashtu siç e mendojnë ata, atëherë ajeti është argument në të mirë të adhuruesve të idhujve dhe jo kundër tyre, sepse ata, sipas këtij mëtimi të gabuar, kanë mundësi të thonë: punimi i idhujve dhe adhurimi kushtuar idhujve, janë prej krijesave të All’llahut, prandaj, në një gjendje të këtillë, ne nuk jemi fajtorë.

E treta: Nëse hamendsojmë se kuptimi i ajetit është ashtu siç mëtojnë ithtarët e shkollës së “imponimit të njeriut”, këtu s’ka asnjë argument që vërteton imponimin, sepse punimi i idhujve dhe adhurimi i tyre, shkojnë krah për krah me lirinë, vullnetin dhe përzgjedhjen vetiake. Sigurisht, All’llahu i Lartësuar është Krijuesi i punëve tona, por këtë liri, këtë vullnet dhe këtë fuqi për

të bërë projekte, gjithashtu dhe të gjitha fuqitë trupore, mendore, materiale e morale, të gjitha këto ne nuk na i ka dhënë askush tjetër përveç All'llahut. Atëherë rezulton se Krijuesi është vetëm All'llahu, kurse puna është me përzgjedhjen tonë vetiake.

2- Emigrimi i Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*

Shumë Profetë *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)* kanë emigruar gjatë jetës së tyre, për të kryer misionin e ngarkuar. Ndër ata është edhe Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, historia e të cilit është shpalosur në ajete të ndryshme të Kur'ànit Famëlartë që flasin për emigrimin e tij, si, për shembull, ashtu siç ka ardhur në ajetin 26 të sures "El Ankebùt": **"... dhe ai** (Ibrahimi) **tha: unë do të emigroj për te Zoti im, me të vërtetë Ai është i Gjithëfuqishmi, i Urti."**.

Miqtë e zgjedhur të All'llahut të Lartësuar, kanë dëshiruar që misionin e ngarkuar ta kryenin në zonën ku ata jetonin, por kur ata e shihnin se shoqëria në të cilën ata ishin ngarkuar me detyrën e profetnisë nuk e pranonte kumtin që ata kumtonin, atëherë ata emigronin, me qëllim që të mos mbetej pa u kumtuar kumti me të cilin ata ishin ngarkuar të kumtonin.

Ky emigrim i Profetëve, ishte burim i begative të shumta përgjatë gjithë historisë së feve, madje edhe në historinë e Islamit, emigrimi, qoftë emigrimi faktik, qoftë nga ana morale, ka si bosht rrotullimi emigrimin e Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*. Sikur të mos kishte ndodhur emigrimi, Islami me siguri do të ishte mbytur një herë e përgjithmonë në moçalin e adhuruesve të idhujve në Mekë, por

emigrimi u dha Islamit e myslimanëve një frymëmarrje të re. Emigrimi e ndryshoi çdo gjë në interes të Islamit e të myslimanëve, njëkohësisht vijëzoi për mbarë Njerëzimin një rrugë të re e të drejtë, në të cilën është detyrë të ecet.

Me fjalë të tjera, emigrimi është një program i përgjithshëm për çdo besimtar, kur ai e sheh se mjedisi ku ai jeton nuk është i përshtatshëm për zbatimin e qëllimeve të tij të shenjta, kur e sheh se mjedisi ku ai jeton është bërë një moçal me ujë të ndenjur, që bie erë të keqe dhe prish çdo gjë që është në atë mjedis; në këto kushte, emigrimi është detyrim për çdo besimtar; çdo besimtar ka detyrë të bëjë gati valixhet dhe menjëherë të niset për udhëtim, me qëllim që të vendoset në një vend tjetër më të mirë, sepse ai e di që toka e All'llahut është shumë e gjerë.

Emigrimi, para se të jetë me karakter vetiak të jashtëm, është më karakter të brendshëm. Në fillim, patjetër duhet që zemra e shpirti të heqin dorë nga ligësitë dhe të synojnë pastrimin, të heqin dorë përfundimisht prej idhujtarisë dhe të përqafojnë besimin në All'llahun, Zotin Një e të Vetëm dhe në bindje të urdhërave të All'llahut të Madhëruar, të heqin dorë nga mëkatet.

Emigrimi i brendshëm, në fillim ndryshon individin e shoqërinë dhe është parathënia e emigrimit faktik. Kjo temë është trajtuar në mënyrë të hollësishme në këtë tefsir, në paragrafin me temë: "Islami dhe emigrimi", pas ajetit 100 të sures "En Nisà".

Ajetet: 101 – 110

فَبَشَّرْنَٰهُ بِغُلَٰمٍ حَلِيمٍ ﴿١٠١﴾ فَلَمَّا بَلَغَ مَعَهُ ٱلسَّعْىَ قَالَ يَٰبُنَىَّ إِنِّىٓ أَرَىٰ فِى
ٱلْمَنَامِ أَنِّىٓ أَذْبَحُكَ فَٱنظُرْ مَاذَا تَرَىٰ ۚ قَالَ يَٰٓأَبَتِ ٱفْعَلْ مَا تُؤْمَرُ ۖ
سَتَجِدُنِىٓ إِن شَآءَ ٱللَّهُ مِنَ ٱلصَّٰبِرِينَ ﴿١٠٢﴾ فَلَمَّآ أَسْلَمَا وَتَلَّهُۥ لِلْجَبِينِ ﴿١٠٣﴾
وَنَٰدَيْنَٰهُ أَن يَٰٓإِبْرَٰهِيمُ ﴿١٠٤﴾ قَدْ صَدَّقْتَ ٱلرُّءْيَآ ۚ إِنَّا كَذَٰلِكَ نَجْزِى
ٱلْمُحْسِنِينَ ﴿١٠٥﴾ إِنَّ هَٰذَا لَهُوَ ٱلْبَلَٰٓؤُا۟ ٱلْمُبِينُ ﴿١٠٦﴾ وَفَدَيْنَٰهُ بِذِبْحٍ
عَظِيمٍ ﴿١٠٧﴾ وَتَرَكْنَا عَلَيْهِ فِى ٱلْءَاخِرِينَ ﴿١٠٨﴾ سَلَٰمٌ عَلَىٰٓ إِبْرَٰهِيمَ ﴿١٠٩﴾
كَذَٰلِكَ نَجْزِى ٱلْمُحْسِنِينَ ﴿١١٠﴾

"Ne e përgëzuam atë me një djalë të butë (të sjellshëm)**."**

"Dhe kur ai (djali) **arriti moshën e u bë të punojë së bashku me atë** (me Ibrahimin)**, ai** (Ibrahimi) **i tha: o djali im, unë kam parë** (jam urdhëruar) **në ëndërr të të flijoj, si mendon për këtë? Ai** (djali) **tha: o babai im, bëj atë që je urdhëruar dhe mua, me dashjen e All'llahut, do të më gjesh prej durimtarëve."**

“Dhe kur të dy iu dorëzuan urdhërit (të Zotit) **dhe ai e shtriu atë** (djalin) **në brinjë.” “Ne i thirrëm atij; o Ibrahim.”**

“Ti e vërtetove ëndrrën; Ne kështu i shpërblejmë punëmirët.”

“Vërtet kjo ishte një sprovë e qartë.”

“Ne e shpaguam atë me një flijim të madh.”

“Dhe Ne e lamë atë një detyrim për të tjerët.”

“Selàm (paqe e shpëtim) **për Ibrahimin.”**

“Ne kështu i shpërblejmë punëmirët.”

Komentimi

Ibrahimi në vendin e flijimit

Në ajetet e sipërme, pamë si përfundoi emigrimi i Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* prej Babilit, pasi ai e përfundoi -+misionin e tij në atë vend; gjithashtu, pamë edhe kërkesën e tij drejtuar All'llahut të Lartësuar që t'i dhuronte atij një djalë të mirë, pasi deri tani ai nuk kishte fëmijë.

Ajeti i parë i grupit të ajeteve objekt studimi, tregon se kërkesa e Ibrahimit u pranua dhe për këtë, ajeti njofton: **“Ne e përgëzuam atë me një djalë të butë** (të sjellshëm)**.”**.

Në fakt, në këtë ajet janë së bashku tre përgëzime; *i pari:* All'llahu do t'i dhuronte atij një fëmijë mashkull; *i dyti:* ky djalë do të arrinte moshën e adoleshencës; *i treti:* djali do të ishte i butë (i sjellshëm).

Fjala *"halijmin"* do të thotë: ai nuk nxiton të bëjë punën para kohës, megjithëse ka mundësi ta bëjë atë punë; gjithashtu, thuhet se kjo fjalë është në kuptimin: ai nuk nxiton të dënojë, ose është në kuptimin: njeri me shpirt të madh dhe ka nën zotërin ndjenjat e tij.

Kurse Ragibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", thotë se fjala *"halijmin"* është në kuptimin: njeri që e frenon veten në çaste ngacmimi e zemërimi dhe se kjo gjendje lind prej mendjes e inteligjencës; gjithashtu, fjala *"halijmin"*, në disa raste është në kuptimin: mendje dhe inteligjencë.

Gjithësesi, kuptimi i vërtetë i fjalës *"halijmin"*, mbetet kuptimi i parë që u tha më sipër.

Prej këtij përshkrimi, mund të mësohet se All'llahu i Lartësuar e përgëzoi robin e Tij Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* se djalit të tij Ismailit do t'i jepte jetë që i mundësonte të cilësohej i butë; gjithashtu, në ajetet vijuese, do të shpjegohet qartë se Ismaili *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e tregoi qartë shkallën e lartë të butësisë së tij në çështjen e flijimit të tij, ashtu siç e tregoi edhe babai i tij Ibrahimi butësinë e tij gjatë kohës se flakjes së tij në zjarr.

Në Kur'ànin Famëlartë, fjala *"halijmin"* – *"i butë"* përsëritet pesëmbëdhjetë herë dhe në shumicën e herëve, kjo fjalë ka ardhur

si cilësi e All'llahut të Lartësuar, me përjashtim të dy herëve që kjo fjalë në Kur'ànin Famëlartë ka ardhur për të cilësur Ibrahimin dhe djalin e tij Ismailin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Fjala *"halijmun"* – *"i butë"* në Kur'ànin Famëlartë një herë ka ardhur për të cilësuar me fjalën e të tjerëve Shuajbin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Në lidhje me fjalën e ajetit *"gulàm"* – *"djalë"* disa mendojnë se kjo fjalë thuhet për fëmijën që ende nuk ka arritur moshën e rinisë; disa të tjerë kanë thënë se kjo fjalë përdoret për të treguar fëmijën mbi dhjetë vjeç, por që ende nuk ka arritur moshën e pjekurisë seksuale.

Prej shprehjeve të ndryshme që përdoren në të folurën e arabëve, mund të mësohet se fjala *"gulàm"* – *"djalë"* përdoret për të treguar fëmijën mashkull që e kaluar moshën e fëmijërisë, por që ende nuk e ka arritur moshën e rinisë.

Më në fund, lindi edhe fëmija i premtuar për Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në përputhje të plotë me përgëzimin hyjnor. Ibrahimi rrinte me zemër të ngrirë, për shumë vite, në pritje të një djali të mirë dhe kur djali e kaloi moshën e fëmijërisë dhe u bë në moshën kur fëmija quhet djalë, pikërisht këtu Kur'àni Famëlartë thotë: **"Dhe kur ai** (djali) **arriti moshën e u bë të punojë së bashku me atë** (me Ibrahimin)**."**.

Domethënë se djali u rrit dhe u bë në një moshë në të cilën kishte mundësi të punonte së bashku me babanë e tij dhe të ndihmonte babanë në punët që kishte.

Disa të tjerë, kanë thënë se fjala *"es sa'j"* do të thotë: punon për All'llahun dhe bën adhurim. Natyrisht që fjala *"es sa'j"* ka

shumë kuptime dhe ndër këto kuptime është edhe ky kuptim. Por kuptimi i kësaj fjalë nuk reduktohet vetëm me këto kuptime; kurse fjala *"meahù"*, tregon se ai e ndihmonte babanë e vet në punët e jetës.

Një grup interpretuesish të Kur'ànit Famëlartë, kanë thënë se Ismaili ishte në moshën 13 vjeç kur Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)* pa ëndrrën e çuditshme që e linte njeriun pa mend; ajo ëndërr ishte fillimi i një provimi tjetër shumë të vështirë për këtë Profet me pozitë kaq të lartë; ai pa në ëndërr se All'llahu i Lartësuar e urdhëron të flijonte djalin e tij të vetëm dhe t'i priste atij kokën. Ai u zgjua prej gjumit i tmerruar, sepse ai e dinte se ëndrrat që shohin Profetët në gjumë, janë të vërteta dhe nuk janë prej pështpëritjeve të djajve, madje kjo ëndërr atij iu përsërit edhe dy net të tjera dhe kjo ishte një përforcim që tregonte se ky urdhër patjetër duhej zbatuar menjëherë.

Thuhet se nata e parë kur ai e pa atë ëndërr, ishte nata e "tervijes" (haxhilerët e kalojnë atë natë në Minà dhe të nesërmen, pas lindjes së Diellit, shkojnë në Arefat), domethënë nata e datës tetë të muajit Dhul Hixh'xheh. Gjithashu, ai pa të njëjtën ëndërr edhe natën e ditës së Arefes dhe natën e ditës së Kurban Bajramit. Me këtë ëndrrën e fundit, për atë nuk mbeti më asnjë dyshim që ky urdhër ishte prej All'llahut të Lartësuar.

Tani Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* do të kalonte nëpër një provim shumë të rëndë. Ibrahimi kishte dalë me sukses në të gjitha provimet e vështira në të kaluarën, madje kishte dalë me kokën lart, por ky urdhër e detyronte të linte mënjanë ndjenjat e tij prindërore dhe të zbatonte urdhërin e All'llahut për të therur djalin e vet, atë djalë që ai e priste qysh prej një kohë shumë të

gjatë, për më tepër tani që djali ishte rritur e ishte bërë një djalë i fuqishëm.

Në këtë gjendje, Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në radhë të parë mendoi të përgatisë të birin në lidhje me këtë urdhër dhe për këtë, ajeti objekt studimi vazhdon me fjalën që ai i tha të birit: **"Ai** (Ibrahimi) **i tha: o djali im, unë kam parë** (jam urdhëruar) **në ëndërr të të flijoj, si mendon për këtë?"**.

Djali, që ishte kopje origjinale e babait të tij dhe gjatë jetës së tij të shkurtër kishte mësuar në shkollën e babait të vet durimin, qëndrueshmërinë dhe besimin, prandaj e përshëndeti urdhërin hyjnor me zemër të hapur dhe me shpirtmirësi e me fjalë të qarta, fare hapur, i tha babait të tij: **"Ai** (djali) **tha: o babai im, bëj atë që je urdhëruar."**.

Dhe mos mendo fare për punën time, sepse: **"Dhe mua, me dashjen e All'llahut, do të më gjesh prej durimtarëve."**.

Sa të mëdha janë këto fjalë që u shkëmbyen në mes babait e të birit, sa çështje të fshehta e kuptime të thella ka në brendinë e këtyre fjalëve!

Nga njëra anë, babai i shpjegon çështjen e flijimit djalit të tij, që sapo ka mbushur 13 vjet prej jetës së tij, madje i kërkon djalit të japë mendimin e tij në lidhje me këtë urdhër, pasi tani është rritur dhe është bërë njeri i pavarur e me vullnet të lirë.

Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kurrë nuk ka qëllim të mashtrojë djalin e tij dhe t'i thotë atij që të shkojë në sheshin e provimit më të vështirë verbërisht; jo, ai dëshiron që edhe djali të jetë pjesëmarrës, së bashku me babanë e tij, në luftën e madhe

kundër vetes dhe me fjalën e tij ai bëri që edhe djali të shijonte ëmbëlsinë e dorëzimit ndaj urdhërit të All'llahut të Lartësuar dhe të ndjente kënaqësië e këtij dorëzimi, ashtu siç e ndjente ai vetë ëmbëlsinë e zbatimit të urdhërit hyjnor.

Nga një anë tjetër, djali kishte qëllim të forconte vendosmërinë e babait të tij që ai të zbatonte urdhërin që i ishte dhënë, prandaj ai nuk i tha babait: më flijo, por i tha: vepro ashtu siç je urdhëruar se unë i jam dorëzuar këtij urdhëri, duke vënë në konsiderate se ai i drejtohet babait të vet me shprehjen *"jà ebeti"* – **"o babai im"** me këtë shprehje djali i thoshte hapur e qartë babait të vet se kjo çështje nuk e pakësonte kurrë ndjenjën e dashurisë së djalit ndaj babait të tij as edhe një grimcë dhe se urdhëri i All'llahut qëndron mbi çdo gjë.

Nga një anë e tretë, djali, me fjalën e tij tregoi edukatën më të lartë ndaj All'llahut të Lartësuar; me fjalën e tij kuptohet se askush nuk duhet të mbështetet në besimin e tij, ose në vullnetin e në vendosmërinë e tij, por patjetër duhet të mbështetet në vullnetin e në dëshirën e All'llahut të Lartësuar; me fjalë të tjera, çdo njeri, patjetër duhet të kërkojë mbarësinë, ndihmë dhe udhëzim në rrugën e drejtë vetëm prej All'llahut të Lartësuar.

Me këtë mënyrë e kapërcyen babë e bir etapën e parë të këtij provimi të vështirë, me fitore të plotë.

Ç'ndodhi në atë mjedis? Kur'àni Famëlartë nuk jep hollësi rreth zhvillimit të ngjarjes, por përqendrohet vetëm në pikat më të ndjeshme të këtij tregimi mahnitës.

Disa kanë shkruar se Ismaili *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e ndihmoi babanë e tij jo vetëm që të zbatonte këtë urdhër, por me fjalën e tij ai e pakësoi dhimbjen e hidhërimin e babait të tij.

Kur Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e shtriu djalin e tij për tokë për ta therur në mes maleve të zhveshura e të thata, në truallin e quajtur Minà, Ismaili i tha babait të tij:

O babai im, shtrëngoje fort litarin, që të mos më lëvizin as duart e as këmbët kur ti të zbatosh urdhërin hyjnor, sepse kam frikë se nga lëvizja e duarve dhe e këmbëve, do të më pakësohet shpërblimi që do të arrij.

Djali vazhdoi: baba i dashur, mprihe mirë thikën dhe lëvize atë me shpejtësi mbi qafën time, që dhimbja e therjes të jetë e lehtë për mua dhe për ty.

Baba i dashur, para se të më therësh, më zhvish rrobat, që ato të mos përlyhen me gjak, pasi kam frikë se kur do t'i shohë nëna ime të gjakosura, ajo do të humbë durimin.

Pastaj djali shtoi: baba, përcilli nënës sime përshëndetjet e mia me selam dhe në se nuk të pengon ndonjë gjë, jepja asaj rrobat e mia, që mendimet e saj të gëzohen dhe që dhimbjet e saj të qetësohen, sepse ajo do të nuhasë prej rrobave erën e birit të saj dhe sa herë që asaj t'i ngushtohet zemra, ajo do t'i vërë rrobat e mia në gjoksin e saj dhe kështu asaj do t'i lehtësohet zjarri që gjendet në thellësitë e zemrës së saj.

Çastet më të ndjeshme u afruan, urdhëri hyjnor duhej zbatuar dhe kur Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* pa shkallën e lartë të dorëzimit të djalit të tij ndaj urdhërit të

All'llahut, e shtrëngoi pas gjoksit dhe e puthi në fytyrë; në ato çaste qanë të dy, qarje në të cilën dalloheshin qartë ndjenjat njerëzore, njëkohësisht qarja e tyre ishte një parathënie e dashurisë së madhe për të takuar All'llahun e Lartësuar.

Kur'àni Famëlartë e shpjegon këtë punë me një frazë të shkurtër, por të mbushur me kuptime të larta dhe i Larti njofton: **"Dhe kur të dy iu dorëzuan urdhërit** (të Zotit) **dhe ai e shtriu atë** (djalin) **në brinjë."**.[1]

Edhe një herë, Kur'àni Famëlartë e prek këtë çështje në mënyrë shumë të përmbledhur, me qëllim që lexuesi të ketë mundësi të ndjekë këtë tregim me përqendrimin më të madh.

Disa kanë thënë se shprehja e ajetit *"ue tel'lehù lil xhebijni"* - do të thotë: *"ai e shtriu atë (djalin) në brinjë dhe vuri në tokë ballin e djalit"* sipas propozimit të vetë djalit - me qëllim që sytë e babait të mos shikonin fytyrën e të birit dhe kështu te ai do të ndizeshin ndjenjat prindërore, çka do ta ndalonte atë nga zbatimi i urdhërit hyjnor.

Si do që të ishte, Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e përmbysi djalin dhe e kaloi thikën me shpejtësi e me forcë mbi qafën e djalit të vet; ndërkaq, shpirti i babait përjetonte gjendjen e vlimit më të madh; megjithëkëtë, dashuria për All'llahun e Lartësuar ishte gjëja e vetme që e shtynte atë të zbatonte atë urdhër pa asnjë ngurrim.

[1] Fjala *"tel'lehù* në rrënjën e saj *"tel'lun"*, do të thotë vend i ngritur; kurse fraza *"tel'lehù lil xhebijni"*, do të thotë se ai e vuri njërën anë të fytyrës së djalit në tokë, mbi një vend të ngritur.

Por thika e mprehtë nuk la asnjë shenjë mbi qafën e butë të Ismailit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Këtu, Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, mbeti i hutuar dhe e kaloi edhe një herë tjetër thikën mbi qafën e djalit të tij, por thika, ashtu si edhe herën e parë, përsëri nuk la asnjë shenjë.

Po, kur miku i All'llahut, Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i mëshonte thikës për të therur djalin e vet, All'llahu i Gjithëfuqishëm e urdhëronte thikën të mos e therë djalin dhe thika nuk mund të zbatonte urdhër tjetër përveç urdhërit të Krijuesit, të Gjithëfuqishmit.

Në këtë çast, Kur'àni Famëlartë, me një frazë të shkurtër, por me kuptime të thella, i jep fund gjendjes së atij ankthi që po zgjatej shumë dhe njofton: **"Ne i thirrëm atij; o Ibrahim! Ti e vërtetove ëndrrën; Ne kështu i shpërblejmë punëmirët."**.

Ne u japim atyre mbarësinë e suksesit në provim dhe për mikun Tonë Ne e ruajmë djalin e tij të dashur. Patjetër, ai që i dorëzohet plotësisht dhe me të gjithë qenien e tij, urdhërit hyjnor dhe arrin në shkallët më të larta të punës së mirë, është e pamundur që ai të shpërblehet më pak se puna e tij e mirë.

Në vijim, Kur'àni Famëlartë shton: **"Vërtet kjo ishte një sprovë e qartë."**.

Procesi i therjes se djalit të mbarë e të dëgjueshëm me dorën e babait të tij, nuk mund të numërohet sprovë e lehtë në raport me një baba, i cili ka pritur për një kohë të gjatë që All'llahu i Lartësuar t'i dhurojë këtë djalë. Si ka mundësi të mos

ndalojë rrahjet zemra e tij kur ai i mëshonte thikës me forcë për të therur të birin? Por, më shumë se kjo ndjenjë prindërore, ishte dorëzimi i plotë dhe miratimi i tij pa kushte e pa asnjë ngurrim për të zbatuar atë urdhër në të gjitha etapat e procesit të therjes, nga e para deri tek e fundit dhe për këtë, ai jo vetëm që u përgatit shpirtërisht, por bëri gati edhe të gjitha mjetet e duhura për procesin e therjes.

Ajo që të çudit në këtë tregim, është dorëzimi pa kushte i djalit ndaj urdhërit të All'llahut; djali e priti urdhërin e therjes me zemër të hapur, me sigurinë me të cilën e kishte rrethuar butësia hyjnore dhe dorëzimi i plotë para këtij urdhëri.

Në disa transmetime, thuhet se Xhibrijli, gjatë procesit të therjes, u çudit aq shumë, sa thirri me zë të lartë: "All'llahu ekber" "All'llahu ekber" - All'llahu është më i madhi, All'llahu është më i madhi.

Ndërkaq edhe Ismaili *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* thirri me zë të lartë: "Là ilàhe il'lell'llàh, uell'llàhu ekber" - S'ka zot tjetër përveç All'llahut dhe All'llahu është më i madhi.

Pastaj Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* tha: "All'llàhu ekber ue lil'làhil hamd"[1] - All'llahu është më i madhi dhe falënderimi është vetëm për All'llahun.

Këto shprehje janë të ngjashme me tekbiret që ne i këndojmë ditën e Kurban Bajramit.

Dhe që programi i Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të mos mbetej i mangët e të realizohej dëshira e tij e madhe për të

[1] Tefsiri i "Kurtubij'jut" dhe tefsiri "Rùhul Bejàn".

bërë flijim për All'llahun, i Gjithëfuqishmi i dërgoi Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* një dash, që ta flijonte në vend të djalit të tij Ismailit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe që flijimi i një bagëtie të mbetej një urdhër për t'u zbatuar prej brezave të ardhshëm, që edhe ata të marrin pjesë në ritualet e Haxhit dhe të vijnë në tokën ku u bë flijimi për All'llahun (Minà), ashtu siç njofton për këtë ngjarje ajeti vijues: **"Ne e shpaguam atë me një flijim të madh."**.

Por, cili është qëllimi me frazën: **"me një flijim të madh"**? A është qëllim me flijimin nga ana trupore e jashtme? Apo ai flijim ishte shpagim për Ismailin? Apo flijimi i madh ishte për hir të All'llahut dhe në rrugën e All'llahut? Apo ishte nga që këtë kurban ia dërgoi All'llahu i Lartësuar Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*?

Në lidhje me çështjen e atij kurbani, interpretuesit e Kur'ànit Famëlartë kanë thënë shumë fjalë, por nuk ka asnjë ndalues që na pengon të bashkojmë të gjitha fjalët e tyre në qëllimin e lartpërmendur.

Njëri prej argumenteve që vërteton madhështinë e therjes së kurbanit, është shtrirja e madhe që ka marrë ky proces me kalimin e kohës, nga viti në vit, aq sa në ditët tona, për çdo vit, theren më shumë se një milion kurbane, duke pasur qëllim atë "flijimin e madh" dhe për të mbajtur gjallë atë punë me të vërtetë të madhe.

Fjala *"fedejnàhu"* në rrënjën e saj *"el fidàu"*, do të thotë: *bërja e një sendi në vend të një sendi tjetër*, me qëllim largimin e dëmit prej këtij të fundit. Prandaj edhe shuma e parave që jepet për të liruar

robin e luftës, në gjuhën arabe quhet *"fidjetun"* – *"pagesë për shlyerje"*. Gjithashtu, kjo fjalë thuhet edhe për shumën e parave që japin të sëmurët për agjërimin që nuk e agjërojnë muajin e Ramazanit për shkak të sëmundjes.

Në lidhje me mënyrën e arritjes së dashit te Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* shumë interpretues të Kur'ànit Famëlartë janë shprehur se atë dash e solli Xhibrijli. Disa të tjerë kanë thënë se dashi zbriti prej shpateve të maleve të Minàsë. Pavarësisht nga këto fjalë, pa dyshim që dashi arriti te Ibrahimi me urdhërin e All'llahut të Lartësuar.

Për suksesin që realizoi Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në provimin e vështirë, All'llahu i Lartësuar nuk e lavdëroi atë vetëm për atë ditë, por veprimin e tij e bëri të jetë veprim i përjetshën ndër brezat, ashtu siç njofton ajeti vijues: **"Ne e lamë atë një detyrim për të tjerët."**.

Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u bë modeli i mirë që duhet ta ndjekin të gjithë brezat. Ai u bë model për t'u ndjekur prej atyre që janë të pastër. Veprimet e tij u bënë detyrim për kryerjen e Haxhit dhe këto punë të tij do të mbeten të përjetshme, deri në Ditën e Kiametit, sepse Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* është babai i Profetëve të mëdhenj, është babai i ymetit islam dhe i Dërguari i këtij ymeti është burri më i nderuar Muhammed bin Abdullahu *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Për cilësitë e lavdërueshsme me të cilat e kishte dalluar All'llahu i Lartësuar Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* Krijuesi i Gjithëfuqishëm e veçoi atë me përshëndetjen me selam: **"Selàm** (paqe e shpëtim) **për Ibrahimin"** dhe ajeti vijues njofton:

Po, Ne kështu i shpërblejmë punëmirët: **"Ne kështu i shpërblejmë punëmirët"**, shpërblim që është i barabartë me madhësinë e kësaj bote, shpërblim i përjetshëm, në jetë të jetëve, shpërblim që e bëri Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të meritojë përshëndetjen me selam prej All'llahut të Lartësuar.

Këtu duhet theksuar se fraza e ajetit **"Ne kështu i shpërblejmë punëmirët"**, ka ardhur edhe para disa ajeteve të tjera në këtë grup ajetesh, por këtu përmendet për herë të dytë dhe patjetër kjo përsëritje ka një shkak.

Herën e parë mund të jetë për shkak se All'llahu i Lartësuar pohon fitoren e Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në provimin e vështirë dhe e firmosi rezultatin e pranimit të Tij; por kjo në vetvete është shpërblimi më i rëndësishëm që All'llahu i Lartësuar i dha Ibrahimit pastaj vjen çështja e shpagimit me "një flijim të madh" dhe "qëndrimi i emrit e i rrugës që ai hapi në jetë të jetëve", domethënë se rruga që ai hapi me veprimin e tij, do të vazhdojë përgjatë historisë, përfshirë dërgimin e përshëndetjes me selam nga ana e Krijuesit të Lartësuar për Ibrahimin. Prej këtyre ajeteve, mësojmë se All'llahu i Lartësuar i dha tri mirësi robit të Tij Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe këto mirësi i përmblodhi me titullin: ***"Ky është shpërblimi për punëmirët."***.

Hulumtime

1- Cili është i flijuari i All'llahut *(dhebijhull'llàh)*?

Në mesin e interpretuesve të Kur'ànit, ka mendime të ndryshme në lidhje me djalin për të cilin u urdhërua të flijonte Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* është Ismaili, apo ai është Is'hàku dhe që u emërtua me epitetin *"dhebijhull'llàh"* - *"i flijuari i All'llahut"*? Për këtë çështje, ka një diskutim të gjatë dhe një grup prej interpretuesve të Kur'ànit Famëlartë kanë thënë se i "flijuari i All'llahut" është Is'hàku, kurse një grup tjetër kanë thënë se "i flijuari i All'llahut" është Ismaili *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Në ajete të tjera të Kur'ànit Famëlartë, bëhet e qartë se Ismaili *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* është "i flijuari i All'llahut", për shkaqet vijuese:

1- Në ajetin 112 të sures "Es Saffàt" lexojmë: **"Dhe Ne e përgëzuam atë me Is'hakun, Profet prej të mirëve."**.

Kjo frazë e ajetit shpjegon në mënyrën më të mirë se All'llahu i Lartësuar e përgëzoi Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* për lindjen e Is'hàkut, pas ngjarjes së flijimit si rezultat i sakrificave të tij. Prandaj, çështja e flijimit s'ka të bëjë fare me Is'hàkun. Këtu duhet shtuar fakti se, kur All'llahu i Lartësuar përgëzon një njeri me profetninë, kjo do të thotë se ai njeri do të jetojë, prandaj edhe ky fakt vërteton se çështja e flijimit nuk ka lidhje me Is'hàkun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*; veç kësaj, ajetet e sipërme njoftojnë se flijimi ishte i veçantë për një fëmijë që ka arritur moshën të thirret djalë.

2- Në ajetin 71 të sures "Hùd", lexojmë fjalën e të Lartit: **"Ne e përgëzuam atë** (Ibrahimin) **me Is'hàkun dhe pas Is'hàkut me Ja'kùbin."**. Ky ajet shpjegon qartë se Ibrahimi ishte i siguruar që djali i tij Is'hàku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* do të jetonte dhe All'llahu i Lartësuar do t'i dhuronte Is'hakut një djalë me merin Ja'kùb. Kjo do të thotë se Is'haku kurrësesi nuk është i përfshirë në çështjen e flijimit. Mesa duket, ata që thonë se i flijuari është Is'hàku nuk kanë marrë në konsideratë të vërtetën e këtyre ajeteve.

Prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* citohet një hadith i shkallës "besueshëm" (meuthùk), në të cilin lexojmë se ai ka thënë: *"Unë jam biri i dy të flijuarve"* dhe qëllimi me fjalën "dy të flijuarve", i pari është babai i tij Abdullahu, të cilin babai i tij Abdul Mut'talibi kishte taksur ta flijonte me qëllim afrimin te All'llahu i Lartësuar, por që me urdhër të All'llahut flijimi i tij u shpagua duke therur njëqind deve dhe kjo ngjarje është e njohur, kurse "i flijuari" i dytë është Ismaili *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Është vërtetuar se Profeti ynë Muhammedi është prej pasardhësve të Ismailit dhe jo prej pasardhësve të Is'hàkut.[1]

Në lutjen e përcjellë prej Prijësit të besimtarëve, Imamit Ali bin Ebù Tàlib, prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ai ka thënë: *"O Ti që e shpagove Ismailin prej flijimit."*.[2]

Në disa transmetime të tjera, të ardhura prej Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*,

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", fundi i ajetit objekt studimi.
[2] Tefsiri "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 421.

mësojmë se të dy janë pyetur: *"Cili është 'i flijuari i All'llahut'"?* Ata janë përgjigjur: *"Ai është Ismaili (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)."*.

Në një transmetim të cituar prej Imamit Riza *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Sikur All'llahu i Gjithëfuqishëm të bënte një gjë më të respektuar se bagëtia, patjetër që me atë gjë Ai do të shpaguante flijimin e Ismailit."*.[1]

Si përmbledhje, themi: Hadithet e transmetimet e ardhura në lidhje me çështjen se cili është i "flijuari i All'llahut", janë të shumta dhe sikur ne të duam t'i paraqisim të gjitha, patjetër që studimi do të zgjerohej shumë.[2]

Përveç transmetimeve të shumta që janë në harmoni të plotë me ajetet kur'anore, ka edhe transmetime të stisura, në të cilat thuhet se me shprehjen "i flijuari i All'llahut", qëllimi është për Is'hàkun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* por këto transmetime të stisura natyrisht që nuk janë në harmoni as me grupin e parë të transmetimeve të sakta dhe as me kuptimin që shprehin ajetet e Kur'ànit Famëlartë në lidhje me këtë çështje.

Pavarësisht nga sa thuhet, këtu kemi të bëjmë me një çështje të pranuar e të vërtetuar se Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* erdhi në Mekën e nderuar së bashku me nënën e fëmijës, pastaj i la atje nënë e bir; më pas, ky djalë jo vetëm që e ndihmoi babanë e tij në ndërtimin e Qabesë së Shenjtëruar, por, së bashku me babanë e tij, kreu edhe ritualin e rrotullimit rreth Qabesë (tauaf), kreu edhe ecjen nga kodra Safà në kodrën Merveh (sa'jun) dhe ky djalë është Ismaili *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Të gjitha

[1] Burimi i sipërm, f. 422.
[2] Për më shumë informacion, referohu në tefsirin "El Burhàn", vëll. 4, f. 23 dhe në tefsirin "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 42.

këto fakte argumentojnë se "i flijuari" është Ismaili sepse, procesi i flijimit i plotëson të gjitha punët e sipërpërmendura.

Kurse në Teuràtin e tanishëm dhe që njihet me emrin "Dhiata e vjetër", theksohet se "i flijuari" ishte Is'hàku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Qarkullojnë edhe disa transmetime islame të panjohura, që theksojnë se Is'hàku është "i flijuari i All'llahut", por këto transmetime janë ndikuar prej transmetimeve izraelite, të cilat i kanë stisur jehuditë, pasi ata janë prej pasardhësve të Is'àkut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Me këto lloje transmetimesh, jehuditë janë munduar që këtë krenari ta kenë për vete, qoftë edhe me rrugë falsifikimi të fakteve dhe të vërtetave, mjafton që këtë krenari t'ua heqin myslimanëve, sepse Profeti i Islamit, Profeti i mëshirës është prej stërnipërve të Ismailit.

Pa dyshim që ajetet e Kur'ànit për ne janë argumenti më i fuqishëm dhe shpjegojnë qartë se "i flijuari" është Ismaili; gjithësesi, e rëndësishme është që të theksohet se ajo ngjarje është e një rëndësie historike të madhe e të veçantë, pa harruar se Ismaili e Is'hàku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)* janë prej Profetëve të mëdhenj të All'llahut të Lartësuar.

2- A ishte urdhëruar Ibrahimi të therte të birin?

Prej pyetjeve të tjera që shtrohen në këtë studim dhe që qarkullojnë në mesin e interpretuesve të Kur'ànit Famëlartë, janë: a me të vërtetë Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte

urdhëruar të therte të birin, apo ai ishte urdhëruar të zbatonte vetëm veprimet paraprake të procesit të therjes?

Nëse ishte i ngarkuar të therte të birin, atëherë si ka mundësi të anulohet ky vendim hyjnor para zbatimit të procesit të therjes, në një kohë që anulimi para kryerjes së një pune të urdhëruar është i palejueshëm dhe ky rregull është i vërtetuar në shkencën e bazave të jurisprudencës islame (Usùlul-fikh).

Nëse ishte urdhëruar të zbatonte vetëm veprimet paraprake të procesit të therjes, kjo nuk mund të konsiderohet krenari për atë dhe ajo që thuhet se rëndësia e çështjes ka lindur nga që Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* pasi zbatoi këtë urdhër dhe bëri veprimet paraprake të therjes, rrinte në pritje të zbritjes së urdhërit në lidhje me çështjen e therjes së djalit, në të vërtetë kjo tregon se kjo punë ishte një provim i madh për atë. Në fakt, kjo thënie nuk meriton të ketë përgjigje.

Ne besojmë se këto zëra të përhapur, kanë dalë për shkak të mosdallimit në mes të urdhërave provues dhe urdhërave joprovues, ndërsa urdhëri i dalë për Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte urdhër provues. Siç dihet, urdhërat provues nuk kanë lidhje me vullnetin e vërtetë dhe me natyrën e punës, pasi qëllimi me urdhërat provues është që të dalë sheshit masa e gatishmërisë në njeriun e vënë në provë, në raport me bindjen e tij ndaj urdhërave të All'llahut; gjithashtu, njeriu i vënë në provim, s'ka inoformacion për anët e fshehta të punës që urdhërohet të kryejë. Me këtë mënyrë, procesi i anulimit këtu nuk është arritur që të diskutohet saktësia dhe ndodhja e kësaj ngjarjeje para kryerjes së punës.

Biseda që i drejton Krijuesi i Lartësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë robit të Tij Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* pas zbatimit të urdhërit të All'llahut të Lartësuar për flijimin e djalit: **"Ti e vërtetove ëndrrën"**, ëndërr e cila erdhi që të vërtetohej vendosmëria e Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* për të therur të birin e tij të dashur, erdhi për ta përgatitur atë shpirtërisht që të zbatonte atë urdhër dhe sigurisht për të dëshmuar edhe suksesin e tij në këtë provim.

3- Si ka mundësi që ëndrra e Ibrahimit të jetë argument?

Në lidhje me ëndrrën, janë thënë shumë fjalë dhe një pjesë prej këtyre thënieve janë përmendur gjatë komentimit të sures "Jùsuf", pas ajetit të katërt të kësaj sureje.

Por këtu, patjetër duhet pasur parasysh fakti se Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e konsideroi ëndrrën që pa në gjumë argument dhe e mori kriter për punën e tij.

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, është thënë: Ëndrrat e Profetëve është e pamundur të jenë cytje prej djallit dhe se ëndrrat e Profetëve nuk lindin nga reaksioni i forcës së iluzioneve. Në të vërtetë, ëndrrat e Profetëve janë njëra anë e sistemit të profetsisë e të Revelatës.

Thënë ndryshe: Lidhja e Profetëve me Revelatën, herë ndodh që ajo mund të jetë në formën e hedhjes në zemër.

Herë tjetër me anë të shikimit në Revelatën.

Herë tjetër me anë të dëgjimit të valëve zanore dhe marrjen e një urdhëri prej All'llahut të Lartësuar.

Dhe herë të tjera ndodh me anë të ëndrrës, në gjumë.

Me këtë mënyrë, është e pamundur të ndodhë ndonjë gabim ose dyshim në ëndrrën e Profetëve dhe ajo që Profetët shohin në ëndrrën gjatë gjumit, është sikur ta shihnin atë zgjuar.

Gjithashtu, është thënë se në ëndrrën e Ibrahimit ka shembuj krahasues, madje disa prej atyre shembujve janë përsëritur tri net me radhë, çka bëri që te ai të ketë dijeni dhe ndërgjegjësim se urdhëri që ai mori me ëndrrën që pa në gjumë, ishte detyrim hyjnor dhe jo ndonjë gjë tjetër.

Pavarësisht nga sa u tha, të gjitha këto interpretime ka mundësi të jenë të sakta dhe në mes gjithë këtyre interpretimeve nuk ka asnjë kundërthënie; gjithashtu, këto interpretime nuk janë në kundërshtim me kuptimin që shprehin fjalët e ajeteve të Kur'ànit Famëlartë.

4- Shpirti i madh i Ibrahimit nuk ndikohej prej pështpëritjeve të djallit

Pa dyshim që provimi i Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* është provimi më i madh gjatë gjithë historisë dhe qëllimi me këtë provim ishte zbrazja e zemrës së tij prej çdo dashurie tjetër përveç dashurisë për All'llahun e Lartësuar, që zemra e tij të ndriçohej vetëm me dëshirën e flaktë të dashurisë për All'llahun e Lartësuar; por djalli, ashtu siç ka ardhur në disa transmetime, vuri

të gjitha mundësitë e fuqitë që ai ka për të bërë ndonjë gjë, me qëllim që Ibrahimi të mos dilte fitues në provimin e tij.

Djalli, herë shkonte te gruaja e tij Hàxheri dhe i thoshte asaj: A e di ti se ç'ka ndërmend të bëjë Ibrahimi? Ai sot ka ndërmend të therë djalin e tij, Ismailin!

Por Hàxheri i përgjigjej atij: Shko tutje dhe mos fol për një punë që është e pamundur të ndodhë; ai është shumë i mëshirshëm dhe jo më të vrasë djalin e vet. A është e mundur të gjendet në këtë botë një baba që do të therte djalin e tij me dorën e vet?!

Përsëri djalli i vazhdon dërdëllitjet e tij dhe i thotë asaj: Ai mëton se All'llahu e ka urdhëruar të flijojë të birin.

Hàxheri menjëherë i përgjigjet djallit: Meqë All'llahu e ka urdhëruar për këtë, atëherë ai ka detyrim t'i bindet urdhërit të All'llahut dhe këtu s'ka rrugë tjetër përveç kënaqësisë që jep dorëzimi ndaj urdhërit të All'llahut të Lartësuar.

Djalli shkon edhe te djali, që të hedhë dyshimet në zemrën e tij, por djalli përsëri dështoi dhe nuk arriti asnjë lloj rezultati, sepse Ismaili *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte krejtësisht i dorëzuar ndaj këtij urdhëri dhe e miratonte atë urdhër me zemër të hapur.

Më në fund, djalli iu drejtua babait dhe i tha: O Ibrahim, ëndrra që ke parë është ëndërr djallëzore, prandaj ti mos iu bind urdhërit të djallit!

Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e njohu djallin, sepse ai shikonte me dritën e besimit dhe të profetnisë, prandaj i thirri me zë të lartë: Largohu prej këtu, o armik i All'llahut.[1]

Në një hadith tjetër, thuhet se Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në fillim shkoi në "Ma'sheril Haràm" (Muzdelifeh) që të flijonte të birin, por djalli e ndoqi nga prapa, prandaj ai e la atë vend dhe shkoi në vendgjuajtjen e parë të guralecëve (el xhemretul ulà), por përsëri djalli e ndoqi nga prapa dhe këtu Ibrahimi, e gjuajti djallin me shtatë guralecë dhe kur arriti në vendgjuajtjen e dytë të gjuajtjes së guralecëve (el xhemretuth thànijeh), përsëri e pa djallin para tij, prandaj edhe këtu e qëlloi me shtatë guralecë dhe kur arriti në "xhemretul-akabeh" e pa djallin për herë të tretë dhe përsëri e gjuajti me shtatë guralecë; me këtë djalli u hidhërua përgjithmonë për shkak të këtij qëndrimi.[2]

Prej këtij tregimi, del qartë se cytjet e djallit gjatë plotësimit të këtij provimi të madh, qenë të gjithanshme dhe se djalli me pështpëritjet e tij mundohet t'i zërë rrugën njeriut nga anë të shumta, duke marrë ngjyra të ndryshme, prandaj mbetet detyrë e besimtarëve që të kenë aftësi si Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* për të njohur me shpejtësi djallin e mashtrimet e tij, pavarësisht nga forma që djalli mund të marrë që të fshihet prapa asaj forme; gjithashtu, mbetet detyrë e çdo besimtari të mbyllë të gjitha rrugët nga mund të ndikojnë cytjet e djallit mbi atë, madje ta gjuajë djallin edhe me gurë. Sa mësim i madh!

[1] Tefsiri "Rùhul Xhinàn", vëll. 9, f. 326, fundi i ajetit objekt studimi.
[2] Burimi i sipërm.

5- Filozofia e tekbireve që merren në Minà

Dihet se prej veprimeve që kanë ardhur në transmetimet Islame në lidhje me ditën e Kurban Bajramit, janë tekbijret e veçanta, që i përsërisin jo vetëm myslimanët pjesëmarrës në kryerjen e ritualeve të Haxhit pas faljes së namazit, por i përsërisin edhe myslimanët e tjerë, që nuk janë pjesëmarrës në kryerjen e Haxhit, kudo që ndodhen nëpër vendet e tyre. (Haxhijtë në Minà i thonë këto tekbijre duke filluar qysh me namazin e drekës së Bajramit. Po kështu veprojnë edhe myslimanët e tjerë, pas faljes së çdo namazi, derisa të bëhen dhjetë namaze.)

Fjalët e tekbirit që merren me këtë rast, janë:

"All'llàhu ekber, All'llàhu ekber; Là ilà il'lell'llàhu uell'llàhu ekber; All'llàhu ekber ue lil'làhil hamd; All'llàhu ekber alà mà hedànà" – *"All'llahu është më i madhi, All'llahu është më i madhi; S'ka zot tjetër përveç All'llahut dhe All'llahu është më i madhi; All'llahu është më i madhi dhe falënderimi e lavdërimi janë vetëm për All'llahun; All'llahu është më i madhi për atë që na udhëzoi në rrugën e drejtë."*. Kur bëjmë krahasimin në mes kësaj pune dhe asaj që ne përmendëm më sipër, për ne bëhet e qartë e vërteta e këtyre tekbireve, që janë një tubë tekbiresh të thëna prej Xhibrijlit, Ismailit dhe babait të tij, Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*.

Me fjalët të tjera, shprehjet e këtyre tekbireve ngjallin në mendjet e njerëzve fitoren e Ibrahimit dhe të djalit të tij Ismailit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)* në provimin e madh dhe u japin një mësim të gjithë myslimanëve, atyre që ditën e Kurban Bajramit ndodhen në Minà dhe atyre që ndodhen në vendet e tyre.

Në transmetimet islame, shpjegohet qartë përse vendi Minà është quajtur me këtë emër. Në këto transmetime, thuhet se ky emërtim ka të bëjë me ngjarjen kur Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* arriti në këtë vend, pasi kaloi me sukses provimin e vështirë, te ai erdhi Xhibrijli dhe i tha: kërko ç'të duash prej Zotit të botëve dhe ai dëshironte me gjithë zemër prej All'llahut, që Ai ta urdhëronte atë të flijonte një dash në vend të djalit të tij, Ismailit dhe dëshira e tij u realizua.[1]

6- Haxhi është adhurim shumë i rëndësishëm për ndërtimin e njeriut

Në të vërtetë, udhëtimi për të kryer Haxhind, është një udhëtim me rëndësi të madhe dhe pa dyshim që është udhëtim hyjnor, është një fushë e gjerë për ndërtimin e shpirtit dhe është lufta më e madhe që myslimani ndërmerr në rrugën e All'llahut të Lartësuar.

Ritualet e Haxhit shpjegojnë konkretisht dhe qartë se ato janë një adhurim i përzier në mënyrë shumë të thellë me përfytyrimin e luftës në rrugën e All'llahut, që bënë Ibrahimi, djali i tij, Ismaili dhe gruaja e tij, Hàxheri *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*. Sikur ne të mos i kushtojmë rëndësinë e duhur kësaj pike, gjatë njohjes me punët e veçanta të sekreteve të Haxhit, shumë prej ritualeve të Haxhit do të na dukeshin si enigma; prandaj, çelsi i zgjidhjes së këtyre enigmave është marrja parasysh pikërisht e kësaj përzierjeje të thellë.

[1] Tefsiri "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 420.

Kur ne vijmë në vendin e therjes së kurbaneve, në vendin e quajtur Minà, çuditemi dhe pyesim veten: përse theren këto kurbane?! Vallë, a mund të jetë therja e një kafshe njëra seancë prej tërësisë së seancave të adhurimit?!

Por ne, kur kujtojmë zgjedhjen që bëri Ibrahimi, i cili i vuri vetes qëllim të flijonte në rrugën e All'llahut të Lartësuar më të dashurin e të dashurve të tij dhe frutin më të mirë të jetës së tij, Ismailin pikërisht mbi truallin e këtij vendi të quajtur Minà dhe ky veprim që ai kreu pas tij u bë rrugë që ndiqet nën emrin: "therja e kurbaneve" në Minà, vetëm kështu ne e kuptojmë filozofinë e kësaj pune.

Therja e kurbanit tregon kapërcimin e të gjitha gjërave në rrugën e orientimit për te All'llahu i Lartësuar, sepse therja e kurbanit është një dukuri e zbrazjes së zemrës nga të gjitha gjërat, me përjashtim të përmendjes së All'llahut të Lartësuar, prandaj është plotësisht e mundshme të kërkohet edukimi i mjaftueshëm prej kalimeve nëpër vendet ku kryhen ritualet e Haxhit; në ato vende për ne formësohet pamja e flijimit të Ismailit, formësohen moralet dhe edukata e babait dhe e djalit të tij, Ismailit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* gjatë procesit të flijimit dhe pikërisht ajo pamje bën që moralet e njeriut të shndrisin me dritat e veta.[1]

[1] Është për të ardhur keq që rituali i therjes së kurbaneve, në kohën e sotme nuk bëhet ashtu siç kërkohet dhe ashtu siç është detyrë të plotësohet ky ritual; prandaj, bie detyrë mbi dijetarët myslimanë që të punojnë me ngulm për t'i shpëtuar këto rituale me rëndësi kaq të madhe. Në lidhje me këtë çështje dhe në veçanti në lidhje me filozofinë e Haxhit, kemi vënë studime të hollësishme në komentin e ajetit 38 të sure "El Haxh".

Kur ne shkojmë për të bërë gjuajtjen e guralecëve në "xhemeratet" (që janë tri kolona të ndërtuara me gurë dhe mbi të cilat haxhijtë gjuajnë guralecët gjatë kryerjes së ritualeve të Haxhit), ata, në çdo kolonë gjuajnë nga shtatë guralecë, sipas një rituali të veçantë, menjëherë në mendjet tona kalon pyetja: ç'kuptim ka gjuajtja e një sasie të caktuar guralecësh mbi një kolonë guri pa shpirt? Dhe çfarë problemi do të zgjidhë ky veprim?

Por, kur ne kujtojmë se ky proces përfaqëson luftën në rrugën e All'llahut të besimtarit monoteist Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kundër mashtrimeve të djallit, që i doli atij përpara tri herë me radhë në rrugën për ku ai ishte nisur të shkonte, duke shtuar se djalli ishte shumë i vendosur të thyente vendosmërinë e Ibrahimit në sheshin e luftës më të madhe kundër cytjeve e pështpësheve të djallit, i cili sa herë që e shihte djallin e gjuante me gurë, për ne rituali i gjuajtjes së guralecëve në këto tri kolona, bëhet gjithnjë e më shumë i qartë.

Kuptimi i këtij rituali ka të bëjë me faktin se gjatë jetës suaj, jetoni në sheshin e betejës më të madhe në rrugën e All'llahut kundër ngacmimeve të djallit dhe nëse nuk e gjuani këtë djall dhe nëse nuk e largoni djallin prej vetes suaj, asnjëherë nuk do të triumfoni.

Nëse ju prisni që All'llahu i Lartësuar t'ju përfshijë me butësinë e me mëshirën e Tij, ashtu siç përfshiu Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* me butësi e me mëshirë, i përcolli atij përshendetjen e Tij me *selam* dhe e bëri kumtin e tij e kujtimin e tij të përjetshëm në të gjitha botët, detyra juaj është të ecni në gjurmët e këtij Profeti të madh.

Sapo ne arrijmë në "Safà" e në "Merva", shohim njerëzit grupe-grupe të ecin e të vrapojnë ndërmjet këtyre dy kodrave të vogla; njerëzit shkojnë nga njëra kodër në kodrën tjetër dhe këtë punë e përsërisin pa qëllim që të arrijnë ndonjë send material; ata herë ecin me hap të zakonshën dhe herë vrapojnë; natyrisht që ky veprim i çuditshëm i atyre njerëzve në këtë vend, patjetër që ndikon në zemrën e njeriut dhe kjo na bën të pyesim: ç'kuptime përmban kjo punë?

Sikur të kthehemi në atë kohë e të kujtojmë mundimet e asaj gruaje besimtare, Hàxherit, e cila, për të shpëtuar jetën e djalit të saj që ende ushqehej me qumështin e gjirit të nënës së tij Ismailit në atë tokë të thatë dhe të përvëluar nga nxehtësia e diellit, sikur të mendojmë si vraponte ajo nga njëra kodër në tjetrën, duke kthyer kokën herë pas here për të parë të birin që e kishte lënë rrëzë një shkëmbi dhe si shikonte ajo sa në një anë në një anë tjetër në kërkim të ujit për foshnjen e vogël, nëse sjellim në mendje se si All'llahu i Lartësuar i dha asaj burimin e "Zemzemit" nën këmbët e foshnjes së saj, menjëherë rrota e kohës do të na kthehet prapa, për ne do të ngrihet mbulesa që na errësonte mendimin dhe me siguri do të shohim veten në ato çaste të qëndrojmë pranë Hàxherit dhe të marrim pjesë, së bashku me atë, në ecjen e në lodhjen e saj dhe menjëherë do të kuptojmë se, kush nuk ecën e nuk punon në rrugën e All'llahut, nuk arrin asnjë rezultat.

Fare thjesht kemi mundësi të përmbledhim atë që thamë: "është detyrë që Haxhi të shoqërohet me mësimin e këtyre simboleve, në saje të të cilave formësohet kujtimi për Ibrahimin, djalin dhe gruan e tij *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)* hap pas hapi; vetëm kështu, haxhiu arrin të kuptojë filozofinë e Haxhit dhe

vetëm kështu do të shndrisin dritat e ndikimeve morale të Haxhit në shpirtrat e haxhijve. Pa këto kuptime dhe pa këto mësime, Haxhi do të jetë thjesht një lëvore e zhvoshkur dhe asgjë më shumë.

Ajetet: 111 – 113

إِنَّهُۥ مِنْ عِبَادِنَا ٱلْمُؤْمِنِينَ ﴿١١١﴾ وَبَشَّرْنَٰهُ بِإِسْحَٰقَ نَبِيًّا مِّنَ
ٱلصَّٰلِحِينَ ﴿١١٢﴾ وَبَٰرَكْنَا عَلَيْهِ وَعَلَىٰٓ إِسْحَٰقَ ۚ وَمِن ذُرِّيَّتِهِمَا مُحْسِنٌ
وَظَالِمٌ لِّنَفْسِهِۦ مُبِينٌ ﴿١١٣﴾

"Me të vërtetë ai (Ibrahimi) **ishte prej robve Tanë besimtarë."**

"Ne e përgëzuam atë (Ibrahimin) **me Is'hàkun, Profet prej të mirëve."**

"Ne dhuruam bekim për atë (Ibrahimin) **e për Is'hàkun dhe prej pasardhësve të atyre të dyve do të ketë punëmirë dhe të atillë që bëjnë padrejtësi hapur kundër vetes së tyre."**

Komentimi

Ibrahimi, robi besimtar

Në tre ajetet e këtij grupi ajetesh, vazhdohet e plotësohet biseda rreth tregimit të Ibrahimit dhe djalit të tij *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)* dhe në të vërtetë këta tre ajete janë një argument që shpjegon qartë ngjarjet që ndodhën më përpara dhe në të njëjtën kohë, janë rezultat i atyre ngjarjeve.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, e cilëson Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* me cilësinë e robit besimtar dhe ajeti njofton: **"Me të vërtetë ai** (Ibrahimi) **ishte prej robve Tanë besimtarë."**.

Në fakt, ky ajet argumenton atë që kemi thënë më parë; gjithashtu, ky ajet sqaron të vërtetën që mësuam më parë, se besimi i fortë e motivoi Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* që të vërë veten e tij dhe djalin e tij të dashur e të shtrenjtë në gurin e provës së sinqeritetit, duke flijuar djalin për hir të Zotit të tij të Gjithëfuqishëm.

Patjetër, të gjitha këto janë prej frutave e dukurive të besimit. Sa të çuditshme që janë këto dukuri të besimit!

Kjo shprehje i jep përmasat më të mëdha e më përgjithësuese ngjarjes së Ibrahimit e djalit të tij Ismailit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)* dhe i nxjerr ato ngjarje prej përmasës vetiake, njëkohësisht shpjegon qartë se kudo që ai ishte, besimi i tij ishte ndikim, dashuri, sakrificë e falje dhe se Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* parapëlqente vetëm atë që parapëlqente

All'llahu dhe kishte qëllim vetëm atë që dëshironte All'llahu i Lartësuar; po nga kjo del qartë se çdo besimtar ka mundësi të jetë i këtillë.

Në vijim, këto ajete trajtojnë një mirësi tjetër prej mirësive që All'llahu i Lartësuar i dha Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe ajeti njofton: **"Ne e përgëzuam atë** (Ibrahimin) **me Is'hàkun, Profet prej të mirëve."**.

Nëse shikojmë me vëmendje në ajetin që kemi përmendur në fillim të këtyre ngjarjeve: **"Ne e përgëzuam atë** (Ibrahimin) **me një djalë të urtë** (të bindur)**"**, del qartë se këto dy përgëzime kanë lidhje me dy djem dhe se përgëzimi i dytë, në përputhje me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit, rezulton se ajeti flet në mënyrë të veçantë për Is'hàkun. Kurse përgëzimi me **"djalin e butë"**, pa asnjë dyshim tregon për Ismailin. Ata që këmbëngulin dhe thonë se "i flijuari" për hir të All'llahut është Is'hàku, në radhë të parë duhet të dinë se kanë vënë në konsideratë se të dy ajetet flasin për të njëjtën çështje, megjithëse ndryshimi në shprehjet e të dy ajeteve është i dallueshëm dhe fare qartë. Ajeti i parë përgëzon për djalin, kurse ajeti i dytë përgëzon për profetsinë. Pa dyshim, është e qartë se ky kuptim që ata u japin dy përgëzimeve, përjashtohet krejtësisht, për faktin e thjeshtë se këto dy ajete shpjegojnë hapur e qartë se dy përgëzimet kanë lidhje me dy djem.

Fakti se ajeti i dytë përgëzon për profetsinë, zbulon se Is'hàku *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* do të mbetej në jetë dhe do të kryente detyrimet dhe detyrën e profetnisë, prandaj del qartë se kjo e vërtetë nuk ka të bëjë fare me çështjen e flijimit.

Edhe një herë do të shikojmë pozitën e njerëzve të mirë, kur shikojmë se ajeti i nderuar e cilëson Is'hàkun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* se ai patjetër do të bëhet Profet dhe se do të jetë prej njerëzve të mirë; por sa e lartë është kjo pozitë e njerëzve të mirë te All'llahu i Gjithëfuqishëm?

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve objekt studimi, në frazën e tij të parë, flet për bekimin që All'llahu i Lartësuar ka zbritur mbi Ibrahimin dhe mbi djalin e tij Is'hàkun: **"Ne dhuruam bekim për atë** (Ibrahimin) **e për Is'hàkun."**.

Bekim, por për çfarë gjëje? Në lidhje me këtë çështje, s'ka ardhur asnjë shpjegim; por dihet se kur folja, sipas rregullave të gjuhës arabe, vjen e pakushtëzuar me ndonjë kusht, kjo i jep shprehjes një kuptim përgjithësues dhe me këtë kuptim, bekimi përfshin të gjitha sendet në jetë, në brezat e ardhshëm, në histori, në kumtin hyjnor dhe në të gjitha punët e sendet.

Fjala *"bereketun"* në rrënjën e saj *"berkun"*, ka kuptimin e gjoksit të devesë, e cila, kur ulet, vë në tokë gjoksin e saj dhe kjo sjellje e devesë, në gjuhën arabe shprehet me këtë fjalë.

Gradualiasht, kësaj fjale i është dhënë kuptimi: *send që mbetet, send që do të jetë i qëndrueshëm.* Ky është edhe shkaku që kjo fjalë është përdorur në këtë ajet, ku tregohet se bekimi e begatia do të jenë të qëndrueshme, njëkohësisht edhe mirësitë që vijnë prej këtij bekimi do të jenë të qëndrueshmne dhe të bekuara.

Prej këtij ajeti, kuptohet qartë se mirësitë e All'llahut për Ibrahimin dhe për djalin e tij Is'hàkun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)* do të jenë të qëndrueshme për ata dhe për familjen e tyre dhe njëri prej bekimeve është mirësia e madhe që bëri

All'llahu për Ibrahimin e për Is'hàkun është se të gjithë Profetët e Beni Israilëve janë prej pasardhësve të Is'hàkut, kurse Profeti i madh i Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* është prej pasardhësve të Ismailit.

Është e qartë se ky bekim dhe këto mirësi, nuk përfshijnë të gjithë individët e familjes së Ibrahimit dhe as të gjithë pjesëtarët e fisit së tyre; në të vërtetë, në atë bekim prej atyre përfshihen vetëm besimtarët punëmirë, ashtu siç njoftohen në frazën e fundit të këtij ajeti: **"…dhe prej pasardhësve të atyre të dyve do të ketë punëmirë dhe të atillë që bëjnë padrejtësi hapur kundër vetes së tyre."**.

Fjala *"muhsinun"* këtu ka ardhur në kuptimin e besimtarit të bindur ndaj All'llahut të Lartësuar dhe a mund të mendohet se ka punë më të mirë e më të lartë se bindja ndaj urdhërave të All'llahut të Lartësuar?

Kurse fjala *"dhàlimun"* – *"i padrejti"*, këtu ka ardhur në kuptimin e mohuesit e të fajtorit.

Kurse shprehja *"li nefsihi"* – *"për veten e tij"* tregon se mohimi dhe fajet, në radhë të parë numërohen padrejtësi kundër vetes, pasi padrejtësia ndaj vetes duke mohuar është e qartë dhe shihet nga vetë njeriu.

Ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh, u jep përgjigje jehudive e të krishterëve, të cilët krenohen se rrjedhin prej bijve të Profetëve dhe për këtë ajeti u thotë atyre: vetëm lidhjet e afërsisë nuk janë motiv për krenari, nëse ato nuk janë të shoqëruara me lidhjen në mendim dhe në konsekuencën ndaj kumtit hyjnor.

Si dëshmi për këtë fjalë, kemi hadithin e ardhur prej Profetit tonë Muhammedit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* kur u fliste njerëzve të fisit të tij Beni Hàshim, ai u thoshte atyre: "*Njerëzit nuk vijnë tek unë me punët e tyre, kurse ju vini tek unë me prejardhjen tuaj"*, domethënë: njerëzit janë të lidhur me mua me kumtin që unë kumtoj, kurse ju me mua jeni të lidhur trupërish.t[1]

[1] Tefsiri "Rùhul Bejàn", vëll. 7. F, 479.

Ajetet: 114 – 122

وَلَقَدْ مَنَنَّا عَلَىٰ مُوسَىٰ وَهَٰرُونَ ﴿١١٤﴾ وَنَجَّيْنَٰهُمَا وَقَوْمَهُمَا مِنَ
ٱلْكَرْبِ ٱلْعَظِيمِ ﴿١١٥﴾ وَنَصَرْنَٰهُمْ فَكَانُوا۟ هُمُ ٱلْغَٰلِبِينَ ﴿١١٦﴾ وَءَاتَيْنَٰهُمَا
ٱلْكِتَٰبَ ٱلْمُسْتَبِينَ ﴿١١٧﴾ وَهَدَيْنَٰهُمَا ٱلصِّرَٰطَ ٱلْمُسْتَقِيمَ ﴿١١٨﴾ وَتَرَكْنَا
عَلَيْهِمَا فِى ٱلْءَاخِرِينَ ﴿١١٩﴾ سَلَٰمٌ عَلَىٰ مُوسَىٰ وَهَٰرُونَ ﴿١٢٠﴾ إِنَّا
كَذَٰلِكَ نَجْزِى ٱلْمُحْسِنِينَ ﴿١٢١﴾ إِنَّهُمَا مِنْ عِبَادِنَا ٱلْمُؤْمِنِينَ
﴿١٢٢﴾

“Ne derdhëm mirësitë Tona mbi Mùsànë dhe Hàrùnin.”

“Ne i shpëtuan ata të dy dhe popullin e tyre prej mjerimit të madh.”

“Ne i ndihmuam ata dhe ata ngadhënjyen.”

“Atyre të dyve Ne u dhamë librin e përsosur e të qartë.”

“Ata të dy Ne i udhëzuam në Rrugën e Drejtë.”

“Kujtimin e tyre Ne e kemi lënë në ata që do të vijnë më vonë.”

"Selam (paqe e shpëtim) **për Mùsànë e Hàrùnin."**

"Ne kështu i shpërblejmë punëmirët."

"Me të vërtetë ata të dy ishin prej robve Tanë besimtarë."

Komentimi

Mirësitë që u dha All'llahu Mùsait e Hàrùnit

Ky grup ajetesh të nderuar, tregon njërën anë të mirësive hyjnore që All'llahu i Lartësuar derdhi mbi Mùsànë dhe vëllanë e tij Hàrùnin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)*. Edhe studimi mbi këto ajete, është i ngjashëm me studimet që pamë në ajetet e përparme në lidhje me Nùhun e Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)*. Është normale që ajetet e Kur'ànit Famëlartë kanë ngjashmëri njëri me tjetrin, madje të njëjtat fjalë përsëriten në disa ajete, me qëllim që për besimtarët të dalë një sistem edukues i harmonizuar.

Edhe në këto ajete, është përdorur mënyra përgjithësuese dhe mënyra shkoqitëse, mënyrë të cilën Kur'àni Famëlartë e përdor në rastin e tregimit të ndodhive.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, e vë theksin mbi fjalën e të Lartit: **"Ne derdhëm mirësitë Tona mbi Mùsànë dhe Hàrùnin."**.

Fjala *"menen'nà"*, në rrënjën e saj *"el men'netu"*, e cila në origjinë është marrë prej fjalës *"el men'nu"*, do të thotë: "*guri që*

përdoret për peshim". Më pas, kjo fjalë është përdorur për të treguar mirësitë e mëdha e të rëndësishme. Kur kjo fjalë tregon një anë praktike konkrete, atëherë "dhënia" është veprim i bukur e i lavdëruar; kur dhënia reduktohet vetëm në fjalët, atëherë është negative dhe e dënueshme. Në shumicën e rasteve, kjo fjalë përdoret në dialogjet zakonore në kuptimin e dytë. Ky është edhe shkaku që, për këto ajete të nderuara mëtohet kuptimi negativ, por patjetër duhet thënë se kjo fjalë, në gjuhën e folur dhe në ajetet e Kur'ànit Famëlartë, ka ardhur në kuptimin më të gjerë, që përfshihet në kuptimin e parë, domethënë dhënien e mirësive dhe të dhuntive të mëdha.

Në këtë ajet, njoftohet se mirësia që All'llahu i Lartësuar u ka dhuruar dy vëllezërve, Mùsait e Hàrùnit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)* është një mirësi shumë e madhe.

Ajetet vijuese shpjegojnë shtatë prej atyre mirësive dhe çdonjëra mirësi është më e mirë se mirësia tjetër.

Në fillim, i Larti njofton: **"Ne i shpëtuan ata të dy dhe popullin e tyre prej mjerimit të madh."**.

A mund të kishte atje mjerim më të madh, kur Beni Israilët jetonin nën grushtin shtypës të faraonëve tiranë e gjakatarë, të cilët thernin fëmijët e tyre meshkuj, i vinin gratë e tyre të punojnë për ata, kurse burrat e Beni Israilëve tiranët i skllavëronin dhe i përdornin për punë të rënda.

Humbja e lirisë, vuajtjet e rënda nën grushtin e një tirani kriminel dhe sundimtar i një vendi ku nuk mëshirohet as i madhi e as i vogli, madje dhuna e atij tirani kishte arritur deri aty sa ai engledisej me nderin e njerëzve, a nuk është kjo gjendje hidhërim

më i madh dhe me dhimbje të forta; atëherë shpëtimi i tyre prej grushtit shtypës të faraonëve tiranë të Egjiptit, ishte mirësia e parë që derdhi Krijuesi i Gjithëfuqishëm mbi Beni Israilët.

Në radhë të dytë, Krijuesi i Gjithfuqishëm njofton: **"Ne i ndihmuam ata dhe ata ngadhënjyen."**.

Në ato kohë, ushtria e faraonit ishte një forcë e madhe, që e udhëhiqte vetë faraoni, ndërsa Beni Israilët ishin të dobët e të pafuqishëm; ata nuk kishin as burra që të luftonin e as armë, por përforcimet hyjnore i çuan Beni Israilët në ato çaste kur ata panë se si All'llahu i Lartësuar bëri që faraoni, së bashku me ushtrinë e tij, të mbytej në mesin e dallgëve të detit dhe pastaj All'llahu bëri që Beni Israilët të trashëgojnë pallatet, pasuritë, kopshtet dhe thesaret e faraonëve.

Në radhën e tretë të mirësive për Beni Israilët, vjen përfshirja e tyre nën kujdesin e vetë All'llahut të Lartësuar, ashtu siç njoftohet në Librin madhështor të All'llahut: **"Atyre të dyve Ne u dhamë librin e përsosur e të qartë."**.

Po, Teuràti është libri i përsosur e i qartë; Teuràti u shpjegoi Beni Israilëve me qartësi gjërat për të cilat ata nuk kishin dijeni; në Teuràt Beni Israilët gjenin përgjigje për çdo nevojë që kishin për punët e jetës e të fesë, ashtu siç shpjegohet qartë në ajetin nr. 44 të sures "El Màide": **"Ne e zbritën Teuràtin, në atë ka udhëzim në Rrugën e Drejtë dhe dritë."**.

Në radhë të katërt, Kur'àni Famëlartë tregon për një mirësi tjetër morale, që All'llahu i Lartësuar u ka dhënë Mùsàit e Hàrùnit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)* dhe kjo mirësi e madhe është

udhëzimi i atyre të dyve në Rrugën e Drejtë: **"Ata të dy Ne i udhëzuam në Rrugën e Drejtë."**.

Rrugë e Drejtë, pa asnjë shtrembërim, ajo është Rruga e Profetëve dhe e njerëzve të mirë; në atë rrugë nuk ka asnjë rrezik se mund të shmangesh, ose mund të biesh në rrugën e humbjes, ose mund të rrëzohesh.

Kur ne këndojmë suren "El Fàtiha" në çdo namaz, kërkojmë prej All'llahut të Lartësuar të na udhëzojë në Rrugën e Drejtë: **"Na udhëzo në Rrugën e Drejtë. Në rrugën e atyre mbi të cilër Ti ke derdhur mirësitë e Tua dhe jo në rrugën e atyre që kanë merituar zemërimin Tënd dhe as në rrugën e atyre që kanë rënë në rrugën e humbjes.";** me fjalë të tjera, ne i kërkojmë All'llahut të Lartësuar të na udhëzojë në Rrugën e Profetëve.

Në radhë të pestë, Kur'àni Famëlartë thekson vijimësinë e kumtit të atyre të dyve dhe thur për ata të dy lavdërimet më të bukura, ashtu siç njofton ajeti i nderuar: **"Kujtimin e tyre Ne e kemi lënë në ata që do të vijnë më vonë."**.

Kjo shprehje kur'anore, ka ardhur edhe në ajetet e përparshme në lidhje me Nùhun e Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)* sepse të gjithë Profetët kanë bërë thirrje për të besuar në All'llahun, Zotin Një e të Vetëm dhe kanë ecur në rrugën e vërtetë. Prandaj, emrat dhe historitë e tyre kanë mbetur të përjetshëm gjatë kohëve. Madje, ata patjetër duhet të mbeten të përjetshëm, sepse ata nuk i përkasin vetëm një kombi, ose vetëm një populli të caktuar, por, i përkasin gjithë njerëzimit.

Në radhë të gjashtë, Kur'àni Famëlartë shpalos përshëndetjen e mirë e të bekuar me të cilën përshëndeten Mùsài dhe Hàrùni: **"Selam** (paqe e shpëtim) **për Mùsànë e Hàrùnin."**.

Selam prej All'llahut, të Madhëruarit, të Gjithëmëshirshmit, selam që është simboli i shpëtimit të fesë, besimit dhe kumtit hyjnor, selam që bën të qartë shpëtimin dhe sigurinë prej dënimit e ndëshkimit në këtë botë e në Botën Tjetër.

Në radhë të shtatë e të fundit, ne arrijmë në etapën e shpërblimit më të madh, shpërblim që do të japë i Gjithëfuqishmi për ata të dy: **"Ne kështu i shpërblejmë punëmirët."**.

Po, arritja e kësaj shkalle krenarie për ata të dy, nuk është pa argument e pa shkak: të dy ishin punëmirë, besimtarë të sinqertë dhe njerëz të mirë; të këtillë njerëz, patjetër që e meritojnë këtë shpërblim.

Edhe në këtë grup ajetesh, tërheq vëmendjen fakti se ajeti **"Ne kështu i shpërblejmë punëmirët."**, përsëritet në këtë sure disa herë dhe ka ardhur në lidhje me Nùhun, Ibrahimin, Mùsànë, Hàrùnin dhe Iljasin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata!)*. Një shprehje e ngjashme ka ardhur edhe në ajetin 22 të sures "Jùsuf" dhe në ajetin 84 të surës "El En'àm", në lidhje me Profetë të tjerë, për të cilët është treguar se kanë të njëjtin shpërblim. Të gjithë Profetët kanë pohuar se ai që ka dëshirë që ta përfshijë përkujdesja e All'llahut, në radhë të parë duhet të bashkohet me grupin e punëmirëve, që mbi atë të derdhen bekimet e begatitë e Tij.

Ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh, përmend të njëjtin argument që ka ardhur më parë edhe në tregimin e Nùhut e të Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)* dhe ajeti thotë në

lidhje me Mùsànë e Hàrùnin: **“Me të vërtetë ata të dy ishin prej robve Tanë besimtarë.”**.

Besimi është ai që e ndriçon shpirtin e njeriut dhe që i jep fuqi njeriut; besimi e shtyn njeriun drejt pastërtisë, përkushtimit, punës së mirë e bamirësisë. Të gjitha këto punë, hapin portat e mëshirës hyjnore për njeriun dhe bëjnë që mbi njeriun të zbresin format e ndryshme të mirësive.

Ajetet: 123 – 132

وَإِنَّ إِلْيَاسَ لَمِنَ ٱلْمُرْسَلِينَ ﴿١٢٣﴾ إِذْ قَالَ لِقَوْمِهِۦٓ أَلَا تَتَّقُونَ ﴿١٢٤﴾
أَتَدْعُونَ بَعْلًا وَتَذَرُونَ أَحْسَنَ ٱلْخَٰلِقِينَ ﴿١٢٥﴾ ٱللَّهَ رَبَّكُمْ وَرَبَّ ءَابَآئِكُمُ
ٱلْأَوَّلِينَ ﴿١٢٦﴾ فَكَذَّبُوهُ فَإِنَّهُمْ لَمُحْضَرُونَ ﴿١٢٧﴾ إِلَّا عِبَادَ ٱللَّهِ
ٱلْمُخْلَصِينَ ﴿١٢٨﴾ وَتَرَكْنَا عَلَيْهِ فِى ٱلْءَاخِرِينَ ﴿١٢٩﴾ سَلَٰمٌ عَلَىٰٓ إِلْ يَاسِينَ
﴿١٣٠﴾ إِنَّا كَذَٰلِكَ نَجْزِى ٱلْمُحْسِنِينَ ﴿١٣١﴾ إِنَّهُۥ مِنْ عِبَادِنَا ٱلْمُؤْمِنِينَ
﴿١٣٢﴾

"Vërtet, edhe Iljàsi ishte prej të Dërguarve."

"Kur ai i tha popullit të vet: a nuk e keni frikë (All'llahun)**?"**

"Qysh adhuroni Ba'lin (emri i një idhulli) **dhe hiqni dorë prej Krijuesit më të mirë?"**

"All'llahut, Zotit tuaj dhe Zotit të prindërve tuaj të përparshëm."

"Ata e përgënjeshtruan atë (Iljàsin)**, prandaj ata patjetër do të sillen** (në Xhehennem)." **"Me përjashtim të robve të sinqertë të All'llahut."**

"Ne lamë mbi atë kujtim të mirë në ata që do të vijnë më vonë."

"Selam (paqe e shpëtim) **për Iljàsin."**

"Ne kështu i shpërblejmë punëmirët."

"Pa dyshim, ai ishte prej robve Tanë besimtarë."

Komentimi

Profeti Iljàs dhe ballafaqimi i tij me idhujtarët

Tregimi i katërt në këtë sure, shpalos shkurtimisht jetën e Profetit të All'llahut Iljàsit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* për të cilin, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Vërtet, edhe Iljàsi ishte prej të Dërguarve."**.

Me lejen e All'llahut të Lartësuar, biseda rreth Iljasit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, rreth veçorive të tij dhe jetës së tij, do të vijë në fundin e këtij grupi ajetesh.

Menjëherë pas këtij njoftimi në përgjithësi, ajetet vijuese fillojnë të japin hollësi dhe njoftojnë se ai, kur paralajmëroi popullin e tij, tha: **"Kur ai i tha popullit të vet: a nuk e keni frikë** (All'llahun)**?"**.

Ai u tha atyre: Kijeni frikë All'llahun, largohuni prej idhujtarisë, largohuni prej adhurimit të idhujve, hiqni dorë nga fajet e padrejtësitë dhe nga çdo gjë e veprim që e çon njeriun në rrugë të gabuar e në shkatërrim.

Ajeti vijues flet shumë qartë dhe ai u drejtohet atyre me këto fjalë:

"Qysh adhuroni Ba'lin (emri i një idhulli) **dhe hiqni dorë prej Krijuesit më të mirë?"**.

Prej këtij ajeti, kuptohet se ata adhuronin një shtatore idhull, që e quanin "Ba'l", madje e madhëronin shumë, deri edhe kokën e vinin në tokë për të adhuruar atë idhull. Prandaj, ky Profet i madh, u bënte atyre thirrje që të heqnin dorë prej kësaj pune shumë të keqe për vetë ata dhe të orientohen për te All'llahu i Lartësuar, Krijuesi i Gjithësisë dhe të besojnë se All'llahu është Një dhe të adhurojnë vetëm Atë.

Një grup prej interpretuesve të Kur'ànit Famëlartë, janë shprehur se Iljàsi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte dërguar Profet në qytetin *"Ba'labak"*, që ishte njëri prej qyteteve të trevave të Shàmit.[1] Ky qytet e ka marrë këtë emër nga bashkimi i emrit të idhullit *"Ba'l"* dhe fjalës *"bek'ke"*, që do të thotë qytet dhe kështu nga bashkimi i këtyre fjalëve doli emri Ba'lebak'. Thuhet se idhulli "Ba'l" ishte punuar prej floriri, ishte njëzet krahë i gjatë dhe se në shërbim të atij idhulli ishin katërqind vetë.[2]

[1] Në ditët e sotme "Balebak'k" është pjesë e territorit të Libanit dhe gjendet afër kufirit me Sirinë.
[2] Tefsiri "Rùhul Meànij", fundi i ajeteve objekt studimi.

Disa interpretues të tjerë të Kur'ànit, kanë thënë se fjala *"ba'l"* nuk është emri i ndonjë idhulli të caktuar, por përdoret për të treguar idhujt në përgjithësi. Kurse një grup i tretë prej interpretuesve të Kur'ànit Famëlartë, kanë thënë se fjala *"ba'l"* do të thotë: zot dhe i adhuruar. Ndërsa Ràgibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu El Fàdhil Kur'àni", shpjegon se fjala *"ba'l"* do të thotë: bashkëshort. Por arabët e kohës së injorancës, para Islamit, e përdornin këtë fjalë në kuptimin e idhujve që ata adhuronin dhe sipas mëtimit të tyre të gabuar, ata thoshin se, me ndërmjetësinë e idhujve, ne afrohemi te All'llahu i Lartësuar.

Shprehja *"ahsenel khàlikijne"* domethënë se vetëm All'llahu i Gjithëfuqishëm është Krijuesi i Gjithësisë dhe se nuk ka krijues tjetër përveç Atij. Gjithashtu, kjo shprehje tregon se edhe sendet e punuara, sendet që i punon njeriu duke ndryshuar formën e lëndëve natyrore, janë krijuar prej All'llahut të Gjithëfuqishëm.

Iljàsi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* me ajetin vijues ka qëllim të qortojë popullin e tij me fjalë të rënda dhe u kujton atyre se cili është Krijuesi më i mirë: **"All'llahut, Zotit tuaj dhe Zotit të prindërve tuaj të përparshëm."**.

Ai u thotë atyre: All'llahu është Sunduesi dhe Edukuesi juaj, të gjitha mirësitë që ju gëzoni vijnë vetëm prej Atij; çdo problem që ju keni bëhet i lehtë vetëm me fuqinë e Tij, kurse të tjerët as nuk janë burim të mirash e begatish dhe as nuk e sprapsin të keqen dhe pësimet që bien mbi ju.

Nga këto fjalë të ajetit, del qartë se idhujtarët e kohës së Iljàsit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* thoshin të njëjtat fjalë siç

thoshin edhe idhujtarë e kohës së Profetit tonë Muhammedit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ata përsërisnin të njëjtin justifikim për të mos pranuar thirrjen që u bëhej: ne ndjekim rrugën e gjyshërve tanë të përparshëm, ndërsa Iljàsi u përgjigjej atyre me fjalën e tij: **"All'llahut, Zotit tuaj dhe Zotit të prindërve tuaj të përparshëm."**.

Përdorimi i fjalës *"rab'bun"* është sinjalizuesi më i mirë për të bërë njeriun të logjikojë e të mendojë, sepse çështja më e rëndësishme në jetën e njeriut është që ai të njohë se cili është Krijuesi i tij? Cili është Sunduesi dhe Edukuesi i tij dhe cili është Ai që e ka në dorë sot të mirën që ai gëzon?

Por populli i tij ishin njerëz kokëngjeshur e mendjemëdhenj dhe nga kjo nuk u kushtonin asnjë rëndësi fjalëve e këshillave të tij; ata, jo vetëm nuk i thirrën mendjes që të dëgjonin fjalët e tij e të udhëzoheshin në rrugën e drejtë, por i thanë që je gënjeshtar, ashtu siç njofton fjala e parë e ajetit vijues: **"Ata e përgënjeshtruan atë** (Iljàsin)**."**.

Përballë këtyre veprimeve të tyre, All'llahu i Lartësuar i kërcënon ata me ndëshkimin e Tij, me një frazë të shkurtër, me të cilën u thotë atyre: Ne patjetër do t'ju nxjerrim para gjykatës së drejtësisë hyjnore dhe shumë shpejt do t'ju ndëshkojmë në zjarrin e Xhehennemit: **"Prandaj ata patjetër do të sillen** (në Xhehennem)**."**. Aty ju do të merrni dënimin për punët tuaja të këqija e të urryera.

Mesa duket, në mesin e atyre idhujtarëve ishte edhe një grup njerëzish të pastër e punëmirë, të cilët i besuan me sinqeritet thirrjes që u bënte Iljàsi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe që të mos humbë e drejta e atyre besimtarëve, menjëherë i Larti njofton

në ajetin vijues: **“Me përjashtim të robve të sinqertë të All’llahut.”**.[1]

Ajetet e fundit të këtij grupi ajetesh, objekt i studimit tonë, shpalosin katër çështje, që janë të njëjta me ato që u shpalosën në ajetet e sipërme në lidhje me të drejtën e Profetëve të përparshëm: Nùhu, Ibrahimi, Mùsài e Hàrùni dhe kjo përsëritje vjen për shkak të rëndësisë së madhe që shprehin këto ajete.

Fjala e të Lartit: **“Ne lamë mbi atë kujtim të mirë në ata që do të vijnë më vonë.”**, domethënë: popujt e ardhshëm kurrë nuk do të harrojnë punën e madhe që kanë bërë Profetët e mëdhenj për të ruajtur vijën e Njëtimit të All’llahut (All’llahu është Zoti Një e i Vetëm) dhe për të ujitur pemën e besimit; ata nuk do të harrohen derisa do të ketë jetë mbi këtë botë dhe patjetër që, kumti që ata kumtuan, do të mbetet i gjallë përjetësisht.

Në etapën e dytë, All’llahu i Lartësuar lavdëron Iljasin *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)* dhe e përshendet atë me selam: **“Selam** (paqe e shpëtim) **për Iljàsin.”**.

Përdorimi i fjalës *“il jàsijn”* është thënë në vend të fjalë Iljàs, ose për shkak se, nga ana gjuhësore, fjala është për Iljàsin, por që ka të njëjtin kuptim me fjalën: *“Iljàs”*, ose bën shenjë për Iljàsin

[1] Sipas asaj që kemi thënë më sipër, ky përveçim ka lidhje me fjalën *“fekedh'dhebùhu”* - **“ata e përgënjeshtruan atë** (Ijlasin): domethënë se i gjithë populli e përgënjeshtroi atë dhe prandaj u përfshinë në ndëshkimin e All’llahut, me përjashtim të atyre që kishin besuar në All’llahun e Lartësuar me sinqeritet.

dhe për ndjekësit e tij besimtarë; prandaj fjala Iljàs, në këtë ajet ka ardhur në numrin shumës.[1]

Në etapën e tretë, i Larti thotë: **"Ne kështu i shpërblejmë punëmirët."**.

Fjala *"ihsàn"* në këtë ajet ka një kuptim shumë të gjerë dhe do të thotë: puna e kryer sipas të gjitha rregullave e urdhërave dhe pastaj vjen lufta në rrugën e All'llahut kundër të gjitha llojeve të idhujtarisë (shirkut), shmangies prej udhëzimit në rrugën e drejtë, fajeve e ngatërresave.

Në etapën e katërt, shtrohet çështja e besimit të Profetëve, e përmendur në këtë sure të bekuar. Natyrisht që besimi i Profetëve patjetër është në shkallën më të lartë, ashtu siç njofton ajeti për ata: **"Pa dyshim, ai ishte prej robve Tanë besimtarë."**.

Besimi dhe robëria ndaj All'llahut të Lartësuar janë burimi i punës së mirë dhe është puna e mirë ajo që e bashkon punëmirin me radhët e të sinqertëve, të cilët janë të përfshirë në përshëndetjen e All'llahut me selam.

[1] Në fillim ishte *"Iljàs"* dhe pastaj i është shtuar germa *"j"* dhe është bërë *"Iljàsij'je"*; pastaj është bërë në numrin shumës *"iljasij'jijne"* dhe duke e zbutur shqiptimin me heqjen e njërës prej dy germave *"j"*, fjala u bë **"إِلْيَاسِيْنَ"** *"Iljàsine"*.

Dy hulumtime

1- Cili është Iljasi?

S'ka dyshim që Iljàsi është prej Profetëve të mëdhenj të All'llahut dhe ajetet objekt i studimit tonë e deklarojnë hapur këtë fakt me fjalën e All'llahut të Lartësuar: **"Vërtet, edhe Iljàsi ishte prej të Dërguarve."**.

Emri i Profetit të All'llahut Iljàsit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ka ardhur në dy ajete të Kur'ànit Famëlartë. Ka ardhur në këtë sure, në suren "Es Sàffàt" dhe në ajetin 85 të sures "El En'àm", ku emri i tij është përmendur së bashku me emrat e Profetëve të tjerë: **"Edhe Zekerijà, Jahjà, Isà e Iljàs, janë prej të mirëve."**.

Interpretuesit e Kur'ànit Famëlartë, kanë shprehur pikëpamje të ndryshme në lidhje me Iljàsin. Disa shtrojnë pyetjen: emri Iljàs a është emër i dytë për një Profet të vetëm, apo është emër që ka lidhje me ndonjë Profet që nuk ka emër të dytë dhe cilat janë veçantitë e cilësitë e këtij Profeti?

Në përgjigje të këtyre pyetjeve, do të shpalosim disa pikëpamje të ndryshme:

a) Disa besojnë se "Iljàsi" është "Idrisi". Ata thonë se fjala Idris shqiptohet Idràs dhe pas ndryshimeve të pakta që kanë ndodhur mbi këtë fjalë, ajo u bë Iljàs.

b) "Iljàs" është emri i njërit prej Profetëve të Beni Israilëve dhe është i biri i "Jàsinit" dhe ky i fundit është njëri prej nipërve të Hàrùnit, vëllait të Profetit të All'llahut Mùsà *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)*.

c) Një grup interpretuesish të Kur'ànit Famëlartë, janë shprehur se Iljàsi është Hidri (Hizri).

Në të njëjtën kohë, disa të tjerë janë shprehur se Iljàsi është shok i Hidrit dhe të dy vazhdojnë të jenë gjallë dhe shtojnë se Iljàsi është i autorizuar për shkretëtirat, kurse Hidri është i autorizuar për detrat e ishujt.

Një grup i tretë, kanë thënë se Iljàsi është i autorizuar për shkretëtirat dhe Hidri është i autorizuar për malet. Edhe këta thonë se që të dy janë të përjetshëm.

Disa të tjerë mendojnë se Iljàsi është djali i Eljesa.

d) Iljàsi është vetë Ilija, Profet i Beni Israilëve, që është bashkëkohës i mbretit Àxhàb dhe Krijuesi i Gjithëfuqishëm e dërgoi Iljàsin që të paralajmëronte tiranin arrogant Àxhàb dhe ta udhëzonte atë në rrugën e drejtë.

Të tjerë, kanë thënë se Iljàsi është Jahja, bekuesi i Mesihut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*.

Por, duke parë me kujdes në ato që thonë ajetet e Kur'ànit Famëlartë, rezulton se Iljàs është emri i njërit prej Profetëve të All'llahut dhe jo i Profetëve të tjerë që janë përmendur në Kur'ànin Famëlartë. Ai u dërgua për të udhëzuar në rrugën e vërtetë një popull që adhuronte idhujt, por pjesa më e madhe e

popullit e përgënjeshtroi atë, me përjashtim të një grupi besimtarësh të sinqertë, të cilët besuan në kumtin që ai kumtoi.

Siç thamë më sipër, disa besojnë se Iljasi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u dërgua në vendet e Shamit dhe bazuar mbi emrin e idhullit *"Ba'l"*, të cilin e adhuronin banorët e asaj zone, që kishte si kryeqendër qytetin *"Ba'labak"* dhe ashtu siç u tha më sipër, është njëri prej qyteteve të Libanit dhe shtrihet afër kufirit me Sirinë.

Në fakt, në librat e tefsireve, kanë ardhur tregime të ndryshme në lidhje me këtë Profet, por këto tregime nuk janë të mbështetur me argumente dhe për rrjedhojë, nuk janë të besueshëm, prandaj ato kanë mbetur jashtë shikimit.[1]

2- Cili është Il Jàsini?

Interpretuesët e Kur'ànit Famëlartë dhe historianët, kanë shprehur pikëpamje të ndryshme në lidhje me "Il Jàsinin" dhe prej këtyre pikëpamjeve rendisim:

a) Disa kanë thënë: Iljàs dhe Iljàsin janë dy fjalë, po ashtu siç ka përhapje fjala Mikàl dhe Mikàil, që shprehin emrin e njërit prej engjëjve, ose ashtu siç thuhet edhe për fjalët "*sinà*" e "*sinine*", që thuhen për një sipërfaqe toke që shtrihet ndërmjet Egjiptit e Palestinës; kështu qëndron puna edhe me fjalët Iljàs e Iljàsin,

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", tefsiri "El Mijzàn", tefsiri "Rùhul Bejàn", tefsir "El Kebijr", tefsiri "Fij Dhilàlil Kur'àn" dhe tefsiri "A'làmul Kur'àn".

domethënë janë dy fjalë që shprehin një emër të vetëm të këtij Profeti të madh.[1]

b) Të tjerë e kanë konsideruar fjalën "Iljàsin" shumës dhe sipas këtij mendimi, emrit "Iljàs" iu shtua germa "j" dhe kështu, nga Iljàs u bë "Iljàsij"; më pas është bërë në numrin shumës, duke i shtuar fjalës "Iljàsij" një tjetër "j" dhe një "n" dhe fjala u bë "Iljàsijijne"; më pas fjala është lehtësuar, duke i hequr njërën germë "j" dhe u bë "Iljàsijn". Në përputhje me këtë mendim, kuptohet se kjo fjalë është e veçantë për të gjithë ata që iu bindën Iljàsit dhe u përkushtuan në programin e tij.[2]

c) Fjala *"Àl jàsijn"* me "a" të zgjatur, është e përbërë prej dy fjalëve: prej "Àl", që do të thotë familje dhe prej fjalës "Jàsijn", për të cilën thuhet se është emri i babait të Iljàsit, por, sipas një transmetimi tjetër, thuhet se emri "Jàsijn" është njëri prej emrave të Profetit tonë Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi atë e mbi familjen e tij!)*. Me këtë shpjegim, fjala *"Àl Jàsijn"* do të thotë familja e Profetit të Islamit, ose familja e babait të Iljàsit.

Argumentet e qartë që gjenden në Kur'ànin Famëlartë, përforcojnë kuptimin e parë, kurse ai që thotë se qëllimi me fjalën "Iljàsijn" është për "Iljàsin", mbështetet në ajetin vijues: **"Selam** (paqe e shpëtim) **për Iljàsin"** dhe ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh njofton: **"Pa dyshim, ai ishte prej robve Tanë besimtarë."**. Sipas rregullave të sintaksës së gjuhës arabe, përemri *"hù"* në numrin njëjës, veta e tretë, në shprehjen *"in'nehù"* – *"me të vërtetë ai"* i referohet fjalës *"Il Jàsijn"* dhe është argument që vërteton se ai

[1] "El bejànu fij garijbi I'ràbil Kur'àn', vëll. 2, f. 308.
[2] Burimi i sipërm.

është vetëm një njeri e asgjë më shumë dhe ky njeri është Iljàsi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Fakti që katër ajetet e fundit që kanë ardhur në fundin e tregimit të Iljasit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* janë të njëjtat ajete që kanë ardhur edhe në fundin e tregimeve të Nùhut, Ibrahimit, Mùsàit e Hàrùnit dhe kur ne i vëmë këto ajete pranë njëri-tjetrit, vërejmë se përshëndetja me "selam" prej All'llahut të Lartësuar, u është Dërguar Profetëve për të cilët flasin ajetet e bekuara sipas radhës: **"Paqe e shpëtim për Nùhun në të gjitha botët"; "Selàm** (paqe e shpëtim) **për Ibrahimin"; "Selam** (paqe e shpëtim) **për Mùsànë e Hàrùnin."**. Sipas kësaj radhe edhe ajeti **"Selam** (paqe e shpëtim) **për Iljàsin"**, që, siç shihet në tekstin e Kur'ànit Famëlartë ka ardhur *"Il Jàsijn"*, do të thotë: selam për Iljàsin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Ka edhe një pikë që bie në sy në shumë libra tefsiresh dhe që ka të bëjë me një hadith të përcjellë prej Ibni Ab'bàsit, i cili është shprehur se qëllimi me fjalën *"Il Jàsijn"* është për Muhammedin *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* sepse njëri prej emrave të Profetit tonë është "Jàsijn".

Shejhu Es Aadùk, në librin e tij "Meànil Akhbàr", kapitulli: "Komentimi i fjalës *"Il Jàsijn""*, ka sjellë pesë transmetime, të cilat, nga ana e përcjellësve përfundojnë te Ehli Bejti, me përjashtim të njërit, që është përcjellë prej një njeriu të quajtur "Kàdih",[1] por që konsiderohet njeri i panjohur dhe jetëshkrimi i tij nuk gjendet në librat që përshkruajnë përcjellësit e transmetimeve.

[1] "Meànil Akhbàr", f. 122.

Le të hamendsojmë që ajetin objekt studimi, sipas këtyre transmetimeve, ne e lexojmë në formën *"Selàmun alà Àl Jàsin"* pavarësisht se nuk është në harmoni me ajetet e tjera, ne vëmë re se të këtilla transmetime janë të diskutueshme, prandaj është më mirë që të lëmë mënjanë gjykimin në lidhje me këto transmetime dhe t`ua lëmë gjykimin në lidhje me ato vetëm atyre që merren me vërtetimin e saktësisë së transmetimeve.

Ajetet: 133 – 138

وَإِنَّ لُوطًا لَّمِنَ ٱلْمُرْسَلِينَ ﴿١٣٣﴾ إِذْ نَجَّيْنَٰهُ وَأَهْلَهُۥٓ أَجْمَعِينَ ﴿١٣٤﴾ إِلَّا
عَجُوزًا فِى ٱلْغَٰبِرِينَ ﴿١٣٥﴾ ثُمَّ دَمَّرْنَا ٱلْءَاخَرِينَ ﴿١٣٦﴾ وَإِنَّكُمْ لَتَمُرُّونَ عَلَيْهِم
مُّصْبِحِينَ ﴿١٣٧﴾ وَبِٱلَّيْلِ ۗ أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿١٣٨﴾

"Edhe Lùti pa dyshim ishte prej të Dërguarve."

"Kur Ne e shpëtuam atë dhe të gjithë familjen e tij."

"Përveç një plake (gruaja e Lutit) **që mbeti me të dënuarit."**

"Pastaj të tjerët Ne i shkatërruam."

"Dhe ju (o banorë të Mekës) **patjetër që kaloni atypari në mëngjes** (gjatë udhëtimeve që bëni)**."**

"Dhe në mbrëmje; a nuk po mendoni."

Komentimi

Shkatërrimi i popullit të Lùtit

Luti është Profeti i pestë, emri i të cilit përmendet në disa ajete të kësaj sureje që flasin në mënyrë të shkurtër rreth historisë së tij dhe të mësimeve që nxirren prej historisë së tij.

Në përputhje të plotë me atë që ka ardhur në ajetet e Kur'ànit në lidhje me Lùtin, del qartë se ai ishte bashkëkohës me Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)* dhe se ai është prej Profetëve të mëdhenj që All'llahu i Lartësuar ka dërguar, ashtu siç thuhet në ajetin 26 të sures "El Ankebùt" dhe në ajetin 74 të sures "Hùd".

Në ajetet e Kur'ànit Famëlartë, emri i Lùtit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ka ardhur shumë here. Gjithashtu, në Kur'ànin Famëlartë, studimi në lidhje me Lutin e me popullin e tij, që ishte shmangur nga udhëzimi në rrugën e drejtë, është përsëritur disa herë në: (ajetet 167-173 të sures "Esh Shuarà"; në ajetet 70-83 të sures "Hùd"; në ajetet 54-58 të sures "En Neml" dhe në sure të tjera të Kur'ànit Famëlartë). Këto ajete flasin për ndëshkimin e dhimbshëm me të cilin u godit ai popull i degjeneruar.

Studimi ynë fillon me fjalën e të Lartit: **"Edhe Lùti pa dyshim ishte prej të Dërguarve."**.

Pas këtij shpjegimi të përgjithshëm, Kur'àni Famëlartë kalon në hollësitë dhe shpjegon disa anë të tregimit të Lùtit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe na kujton kohën kur All'llahu i

Lartësuar e shpëtoi Lutin e familjen e tij: **"Kur Ne e shpëtuam atë dhe të gjithë familjen e tij."**.

Me përjashtim të gruas së tij të moshuar, për të cilën Ne bëmë që ajo të mbetej me të ndëshkuarit: **"Përveç një plake** (gruaja e Lutit) **që mbeti me të dënuarit."**.

"Pastaj të tjerët Ne i shkatërruam."

Frazat e shkurtra që pamë më sipër, tregojnë se historia e popullit të Lutit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* është e mbushur me ngjarje që janë shpjeguar në suret: "Hùd", "El Ankebùt" dhe "Esh Shuarà".

Lùti *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!* si të gjithë Profetët e All'llahut, e filloi thirrjen me Njëtimin e All'llahut të Lartësuar (All'llahu është Zoti Një e i Vetëm) dhe më pas ai u hodh në luftë kundër imoralitetit, që ishte bërë zotërues në shoqërinë ku ai jetonte dhe në mënyrë të veçantë ai popull praktikonte shmangien seksuale të njohur me emrin pederasti, imoralitet që ka mbetur si damkë për popullin e Lùtit gjatë gjithë historisë.

Ky Profet i madh u ndesh me vuajtjet më të hidhura, që i vinin prej popullit të tij dhe ai bëri gjithçka që kishte mundësi të bënte për të përmirësuar popullin e tij të shmangur nga udhëzimi në rrugën e drejtë; ai u mundua shumë që t'i ndalonte ata që mos të vazhdonin më atë vesin e tyre të shëmtuar, por lufta e tij e madhe nuk dha asnjë rezultat dhe kur ai pa se vetëm pak individë i besuan thirrjes së tij, atëherë ai vendosi të shpëtojë veten dhe ata besimtarë të pakët prej atij mjedisi të shthurur.

Më në fund Lùti *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* vetëm kur e pa se populli i tij nuk kishte dëshirë të përmirësohej, atëherë ai iu drejtua All'llahut të Lartësuar me lutjen që ta shpëtonte atë, familjen e tij dhe atë pakicë njerëzish të pastër që i kishin besuar

thirrjes së tij, me përjashtim të gruas së tij plakë, e cila, jo vetëm që kishte refuzuar të besonte në mësimet me të cilat kishte ardhur bashkëshorti i saj, por në disa raste ajo kishte ndihmuar armiqtë e tij.

All'llahu i Lartësuar e ndëshkoi atë popull me dënimin më të rëndë: toka e tyre u fundos, ndërkaq mbi ata binte një shi gurësh, që në Kur'ànin Famëlartë janë përmendur me frazën "gurë sixh'xhijli". Ky dënim i dyfishtë, ishte që ata jo vetëm të vdisnin të gjithë pa përjashtim, por edhe që trupat e tyre të mos ekzistonin më në atë vend.

Duke marrë parasysh se këto ajete janë si një parathënie për të zgjuar të shkujdesurit e mendjemëdhenjtë, Kur'àni Famëlartë shton: **"Dhe ju** (o banorë të Mekës) **patjetër që kaloni atypari në mëngjes"**, domethënë: ju kaloni çdo mëngjes pranë vendbanimeve të atyre, të shndërruara në gërmadha për shkak të dënimit.

Gjithashtu, ju kaloni atje edhe natën, prandaj: **"Dhe në mbrëmje; a nuk po mendoni?"**.

Këto ajete u flasin drejtpërdrejt banorëve të Hixhazit, të cilët udhëtonin me karvanet e tyre ditë e natë për në vendet e Shamit dhe rruga që ata ndiqnin kalonte pranë vendbanimeve të popullit të Lutit. Me këto fjalë, këto ajete u thoshin atyre: sikur të kishit veshë të gjallë, patjetër do të dëgjonit britmat tmerruese e ulurimat e dhimbshme të atyre njerëzve të dënuar.

Në të vërtetë, gjurmët e mbetura prej vendbanimeve të popullit të Lùtit, me heshtjen që i ka mbërthyer, japin një mësim

të madh për të gjithë ata që kalojnë nëpër atë rrugë dhe i paralajmërojnë se mund të sprovohen me një ndëshkim si ky.

Po, në atë pësim të rëndë ka shumë mësime, por ata që nxjerrin mësime prej pësimeve janë të pakët, ashtu siç ka thënë Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Sa shumë pësime dhe sa pak mësime të nxjerra prej pësimeve!*".[1]

Një kuptim të ngjashëm e ndeshim edhe në ajetin 76 të sures "El Hixhr", ku, në lidhje me vendbanimet e popullit të Lùtit: **"Dhe ato** (vendbanimet) **mund të shihen nga rruga"**, domethënë: mbetjet e atyre vendbanimeve, karvanet dhe këmbësorët i ndeshin gjithmonë kur kalojnë nga ajo anë.

Një transmetim i ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, e shpjegon në një formë tjetër çështjen e kalimit pranë vendbanimeve të popullit të Lutit, kur atë e ka pyetur njëri prej shokëve të tij për kuptimin e ajetit: **"Dhe ju** (o banorë të Mekës) **patjetër që kaloni atypari në mëngjes**. **Dhe në mbrëmje; a nuk po mendoni?"**; Imami i është përgjigjur atij me këto fjalë: "ju kaloni pranë atyre vendbanimeve kur ju lexoni Kur'ànin, prandaj lexoni njoftimet rreth atyre që jep Kur'àni për ju".[2]

Ky interpretim nuk tregon se kemi të bëjmë me një interpretim të dytë, por, në të gjitha gjendjet, asnjë dëm nuk vjen prej bashkimit të dy interpretimeve, sepse rrënojat e mbetuara prej popullit të Lùtit dallohen qartë edhe me shikim të thjeshtë, me sy, duke shtuar se ajetet e Kur'ànit Famëlartë flasin qartë rreth popullit të Lùtit dhe ndëshkimit të rëndë që ra mbi të.

---

[1] "Nehxhul Belàga", fjalët e shkurtra, nr. 297.
[2] "Reudatul Kàfij", cituar prej tefsirit "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 432.

Ajetet: 139 – 148

وَإِنَّ يُونُسَ لَمِنَ ٱلْمُرْسَلِينَ ﴿١٣٩﴾ إِذْ أَبَقَ إِلَى ٱلْفُلْكِ ٱلْمَشْحُونِ ﴿١٤٠﴾
فَسَاهَمَ فَكَانَ مِنَ ٱلْمُدْحَضِينَ ﴿١٤١﴾ فَٱلْتَقَمَهُ ٱلْحُوتُ وَهُوَ مُلِيمٌ ﴿١٤٢﴾
فَلَوْلَآ أَنَّهُۥ كَانَ مِنَ ٱلْمُسَبِّحِينَ ﴿١٤٣﴾ لَلَبِثَ فِى بَطْنِهِۦٓ إِلَىٰ يَوْمِ يُبْعَثُونَ
﴿١٤٤﴾ ۞ فَنَبَذْنَٰهُ بِٱلْعَرَآءِ وَهُوَ سَقِيمٌ ﴿١٤٥﴾ وَأَنۢبَتْنَا عَلَيْهِ شَجَرَةً مِّن يَقْطِينٍ
﴿١٤٦﴾ وَأَرْسَلْنَٰهُ إِلَىٰ مِاْئَةِ أَلْفٍ أَوْ يَزِيدُونَ ﴿١٤٧﴾ فَـَٔامَنُوا۟ فَمَتَّعْنَٰهُمْ إِلَىٰ
حِينٍ ﴿١٤٨﴾

"Edhe Junusi ishte prej të Dërguarve."

"Kur ai u arratis me anijen e mbushur

"Ai mori pjesë në shortin dhe ishte prej atyre që do të hidheshin (nga anija)**."**

"Atë e gëlltiti peshku dhe ai e meritoi (qortimin)**."**

"Sikur ai të mos ishte prej atyre që madhërojnë (All'llahun)**."**

"Me siguri do të kishte mbetur në barkun e peshkut deri Ditën e Ringjalljes."

“Ne e hodhëm atë në një tokë të zhveshur dhe ai ishte i sëmurë.”

“Ne bëmë që sipër tij të mbinte një bimë gjethemadhe.”

“Ne e dërguam atë te njëqindmijë e më shumë.”

“Ata besuan dhe Ne i lamë ata të jetojnë deri në një kohë.”

Komentimi

Junusi në enën e nxehtë të provimit

Në këtë grup ajetesh, biseda vazhdon me tregimin e Profetit të All’llahut Junusit *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)* dhe popullit të tij të penduar. Ky është tregimi i gjashtë dhe i fundit rreth Profetëve e popujve të tyre, që trajtohen në këtë sure. Këtu duhet theksuar se, në pesë tregimet e përparshme rreth popullit të Nùhut, Ibrahimit, Mùsait, Hàrùnit, Iljàsit dhe Lùtit *(Paqja e All’llahut qoftë mbi ta!)* pamë se ata popuj nuk i dëgjuan këshillat e Profetëve që ishin dërguar tek ata dhe parapëlqyen të mbeten në gjumin e shkujdesjes, prandaj ata i përfshiu dënimi i All’llahut. Njëkohësisht, All’llahu i Gjithëfuqishëm i shpëtoi Profetët e tij të mëdhenj dhe patjetër shpëtoi edhe ata pak besimtarë që i kishin besuar thirrjes së Profetëve që ishin dërguar te ata.

Kurse tregimi që flet për Profetin e All’llahut Jùnusin *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)* përfundon ndryshe nga përfundimi që

pamë në pesë tregimet e mësipërme: populli i Jùnusit u zgjua prej gjumit të shkujdesjes; ata u penduan dhe i kërkuan All'llahut të Lartësuar faljen e fajeve që kishin bërë, kur panë argumentet e dënimit të All'llahut që do të lëshohej mbi ata nëse nuk do të besonin. Në këtë tregim, mësojmë se për pendimin që ata bënë, All'llahu i Lartësuar i përfshiu ata me butësinë e Tij dhe u dha atyre prej begative të Tij materiale e morale, kurse Profeti i All'llahut Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u vu në shumë sprova e u ndesh me shumë probleme, për shkak se ai u nxitua kur e la detyrën parësore që kishte për të bërë në mesin e popullit të tij dhe u largua prej tyre. Kur'àni Famëlartë, ikjen e tij të shpejtë e ka shprehur me fjalën *"ebeka"*, që do të thotë: ai u arratis, siç arratiset skllavi prej pronarit të tij.

Ky tregim është i barabartë me një kumt drejtuar idhujtarëve kurejshë të Mekës dhe të mbarë njerëzve gjatë gjithë historisë. Në këtë kumt thuhet qartë: a dëshironi të jeni si pesë popujt e përparshëm të lartpërmendur, apo dëshironi të jeni si populli i Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*? A doni që fundi juaj të jetë shkatërrim e dhimbje? Apo doni që fundi juaj të jetë mirësi e lumturi? Por, dijeni mirë se kjo është e lidhur vetëm me punën tuaj. Ky Profet i madh dhe populli i tij, janë përmendur në disa sure të Kur'ànit Famëlartë, si, për shembull, në suret: "El Enbijà", "Jùnus", "El Kalem" dhe në suren "Es Sàffàt". Në çdonjërën prej këtyre sureve, pasqyrohen disa anë të gjendjeve të tij e të jetës së tij, kurse në suren "Es Sàffàt", objekt i studimit tonë, flitet rreth çështjes se largimit të Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe provës së rëndë me të cilën ai u sprovua; më pas, flitet për shpëtimin e tij dhe për nxjerrjen e tij prej barkut të peshkut.

Siç e pamë edhe në tregimet e Profetëve të tjerë, Kur'àni Famëlartë flet për pozitën e lartë të mbajtësit të kumtit hyjnor, për të cilin ajeti i parë i këtij grupi ajetesh njofton: **"Edhe Junusi ishte prej të Dërguarve."**.

Profeti i All'llahut Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* si të gjithë Profetët e mëdhenj të All'llahut të Lartësuar, e filloi thirrjen e tij me besimin në All'llahun, Zotin Një e të Vetëm (Teuhid) dhe me luftën kundër adhuruesve të idhujve; pastaj u hodh në luftë kundër idhujtarisë, aq të përhapur në shoqërinë e atij populli, por populli i tij, fanatik në bestytnitë e në traditat e zakonet e trashëguara prej gjyshërve të tyre të përparshëm, nuk pranuan t'i përgjigjeshin thirrjes së tij.

Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* vazhdoi të këshillojë popullin e vet me zemër të thyer e shumë i brengosur, për shkak të refuzimit të tyre, në një kohë që donte për ata vetëm të mirën, si një baba i mëshirshën, por ata, logjikës së tij të mbushur me urtësi, i kundërviheshin me sofizma e fjalë të zbrazëta, me përjashtim të një grupi fare të vogël prej tyre, që i besuan thirrjes së tij, por ka mundësi që ata që besuan kumtin që ai kumtonte të mos ishin më shumë se dy vetë (njëri prej tyre quhej Àbid dhe tjetri Àlim).

Pasi i bëri popullit të tij thirrje për një kohë të gjatë që të adhuronin vetëm All'llahun e Lartësuar dhe të hiqnin dorë prej adhurimit të idhujve, Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u hidhërua shumë, për shkak se ata nuk e pranonin udhëzimin në rrugën e drejtë dhe ashtu siç thuhet në disa transmetime, Jùnusi me propozimin e atij besimtarit të quajtur Àbid dhe duke marrë

parasysh rrugën e humbjes ku kishte hyrë populli i tij, vendosi që në lutjet e tij të kërkojë mallkimin për ata.[1]

Në të vërtetë, në lutjet e tij, ai kërkoi mallkimin për ata dhe kështu menjëherë atij i zbriti revelata që e njoftonte për caktimin e kohës kur ndëshkimi i All'llahut do të lëshohej mbi ata idhujtarë kokëfortë. Me afrimin e kohës së premtuar për zbritjen e ndëshkimit hyjnor, Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* me ndihmën e besimtarit të quajtur Àbid, u nis për udhëtim dhe e braktisi popullin e tij, shumë i zemëruar me ata; ai vazhdoi rrugën derisa arriti në breg të detit, ku pa një anije të mbushur me udhëtarë dhe kërkoi prej atyre që ta lejonin të ngjitej edhe ai në anije.

Pikërisht për këtë ngjarje njofton ajeti vijues: **"Kur ai u arratis me anijen e mbushur."**.

Fjala e ajetit *"ebeka"*, shpreh arratisjen e skllavit prej pronarit të vet. Pa dyshim që është një shprehje shumë e çuditshme, pasi na shpjegon se lënia e punës që ka më shumë përparësi prej Profetëve të mëdhenj të All'llahut, të cilët, siç dihet, gëzojnë një pozitë shumë të lartë te i Gjithëfuqishmi, pavarësisht se sa i thjeshtë është veprimi i Profetit, bën që Krijuesi i Lartësuar të marrë një qëndrim qortues edhe ndaj Profetëve, siç është, për shembull, etiketimi i Profetit të Tij të madh Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* me fjalën *"el àbiku"* – *"i arratisuri"* fjalë që, siç shpjeguam më sipër, përdoret për të treguar skllavin e arratisur.

[1] Tefsiri "El Burhàn", vëll. 4, f. 35.

Patjetër që Profeti i All'llahut të Lartësuar Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte i ruajtur nga gabimet, por do të ishte shumë më mirë për atë të tregohej më i durueshëm ndaj vuajtjeve e dhimbjeve që i vinin prej popullit të tij, pasi detyra e tij kërkonte që të qëndronte disa ditë, ose disa orë më shumë në mesin e tyre; prandaj, për shkak se ai u largua dhe e braktisi popullin e tij, Kur'àni Famëlartë e përngjason atë me skllavin e arratisur.

Sipas asaj që thuhet në transmetimet islame, Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u ngjit në anije, por, më pas, një peshk shumë i madh ndaloi para anijes dhe hapte gojën për të kërkuar ushqim. Në këtë gjendje, udhëtarët që ishin në anije thanë: në mesim tonë kemi ndonjë njeri që ka bërë faje, prandaj ai duhet të bëhet ushqim për këtë peshk dhe për të caktuar njeriun që duhej të bëhej ushqim për peshkun, ata nuk gjetën rrugë tjetër përveç hedhjes së shortit dhe kur shorti u hodh, doli emri i Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Ata hodhën short tri herë me radhë dhe në të tria herët dilte emri i tij; atëherë ata e kapën Jùnusin dhe e flakën në gojën e peshkut të madh. Këtë ngjarje, Kur'àni Famëlartë e njofton vetëm me një frazë të shkurtër: **"Ai mori pjesë në shortin dhe ishte prej atyre që do të hidheshin** (nga anija)**."**.

Fjala e ajetit "*sàheme*", do të thotë: ai mori pjesë në shortin. Natyrisht që shorti u hodh mbi kuvertën e anijes sipas kësaj mënyre: shkruan emrin e çdo udhëtari mbi një send, i përzien sendet dhe tërhoqën vetëm njërin prej atyre sendeve, por rezultoi që në sendin (shortin) e tërhequr të ishte emri i Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Fjala *"mud'hedijne"*, në rrënjën e saj *"deheda"*, do të thotë: bërja pa vlerë e veprimit të një sendi, ose asgjësimi i atij sendi, ose mposhtja e atij sendi dhe këtu qëllimi me këtë fjalë është për të treguar se emri i tij doli në procesin e hedhjes së shortit ndër të gjithë emrat e tjerë.

Në lidhje me këtë çështje, ka edhe një interpretim tjetër, që thotë: në det filloi të frynte një erë shumë e fortë dhe nga kjo, anija, së bashku me udhëtarët që ishin në anije, rrezikoheshin të mbyteshin, për shkak të peshës së rëndë; në këtë gjendje, ata s'kishin rrugë tjetër shpëtimi, përveç lehtësimit të barrës që mbartte anija dhe këtë lehtësim do ta bënin duke flakur në det disa udhëtarë dhe kur ata hodhën short se cilin të hidhnin në det, prej shortit të hedhur doli emri i Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të cilin, pasi ata e hodhën në det, menjëherë e gëlltiti peshku i madh.

Në lidhje me këtë ndodhi, Kur'àni Famëlartë njofton: **"Atë e gëlltiti peshku dhe ai e meritoi** (qortimin)**"**, domethënë: një peshk i madh e gëlltiti atë dhe ai e meritonte qortimin.

Fjala *"iltekame"*, në rrënjën e saj *"el iltikàmu"*, do të thotë: e përpiu, e gëlltiti.

Fjala *"mulimun"*, në rrënjën e saj *"leumun"*, do të thotë qortim dhe kur kuptimi qortim vjen me cilësinë e veprimit, fjala merr kuptimin: e meritoi qortimin.

Pa diskutim që ky qortim nuk ishte për shkak se ai bëri ndonjë faj të madh ose të vogël, por ishte për shkak se la punën që kishte më shumë përparësi dhe për shkak të nxitimit për t'u larguar sa më parë prej popullit të tij.

Pasi atë e gëlltiti peshku i madh, All'llahu i Lartësuar e urdhëroi peshkun me gjuhën me të cilën Ai e ka krijuar atë peshk, që Junùsi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të mos pësonte asnjë lloj dëmtimi. All'llahu i Gjithëfuqishëm kishte vendosur që ai duhet të kalonte një kohë të caktuar në atë burg, për të cilin nuk mund të gjendet një shembull, me qëllim që ai të kuptonte çdo të thotë lënie e punës që ka më shumë përparësi dhe që ai të punojë shumë jo vetëm për të përmirësuar veten, por të përmirësojë edhe punën që do të bënte më pas.

Në njërin prej transmetimeve, thuhet: "All'llahu i Lartësuar e inspiroi balenën: mos i thyej atij asnjë kockë dhe mos këput prej tij asnjë kyç.".[1]

Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u kujtua shumë shpejt për ngjarjen dhe menjëherë iu drejtua All'llahut të Gjithëfuqishëm, për të kërkuar prej Tij faljen e gabimit që ai kishte bërë duke lënë punën me më shumë përparësi.

Në ajetin 87 të sures "El Enbijà", tregohet mënyra si u lut Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* lutje që, në terminologjinë e atyre që janë pajisur me dituri të thella, quhet lutja "Jùnusij'jeh" - lutja sipas formës së lutjes së Jùnusit - dhe për lutjen e tij, i Larti njofton: **"…dhe ai tha në errësirat: s'ka zot tjetër përveç Teje o i Dëlirë nga çdo mangësi e nevojë, unë isha prej të padrejtëve."**.

Ai tha prej barkut të balenës: s'ka të adhuruar tjetër përveç Teje, unë isha prej të padrejtëve, unë bëra padrejtësi kundër vetes sime, kur u largova prej portës së mëshirës Tënde.

[1] Tefsiri "El Kebijr", vëll. 26, f. 165; i njëjti kuptim, me pak ndryshim në fjalë, ka ardhur edhe në tefsirin "El Burhàn", vëll. 4, f. 37.

Pohimi i sinqertë i padrejtësisë ndaj vetvetes prej Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe madhërimi i All'llahut të Lartësuar, i shoqëruar me pendimin për veprimin e nxituar që kishte bërë, të gjitha këto bënë që lutja e tij të meritojë përgjigjen prej All'llahut të Gjithëfuqishëm dhe Ai e shpëtoi atë prej brengosjes, ashtu siç e lexojmë në ajetin 88 të sures "El Enbijà": **"Ne iu përgjigjëm atij dhe e shpëtuam atë prej brengosjes; Ne kështu i shpëtojmë besimtarët."**.

Tani le të shikojmë se ç'thonë ajetet vijuese për Jùnusin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* për gjendjen e të cilit i Larti njofton: **"Sikur ai të mos ishte prej atyre që madhërojnë** (All'llahun)**. Me siguri do të kishte mbetur në barkun e peshkut deri Ditën e Ringjalljes."**, sikur të mos ishte prej atyre që e madhërojnë All'llahun, Ne do të bënim që ai të mbetej në barkun e peshkut deri Ditën e Kiametit, domethënë se i Larti do të shndërronte burgun e tij të përkohëshëm në burg të përhershëm dhe ai burg i përhershëm do të bëhej varri i tij.

Në lidhje me mbetjen e Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në barkun e peshkut deri Ditën e Ringjalljes (duke hamendsuar se ai nuk do të madhëronte All'llahun e Lartësuar dhe nuk do të kërkonte falje prej All'llahut të Gjithëfuqishëm), shtrohet pyetja nëse ai do të mbetej në barkun e peshkut i gjallë apo i vdekur. Në lidhje me këtë çështje, në mesin e interpretuesve të Kur'ànit Famëlartë, janë shtruar disa mundësi, ndër të cilat:

E para: Nëse të dy, Jùnusi dhe peshku, do të mbeteshin gjallë, Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* do të mbetej i burgosur në barkun e peshkut deri Ditën e Ringjalljes.

E dyta: Vdekja e Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe mbetja gjallë e peshkut, në këtë gjendje peshku do të ishte një varr i lëvizshëm për kufomën e Jùnusit.

E treta: Vdekja e të dyve dhe kështu barku i peshkut do të ishte varr për Jùnusin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe tabani i detit do të ishte varr për peshkun, domethënë, ai do të ishte i varrosur në barkun e peshkut dhe peshku do të ishte i varrosur në brendësi të Tokës, deri Ditën e Ringjalljes.

Ajeti objekt studimi nuk tregon për asnjërën prej këtyre tri mundësive që u thanë këtu, por në Kur'ànin Famëlartë ka ajete të tjera që theksojnë vdekjen e të gjithëve në kohën e fundit, prandaj mbetja gjallë e Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ose e peshkut, deri Ditën e Ringjalljes, është e pamundur dhe me këtë sqarim mundësia e tretë mbetet mundësia më afër realitetit.[1]

Ka edhe një mundësi tjetër, që thotë se fraza "qëndrimi në barkun e peshkut deri Ditën e Kiametit", është e barazvlershme për kohën shumë të gjatë dhe do të thotë: në të vërtetë ai do të mbetej për një kohë shumë të gjatë në atë burg.

Ne nuk harrojmë se, të gjitha këto mundësi mund të bëheshin realitet, sikur ai të kishte lënë madhërimin e All'llahut të Gjithëfuqishëm, të mos kërkonte falje prej All'llahut të Gjithmëshirshëm dhe sikur të mos pendohej për lënien e punës më të rëndësishme, por ajo që ndodhi me atë, domethënë

[1] Duhet theksuar se interpretuesi i dëgjuar i Kur'ànit Famëlartë, dijetari poliedrik Et Tabresij, i cili shpesh i bashkon opinionet e ndryshme në fundin e ajeteve, këtu ka bindjen se duhet sjellë vetëm një mundësi, për të cilën ai është shprehur: "barku i peshkut patjetër do të bëhej varr për atë deri Ditën e Kiametit".

madhërimi i All'llahut dhe kërkimi i faljes, bënë që ai të përfshihej në faljen e All'llahut.

Kur'àni Famëlartë shton se, kur Ne e nxorëm atë prej barkut të peshkut, e lëshuam në një vend të zhveshur, pa pemë e pa bimësi dhe ai ishte i sëmurë: **"Ne e hodhëm atë në një tokë të zhveshur dhe ai ishte i sëmurë."**.

Nga që Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* nuk ishte ushqim i mirë për peshkun e madh, peshku e hodhi atë në një breg deti të thatë, pa bimësi e pa pemë. Është e qartë se ai burg i çuditshëm ndikoi shumë në shëndetin e Junùsit dhe ai u lirua prej atij burgu i drobitur e i sëmurë.

Ne nuk e dimë sa kohë qëndroi Jùnusi në barkun e peshkut, por nuk mund të përjashtohen elementet ndikues mbi atë në atë lloj burgu, pavarësisht sa e gjatë ishte koha që ai kaloi në barkun e peshkut; gjithashtu, është e vërtetë se urdhëri hyjnor kishte dalë që Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të mos tretej në barkun e peshkut, por kjo nuk do të thotë se ai nuk do të ndikohej prej faktorëve të atij burgu; prandaj, disa intrerpretues të Kur'ànit Famëlartë, kanë shkruar se Jùnusi doli prej barkut të peshkut aq i pafuqishëm sa ç'është zogu i pulës kur del prej vezës, madje ai ishte aq i rraskapitur, sa nuk kishte fuqi as të lëvizte.

Edhe një herë tjetër atë e përfshiu butësia e All'llahut të Gjithfuqishëm, ai ishte i sëmurë dhe shumë i lodhur, asnjëra prej gjymtyrëve të trupit nuk i funksiononte, veç kësaj, nxehtësia e diellit e mundonte shumë, prandaj ai kishte shumë nevojë të ishte nën hijen e butësisë së All'llahut të Lartësuar dhe Kur'àni Famëlartë e vë në dukje këtë butësi hyjnore me fjalët: Ne bëmë që

mbi atë të mbijë një bimë e madhe kungulli dhe gjethet e mëdha e të njoma të atij kungulli të bënin hije për atë: **"Ne bëmë që mbi atë të mbinte një bimë gjethemadhe."**.

Fjala e ajetit *"jaktijn"*, siç thonë gjuhëtarët dhe interpretuesit e Kur'ànit Famëlartë, është në kuptimin: çdo bimë pa kërcell, me gjethe të mëdha, siç janë bostani, kungulli, kastraveci e të ngjashme me këto bimë, por shumica e interpretuesve të Kur'ànit dhe shumë përcjellës të haditheve, kanë deklaruar se këtu, qëllimi me fjalën *"jaktijn"*, është për bimën e kungullit. Këtu duhet mbajtur shënim se fjala *"shexhereten"*, në gjuhën arabe thuhet për bimët që kanë trung e degë, si dhe për bimët që s'kanë as trung e as degë. Në lidhje me këtë çështje, kanë cituar një hadith të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ku thuhet se dikush i tha të Dërguarit të All'llahut: *"Sa shumë që e do kungullin dhe ai iu përgjegj: natyrisht, ajo bimë është pema e vëllait tim Jùnusit."*.[1]

Thuhet se gjethet e kungullit, jo vetëm që janë të mëdha, por ato kanë edhe shumë lagështi, prandaj, prej këtyre gjetheve mund të përfitohet një hije shumë e mirë; veç kësaj, dihet se kandrat nuk mblidhen rreth gjetheve të kësaj bime, kështu që Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u fut nën ato gjethe që të qetësohej prej nxehtësisë së diellit dhe në të njëjtën kohë, të ruhej edhe prej kandrave. Koha e gjatë që ai kaloi në barkun e peshkut, kishte bërë që lëkura e trupit të tij të hollohej shumë dhe të bëhej tepër e ndjeshme, aq sa ai ndjente dhimbje edhe kur mbi trupin e tij binte ndonjë kandër.

[1] Tefsiri "Rùhul Meànij", vëll. 7, f. 489.

Gjithashtu, ka mundësi që Krijuesi i Gjithëfuqishëm kishte qëllim që, në këtë fazë, të plotësonte mësimin që Ai i dha Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në barkun e peshkut, prandaj duhej që ai të ndjente ndikimin e nxehtësisë së diellit mbi lëkurën e tij të holluar dhe vetëm kështu ai do të derdhte më shumë mundim në të ardhmen, kur të merrte në dorë udhëheqjen për të shpëtuar popullin e tij prej zjarrit të Xhehennemit, ashtu siç e lexojmë këtë përmbajtje në transmetime të ndryshme.[1]

Le të lëmë bisedën për Jùnusin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe të kthehemi te populli i tij. Pasi ai u largua i zemëruar me popullin e vet, atij populli iu shfaqën argumente që u tregonin atyre fare qartë afrimin e zemërimit hyjnor dhe ato argumente jo vetëm që i lëkundën fuqishëm mendjet e tyre dhe i kthyen ata në udhëzimin e rrugës së drejtë, por i shtynë ata që të kërkojnë strehim te ai njeriu i ditur që i kishte besuar Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, i cili vazhdonte të ishte në qytetin e tyre; ata kishin qëllim ta bënin atë udhëheqës, që t'i drejtonte në rrugën e pendimit.

Në transmetime të tjera, thuhet se ata dolën në shkretëtirë dhe i ndanë veçmas nënën prej fëmijës së saj, madje ata ndanë edhe të vegjëlit e kafshëve prej nënave; ata qëndruan ndenjur, duke qarë me të thirrura dhe duke iu lutur All'llahut të Gjithëfuqishëm me sinqeritet të plotë, që t'ua pranonte atyre pendimin, t'ua falte fajet dhe mangësitë e tyre të shumta, që nuk kishin dëgjuar e nuk kishin ndjekur Profetin e All'llahut Jùnusin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

[1] Tefsiri "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 437.

Në këtë gjendje, All'llahu i Lartësuar i tërhoqi retë e ndëshkimit që qëndronin mbi ata dhe me urdhërin e All'llahut të Lartësuar, ato re të dendura u zbrazën nëpër male. Ja, populli i Jùnusit, tanimë i penduar dhe besimtar, shpëtoi në saje të butësisë së All'llahut ndaj atyre.[1]

Pas kësaj, Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u kthye te populli i tij që të shihte se ç'kishte bërë ndëshkimi i All'llahut mbi ata, por, kur ai u kthye te populli i tij, u befasua dhe nga ajo që pa u habit e u çudit: kur u largua, e la popullin e tij duke adhuruar idhujt, kurse sot i gjen ata duke besuar vetëm në All'llahun e Gjithëfuqishëm.

Për këtë gjendje të re të atij populli, Kur'àni Famëlartë, në ajetin vijues njofton:

"Ne e dërguam atë te njëqindmijë e më shumë"; kur ata besuan në All'llahun e Gjithëfuqishëm, mbi ata vërshuan mirësitë hyjnore materiale e morale, deri për një kohë të caktuar, ashtu siç njofton ajeti vijues: **"Ata besuan dhe Ne i lamë ata të jetojnë deri në një kohë."**.

Natyrisht që, pas pendimit, ata kishin një besim të thjeshtë, por pas kthimit të Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* besimi i tyre erdhi duke u shtuar, domethënë: në ata u shtua besimi në All'llahun e Lartësuar dhe në Profetin e Tij Jùnusin ata filluan të punojnë sipas udhëzimeve dhe urdhërave të Profetit të tyre.

Prej ajeteve të Kur'ànit Famëlartë, del qartë se Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u dërgua përsëri te populli i tij. Prandaj

[1] Autori i tefsirit "El Burhàn", vëll. 4, f. 35; transmetimi është prej fjalëve të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*.

ata që kanë thënë se ai u dërgua te një popull tjetër, duhet theksuar se kjo fjalë e tyre nuk është në përshtatje me kuptimin që shprehin fjalët e ajeteve të Kur'ànit Famëlartë.

Nga njëra anë, ne lexojmë fjalën e të Lartit: **"Ata besuan dhe Ne i lamë ata të jetojnë deri në një kohë."**, domethënë: populli te të cilët ne dërguan Jùnusin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishin njerëz besimtarë dhe se Ne u dhamë atyre me shumicë prej mirësive Tona të shumta, për një kohë të caktuar; nga ana tjetër, e njëjta shprehje ka ardhur edhe në suren "Jùnus", në lidhje me njerëzit e përparshëm të popullit të tij, ashtu siç e lexojmë në ajetin 98 të kësaj sureje: **"Nuk pati asnjë vendbanim banorët e të cilit besuan por besimi atyre nuk u solli asnjë dobi, përveç popullit të Jùnusit, të cilët, kur besuan, Ne e larguam prej atyre ndëshkimin e turpërimin në jetën e kësaj bote dhe i lamë ata të jetojnë deri në një kohë të caktuar."**.

Edhe prej këtij ajeti, bëhet e qartë se fraza *"ilà hijnin"*, do të thotë: deri në një kohë të caktuar, deri në fundin e jetës së tyre, deri kur atyre u vjen vdekja natyrore.

Këtu shtrohet pyetja: përse, në ajetin para ajetit të fundit, thuhet: **"njëqindmijë e më shumë"**? Por, cili është qëllimi me frazën: **"njëqindmijë e më shumë"**. Në lidhje me këtë çështje, interpretuesit e Kur'ànit Famëlartë, kanë bërë interpretime të ndryshme, por është e qartë se të tilla shprehje vijnë për të theksuar diçka dhe për t'i dhënë asaj diçkaje rëndësi dhe jo për të krijuar një gjendje ngurrimi e dyshimi.

Hulumtime

1- Paraqitje e shkurtër e jetës së Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*

Jùnusi, i biri i Metës, thirret me epitetin "Dhen'nùn", domethënë "burri i peshkut të madh". Ky epitet i është dhënë atij për shkak se tregimi i tij ka lidhje me qëndrimin e tij në barkun e peshkut të madh; ai është prej burrave të njohur dhe kuptohet qartë se ai ka lindur pas kohës së Mùsait e Hàrùnit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)*.

Disa të tjerë, kanë thënë se ai është prej bijve të Hùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe se është ngarkur prej Krijuesit të Gjithëfuqishëm të udhëzonte në rrugën e drejtë ata që kishin mbetur prej themùdëve.

Rajoni ku ai u dërgua Profet, shtrihet në një zonë të Irakut të quajtur "Nijnùj".[1]

Të tjerë kanë thënë: ai është Dërguar Profet afërsisht 825 vjet para lindjes së Mesihut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Në ditët e sotme, atje gjendet një mauzole mbi brigjet e lumit, që njihet me emrin "varri i Jùnusit".

[1] "Nijnùj" është emri i disa zonave; e para: qytet pranë Mosulit; ose në periferi të Kufes, pranë Qerbelasë; ose është emri i një qyteti në Azinë e Vogël, ose është emri i kryeqytetit të mbretërisë së ashurëve, që shtrihej në brigjet e lumit Tigër ("Dàiretul Meàrifi); të tjerë kanë thënë se "Nijnùj" ishte qyteti më i madh i mbretërisë së ashurëve dhe shtrihej në brigjet lindore të lumit Tigër dhe është ndërtuar përballë Mosulit. (Mu'xhemu kisasul Kur'àn).

Në disa libra, thuhet se Jùnusi ishte prej pinjollëve të Beni Israilëve dhe u dërgua Profet te banorët e qytetit Nijnùj pas Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të dy!)*. Në librin "Jùnàh", që është njëri prej librave të Teuràtit (Dhiata e vjetër), në studime të ndara, flitet për jetën e Profetit Jùnus nën titullin: "Jùnàh bin Metà". Sipas asaj që thuhet në këtë libër, Jùnusi ishte ngarkuar të shkonte në qytetin e madh Nijnùj dhe aty të përballej me despotët më të këqij që ishin atje.

Më pas, Teuràti përmend ngjarje të tjera, që janë shumë të ngjashme me ato që kanë ardhur në Kur'ànin Famëlartë, por patjetër që ka ndryshime. Në transmetimet islame thuhet: Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i bëri thirrje popullit të tij të besonin në All'llahun, Zotin Një e të Vetëm dhe ai e zbatoi misionin me të cilin ishte autorizuar të kumtonte në këtë fushë. Gjithashtu, në Teuràt thuhet se, pasi populli i tij nuk pranoi thirrjen e tij, ai i mallkoi ata, u largua prej tyre dhe i ndodhën ato që i ndodhën në ngjarjen e anijes e të peshkut të madh. Por Teuràti i sotshëm përmend një shprehje të papranueshme kur thotë: Jùnusi, para se të dërgohej Profet te populli i tij, kërkoi që ai të lirohej prej kësaj detyre shumë të rëndësishme, ai nuk bënte më thirrje, ai pësoi disfatë dhe për rrjedhojë atij i ndodhën ngjarjet e anijes e të peshkut të madh.

Por edhe më shumë e çuditshme është se Teuràti thotë: Jùnusi ndjeu dhimbje të fortë dhe u zemërua shumë kur All'llahu i Gjithëfuqishëm e hoqi ndëshkimin prej popullit të tij kur ata shpallën hapur pendimin e tyre.[1]

[1] "Teuràti", libri "Profeti Jùnah", kapitujt: 1, 2, 3 dhe 4.

Gjithashtu, në një kapitull të Teuràtit, thuhet: Jùnusi është dërguar Profet dy herë; herën e parë ai kundërshtoi dhe për këtë ai u vu në sprovën e dhimbshme; edhe herën e dytë ai u dërgua Profet përsëri në qytetin Nijnùj, por kësaj here banorët e atij qyteti ishin zgjuar prej gjumit të shkujdesjes dhe kishin besuar në All'llahun e Lartësuar; ata ishin penduar dhe ishin përfshirë në faljen hyjnore, por kjo falje nuk e gëzoi zemrën e Jùnusit.

Duke krahasuar ato që kanë ardhur në Kur'ànin Famëlartë e në transmetimet islame dhe ato që thuhen në librin e Teuràtit të sotshëm, del qartë shkalla e ulët e Teuràtit të reformuar në lidhje me Profetin e All'llahut Jùnusin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Në Teuràtin e tanishëm, thuhet se ai nuk e pranoi kumtin hyjnor që ishte ngarkuar të kumtonte; herë tjetër, Teuràti i sotshëm flet për zemërimin e tij për shkak të vendimit të All'llahut të Lartësuar që populli i tij i penduar ishte përfshirë në faljen e në mëshirën hyjnore. Të gjitha këto, tregojnë se Teuràti i ditëve tona është një libër në të cilin është e pamundur mbështetja në këtë libër, në çfarëdo forme qoftë.

Pavarësisht nga këto që u thanë, Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* është prej Profetëve të mëdhenj, të cilët i përmend Kur'àni Famëlartë me fjalët më të bukura e më të merituara.

2- Si mbeti gjallë Jùnusi në barkun e peshkut?

Më sipër, thamë se ne nuk kemi ndonjë argument të fuqishëm, që të shpjegojë qartë sa kohë mbeti Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në barkun e peshkut? Vallë, koha që ai qëndroi në barkun e peshkut ishte disa orë, disa ditë, apo ishte disa javë?

Në disa transmetime islame, thuhet se ai qëndroi në barkun e peshkut nëntë orë; në transmetime të tjera thuhet se ka qëndruar tri ditë dhe në disa transmetime të tjera thuhet se ai ka qëndruar në barkun e peshkut më shumë se tri ditë, madje disa të tjerë kanë thënë se ai ka qëndruar në barkun e peshkut dyzetë ditë.

Gjithësesi, ne nuk keni ndonjë argument që të vërtetojë ndonjërën prej këtyre thënieve.

Në tefsirin e Ali Ibrahimit, citohet një transmetim i ardhur prej Prijësit të besimtarëve Ali bin Ebù Tàlibit *(Paqja qoftë mbi të!)*, në të cilin thuhet se Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ka qëndruar nëntë orë në barkun e peshkut.[1]

Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë prej Ehli Synetit, kanë thënë se koha e qëndrimit të Jùnusit në barkun e peshkut, ishte vetëm një orë.[2]

Sa e gjatë ishte koha e qëndrimit të tij në barkun e peshkut? Pa dyshim që kjo çështje është prej punëve të jashtëzakonshme, sepse dihet që njeriu e ka të pamunduar të mbetet gjallë në një

[1] Tefsiri i Ali Ibrahimit, sipas asaj që ka ardhur në tefsirin "Nùruth Thakalejn", vëll. 4, f. 426.
[2] Tefsiri i Kurtubij'jit, vëll. 8, f. 5568.

mjedis pa ajër; por, kur vërejmë se fetusi jeton disa muaj i gjallë në barkun e nënës së tij, ne e dimë se kjo mundësohet për shkak se fetusit nuk i funksionon aparati i frymëmarrjes dhe se oksigjenin e duhur fetusi e merr nëpërmjet gjakut të nënës së tij.

Duke parë me kujdes në këtë fakt, ajo që ngjau me Jùnusin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* nuk ka dyshim që është mrekulli dhe kjo nuk është mrekullia e parë për të cilën flet Kur'àni Famëlartë: Krijuesi i Gjithëfuqishëm e ruajti Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në mesin e zjarrit; All'llahu shpëtoi Mùsànë *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe Beni Israilët prej mbytjes në ujë, pasi hapi për ata një rrugë të thatë në mesin e detit; All'llahu i Lartësuar e shpëtoi Nùhun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* prej tufanit, me anën e një varke të thjeshtë, që më pas ai të zbriste shëndoshë e mirë në një tokë të thatë; pa dyshim që All'llahu i Lartësuar ka fuqi të ruajë edhe njërin prej robve të Tij të sinqertë brenda barkut të peshkut, për aq kohë sa Ai kishte vendosur që ai të mbetej aty.

Natyrisht që peshq të këtillë të mëdhenj ka pasur në të kaluarën, ka edhe sot dhe ekzistenca e peshqve të këtillë nuk përbën çudi. Dihet që edhe në ditët e sotme ekzistojnë lloje peshqish të mëdhenj, që quhen balena, gjatësia e të cilave arrin deri tridhjetë metra dhe që është gjallesa më e madhe në Tokë, duke theksuar se vetëm zemra e balenës peshon njëmijë kilogramë.

Në këtë sure, ne u njohëm shkurtimisht me tregimet e Profetëve të përparshëm, të cilët kaluan nëpër sprova të rënda dhe Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte i fundit në serinë e atyre Profetëve.

3- Mësime të mëdha në tregime të shkurtra

Siç e dimë, Kur'àni Famëlartë, duke shpalosur këto tregime, ka qëllim edukimin e njeriut, sepse Kur'àni Famëlartë nuk është libër tregimesh, por është Libër që ka si objektiv ndërtimin dhe edukimin e njeriut.

Prej këtij tregimi të çuditshëm, mund të nxirren shumë këshilla e mësime:

a) Lënia e punës me më shumë përparësi prej një Profeti, te All'llahu i Lartësuar numërohet veprim shumë i rëndësishëm dhe çon deri në qortimin e atij Profeti, sepse grada e Profetëve është shumë e lartë, prandaj edhe shkujdesja më e vogël nga ana e Profetëve, është e barabartë me një faj të madh që bëjnë njerëzit e zakonshëm dhe për këtë shkak, All'llahu i Gjithëfuqishëm e ka emërtuar robin e Tij Jùnusin, në këtë ajet, "i arratisuri", që do të thotë: skllavi i arratisur.

Në disa transmetime, tregohet se pasagjerët që ishin në anije thanë: në mesin tonë kemi një njeri mëkatar!

Dhe fundi i punës, Krijuesi i Gjithëfuqishëm e vuri atë në sprovë me një burg tmerrues, por e fali, pasi ai u pendua e u kthye te All'llahu, ashtu siç ishte, i pafuqishëm e i sëmurë.

Të gjithë duhet të dinë se negligjenca në punë nuk mund të pranohet prej asnjë njeriu. Përsa u përket Profetëve të All'llahut e njerëzve të mirë, ata e arrijnë gradën e lartë vetëm në saje të bindjes së tyre të sinqertë ndaj urdhërave të All'llahut të Gjithëfuqishëm, ndryshe, All'llahu nuk mban lidhje afërsie me

cilindo qoftë. Veç kësaj, qëndrimi i vendosur që ka shfaqur All'llahu i Lartësuar ndaj robit të Tij Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e shpjegon qartë lartësinë e gradës së këtij Profeti të madh.

b) Ngjarjet e këtij tregimi, veçanërisht ato që tregohen në ajetin 87 të sures "El Enbijà", zbulojnë qartë rrugët e shpëtimit të besimtarëve prej brengosjes, hidhërimit, sprovave e problemeve. Ajo është e njëjta rrugë që ndoqi Jùnusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Besimtari e pranon gabimin e tij para All'llahut të Gjithëfuqishëm, madhërimi i sinqertë i All'llahut, pastrimi e dëlirja e All'llahut prej mangësive e nevojave dhe kthimi i plotë tek Ai.

c) Ky tregim shpjegon se si njerëzit fajtorë, që e meritonin ndëshkimin, gjetën mundësi që, më në fund, të ndryshojnë udhën nëpër të cilën kishin ecur gjatë historisë dhe të kthehen në "prehërin" e mëshirës hyjnore; por, me këtë kthim, ata shpëtuan veten prej ndëshkimit. Siç e pamë, shpëtimi i tyre ishte i kushtëzuar me zgjimin e tyre të plotë prej shkujdesjes, para se të ishte vonë; gjithashtu, ishte i kushtëzuar edhe me detyrën e tyre për të zgjedhur një njeri "dijetar" si udhëheqës të tyre.

d) Ajo ngjarje shpjegon qartë se besimi në All'llahun e Lartësuar dhe pendimi për fajet e kryera, veç të tjerave është shkak për zbritjen e mirësive morale. Gjithashtu, bën që të vijnë edhe mirësitë e kësaj bote dhe bën që ato të jenë në zgjedhjen e vetë njeriut, thënë ndryshe, besimi i sinqertë në All'llahun e Gjithëfuqishëm, bën që të lulëzojë një gjendje e mbarë popullimi e ndërtimi dhe një gjendje që zgjat jetën e njerëzve. Një kuptim të ngjashëm e pamë edhe në tregimin e Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë*

mbi të!) për të cilin, me ndihmën e All'llahut të Lartësuar, do të mësojmë më shumë gjatë komentimit të sures "Nùh".

e) Rrjedha e ngjarjeve në këtë tregim, shpalos qartë fuqinë e madhe të Krijuesit të Gjithëfuqishëm. Gjithashtu, prej ngjarjeve të këtij tregimi, mësojmë se, para fuqisë së All'llahut nuk mund të qëndojë asnjë send dhe për Atë asgjë nuk është e pamundur, madje as ruajtja e jetës së njeriut në gojën e në barkun e një bishe trupmadhe dhe pastaj nxjerrja e tij prej andej shëndoshë e mirë. Kjo punë, për ne shpjegon qartë se, çdo send që ekziston në këtë botë e në Gjithësi, është thjesht një mjet në "dorën" e të Gjithëfuqishmit dhe plotësisht i bindur ndaj urdhërave të Tij.

4- Përgjigje për një pyetje

Shtrohet pyetja: Gjatë shpjegimit të tregimeve rreth popujve të përparshëm, që kanë ardhur në Kur'ànin Famëlartë, vëmë re se, kur mbi ata ka zbritur ndëshkimi i All'llahut dhe është fjala për ndëshkimin asgjësues që ra mbi ata popuj mizorë e mendjemëdhenj, pendimi i tyre nuk ishte i pranueshëm dhe se ata e kishin të pamundur të bënin kthesë, atëherë si u përjashtua populli i Jùnusit prej këtij rregulli?

Për këtë pyetje ka dy përgjigje:

E para: Ndëshkimi nuk kishte zbritur mbi ata, sepse ata, kur panë argumentet e thjeshtë që i paralajmëronin për dënimin e rëndë, e shfrytëzuan rastin, besuan në All'llahun, u penduan dhe kërkuan faljen e All'llahut para se mbi ata të binte sprova e rëndë.

E dyta: Ndëshkimi i atyre nuk ishte për t'i asgjësuar ata, por ishte një paralajmërim edukues para se mbi ata të lëshohej dënimi asgjësues. Kjo është rruga e ndjekur në lidhje me popujt e përparshëm, domethënë: në fillim atyre u janë shfaqur disa argumente që tregonin dënimin si rastin e fundit për ata; nëse ata do të besonin, All'llahu i Lartësuar e largon ndëshkimin prej tyre. Por nëse ata janë të vendosur në arrogancën e në despotizmin e tyre, All'llahu lëshon mbi ata dënimin dhe i asgjëson, nga i pari deri tek i fundit, ashtu siç ndëshkoi popullin e Faraonit, me lloje të ndryshme ndëshkimi, para se t'i mbyste ata në ujin e detit.

5- Shorti dhe ligjshmëria e shortit në Islam

Kanë ardhur disa transmetime në lidhje me shortin dhe ligjshmërinë e hedhjes së shortit në Islam. Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë fjalën e tij: "A mund të ketë çështje më të drejtë se shorti kur puna lihet në dorën e All'llahut të Gjithëfuqishëm, i Cili thotë: **'Ai mori pjesë në shortin dhe ishte prej atyre që do të hidheshin** (nga anija)**.'**".[1]

Ky transmetim, tregon se shorti është rruga e vetme për një zgjidhje të drejtë të një problemi, në rastin kur është e pamundur të gjendet një rrugë tjetër për zgjidhjen e atij problemi, me kushtin që puna patjetër të lihet vetëm në "dorën" e All'llahut të Lartësuar, ashtu siç ka ardhur në tregimin e Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ku shorti u përputh plotësisht me realitetin.

[1] Tefsiri "El Burhàn", vëll. 4, f. 37.

Ky kuptim, ka ardhur i shpjeguar shumë qartë në një hadith të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ai ka thënë: *"S'ka ndonjë grup njerëzish që hedhin short në mes tyre dhe pastaj punën e tyre e lënë në 'dorën' e All'llahut të Lartësuar, patjetër që për ata del ai që ka të drejtë."*.[1]

Ai që dëshiron informacion më shumë në lidhje me këtë çështje, le të lexojë librin me titull "El Kavàidul fikhij'jeh", të autorit të këtij tefsiri.

[1] "Uesàilush Shij'ah" vëll. 18, libri "Gjykimi", kapitulli: gjykimi me short në çështjet me probleme; kapitujt: mënyra e gjykimit dhe dispozitat e ankimit, kapitulli 13, vëll. 5.

Ajetet: 149 – 160

فَٱسْتَفْتِهِمْ أَلِرَبِّكَ ٱلْبَنَاتُ وَلَهُمُ ٱلْبَنُونَ ﴿١٤٩﴾ أَمْ خَلَقْنَا ٱلْمَلَٰٓئِكَةَ
إِنَٰثًا وَهُمْ شَٰهِدُونَ ﴿١٥٠﴾ أَلَآ إِنَّهُم مِّنْ إِفْكِهِمْ لَيَقُولُونَ ﴿١٥١﴾ وَلَدَ
ٱللَّهُ وَإِنَّهُمْ لَكَٰذِبُونَ ﴿١٥٢﴾ أَصْطَفَى ٱلْبَنَاتِ عَلَى ٱلْبَنِينَ ﴿١٥٣﴾ مَا لَكُمْ كَيْفَ
تَحْكُمُونَ ﴿١٥٤﴾ أَفَلَا تَذَكَّرُونَ ﴿١٥٥﴾ أَمْ لَكُمْ سُلْطَٰنٌ مُّبِينٌ ﴿١٥٦﴾ فَأْتُوا۟
بِكِتَٰبِكُمْ إِن كُنتُمْ صَٰدِقِينَ ﴿١٥٧﴾ وَجَعَلُوا۟ بَيْنَهُۥ وَبَيْنَ ٱلْجِنَّةِ نَسَبًا ۚ وَلَقَدْ
عَلِمَتِ ٱلْجِنَّةُ إِنَّهُمْ لَمُحْضَرُونَ ﴿١٥٨﴾ سُبْحَٰنَ ٱللَّهِ عَمَّا يَصِفُونَ ﴿١٥٩﴾ إِلَّا
عِبَادَ ٱللَّهِ ٱلْمُخْلَصِينَ ﴿١٦٠﴾

"Dhe ti (o Muhammed) **pyeti ata: a për Zotin tënd janë vajzat dhe për ata janë djemtë?"**

"Apo kur Ne i krijuam engjëjt femra ata ishin aty."

"Vini re se si ata, prej trillimeve të tyre, patjetër thonë:"

"All'llahu ka lindur; pa dyshim që ata janë gënjeshtarë."

"Mos vallë Ai zgjodhi vajzat mbi djemtë?"

"Si e keni punën, qysh gjykoni kështu?"

"A nuk po mendoni?"

"A keni ju ndonjë argument të qartë?"

"Silleni sa më parë atë librin tuaj, nëse thoni të vërtetën."

"Ata (idhujtarët) **thanë se në mes Tij e në mes xhindëve ka lidhje afërsie, por xhindët e dinë mirë se ata** (idhujtarët) **me siguri janë të flakur në zjarr."**

"All'llahu është krejtësisht i dëlirë nga ato që ata i përshkruajnë Atij për shok."

"Me përjashtim të robve të sinqertë të All'llahut."

Komentimi

Akuza të këqija

Pas shpalosjes së gjashtë tregimeve prej tregimeve të Profetëve të përparshëm, të mbushur me shumë mësime edukuese, Kur'àni Famëlartë ndërron bisedën dhe fillon të trajtojë një çështje tjetër, që ka lidhje me idhujtarët e Mekës së asaj kohe, duke ekspozuar para nesh modele të ndryshme të idhujtarisë së tyre dhe gjykimit të tyre jo vetëm të gabuar, por edhe shumë të

ashpër; pastaj, Kur'àni Famëlartë, me argumente të formës së prerë, hedh poshtë mendimet e tyre mitike.

Çështja shtrohej kështu: Një grup prej idhujtarëve arabë, për shkak të injorancës së tyre dhe mendimeve të tyre sipërfaqësore që kishin mbi çështjet, e masnin All'llahun e Gjithëfuqishëm me të njëjtin metër me të cilin masnin veten e tyre, prandaj herë thoshin se All'llahu i Gjithëfuqishëm ka fëmijë, herë tjetër thoshin se All'llahu ka grua.

Fiset arabe: "Xhuhejneh", "Sulejm", "Khuzà'ah" dhe "Benij Melijh", besonin se engjëjt janë vajzat e All'llahut të Lartësuar; një tjetër grup idhujtarësh besonin se xhindët janë fëmijë të All'llahut, ndërsa disa të tjerë besonin se xhindët janë gratë e All'llahut të Gjithëfuqishëm.

Iluzionet e tyre mitike, jo vetëm që ishin shkaku kryesor i shmangies së tyre prej rrugës së vërtetë, por mitet në të cilët ata besonin, kishin fshirë prej zemrave të tyre çdo gjurmë të besimit në Njëtimin e All'llahut.

Në një transmetim, ka ardhur se milingona e përfytyron Zotin e saj me dy tentakula, ashtu siç ka ajo vetë dy tentakula.[1]

Është e qartë se, mendja e shkurtër e çon njeriun të bëjë të këtilla krahasime në mes Krijuesit dhe të krijuarit. Pa dyshim, ky krahasim i tyre është edhe më i zi se shkaqet që e çojnë njeriun në rrugën e humbjes e në mosnjohjen e All'llahut të Gjithëfuqishëm.

[1] Imam Bàkiri *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Sa herë që ju e përshkruani Atë, me iluzionet tuaja, në kuptimet e Tij të imta të krijuar e të punuar ashtu siç jeni ju, kjo thënie juaj kthehet te ju dhe mbase edhe milingona e vogël pandeh se All'llahu ka dy tentakula, sepse kjo është forma e saj e plotësuar."* ("Bihàrul Enuàr", vëll. 69, f. 293).

Kur'àni Famëlartë u përgjigjet atyre që i përfytyrojnë engjëjt femra dhe thonë se janë bijat e All'llahut, me tri rrugë: me rrugën e provës, me rrugën e logjikës dhe me tekst. Në fillim, All'llahu i Lartësuar thotë: Pyeti ata nëse me të vërtetë All'llahu ka bërë që për veten e Tij të ketë vajza dhe ata të kenë djem: **"Dhe ti** (o Muhammed) **pyeti ata: a për Zotin tënd janë vajzat dhe për ata janë djemtë?"**.[1]

Qysh thoni për All'llahun gjëra që nuk i pranoni për veten tuaj? Sipas bestytnive të tyre, ata e urrenin shumë të kishin fëmijë vajza dhe kishin shumë dëshirë të kishin vetëm djem, sepse djemtë për ata kishin një rol shumë ndikues në luftërat e në fushatat që ata ndërmerrnin kundër fiseve të tjera, në një kohë që vajzat, sipas bestytnive të tyre të kota, nuk kishin mundësi të jepnin një ndihmë të këtillë.

Pa dyshim, djali dhe vajza, nga pikëpamja njerëzore dhe nga pikëpamja e vlerësimit te All'llahu i Lartësuar, janë të barabartë dhe ajo që e dallon personalitetin e djalit e të vajzës është vetëm përkushtimi e pastërtia. Një kuptim i ngjashëm me mendësinë e atyre idhujtarëve, shpjegohet edhe në sure të tjera të Kur'ànit Famëlartë, siç është, për shembull, shpjegimi që japin ajetet 21 dhe 22 të sures "En Nexhm": **"A për ju janë meshkujt dhe për Atë janë femrat? Atëherë kjo është një ndarje e padrejtë."**.

Më pas, në këto ajete biseda kalon në paraqitjen e një argumenti të gjallë kundër kësaj çështjeje dhe në formë pyetjeje

[1] Fjala e ajetit *"festeftihim"*, në rrënjën e saj *"fetuà"*, do të thotë: përgjigje për çështje të vështira.

mohuese, i Larti thotë: **"Apo kur Ne i krijuam engjëjt femra ata ishin aty?"**.

Pa asnjë dyshim që përgjigja e tyre për këtë pyetje është negative; asnjëri prej tyre s'ka mundësi të mëtojë se ai ishte i pranishëm gjatë krijimit të engjëjve.

Herë tjetër, Kur'àni Famëlartë shtron argumentin logjik të marrë prej postulateve logjike të idhujtarëve dhe thotë: **"All'llahu ka lindur; pa dyshim që ata janë gënjeshtarë. Mos vallë Ai zgjodhi vajzat mbi djemtë?"**.

A e kuptoni se ç'thoni dhe qysh gjykoni kështu: **"Si e keni punën, qysh gjykoni kështu?"**.

A nuk ka ardhur koha të hiqni dorë prej këtyre miteve e iluzioneve të këqija e të dëmshme? Dhe ajeti vijues i pyet ata: **"A nuk po mendoni?"**.

Dijeni mirë se kjo fjalë e juaja është e gabuar që nga themeli, madje është aq e gabuar, sa edhe çdo njeri që ka fare pak mendje e dituri dhe mendon qoftë edhe fare pak për këtë çështje, menjëherë do të kuptojë sa të gabuara janë këto mëtimet tuaja.

Pasi u vërtetua pavlefshmëria e mëtimeve të tyre mitike, njëri me argument praktik dhe tjetri me argument logjik, do të kalojmë në shtrimin e argumentit të tretë, argumentit tekst, ashtu siç thotë Kur'àni Famëlartë, duke iu drejtuar atyre drejtpërdrejt: sikur ato mëtimet tuaja të ishin të vërteta, patjetër do të ishin përmendur në librat e përparshëm dhe menjëherë Kur'àni Famëlartë i pyet ata: A keni ju ndonjë argument të qartë që të vërtetojë mëtimin tuaj?: **"A keni ju ndonjë argument të qartë?"**.

Nëse ju thoni të vërtetën, atëherë silleni atë libër sa më parë: **"Silleni sa më parë atë librin tuaj, nëse thoni të vërtetën."**.

Në cilin libër gjendet ky mëtimi juaj? Në cilën Shpallje të All'llahut është përmendur? Cilit Profeti i ka zbritur?

Kjo fjalë është e ngjashme me fjalët e tjera me të cilat Kur'àni Famëlartë u flet drejtpërdrejt adhuruesve të idhujve, ashtu siç ka ardhur në ajetet 19-21 të sures "Ez Zukhruf": **"Edhe për engjëjt që janë rob të All'llahut, ata thanë se janë femra. A mos ishin ata të pranishëm kur u krijuan engjëjt?; dëshmia e tyre është regjistruar dhe** (për këtë shpifje) **ata do të merren në pyetje. Ata thanë: sikur të kishte dashur i Gjithëmëshirshmi, ne nuk do t'i adhuronim ata** (idhujt)**; për fjalët që ata thonë, s'kanë asnjë dijeni, ata vetëm sa belbëzojnë** (gënjeshtra)**. Apo Ne u kemi dhënë atyre ndonjë libër para këtij** (Kur'ànit) **dhe ata i përmbahen atij libri?"**.

Jo dhe jo, mëtimet e tyre të gabuara nuk janë përmendur në librat qiellorë, mëtimet e tyre janë thjesht mite të mbartura prej një brezi injorant, në brezin tjetër po aq injorant. Patjetër që këto mëtime të idhujtarëve janë të papranueshme, për faktin se nuk kanë asnjë bazë, ashtu siç e pamë në ajetin e fundit të ajeteve të lartpërmendur të sures "Ez Zukhruf": **"Apo Ne u kemi dhënë atyre ndonjë libër para këtij** (Kur'ànit) **dhe ata i përmbahen atij libri?"**.

Tani le të shikojmë shpifjen tjetër të idhujtarëve, që thoshin se në mes All'llahut e xhindëve ka lidhje afërsie?

Në lidhje me këtë pyetje, janë bërë interpretime të ndryshme, prej të cilave:

Disa kanë thënë: në të vërtetë, ata ishin dualistë, besonin se ka dy zota (All'llahu na ruajt!); ata besonin se All'llahu dhe djalli janë vëllezër dhe thoshin: All'llahu është krijuesi i dashurisë, kurse djalli është krijuesi i të këqijave.

Ky interpretim është krejtësisht i papranueshëm, për faktin se doktrina "dualiste" nuk njihej ndër arabët e asaj kohe, por ajo doktrinë ishte e përhapur në Iran, gjatë kohës së sundimit të dinastisë sasanide

Të tjerë kanë thënë: xhindët janë vetë engjëjt, sepse edhe xhindët janë qenie që nuk i shohin sytë.

Kur'àni Famëlartë shpjegon se fjala "xhind" përdoret edhe për të treguar engjëjt. Kurse me lidhjen e afërsisë që ata mëtonin, qëllimi është lidhja që mëtonin arabët e kohës së injorancës, para Islamit, kur thoshin se engjëjt janë vajzat e All'llahut.

Këtij interpretimi i përgjigjen vetë ajetet objekt studimi. Në këto ajete, studimi shtrihet në dy tema, duke shtuar se përdorimi i fjalës "xhind" ka ardhur për të treguar engjëjt, por në veçanti një gjë e këtillë nuk ka ardhur në Kur'ànin Famëlartë.

Ka edhe një interpretim të tretë, që thotë: ata i konsideronin xhindët gra të All'llahut, kurse engjëjt i konsideronin bija të All'llahut.

Edhe ky interpretim, gjithashtu, është krejtësisht i përjashtuar, sepse përdorimi i fjalës *"neseben"* – *"afërsi fisi"* nuk thuhet për gruan.

Interpretimi që është më shumë në përshtatje prej tërësisë së interpretimeve të bëra në lidhje me çështjen e lidhjes së afërsisë,

ka për qëllim të tregojë të gjitha format e lidhjeve e të marrëdhënieve, madje edhe kur nuk ka asnjë lidhje afërsie në ato marrëdhënie e lidhje. Ne e dimë se, një grup idhujtarësh arabë adhuronin xhindët dhe mëtonin se xhindët janë ortakë me All'llahun, prandaj ata mëtonin ekzistencën e lidhjeve të afërsisë në mes xhindëve dhe All'llahut.

Patjetër që Kur'àni Famëlartë i hedh poshtë me neveri këto lloje doktrinash mitike dhe thotë se ishin idhujtarët ata që adhuronin xhindët dhe thoshin se ka lidhje afërsie në mes xhindëve e në mes All'llahut, megjithëse xhindët e dinin shumë mirë se idhujtarët do të dalin para Gjykatës së Drejtësisë së All'llahut, ku do të japin llogari dhe ku do të marrin edhe dënimin: **"Por xhindët e dinë mirë se ata** (idhujtarët) **me siguri janë të flakur në zjarr."**.

Të tjerë janë shprehur për mundësinë e interpretimit vijues për ajetin objekt studimi dhe sipas këtij interpretimi thuhet: në të vërtetë, xhindët që mashtrojnë njerëzit, e dinë mirë se Ditën e Gjykimit, ata (idhujtarët) do të sillen para Gjykatës së Drejtësisë SË All'llahut për të dhënë llogari dhe për të marrë dënimin.

Gjithësesi, interpretimi i parë është më i përshtatshëm.[1]

All'llahu i Lartësuar e ka pastruar Veten prej fjalëve që thoshin ata rrugëhumbur në lidhje me cilësitë e larta të All'llahut të Gjithëfuqishëm dhe për këtë, ajeti vijues dëshmon: **"All'llahu është krejtësisht i dëlirë nga ato që ata i përshkruajnë Atij për shok."**. Në vijim, All'llahu i Lartësuar ka përveçuar robtë e Tij të sinqertë, të cilët e përshkruajnë All'llahun e Lartësuar në bazë të

[1] Përemri *"hum"* – *"ata"* në rastin e parë u referohet idhujtarëve, kurse në rastin e dytë u referohet xhindëve.

diturisë e të njohjes së thellë me ato cilësi, që janë të përveçme, vetëm për All'llahun e Gjithëfuqishëm, sepse ata janë ashtu siç i ka cilësuar All'llahu i Lartësuar **"robtë e Tij të sinqertë"**. Janë njerëz të pastër prej të gjitha formave të idhujtarisë, njerëz që nuk ndjekin dëshirat e ulta, njerëz që janë larg injorancës e rrugës së humbjes. Këta rob të sinqertë e përshkruajnë Krijuesin e Gjithëfuqishëm vetëm me ato cilësi që Ai ka lejuar ta përshkruajnë.[1]

Rreth frazës **"Me përjashtim të robve të sinqertë të All'llahut"**, kemi vënë një studim në fundin e ajetit 128 të kësaj sureje.

Po, për të njohur All'llahun e Lartësuar, nuk duhet të ndiqen mitet e ardhur prej popujve injorantë dhe që njeriu ka turp t'i përmendë mitet e injorantëve të përparshëm. Në të kundërt, është detyrë të ndiqen robtë e sinqertë të All'llahut, të cilët flasin me fjalë që e bëjnë shpirtin e njeriut të fluturojë në lartësitë e qiejve, e shkrijnë shpirtin e tij në dritat e Njëtimit të All'llahut, zemrën e tij e pastrojnë prej ferrave të idhujtarisë dhe fshijnë prej mendjes së njeriut çdo lloj formësimi e përngjasimi për All'llahun e Gjithëfuqishëm.

[1] Sipas këtij interpretimi, shprehja e ajetit të fundit të këtij grupi ajetesh *"il'là ibàdell'llàhi"* – **"Me përjashtim të robëve të All'llahut"** është përveçim i marrë prej përemrit të foljes që është në fundin e ajetit të parafundit të këtij grupi ajetesh *"jesifùne"* – **"ata përshkruajnë"**; të tjerë, kanë thënë: është përveçim i marrë prej përemrit të fjalës që ka ardhur para dy ajeteve të fundit të këtij grupi ajetesh *"muhdarùne"* – **"ata janë të flakur në zjarr"**; ka edhe shumë opinione të tjera, por opinioni i parë është më i përshtatshmi; gjithësesi, përveçimi për robtë e sinqertë të All'llahut është përveçim i padiskutueshëm.

Prandaj, patjetër duhet të lexohen thëniet e sahabëve dhe të dijetarëve islamë dhe në mënyrë të veçantë fjalët e të Dërguarit më të nderuar (P*aqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij)* që të shohin se njerëzit ndriçohen me dritën e cilësive me të cilat i Larti e ka përshkruar atë.

Ajetet: 161 – 170

فَإِنَّكُمۡ وَمَا تَعۡبُدُونَ ﴿١٦١﴾ مَآ أَنتُمۡ عَلَيۡهِ بِفَٰتِنِينَ ﴿١٦٢﴾ إِلَّا مَنۡ هُوَ صَالِ
ٱلۡجَحِيمِ ﴿١٦٣﴾ وَمَا مِنَّآ إِلَّا لَهُۥ مَقَامٞ مَّعۡلُومٞ ﴿١٦٤﴾ وَإِنَّا لَنَحۡنُ ٱلصَّآفُّونَ
﴿١٦٥﴾ وَإِنَّا لَنَحۡنُ ٱلۡمُسَبِّحُونَ ﴿١٦٦﴾ وَإِن كَانُواْ لَيَقُولُونَ ﴿١٦٧﴾ لَوۡ أَنَّ عِندَنَا
ذِكۡرٗا مِّنَ ٱلۡأَوَّلِينَ ﴿١٦٨﴾ لَكُنَّا عِبَادَ ٱللَّهِ ٱلۡمُخۡلَصِينَ ﴿١٦٩﴾ فَكَفَرُواْ بِهِۦۖ
فَسَوۡفَ يَعۡلَمُونَ ﴿١٧٠﴾

“As ju e as ata që ju adhuroni.”

“Ju nuk mund të vini në provë kundër Atij (besimit në All’llahun)**.”**

“Me përjashtim të atij që do të digjet në Xhehennem.”

“Nuk ka ndonjë prej nesh (engjëjve) **që nuk ka një pozitë të caktuar.”**

“Ne (engjëjt) **jemi të rreshtuar.”**

“Ne (engjëjt) **jemi prej atyre që e madhërojmë** (All’llahun)**.”**

“Edhe pse ata thoshin:”

"Sikur ndër ne të kishte një libër prej të parëve."

"Patjetër që ne do të ishim rob të sinqertë të All'llahut."

"Dhe (kur atyre u erdhi libri) **ata e mohuan atë** (Kur'ànin)**; por shumë shpejt do ta kuptojnë."**

Komentimi

Mëtime të rreme

Ajetet para këtij grupi ajetesh, flisnin për zotat e ndryshëm që adhuronin idhujtarët. Edhe ajetet objekt studimi, trajtojnë të njëjtën temë dhe në disa prej ajeteve të këtij grupi ajetesh, shpjegohet qartë e gjithë tema që ka të bëjë me adhurimin e idhujve.

Në fillim të studimit, këto ajete theksojnë se cytjet e adhuruesve të idhujve nuk kanë asnjë ndikim në njerëzit e pastër punëmirë; kurse zemrat tuaja të sëmura dhe shpirtrat tuaj të këqij, o idhujtarë, janë dorëzuar para këtyre cytjeve, ashtu siç njofton i Larti me fjalën e Tij: **"As ju e as ata që ju adhuroni."**.

Po, as ju e as ata që ju adhuroni, s'keni mundësi të mashtroni asnjë njeri me anë të shpifjeve e ngatërresave dhe ta sprapsni atë prej rrugës që çon te All'llahu i Lartësuar: **"Ju nuk mund të vini në provë kundër Atij** (besimit në All'llahun)**"**, ju nuk mund të vini në provë asnjë, përveç atij që do vetë të digjet në

zjarrin e Xhehennemit: **"Me përjashtim të atij që do të digjet në Xhehennem."**.

Këto ajete, në kundërshtim me atë çka mendojnë ithtarët e grupit të "xheberive" - ata që besojnë se njeriu është i imponuar në të gjitha punët e tij - në të vërtetë janë një argument kundër mëtimit të tyre të gabuar. Këto ajete, tregojnë qartë se askush nuk mund të përligjet për shmangien e tij prej udhëzimit në rrugën e drejtë dhe të mëtojë se u mashtrua, ose të mëtojë se shmangia e tij dhe adhurimi që ai bënte për idhujt, ishte për shkak të atyre cytjeve. Për të gjitha këto, ajetet e nderuara thonë qartë: ju, o idhujtarë, jeni të pafuqishëm që, me mashtrimet tuaja, të çoni njerëzit në rrugën e humbjes, përveçse kur ata vetë, me vullnetin e tyre, janë orientuar të ecin në rrugën që i çon ata në Xhehennem.

Shprehja e ajetit *"sàlil xhehijmi"* dëshmon fjalët që u thanë më sipër, sepse fjala *"sàli"*, sipas rregullave të gjuhës arabe, ka ardhur në formën e "emrit veprues" dhe kur fjala përdoret në formën e emrit veprues në lidhje me një qenie me logjikë, është në kuptimin: kryerja e punës me vullnetin e me zgjedhjen e vetë njeriut, atëherë shprehja *"sàlil xhehijmi"* do të thotë: dëshira e njeriut për t'u djegur në zjarrin e Xhehennemit dhe me këtë mbyllen të gjitha rrugët para atyre që e kanë lënë udhëzimin në rrugën e drejtë.

Është e çuditshme që, disa interpretues të njohur të Kur'ànit Famëlartë, e kanë interpretuar këtë ajet si vijon: "ju s'keni mundësi të mashtroni asnjë njeri, në se për atë nuk është vendosur që ai të digjet në zjarrin e Xhehennemit".

Nëse ky interpretim është kuptimi i vërtetë i ajetit, atëherë përse janë Dërguar Profetët? Për çfarë shkaku kanë zbritur librat qiellorë? Ç'kuptim ka marrja në llogari dhe qortimi i adhuruesve të idhujve Ditën e Llogaridhënies, për të cilën flasin tekstet e ajeteve kur'anore? Dhe ku shkoi drejtësia e Krijuesit të Gjithëfuqishëm?

Nëse ky interpretim pranohet si i vërtetë, atëherë do të thotë: pohim i plotë i parimit të "imponimit" dhe dalje kundër parimit të Profetëve; gjithashtu, do të thotë: ky pohim anulon të gjitha konceptet për të cilat u dërguan Profetët, duke ditur se ata u dërguan që të rrënjosin parimet hyjnore; kurse pranimi i këtij interpretimi, asgjëson të gjitha vlerat hyjnore e njerëzore.

Është e domosdoshme të shohim me vëmendje faktin që fjala *"sàli"* në rrënjën e saj *"salà"*, do të thotë: ndezja e zjarrit dhe hyrja në zjarr, ose: djegie në zjarr; kurse fjala *"fàtin"*, sipas rregullave të gjuhës arabe, është emër veprues dhe në rrënjën e saj *"fitnetun"*, do të thotë: ai që mbjell ngatërresa, ose ai që çon të tjerët në rrugën e humbjes.

Pasi përfunduam studimin tonë mbi tre ajetet e para të këtij grupi ajetesh, pamë se në këto ajete shpjegohet qartë çështja e zgjedhjes së punëve prej vetë njeriut, përballë ngatërresave të adhuruesve të idhujve dhe tani do të vazhdojmë studimin mbi tre ajetet vijues, në të cilët trajtohet grada e lartë e engjëjve te All'llahu i Lartësuar dhe duke iu drejtuar adhuruesve të idhujve, këto ajete u flasin atyre drejtpërdrejt e u thonë: ju ishit ata që mëtonit se engjëjt janë femra. Por dijeni se engjëjt kanë një pozitë të caktuar dhe e bukura këtu është se në këto ajete kur'anore janë

engjëjt ata që flasin për veten e tyre, kur thonë: **"Nuk ka ndonjë prej nesh** (engjëjve) **që nuk ka një pozitë të caktuar."**.

Engjëjt e të Gjithëmëshirshmit shtojnë: ne të gjithë qëndrojmë të rreshtuar te All'llahu i Gjithëfuqishëm, në pritje të urdhërave të Tij: **"Ne** (engjëjt) **jemi të rreshtuar."**.

Ne të gjithë e madhërojmë All'llahun dhe e pastrojmë Atë prej gjërave që nuk janë të përshtatshme për madhështinë e Tij dhe ajeti njofton: **"Ne** (engjëjt) **jemi prej atyre që e madhërojmë** (All'llahun)**."**.

Po, ne engjëjt jemi robtë e All'llahut, shpirtrat tanë ne i kemi në gatishmëri të plotë dhe gjithnjë rrimë në pritje të urdhërave të Tij; ne engjëjt e pastrojmë Krijuesin e Gjithëfuqishëm nga mëtimet tuaja të rreme e të këqija dhe jemi shumë të hidhëruar prej miteve e iluzioneve të idhujtarëve.

Në të vërtetë, tre ajetet e lartpërmendur tregojnë tri prej cilësive të engjëjve:

E para: çdo engjëll ka një pozitë të caktuar e të specifikuar dhe këtë pozitë ai nuk e tejkalon dot.

E dyta: engjëjt gjithmonë janë në bindje të urdhërave të All'llahut të Lartësuar dhe gjithmonë janë në gatishmëri për t'i zbatuar urdhërat e Tij në botën e ekzistencës. Ky mision i engjëjve, është i ngjashëm me atë që ka ardhur në ajetet 26 dhe 27 të sures "El Enbijà": **"...ata janë rob të nderuar. Nuk flasin para Tij dhe ata veprojnë me urdhërin e Tij."**.

E treta: engjëjt e madhërojnë All'llahun gjithmonë dhe e pastrojnë atë nga gjërat që nuk janë në përshtatje me madhështinë e Tij.

Dy ajetet: **"Ne** (engjëjt) **jemi të rreshtuar. Ne** (engjëjt) **jemi prej atyre që e madhërojmë** (All'llahun)**"**, na japin konceptin e edukatës arabe. Por duhet theksuar se, disa prej interpretuesve të Kur'ànit Famëlartë, gjatë interpretimit të këtyre dy ajeteve, kanë thënë: engjëjt, me këto fjalë duan të thonë: vetëm ne jemi të bindur ndaj urdhërave të All'llahut dhe vetëm ne e madhërojmë Atë me të vërtetë. Natyrisht që kjo fjalë e engjëjve, tregon se bindja e njeriut ndaj All'llahut të Lartësuar dhe madhërimi që bën njeriu për All'llahun duke e dëlirur atë prej të gjitha mangësive e nevojave, nuk numërohen asgjë para bindjes e madhërimit të engjëjve, madje as që mund të bëhet krahasimi në mes bindjes e madhërimt të engjëjve dhe bindjes e madhërimit të njeriut për All'llahun e Lartësuar.

Tërheq vëmendjem fakti se, një grup interpretuesish të Kur'ànit Famëlartë, në fundin e interpretimit të këtyre ajeteve, kanë cituar një hadith prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* në të cilin ai ka thënë: *"Në qiejt s'ka asnjë pëllëmbë vend që aty të mos ketë një engjëll duke falur namaz e duke madhëruar All'llahun."*.[1]

Në një transmetim tjetër, po prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Në qiej s'ka asnjë këmbë vend që aty të mos ketë një engjëll duke bërë sexhde, ose duke falur namaz më këmbë."*.[2]

[1] Tefsiri i Kurtubij'jit, vëll. 8, f. 5581.
[2] Burimi i sipërm.

Në një hadith tjetër, thuhet se i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* po rrinte ndenjur me një grup prej shokëve të tij dhe në bisedë e sipër, ai u tha atyre: "*Qielli rënkon dhe ka të drejtë të rënkojë; në Qiell s'ka asnjë këmbë vend që aty të mos jetë një ëngjëll në ruku ose në sexhde dhe pastaj lexoi dy ajetet*: **'Ne** (engjëjt) **jemi të rreshtuar. Ne** (engjëjt) **jemi prej atyre që e madhërojmë** (All'llahun)**.'"**.[1]

Shprehjet e ndryshme që u përmendën më sipër, janë shumë të bukura për të treguar se bota e ekzistencën është e tejmbushur me të bindur ndaj urdhërave të All'llahut, që vazhdimisht e madhërojnë Atë.

Katër ajetet e fundit të ajeteve objekt studimi, tregojnë njërin prej justifikimeve mjerane me të cilin justifikoheshin idhujtarët për adhurimin që ata u bënin idhujve, por këto ajete u përgjigjen atyre me këto fjalë: **"Edhe pse ata thoshin";** dhe: **"Sikur ndër ne të kishte një libër prej të parëve. Patjetër që ne do të ishim rob të sinqertë të All'llahut."**.

Idhujtarët, me këto fjalë thonë: mos flisni kaq shumë për robtë e sinqertë të All'llahut, të cilët All'llahu i ka zgjedhur për veten e Tij, mos flisni as për Profetët e mëdhenj, siç janë, për shembull, Nùhu, Ibrahimi dhe Mùsài *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)* sepse, sikur All'llahu të na kishte përfshirë edhe ne me butësinë e Tij dhe sikur Ai të kishte zbritur për ne njërin prej librave të Tij qiellorë, patjetër që edhe ne do të ishim në grupin e robve të Tij të sinqertë.

[1] Tefsiri "Ed Durr'rrul Menthùr", cituar prej tefsirit "El Mijzàn", vëll. 17, f. 188.

Ky justifikim i idhujtarëve, është i ngjashëm me justifikimin e atyre nxënësve përtacë, që patjetër janë mbetës në mësimet e tyre dhe për të mbuluar përtacinë e pavendosmërinë e tyre për të mësuar, thonë: sikur ne të kishim një mësues të mirë, patjetër që do të ishim prej nxënësve të dalluar.

Ajeti vijues thotë: ajo që ata shpresonin, u bë realitet, atyre u zbriti Kur'àni Famëlartë, u zbriti libri qiellor më i madh e më i rëndësishëm, por ata gënjejnë në mëtimet që shprehin, sepse ata nuk i besuan Kur'ànit, nuk i mbajtën fjalët që thoshin dhe morën një qëndrim armiqësor ndaj Kur'ànit, por shumë shpejt, ju, idhujtarët, do të shikoni të ligën e madhe të mohimit tuaj: **"Dhe** (kur atyre u erdhi libri) **ata e mohuan atë** (Kur'ànin)**; por shumë shpejt do ta kuptojnë."**.

Mjaft i keni rrenat e mëtimet tuaja bajate, prandaj as mos e çoni ndërmend se e meritoni të jeni së bashku, në një radhë me robtë e sinqertë të All'llahut, sepse rrena juaj është fare e qartë, mëtimet tuaja nuk janë të vërteta, s'ka asnjë libër më të mirë se Kur'àni Famëlartë dhe s'ka asnjë program edukues më të mirë se programi i Profetit të Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* por, shikoni si ishte qëndrimi që ju morët ndaj këtij libri qiellor? Prandaj rrini në pritje të ndëshkimeve të dhimbshme që do të bien mbi ju, për shkak të mohimit e të mosbesimit tuaj.

Ajetet: 171 – 177

وَلَقَدْ سَبَقَتْ كَلِمَتُنَا لِعِبَادِنَا ٱلْمُرْسَلِينَ ﴿١٧١﴾ إِنَّهُمْ لَهُمُ ٱلْمَنصُورُونَ ﴿١٧٢﴾
وَإِنَّ جُندَنَا لَهُمُ ٱلْغَٰلِبُونَ ﴿١٧٣﴾ فَتَوَلَّ عَنْهُمْ حَتَّىٰ حِينٍ ﴿١٧٤﴾ وَأَبْصِرْهُمْ
فَسَوْفَ يُبْصِرُونَ ﴿١٧٥﴾ أَفَبِعَذَابِنَا يَسْتَعْجِلُونَ ﴿١٧٦﴾ فَإِذَا نَزَلَ بِسَاحَتِهِمْ
فَسَآءَ صَبَاحُ ٱلْمُنذَرِينَ ﴿١٧٧﴾

"Fjala Jonë (premtimi Ynë) **u është dhënë më përpara robve Tanë të Dërguar."**

"Ata pa dyshim do të ndihmohen."

"Dhe ushtritë Tona do të triumfojnë."

"Prandaj, ti (o Muhammed) **largohu prej atyre për një farë kohe."**

"Dhe mbaji ata nën vëzhgim, se ata shumë shpejt do të shohin (ndihmën Tonë për ty)**."**

"A mos po kërkojnë shpejtimin e ndëshkimit Tonë?"

"Por kur ai (ndëshkimi Ynë) **të zbresë në truallin e atyre, atëherë do të jetë mëngjesi më i shëmtuar për të paralajmëruari."**

Komentimi

Partia e All'llahut është triumfuese

Jemi në vazhdim të studimit të ajeteve të kësaj sureje të uruar dhe po i afrohemi fundit të saj. Në studimet e përparme, pamë luftën në rrugën e All'llahut që kanë bërë Profetët e mëdhenj dhe vështirësitë e mëdha e pengesat e shumta që u shkaktonin dhe u nxirrnin atyre idhujtarët.

Në këtë grup ajetesh, do të trajtojmë çështjen më të rëndësishme të kësaj sureje, çështje që e përshkruan mbylljen me formën më të mirë. Në këtë grup ajetesh, për besimtarët jepet përgëzimi i triumfit të ushtrive të së vërtetës mbi ushtritë e djallit. Ky premtim i madh hyjnor, në të vërtetë ka ardhur për të ringjallur shpresën, jo vetëm në radhët e besimtarëve të fillimeve të Islamit, të cilët, në kohën e zbritjes së këtyre ajeteve rënkonin nën shtypjen e armiqve të Islamit në Mekë, por edhe të të gjithë besimtarëve e të privuarve nga të drejtat, në të gjitha kohët e në të gjitha vendet; njëkohësisht, këto ajete janë një motiv për besimtarët që ata të shkundin prej vetes së tyre pluhurin e dëshpërimit dhe të mos e humbin shpresën, por të qëndrojnë në gatishmëri për të luftuar në rrugën e All'llahut dhe për t'u rezistuar ushtrive të djallit, ashtu siç njofton për këtë ajeti i parë i këtij grupi ajetesh: **"Fjala Jonë** (premtimi Ynë) **u është dhënë më përpara robve Tanë të Dërguar"**, që ata: **"Ata pa dyshim do të ndihmohen"** dhe se: **"Dhe ushtritë Tona do të triumfojnë"**; sa shprehje e qartë dhe e hapur, shprehje që forcon shpirtrat dhe mban gjallë shpresën.

Po, fitorja e ushtrive të të vërtetës mbi ushtritë e djallit, triumfi i ushtarëve të All'llahut dhe dhënia e ndihmës prej të Gjithëfuqishmit për robtë e Tij të Dërguar e të sinqertë, është një premtim i vërtetuar me të gjitha rrugët, në mënyrë të prerë, ashtu siç theksohet në ajetin e parë të këtij grupi ajetesh: **"Fjala Jonë** (premtimi Ynë) **u është dhënë më përpara"**, domethënë: ky premtim dhe kjo rrugë kanë ekzistuar qysh në fillim.

Ajete të ngjashme me këtë kuptim kanë ardhur edhe në sure të tjera të Kur'ànit Famëlartë. Ndër to përmendim:

Ajeti 47 në suren "Er Rrùm": **"...ishte detyra Jonë të ndihmonim besimtarët"**;

Ajeti 40 në suren "El Haxh": **"All'llahu patjetër do të ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij"**;

Ajeti 51 në suren "Gàfir": **"Patjetër Ne do të ndihmojmë të Dërguarit Tanë dhe ata që besuan në jetën e kësaj bote dhe në Ditën e paraqitjes së dëshmive"**;

Ajeti 21 në suren "El Muxhàdele": **"All'llahu ka vendosur: Unë dhe të Dërguarit e Mi, patjetër do të triumfojmë..."**.

Është e qartë se, All'llahu është i Gjithëfuqishëm mbi të gjitha sendet, Ai kurrë nuk i thyen premtimet, asnjëherë s'ka ndodhur që Ai të ketë thyer premtimin e bërë, prandaj Ai është i Gjithëfuqishëm të mbajë edhe këto premtime të mëdha, ashtu siç e ka zbritur ndihmën e Tij për besimtarët edhe më përpara.

Premtimi hyjnor është prej punëve më të rëndësishme, që presin me aq dashuri të gjithë ata që ndjekin rrugën e të vërtetës, në rrugën ku ata marrin fuqi shpirtërore e morale; në atë rrugë,

ata i drejtohen vetëm Atij për ndihmë dhe sa herë që ndjejnë lodhje e dobësim, ata menjëherë kujtojnë ndihmën e të Lartit dhe në damarët e tyre fillon të rrjedhë gjaku i ri.

Një pyetje e rëndësishme

Shtrohet pyetja: nëse dëshira dhe vullneti i Krijuesit të Gjithëfuqishëm kanë vendosur për të përkrahur Profetët dhe për të ndihmuar besimtarët, përse shikojmë se Profetët kanë rënë dëshmorë gjatë gjithë historisë së ngjarjeve njerëzore dhe se në disa raste besimtarët kanë pësuar disfatë? Nëse kjo është rruga hyjnore, në atë rrugë patjetër s'ka gabime, atëherë përse gjithë këto përjashtime?

Kësaj pyetjeje, i përgjigjemi me fjalët vijuese:

E para: fjala triumf ka kuptime të gjera dhe jo në të gjitha rastet jep kuptimin e triumfit të dukshëm e konkret mbi armikun; herë tjetër, fjala triumf është në kuptimin e triumfit të parimit dhe ky është triumfi më i rëndësishëm. Sikur të hamendsojmë se i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* në njërën prej luftërave që ka marrë pjesë do të binte dëshmor dhe ligji i fesë së tij ka përfshirë botën mbarë, a mund ta konsiderojmë disfatë rënien e tij dëshmor?!

Një shembull tjetër të qartë, e gjejmë në Imam Hysejnin *(Paqja qoftë mbi të!)* e në shokët e tij të nderuar, që ranë dëshmorë në Qerbela, duke luftuar me qëllim që të diskreditonin sudimtarët e fisit "Beni Umej'jeh", të cilët kishin uzurpuar pushtetin dhe mëtonin se ishin zëvendësit e Profetit. Ndërkohë që me veprimet e tyre po e kthenin shoqërinë islame në kohën e injorancës para Islamit. Në të vërtetë, objektivi i tyre madhor u realizua, rënia

dëshmor e atyre burrave çoi në ndërgjegjësimin e myslimanëve para rrezikut të madh e humbjes ku po e çonin ata udhëheqës Islamin, prandaj, a mund të thuhet se Imam Hysejni *(Paqja qoftë mbi të!)* e shokët e tij humbën betejën në Qerbela?!

Në çështjen e ndihmës së All'llahut, është me rëndësi fakti që Profetët dhe ushtarët e All'llahut, domethënë besimtarët, në saje të kësaj ndihme, bënë të mundur përhapjen e parimeve të tyre në të gjithë botën, parime që sot i ndjekin shumë njerëz, madje përhapjen e parimeve dhe të mendimeve të tyre, besimtarët e vazhdojnë pa pushim, pavarësisht nga përpjekjet e vazhdueshme e nga vështirësitë e mëdha që u vijnë atyre prej armiqve të të vërtetës.

Kemi edhe një lloj triumfi tjetër, të quajtur triumfi i përkohshëm mbi armikun dhe që mund të bëhet realitet pas shekujsh qysh nga fillimi i luftës: ndodh që hyn në luftë një brez dhe nuk arrin asnjë fitore, por pas atij brezi, vijnë brezat e tjerë, që e vazhdojnë luftën dhe triumfojnë, siç qe triumfi që realizuan myslimanët më në fund kundër kryqtarëve në beteja të shumta, që zgjatën afërsisht dy shekuj dhe ai triumf llogaritet si triumf i të gjithë myslimanëve.

E dyta: është detyrë të mos harrojmë se premtimi i të Gjithëfuqishmit për të ndihmuar besimtarët, është premtim i kushtëzuar, sepse, gabimet e fajet e shumta, janë burim për të mos u orientuar nga kjo e vërtetë. Veç kësaj, shprehjet e fjalët e ngjashme që kanë ardhur në Kur'ànin Famëlartë në lidhje me ndihmën e All'llahut për besimtarët, siç janë shprehjet: *"hizbull'llàhu"* – *"partia e All'llahut" (*sure "El Muxhàdele" ajeti 22); *"uel'ledhijne xhàhedù fijna"* – *"ata që luftuan në rrugën Tonë"* (sure

"El Ankebùt", ajeti 69); *"lejensuren'nell'llàhu men jensuruhù"* – *"patjetër All'llahu do të ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij"* (sure "El Haxh", ajeti 40), si dhe ajete e shprehje të tjera të ngjashme në kuptim, të gjitha shpjegojnë qartë kushtet e dhënies së ndihmës.

Ne nuk duam të jemi besimtarë dhe të mos jemi as luftëtarë në rrugën e All'llahut e as ushtarë të sinqertë; ne duam të triumfojmë mbi armiqtë e të vërtetës dhe mbi armiqtë e drejtësisë edhe pse jemi në këtë gjendje.

Por, nëse duan të marshojmë përpara në udhën tonë për te All'llahu, duke mbartur mendime djallëzore, nuk ka arsye të çuditemi që armiqtë triumfojnë mbi ne; a e kemi mbajtur ne besën, që të kërkojmë prej All'llahut të Lartësuar që Ai të plotësojë premtimet e Tij për ne?!

Në betejën e Uhudit, i Dërguari më i nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* u premtoi myslimanëve fitore dhe në fazën e parë të betejës, ata praktikisht korrën fitore, por veprimi i disave në kundërshtim me urdhërat e Profetit dhe lënia e pozicioneve prej atyre për të rendur pas plaçkës së luftës, duke shtuar edhe punën sabotuese të disa të tjerëve për të mbjellë përçarje e hipokrizi në radhët e luftëtarëve myslimanë, të gjitha këto bënë që myslimanët të mos e ruanin fitoren e korrur në fazën e parë të betejës dhe në fundin e betejës, për rrjedhojë, pësuan humbje të rënda.

Pas përfundimit të asaj beteje, erdhi një grup burrash te i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe i folën atij me një gjuhë jo të zakonshme: ç'do të na thuash për premtimin se do të triumfonim? Kur'àni Famëlartë u përgjigjet atyre në mënyrë të ëmbël e të butë,

përgjigje që mundëson të jetë dëshmuese për bisedën tonë dhe kjo përgjigje e bukur është në ajetin 152 të sures "Àli Imràn": **"All'llahu e plotësoi premtimin e Tij ndaj jush; me lejen e Tij ju i korrët ata, më pas ju dështuat, kur u grindët në mes jush dhe vepruat në kundërshtim me urdhërat** (e Profetit)**, kur patë atë që ju e dëshironi** (plaçkën e luftës)**; prej jush kishte nga ata që kishin qëllim këtë botë, gjithashtu prej jush kishte të atillë që kishin qëllim Botën Tjetër; më pas Ai u largoi ju prej atyre që t'ju sprovonte; në të vërtetë, Ai jua fali** (gabimin)**, All'llahu është dhurues i madh ndaj besimtarëve."**.

Shprehjet *"feshiltum"* – *"ju dështuat"*; *"tenàzaëtum"* – *"u grindët në mes jush"* dhe *"asajtum"* – *"kundërshtuat urdhërin"* të përmendura në ajetin e sipërm, shpjegojnë në mënyrën më të qartë se myslimanët, ditën e luftës së Uhudit i kishin lënë kushtet që mundësonin zbritjen e ndihmës hyjnore, prandaj dështuan në arritjen e objektivave të tyre.

Po, Krijuesi i Gjithëfuqishëm nuk i ka premtuar kujtdo që mëton se është mysliman, thotë se është prej ushtarëve të All'llahut dhe i partisë së All'llahut, që ta ndihmojë atë gjithmonë mbi armiqtë e tij. Jo, premtimi i All'llahut është taksativ vetëm për atë që shpreson nga thellësia e zemrës dhe e shpirtit të tij që, me punën e tij, të fitojë kënaqësinë e All'llahut të Lartësuar, që vepron sipas programit që ka vënë All'llahu i Gjithëfuqishëm dhe është i zbukuruar me përkushtim e besnikëri.

Një pyetje e ngjashme ka ardhur në lidhje me lutjen dhe me premtimin hyjnor që lutja të gjejë përgjigje. Këtë çështje e kemi trajtuar në komentin e ajetit 186 të sures "El Bekare".

Për të qetësuar të Dërguarin *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* njëkohësisht për të qetësuar edhe besimtarët dhe për t'i siguruar ata se fitoren përfundimtare e keni aleatin tuaj, All'llahu thotë: **"Prandaj ti** (o Muhammed) **largohu prej atyre për një farë kohe."**. Në të njëjtën kohë, fjalët e këtij ajeti janë një kërcënim për idhujtarët.

Po, ky ajet është një kërcënim i mbushur me kuptime dhe me frikësim; gjithashtu, fjalët e këtij ajeti janë një burim sigurie për besimtarët, kur mendojnë premtimin madhor se fitorja përfundimtare do të jetë aleati i tyre. Këtë të vërtetë e vëmë re nëse analizojmë shprehjen *"het'tà hijnin"* - **"për një farë kohe"**, që siç shihet, ka ardhur pa e caktuar qartë kohën.

Por, për cilën kohë bën shenjë kjo shprehje? Për kohën e emigrimit, apo për kohën e luftës së Bedrit, apo flet për kohën deri në çlirimin e Mekës, apo flet për kohën kur të plotësohen kushtet për kryengritjen përfundimtare e të gjerë të myslimanëve kundër tiranëve shtypës?

Saktësisht, këtë kohë asnjë njeri nuk e di.

Ajete të tjera kanë ardhur në Kur'ànin Famëlartë me të njëjtin kuptim, siç është ajeti 81 i sures "En Nisà": **"...largohu prej atyre dhe mbështetu në All'llahun..."** dhe ajeti 91 i sures "El En'àm", në të cilin lexojmë fjalën e të Lartit: **"Ti thuaj All'llahu dhe pastaj lëri ata të luajnë në pellgun e tyre."**.

Kur'àni Famëlartë e përforcon kërcënimin e parë me një kërcënim tjetër, që vjen në ajetin vijues të ajeteve objekt studimi, kur thotë: Shiko në kokëfortësinë e në gënjeshtrat e tyre, shiko në mitet që ata besojnë, shiko edhe në idiotizmin e tyre.

Ata, shumë shpejt do të shohin jo vetëm ndëshkimin për punët e tyre të këqija: **"Dhe mbaji ata nën vëzhgim, se ata shumë shpejt do të shohin** (ndihmën Tonë për ty)**"**, por do të shohin edhe triumfin e besimtarëve dhe thyerjen e disfatën e idhujtarëve, të poshtëruar qysh në këtë botë.

Ata kokëtrashë, me përsëritjen e pyetjes tallëse që i drejtonin të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* se ku është ai ndëshkimi hyjnor me të cilin ti na kërcënon? Dhe nëse thua të vërtetën, përse kjo vonesë?

Kur'àni Famëlartë u përgjigjet atyre me një gjuhë të ashpër, të shoqëruar me kërcënime dhe u thotë: ata që kërkojnë shpejtimin e zbritjes së ndëshkimit, disa herë pyesin: kur do të realizohet ai premtim; herë tjetër, duke pyetur njëri-tjetrin, thonë: kur do të jetë gykimi? Këtyre idhujtarëve, Kur'àni u përgjigjet: **"A mos po kërkojnë shpejtimin e ndëshkimit Tonë?"**.

Kur ndëshkimi Ynë të zbresë mbi ata, atëherë mëngjesi i tyre do të jetë një errësirë e plotë; pikërisht në atë kohë, njofton ajeti vijues, ata do të kuptojnë sa i keq e sa i rrezikshëm është mëngjesi i atyre që ishin paralajmëruar: **"Por, kur ai** (ndëshkimi Ynë) **të zbresë në truallin e tyre, atëherë do të jetë mëngjesi më i shëmtuar për të paralajmëruarit."**.

Përdorimi i shprehjes *"sàhetun"*, që do të thotë: oborri i shtëpisë, ose mjedisi në mesin e shtëpisë, ka ardhur që të formësojë për ata zbritjen e ndëshkimit në mesin e jetës së tyre dhe që ata të shohin se si do të tjetërsohet jeta e tyre në një jetë të egër e të trazuar.

Kurse fraza*"sabàhul mundherijne"* – *"mëngjesi i të paralajmëruarve"* tregon se ndëshkimi hyjnor do të zbresë në mëngjes mbi ata mohues kokëfortë e shtypës, ashtu siç ka zbritur në mëngjes edhe mbi popujt mohues në të kaluarën. Por ajeti ka edhe kuptimin: të gjithë njerëzit presin që mëngjesi i tyre të fillojë me mbarësi e me punë të mira, kurse ata i pret një mëngjes i errët; gjithashtu, ka mundësi që ajeti, me fjalën "mëngjes", ka qëllim kohën e zgjimit të tyre në mëngjes dhe shpjegon: ata zgjohen në mëngjes, por për ata s'ka mbetur më rrugë shpëtimi prej ndëshkimit; tanimë, për ata çdo gjë ka marrë fund.

Ajetet: 178 – 182

وَتَوَلَّ عَنْهُمْ حَتَّىٰ حِينٍ ﴿١٧٨﴾ وَأَبْصِرْ فَسَوْفَ يُبْصِرُونَ ﴿١٧٩﴾ سُبْحَانَ
رَبِّكَ رَبِّ الْعِزَّةِ عَمَّا يَصِفُونَ ﴿١٨٠﴾ وَسَلَامٌ عَلَى الْمُرْسَلِينَ ﴿١٨١﴾
وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٨٢﴾

“Ti largohu prej tyre për një kohë.”

“Ti vështroji ata dhe më vonë ata do të shohin.”

“I pastër e i lartë është Zoti yt, Zoti i Gjithëfuqishëm nga ato që ata i përshkruajnë.”

“Paqe e shpëtim për të Dërguarit.”

“Dhe falënderimi i takon vetëm All’llahut, Zotit të botëve.”

Komentimi

Largohu prej atyre

Siç kemi thënë, ajetet e fundit të kësaj sureje kanë zbritur për të qetësuar e gëzuar të Dërguarin më të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* njëkohësisht për të qetësuar e për të gëzuar edhe besimtarët e vërtetë dhe për të kërcënuar mohuesit kokëngjeshur.

Dy ajetet e para të grupit të ajeteve objekt studimi, janë të ngjashëm me ajetet që pamë në studimin e përparshëm dhe përsëritja e ajeteve këtu ka ardhur si përforcim, por kanë ardhur me një gjuhë të ashpër, të shoqëruar me kërcënim dhe All'llahu i Lartësuar e urdhëron Profetin *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*: Largohu prej atyre dhe deri në një kohë të caktuar, lëri ata në punët e veta: **"Ti largohu prej tyre për një kohë."**.

Dhe vëzhgoje kokëfortësinë e gënjeshtrën e tyre, vëzhgo edhe praktikat e tyre armiqësore kur mohojnë ekzistencën e All'llahut të Lartësuar dhe ajeti vijues njofton se ata shumë shpejt do të marrin dënimin për punët që kanë bërë: **"Ti vështroji ata dhe më vonë ata do të shohin."**.

Siç kemi thënë, përsëritja ka ardhur si përforcim që ata mohues të kuptonin se dënimi, shpartallimi i tyre dhe humbja e shpresës nga ana e tyre, është punë e mbaruar dhe patjetër kështu do të jetë, shumë shpejt, kur ata do të provojnë rezultatet e

hidhura të punëve të tyre; gjithashtu edhe fitorja e besimtarëve patjetër që është punë e mbaruar dhe e padiskutueshme.

Ajeti i nderuar, herën e parë i kërcënon ata me ndëshkimin në këtë botë, kurse herën e dytë i kërcënon me ndëshkimin hyjnor Ditën e Kiametit.

Kjo sure e nderuar, domethënë sure "Es Sàffàt", mbyllet me tre ajete me kuptime shumë të thella, që flasin për cilësitë e bukura të All'llahut të Lartësuar, flasin për pozitën e lartë të të Dërguarve dhe për botët. Këto ajete e dëlirin All'llahun e Lartësuar nga çdo lloj mangësie e nevoje, pohojnë se vetëm Ai është i Gjithëfuqishmi dhe hedhin poshtë të gjitha gënjeshtrat që i përshkruanin idhujtarët injorantë All'llahut të Lartësuar: **"I pastër e i lartë është Zoti yt, Zoti i Gjithëfuqishëm nga ato që ata i përshkruajnë."**.

Idhujtarët, herë thoshin se engjëjt janë vajzat e All'llahut, herë tjetër thoshin se ka lidhje afërsie në mes All'llahut të Lartësuar e në mes xhindëve; ata punonin shtatore prej gruri, ose prej druri, pa asnjë vlerë dhe për ato që punonin me duart e veta thoshin se janë në pozitën e All'llahut të Gjithëfuqishëm.

Fjala *"el iz'zeti"* - do të thotë: Zotëruesi i fuqisë absolute, i Cili është e pamundur të mposhtet; kjo fjalë jep kuptimin: Sa të gabuar e sa pa dobi janë ata zotat e rremë dhe mitet që adhuronin idhujtarët.

Ajetet e sures "Es'Sàffàt", herë flasin për madhërimin e për dëlirjen e All'llahut të Lartësuar nga të metat që bëjnë robtë e sinqertë të All'llahut të Lartësuar: **"robtë e sinqertë të All'llahut"**; herë tjetër këto ajete flasin për dëlirjen nga të metat që i bëjnë

All'llahut engjëjt, kurse këtu flasin për dëlirjen që Krijuesi i Gjithëfuqishëm i bën Vetes së Tij të shenjtëruar.

Në ajetin vijues, Krijuesi i Gjithësisë njofton se Ai ka përfshirë me butësinë e Tij të pakufizuar, të gjithë Profetët e Tij: **"Paqe e shpëtim për të Dërguarit."**. Kjo përshëndetje me selam prej All'llahut të Lartësuar, shpjegon qartë shpëtimin prej të gjitha llojeve të dënimit Ditën e Kiametit; ajo paqe e premtuar prej All'llahut, është valvula e sigurisë ndaj rreziqeve e humbjeve dhe një garanci për fitoren mbi armiqtë.

Në ajetet e kësaj sureje të nderuar, All'llahu i Lartësuar ka përshëndetur me "selam" shumë prej Profetëve të Tij; në ajetet e kësaj sureje, i Larti ka përveçuar me "selamim" e Tij Profetët e mëposhtëm: në ajetin 79 Ai thotë: **"Paqe e shpëtim për Nùhun, në të gjitha botët"**; në ajetin 109, thotë: **"Paqe e shpëtim për Ibrahimin"**, kurse në ajetin 130: **"Paqe e shpëtim për Iljàsin"**.

Kurse këtu, përshëndetjen me "selam" ua drejton të gjithë Profetëve së bashku: **"Paqe e shpëtim për të Dërguarit"** dhe surja mbyllet me falënderimin vetëm për All'llahun e Lartësuar: **"Dhe falënderimi i takon vetëm All'llahut, Zotit të botëve."**.

Gjithashtu, tre ajetet e fundit mund të jenë një përmbledhje e shkurtër për të gjitha çështjet dhe punët që trajtohen në këtë sure, duke theksuar se, në një pjesë të mirë të ajeteve të kësaj sureje trajtohet Njëtimi i All'llahut dhe lufta kundër të gjitha llojeve të idhujtarisë. Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, flet për pastrimin e për dëlirjen e All'llahut të Lartësuar prej të gjithë atyre përshkrimeve që i vishnin Atij idhujtarët; kurse pjesa tjetër e ajeteve të kësaj sureje shpjegon disa prej gjendjeve të shtatë Profetëve të mëdhenj që u përmendën në ajetet e kësaj sureje.

Në ajete të tjera, janë shpalosur një pjesë tjetër prej mirësive hyjnore dhe në veçanti mirësitë që gjenden në Xhennet. Gjithashtu, në këto ajete flitet për triumfin e ushtrive të All'llahut mbi mohuesit dhe në fund vjen falënderimi e lavdërimi për All'llahun e Lartësuar, për të gjitha llojet e mirësive të përmendura në këtë sure.

Disa interpretues të tjerë të Kur'ànit, kanë përmedur analiza të tjera në lidhje me tre ajetet e fundit të kësaj sureje dhe kanë thënë: prej detyrave të njeriut të mençur, janë njohja e tri gjendjeve:

E para: Njohja e All'llahut të Lartësuar në masën e mundshme për njerëzit dhe e fundit që ka mundësi njeriu të dijë në lidhje me këtë çështje, janë tri gjëra: pastrimi e madhërimi i All'llahut të Lartësuar prej çdo gjëje që nuk është në përshtatje me cilësitë e All'llahut dhe ky madhërim shpjegohet qartë me fjalën e të Lartit *"subhàne"* – *"i pastër e i lartë nga çdo e metë e nevojë"*.

All'llahu i Lartësuar e ka përshkruar veten me të gjitha cilësitë që janë në përshtatje me Qenien e Tij Zot dhe i plotësuar, kurse fjala e ajetit *"rab'bun"*, tregon qartë urtësinë, mëshirën dhe sundimin e Tij mbi të gjitha sendet; gjithashtu, kjo fjalë dëshmon se Ai është edukuesi i të gjitha qenieve.

Kurse pastrimi i Tij prej çdo ortaku apo ortakësh në sundimin e Tij, apo për ekzistencën e një të ngjashmi me All'llahun, ka ardhur në frazën e ajetit: **"nga ato që ata i përshkruajnë"**.

Çështja e dytë e rëndësishme në jetën e njeriut, ka të bëjë me plotësimin e të metave që ka njeriu, por kjo nuk është e mundur të

realizohet pa ekzistencën e Profetëve *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)* dhe fraza e ajetit vijues: **"Paqe e shpëtim për të Dërguarit"**, tregon pikërisht këtë çështje.

Çështja e tretë e rëndësishme në jetën e njeriut, është: njeriu ka detyrë të dijë se si do të jetë gjendja e tij pas vdekjes; t'i kushtojë kujdes e vëmendje mirësive të Zotit të botëve dhe pozitës së lartë të All'llahut, të përshkruar me cilësitë "i Pasuri", domethënë se Ai nuk ka nevojë për ndihmën e askujt, "Mëshiruesi" dhe "i Buti"; këto cilësi të bukura të All'llahut të Lartësuar i japin njeriut siguri dhe për të gjitha këto: **"Dhe falënderimi i takon vetëm All'llahut, Zotit të botëve."**.[1]

Hulumtim

Të menduarit rreth fundit të çdo pune

Në disa transmetime të ardhura me rrugët e Imamëve të Ehli Bejtit, thuhet: "Kush dëshiron të matet me matësin më të bollshëm (të shpërblimit Ditën e Gjykimit) le të jetë fjala e tij e fundit në kuvendin e tij: **"I pastër e i lartë është Zoti yt, Zoti i Gjithëfuqishëm nga ato që ata i përshkruajnë. Paqe e shpëtim**

[1] Tefsiri "El Kebijr", vëll. 16, f. 173.

për të Dërguarit. Dhe falënderimi i takon vetëm All'llahut, Zotit të botëve.".[1]

Po. Le t'i mbyllim mbledhjet tona me fjalën: i pastër nga të metat e nevojat është All'llahu i Gjithëfuqishëm, le t'i mbyllim mbledhjet tona duke u dërguar përshëndetje me selam Profetëve të All'llahut dhe me falënderimin e All'llahut për mirësitë që Ai na ka dhuruar; vetëm kështu fshihen nga "regjistri" punët jo të mira, ose fjalët e ndaluara që janë bërë e janë thënë në atë mbledhje.

Në librin "Et Teuhijd", të shejhut Es Sadùk, tregohet se njëri prej dijetarëve të Shamit shkoi te Imam Bàkiri *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe i tha: erdha të të pyes për një çështje, pasi nuk kam gjetur njeri që të ma shpjegojë. Kam pyetur tri kategori njerëzish dhe secila kategori më tha jo atë që tha tjetra.

Ebù Xhaferi *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: "Cila është kjo çështje"?

Ai tha: Dua të të pyes, cilën gjë ka krijuar All'llahu para të gjitha krijesave të Tij? Disa prej atyre që kam pyetur më kanë thënë: Në fillim All'llahu ka krijuar fuqinë, të tjerë më kanë thënë: në fillim All'llahu ka krijuar diturinë dhe disa të tjerë më kanë thënë: Në fillim All'llahu ka krijuar shpirtin.

Ebù Xhaferi *(Paqja qoftë mbi të!)* iu përgjegj: "Nuk kanë thënë asgjë, unë po të njoftoj se All'llahu, u lartësoftë emri i Tij, ekzistonte dhe nuk ishte asgjë tjetër përveç Tij, Ai ishte i

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", fundi i ajetit objekt studimi; "Usùlul Kàfij", kapitulli: "ai që nuk ka ndenjur me një dijetar të ligjit të fesë", cituar prej tefsirit "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 440.

Gjithëfuqishëm dhe nuk ekzistonte fuqia, sepse Ai ekzistonte para fuqisë së Tij, ashtu siç njofton vetë i Larti me fjalën e Tij: **"I pastër e i lartë është Zoti yt, Zoti i Gjithëfuqishëm nga ato që ata i përshkruajnë."**.[1] All'llahu ishte krijues kur nuk ekzistonte asnjë i krijuar". Transmetimi është i gjatë dhe ne morëm prej tij vetëm sa ishte e nevojshme (Ky transmetim tregon se fjalët që të kanë thënë njerëzit që ti ke pyetur, nuk janë pa një dozë idhujtarie (shirku) që përfshihet në kuptimin e këtij ajeti, sepse All'llahu i Lartësuar është i Fuqishmi, i Dituri dhe i Pushtetshmi, qysh atëherë kur nuk ekzistonte asnjë krijesë).

FUNDI I SURES "ES SÀFFÀT"

[1] Tefsiri "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 440.

Sure Sàd

zbritur në Mekë, numri i ajeteve 88

Përmbajtja e sures "Sàd"

Surja "Sàd" mund të konsiderohet plotësuese për suren "Es Sàffàt" dhe në përgjithësi, temat që trajtohen në këtë sure janë të ngjashme me temat që u trajtuan në suren "Es Sàffàt". Gjithashtu, edhe karakteristikat e sures "Sàd" janë si karakteristikat e të gjitha sureve të zbritura në Mekë, domethënë se edhe në këtë sure, studiohen temat e fillimit të krijimit, ringjallja pas vdekjes, Profetnia e të Dërguarit më të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*. Po ashtu, kjo sure përmban edhe tema të tjera shumë të mprehta. Në përgjithësi, kjo sure është si një ilaç shërues për të gjithë kërkuesit e rrugës së vërtetë.

Përmbajtjen e ajeteve të kësaj sureje mund ta ndajmë shkurtimisht në pesë pjesë:

E para: Flitet për çështjen e Njëtimit të All'llahut (All'llahu është Zoti Një e i Vetëm) dhe për luftën kundër idhujtarisë e idhujtarëve, për rëndësinë e madhe të profetnisë së të Dërguarit më të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* si dhe për mërinë e egër të armiqve kundër dy çështjeve të sipërpërmendura.

E dyta: Pasqyrohet anë prej tregimeve të nëntë Profetëve të All'llahut, ndër të cilët: Dàùdi, Sulejmàni dhe Ej'jùbi, për të cilët në këtë sure flitet më shumë se sa flitet për Profetët e tjerë. Gjithashtu, në këtë sure gjejnë pasqyrim problemet e shumta prej të cilave Profetëve u erdhën vuajtje të mëdha në jetën e tyre e në

rrugën e thirrjes që ata u bënin njerëzve për të besuar në All'llahun, Zotin Një e të Vetëm. Është e qartë se, të gjitha këto ajete ishin një mësim dobisjellës dhe një burim ku merrnin këshilla besimtarët e parë, të cilët, në kohën e zbritjes së këtyre ajeteve, vazhdonin të rënkonin nën shtypjen e dhunën e idhujtarëve.

E treta: Flitet mbi të ardhmen që i pret mohuesit tiranë Ditën e Kiametit dhe polemikën që do të zhvillojnë mohuesit tiranë njëri me tjetrin në Xhehennem.

Gjithashtu, u bën të qartë idhujtarëve dhe atyre që nuk besojnë në All'llahun, se ku do t'i çojnë punët që bëjnë.

E katërta: Trajtohen çështjet e krijimit të njeriut dhe të pozitës së tij aq të lartë, sa edhe engjëjt u urdhëruan t'u bëjnë sexhde. Njëkohësisht, shpjegojnë edhe dallimin e madh në mes lartësisë së njeriut dhe degradimit të tij, me qëllim që ata kokëfortë të kuptonin vlerën e qenies së tyre njerëz, të shikonin me kujdes në sistemet e tyre të shmangura dhe të dilnin jashtë grupit të djajve.

E pesta: Kërcënohen me ndëshkim armiqtë mendjemëdhenj dhe qetësojnë e gëzojnë të Dërguarin e All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* njëkohësisht shpjegojnë të vërtetën se Profeti nuk kërkon shpërblim prej asnjë njeriu për thirrjen që u bën njerëzve. Gjithashtu, ai nuk ka qëllim që me thirrjen e tij të rëndojë ose të fyejë dikë.

Mirësia e leximit të sures "Sàd"

Në një transmetim të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Kush lexon suren "Sàd", atij i jepen të mira që peshojnë sa të gjitha malet që All'llahu i Lartësuar vuri në dispozicion të Dàùdit dhe atë All'llahu e ruan që të mos bëjë as ndonjë faj të vogël e as ndonjë faj të madh."*.[1]

Gjithashtu, në një transmetim të ardhur prej Imam Bàkirit *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Kush e lexon suren "Sàd" natën e ditës së Xhuma, atij i jepen prej të mirave të kësaj bote e të Botës Tjetër aq sa nuk i është dhënë ndonjë njeriu tjetër, me përjashtim të Profetëve dhe engjëjve që janë pranë All'llahut të Lartësuar; All'llahu do të fusë në Xhennet atë dhe ata që Ai do prej pjesëtarëve të familjes së tij, deri edhe shërbyesin që i ka shërbyer atij."*.[2]

Kur ne e vëmë përmbajtjen e kësaj sureje pranë mirësisë e shpërblimit që arrihet me leximin e kësaj sureje, për ne bëhet shumë e qartë lidhja që ekziston në mes shpërblimit e përmbajtjes së saj. Por duhet të theksojmë edhe një herë se, qëllimi me leximin nuk është ai leximi i thatë e pa shpirt, por qëllimi është për leximin e shoqëruar me mendimin e thellë rreth asaj që lexohet dhe për të punuar me vendosmëri e seriozitet, sepse këta dy faktorë e shtyjnë njeriun të punojë sipas asaj që ka ardhur në këtë sure të uruar.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 8, f. 463, fillimi i sures "Sàd".
[2] Burimi i sipërm.

Ajetet: 1 – 3

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

صٓۚ وَٱلۡقُرۡءَانِ ذِى ٱلذِّكۡرِ ۝١ بَلِ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ فِى عِزَّةٍ وَشِقَاقٍ ۝٢ كَمۡ أَهۡلَكۡنَا مِن قَبۡلِهِم مِّن قَرۡنٍ فَنَادَواْ وَّلَاتَ حِينَ مَنَاصٍ ۝٣

Bismil'làhir Rrahmànir Rrahim

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Sàd; betohem në Kur'ànin e mbushur me këshilla."

"Ata që mohuan janë të poshtëruar e të përçarë."

"Sa shumë breza kemi shkatërruar para atyre, të cilët (kur panë ndëshkimin) **u lutën për shpëtim, por tanimë ajo kohë kishte përfunduar."**

Shkaqet e zritjes

Në librat e tefsireve dhe të haditheve, janë përmendur shkaqe të ngjashme në lidhje me shkakun e zbritjes së ajeteve të para të kësaj sureje, por ne këtu do të shikojmë vetëm njërin prej këtyre shkaqeve, për faktin se është më i hollësishëm e më përgjithësues se shkaqet e tjera. Në një transmetim që e ka cituar i ndjeri dijetari poliedrik El Kulejni prej Imam Bàkirit *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: Ebù Xhehl bin Hish'shàm, së bashku me disa kurejshë të tjerë, shkuan te Ebù Tàlibi dhe i thanë: Djali i vëllait tënd po na fyen ne dhe po fyen zotat tanë, prandaj thirre dhe urdhëroje që ai të heqë dorë prej zotave tanë, që edhe ne të heqim dorë prej Zotit të tij.

Ebù Tàlibi e thirri të Dërguarin e All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*. Kur Profeti hyri në shtëpinë e xhaxhait të tij, aty pa vetëm një idhujtar dhe para se të ulej përshëndeti me fjalët: "*Paqe e shpëtim për cilindo që ndjek udhëzimin në rrugën e drejtë.*". Ebù Tàlibi e njoftoi për shkakun që e kishte thirrur. Atëherë i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* tha: "*A ka fjalë më të mirë për ata, fjalë me të cilën arabët të jenë zotërinj dhe të ulin kokat e tyre?*".

Ebù Xhehli tha: Na e thuaj, cila është kjo fjalë?

Ai tha: Të thoni "Là ilàhe il'lell'llàh" (Nuk ka zot tjetër përveç All'llahut.)

Sapo i dëgjuan këto fjalë, ata menjëherë zunë vrimat e veshëve me gishtat e duarve dhe dolën jashtë duke thënë: Për këtë fe të fundit ne nuk kemi dëgjuar, prandaj kjo është vetëm një

sajesë. Atëherë i Larti zbriti ajetet: 1 deri te fundi i ajetit 7 të kësaj sureje: **"Sàd; betohem në Kur'ànin e mbushur me këshilla… veçse një sajesë."**.[1]

Komentimi

Koha për shpëtim mbaroi

Edhe një herë tjetër, ndeshemi me një sure që fillon me germa të ndara. Shikojmë se edhe kjo sure fillon me një germë të vetme, fillon me germen *"Sàd"*, prandaj edhe këtu shtrohet pyetja e përparshme në lidhje me interpretimin e germave të ndara, nëse këto germa të ndara tregojnë madhështinë e Kur'ànit Famëlartë, i cili ndjek rrjedhën e jetës njerëzore në këtë botë dhe përbëhet prej germave të ngjashme, që lakohen aq lehtë prej të gjithëve, siç lexohet zakonisht alfabeti.

Por, fuqia e madhe e All'llahut të Lartësuar bëri që me këto germa të thjeshta të përbëhet Libri Famëlartë, Kur'àni Madhështor, Fjala e All'llahut të Lartësuar; apo kjo germë është një simbol prej sekreteve të të Gjithëfuqishmit e të Profetëve të Tij, apo kjo germë në krye të kësaj sureje, nënkupton punë të tjera?

Një grup prej interpretuesve të Kur'ànit Famëlartë, janë shprehur se germa *"Sàd"* është simbol që tregon njërin prej

[1] "Usùlul Kàfij", cituar prej tefsirit "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 441.

emrave të bukur të All'llahut të Lartësuar, sepse shumë prej emrave të bukur të All'llahut fillojnë me germën *"Sàd"*, si, për shembull, emrat *"Sàdik" – "i Drejti"*; *"Samed" – "i Përhershmi"*; *"Sàni'u" – "Bërësi"*; *"sadekall'llàhu" – "All'llahu thotë të vërtetën"*; dhe për shkurtim është shkruar vetëm me germën *"Sàd"*.

S'ka dyshim që e keni lexuar interpretimin në lidhje me germat e ndara, qysh në fillimin e sures së parë të Kur'ànit Famëlartë, sures "El Bekare" dhe të sureve "Àli Imràn", "El A'ràf" etj.

Më pas, All'llahu i Lartësuar betohet në Kur'ànin e mbushur me këshilla dhe që me të vërtetë është një mrekulli hyjnore: **"Betohem në Kur'ànin e mbushur me këshilla."**.[1]

Po, Kur'àni Famëlartë është këshillë dhe përmban këshilla me vlera shumë të rëndësishme dhe këshillë do të thotë: Heqja e ndryshkut të shkujdesjes prej zemrave me gdhendje me daltë, që njeriu të mbajë në mendje All'llahun e të përmendë mirësitë e All'llahut, të kujtojë gjykatën madhore të All'llahut Ditën e Kiametit, të mendojë edhe për qëllimin e krijimit të njeriut.

Po, harresa dhe shkujdesja janë prej faktorëve më të rëndësishëm që sjellin brengosjen e njeriut, kurse Kuràni Famëlartë është ilaçi më i mirë për shërimin e harresës e të shkujdesjes.

Në lidhje me hipokritët, Kur'àni Famëlartë thotë, në ajetin 67 të sures "Et Teube": **"...ata e harruan All'llahun, prandaj edhe**

[1] Fjalia **"Betohem në Kur'ànin e mbushur me këshilla"**, është si formulë betimi me përgjigje të hequr, prandaj vlerësimi i kësaj fraze është: (Kur'àni i mbushur me këshilla, ti thua të vërtetën dhe kjo fjalë është mrekulli).

Ai i harroi ata"; domethënë: Ata nuk u kujtuan për All'llahun, prandaj, kundrejt harresës së tyre edhe All'llahu i la ata në harresë dhe preu mëshirën e Tij për ata.

Kurse në ajetin 26 të sures objekt studimi (sure "Sàd"), i Larti flet për ata që e kanë lënë udhëzimin në Rrugën e Drejtë dhe kanë harruar Ditën e Llogaridhënies: **"…ata që i largohen Rrugës së All'llahut, i pret ndëshkimi shumë i ashpër, për shkak se ata e harruan Ditën e Llogaridhënies."**.

Po, po, harrimi është sprova e rëndë me të cilën vihen në provë ata që e lënë udhëzimin në Rrugën e Drejtë dhe fajtorët, madje ata kanë harruar deri edhe vlerën e qenies së tyre njeri, ashtu siç njofton Kur'àni Famëlartë, në ajetin 19 të sures "El Hashr": **"Dhe mos u bëni si ata që e harruan All'llahun dhe All'llahu bëri që ata të harrojnë veten e tyre; të këtillë janë të degjeneruarit."**.

Kur'àni Famëlartë është mjeti më i mirë për të grisur perden e harresës, për të zhdukur errësirat e shkujdesjes, shpërfilljes e harresës; ajetet e Kur'ànit Famëlartë i kujtojnë njeriut All'llahun dhe ringjalljen pas vdekjes; ato e mësojnë njeriun të njohë vlerën e ekzistencës së tij në këtë botë.

Ajeti vijues i flet drejtpërdrejt të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe i thotë: Kur sheh se ata që nuk dorëzohen para argumenteve të qartë të All'llahut dhe Kur'ànit Famëlartë, dije se shkaku që ata kundërshtojnë, është se para syve ata kanë një perde që ua mbulon fjalën e vërtetë. Në të vërtetë, ata janë vënë në sprovë me mendjemadhësinë e me mashtrimin, dy vese të liga, që i pengojnë

mohuesit të pranojnë të vërtetën; por edhe kokëfortësia e fanatizmi i tyre, janë dy pengesa që i ndalojnë ata të pranojnë thirrjen tënde dhe ajeti njofton: **"Ata që mohuan, janë të poshtëruar e të përçarë."**.

Fjala *"iz'zetin"*, shpjegon Ràgibi në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", do të thotë: Njeri i pathyeshëm dhe fjala *"iz'zetin"*, në rrënjën e saj *"az'zàz"*, do të thotë: Tokë e fortë, në të cilën nuk depërton uji, por kjo fjalë jep dy kuptime: Herë jep kuptimin e fuqisë së madhe dhe në këtë kuptim është cilësi e lavdëruar dhe e respektuar, pasi me këtë fjalë All'llahu i Lartësuar ka përshkruar veten e Tij: *"el azijzu"* – *"Fuqiploti"*, herë tjetër kjo fjalë jep kuptimin e kundërshtimit e të mendjemadhësisë për të mos pranuar të vërtetën. Patjetër që, kuptimi i fundit në lidhje me të vërtetën e punës, është poshtërim.

Kurse fjala tjetër *"shikàk"*, në rrënjën e saj *"shek'kun"* - do të thotë çarje, por më vonë është përdorur në kuptimin e divergjencave që shkaktojnë çarjen e grupit dhe për rrjedhojë, grupi i dalë prej asaj çarjeje, ndahet prej grupit mëmë dhe qëndron mënjanë.

Në këtë ajet, Kur'àni Famëlartë, ndër shkaqet që sjellin brengosjen e mohuesve, numëron mendjemadhësinë, krekosjen dhe ndjekjen e rrugës së veçimit e të ndarjes. Patjetër, të gjitha këto vese shumë të këqija, njeriut i verbojnë sytë e i shurdhojnë veshët dhe bëjnë që ai të humbë ndjenjat e tij. Sa e dhimbshme është për njeriun që i ka sytë për të parë dhe veshët për të dëgjuar, por që nga mendjemadhësia duket sikur është i vebër e shurdh.

Në ajetin 206 të sures "El Bekare", i Larti njofton: **"Dhe kur atij i thuhet: kije frikë All'llahun, ai krekoset me mëkatin,**

prandaj vendi i tij do të jetë Xhehennemi dhe sa vendqëndrim i keq është ai!"; domethënë: Kur hipokritit i thuhet kije frikë All'llahun, ai kapardiset e mburret me fanatizmin që e ka mbërthyer dhe që në të vërtetë e çon të zhytet edhe më shumë në faje e të rrëzohet në zjarrin e Xhehennemit, prandaj për atë s'mund të ketë vendqëndrim më të keq.

Për të zgjuar ata mendjemëdhenj e shpërfillës, Kur'àni Famëlartë i kthehet të kaluarës së historisë njerëzore, me qëllim që ata të shohin se si qe e ardhmja e popujve të mashtruar e mendjemëdhenj, që ata të nxjerrin mësim prej pësimit të të përparshmëve dhe ajeti njofton: **"Sa shumë breza kemi shkatërruar para atyre?"**.

Domethënë: shumë popuj para tyre, Ne i shkatërruam, për shkak se përgënjeshtruan Profetët, mohuan argumentet e All'llahut, ishin mizorë dhe bënë faje të shumta. Megjithëkëtë, kur mbi ata zbriste ndëshkimi i All'llahut, kërkonin ndihmë me zë të lartë, por kjo atyre nuk u solli asnjë dobi, pasi ishin të vonuar, koha e pendimit për ata tashmë kishte kaluar dhe para tyre s'kishte më kohë të mjaftueshme as që të shpëtonin veten; për këtë, fraza e fundit e ajetit të fundit të këtij grupi ajetesh, njofton: **"U lutën për shpëtim, por tanimë ajo kohë kishte përfunduar."**.

Kur Profetët e All'llahut i këshillonin ata mohues e i paralajmëronin për përfundimin e keq që kishin punët e tyre, ata nuk u mjaftuan të zënë veshët me gishta për të mos dëgjuar fjalën e Profetëve, por u tallën e i vunë në lojë Profetët dhe torturuan e vranë besimtarët. Me punë të këtilla, ata e humbën rastin dhe shkatërruan të gjitha urat prapa tyre. Pikërisht, atëherë zbriti mbi ata ndëshkimi i All'llahut, që i shkatërroi deri tek i fundit, duke

mbyllur për ata portën e pendimit e të kthimit në jetën e zakoshme. Kur ata mohues shikonin se mbi ata po zbriste ndëshkimi i All'llahut, ata thërrisnin me zë të lartë, për të kërkuar ndihmë, por atyre në ato çaste nuk u sillte dobi asnjë send.

Fjala *"uelàte"*, është fjalë mohuese dhe në origjinë është në kuptimin e shprehjes *"là"* – *"jo"* por asaj i është është shtuar germa *"t"*, që tregon gjininë femërore, me qëllim që fjala të marrë kuptim përforcues.

Ndërsa fjala tjetër *"menàs"*, në rrënjën e saj *"nùs"*, do të thotë: "*strehim, vend ku të fusin kokën*". Thuhet se arabëve të asaj kohe, kur u ndodhte të ishin në gjendje të vështirë dhe frikësuese, veçanërisht nëpër luftërat, ata e përsërisnin fjalën *"menàs menàs"* në kuptimin: ku është strehimi? Ku është strehimi? Në të vërtetë, ky kuptim është në harmoni me kuptimin e fjalës: U larguan me vrap, i kthyen shpinën luftës; herë tjetër, kjo fjalë vjen në kuptimin: nga t'ia mbajmë, që të largohemi.[1]

Në të gjitha gjendjet, ata mendjemëdhenj e shpërfillës nuk përfituan prej rastit që e kishin në dorë dhe të gjenin strehim në prehërin e mëshirës e të butësisë së All'llahut, por, pasi e humbën rastin dhe mbi ata ra ndëshkimi hyjnor, ata filluan të kërkojnë ndihmë me zë të lartë dhe bënin ç'mos për të gjetur një rrugë shpëtimi për veten e tyre; por të gjitha përpjekjet e tyre dështuan, pavarësisht sa shumë u munduan e sa shumë e kërkuan ndihmën, ata nuk mund të arrinin qëllimin e tyre.

[1] Fjalori i fjalëve të Kur'ànit i Ràgibit "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn"; tefsiri i Fakhru Ràziut "El Kebijr"; tefsiri "Rùhul Meànij" dhe libri "Mexhmaul Bahrejn" lënda: *"nùs"*.

Kjo ka qenë rruga e All'llahut me të gjithë popujt e kaluar dhe e këtillë do të mbetet, sepse rruga e All'llahut nuk ndryshon, nuk tjetërsohet e nuk zëvendësohet.

Është për të ardhur keq kur shikon se shumica e njerëzve nuk e kanë gatishmërinë për të marrë këshilla e për të nxjerrë mësime prej përvojave që kanë kaluar të tjerët para tyre, madje, me qëndrimet që mbajnë, duket sikur dëshirojnë që ato përvoja të kaluara të përsëriten edhe një herë; mirëpo përvoja të këtilla ndodhin vetëm një herë në jetën e njeriut dhe kurrë nuk përsëriten për herë të dytë, me fjalë të tjera, ato janë të parat dhe të fundit.

Ajetet: 4 – 7

وَعَجِبُوٓاْ أَن جَآءَهُم مُّنذِرٞ مِّنۡهُمۡۖ وَقَالَ ٱلۡكَٰفِرُونَ هَٰذَا سَٰحِرٞ كَذَّابٌ ٤ أَجَعَلَ ٱلۡأٓلِهَةَ إِلَٰهٗا وَٰحِدًاۖ إِنَّ هَٰذَا لَشَيۡءٌ عُجَابٞ ٥ وَٱنطَلَقَ ٱلۡمَلَأُ مِنۡهُمۡ أَنِ ٱمۡشُواْ وَٱصۡبِرُواْ عَلَىٰٓ ءَالِهَتِكُمۡۖ إِنَّ هَٰذَا لَشَيۡءٞ يُرَادُ ٦ مَا سَمِعۡنَا بِهَٰذَا فِي ٱلۡمِلَّةِ ٱلۡأٓخِرَةِ إِنۡ هَٰذَآ إِلَّا ٱخۡتِلَٰقٌ ٧

"Ata (idhujtarët) **u habitën që paralajmëruesi u erdhi prej mesit të tyre; mohuesit thanë: ky është magjistar gënjeshtar."**

"Qysh i bën ai zotat vetëm një Zot; kjo gjë është shumë e çuditshme!"

"Paria e tyre shpejtoi t'u thoshte atyre; vazhdoni të qëndroni në zotat tuaj; se kjo patjetër është diçka e kurdisur."

"Ne nuk kemi dëgjuar diçka si kjo prej brezit të fundit dhe kjo s'është gjë tjetër veçse një trillim."

Shkaqet e zbritjes

Shkaku i zbritjes së këtyre ajeteve është i ngjashëm me shkakun e zbritjes së ajeteve të para dhe nuk përjashtohet mundësia që të jetë i njëjti shkak edhe për ajetet objekt studimi.

Por shkaku i zbritjes së këtyre ajeteve, ka në brendinë e tij kërkesa të reja. Në lidhje me këtë çështje, në tefsirin e Ali Ibrahimit, thuhet: Pasi i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* filloi të bëjë thirrjen e tij haptasi, kurejshët u mblodhën dhe shkuan te Ebù Tàlibi e i thanë: Djali i vëllait tënd na ka prishur gjumin. Ai shan zotat tanë, e ka shthurur rininë dhe e ka përçarë shoqërinë tone. Nëse atë e shtyn varfëria ta bëjë këtë punë, ne kemi mbedhur pasuri për atë sa ai të jetë burri më i pasur ndër të gjithë kurejshët dhe ne atë e bëjmë mbretin tonë.

Ebù Tàlibi e njoftoi të Dërguarin e All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe ai (Profeti) iu përgjegj: "*Sikur ata të më vënë Diellin në dorën e djathtë dhe Hënën në dorën e majtë, nuk heq dorë nga rruga ime, por dua prej atyre të më japin vetëm një fjalë, me të cilën ata do të zotërojnë arabët, ajo do të jetë feja e joarabëve dhe ata vetë do të jenë mbretër në Xhennet.*".

Ebù Tàlibi ua tha këto fjalë kurejshëve dhe ata thanë: Po, i japim edhe dhjetë fjalë në vend të një fjale, por për cilën fjalë është qëllimi yt: I Dërguari i All'llahut iu thotë: "*Të dëshmoni se nuk ka zot tjetër përveç All'llahut dhe se unë jam i Dërguari i All'llahut.*".

Kur dëgjuan këtë përgjigje, ata u ndjenë shumë ngushtë dhe thanë: Të lëmë treqind e gjashtëdhjetë zota dhe të adhurojmë vetëm një zot? Shumë punë e çuditshme, të adhurojmë vetëm një zot, që nuk është e mundur të shihet me sy! Atëherë zbritën ajetet objekt studimi: **"Ata** (idhujtarët) **u habitën që paralajmëruesi u erdhi prej mesit të tyre; mohuesit thanë: ky është magjistar gënjeshtar."** deri në frazën e fundit të ajetit 7.[1]

Ky kuptim, me fare pak ndryshim, ka ardhur edhe në tefsirin "Mexhmaul Bejàn", autori i të cilit, në fundin e transmetimit thotë se i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* pasi dëgjoi përgjigjen e krerëve të kurejshëve, tha: "*O xhaxha, pasha All'llahun, sikur ata të më vënë Diellin në dorën e djathtë dhe Hënën në dorën e majtë, unë nuk heq dorë prej kësaj fjale, ose e zbatoj atë, ose vritem për atë.*". Atëherë Ebù Tàlibi i tha: "*Shko e vazhdo punën tënde, betohem në All'llahun, unë kurrë nuk të braktis ty.*".[2]

[1] Tefsiri i Ali Ibrahimit, cituar prej tefsirit "Nùruth Thekalejni", vëll. 4, f. 442.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 8, f. 465.

Komentimi

A mund të pranohet vetëm një Zot në vend të gjithë atyre zotave?

Idhujtarët mendjemëdhenj nuk njihnin asnjë punë që nuk ishte në përshtatje me mendimet e tyre të kufizuara e të cunguara, megjithëse ata i konsideronin mendimet e tyre njësi matëse për të gjitha vlerat, prandaj, kur i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ngriti flamurin e Njëtimit të All'llahut në Mekë dhe shpalli kryengritjen kundër 360 idhujve të mëdhenj e idhujve të vegjël që ishin vënë në Qabe, ata çuditeshin dhe kur bisedonin njëri me tjetrin, thoshin: përse paralajmëruesi u erdhi prej mesit të tyre? **"Ata** (idhujtarët) **u habitën që paralajmëruesi u erdhi prej mesit të tyre."**.

Atyre u vinte çudi nga që Muhammedi *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ishte një burrë prej tyre. Përse nuk zbresin engjëjt prej Qiellit, me kumtin? Ata idhujtarë mendonin se kjo tregon mungesën e fuqisë. Ata nuk e kuptonin se ai që ngarkohej me misionin e mbajtësit të kumtit, patjetër duhej të ishte prej mesit të popullit, sepse vetëm ai i njihte më mirë nevojat që kishin njerëzit dhe ku i dhimbte më shumë popullit të tij. Duke qenë mbajtësi i kumtit të All'llahut prej mesit të tyre, ai njihte më mirë jo vetëm problemet që ata kishin, por ai njihte dhe çdo pjesë të jetës së tyre. Veç kësaj, ky paralajmërues, që ishte prej mesit të tyre, ishte shembull e model që duhej të ndiqej prej atyre. Por ata e konsideronin këtë privilegj të madh pikë negative në thirrjen e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut*

qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) dhe u çuditën që ai u dërgua Profet te ata.

Herë tjetër, ata idhujtarë e kapërcenin fazën e çuditjes dhe kalonin në fazën e akuzimit. Ata e akuzuan të Dërguarin e All'llahut si magjistar e gënjeshtar, ashtu siç njofton fraza e fundit e ajetit të parë të këtij grupi ajetesh: **"Mohuesit thanë: Ky është magjistar gënjeshtar."**.

Disa herë kemi thënë: Akuzimi që ata i bënin të Dërguarit më të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* se ai është magjistar, në të vërtetë kjo akuzë e idhujtarëve ishte rezultat i shikimit të mrekullive të tij, mrekulli që nuk mund të mohoheshin dhe që depërtonin në mënyrë të habitshme në mendimet e shoqërisë. Gjithashtu edhe akuza që ata i bënin atij si gënjeshtar, ishte për shkak se ai u fliste atyre për punë që ishin në kundërshtim me bestytnitë e tyre mitike dhe me mendimet e tyre të kohës së injorancës, para Islamit, por mitet e bestytnitë në shoqërinë e asaj kohe konsideroheshin si norma morale, kurse ai vinte e u thoshte atyre se jam i ngarkuar prej All'llahut të kumtoj kumtin e Tij.

Kur i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*, filloi të shpallë hapur thirrjen për të besuar në All'llahun, Zotin Një e të Vetëm, ata filluan të shikojnë njëri-tjetrin dhe t'i thonë shoku-shokut: eja të dëgjosh çudinë e çudirave: **"Qysh i bën ai zotat vetëm Një Zot; kjo gjë është shumë e çuditshme!"**.

Po, krekosja, mendjemadhësia, shto këtu edhe degjenerimin e shoqërisë, të gjitha këto ndihmojnë në ndryshimin e aftësisë së njeriut për të kuptuar dhe bëjnë që njeriu të çuditet

edhe prej disa punëve reale e të qarta dhe në të njëjtën kohë, ndjek me këmbëngulje mitet e iluzionet e kota.

Fjala *"uxhàbun"*, është në kuptimin e çudisë në shkallën më të lartë dhe përdoret për të treguar një punë shumë të çuditshme.

Mendjelehtët prej kurejshëve, besonin se, sa më shumë të shtohej numri i zotave të tyre, aq më shumë shtoheshin edhe depërtimi e fuqia e tyre, prandaj ekzistenca e vetëm një zoti, sipas mendimit të tyre, ishte shumë pak; por dihet, sendet e shumta, në këndvështrimin e filozofisë, gjithmonë janë të kufizuara, kurse qenia e pakufizuar është vetëm një dhe jo më shumë; ky është edhe shkaku që studimet në lidhje me njohjen e All'llahut, përfundojnë në Njëtimin e Tij.

Pasi shtypësit kurejshë e humbën shpresën prej ndërmjetësimit të Ebù Tàlibit, u larguan prej shtëpisë së tij dhe filluan t'i thonë njëri-tjetrit, ose pasuesve të tyre: shkoni dhe përkushtohuni më shumë në adhurimin e zotave tuaj, qëndroni në fenë tuaj, madje duroni edhe vështirësitë për shkak të fesë suaj, sepse Muhammedi ka qëllim të çojë shoqërinë tonë drejt shkatërrimit dhe që ne të humbim mirësitë e All'llahut, për shkak se do të heqim dorë prej adhurimit të idhujve; ai synon të bëhet i parë ndër ne, ashtu siç njofton ajeti vijues: **"Paria e tyre shpejtoi t'u thoshte atyre: vazhdoni të qëndroni në zotat tuaj, se kjo patjetër është diçka e kurdisur."**.

Fjala *"intaleka"*, në rrënjën e saj do të thotë: largim me të shpejtë prej një pune të mëparshme dhe këtu tregon se ata, pasi u larguan nga kuvendi me Ebù Tàlibin, në sjelljet e në fjalët e tyre dalloheshin qartë shenjat e zemërimit e të mllefit.

Fjala tjetër *"el meleu"*, tregon se ata që shkuan te Ebù Talibi, ishin burra të njohur prej parisë së kurejshëve dhe pasi u larguan prej shtëpisë së tij, ata biseduan njëri me tjetrin, ose u thanë pasuesve të tyre: mos hiqni dorë prej adhurimit të idhujve tuaj, madje t'i adhuroni ata edhe më shumë.

Fraza e ajetit *"le shej'un juràdu"*, do të thotë: "*Atje ka një punë të qëllimshme*". Në të vërtetë, kjo frazë ka një lloj paqartësie, prandaj interpretuesit e Kur'ànit Famëlartë kanë bërë interpretime të shumta në lidhje me këtë frazë dhe në njërin prej të cilëve thuhet se i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* u bëri thirrje kurejshëve të besonin në Njëtimin e All'llahut (Teuhid), por kurejshët e konsideruan thirrjen e tij komplot kundër tyre dhe thoshin: Në dukje ai bën thirrje për të besuar në All'llahun, kurse nga brenda thirrja e tij ka qëllim që ai të bëhet i parë mbi ne dhe mbi të gjithë arabët. Ai e përdor këtë thirrje si pretekst për të realizuar qëllimin e tij të vërtetë, që ai të jetë kryetar mbi ne, prandaj ata u flisnin njerëzve të adhuronin idhujt e tyre sa më shumë, kurse punën e këtij komploti, njerëzit duhet ta linin në dorën e të parëve të vendit. Kjo është metoda që kanë praktikuar gjithmonë krerët e rrugës së humbjes, për të bërë të heshtin zërat e atyre që ecin në rrugën e të vërtetës; madje ata edhe thirrjen për të besuar në All'llahun e quajtën komplot, prandaj ishte detyra e burrave të politikës që të analizonin punën e këtij komploti me imtësi, me qëllim që të bënin plane e programe të sistemuara që të përballeshin me atë thirrje dhe për këtë duhej që masa e njerëzve jo vetëm të mos i kushtonte thirrjes së tij asnjë interes, por ata patjetër duhej të përmbaheshin edhe më shumë në adhurimin e idhujve të tyre.

Një bisedë e ngjashme ka ardhur edhe në tregimin e Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kur paria e popullit të tij u thoshte njerëzve të thjeshtë: **"Ky s'është gjë tjetër veçse njeri siç jeni edhe ju, porse ai ka qëllim të jetë më i lartë se ju."** (Sure "El Mu'minùn", ajeti 24).

Të tjerë kanë thënë se qëllimi me frazën *"leshej'un juràdu"*, është: o adhurues të idhujve, qëndroni fuqishën në adhurimin e zotave tuaj, sepse kjo është ajo që kërkohet prej jush.

Të tjerë kanë thënë: qëllimi me këtë frazë është: Muhammedi na ka vënë ne në shënjestër dhe se ai ka qëllim të çojë shoqërinë tonë drejt shkatërrimit, ai na kërkon të heqim dorë ne prej zotave tanë, por përfundimi i lënies së zotave patjetër do të jetë që ne të mos kemi më mirësitë që kemi dhe mbi ne të bjerë ndëshkimi i zotave!

Të tjerë kanë thënë: qëllimi me këtë frazë është: Muhammedi nuk do ta pushojë thirrjen e tij. Ai është i vendosur plotësisht për përhapjen e thirrjes që bën dhe kjo vendosmëri nga ana e tij, është shkaku që bisedimet me atë janë pa asnjë rezultat, prandaj ju shkoni dhe kapuni sa më shumë në besimet tuaja.

Të tjerë kanë thënë se qëllimi me këtë frazë është: Fatkeqësia do të bjerë mbi ne, por, si do që të bëhet, ne kemi detyrë të përgatitemi dhe të kapemi dhe të jemi sa më të vendosur për të ecur në rrugën tonë e të mbajmë besimet tona.

Natyrisht që kjo frazë ka një kuptim përgjithësues, prandaj shumica e interpretimeve jep kuptimin e kërkuar; megjithëkëtë, interpretimi i parë konsiderohet interpretimi më i përshtatshëm me kuptimin që shprehin vetë fjalët e kësaj fraze të këtij ajeti.

Në të gjitha rastet, krerët e idhujtarëve, me fjalët që thoshin lart e poshtë, kishin qëllim që të ngrinin lart moralin e pasuesve të tyre dhe që atyre të mos u tronditeshin besimet në idhujt; por të gjitha përpjekjet e tyre shkuan së bashku me vrundujt e erërave.

Krerët e idhujtarëve, me qëllim që të mashtronin masën e njerëzve të thjeshtë dhe njëkohësisht që t'i mbushnin mendjen vetes, thanë: **"Ne nuk kemi dëgjuar diçka si kjo prej brezit të fundit, kjo s'është gjë tjetër veçse një trillium."**.

Me këto fjalë, ata thoshin: sikur mëtimi për të adhuruar vetëm një zot dhe për të hequr dorë prej adhurimit të idhujve të ishte diçka reale, patjetër që prindërit tanë, si burra me personalitet që ishin, patjetër që do ta kishin kuptuar këtë punë dhe ne patjetër do të kishim dëgjuar prej tyre në lidhje me këtë çështje, prandaj kjo është thjesht gënjeshtër.

Fraza e ajetit **"brezit të fundit"**, ka mundësi të tregojë për brezin e prindërve të tyre, duke e konsideruar brezi i fundit në raport me ata; gjithashtu, ka mundësi që kjo frazë të tregojë për ithtarët e librave të përparshëm, sidomos për të krishterët, që ishin populli i fundit dhe feja e tyre ishte feja e fundit para ardhjes së Profetit të Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*. Me këtë frazë, ata kishin qëllim të thoshin: ne nuk kemi gjetur asgjë në lidhje me adhurimin e një Zoti të vetëm në librat e të krishterëve dhe në fakt nuk kishin si ta gjenin, sepse në librat e të krishterëve flitet për trinitetin, kurse adhurimi i një Zoti të vetëm, siç mëton Muhammedi, është një punë e re.

Ajetet e Kur'ànit Famëlartë, shpjegojnë qartë se, arabët e kohës së injorancës para Islamit, nuk bazoheshin as në librat e jehudive e as në librat e të krishterëve. Ata mbështeteshin vetëm

në rregullat, në mitet e në zakonet që u kishin lënë gjyshërit e prindërit e tyre dhe kjo është një argument që vërteton saktësinë e interpretimit të parë të kësaj fraze.

Ndërsa fjala *"ikhtilàk"*, në rrënjën e saj do të thotë: fillimi i një pune që nuk ishte më parë; gjithashtu, kjo fjalë thuhet edhe për rrenën, sepse rrena, në shumicën e herëve, shtron çështje që nuk ekzistojnë, prandaj edhe qëllimi me fjalën *"ikhtilàk"*, në ajetin objekt studimi, tregon se Njëtimi i All'llahut, për të cilin bën thirrje ky Profet, për ata ishte një çështje e panjohur, ashtu siç ishte e panjohur edhe për gjyshërit e tyre të përparshëm; prandaj, idhujtarët thoshin se thirrja e tij është thjesht diçka e kotë dhe trillim.

Hulumtim

Frika nga e reja

Frika prej punëve që dalin rishtas, gjatë gjithë historisë ka qenë njëri prej shkaqeve që kanë qëndruar prapa këmbënguljes së popujve që kishin humbur udhëzimin në rrugën e drejtë, për të ruajtur sa më shumë rrugën e shmangies që i kishin bërë udhëzimit në rrugën e vërtetë, si dhe mosdorëzimi ndaj thirrjeve që u kanë bërë atyre Profetët e All'llahut. Prandaj, ata kanë frikë prej çdo risie. Nga kjo frikë, ata i shihnin ligjet e fesë me të cilin vinin Profetët, si gjëra shumë të këqija. Madje ata vazhdonin të mbartnin mbeturina të mendimit të kohës së injorancës para Islamit, në një kohë që thirrja e Profetëve për të besuar vetëm në All'llahun, Zotin Një e të Vetëm, nuk është ndonjë punë e re, por edhe sikur të mendohet ashtu siç mendonin ata se thirrja e Profetëve ishte diçka e stisur kohët e fundit, kjo nuk është argument që vërteton se thirrja e tyre është e pavlerë. Prandaj, mbetet detyrë të ndjekim logjikën dhe të dorëzohemi para të vërtetës, kudo që ajo të gjendet dhe prej kujtdo që e vërteta të mësohet.

Është e çuditshme se çështja e frikës ndaj të resë, fakeqësisht është shtrirë edhe në disa dijetarë të fesë, të cilët marrin qëndrim kundërshtues ndaj teorive të reja shkencore, duke u përligjur me frazën e fundit të ajetit objekt studimi: **"...kjo s'është gjë tjetër veçse një trillium."**.

Frika prej të resë u dëshmua në mënyrë të veçantë në historinë e kishës së krishterë, krerët e të cilës morën qëndrime negative ndaj zbulimeve shkencore që realizuan shkencëtarët në

fushën e shkencave të natyrës, si Galileu, i cili u përball me sulmet më të ashpra të kishës kur ai shpalli se Toka rrotullohet rreth Diellit dhe rreth vetes së saj, por drejtuesit e kishës në atë kohë thoshin se kjo fjalë është trillim.

Por edhe më e çuditshme është se disa shkencëtarë, kur arrinin në të vërtetat e reja shkencore, e mbështesnin studimin e realizuar në librat më të njohur, me shpresën që të gjenin shkencëtarë të përparshëm që kishin të njëjtin mendim dhe e gjitha kjo vinte prej frikës që ata kishin për të mos qenë në shënjestrën e sulmeve të Inkuizicionit. Me këtë mënyrë, shumë shkencëtarë gjetën mundësinë për të shfaqur pikëpamjet e tyre, duke i paraqitur punimet e tyre si të vjetra dhe jo si punime shkencore të reja; por edhe kjo është e dhimbshme.

Një shembull në lidhje me këtë çështje e shikojmë në librin *El Esfaru*, në të cilët flitet për teorinë e njohur *"el hareketul xheuherijetutë"* i Sadr El Mute'elihijne Esh Shijrazij.

Në të gjitha gjendjet, rruga e ndjekur për trajtimin e problemeve të reja dhe të shpikjeve të reja, ka çuar në humbje të mëdha për shoqërinë njerëzore dhe në botën e shkencës, prandaj, mbetet detyrë e atyre që kanë lidhje me këto punë, që të punojnë për të ndrequr këto dukuri dhe të zhdukin mbeturinat e kohës së injorancës prej opinionit publik.

Por kjo, në asnjë rast nuk do të thotë pranim të çdo mendimi dhe të thuhet se është mendim i ri edhe kur ai mendim është pa asnjë bazë, sepse kapja pas kësaj të reje pa asnjë bazë, do të ishte një fatkeqësi e madhe, ashtu siç ishte fatkeqësi edhe dashuria e verbër për t`u kapur pas të kaluarës; kurse maturia e drejtpeshimit islam na bën thirrje që, në punët tona, as të mos e kalojmë masën e as të mos e lëmë mangut.

Ajetet: 8 – 11

أَءُنزِلَ عَلَيْهِ ٱلذِّكْرُ مِنۢ بَيْنِنَا ۚ بَلْ هُمْ فِى شَكٍّ مِّن ذِكْرِى ۖ بَل لَّمَّا يَذُوقُوا۟
عَذَابِ ﴿٨﴾ أَمْ عِندَهُمْ خَزَآئِنُ رَحْمَةِ رَبِّكَ ٱلْعَزِيزِ ٱلْوَهَّابِ ﴿٩﴾ أَمْ لَهُم
مُّلْكُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا ۖ فَلْيَرْتَقُوا۟ فِى ٱلْأَسْبَٰبِ ﴿١٠﴾ جُندٌ مَّا
هُنَالِكَ مَهْزُومٌ مِّنَ ٱلْأَحْزَابِ ﴿١١﴾

"A mos atij nga mesi ynë iu zbrit Kur'àni? Jo, ata kanë dyshim në Kur'ànin Tim, por (për këtë) **do të shijojnë ndëshkimin Tim."**

"A mos janë te ata depot e mëshirës së Zotit tënd, të Fuqishmit, Dhuruesit të madh?" "A mos ata kanë pushtetin e qiejve, Tokës dhe ç`ka në mes të dyjave (në mes qiejve e Tokës)**? Le të ngjiten lart me shkaqet."**

"Atje është një ushtri e shpartalluar e grupeve."

Komentimi

Ushtria e shpartalluar

Ajetet e mëparshme, flisnin për qëndrimet negative që morën kundërshtarët e programit të Njëtimit të All'llahut dhe Islamit. Edhe në këto ajete, vazhdon biseda rreth qëndrimeve të idhujtarëve të Mekës, të cilët e ndjenin se interesat e tyre të paligjshme po viheshin në rrezik dhe kjo bëri që në zemrat e tyre të ndizej zjarri i urrejtjes e i smirës. Prandaj, për të mashtruar njerëzit dhe njëkohësisht për t'i mbushur mendjen edhe vetes së tyre, me një logjikë mashtruese, filluan të ngrinin mëtime nga më të ndryshmet, për të luftuar të Dërguarin e All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe njëri prej mëtimeve të tyre ishte pyetja që ata e shtronin në mënyrën habitore dhe që shprehte mohimin e tyre, kur thoshin në mes njëri-tjetrit: **"A mos atij nga mesi ynë iu zbrit Kur'àni?"**.

A nuk gjeti All'llahu një njeri tjetër që t'i zbriste Kur'ànin e Tij përveç këtij jetimi të varfër, Muhammedit, veçanërisht kur ndër ne ka shumë thinjoshë të moshuar, të pasur dhe shumë të njohur?

Kjo logjikë nuk është specifike vetëm për atë kohë. Jo, kjo logjikë ka qenë zotëruese në çdo shekull e në çdo kohë, madje edhe tani, në kohën tonë. Sapo dikush merr një përgjegjësi a detyrë, në zemrat e të tjerëve vlon zemërimi e smira, gjuhët e tyre fillojnë nga dërdëllitjet dhe nga lëshimi i kritikave e akuzave, më e pakta duke thënë: A nuk kishte këtu ndonjë njeri tjetër më të

mirë që ta merrte këtë detyrë se filani, që është prej një familjeje të varfër dhe të panjohur?

Po, ithtarët e librave të mëparshëm, jehuditë dhe të krishterët, kanë disa të përbashkëta me myslimanët. Por, nga njëra anë dashuria për këtë botë dhe nga ana tjetër smira e tyre, ishin shkak që ata të sulmonin Islamin dhe Kur'ànin, kur u thoshin adhuruesve të idhujve: rruga që ju ndiqni është shumë më e mirë se rruga që ndjekin besimtarët, ashtu siç e lexojmë këtë në ajetin 51 të sures "En Nisà": **"A nuk e sheh se atyre që u është dhënë pjesë prej librit, besojnë në idhujt e në djajtë dhe thonë për mohuesit: këta janë në rrugën më të drejtë se rruga e atyre që kanë besuar?"**.

Patjetër që format e çuditjes dhe mohimi janë rezultat i gabimit në përcaktimin e vlerave, duke i shtuar këtij gabimi edhe dashurinë për këtë botë, së bashku me smirën. Por, këto vese të ulta, kurrë nuk mund të jenë kriter logjik në fushën e gjykimit, nëse mendojmë se personalitetin e njeriut e përcaktojnë emri i tij ose pasuria që ai ka, ose pozita që ai gëzon, madje edhe mosha e tij.

Për këtë arsye, pjesa tjetër e ajetit të parë të këtij grupi ajetesh, thotë: sëmundja e atyre është diçka tjetër, sepse, në të vërtetë, ata dyshojnë në lidhje me kumtin dhe urdhërin e All'llahut: **"Jo, ata kanë dyshim në Kur'ànin Tim."**.

Vërejtja e tyre se për ata nuk kishte vlerë personaliteti i të Dërguarit, s'është gjë tjetër veçse justifikim mjeran. Gjithashtu, edhe dyshimi e ngurrimi i tyre në lidhje me këtë çështje, nuk ishte për shkak se në Kur'ànin Famëlartë ka shprehje me dy kuptime; jo, shkaku i vërtetë qëndronte në dëshirat e tyre vetiake, në

dashurinë e tyre të madhe për këtë botë dhe në smirën që ata i gërryente nga brenda.

Në fund edhe Kur'àni Famëlartë i kërcënon ata në frazën e fundit të këtij ajeti: **"...por** (për këtë) **do të shijojnë ndëshkimin Tim."**, domethënë: ata nuk e kanë provuar ndëshkimin hyjnor, prandaj ata jo vetëm që guxojnë t'i kundërvihen të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* por me logjikën e tyre të thatë, guxojnë të futen në betejë edhe kundër Shpalljes hyjnore.

Po, ka grupe njerëzish me të cilët nuk sjell dobi as logjika e as fjala e drejtpërdrejtë, prandaj, për këtë kategori kokëngjeshurish, kamzhiku i ndëshkimit është mjeti i vetëm që i rrëzon ata prej kalit të mendjemadhësisë e të krekosjes dhe që ata të shërohen prej sëmundjes që kanë, patjetër duhet të dënohen me ndëshkimin hyjnor.

Në përgjigje të fjalëve të tyre, Kur'àni Famëlartë u thotë atyre: mos vallë ju zotëroni depot e mëshirës hyjnore që t'i dhuroni detyrën e profetnisë atij që doni ju dhe të mos ia jepni atij që ju nuk e doni? **"A mos janë te ata depot e mëshirës së Zotit tënd, të Fuqishmit, Dhuruesit të madh?"**.

All'llahu i Gjithëfuqishëm, duke qenë Zot i Gjithësisë dhe Sunduesi i saj, si dhe Krijuesi i botës së ekzistencës dhe i botës njerëzore, për të mbajtur kumtin e Tij, zgjedh njeriun që ka mundësi të udhëheqë popullin në rrugën e plotësimit dhe të edukimit. Edhe përshkrimi i All'llahut me epitetin "i Gjithëfuqishmi", tregon se Ai nuk mund të bjerë nën ndikimin e të tjerëve dhe t'u dorëzojë pozitën e mbajtësit të kumtit njerëzve

të papërshtatshëm, pasi pozita e profetnisë është shumë e madhe dhe vetëm All'llahu i Lartësuar e askush tjetër, vendos për dhënien e kësaj pozite. Gjithashtu, edhe përshkrimi i All'llahut të Lartësuar me epitetin Dhuruesi, tregon se All'llahu i Lartësuar dhuron çdo gjë që Ai dëshiron dhe i jep pozitën e profetsisë njeriut që ka fuqi të mbajë kumtin e All'llahut.

Duhet theksuar se, përshkrimi i All'llahut me cilësorin *"El Ueh'hàb"* që në gjuhën arabe është mbiemër cilësor në shkallën sipërore, është në kuptimin: jep me shumicë. Nga ky kuptim rezulton se Profetsia nuk është një mirësi e vetme. Në të vërtetë, Profetsia ka shumë mirësi, të cilat i mundësojnë mbajtësit të kësaj pozite të lartë të kryejë misionin e tij. Mirësitë e profetsisë përfshijnë diturinë, përkushtimin, ruajtjen prej gabimeve e fajeve, trimërinë dhe vendosmërinë.

Një fjalë të njëjtë me këtë ajet, e lexojmë edhe në ajetin 32 të sures "Ez Zukhruf", në të cilin i Larti thotë: **"Mos vallë ata e ndajnë mëshirën e Zotit tënd?"**, domethënë: ata flasin kundër teje për shkak se Kur'àni të është zbritur ty, mos vallë ata e kanë përgjegjësinë për pjesëtimin e mëshirës së Zotit të botëve?

Gjithashtu, edhe prej fjalës *"rahmetun"* – *"mëshirë"* përftohet kuptimi se profetsia në të vërtetë është mëshirë e butësi prej Zotit të botëve në botën njerëzore. Patjetër që është kështu. Sikur të mos ishte dërgimi i Profetëve, njerëzit, pa dyshim, do të pësonin humbje në këtë botë e në Botën Tjetër, ashtu siç pësuan humbje të gjithë ata që kundërshtuan programin e Profetëve.

Edhe ajeti vijues trajton të njëjtën temë, por e trajton nga një anë tjetër dhe thotë: **"A mos ata kanë pushtetin e qiejve,**

Tokës dhe ç`ka në mes të dyjave (në mes qiejve e Tokës)**? Le të ngjiten lart me shkaqet."**.

Kjo frazë kur'anore, në të vërtetën e saj numërohet plotësuese për studimin e sipërm. Në ajetin para këtij ajeti thuhej: ju nuk zotëroni depot e mëshirës së All'llahut që t'ia jepni Profetsinë atij njeriu dëshirat e të cilit përkojnë me dëshirat tuaja. Ky ajet thotë: Tani që u bë e qartë se ato depo nuk janë në dorën tuaj, por janë krejtësisht nën administrimin e Krijuesit të Gjithëfuqishëm, atëherë për ju ka vetëm një rrugë: Të ngjiteni në Qiell që të ndaloni Revelatën që ajo të mos i zbresë të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*. Por ju e dini mirë se kjo punë nuk mund të realizohet dhe patjetër që jeni të pafuqishëm për të vënë në zbatim këtë ngjitje e këtë ndalim të Revelatës.

Bazuar mbi këto që u thanë, për ju s'ka asnjë rrugë që ju të bëni zgjedhjen tuaj; ju s'keni as fuqi për të ndaluar, atëherë, ç'mundësi keni që ta bëni këtë ndalim në gjendjen që jeni? Prandaj, për ju s'mbetet rrugë tjetër veçse të vdisni me atë zemërimin, mllefin e smirën tuaj, prandaj bëni ç'të dëshironi.

Siç shihet, të dy këto ajete nuk përsërisin të njëjtën çështje, siç janë shprehur disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë; njëri ajet trajton njërën prej anëve të kësaj çështjeje.

Ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh, ka ardhur si element që shpreh përçmimin për ata mendjemëdhenj mendjelehtë dhe për këtë i Larti thotë: **"Atje është një ushtri e shpartalluar e grupeve"**, ata janë vetëm pak ushtarë dhe janë të shpartalluar.

Shprehja *"hunàlike"*, tregon largësi dhe për shkak se kjo shprehje gjendet në këtë ajet, disa interpretues të Kur'ànit e kanë konsideruar si treguese të disfatës që pësuan idhujtarët në luftën e Bedrit, që, siç dihet, u zhvillua në një zonë që gjendet larg Mekës së nderuar, të quajtur "Bedër".

Gjithashtu edhe fjala e ajetit *"el ahzàb"* – *"partitë"* sipas kuptimit që shpreh kjo fjalë - tregon të gjitha grupimet që morën qëndrim kundër të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*. Mirëpo, All'llahu i Lartësuar i asgjësoi grupet që kundërshtonin Profetin. Gjithashtu, kjo fjalë tregon se shoqëria e idhujtarëve të Mekës ishte një grup fare i vogël prej atyre grupeve, por që shumë shpejt edhe ky grup idhujtarësh do të vihet në sprovë me pësimet që do të bien mbi ata (Kjo bisedë dëshmon bisedën që do të vijë në ajetet e ardhshme, në të cilët trajtohet kjo çështje).

Ne nuk e harrojmë, se kjo sure është prej sureve të zbritura në Mekë, domethënë se ka zbritur në kohën kur numri i myslimanëve ishte shumë i vogël, madje ata ishin aq pak, sa idhujtarët e kishin të lehtë t'i asgjësonin të gjithë njëherësh, ashtu siç njofton i Larti me fjalën e Tij në ajetin 26 të sures "El Enfàl": **"Ju kishit frikë se do t'u rrëmbenin njerëzit."**.

Në ato ditë, në Mekë asgjë nuk tregonte se myslimanët do të triumfonin; ende nuk kishin filluar betejat, nuk kishin ndodhur fitoret në betejën e Bedrit, në betejën e Hendekut, në të cilën, krahas idhujtarëve të Mekës, kishin ardhur të luftonin kundër myslimanëve edhe grupe të tjerë idhujtarësh, nuk kishte ndodhur as beteja e Hunejnit.

Por Kur'àni Famëlartë, njofton se ata armiq ishin vetëm një grup i vogël prej atyre grupeve dhe shumë shpejt, në fundin e rrugës së tyre do të shpartalloheshin të gjithë.

Kur'àni Famëlartë i përgëzon myslimanët e botës së sotme, kudo që të gjenden, se ata do të fitojnë kundër fuqive agresore e të padrejta, i përgëzon myslimanët e sotshëm me të njëjtin sihariq që dha për myslimanët e parë para 1400 vjetësh. Kur'àni Famëlartë i njofton të gjithë myslimanët se All'llahu i Lartësuar do të bëjë realitet premtimin e Tij për shpartallimin e ushtrive të grupeve, me kushtin që myslimanët e sotëm të mbajnë besën që i kanë dhënë All'llahut, ashtu siç e mbajtën besën myslimanët e orëve të para.

Ajetet: 12 – 16

كَذَّبَتۡ قَبۡلَهُمۡ قَوۡمُ نُوحٖ وَعَادٞ وَفِرۡعَوۡنُ ذُو ٱلۡأَوۡتَادِ ١٢ وَثَمُودُ وَقَوۡمُ لُوطٖ
وَأَصۡحَٰبُ لۡـَٔيۡكَةِۚ أُوْلَٰٓئِكَ ٱلۡأَحۡزَابُ ١٣ إِن كُلٌّ إِلَّا كَذَّبَ ٱلرُّسُلَ فَحَقَّ
عِقَابِ ١٤ وَمَا يَنظُرُ هَٰٓؤُلَآءِ إِلَّا صَيۡحَةٗ وَٰحِدَةٗ مَّا لَهَا مِن فَوَاقٖ ١٥
وَقَالُواْ رَبَّنَا عَجِّل لَّنَا قِطَّنَا قَبۡلَ يَوۡمِ ٱلۡحِسَابِ ١٦

"Para tyre kanë përgënjeshtruar populli i Nùhut, Àdët e Faraoni, ngritësi i kolonave."

"(përgënjeshtruan) **edhe Themudët, populli i Lùtit dhe banorët e Ejkes; ata ishin grupet** (kundërshtare)**."**

"Çdonjëri (prej atyre popujve) **përgënjeshtroi të Dërguarit, prandaj e merituan dënimin Tim."**

"Ata nuk presin gjë tjetër, përveçse një britmë të vetme që nuk përsëritet."

"Dhe ata thanë: Zoti ynë shpejtoje pjesën (dënimin) **tonë para Ditës së Llogaridhënies."**

Komentimi

Për ata mjafton një britmë e vetme

Në plotësim të ajetit të sipërm, që përgëzon për disfatën e idhujtarëve të Mekës në të ardhmen e afërt dhe përshkrimin e tyre si një grup i vogël prej tërësisë së grupeve idhujtare, ajetet objekt studimi flasin për disa grupe që përgënjeshtruan Profetët e dërguar te ata dhe shpjegojnë të ardhmen e dhimbshme që i pret ata që përgënjeshtruan Profetët.

Këto ajete njoftojnë se para këtyre idhujtarëve edhe populli i Nùhut, Àdit dhe Faraoni që ndërtoi godina të larta me kolona, kishin përgënjeshtruar argumentet e All'llahut dhe të Dërguarit e Tij: **"Para tyre kanë përgënjeshtruar populli i Nùhut, Àdët e Faraoni, ngritësi i kolonave."**.

Edhe Themùdët, populli i Lùtit dhe banorët e Ejkes - populli i Shuajbit - i përgënjeshtruan Profetët e tyre: **"**(përgënjeshtruan) **Edhe Themudët, populli i Lùtit dhe banorët e Ejkes; ata ishin grupet** (kundërshtare)**."**.[1]

Po, ata janë gjashtë grupet prej grupeve të injorantëve idhujtarë, që punuan kundër Profetëve të All'llahut dhe që refuzuan të pranojnë kumtin me të cilin ata kishin ardhur prej All'llahut të Lartësuar; ata gjashtë grupe kundërshtare ishin:

[1] Shprehja *"ulàikel ahzàbu"*, nga ana e sintaksës së gjuhës arabe janë kryefjalë dhe kallzues; fjala *"ulàike"* tregon gjashtë popujt e përmendur në këto dy ajete, kurse fjala *"el ahzàbu"* tregon grupet që u përmendën në dy ajetet e sipërme dhe ne idhujtarët e Mekës i konsideruam një grup të vogël prej atyre grupeve.

Populli i Nùhut, iu kundërvunë atij Profeti të madh.

Populli Âd, iu kundërvunë Profetit të All'llahut Hùdit.

Faraoni kundërshtoi Mùsànë dhe Hàrùnin.

Populli Themùd kundërshtuan Sàlihun.

Populli i Lùtit kundërshtuan ashpër Profetin e All'llahut Lùtin.

Banorët e Ejkes iu kundërvunë Profetit të All'llahut Shuajbit.

Të gjitha këto grupe përgënjeshtruan e fyen Profetët e All'llahut e besimtarët dhe në këtë rrugë, ata nuk lanë gjë pa bërë kundër tyre, por më në fund mbi ata zbriti ndëshkimi hyjnor dhe i bëri të gjithë si lëvoret e hurmës pas ngrënies.

Populli i Nùhut u asgjësua me tufanin dhe me shirat e shumtë.

Populli Âd u asgjësua me erëra të fuqishme.

Faraoni dhe pasuesit e tij u mbytën në ujërat e lumit Nil.

Populli Themùd u asgjësua me zhurmat e fuqishme qiellore.

Populli i Lùtit u asgjësua me tërmet të fuqishëm, të shoqëruar me shiun e gurëve që binte mbi ata prej Qiellit.

Populli i Shuajbit u asgjësua me rrufetë vrastare që ranë mbi ata prej reve të dendura që kishin mbuluar qiellin e asaj zone. Ja kështu, "uji", "ajri", "dheu" dhe "zjarri", që janë bazat e jetës së

njeriut, u bënë shkak që të vdisnin e të asgjësoheshin popujt mëkatarë e mendjemëdhenj dhe të gjithë mbetën ndër të harruarit, pasi prej atyre s'ka mbetur asnjë gjurmë. Prandaj, idhujtarët e Mekës duhej ta kuptonin se ata nuk ishin gjë tjetër veçse një grup i vogël në raport me ata popuj; përse nuk zgjoheshin nga gjumi i shkujdesjes?!

Ajeti i nderuar e përshkruan Faraonin me epitetin *"dhul eutàd"* - domethënë zotëruesi i kolonave të fuqishme. Gjithashtu, Faraoni përmendet me këtë epitet edhe në ajetin 10 të sures "El Fexhr" si i barazvlershëm i fuqisë e i sundimit të Faraonit e të faraonëve; madje, fjala "kolonë" përdoret shumë për të treguar fuqinë; për shembull, thuhet për një njeri: filani i ka kolonat e forta, ose kolonat e kësaj pune janë të fuqishme, ose ajo është përforcuar me katër kolona, në kuptimin se kolonat gjithmonë përdoren për të përforcuar qëndrueshmërinë e tendës.

Disa të tjerë e kanë konsideruar fjalën kolona në kuptimin e ushtrive të shumta të Faraonit që lëviznin nëpër tokë dhe të shtyllave të shumta të tendave të ushtrisë së tij.

Të tjerë kanë thënë se fjala kolona tregon torturat barbare me të cilat faraonët torturonin kundërshtarët e tyre. Faraonët i lidhnin njerëzit e dënuar në katër shtylla të ngulura në tokë, ose mbi një podium të ndërtuar me dërrasa, ose mbi mure; në dy shtylla ata mbërthenin dy këmbët e të dënuarit dhe në dy shtyllat e tjera i mbërthenin atij duart dhe e linin të dënuarin në atë torturë derisa të vdiste.

Të tjerë janë shprehur se kolonat janë në kuptimin e piramidave, që gjenden në truallin e Egjiptit dhe që duken si

kolona të ngulura në tokë, sepse vetëm faraonët i ndërtuan piramidat dhe ky epitet është vetëm për ata.

Sido që të jetë, në mes këtyre mundësive, kuptimi s'ka asnjë kundërthënie, madje është plotësisht e mundur që të bashkohen të gjitha për të dhënë një kuptim të plotë të kësaj fjale.

Fjala e ajetit *"el ejketu"*, do të thotë: pemë dhe banorët e Ejkes janë populli i Profetit të All'llahut Shuajbit. Banorët e Ejkes jetonin në një zonë të gjelbëruar, që shtrihej ndërmjet Hixhazit dhe Shamit. Më gjerë në lidhje me këtë popull, flitet në ajetin 78 të sures "El Huxhuràt". Po, çdonjëri prej atyre popujve e përgënjeshtruan atë çka atyre u erdhi me të Dërguarit e All'llahut, prandaj, me të drejtë, mbi ata zbriti ndëshkimi hyjnor, ashtu siç njofton ajeti vijues: **"Çdonjëri** (prej atyre popujve) **përgënjeshtroi të Dërguarit, prandaj e merituan dënimin Tim."**.[1]

Historia shpjegon se çdonjëri prej atyre popujve u asgjësua me njërin prej llojeve të ndëshkimit; gjithashtu, në histori lexojmë se qytetet e atyre popujve u shndërruan në gërmadha brenda disa çasteve dhe të gjithë njerëzit mohues që banonin atje, mbetën kufoma pa shpirt.

Mos vallë idhujtarët e Mekës mendojnë se e ardhmja e tyre do të jetë më e mirë se ajo e idhujtarëve të përparshëm, në një kohë kur punët armiqësore të idhujtarëve të Mekës ishin të njëjta

[1] Shprehja e fundit e këtij ajeti *"fehak'ka ikàbi"* – **"e merituan dënimin Tim"** në origjinë është *"fehak'ka ikàbij"*; siç shihet në tekstin e Kur'ànit, fjalës *"ikabij"* i është hequr germa "j" dhe ka mbetur *"ikàbi"*, pra ka mbetur zanorja *"i"*, që tregon si është fjala në origjinën e saj; kurse fjala *"hak'ka"*, është folje dhe fjala *"ikàbi"* është vepruesi i kuptimit të kësaj foljeje dhe si frazë është në kuptimin: "ndëshkimi im mbi ata është bërë i detyrueshëm dhe shumë shpejt do të zbatohet".

me punët që bënin idhujtarët e përparshëm, por edhe rruga e All'llahut është po e njëjta rrugë.

Prandaj, ajeti vijues u flet drejtpërdrejt idhujtarëve me gjuhën e kërcënimit të hapur e të prerë dhe u thotë: dënimi që i pret ata s'është gjë tjetër veçse një britmë qiellore, që do t'i asgjësojë dhe për ata s'do të ketë kohë të bëjnë kthesë: **"Ata nuk presin gjë tjetër, përveçse një britmë të vetme që nuk përsëritet."**.

Ka mundësi që ajo britmë të ishte si britmat e përparshme, që zbritën mbi popujt e kaluar, mund të ishte një rrufe frikësuese, ose një tërmet i fuqishëm; por të gjitha këto forma të zbritjes së ndëshkimit hyjnor, shkatërruan e i dhanë fund jetës së atyre mohuesve.

Fjala *"sijheten uahideten"* – **"një britmë e vetme"** mund të tregojë edhe britmën e Ditës së Ringjalljes dhe ajo britmë, në Kur'ànin Famëlartë është përmendur me frazën: **"fryrja e parë në sùr"**.

Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, e kanë kundërshtuar interpretimin e parë, duke thënë se ai interpretim është në kundërshtim me atë që thuhet në ajetin 33 të sures "El Enfàl": **"All'llahu nuk do t'i ndëshkojë ata, derisa ti** (o Muhammed) **je në mesin e tyre…"**.

Duke vënë parasysh se idhujtarët e Mekës nuk besonin as në të Dërguarin e Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* e as në kumtin që ai kumtonte, duke shtuar se punët e tyre ishin të ngjashme me punët e popujve të përparshëm që u asgjësun me britma qiellore, prandaj, idhujtarët e Mekës

duhej të parashikonin një fund si fundi që patën idhujtarët e përparshëm; gjithashtu, ata duhej të mendonin se kur do të jetë ai çast, në një kohë që vetë ajeti flet për pritje!

Të tjerë interpretues të Kur'ànit, kanë kundërshtuar interpretimin e dytë dhe kanë thënë: idhujtarët e Mekës nuk do të mbeten gjallë deri në fundin e kësaj bote, që ata t'i përfshijë britma.

Por, ky kundërshtim nuk ka ardhur për të të njëjtat shkaqe që thamë më sipër; në të vërtetë, asnjë njeri nuk e di kur do të jetë çasti i fundit i kësaj bote dhe kur do të ndodhë Kiameti, prandaj, idhujtarët e Mekës duhet të rrinë në pritje të çastit kur do të ndodhë ajo britmë.[1]

Në të vërtetë, ata injorantë ishin në një gjendje sikur rrinin në pritje të ndëshkimit hyjnor, si dënim për përgënjeshtrimin e mohimin që ata u bënin argumenteve të All'llahut të Lartësuar dhe për fjalët e padenja që ata thoshin në mes tyre kundër të Dërguarit më të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe patjetër fjalët e tyre nuk ishin të merituara të thuheshin për personin e tij të pastër, duke shtuar ndër punët e tyre të liga edhe këmbënguljen e tyre për të vazhduar në adhurimin e idhujve, pa harruar as përhapjen e gjerë që kishte marrë degjenerimi në mesin e atyre idhujtarëve; prandaj, ndëshkimi do të ishte i atillë që do të digjte rezultatet e punëve të

[1] Opinioni që hamendsojnë disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë se këtu qëllimi me fjalën britmë është për britmën e dytë, që do të lëshohet për të ringjallur të vdekurit e çuarjen e tyre në Gjykatën e Drejtësisë së All'llahut, në të vërtetë është shumë larg për t'u marrë në konsideratë, për shkak se ky interpretim i tyre nuk është në harmoni as me ajetin vijues e as me ajetet e përparme.

tyre, ose britma do t'i jepte fund çdo sendi në këtë botë dhe ata idhujtarë do t'i fuste në një rrugë pa kthim.

Në lidhje me fjalën e ajetit *"feuàkin"*, gjuhëtarët dhe interpretuesit e Kur'ànit Famëlartë kanë dhënë disa kuptime, prej të cilëve: shkëputja që bën foshnja në mes dy thithjeve të gjirit të nënës, domethënë: një kohë foshnja e thith qumështin prej gjirit në mënyrë të plotë dhe pastaj e thith përsëri dhe qumështi zbret në gojën e tij edhe një herë tjetër.

Të tjerë kanë thënë se është në kuptimin e hapjes së gishtave të dorës prej gjirit të kafshës gjatë procesit të mjeljes dhe pastaj mbyllja e gishtave për të bërë edhe një mjelje tjetër.

Meqenëse gjiri qetësohet pak pas çdo mjeljeje, fjala *"feuàkin"* ka mundësi të japë kuptimin e qetësisë e të pushimit.

Duke marrë parasysh se ndarja në kohë për kthimin e qumështit edhe një herë tjetër në gjirin, *"feuàkin"* jep edhe kuptimin e kthimit, ashtu siç thuhet për të sëmurin: bëri kthesë, kur gjendja e tij shëndetësore fillon të përmirësohet, në kuptimin e rikthimit të shëndetit të tij; gjithashtu, fjala *"feuàkin"* thuhet për të treguar edhe gjendjen e të dehurit kur atij i del pija, ose kur kjo fjalë thuhet për të çmendurin kur atij i kthehet mendja dhe ai rifiton aftësinë të ndjejë e të kuptojë.[1]

---

[1] Disa gjuhëtarë, janë shprehur për disa dallime në kuptim të fjalës *"feuàk"*, kur germa *"f"* e kësaj fjale lexohet me zanoren *"e"*, pra lexohet *"fe"* dhe kur germa *"f"* lexohet me zanoren *"u"*, pra lexohet *"fu"*, *"fuvàk"*; të tjerë kanë thënë se, në të dy rastet, kuptimi i kësaj fjale është i njëjtë. Kush dëshiron më shumë shpjegime, le të referohet në: fjalorin "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", të autorit Ràgib El Isfehànij; në tefsirin "Rùhul Meànij"; në tefsirin "El Kebijr"; në tefsirin "Rùhul Xhinàn"; në tefsirin e Kutrubij'jit dhe në burimet gjuhësore.

Në të gjitha gjendjet, pas britmës frikësuese, s'ka as kthim, as pushim, as qetësi, as shërim prej sëmundjes e as ardhje në vete; ndodhja e asaj britme frikësuese do të thotë mbyllja e të gjitha dyerve para njeriut, domethënë se në atë kohë njeriut nuk i sjell dobi pendimi, sepse s'ka më as vend e as kohë për të përmirësuar të kaluarën; gjithashtu, pas asaj britme frikësuese, edhe thirrjet e njerëzve për ndihmë, nuk gjejnë përgjigje.

Ajeti i fundit në këtë studim, tregon fjalën e fundit të idhujtarëve, të cilët, për të vënë në lojë e për të përqeshur, thoshin: mbase Zoti e shpejton zbritjen e ndëshkimit mbi ne para Ditës së Llogaridhënies, ashtu siç njofton ajeti vijues: **"Dhe ata thanë: Zoti ynë shpejtoje pjesën** (dënimin) **tonë para Ditës së Llogaridhënies."**.

Mendjemadhësia te ata idhujtarë kishte arritur deri aty, sa të talleshin edhe me ndëshkimin e All'llahut e me Gjykatën e Tij të drejtë, kur me përqeshje thoshin: përse e vonon All'llahu pjesën tonë të ndëshkimit?!

Përse All'llahu nuk na e jep sa më shpejt pjesën tonë të ndëshkimit?

Edhe popujt idhujtarë të Mekës së asaj kohe, kishin shumë pika të përbashkëta me idhujtarët e përparshëm mendjelehtë, të cilët hungërinin e ulurinin si kafshët kur mbi ata binte ndëshkimi hyjnor, por, në çastin e zbritjes së ndëshkimit të All'llahut, askush nuk mund të interesohet për fundin e tyre.

Fjala e ajetit *"kit'tà"*, do të thotë: *"prerja e një sendi për së gjeri"*, kurse fjala *"kad"*, do të thotë: "*prerja e një sendi përsëgjati"*; gjithashtu, fjala *"kit'tà"*, do të thotë: pjesa që i takon dikujt, ose

shorti që i bie dikujt, herë tjetër është në kuptimin e letrës së shortit në të cilën është shkruar emri i atij që ka hedhur short, ose është në kuptimin e letrës në të cilën janë shkruar emrat e tyre që kanë fituar çmime.

Për të gjitha këto, disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, në lidhje me interpretimin e ajetit objekt studimi, kanë thënë: qëllimi këtu është: All'llahu i Lartësuar u dorëzon robve të Tij fletoret e punëve të tyre para ardhjes së Ditës së dhënies së Shpërblimit ose Dënimit. Kjo fjalë thuhet pasi janë zbritur ajetet kur'anorë që theksojnë se ka një grup, të cilëve fletorja e punëve që kanë bërë në këtë botë, u jepet në dorën e djathtë, por ka edhe një grup tjetër, të cilëve fletorja e punëve u jepet në dorën e majtë.

Një grup prej idhujtarëve të Mekës, për t'u tallur e për të përqeshur ajetet e Kur'ànit Famëlartë, thoshin: sa bukur do të ishte sikur fletoret e punëve tona të na jepeshin tani, që t'i lexojmë dhe të shikojmë punët që kemi bërë.

Në të gjitha gjendjet, injoranca e mendjemadhësia janë dy vese të këqia e të përbuzura, që nuk mund të ndahen njëri prej tjetrit, sepse injorantët janë mendjemëdhenj, por edhe mendjemëdhenjtë janë injorantë. Dhe dukuritë e këtyre dy veseve të ulta ishin të shumta te idhujtarët e kohës së injorancës, para Islamit.

Ajetet: 17 – 20

ٱصۡبِرۡ عَلَىٰ مَا يَقُولُونَ وَٱذۡكُرۡ عَبۡدَنَا دَاوُۥدَ ذَا ٱلۡأَيۡدِۖ إِنَّهُۥٓ أَوَّابٞ ١٧ إِنَّا
سَخَّرۡنَا ٱلۡجِبَالَ مَعَهُۥ يُسَبِّحۡنَ بِٱلۡعَشِيِّ وَٱلۡإِشۡرَاقِ ١٨ وَٱلطَّيۡرَ مَحۡشُورَةٗۖ
كُلّٞ لَّهُۥٓ أَوَّابٞ ١٩ وَشَدَدۡنَا مُلۡكَهُۥ وَءَاتَيۡنَٰهُ ٱلۡحِكۡمَةَ وَفَصۡلَ ٱلۡخِطَابِ ٢٠

"Duroji fjalët që ata thonë dhe kujto robin Tonë Dàùdin e fuqishëm (në fe e në trup)**; ai gjithnjë i drejtohej All'llahut."**

"Ne i nënshtruam malet që, së bashku me atë (Dàùdin)**, të madhërojnë All'llahun mbrëmje e mëngjes."**

"Edhe shpezët janë tubuar; të gjithë vetëm Atij i drejtohen."

"Ne e forcuam sundimin e tij (Dàùdit) **dhe i dhamë urtësi dhe aftësi në gjykim."**

Komentimi

Mësim prej Dàùdit

Profeti i All'llahut Dàùdi *(Paqja e All'llahut qofshtë mbi të!)* është njëri prej Profetëve të mëdhenj të Beni Israilëve dhe sundimtar i një shteti të madh. Pozita e lartë e këtij Profeti përmendet në disa ajete të Kur'ànit Famëlartë.

Në plotësim të studimeve të mësipërme, në të cilat ajetet e Kur'ànit shpalosën fyerjet që i bënin idhujtarët të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* si dhe fjalët e padenja që ata thoshin në adresë të tij, Kur'àni Famëlartë, për të gëzuar Profetin e All'llahut dhe besimtarët e paktë në atë kohë, shtron çështjen e Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të cilit All'llahu i Lartësuar i kishte dhënë fuqi shumë të madhe, sa edhe malet e shpezët ishin vënë në dispozicion të tij. Nëpërmjet këtij tregimi, i Larti i shpjegon Profetit të Tij më të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* se kur mëshira e butësia hyjnore përfshijnë një njeri, të gjithë njerëzit s'kanë mundësi të bëjnë asgjë kundrejt kësaj butësie hyjnore.

I Larti njofton se edhe Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* edhe pse atij Zoti i botëve i kishte dhënë fuqi shumë të madhe, nuk shpëtoi as prej goditjeve që i jepnin të tjerët e as prej fjalëve të këqija që lëshonin gjuhët e tyre kundër tij. Pa dyshim që këto fjalë të Kur'ànit Famëlartë janë qetësim e gëzim për Profetin më të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe i jepte atij të kuptojë se çështja e fyerjeve dhe talljeve nga ana

e idhujtarëve nuk ishte vetëm për atë sepse, kështu u ka ndodhur edhe Profetëve të tjerë të mëdhenj *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*.

Në fillim, ajeti i parë i grupit të ajeteve objekt i studimit tonë, thotë: **"Duroji fjalët që ata thonë dhe kujto robin Tonë Dàùdin e fuqishëm** (në fe e në trup)**; ai gjithnjë i drejtohej All'llahut."**.

Fjala *"el ejdi"* këtu është në kuptimin e fuqisë. Gjithashtu, kjo fjalë vjen edhe në kuptimin e sendit të mirë që i jepet njeriut.

Këto dy kuptime të fjalës *"el ejdi"* i ishin dhënë me shumicë Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ai gëzonte një fuqi trupore sa ai vrau despotin e egër Xhàlùt, në njërën prej betejave, vetëm me një gur që e gjuajti me hobenë e tij dhe e rrëzoi atë prej kalit të lyer me gjak.

Disa kanë thënë se guri me të cilin Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e gjuajti Xhàlutin, i çau atij gjoksin dhe i doli prapa shpinës.

Edhe nga ana e fuqisë politike, qeveria e tij ishte e fuqishme dhe gjithnjë në gatishmëri për t'u përballur me armiqtë me të gjithë forcën, madje thuhej se mijëra ushtarë të tij qëndronin në gatishmëri, nga mbrëmja deri në mëngjes, në të dyja anët e vendit ku ai adhuronte All'llahun e Lartësuar.

Edhe fuqia e madhe morale e fizike te ai është e dallueshme; Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e kalonte pjesën më të madhe të natës duke adhuruar All'llahun e Lartësuar; veç kësaj, ai agjëronte gjysmën e ditëve të vitit.Krijuesi i Gjithëfuqishëm i kishte dhënë këtij Profeti të madh mirësi të shumta, të dukshme e të padukshme.

Me pak fjalë, Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* sa i fuqishëm ishte në fushën e betejës, po aq qëndrestar ishte edhe në adhurimin që bënte, ishte i fuqishëm në dituri e në fushën e politikës, por mbi të gjitha ai zotëronte mirësi të mëdha.[1]

Fjala e ajetit *"eu'uàbun"*, në rrënjën e saj *"euebe"*, do të thotë: kthim me vetëdashje në një punë, por meqenëse fjala *"eu'uàbun"*, është mbiemër cilësor në shkallën sipërore, tregon se ai i drejtohej All'llahut të Gjithëfuqishëm shumë herë dhe parashtronte pendimin e tij, i kërkonte All'llahut faljen e gabimit edhe për shkujdesjen më të vogël që kishte treguar, ose nga që kishte lënë punën më me përparësi.

Ajetet objekt studimi, në përputhje të plotë me metodën e Kur'ànit Famëlartë në shtrimin e çështjeve të ndryshme, me fjalë të shkurtra e të shkoqitura, pasi trokitën shkurtimisht mbi mirësitë e shumta që All'llahu i Lartësuar i kishte dhënë Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* shpjegojnë disa lloje prej atyre mirësive, për të cilat i Larti njofton me fjalën e Tij: **"Ne i nënshtruam malet që, së bashku me atë, të madhërojnë All'llahun mbrëmje e mëngjes."**.[2]

---

[1] Fjala e ajetit *"ejdi"* është shumës i fjalës *"jedun"* – "dorë" është përdorur për faktin se dora është dukuri e fuqisë, e të mirave që gëzon njeriu dhe e sundimit; në të vërtetë, dora i ka të gjitha këto kuptime.

[2] Fjala e ajetit *"meahù"*, ka mundësi të ketë lidhje me fjalën e ajetit *"juseb'bihne"* – **"madhërojnë All'llahun"** dhe sipas këtij kuptimi, malet, për të madhëruar All'llahun e Lartësuar veprojnë ashtu siç vepron Dàùdi. Të njëjtin kuptim e lexojmë edhe në ajetin 10 të sures "Sebe": **"…o male madhëroni** (All'llahun) **së bashku me atë** (Dàùdin)**"**; por fjala *"meahù"* mundet që ka lidhje me fjalën tjetër të ajetit *"sekh'kharnà"* – **"Ne i nënshtruam"** dhe në këtë rast kuptimi i frazës është: "Ne i nënshtruam malet për atë", çka tregon se fjala *"meahù"* – **"së bashku me atë"** është përdorur në vend të fjalës *"lehù"* – *"për atë"* për të bërë

Gjithashtu, i Larti njofton: Ne nënshtruam të gjitha llojet e shpezëve, që të jenë në dispozicion të Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Ne bëmë që ato të jenë të bindura ndaj urdhërave të tij dhe së bashku me atë të madhërojnë All'llahun e Lartësuar dhe të gjithë të kthehen te Ai: **"...të gjithë vetëm Atij i drejtohen."**.

Përemri *"hu"* – *"atë"* në shprehjen *"lehù"* – *"për atë"* mundet që i adresohet Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe sipas kësaj pikëpamjeje, kuptimi i fjalës është në përputhje të plotë me ato që thamë më sipër; gjithashtu, ka edhe një mundësi që thotë se përemri në shprehjen e sipërme i adresohet Qenies së pastër të All'llahut, që do të thotë se çdo grimcë e botës kthehet tek Ai dhe është e nënshtruar ndaj urdhërave të Tij.

Pyetje: Si e lokojnë shpezët e malet zërin së bashku me Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* për të madhëruar All'llahun (për të thënë "subhànell'llàh)?

Përgjigje: Në përgjigje të kësaj pyetjeje, në mesin e interpretuesve të Kur'ànit Famëlartë ka mendime të ndryshme dhe ata kanë përmendur disa interpretime për këtë çështje. Në vijim, rendisim disa prej interpretimeve të tyre:

1- Disa kanë thënë: jehona e valëve zanore të zërit të bukur të Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* përplasej nëpër shpatet e maleve dhe tërhiqte shpezët (Natyrisht që kjo nuk numërohet meritë e madhe sa Kur'àni Famëlartë ta prekë si një çështje madhore).

---

edhe më të qartë pjesëmarrjen e përbashkët në madhërimin e All'llahut të Lartësuar.

2- Disa të tjerë kanë thënë se madhërimi i maleve e i shpezëve ishte binjakëzim me zërin e dëgjueshëm dhe i shoqëruar me një lloj kuptimi e ndjenje që është në brendi të grimcave të botës. Sipas kësaj mundësie, të gjitha qeniet e botës kanë një lloj mendjeje e ndjenjash dhe kur ato dëgjonin bisedat konfidenciale të atij Profeti të madh, shpezët e malet përsërisnin atë bisedë konfidenciale së bashku me atë dhe kështu madhërimi i shpezëve e i maleve përzihej me madhërimin (tesbijhun) e Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

3- Të tjerë kanë thënë se madhërimi i maleve e i shpezëve është madhërim i dhënë me natyrën e krijimit dhe shqiptohet me gjuhën e gjendjes së çdo krijese. Sistemi i krijimit të atyre thotë: All'llahu i Madhëruar s'ka asnjë mangësi e as nevoja, Ai është i Shenjtëruar dhe i Dëlirë nga çdo e metë e nga çdo nevojë, Ai është i Ditur dhe i Fuqishëm dhe Ai ka të gjitha cilësitë e plotësimit.

Por ky kuptim nuk është i veçantë për Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* që të numërohet prej virtyteve të tij, prandaj interpretimi i dytë është më i përshtatshëm dhe ajo që ata kanë përmendur nuk mund të përjashtohet se mund të jetë kriter për të treguar fuqinë e All'llahut të Lartësuar.

Biseda intime gjendet në brendësi të të gjitha krijesave të Gjithësisë dhe jehona e atyre bisedave konfidenciale përsëritet gjithmonë në brendësi të qenieve, por All'llahu i Lartësuar, këto biseda të brendshme të qenieve, i bëri të dukshme për Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ashtu siç bëri të madhërojnë All'llahun (të thonë subhànell'llàh) edhe guralecët në dorën e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*.

Ajeti vijues dhe i fundit i këtij grupi ajetesh, në frazën e tij të parë shpalos mirësitë e shumta që All'llahu i Lartësuar i kishte dhënë Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. I Larti njofton **"Ne e forcuam sundimin e tij"**; domethënë: Ne e forcuam dhe e përsosëm mbretërinë e tij, në atë mënyrë sa kundërshtarët e tiranët prej armiqve të tij duhej ta llogarisnin njëmijë herë fuqinë e mbretërisë së tij.

Veç kësaj, i Larti, në vijim të këtij ajeti, njofton se Ne i kemi dhënë atij urtësi, dituri dhe aftësi për të njohur: **"Ne i dhamë atij urtësi"**; urtësi për të cilën Kur'àni Famëlartë thotë në ajetin 269 të sures "El Bekare": **"…dhe kujt i është dhënë Urtësia, atij i janë dhënë mirësi të shumta… "**.

Këtu, fjala "urtësi" do të thotë: dituri, njohje dhe mirëadministrim i punëve të vendit, ose është në kuptimin e pozitës së lartë të profetnisë, ose është në kuptimin e të gjithave këtyre së bashku.

"Urtësia", disa herë mund të jetë në kuptimin e anës shkencore dhe shpreh dituritë e larta, herë tjetër "urtësia" mund të jetë në kuptimin e punës konkrete, që shprehet me moralet e larta dhe me punën e mirë, por për Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të gjitha këto përbëjnë një përmasë shumë të gjerë.

Mirësia hyjnore e fundit e përmendur në këtë ajet, që i ishte dhënë Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte mundësia e tij për të gjykuar në mënyrë të drejtë dhe ajeti në frazën e tij të fundit, njofton: **"dhe aftësi në gjykim"**.

Shprehja *"faslel khitàb"* – **"aftësi në gjykim"** është përdorur këtu sepse fjala *"khitàb"* do të thotë: fjalët e dy palëve në konflikt gjyqësor, kurse fjala *"fasle"* do të thotë, vendim i prerë e i drejtë.

Siç dihet, fjalët e dy palëve në konflikt gjyqësor ndahen në mënyrë të prerë vetëm kur në mes tyre gjykohet me drejtësi, prandaj shprehja "*faslel khitàb",* do të thotë: "*gjykim me drejtësi*".

Ka edhe një mundësi tjetër interpretimi për këtë shprehje: All'llahu i Lartësuar e pajisi Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* me një logjikë të fuqishme, që tregonte lartësinë dhe thellësinë e mendimit të tij dhe kjo logjikë e fuqishme nuk ishte e veçantë për atë vetëm në fushën e gjykimit, por logjika e tij ishte e fuqishme në të gjitha bisedat e tij.

Është e vërtetë që askush nuk duhet të presë shpresën prej mëshirës e prej butësisë së All'llahut të Lartësuar, sepse vetëm All'llahu i Lartësuar ka mundësi t'i japë njeriut të përshtatshëm këtë fuqi e këtë forcë, prandaj këto ajete nuk ishin gëzim e qetësim vetëm për Profetin më të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe për besimtarët në Mekë, të cilët në atë kohë jetonin në kushtet më të rënda e më të vështira, por këto ajete janë gëzim e qetësim edhe për të gjithë besimtarët e shtypur, në çdo vend e në çdo kohë.

Hulumtim

Dhjetë cilësitë e Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*

Në lidhje me ajetet objekt studimi, disa interpretues të Kur'ànit kanë përmendur dhjetë dhunti hyjnore të mëdha që i ishin dhënë Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Këto dhunti, nga njëra anë pasqyrojnë pozitën e lartë e të madhe të atij Profeti dhe nga ana tjetër, pasqyrojnë veçantitë e njeriut të plotësuar:

1- All'llahu i Gjithëfuqishëm e urdhëron Profetin e Islamit Muhammedin *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* pavarësisht nga pozita e lartë që ai kishte, që në punën e durimit të marrë shembull Dàùdin: **"Duroi fjalët që ata thonë dhe kujto…"**.

2- Kur'àni Famëlartë e ka cilësuar Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* me fjalën rob dhe në të vërtetë, e veçanta më e rëndësishme për Dàùdin, ishte robëria e tij ndaj All'llahut të Lartësuar, prandaj i Larti thotë: **"robin Tonë Dàùdin"**; të njëjtin kuptim të fjalës rob e lexojmë edhe në lidhje me të Dërguarin e All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* kur flet për çështjen e "Isras", udhëtimit të tij natën prej Mekës në Kudsi Sherijf (në xhaminë Aksa në Jeruzalem), ashtu siç e lexojmë në ajetin 1 të sures "El Isra": **"Pa të meta është vetëm Madhëria e Tij, i cili e kaloi robin e Vet natën…"**.

3- Dhënia e kapacitetit dhe fuqisë për të qenë gjithmonë në bindje të urdhërave të Krijuesit të Lartësuar, për të qenë i ruajtuar që të mos kryente mëkate dhe për të sistemuar punët në

mbretërinë e tij dhe të gjitha këto, në ajetin e Kur'anit janë shprehur vetëm me frazën **"i fuqishëm"**; një kuptim i ngjashëm ka ardhur edhe në ajetin 62 të sures "El Enfàl", në lidhje me të Dërguarin e All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*: **"Ai të fuqizoi ty me ndihmën e Vet dhe me besimtarët."**.

4- Cilësimi i tij *"eu'uàb"* – *"gjithnjë i drejtohej All'llahut"* domethënë: kthimi i tij i përsëritshëm e i vazhdueshëm te All'llahu i Gjithëfuqishëm, ashtu siç njofton i Larti me fjalën e Tij: **"ai gjithnjë i drejtohej All'llahut"**.

5- Vënia e maleve në dispozicion të tij, për të madhëruar All'llahun së bashku me atë në mbrëmje e në mëngjes dhe i Larti për këtë njofton: **"Ne i nënshtruam malet që, së bashkku me atë, të madhërojnë All'llahun mbrëmje e mëngjes."**.

6- Bisedat konfidenciale të shpezëve dhe madhërimi i All'llahut prej shpezëve, së bashku me Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* edhe kjo ishte prej mirësive që All'llahu i Lartësuar i dha atij, ashtu siç njofton i Larti me fjalën e Tij: **"Edhe shpezët janë tubuar…"**.

7- Vazhdimi i shpezëve e i maleve duke madhëruar All'llahun e Lartësuar së bashku me Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* sa herë herë që ai madhëronte All'llahun, malet e shpezët ktheheshin dhe madhëronin All'llahun së bashku me atë dhe këtë i Larti e njofton me fjalën e Tij: **"të gjithë vetëm Atij i drejtohen"**.

8- All'llahu atij i dha pushtet e sundim dhe i përsosi bazat e sundimit të tij, duke shtuar se All'llahu i Lartësuar vuri në

dispozicion të tij çdo gjë materiale e morale për të cilat ai kishte nevojë: **"Ne e forcuam sundimin e tij"**, njofton i Larti me fjalën e Tij.

9- All'llahu i Gjithëfuqishëm i dha atij një pasuri shumë të rëndësishme, i dha dituri që e tejkalonte kapacitetin natyror të njeriut, i dha dituri e njohje që ishin burim i shumë të mirave, burim i çdo begatie e bamirësie, kudo që ato të ishin, ashtu siç njofton i Larti me fjalën e Tij: **"dhe Ne i dhamë atij urtësi"**.

10- All'llahu e pajisi atë me një logjikë të fuqishme, i dha aftësi të fliste me fjalë mbresëlënëse dhe ndikuese, e pajisi me fuqi të madhe logjike, për të gjykuar në mënyrë të vendosur e të drejtë, ashtu siç njofton i Larti me fjalën e Tij: **"dhe aftësi në gjykim"**.[1]

Patjetër, asnjë qeverisje nuk mund të jetë e përsosur pa këto cilësi të qeveritarit, që ishin: dituria, logjika, frika ndaj All'llahut, fuqia për të disiplinuar veten dhe mundësia për të arritur pozitën e lartë për të qenë rob i All'llahut.

[1] Tefsiri "El Kebijr", vëll. 26, f. 184, fundi i ajeteve objekt studimi.

Ajetet: 21 – 25

۞ وَهَلۡ أَتَىٰكَ نَبَؤُاْ ٱلۡخَصۡمِ إِذۡ تَسَوَّرُواْ ٱلۡمِحۡرَابَ ﴿٢١﴾ إِذۡ دَخَلُواْ عَلَىٰ
دَاوُۥدَ فَفَزِعَ مِنۡهُمۡۖ قَالُواْ لَا تَخَفۡۖ خَصۡمَانِ بَغَىٰ بَعۡضُنَا عَلَىٰ بَعۡضٖ
فَٱحۡكُم بَيۡنَنَا بِٱلۡحَقِّ وَلَا تُشۡطِطۡ وَٱهۡدِنَآ إِلَىٰ سَوَآءِ ٱلصِّرَٰطِ ﴿٢٢﴾ إِنَّ هَٰذَآ
أَخِي لَهُۥ تِسۡعٞ وَتِسۡعُونَ نَعۡجَةٗ وَلِيَ نَعۡجَةٞ وَٰحِدَةٞ فَقَالَ أَكۡفِلۡنِيهَا وَعَزَّنِي فِي
ٱلۡخِطَابِ ﴿٢٣﴾ قَالَ لَقَدۡ ظَلَمَكَ بِسُؤَالِ نَعۡجَتِكَ إِلَىٰ نِعَاجِهِۦۖ وَإِنَّ كَثِيرٗا
مِّنَ ٱلۡخُلَطَآءِ لَيَبۡغِي بَعۡضُهُمۡ عَلَىٰ بَعۡضٍ إِلَّا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ وَعَمِلُواْ
ٱلصَّٰلِحَٰتِ وَقَلِيلٞ مَّا هُمۡۗ وَظَنَّ دَاوُۥدُ أَنَّمَا فَتَنَّٰهُ فَٱسۡتَغۡفَرَ رَبَّهُۥ وَخَرَّ
رَاكِعٗا وَأَنَابَ۩ ﴿٢٤﴾ فَغَفَرۡنَا لَهُۥ ذَٰلِكَۖ وَإِنَّ لَهُۥ عِندَنَا لَزُلۡفَىٰ وَحُسۡنَ
مَـَٔابٖ ﴿٢٥﴾

“A të erdhi ty (o Muhammed) **lajmi i palëve ndërgjykuese kur kaluan prej së larti në dhomën ku ai** (Dàùdi) **lutej?”**

"Kur ata hynë te Dàùdi, ai u frikësua prej atyre; por ata i thanë: mos u frikëso, dy vetë që kemi konflikt, i kemi bërë padrejtësi njëri-tjetrit, prandaj gjyko me drejtësi në mes nesh, mos mbaj anë dhe na udhëzo në rrugën e drejtë."

"Ky vëllai im ka nëntëdhjetë e nëntë dele, kurse unë kam vetëm një dele, po ai më tha: ma jep mua atë (delen tënde) **dhe më mposhti me fjalë."**

"Ai (Dàùdi) **tha: ai të ka bërë padrejtësi duke të kërkuar që të bashkojë delen tënde me delet e tij; është e vërtetë që shumë prej ortakëve i bëjnë padrejtësi njëri-tjetrit, me përjashtim të atyre që janë besimtarë dhe bëjnë punë të mira, por të këtillë janë pak. Dàùdi mendoi se Ne e kemi vënë atë në sprovë, prandaj kërkoi faljen e mëkateve dhe u përkul i penduar."**

"Këtë Ne ia falëm atij dhe te Ne për atë ka afrim dhe të ardhme të mirë."

Komentimi

Dàùdi dhe provimi i madh

Ajetet objekt studimi, shtrojnë një studim të thjeshtë e të qartë në lidhje me gjykimin e Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, njëkohësisht këto ajete i japin përgjigje shmangies nga e rruga e drejtë dhe shprehjeve të këqija të disa injorantëve, të cilat kanë shkaktuar një zhurmë të madhe në mesin e interpretuesve të

Kur'ànit, madje valët e asaj zhurme janë kaq të fuqishme, sa i kanë vënë përpara disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë dhe kanë bërë që ata të gjykojnë në lidhje me një çështje të papranueshme dhe të thonë fjalë jo të përshtatshme për këtë Profet të madh.

Në lidhje me këtë çështje, do të mundohemi të shpjegojmë kuptimin e ajeteve, pa koment dhe pa hollësira, me qëllim që lexuesi i nderuar t'i kuptojë ajetet e Kur'ànit Famëlartë me mendje të kthjellët e të pastër dhe pasi të mbarojmë me komentin e shkurtër të këtyre ajeteve, do të trokasim në mendimet e ndryshme që janë thënë në lidhje me interpretimet e këtyre ajeteve.

Në plotësim të ajeteve të përparme, që shpalosën cilësitë e veçanta të Dàùdit dhe të mirësive që Krijuesi i Gjithëfuqishëm i kishte dhënë atij, në këto ajete, Kur'àni Famëlartë shpjegon ngjarjet e një gjykimi që iu kërkua Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Në ajetin e parë të këtij grupi ajetesh, Kur'àni Famëlartë i flet drejtpërdrejt të Dërguarit më të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe i thotë: **"A të erdhi ty** (o Muhammed) **lajmi i palëve ndërgjykuese kur kaluan prej së larti në dhomën ku ai** (Dàùdi) **lutej?"**.

Fjala *"el khasmu"* - *"palë në konflikt"* nga ana gramatikore e gjuhës arabe, është rrënjë fjale dhe në shumicën e rasteve thuhet për dy palë në konflikt. Kjo fjalë përdoret në numrin njëjës dhe në numrin shumës, por në disa raste përdoret edhe në numrin shumës: *"khusùmun"*.

Fjala *"teseu'uerù"*, në rrënjën e saj *"sùrun"*, do të thotë: mur i lartë që ndërtohet rreth shtëpisë, ose rreth qytetit dhe në këtë kuptim fjala e ajetit *"teseu'uerù"*, do të thotë: kapërcim i murit, ose ngjitje lart në mur.

Fjala *"el mihràb"*, do të thotë: kreu i vendit ose: dhomat e larta, por me qenë se "kryet e vendit" u bë vendi ku kryhet adhurimi, gradualisht filloi të quhet faltore, kurse sot fjala "mihrab" përdoret për të treguar vendin ku qëndron Imami gjatë faljes së namazit me xhemat në xhami. Në fjalorin e fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", shpjegohet se shkaku që fjala "mihrab" përdoret për të treguar mihrabin e xhamisë, ka të bëjë me faktin se mihrabi konsiderohet i dalë nga rrënja *"harbun"* – *"luftë"* fjala "mihràb" është në kuptimin mjeti i luftës kundër djallit dhe kundër dëshirave të vetvetes.

Në të gjitha gjendjet, nga fjalët e ajetit kuptohet se Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* edhe pse ishte i rrethuar nga një numër i madh ushtarësh e rojesh, dy palët në konflikt mundën që, me rrugë jo të zakonshme, të kapërcenin muret e dhomës ku ai bënte adhurim dhe të dalin papritmas përpara Dàùdit dhe kur ai i pa ata të dy, u frikësua dhe mendoi si hynë ata te ai pa kërkuar leje dhe pa lajmërim; në këtë gjendje, Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* mendoi se ata kanë qëllim të keq kundër tij; për këtë, ajeti vijues njofton: **"Kur ata hynë te Dàùdi, ai u frikësua prej atyre."**.

Por ata të dy, menjëherë nxituan ta qetësojnë dhe të dy i thanë: mos u frikëso prej nesh, në mes nesh ka lindur një konflikt dhe po e teprojmë ndaj njëri-tjetrit, ashtu siç njofton pjesa vijuese e ajetit: **"...dy vetë që kemi konflikt, i kemi bërë padrejtësi njëri-tjetrit..."**.

Prandaj, tani gjyko në mes ne të dyve dhe në gjykimin tënd mos mbaj anë, por na udhëzo në rrugën e drejtë, ashtu siç e lexojmë në frazën e fundit të këtij ajeti: **"Prandaj gjyko me drejtësi në mes nesh, mos mbaj anë dhe na udhëzo në Rrugën e Drejtë."**.

Fjala *"tushtit"* në rrënjën e saj *"shetata"*, është në kuptimin: shumë larg dhe dihet se padrejtësia e tirania e largojnë njeriun shumë nga e drejta. Gjithashtu, kjo fjalë thuhet edhe për rastin kur themi: shumë larg nga e vërteta.

Patjetër që frika e shqetësimi i Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u qetësua në një farë mënyre kur dy vëllezërit i shpjeguan atij qëllimin e ardhjes së atyre të dyve te ai; megjithëkëtë, në mendjen e tij trokiste pyetja: Kur ju të dy nuk keni qëllim të keq, atëherë cili është qëllimi që ju të dy erdhët me një rrugë jo të zakonshme?

Ndërkaq, njëri prej atyre të dyve i shtroi atij problemin që kishin njëri me tjetrin dhe i shpjegoi Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* çështjen që kishin në mes tyre dhe e njoftoi se burri që ai ishte në konflikt ishte vëllai i tij, pastaj shtoi: ai ka 99 kokë dele, kurse unë kam vetëm një dele, megjithëkëtë ai këmbëngul që unë t'ia jap atij edhe delen e vetme që kam, që ai ta bashkojë me delet e veta, madje për këtë më ka folur ashpër, ashtu siç njofton ajeti: **"Ky vëllai im ka nëntëdhjetë e nëntë dele, kurse unë kam vetëm një dele, po ai më tha: ma jep mua atë** (delen tënde) **dhe më mposhti me fjalë."**.

Fjala *"ne'xhetun"* është në kuptimin e bagëtive të imta femër, por thuhet edhe për femrën e gjedheve, si dhe për femrën e dashit të egër të maleve.

Fjala *"ekfilnijhà"*, këtu është në kuptimin: hiq dorë, me fjalë të tjera ai i thoshte: delen tënde ma jep mua, që edhe ajo të jetë prona ime.

Fjala *"az'zenij"*, do të thotë: *"ai më mposhti"* dhe sipas këtij shpjegimi, fraza e ajetit merr kuptimin: *ai më mposhti mua*.

Sipas kuptimit që shprehin fjalët e ajetit, mësohet se Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* iu drejtua ankuesit para se të dëgjojë fjalën e tjetrit dhe i tha: Natyrisht, që të ka bërë padrejtësi duke të kërkuar që edhe delen tënde të vetme ta bashkonte me delet e veta, ashtu siç njofton fraza e parë e ajetit vijues: **"Ai** (Dàùdi) **tha: ai të ka bërë padrejtësi duke të kërkuar që të bashkojë delen tënde me delet e tij."**.

Megjithëse kjo që të ka ndodhur ty nuk është diçka e re, pasi shumë prej miqve që bëjnë ortakëri, i bëjnë padrejtësi ortakut të vet, me përjashtim të atyre që kanë besuar dhe bëjnë punë të mira, por ata janë pakicë dhe ajeti vijues njofton: **"...është e vërtetë që shumë prej ortakëve i bëjnë padrejtësi njëri-tjetrit, me përjashtim të atyre që janë besimtarë dhe bëjnë punë të mira, por të këtillë janë pak..."**.

Po, është shumë e vërtetë që njerëzit të cilët ruajnë me kujdes të plotë ortakërinë dhe miqësinë me palën tjetër, ata nuk e dëmtojnë palën tjetër në marrëveshje as edhe në sendin më të vogël, por i plotësojnë të gjitha të drejtat që u takojnë miqve e ortakëve të tyre në mënyrë të plotë, por të këtillë janë shumë pak.

Natyrisht, ata që veprojnë me kaq drejtësi, janë besimtarë dhe njerëz që bëjnë vetëm punë të mira.

Në të gjitha rastet, nga fjalët e ajetit mësohet se të dyja palët në konflikt mbetën të bindur prej fjalëve të Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe u larguan të kënaqur me gjykimin e tij.

Por Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* pas largimit të atyre dy burrave filloi të mendojë, megjithëse ishte i bindur që kishte gjykuar me drejtësi në mes atyre dy burrave, përsëri thoshte me vete: sikur pala e dytë të mos ishte dakord me mëtimet e palës së parë, domethënë me mëtimet e ankuesit, ai patjetër që do ta kundërshtonte, por heshtja e tij është argumenti më i mirë që tregon se çështja qëndronte ashtu siç e shtroi ankuesi.

Megjithëkëtë, edukata e gjykimit e detyronte Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* që ai të shikonte mirë punën e nxjerrjes së vendimit dhe kurrë të mos nxitohej të jepte vendimin për çështjen në fjalë; gjithashtu, edukata e gjykimit e detyronte atë të pyeste edhe palën tjetër; prandaj, ai u pendua shumë për këtë që bëri dhe mendoi se Krijuesi i Gjithëfuqishëm, me këtë ngjarje e vuri në sprovë. Fraza vijuese e këtij ajeti njofton gjendjen e tij: **"...Dàùdi mendoi se Ne e kemi vënë atë në sprovë..."**.

Por pikërisht në këtë gjendje, natyra e tij e pastër i dha të kuptojë se ai ishte prej atyre që i drejtohej vetëm All'llahut të Lartësuar, prandaj menjëherë kërkoi prej Zotit të tij faljen e mëkatit dhe u përkul i penduar para All'llahut, të Gjithëfuqishmit, të Urtit dhe fraza e fundit e ajetit njofton gjendjen

e tij: **"... Prandaj kërkoi faljen e mëkateve dhe u përkul i penduar."**.

Fjala *"kharr'rre"*, në rrënjën e saj *"kharijr"*, do të thotë: rrëzimi i një sendi prej një lartësie dhe zëri që del prej rrëzimit, ashtu siç dëgjohet nëpër ujëvarat zhurma e ujit që bie; kurse këtu, kjo fjalë tregon rënien në sexhde, në kuptimin se ata që janë në sexhde, më parë ishin më këmbë dhe pastaj, me shpejtësi, gjenden në pozicion, me krye në tokë, domethënë në sexhde dhe të gjitha këto lëvizje i shoqërojnë me lutje për të madhëruar All'llahun e Lartësuar.

Edhe fjala *"ràkian"*, nga ana gjuhësore do të thotë rënie në sexhde, ose përkulje e trupit në ruku, duke e konsideruar rukunë si veprim paraardhës të sexhdes.

Në të gjitha gjendjet, All'llahu i Gjithëfuqishëm e kishte përfshirë Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në mëshirën e në butësinë e Tij dhe ia fali atij shkarjen e vogël që bëri duke lënë punën me më shumë përparësi, ashtu siç shpjegohet edhe më qartë në ajetin vijues: **"...Këtë Ne ia falëm atij..."**. Pjesa vijuese e ajetit të fundit të këtij grupi ajetesh, njofton: pa dyshim që ai ka një pozitë shumë të lartë te All'llahu i Lartësuar: **"...dhe te Ne për atë ka afrim dhe të ardhme të mirë."**.

Fjala *"zulfà"*, do të thotë: "pozitë e lartë dhe afrim te All'llahu", kurse shprehja *"ue husne meàbin"* – **"dhe te Ne për atë ka afrim dhe të ardhme të mirë"** tregon Xhennetin dhe mirësitë e Botës Tjetër.

Hulumtime

1- Si është e vërteta e ngjarjeve në tregimin e Dàùdit?

Ajo që sqaron Kur'àni Famëlartë në lidhje me këtë çështje, reduktohet vetëm në atë që dy vetë kapërcyen murin e dhomës ku bënte adhurim Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* me qëllim që ai të gjykonte në mes atyre të dyve. Gjithashtu, Kur'àni njofton se ai u frikësua kur i pa ata dy burrat dhe më pas dëgjoi fjalët e ankuesit, i cili i tha se vëllai i tij, që kishte 99 kokë dele dhe ai kishte një dele të vetme, por vëllai i kërkonte me ngulm që edhe atë dele të vetme që ai kishte, t'ia jepte atij, që ta bashkonte me delet e veta. Ajetet e Kur'ànit njoftojnë se Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i dha të drejtë ankuesit dhe kërkesën e vëllait të tij e konsideroi padrejtësi e tirani; pastaj u pendua për gjykimin që kishte bërë, prandaj i kërkoi All'llahut të Gjithëfuqishëm faljen e mëkatit për atë gjykim dhe All'llahu i Lartësuar e fali jo vetëm për gjykimin e nxituar, por i fali edhe mëkatin që bëri me këtë rast.

Këtu dalin dy pyetje të imta; e *para:* është çështja e provimit dhe *e dyta:* është çështja e kërkesës për faljen e mëkatit.

Kur'àni Famëlartë nuk e ndan bisedën në lidhje me këto dy çështje, por argumentet që gjenden në këto ajete dhe transmetimet islame që kanë ardhur në lidhje me interpretimin e këtyre ajeteve, thonë se Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte pajisur me një dituri shumë të gjerë dhe me një zotësi shumë të lartë në çështjen e gjykimit të çështjeve që kishin njerëzit në mes njëri-tjetrit, por ishte vullneti i All'llahut të Lartësuar që ai të vihej në provim dhe për këtë provim, All'llahu i Madhëruar krijoi ato kushte jo të

zakonshme, siç ishin hyrja te ai e dy burrave me rrugë jo të zakonshme, kapërcimi i mureve të dhomës ku ai bënte adhurim, provimi i tij për nxitimin që ai tregoi në nxjerrjen e vendimit të gjykimit para se të dëgjojë fjalët e palës tjetër, megjithëse gjykimi i tij qe i drejtë.

Megjithëkëtë, Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u kujtua shumë shpejt që kishte bërë një shkarje të vogël dhe u mundua ta përmirësojë edhe atë shkarje të vogël, para se të ishte vonë. Ai u ndërgjegjësua se veprimi i tij nuk ishte në përshtatje me pozitën e lartë të profetnisë, prandaj edhe kërkimi i faljes nga ana e tij është se ai la pa bërë punën me më shumë përparësi, prandaj All'llahu i Lartësuar e përfshiu atë me faljen e Tij të madhe dhe i fali mëkatin.

Përveç kësaj që u tha, dëshmues për këtë interpretim është edhe ajeti që vjen menjëherë pas këtij grupi ajetesh, në në të cilin, i Larti i drejtohet Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* drejtpërdrejt dhe i thotë: **"O Dàùd, Ne të kemi bërë sundimtar mbi Tokë, prandaj gjyko me drejtësi në mes njerëzve dhe mos ndiq dëshirat, se ato të shmangin prej rrugës së All'llahut…"**. Ky ajet na shpjegon qartë se shkarja e Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kishte të bënte me mënyrën e gjykimit të tij.

Siç shihet, ajetet e lartpërmendura nuk thonë asgjë që e pakëson dhe e ul pozitën e këtij Profeti të madh.

2- Teuràti dhe tregimet në lidhje me Dàùdin

Dhe tani do të shfletojmë Teuràtin, që të shikojmë ato që janë përmendur në këtë libër në lidhje me atë ngjarje dhe të zbulojmë se mbi ç'bazë janë mbështetur disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, por që në fakt janë injorantë dhe që nuk kanë fare informacion në lidhje me interpretimin e këtyre ajeteve.

Në Teuràt, në librin e dytë "Ishmùijl", paragrafi i njëmbëdhjetë, prej fjalisë së dytë deri në fjalinë e njëzet e shtatë, thuhet: "Ishte kohë mbrëmjeje kur Dàùdi u ngrit prej poltronës dhe filloi të ecë mbi tarracën e shtëpisë së mbretit dhe aty ku ishte, mbi tarracë, pa një grua shumë të bukur, që po bënte banjë. Dërgoi njerëz që të pyesnin se cila ishte ajo grua dhe iu tha: ajo është Bitshebi,[1] vajza e Iljeàmit dhe gruaja e Eurij'ja El Hit'tij.[2]

Dàudi ngarkoi një njeri me detyrën që ta merrte gruan dhe ai e mori. Dàùdi fjeti me gruan; në atë kohë gruaja ishte e pastër nga mentruacionet; pastaj ai e ktheu gruan në shtëpinë e saj. Gruaja mbeti shtatzanë dhe çoi dikë që e njoftoi Dàudin se ajo ishte shtatzanë.

Pasi mësoi për shtatzaninë e Bitshebit, Dàùdi i shkroi një letër Jùàbit,[3] të cilit i kërkonte që të sillte te ai Eurij'jan dhe Jùàbi e solli Eurij'jan tek ai. Sapo Eurij'ja arriti në pallatin e Dàùdit, ai i

[1] Bitshebi ishte emri i asaj gruas për të cilën Teuràti thotë se Dàùdi e pa atë të zhveshur kur po ecte mbi tarracën e shtëpisë së tij dhe se ai ra në dashuri me atë. Ajo ishte e bija e Jeàmit, i cili në atë kohë ishte prej atyre që mbanin përgjegjësi dhe ishte hebre.

[2] Eurij'ja, është emri i njërit prej komandantëve të mëdhenj të ushtrisë së Dàùdit dhe fjala "El Hitij'j" pas emrit të këtij komandanti, tregon se ai rridhte prej Hitit, të birit të Ken'ànit dhe fisi i tij quhej Benij Hit.

[3] Jùàbi ishte komandanti i përgjithshëm i forcave të Dàùdit.

kërkoi shpjegime në lidhje me gjendjen shëndetësore të Jùàbit, gjithashtu i kërkoi shpjegime rreth gjendjes së shëndetit të ushtarëve dhe patjetër i kërkoi ta informonte rreth betejave që ishin zhvilluar.

Pastaj Dàùdi e urdhëroi Eurij'jan të shkonte në shtëpinë e tij dhe të lante të dyja këmbët dhe Eurij'ja doli prej pallatit të Dàùdit. Nga pas, Dàudi i çoi atij lloje gjellërash, porse Eurinj'ja fjeti te porta e pallatit të Dàùdit së bashku me skllevërit e tjerë të zotërisë së tij Dàùdit dhe nuk shkoi në shtëpinë e vet. Kur Dàùdi mësoi se Eurij'ja nuk kishte shkuar në shtëpinë e tij, Dàùdi i tha Eurij'jas: A nuk ishe kthyer prej udhëtimit? Përse nuk shkove në shtëpinë tënde? Ai i tha Dàùdit: Arka, Israijli, Jehùda dhe padroni im Jùàbi jetojnë nëpër tenda në shkretëtirë, a më lejohet mua të shkoj në shtëpinë time për të ngrënë e për të pirë dhe të fle në shtëpi? Pasha jetën tënde, unë këtë nuk e bëj.

Në mëngjes, Dàùdi i dërgoi një letër Jùàbit me dorën e Eurij'jas. Në atë letër i shkruante Jùàbit: vëreni Eurij'jan në ballë të një luftë të ashpër dhe prapa tij ju tërhiquni, ndërkaq ai do të goditet e do të vdesë. Juàbi veproi sipas porosisë dhe për këtë njoftoi Dàùdin.

Kur gruaja e Eurij'jas dëgjoi se Eurij'ja vdiq, ajo qau burrin e saj dhe pasi mbaroi koha e zisë, Dàùdi dërgoi njerëz, mori gruan dhe e futi në shtëpinë e vet, e cila tani u bë gruaja e tij. Kjo punë që bëri Dàùdi, në sytë e Zotit ishte shumë e keqe."[1]

Thelbi i këtij tregimi është si më poshtë: një ditë Dàùdi u ngjit në tarracën e pallatit dhe sytë i ranë në shtëpinë që ishte

[1] Cituar prej paragrafit të njëmbëdhjetë të librit "Samueli i dytë", fjalitë 2-27.

pranë pallatit; aty lart ku ishte, ai pa një grua të zhveshur që po lahej; ai e dashuroi gruan dhe mundësoi njërën prej rrugëve për ta sjellë gruan në shtëpinë e tij, fjeti me gruan dhe ajo mbeti shtatzanë.

Burri i kësaj gruaje ishte njëri prej oficerëve me famë të ushtrisë së Dàùdit dhe ishte njeri i pastër, por atë e vrau Dàùdi (kërkojmë mbrojtjen e All'llahut për këto fjalë që na nxjerr gjuha) me një komplot prej frikacaku, kur e dërgoi atë të vetëm në një zonë shumë të rrezikshme në sheshin e betejës, pastaj Dàùdi u martua me gruan e tij.

Tani le të ndjekim pjesën që ka mbetur prej atij tregimi sipas fjalëve të Teuràtit të sotshëm: Në paragrafin e dymbëdhjetë prej librit "Samueli i dytë", thuhet: "Zoti dërgoi Nàthanin, njërin prej Profetëve të Beni Israilëve, i cili në të njëjtën kohë ishte dhe këshilltar i Dàùdit dhe ky këshilltar i tregoi Dàùdit se në një qytet jetonin dy burra. Njëri prej atyre të dyve ishte i pasur, kurse tjetri ishte i varfër. I pasuri kishte shumë bagëti të imta dhe shumë lopë, kurse i varfëri s'kishte pasuri tjetër përveçse një dele të vogël, të cilën e rriste me kujdes. Një ditë, në shtëpinë e të pasurit erdhi një mik dhe i pasuri nuk mori të therte prej bagëtive e prej lopëve të tij që të gatuante për mikun që i kishte ardhur në shtëpi, por shkoi te i varfëri, mori delen e tij të vetme dhe me atë përgatiti ushqimin për mikun e tij.

Dàùdi u zemërua shumë dhe i tha Nàthànit: betohem në Zotin se njeriu që ka bërë këtë veprim, meriton të vritet. Ai ka detyrim t'i kthejë atij delen me katërfish. Këtu Nàthàni i tha Dàùdit: Ai burrë je ti!

Dàùdi i kushtoi vëmendje punës jo të mirë që kishte bërë, prandaj iu lut Zotit t'ia falë gabimin dhe Zoti e fali për gabimin që kishte bërë, por, në të njëjtën kohë, zbriti mbi Dàùdin sprova të shumta".

Ja kështu, Teuratit ka përdorur shprehje që edhe lapsi turpërohet t'i shkruajë, prandaj edhe ne nuk po shikojmë më shumë.

Në këtë pjesë të tregimit që shpalos Teuràti, ai që e ndjek ka mundësi të bëjë vërejtjet e mëposhtme:

1- Asnjë njeri prej atyre që u ishte bërë padrejtësi nuk erdhi të ankohej te Dàùdi, por në të vërtetë te ai shkoi njëri prej Profetëve të Beni Israilëve, i cili në të njëjtën kohë ishte edhe këshilltar i Dàùdit dhe ky këshilltar i foli Dàùdit për tregimin e mësipërm, me qëllim që Dàùdi, nëpërmjet atij tregimi të këshillohej e të nxirrte mësime. Tregimi fiste rreth dy burrave, i pari ishte i pasur dhe i dyti ishte i varfër. I pasuri zotëronte shumë dhen e lopë, kurse i varfëri kishte vetëm një dele të vogël. Mirëpo, i pasuri ia mori delen të varfërit që të gatuante me mishin saj për mikun që i kishte ardhur në shtëpi.

Deri në këtë pikë të tregimit nuk thuhet asgjë në lidhje me kapërcimin e mureve të dhomës së adhurimit, as në lidhje me frikën që e zuri Dàùdin prej grindjes së atyre dy njerëzve, duke shtuar edhe kërkimin e faljes për mëkatin që ai bëri.

2- Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e konsideroi të pasurin tiran që meritonte të vritej, por, përse të vritej, vetëm për një dele?!

3- Përse u nxitua Dàudi të nxjerrë vendimin e tij kur tha: i pasuri ka detyrim të kthejë delen me katërfish?

4- Dàùdi pohon fajin e tij në lidhje me gruan e Eurij'jas.

5- Përse Zoti i Gjithëfuqishëm e fali atë me kaq lehtësi?!

6- All'llahu i Lartësuar përmend dënime të atilla që për Dàùdin është më e parapëlqyeshme të mos përmenden këtu.

7- Ajo gruaja, me të kaluarën e saj të famshme, është nëna e Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Citimi i tregimeve të këtilla në të vërtetë është shumë i dhimbshëm. Por, si i bëhet kur disa injorantë të painformuar, të ndikuar prej transmetimeve izraelite, flasin e shkruajnë të këtilla lloj tregimesh banale për Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Ata nuk mund të vepronin më keq se sa kur e interpretojnë Kur'ànin Famëlartë, që është krejtësisht i pastër nga mitet e legjendat dhe ata fusin në interpretimin e Kur'ànit Famëlartë të këtilla transmetime. Prandaj, para nesh s'ka rrugë tjetër veçse të përmendim disa pjesë prej atyre tregimeve skandaloze, me qëllimin e vetëm për t'i hedhur poshtë.

Dhe tani pyesim

1- A mund të akuzohet një Profet të cilin e ka lavdëruar Krijuesi i Gjithëfuqishëm në Kur'ànin Famëlartë me dhjetë cilësi të mëdha dhe i ka bërë thirrje Profetit më të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* që të frymëzohet prej udhës së atij Profeti, si është e mundur që ai të akuzohet për punë të këtilla?

2- A përputhen këto thashetheme të stisura me ajetin e Kur'ànit Famëlartë: **"O Dàùd, Ne të kemi bërë sundimtar mbi Tokë…"**?

3- Kur një njeri i zakonshëm - dhe jo njëri prej Profetëve - bën një punë të këtillë kriminale dhe sulmon në nder nëpërmjet një veprimi shumë të keq, gruan e një oficeri besnik e të pastër, si do ta gjykonin njerëzit një mëkatar të këtillë dhe si do të ishte dënimi i këtij mëkatari? Njeriu i zakonshëm, për një punë të këtillë të ulët do të ekzekutohej, atëherë si qëndron puna me Profetin e All'llahut Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*?

Këtu vlen të theksohet se Teuràti nuk e konsideron Dàùdin Profet, por e konsideron vetëm një mbret të drejtë, me një pozitë të nderuar dhe si ndërtuesin e faltores së madhe për Beni Israilët.

4- Në këtë çështje, është kuptimplotë fakti se libri "Mezàmijru Dàùd" (Psalmet e Dàvidit), që është njëri prej librave të Teuràtit dhe në "psalmet" janë mbledhur përsiatjet e Dàudit, shtrohet pyetja: A mund të radhiten përsiatjet e një njeriu të këtillë në përmbajtjen e librave qiellorë?

5- Sikur këto tregime t'i paraqiteshin një njeriu që nuk ka as shumë zgjuarsi e as shumë aftësi për të kuptuar, me siguri që edhe një njeri i këtillë do të pohonte se tregimet e Teuràtit të revizionuar të ditëve tona, nuk janë gjë tjetër veçse mite dhe se armiqtë e vijës së Profetëve, ose individë injorantë, që s'kanë dituri, kanë stisur të këtilla mite; atëherë si mundet që këto mite të jenë kriter për studim?

Po, madhështia e Kur'ànit Famëlartë dallohet për faktin se në të nuk ka të këtilla mite.

3- Transmetimet islame dhe tregimi i Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*

Transmetimet islame i përgënjeshtrojnë fuqishëm tregime të këtilla, mite të këqija që gjenden në Teuràt.

Nga tërësia e transmetimeve që kanë ardhur prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë se ai, në lidhje me pastërtinë e Dàudit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Nëse te unë do të sillej një burrë që thotë se Dàùdi i mori gruan Eurij'jas, mbi këtë gënjeshtar do të zbatoja dy ndëshkime me rrahje me kamzhik, njërin ndëshkim për përdhosjen e profetnisë dhe ndëshkimin tjetër në zbatim të ligjit islam për akuza të rreme në nder të njeriut.*".[1]

Përse dy dënime? Sepse shpifjet e përmendura, nga njëra anë akuzojnë një njeri besimtar se ai ka bërë një punë të ndaluar rreptësisht (punë haram) dhe nga ana tjetër ai shkel shenjtërinë e pozitës së profetnisë, prandaj Imami gjykoi të ndëshkohet me dy dënime me rrahje me kamzhik çdo njeri që shpif kundër tij (çdo dënin me nga 80 goditje me kamzhik lëkure).

Në një transmetim tjetër, që jep të njëjtim kuptim, të ardhur gjithashtu prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë se ai ka thënë: "*Ai që ju flet juve ndonjë fjalë për Dàùdin sipas asaj që thonë përralltarët, mbi atë do të zbatoja ligjin e ndëshkimt me rrahje me njëqind e gjashtëdhjetë rrahje me kamzhik.*".[2]

Në një transmetim tjetër, të cituar prej shejhut Es Sadùk në librin "El Emàlij", të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Të kënaqësh njerëzit është e pamundur, as gjuhët e*

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 8, f. 472, fundi i ajeteve objekt studimi.
[2] Tefsiri "El Kebijr", fundi i ajeteve objekt studimi.

njerëzve nuk frenohen, a nuk kanë thënë për Dàùdin se ai po ndiqte shpendët në fluturim, derisa sytë i ranë në gruan e Eurij'jas dhe se ai u mahnit pas saj dhe për këtë qëllim ai e vuri burrin e saj para "arkës" në ballë të betejës, që ai të vritej dhe pastaj u martua me gruan e tij!?".[1]

Në një transmetim që gjendet në librin "Ujùnul Akhbàr", në kapitullin: Kuvendi i Imamit Rizait *(Paqja qoftë mbi të!)* te kalifi abasit Me'mùni, që ishte bashkë me disa njerëz të mërzitur dhe po merreshin me thashetheme. Imami Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha Ibni Xhehmit: "Ç'thuhet prej jush për Dàùdin?"

Ai u përgjegj: Thonë se Dàùdi po falte namaz në dhomën e tij dhe para tij doli djalli në formën e një shpendi aq të bukur, sa nuk mund të kishte shpend më të bukur. Dàùdi e ndërpreu namazin dhe u ngrit që të kapte shpendin nëpër shtëpi, por shpendi fluturoi, kështu që ai u ngjit në tarracën e shtëpisë në kërkim të shpendit dhe pa se shpendi shkoi e ra në shtëpinë e Eurij'ja bin Haj'jànit.

Dàùdi, ndërsa po ndiqte gjurmët e shpendit, pa gruan e Eurij'jas që po lahej dhe sapo e pa ra në dashuri me atë grua. Burri i gruas, Eurij'ja, gjendej në disa fushata ushtarake, prandaj ai i shkroi eprorit të Eurij'jas që ta vinte Eurij'jan para "arkës"; ai doli para "arkës" dhe korri fitore kundër idhujtarëve, por kjo e vuri Dàùdin në vështirësi, prandaj ai i shkroi eprorit të Eurij'jas për herë të dytë që Eurij'ja të vihej para "arkës"; kësaj here Eurij'ja u vra dhe Dàùdi u martua me gruan e tij.

Përcjellësi i transmetimit tregon: Imam Rizai i ra ballit të vet me dorë dhe tha: "Ne jemi të All'llahut dhe te All'llahu do të

[1] Libri "El Emàlij" i shejhut Es Sadùk, cituar sipas tefsirit "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 446.

kthehemi, ju po thoni për një Profet të All'llahut se ai e la pas dore faljen e namazit për të ndjekur një shpend dhe pastaj thoni se ai prostituoi dhe pastaj kaloi në vrasje".

Ai e pyeti: "O bir i të Dërguarit të All'llahut, ç'gabim bëri ai?"

Ai tha: "Sa shumë nxitohesh, në të vërtetë, Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* mendoi se ai ishte më i dituri ndër të gjitha krijesat që ka krijuar All'llahu i Lartësuar, prandaj All'llahu i Lartësuar dërgoi te ai dy engjëj që kapërcyen murin e dhomës ku ai bënte adhurim dhe thanë: **"…dy vetë që kemi konflikt, i kemi bërë padrejtësi njëri-tjetrit, prandaj gjyko me drejtësi në mes nesh, mos mbaj anë dhe na udhëzo në rrugën e drejtë. Ky vëllai im ka nëntëdhjetë e nëntë dele, kurse unë kam vetëm një dele, po ai më tha: ma jep mua atë** (delen tënde) **dhe më mposhti me fjalë."**.

Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u shpejtua kur i tha ankuesit: **"… ai të ka bërë padrejtësi duke të kërkuar që të bashkojë delen tënde me delet e tij…"** dhe nuk i kërkoi të padituri që të paraqiste argument për këtë akuzë, madje as nuk e pyeti të padiurin dhe t'i thotë: çdo të na thuash? Ky qe gabimi i tij në këtë gjykim dhe jo ashtu siç thatë ju; a nuk e ke dëgjuar se All'llahu i Lartësuar thotë: **"O Dàùd, Ne të kemi bërë sundimtar mbi Tokë, prandaj gjyko me drejtësi…"**.

Ai e pyeti: "O bir i të Dërguarit të All'llahut, si është tregimi i tij me Eurij'jan?"

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"Në kohën e Dàùdit (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) gruas që i vdiste burri ose kur burri i*

saj vritej, ajo grua, pas atij nuk martohej me ndonjë burrë tjetër. Të parit që All'llahu i Lartësuar i lejoi të martohej me një grua të cilës i ishte vrarë burri, ishte Dàùdi (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) dhe ai është martuar me gruan e Eurij'jas, pasi ai u vra në luftë dhe vetëm pasi gruaja kaloi kohën ligjore të pritjes. Ja kjo është ajo që u rëndon njerëzve prej vrasjes së Eurij'jas.".[1]

Prej këtij transmetimi, mësohet se çështja e Eurij'jas në rrënjën e saj ka një të vërtetë të vogël dhe se Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* zbatoi vetëm atë që erdhi në kumtin hyjnor, por nga njëra anë armiqtë e All'llahut, nga ana tjetër injorantët dhe nga një anë e tretë janë edhe autorët e tregimeve fantastike, të cilët gjithmonë shkruajnë tregime të çuditshme, të mbushur me gënjeshtra; të gjithë së bashku stisën kërcellin, degët dhe gjethet e këtij tregimi, me qëllim që njerëzit të largoheshin e të kishin frikë prej Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Njëri prej të pranishmëve në atë kuvend, tha: ajo martesë ishte e pamundur të bëhej deri sa për atë nuk kishte veprime paraprake.

Një tjetër tha: mundet që shtëpia e Eurij'jas të ishte pranë shtëpisë së Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Së fundi, që të vërtetonin se Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* pa gruan e Eurij'jas, ata stisën edhe tregimin e shpendit dhe në fund akuzuan njërin prej Profetëve të mëdhenj të All'llahut për kryerjen e shumë punëve të turpshme e rreptësisht të ndaluara. Pastaj, këto akuza të stisuara i përsërisin gjuhët e injorantëve dhe të mendjelehtëve. Nëse këto tregime të stisura nuk do të ishin përmendur në libra të njohur, patjetër që do të

[1] "Ujùnul Akhbàr", cituar sipas tefsirit "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 445.

ishte gabim i rëndë që këto tregime të përmendeshin e të shpaloseshin edhe këtu.

Natyrisht që edhe ky transmetim nuk ndryshon nga transmetimi i Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, për faktin se transmetimi i tij thekson se ai është një tregim i rremë, i falsifikuar, që i vesh njërit prej Profetëve të mëdhenj të All'llahut mëkatin e prostitucionit e faje të tjera të ndaluara rreptësisht - për këto fjalë kërkojmë mbrojtjen e All'llahut.

Mendimet e interpretuesve të Kur'ànit

Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, kanë përmendur mendime të tjera në lidhje me tregimin e Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* megjithëse mendimet e tyre nuk janë në harmoni me kuptimin që shprehin fjalët e ajeteve të Kur'ànit Famëlartë. Prandaj, e shikojmë domosdoshmëri që, në plotësim të studimit, të shfletojmë disa prej këtyre mendimeve:

Prej atyre mendimeve kemi: Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i kishte ndarë orët e ditës së tij sipas një programi të sistemuar dhe nuk lejonte asnjë njeri të takohej me të për konsultim jashtë orëve të caktuara; por një ditë, dy vetë kapërcyen murin e dhomës ku ai bënte adhurim dhe në të vërtetë ishin marrë vesh në mes tyre që të vrisnin Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe gjatë kohës kur ai po adhuronte All'llahun e Gjithëfuqishëm, ata kapërcyen murin e dhomës së adhurimit, por kur u afruan pranë murit të dhomës, ata të dy panë rojet e ushtarët që e kishin rrethuar dhomën nga të gjitha anët dhe nga frika se mos zbulohej puna që ata kishin qëllim të bënin, në çast stisën një tregim të rremë dhe duke mashtruar

thanë se ne erdhëm te Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* që ai të gjykonte konfliktin që kishin në mes tyre dhe njëri prej atyre të dyve i shpjegoi ato që shpjegon Kur'àni Famëlartë dhe Dàùdi gjykoi në mes atyre të dyve; por, meqenëse qëllimi me këtë lojë ishte vrasja e tij, Dàùdi u zemërua shumë dhe ishte i vendosur të hakmerrej kundër atyre të dyve, por kaluan vetëm pak çaste dhe Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u pendua për vendimin e tij për hakmarrje dhe i kërkoi All'llahut faljen e mëkatit.[1]

Dijetari poliedrik Et Tabàtàij dhe pjesa më e madhe e interpretuesve të Kur'ànit Famëlartë, në vazhdën e transmetimeve, kanë thënë se dy burrat, që ishin në konflikt njëri me tjetrin dhe që hynë te Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishin dy engjëj, të cilët All'llahu i Lartësuar i dërgoi për ta vënë atë në sprovë. Tani ne dimë se ç'thonë transmetimet islame në lidhje me këtë tregim.Ai u ndërgjegjësua shumë shpejt se e gjitha kjo ishte një sprovë nga ana e All'llahut të Lartësuar dhe nuk ishte një ndodhi e zakonshme; veç kësaj i Larti njofton:

"... Prandaj gjyko me drejtësi në mes njerëzve dhe mos ndiq dëshirat". Në të vërtetë, All'llahu i Lartësuar e vuri atë në sprovë, me qëllim që ai të tregonte kujdes e maturi në marrëdhëniet me njerëzit dhe në gjykimin e çështjeve që njerëzit mund të kishin në mes tyre. Të gjitha këto e përforcojnë kuptimin se ata të dy ishin engjëj që u paraqitën në formën e dy burrave.

Gjithashtu edhe qëllimi me paraqitjen është se ata dy burra realisht nuk ekzistonin si njerëz, por e gjitha kjo gjeti pasqyrim në mendjen e Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

[1] Tefsiri "El Kebijr" dhe tefsiri "Rùhul Meànij" e kanë përmendur këtë çështje si orientim; kurse El Meràgij e ka miratuar këtë çështje në tefsirin e tij.

Në të vërtetë, engjëjt u shfaqën në formën e dy burrave që ishin në konflikt njëri me tjetrin, për shkak se njëri i kishte marrë tjetrit delen e vetme që ai kishte, me qëllim që ta bashkonte atë me nëntëdhjetë delet e veta, prandaj burri që kishte vetëm një dele, i kërkoi të gjykonte këtë çështje dhe ne e pamë se ai i tha ankuesit: **"Ai të ka bërë padrejtësi…"**. Sikur gjykimi i tij të ishte ekzekutiv, në kushtet e përfytyrimit, do të ishte sikur ai i ka parë ata të dy ashtu siç sheh njeriu në gjumë dhe u tha atyre të dyve ato që u tha në lidhje me gjykimin në mes tyre. Por dihet se, në kushtet e përfytyrimit dhe të marrjes me mend, nuk ka detyrim, ashtu siç nuk ka detyrim në botën e ëndrrave, pasi detyrimi ka të bëjë vetëm me botën tonë konkrete, në botën e materies dhe realiteti nuk mund të ndodhë në përfytyrimin e në ëndrrën. Nëse ajo që pa Dàùdi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* do të ishte përfytyrim, atje nuk do të kishte as dy burra në konflikt, as një dele e as shumë dele, sepse të gjitha këto ishin vetëm në kushtet e përfytyrimit, prandaj, në kushte përfytyrimi, gabimi i Dàùdit nuk është detyrim dhe është i ngjashëm me gabimin që bëri Ademi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në Xhennet për ngrënien e pemës para se ai të ulej në Tokë, ku u vu ligji dhe u vunë edhe detyrimet. Gjithashtu, edhe kërkimi i Dàùdit për faljen e gabimit dhe pendimi i tij, është si kërkimi i Ademit për faljen e gabimit dhe pendimi për punët që dolën prej tij, por All'llahu i Lartësuar shprehet qartë se Ai e ka bërë Dàùdin sundues mbi Tokë, ashtu siç është shprehur edhe për Ademin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të dy!)*.[1]

Gjithësesi, fjalët e ajeteve shpjegojnë qartë se ankesa dhe konflikti ishin prej individëve realë dhe ata të dy kishin trup që

[1] Tefsiri "El Mijzàn", vëll. 17, f. 203.

shihej me sy; në këtë gjendje, gjykimi i Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* nuk është një faj i bërë prej tij, veçanërisht pasi dëgjoi fjalët e njërit prej atyre të dyve dhe nga fjalët që dëgjoi, te ai u formua mendimi i qartë për dhënien e vendimit në atë gjykim, megjithëse edukata e parapëlqyer në gjykimin e çështjes, kërkon që ai duhej të tregonte më shumë kujdes në nxjerrjen e vendimit dhe të mos nxitohej, por, siç kemi thënë më sipër, kërkesa për faljen e mëkatit që ai bëri, ka të bëjë vetëm me faktin se nuk bëri punën që kishte më shumë përparësi.

Si do që të jetë, këtu s'ka asnjë domosdoshmëri të thuhet se ngjarja e këtij gjykimi të konsiderohet se ka ndodhur në kushte përfytyrimi, ose ngjarja ndodhi për t'i tërhequr vëmendjen Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Puna më e mirë është që ne t'i përmbahemi kuptimit që shprehin fjalët e ajeteve dhe interpretimit të këtyre ajeteve sipas rregullit që pamë më sipër, intepretim që ruan kuptimin e fjalëve të ajeteve pa nxjerrë asnjë problem që sulmon pagabueshmërinë e Profetëve.

Ajetet: 26 – 29

يَـٰدَاوُۥدُ إِنَّا جَعَلْنَـٰكَ خَلِيفَةً فِى ٱلْأَرْضِ فَٱحْكُم بَيْنَ ٱلنَّاسِ بِٱلْحَقِّ وَلَا تَتَّبِعِ ٱلْهَوَىٰ فَيُضِلَّكَ عَن سَبِيلِ ٱللَّهِ ۚ إِنَّ ٱلَّذِينَ يَضِلُّونَ عَن سَبِيلِ ٱللَّهِ لَهُمْ عَذَابٌ شَدِيدٌۢ بِمَا نَسُوا۟ يَوْمَ ٱلْحِسَابِ ﴿٢٦﴾ وَمَا خَلَقْنَا ٱلسَّمَآءَ وَٱلْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا بَـٰطِلًا ۚ ذَٰلِكَ ظَنُّ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ ۚ فَوَيْلٌ لِّلَّذِينَ كَفَرُوا۟ مِنَ ٱلنَّارِ ﴿٢٧﴾ أَمْ نَجْعَلُ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟ ٱلصَّـٰلِحَـٰتِ كَٱلْمُفْسِدِينَ فِى ٱلْأَرْضِ أَمْ نَجْعَلُ ٱلْمُتَّقِينَ كَٱلْفُجَّارِ ﴿٢٨﴾ كِتَـٰبٌ أَنزَلْنَـٰهُ إِلَيْكَ مُبَـٰرَكٌ لِّيَدَّبَّرُوٓا۟ ءَايَـٰتِهِۦ وَلِيَتَذَكَّرَ أُو۟لُوا۟ ٱلْأَلْبَـٰبِ ﴿٢٩﴾

“O Dàùd, Ne të kemi bërë sundimtar mbi Tokë; prandaj gjyko me drejtësi në mes njerëzve dhe mos ndiq dëshirat, se ato (dëshirat) **të shmangin prej Rrugës së All’llahut dhe ata që i largohen rrugës së All’llahut, kanë një dënim të ashpër, për shkak se harruan Ditën e Llogaridhënies.”**

"Ne nuk i krijuan Qiellin, Tokën dhe ç'ka në mes këtyre të dyjave (në mes Qiellit e Tokës) **pa qëllim, ashtu siç mendojnë mohuesit; mjerë ata që nuk besuan prej dënimit në zjarr."**

"A mos do të bëjmë të barabartë ata që besuan dhe bënë punë të mira me ata që mbjellin nëpër tokë ngatërresa e bëjnë shkatërrime, apo do t'i konsiderojmë të barabartë të devotshmit me mëkatarët?"

"Libër i begatë që Ne ta shpallëm ty (o Muhammed)**, që ata** (njerëzit) **t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të mençurit të marrin mësim prej tij."**

Komentimi

Gjyko me drejtësi dhe mos ndiq dëshirat

Jemi në vazhdim të tregimit të Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe me këtë grup ajetesh kemi arritur në pragun e fundit të këtij tregimi, për faktin se ajetet objekt i studimit tonë janë ajetet e fundit në këtë sure që flasin për Dàùdin. Këto ajete i flasin atij në vetën e dytë, me një gjuhë të vendosur dhe me shprehje të mbushura me shumë kuptime, duke i shpjeguar detyrat dhe përgjegjësitë e tij të rëndësishme; ajetet e përparshme i bënë atij të qartë pozitën e lartë që ai kishte, kurse këto ajete i thonë atij: **"O Dàùd, Ne të kemi bërë sundimtar mbi Tokë; prandaj gjyko me drejtësi në mes njerëzve dhe mos ndiq dëshirat, se ato të shmangin prej rrugës së All'llahut dhe ata që i**

largohen Rrugës së All'llahut, kanë një dënim të ashpër, për shkak se harruan Ditën e Llogaridhënies.".

Përmbajtja e këtij ajeti flet për pozitën e lartë të Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe për detyrat shumë të rëndësishme me të cilat ai është ngarkuar të plotësojë; gjithashtu shpjegojnë se tregimet e përfytyruara të rreme që janë thurur në lidhje me martesën e Dàùdit me gruan e Eurij'jas, të gjitha janë gënjeshtra dhe s'kanë asgjë nga e vërteta.

A ka mundësi që Krijuesi i Gjithëfuqishëm të zgjedhë një njeri i cili shikon në nderin e besimtarëve dhe të afërmëve me syrin e tradhtisë, një njeri që e përlyen dorën e tij me gjakun e të pafajshmëve dhe këtë njeri ta bëjë mëkëmbës të sundimit të Tij mbi Tokë e t'i japë atij urtësinë absolute në fushën e gjykimit?!

Në këtë ajet, janë pesë fjali dhe çdonjëra prej këtyre pesë fjalive flet për një të vërtetë të caktuar:

Fjalia e parë: Me frazën "sundimi i Dàùdit në Tokë", mos vallë me këtë frazë qëllimi është për sundimin e tij si zëvendës i sundimit të Profetëve të përparshëm, apo sundimi i tij është në kuptimin se ai është mëkëmbës i sundimit të All'llahut? Kuptimi i dytë është më në përshtatje dhe përputhet edhe me përmbajtjen e ajetit 30 të sures "El Bekare", në të cilën i Larti njofton: **"Dhe kur Zoti yt u tha engjëjve: Unë bëra në Tokë një mëkëmbës…"**.

Natyrisht që kuptimi real i mëkëmbësit (sunduesit), nuk ka lidhje me All'llahun, sepse zëvendësimi i sunduesit vjen me vdekjen ose me mungesën e sundimtarit; kurse këtu, qëllimi me mëkëmbës është në kuptimin që njeriu të jetë përfaqësues i All'llahut në mesin e njerëzve dhe zbatues i urdhërave të

All'llahut të Gjithëfuqishëm në Tokë. Kjo fjali shpjegon qartë se ligjshmëria e qeverisë në Tokë duhet të frymëzohet prej qeverisë hyjnore, sepse çdo qeveri që nuk frymëzohet prej ligjshmërisë së qeverisë hyjnore, është qeveri e padrejtë dhe grabitëse.

Fjalia e dytë e urdhëron Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* duke i thënë: pasi All'llahu i Gjithëfuqishëm të dha këtë mirësi të madhe, domethënë që të jesh mëkëmbës i Tij në Tokë, patjetër që je i detyruar të gjykosh në mes njerëzve me drejtësi: **"…prandaj gjyko me drejtësi në mes njerëzve…"**.

Konkretisht, njëra prej frutave e të qenit mëkëmbës i sundimit të All'llahut, është dalja e një qeverie që qeveris në bazë të të drejtës së All'llahut. Prej kësaj fjalie, mund të thuhet se qeveria e të drejtës del vetëm prej mëkëmbësisë së sundimit të All'llahut dhe është rezultat i drejtpërdrejtë i saj.

Fjalia e tretë thekson se rreziku më i madh që e kërcënon sundimtarin e drejtë është ndjekja e dëshirave, ndjekja e interesave: **"…dhe mos ndiq dëshirat…"**.

Po, dëshirat dhe interesat vetiake, në të vërtetë janë një perde e trashë, që i mbulojnë njeriut shikimin dhe e mbajnë atë larg prej drejtësisë.

Prandaj, *fjalia e katërt* e njofton atë: **"…se ato** (dëshirat) **të shmangin prej Rrugës së All'llahut…"**.

Kudo që vërehet shmangie prej udhëzimit në rrugën e drejtë, aty patjetër që dëshirat vetiake kanë peshën e vet dhe kudo që ndiqen dëshirat, fundi do të jetë shmangia prej udhëzimit në rrugën e drejtë.

Sundimtari që ndjek dëshirat vetiake, në të vërtetë i shkel rëndë të drejtat e njerëzve për ambiciet e tij; pikërisht këto veprime të tij janë shkaku që qeveria e tij është e trazuar dhe fundi i asaj qeverie patjetër është degradimi e asgjësimi.

Natyrisht që fraza **"ndjekja e dëshirave"** ka shumë kuptime të gjera dhe patjetër ka në brendinë e vet dëshirat e njeriut dhe dëshirat te çdo njeri. Prandaj, Kur'àni Famëlartë ka vendosur pavlefshmërinë e sistemeve të vëna prej njeriut, pasi këto sisteme në punët e sundimit bazohen mbi mendimet e masës së njerëzve, sepse rezultati i këtyre është shmangie prej udhëzimit dhe shmangie prej rrugës së All'llahut.

Në ditët e sotme i shohim qartë ndikimet e këqia të kësaj mendësie në atë që quhet "bota e zhvilluar" dhe "bota moderne". Në këtë botë të zhvilluar, shpesh shikojmë që edhe punët më të këqija e më të urryera, të marrin formë ligjore, si rezultat i marrjes në konsideratë të opinioneve të njerëzve, prandaj në botën e sotme era e qelbur e skandalit është bërë aq e rëndë, sa shkakton rrufë në hundët e njerëzve dhe lapsi e ka të pamundur t'i shkruajë.

Është e vërtetë që themelet e qeverisë janë të mbështetur mbi masat e gjera të popullit dhe pjesëmarrja e të gjithëve në qeverisje ruan themelet e qeverisjes, por kjo nuk do të thotë se opinioni i shumicës është kriter për të vlerësuar të drejtën e të gabuarën në çdo punë e në çdo vend.

Është detyrë që rrethi mbështjellës i qeverisë të jetë e drejta dhe për të zbatuar të drejtën s'ka problem që të kërkohet ndihma e kapaciteteve të individëve të shoqërisë, madje edhe shprehja

(Republika Islamike) e përbërë prej dy fjalëve (Republika) dhe (Islamike), jep kuptimin e sipërm; me fjalë të tjera, bazat e kësaj republike janë të mbështetura në Islamin dhe zbatimi i këtyre bazave plotësohet me pjesëmarrjen e masave të popullit.

Dhe e fundit, *fjalia e pestë* thekson se çdo shmangie prej rrugës së All'llahut, nuk mund të ndahet prej harrimit të Ditës së Llogaridhënies dhe ai që e harron Ditën e Llogaridhënies, le ta dijë se atë e pret dënimi i Ashpër i All'llahut, ashtu siç njofton ajeti vijues: **"…dhe ata që i largohen Rrugës së All'llahut, kanë një dënim të ashpër, për shkak se harruan Ditën e Llogaridhënies."**.

Është normale që harrimi i Ditës së Gjykimit është burimi i shmangies prej udhëzimit në Rrugën e Drejtë, por çdo shmangie prej udhëzimit në Rrugën e Drejtë ka lidhje me harrimin. Ky parim shpjegon qartë ndikimin e madh që ka në jetën e njerëzve edukimi me interesimin për ringjalljen pas vdekjes.

Në lidhje me këtë çështje, në burimet islame kanë ardhur transmetime, ndër të cilat kemi transmetimin e mirënjohur të ardhur prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, në të cilin lexojmë fjalën e tij: *"O njerëz, ajo që unë kam më shumë frikë për ju, janë vetëm dy gjëra: ndjekja e dëshirave dhe shpresa e gjatë; ndjekja e dëshirave të nxjerr nga e vërteta, kurse shpresa e gjatë bën që të harrohet Bota Tjetër."*.[1]

Sa mirë do të ishte që këto fjalë të shkruheshin me shkronja ari dhe të viheshin para të gjithëve, veçanërisht para qeveritarëve, gjykatësve dhe njerëzve me përgjegjësi!

[1] "Nehxhul Belàga", hytbeja 42.

Në një transmetim tjetër, të ardhur prej Imam Bàkirit *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "Tre janë shkatërruese: kopracia prej atij që ka mundësi, ndjekja e dëshirave dhe pëlqimi i vetes.".[1]

Në plotësim të studimit që flet për gjendjen e Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe sundimin e tij në Tokë, ajetet vijuese trokasin mbi qëllimet e krijimit të botës së ekzistencës, që të specifikohen shkaqet e qeverisjes mbi Tokë si pjesë e botës së ekzistencës; për të gjitha këto i Larti njofton: **"Ne nuk i krijuan Qiellin, Tokën dhe ç'ka në mes këtyre të dyjave** (në mes Qiellit e Tokës) **pa qëllim, ashtu siç mendojnë mohuesit; mjerë ata që nuk besuan prej dënimit në zjarr."**.

Këtu del një çështje shumë e rëndësishme, që numërohet burim i të gjitha të vërtetave: cili është qëllimi për ekzistencën e njerëzve? Kur ne shikojmë këtë botë të gjerë, patjetër themi se All'llahu i Lartësuar nuk e ka krijuar kot këtë botë kaq të madhe dhe kërkojmë të mësojmë qëllimin prapa këtij krijimi, qëllim që mund të shprehet me fjalë të shkurtra, si: plotësim, mësim, edukim dhe prej këtej nxjerrim rezultatin se qeveritë kanë detyrim të ecin sipas kësaj linje; gjithashtu, qeveritë kanë detyrim të forcojnë bazat e edukimit të plotësimit moral të njeriut.

Me fjalë të tjera, e vërteta dhe drejtësia janë dy bazat e botës së ekzistencës dhe qeveritë kanë detyrim të punojnë në përputhje me peshoret e të vërtetës dhe drejtësisë.

Fjalia e fundit në këtë ajet, troket mbi çështjen e harrimit të Ditës së Llogaridhënies dhe në përputhje të plotë me ajetin objekt studimi, rezulton se vetë qëllimi i krijimit të botës e bën të

[1] Libri "El Khisàl", cituar prej tefsirit "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 453.

detyrueshme të mos harrohet Dita e Gjykimit dhe e dhënies llogari, ashtu siç kemi thënë më sipër, gjatë studimit të ajeteve të fundit të sures "Jàsin", në lidhje me çështjen e ringjalljes pas vdekjes: sikur të mos ishte Dita e Llogaridhënies, krijimi i njerëzve do të ishte një punë e kotë.

Fjalia e fundit e këtij ajeti, thekson linjat e qarta që ndajnë besimin prej mosbesimit dhe besimin prej rrymës ateiste, që thotë se Bota është krijuar pa qëllim. Ky ajet është shembulli më i qartë për sprovat me të cilat ne po sprovohemi sot, kur shohim se pasuesit e rrymës ateiste shpallin hapur se në krijimin e Botës s'ka as dobi e as qëllim, ose që pas këtij krijimi të shpresohet për ndonjë gjë. Ai që mendon kështu, si ka mundësi që në qeverinë e tij të zbatohet e vërteta dhe drejtësia?!

Qeveria e vetme që mundëson zbatimin e të vërtetës dhe drejtësisë, është ajo qeveri, mendimet dhe besimet e të cilës frymëzohen prej parimeve hyjnore dhe prej asaj që thotë Krijuesi i Gjithëfuqishëm se Ai nuk e ka krijuar Botën kot, por e ka krijuar për qëllime të caktuara dhe ka urdhëruar që qeveritë të ecin sipas këtyre qëllimeve. Mirëpo, sot rryma ateiste ka arritur në një rrugë pa krye në lidhje me punët e sundimit, luftës, paqes, ekonomisë e kulturës. Natyrisht që shkaku kryesor për këtë gjendje është largimi i tyre prej frymëzimit hyjnor, prandaj edhe themelet e qeverive të tyre mbështeten mbi padrejtësinë e arbitraritetin. Sa e egër dhe e frikshme do të ishte Bota sikur të bëhej që ajo të rrotullohej vetëm sipas këtij mendimi obsKur'antist!

Në të gjitha gjendjet, Krijuesi i Gjithëfuqishëm është i Urti dhe është e pamundur që Ai të krijonte këtë botë pa ndonjë qëllim. Patjetër, kjo botë është parathënia për një botë tjetër

shumë më të gjerë se bota jonë dhe ajo botë është e përhershme, e përjetshme dhe i shpjegon qëllimet e vërteta që gjenden prapa krijimit të Botës së Tokës.

Ajeti vijues shton: **"A mos do të bëjmë të barabartë ata që besuan dhe bënë punë të mira me ata që mbjellin nëpër Tokë ngatërresa e bëjnë shkatërrime, apo do t`i konsiderojmë të barabartë të devotshmit me mëkatarët?"**.[1]

Mungesa e qëllimit në krijimin e Botës numërohet prej punëve krejtësisht të pamundura. Gjithashtu, është i pamundur edhe barazimi i njerëzve të mirë me njerëzit e këqij, për faktin se grupi i njerëzve të mirë ecën në përputhje me qëllimet e krijimit të Botës, për të arritur qëllimin e lartë përfundimtar, që është plotësimi i njeriut dhe lumturia e tij; kurse grupi i njerëzve të këqij, ecën në drejtim të kundërt me rrugën që ndjekin njerëzit e mirë.

Realisht, studimi rreth ringjalljes pas vdekjes, me të gjitha përmasat që ajo ka, është trajtuar në këtë ajet dhe në ajetet e sipërme në një mënyrë të atillë, që prej këtyre ajeteve bëhet e mundur të nxirren argumente që vërtetojnë çështjen e ringjalljes pas vdekjes.

Nga njëra anë, ajeti thotë se Urtësia e Krijuesit kërkon që në krijimin e Botës të jetë një qëllim, por ky qëllim nuk mund të bëhet realitet pa ekzistencën e Botës Tjetër, sepse ditët që njeriu

[1] Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, kanë thënë se fjala pyetëse *"em"* – *"a mos"* këtu jep kuptimin *"por"*; ka edhe një mundësi tjetër, që thotë se fjala pyetëse *"em"* ka ardhur si lidhëse për një pyetje të hequr dhe sipas kësaj mundësie, vlerësimi i ajetit do të ishte: (A Ne i krijuam qiejt dhe Tokën kot, apo të barazojmë të devotshmit me mëkatarët?).

jeton në këtë botë, s'kanë asnjë vlerë në raport me qëllimin kryesor që gjendet prapa krijimit të kësaj bote kaq të gjerë.

Nga një anë tjetër, Urtësia dhe Drejtësia e Krijuesit të Gjithëfuqishëm, e bëjnë detyrim që të mos jenë të barabartë punëmiri me punëkeqin dhe i drejti me të padrejtin, prandaj, detyrimisht ekzistojnë ringjallja pas vdekjes, shpërblimi, dënimi, Xhenneti dhe Xhehennemi.

Pavarësisht nga kjo, kur shikojmë në mjedisin e shoqërisë njerëzore në këtë botë, vërejmë se mëkatari është në pozitën e besimtarit, punëkeqi qëndron përkrah punëmirit, madje shumë herë shohim se të degjeneruarit, shkatërruesit e fajtorët, e kalojnë jetën në mirëqenie dhe kanë të mira më shumë se të tjerët dhe nëse nuk ka një botë tjetër pas kësaj botës sonë, ku do të zbatohet drejtësia? Veç kësaj, mospasja e një bote tjetër tregon se gjendja e kësaj bote është në kundërshtim me "Urtësinë" dhe me "Drejtësinë". Në të vërtetë, ekzistenca e Botës Tjetër është një argument tjetër që vërteton çështjen e ringjalljes pas vdekjes.

Me fjalë të tjera, për të vërtetuar çështjen e ringjalljes pas vdekjes, disa herë vërtetuesi për këtë mund të nxirret prej argumentit të "urtësisë", herë tjetër mund të nxirret prej argumentit të "drejtësisë" dhe ajeti objekt studimi tregon vërtetimin me argumentin e "urtësisë", kurse ajeti vijues tregon vërtetimin me anë të argumentit të "drejtësisë".

Ajeti i fundit në këtë grup ajetesh të studimit tonë, thekson një çështje e cila e shpjegon më qartë të vërtetën e qëllimit të krijimit dhe për këtë ajeti i nderuar njofton: **"Libër i begatë që Ne ta shpallëm ty** (o Muhammed)**, që ata** (njerëzit) **t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të mençurit të marrin mësim prej tij."**.

Sepse udhëzimet e këtij Libri janë të përjetshme, urdhërat e tij janë me kuptime të thella dhe origjinalë, sistemet e këtij Libri janë motive për jetën dhe udhëzues për njeriun që ai të ecë në rrugën që çon në zbulimin e qëllimit të Krijuesit.

Edhe qëllimi i zbritjes së këtij Libri Famëlartë, nuk reduktohet vetëm me faktin që ai të lexohet dhe që gjuha të lakojë fjalët e tij. Jo, ky Libër zbriti që argumentet e tij të jenë burim për mendim e përsiatje, shkak për ndërgjegjësimin e njeriut dhe që me anë të këtij Libri të marrë gjallëri lëvizja në rrjedhën e punëve.

Fjala e ajetit *"mubàrekun"*, do të thotë: Një send me të mira të përhershme dhe të vazhdueshme. Në këtë ajet, theksohet përfitimi i vazhdueshëm që ka shoqëria njerëzore prej direktivave të këtij Libri; gjithashtu, fakti që kjo fjalë ka ardhur e pashquar, tregon se në këtë fjalë përfshihet çdo e mirë e lumturi në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

Thelbi i fjalës është: Çdo e mirë e çdo begati gjendet në Kur'ànin Famëlartë, me kushtin që ne të studiojmë argumentet e këtij Libri, që në punën tonë të frymëzohemi prej ajeteve të këtij Libri.

Dy hulumtime

1- Devotshmëria përballë mëkateve

Në ajetet objekt studimi, degjenerimi, shkatërimi e ngatërresat janë vënë përballë besimit dhe punës së mirë, kurse mëkati (grisja e perdes së fesë) është vënë përballë devotshmërisë e nënshtrimit.

Vallë, a shpjegojnë këto të dyja, domethënë degjenerimi e shkatërrimi nga njëra anë dhe përkushtimi e puna e mirë, nga ana tjetër, një të vërtetë të vetme në dy shprehje, apo të dyja shpjegojnë dy çështje? Nuk përjashtohet që të dyja të theksojnë një kuptim të vetëm, sepse "të përkushtuarit" janë besimtarët që bëjnë punë të mira, kurse "mëkatarët" janë ata që bëjnë shkatërrime e mbjellin ngatërresa në Tokë.

Ka mundësi që fjalia e parë të tregojë anët praktike dhe anët e besimit të të dyja palëve, kur bën krahasim në mes njerëzve me besim të shëndoshë e punëmirë dhe në mes njerëzve me besim të prishur e punëkëqij, në një kohë që fjalia e dytë thekson vetëm anët praktike.

Gjitashtu, ka mundësi që (përkushtimi e mëkatet) të dëshmojnë plotësimin dhe mangësinë e njeriut, kurse puna e mirë dhe shkatërrimi e ngatërresat në Tokë dëshmojnë anët shoqërore, por përforcimi që ka ardhur në këto dy shprehje është më shumë në përshtatje me kuptimin e fjalëve të ajetit.

2- Në një transmetim që shpjegon fjalën e të Lartit: **"ata që besuan dhe bënë punë të mira"**, thuhet: *"Qëllimi këtu është për*

Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!) dhe për pasuesit e tij. Kurse me pjesën tjetër të ajetit **"ata që mbjellin nëpër Tokë ngatërresa e bëjnë shkatërrime"**, *tregon se qëllimi është për armiqtë e tij."*.[1]

Në një transmetim tjetër, të cituar prej Ibni Asakirit, të ardhur prej Ibni Ab'bàsit, thuhet se qëllimi në ajetin **"ata që besuan"** janë: Aliu, Hamzai dhe Ubejdeh, të cilët, në luftën e Bedrit u përballën në duel me Utbeh, Velidin dhe Shejbeh, që simbolizojnë ushtrinë e mohuesve e të idhujtarëve (Tre të parët i vranë tre të fundit në sheshin e betejës), prandaj Utbeh, Velidi dhe Shejbeh janë qëllimi në fjalën e të Lartit **"...ata që mbjellin nëpër Tokë ngatërresa e bëjnë shkatërrime."**.[2]

Prej kuptimit që shprehin këto transmetime, është e qartë se kuptimi i ajetit nuk mund të reduktohet në individë të veçantë, por shpjegojnë se ata mund të jenë shkaku i zbritjes së këtij ajeti, ose ata janë një kriter i qartë e i dallueshëm, me të cilin vërtetohet kuptimi i ajetit të nderuar.

[1] Tefsiri "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 37.
[2] Tefsiri "Rùhul Meànij", vëll. 23, f. 171.

Ajetet: 30 – 33

وَوَهَبۡنَا لِدَاوُۥدَ سُلَيۡمَٰنَۚ نِعۡمَ ٱلۡعَبۡدُۖ إِنَّهُۥٓ أَوَّابٞ ٣٠ إِذۡ عُرِضَ عَلَيۡهِ
بِٱلۡعَشِيِّ ٱلصَّٰفِنَٰتُ ٱلۡجِيَادُ ٣١ فَقَالَ إِنِّيٓ أَحۡبَبۡتُ حُبَّ ٱلۡخَيۡرِ عَن ذِكۡرِ
رَبِّي حَتَّىٰ تَوَارَتۡ بِٱلۡحِجَابِ ٣٢ رُدُّوهَا عَلَيَّۖ فَطَفِقَ مَسۡحَۢا بِٱلسُّوقِ
وَٱلۡأَعۡنَاقِ ٣٣

"Ne i dhuruam Dàùdit Sulejmanin, sa rob i mirë; ai kthehet shumë kah Zoti (kërkon prej Tij mëshirë dhe faljen e mëkateve)**."**

"Kur atij iu shfaqën në një pragmbrëmje kuajt në qëndrim gatitu me tri këmbët dhe ishin shumë të shpejtë."

"Ai (Sulejmàni) **tha: unë i dhashë përparësi dashurisë** (për kuajt) **nga që dua të përmend Zotin tim, derisa dielli u fsheh pas perdes** (perëndoi)**."**

"M'i ktheni ato mua; dhe filloi t'u lëmojë (kuajve) **këmbët e qafat."**

Komentimi

Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* inspekton forcat e tij luftarake

Edhe këto ajete vazhdojnë studimin e mëparshëm rreth *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Ajeti i parë njofton se Dàùdi mori përgëzimin se atij do t'i dhurohej një djalë i mirë, Sulejmani *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe se ky djalë, pas tij do të marrë në dorë jo vetëm pushtetin, por ai do të mbajë edhe barrën e rëndë të kumtit; për këtë ajeti njofton: **"Ne i dhuruam Dàùdit Sulejmanin, sa rob i mirë; ai kthehet shumë kah Zoti** (kërkon prej Tij mëshirë dhe faljen e mëkateve)**."**.

Kjo fjali e ajetit të nderuar shpjegon qartë pozitën e lartë të Sulejmanit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Ajo mund të jetë një përgjigje për të hedhur poshtë akuzat e këqija e të rreme që thuhen në Teuràtin e revizionuar për Sulejmanin, rreth lindjes së tij prej gruas së Eurij'jas, e cila ishte shumë e njohur në shoqëri edhe para zbritjes së Kur'ànit.

Nga njëra anë, shprehja*"uehebnà"* – **"Ne i dhuruam"** dhe nga ana tjetër shprehja *"ni'mel abdu"* – **"sa rob i mire"** si dhe shpjegimi *"in'nehù eu'uàbun"* – **"ai kthehet shumë kah Zoti** (kërkon prej Tij mëshirë dhe faljen e mëkateve)**"**, të gjitha këto tregojnë se ai ishte njeri i bindur ndaj All'llahut dhe i përvetësonte urdhërat e Tij; gjithashtu, ai i kërkonte Krijuesit të Gjithëfuqishëm faljen e fajit menjëherë, pas çdo shkujdesjeje ose shkarjeje; nga një

anë e tretë, të gjitha këto tregojnë pozitën e lartë të këtij Profeti të madh.

Shprehja *"in'nehù eu'uàbun"* – **"ai kthehet shumë kah Zoti** (kërkon prej Tij mëshirë dhe faljen e mëkateve)**"**, në gramatikën e gjuhës arabe është mbiemër cilësor në shkallën sipërore, do të thotë sa shumë kthehej ai te Zoti i tij, por këtu kthimi është në kuptimin: kthim në bindje të urdhërit hyjnor, kthim te e vërteta e drejtësia, kthim prej shkujdesjes dhe lënies së punës me më shumë përparësi.

Ajeti vijues fillon me tregimin për kuajt e Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* por ky tregim është interpretuar në mënyra të ndryshme, madje disa e kanë interpretuar në një mënyrë të keqe dhe në kundërshtim me peshoren e logjikës. Ky lloj interpretimi është krejtësisht gabim edhe kur bëhet për një njeri të zakonshëm, prandaj, me të drejtë, njerëzit me mendje në kokë, të pyesin: Si është e mundur që ato fjalë të padenja të thuhen për një Profet të madh si Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Por studiuesit, me studimet e tyre, të mbështetura në argumente logjikë dhe në tekst, e kanë mbyllur rrugën para të këtilla interpretimesh dhe para se të futemi te hamendjet e ndyshme që janë thënë. Do të komentojmë ajetet, sipas kuptimit që shprehin fjalët e vetë ajeteve, me qëllim që të bëjmë të qartë se, në Kur'ànin Famëlartë, nuk ka vend për të këtilla mëtime të rreme e të falsifikura, që janë thënë prej të tjerëve në adresë të Kur'ànit Famëlartë.

Kur'àni Famëlartë njofton: **"Kur atij iu shfaqën në një pragmbrëmje kuajt në qëndrim gatitu me tri këmbët dhe ishin shumë të shpejtë."**.

Fjala *"sàfinàt"* është shumës i fjalës *"sàfinetun"*, për të cilën shumica e gjuhëtarëve të dëgjuar dhe interpretuesve të mëdhenj të Kur'ànit, kanë thënë se kjo fjalë thuhet për kuajt kur qëndrojnë me tri këmbë dhe ngrenë pak prej tokës njërën prej dy këmbëve të para, nga ana e thundrës. Kjo është gjendja e veçantë për kuajt e racës së pastër dhe është një shenjë që tregon se janë të gatshëm të lëvizin në çdo çast.[1]

Fjala e ajetit *"xhijàd"* është shumësi i fjalës *"xheu'uàd"* dhe do të thotë: kuaj të shpejtë në ecje dhe fjala *"xhijàd"*, në rrënjën e saj *"xhùd"*, do të thotë: bujari; por bujaria te njeriu do të thotë: shpenzim pasurie, kurse te kuajt do të thotë: shpejtësi në ecje. Me këtë shpjegim, kuajt e përmendur në këtë ajet duken se janë në gatishmëri të plotë për të lëvizur edhe kur kanë ndaluar; gjithashtu, kjo fjalë tregon se janë kuaj shumë të shpejtë në vrapim.

Prej këtij ajeti dhe prej krahasimit me ajetet para dhe prapa këtij ajeti, zbulohet se një mbasdite, Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* inspektoi kuajt e tij të racës që ai kishte përgatitur për luftën e tij kundër armiqve të All'llahut; kuajt së bashku me kalorësit parakalonin para Sulejmànit në formacion të rregullt dhe si mbret i drejtë e me shumë ndikim, ishte detyra e tij që të kishte një ushtri të fortë dhe kuaj të shpejtë, që patjetër duhej të ishin me shumicë në ushtrinë e tij. Ky përshkrim në Kur'ànin Famëlartë,

[1] Disa mendojnë se fjala **"صَافِنَات"** *"sàfinàt"* përdoret për gjininë mashkullore dhe për gjininë femërore, prandaj kjo fjalë në këtë ajet nuk tregon vetëm pelat.

vjen pasi është përmendur pozita e lartë e Sulejmànit duke marrë parasysh se ai është model që duhet ndjekur në punët e tij.

Dhe që Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të largonte nga mendja e të tjerëve se dashuria e tij e madhe për kuajt ishte për shkak se ai kishte dashuri të madhe për sendet e kësaj bote, i Larti, me fjalën e Tij njofton: **"Ai** (Sulejmàni) **tha: unë i dhashë përparësi dashurisë** (për kuajt) **nga që dua të përmend Zotin tim"**, domethënë: unë i dua këta kuaj për hir të All'llahut, kam dashuri për kuajt që të zbatoj urdhërat e All'llahut dhe që të përfitoj prej këtyre kuajve në luftën kundër armiqve.

Në transmetimet islame ka ardhur se arabët kuajt i quanin me fjalën *"khajr"* – *"mirësi"* dhe në një hadith të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë se ai ka thënë: *"E mira është e lidhur me krifat e kuajve deri Ditën e Kiametit."*.[1]

Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* vazhdoi të shikonte në kuajt e tij të racës së pastër të përgatitur për të luftuar armiqtë e All'llahut dhe po përjetonte çaste gëzimi, derisa kuajt u zhdukën prej shikimit të tij: **"...derisa dielli u fsheh pas perdes** (perëndoi)**."**.

Ishte një pamje e bukur dhe e ëmbël për një komandant të madh si Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* aq sa ai urdhëroi që kuajt të parakalonin edhe një herë tjetër para tij: **"M'i ktheni ata mua..."** dhe pasi urdhërat e tij u zbatuan për kthimin e

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", fundi i ajetit objekt studimi. Disa kanë thënë se fjala *"khajr"* – *"e mirë"* në këtë ajet është në kuptimin e pasurisë, ose të pasurisë së shumtë. Edhe ky interpretim mund të përputhet me interpretimin e sipërm, sepse pasuria këtu janë edhe kuajt

kuajve, Sulejmàni filloi t'u lëmojë kuajve këmbët e qafat: **"...dhe filloi t'u lëmojë** (kuajve) **këmbët e qafat."**.

Me këtë gjest, ai lavdëronte punën e stërvitësve të atyre kuajve dhe u shprehte atyre vlerësimet e tij për punën e mirë që ata kishin bërë. Është e natyrshme se ai që shpreh vlerësimin e tij për kuajt, ai u lëmon kuajve kokat, fytyrat, qafat, krifën e qafës, ose u lëmon këmbët. Me këto gjeste, Sulejmani *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* tregonte lidhjen e fuqishme që kishte me kuajt e tij, që i kishte përgatitur për të realizuar qëllimet e tij të larta. Lidhja që kishte Sulejmàni me kuajt e tij, në të vërtetë shkakton çudi.

Fjala *"tafika"*, në terminologjinë e gjuhëtarëve që merren me sintaksën e gjuhës arabe, thonë se kjo fjalë është prej foljeve krahasuese dhe vjen në kuptimin: *"ai filloi"*.

Fjala *"sùk"*, është shumësi i fjalës *"sàk"* – *"kërciri i këmbës"*, kurse fjala tjetër e ajetit *"a'nàk"*, është shumësi i fjalës *"unuk"* – *"qafë"* dhe kuptimi i ajetit është: Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* filloi t'u lëmojë kuajve këmbët e qafat.

Kjo që thamë në lidhje me komentin e këtij ajeti, përputhet me atë që kanë thënë disa interpretues të Kur'ànit, si, për shembull, Fakhru Rràzij dhe dijetari Sej'jid El Murtedà, i cili, në librin e tij "Tenzijhul Enbijà", në kapitullin "Hedhja poshtë e mëtimeve të gabuara", që disa interpretues të Kur'ànit dhe disa përcjellës transmetimesh kanë thënë në adresë të Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Në një kohë kur All'llahu i Lartësuar e fillon ajetin me lavdërimin e tij dhe thotë: **"...sa rob i mirë; ai kthehet shumë kah Zoti** (kërkon prej Tij mëshirë dhe faljen e mëkateve)**"**, është e pamundur që, pasi e ka lavdëruar me këto

fjalë dhe pastaj pa vënë asnjë presje, të thotë fjalë të këqija në adresë të tij. Dukej sikur ai i jepte përparësi dëfrimit me parakalimin e kuajve para tij, më shumë se faljes së namazit, por nga ajo që tregojnë fjalët e ajeteve, kuptohet qartë se dashuria e tij e madhe për kuajt ishte me urdhërin e me lejen e Zotit të tij dhe që vazhdimisht ia kujtonte kujdesin që duhet të tregonte për kuajt, sepse All'llahu i Lartësuar na ka urdhëruar të kemi lidhje të fuqishme me kuajt dhe t'i përgatisim kuajt për të luftuar armiqtë; prandaj, nuk mund të përjashtohet që edhe Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte urdhëruar që të kishte dashuri të veçantë për kuajt.[1]

Kurse dijetari El Mexhlisij, në librin e tij "Bihàrul Enuàr", kapitulli "Profetsia", ka bërë një interpretim të këtyre ajeteve që është i ngjashëm me atë që thamë më sipër.[2]

Në të gjitha gjendjet, sipas këtij interpretimi rezulton se prej Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* nuk ka dalë asnjë faj, në renditjen e ajeteve s'ka asgjë që të tregojë ndonjë parregullsi në veprimet e Dàùdit apo Sulejmanit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe në përmbajtjen e këtyre ajeteve në lidhje këtë Profet të madh, nuk dallohet asnjë problem që mbetet për ta shpjeguar.[3]

Tani do të shfletojmë disa komente të bëra prej disa intrepretuesve të Kur'ànit Famëlartë, në lidhje me interpretimin e këtyre e ajeteve dhe interpretimi që ka më shumë përhapje thotë

[1] "Tenzijhul Enbijà", f. 92.
[2] "Bihàrul Enuàr", vëll. 14, f. 104.
[3] Sipas këtij interpretimi, përemri "*ato*", në të dyja shprehjet, "*teuàret*" dhe "*rud'dùhà*" – "*i ktheni ato*" u referohet kuajve të stërvitur të racës së pastër **"…kuajt në qëndrim gatitu me tri këmbët dhe ishin shumë të shpejtë."**.

se përemri në dy shprehjet *"teuàret"* – **"u fshehën prej syve"** dhe *"rud'dùhà"* – **"i ktheni ato"** i referohet Diellit, që nuk është përmendur tekstualisht në këto ajete, por ata argumentin për këtë thënie e kanë nxjerrë prej fjalës së ajetit objekt studimi *"el ashij'ji"*, që do të thotë: *"koha e fundit të ditës"*, para perëndimit të diellit.

Sipas këtij interpretimi, këto ajete japin kuptimin vijues: Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte i përqendruar në parakalimin e kuajve, ndërkaq dielli perëndoi dhe u fsheh prapa perdes së horizontit dhe Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kur pa që dielli perëndoi, u zemërua shumë, për shkak se ai ende nuk kishte falur namazin e mbasditës (iqindisë). Ai iu lut engjëjve të All'llahut që të kthenin diellin. Engjëjt iu përgjegjën lutjes së tij dhe e kthyen diellin, domethënë e kthyen sipër horizontit, atëherë Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* mori abdes (qëllimi me frazën "u lëmoi këmbët e qafat", ishte marrja e avdesit sipas ligjit të fesë me të cilën kishte ardhur Sulejmàni. Dihet që fjala *"el mes'hu"* – *"lëmim me dorë"* disa herë, në të folurën e arabëve përdoret në kuptimin e larjes së trupit *gusl*") dhe pastaj ai fali namazin.

Disa të tjerë, që nuk kanë informacion të mjaftueshëm, kanë thënë edhe më shumë se kaq, madje kanë thënë shumë fjalë të këqija, për punë të ndaluara rreptësisht, që gjoja i paska bërë ky Profet i madh, kurse frazën e ajetit **"…dhe filloi t'u lëmojë** (kuajve) **këmbët e qafat"** e kanë interpretuar: ai filloi të godasë me shpatë këmbët e qafat e kuajve, ose këtë veprim ai e bëri me mendjen e tij për shkak se kuajt u bënë shkak që ai të vonojë përmendjen e All'llahut dhe faljen e namazit.

Natyrisht që pavlefshmëria e interpretimit të fundit nuk është e panjohur për asnjë njeri, sepse kuajt s'kishin bërë asnjë faj që ata t'i vriste me shpatë Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* por edhe sikur në këtë ndodhi të kishte ndonjë faj, ishte vetë ai që e kishte bërë atë faj, sepse ai ishte i përqendruar në shikimin e kuajve të tij dhe kështu harroi faljen e namazit.

Kuptohet që vrasja e kuajve është shpërdorim i tejskajshëm, pa thënë se është një krim i mirëfilltë; por, si është e mundur që një punë kaq pa kuptim të dalë prej një Profeti?! Transmetimet islame të ardhura në burimet islame në lidhje me këtë ajet, i hedhin poshtë fuqishëm këto akuza të hedhura në adresë të Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Përsa u përket interpretimeve të mësipërme, që flisnin për harresën e Sulejmanit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe për shkujdesjen e tij ndaj faljes së namazit të mbasditës, këto çështje nxjerrin pyetjen vijuese: A ka mundësi që një Profet, i cili siç dihet është i ruajtur prej gabimeve, të harrojë dhe të mos plotësojë një detyrë me të cilën është urdhëruar ta plotësojë? Pavarësisht sa i zënë ishte ai për të inspektuar parakalimin e kuajve, para tij ishte një detyrë kryesore, me të cilën ai ishte ngarkuar ta kryente, megjithëse harresa e tij nuk shkakton asnjë problem, pasi ai namaz mund të ishte namaz i vullnetshëm (nàfile), prandaj nuk ishte e domosdoshme të kthehej dielli.

Kur ne themi se me këtë çështje mbaruam, këtu ka edhe disa probleme të tjera që kanë ardhur në lidhje me këtë interpretim:

1- Fjala "diell" nuk është përmendur qartësisht në këto ajete, në një kohë që kuajt **"...kuajt në qëndrim gatitu me tri**

këmbët dhe ishin shumë të shpejtë" është shprehur fare qartë. Prandaj ne e shikojmë plotësisht të përshtatshme që përemri t'i adresohet asaj fjale që është përmendur qartë në këto ajete.

2- Fraza **"nga që dua të përmend Zotin tim"**; fjalët e kësaj fraze të ajetit janë në kuptimin: dashuria ime për kuajt ka lindur prej përmendjes së All'llahut dhe në bindje të urdhërave të Tij; në një kohë që interpretimi i fundit, parafjalën *"an"* – *"prej"* e vë në kuptimin e ndajfoljes *"alà"* – *"mbi, sipër"* dhe sipas këtij interpretimi, kuptimi i frazës është: unë parapëlqeva dashurinë për kuajt më shumë se dashurinë për Zotin tim. Shihet qartë që ky interpretim është në kundërshtim të plotë me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit.

3- Por edhe më i çuditshëm se kjo është interpretimi që ata i kanë bërë frazës se ajetit objekt studimi: **"M'i ktheni ato mua."**. Kjo në vetvete mbart cilësinë e punës, kurse ata thonë se me këtë frazë urdhër ai i drejtohet All'llahut të Gjithëfuqishëm, ose engjëjve; por, si ka mundësi që Sulejmani *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* t'i drejtohet Krijuesit të Gjithëfuqishëm ose engjëjve me një frazë urdhërore dhe t'u thotë: ma ktheni diellin, ashtu siç mund t'u thoshte skllevërve e shërbyesve të tij?!

4- Çështja e kthimit të diellit, megjithëse për fuqinë e All'llahut të Gjithëfuqishëm numërohet një punë fare e lehtë, përsëri ndeshet me disa probleme, që e bëjnë një punë të papranueshme, pa pasur argumente të qartë që të vërtetojnë kërkesën e tij.

5- Ajetet e sipërme fillojnë me lavdërim e glorifikim për Sulejmànin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në një kohë që

interpretimi i fundit, i jep ajetit një kuptim poshtërimi e përbuzjeje për atë.

6- Nëse namazi i lënë ishte prej namazeve të detyrueshme, atëherë gjetja e justifikimit për këtë lënie namazi është një punë shumë e vështirë, por nëse ishte namaz i vullnetshëm, atëherë s'ka arsye për të kthyer diellin.

Pyetja e vetme që ka mbetur këtu, është se ky interpretim ka ardhur në disa transmetime, por nëse do të studiojmë me imtësi në mbështetësit e këtyre transmetimeve, bëhet e qartë se ato transmetime të gjitha janë të kategorisë "me mbështetës të konsideruar të besueshëm"; veç kësaj, pjesa më e madhe e kësaj kategorie transmetimesh rezulton se janë transemetime të stisura (të shkallës "meudùah").

A nuk do të ishte më mirë që, të këtilla transmetime jo të besueshme të mos shikohen dhe dituria në lidhje me të këtilla transmetime të lihet në dorën e dijetarëve që merren me vërtetimin e shkallës së saktësisë së transmetimeve dhe në vend të këtyre transmetimeve të pranojmë transmetimet që i shpjegojnë fjalët e këtyre ajeteve me një logjikë të kulluar e me fjalë të qarta, pasi kështu do të qetësojmë shpirtrat tanë prej barrës së problemeve të kota!

Ajetet: 34 – 40

وَلَقَدْ فَتَنَّا سُلَيْمَـٰنَ وَأَلْقَيْنَا عَلَىٰ كُرْسِيِّهِۦ جَسَدًا ثُمَّ أَنَابَ ﴿٣٤﴾ قَالَ رَبِّ
ٱغْفِرْ لِى وَهَبْ لِى مُلْكًا لَّا يَنۢبَغِى لِأَحَدٍ مِّنۢ بَعْدِىٓ ۖ إِنَّكَ أَنتَ ٱلْوَهَّابُ
﴿٣٥﴾ فَسَخَّرْنَا لَهُ ٱلرِّيحَ تَجْرِى بِأَمْرِهِۦ رُخَآءً حَيْثُ أَصَابَ ﴿٣٦﴾
وَٱلشَّيَـٰطِينَ كُلَّ بَنَّآءٍ وَغَوَّاصٍ ﴿٣٧﴾ وَءَاخَرِينَ مُقَرَّنِينَ فِى ٱلْأَصْفَادِ ﴿٣٨﴾
هَـٰذَا عَطَآؤُنَا فَٱمْنُنْ أَوْ أَمْسِكْ بِغَيْرِ حِسَابٍ ﴿٣٩﴾ وَإِنَّ لَهُۥ عِندَنَا لَزُلْفَىٰ
وَحُسْنَ مَـَٔابٍ ﴿٤٠﴾

"Ne e sprovuam Sulejmànin dhe e hodhëm në poltronën e tij si një trup (pa jetë) **dhe më pas ai u kthye** (në gjendjen e parë)**."**

"Ai (Sulejmàni) **tha: Zoti im, më fal fajin dhe më dhuro një pushtet të atillë që të mos e ketë askush pas meje; vetëm Ti je Dhuruesi më i madh."**

"Ne nënshtruam erën që të fryjë me urdhërin e tij (Sulejmànit) **nga ajo anë që ai dëshiron."**

"(Ne nënshtruam për atë) **edhe djajtë, çdo ndërtues e zhytës** (në ujë)**."**

"Dhe të tjerë (djaj) **të lidhur në pranga."**

"Kjo është dhënie nga ana Jonë, kurse ti jep ose nuk jep, nuk ke përgjegjësi."

"Me të vërtetë ai (Sulejmani) **te Ne është shumë i afërt dhe ka të ardhme të mirë."**

Komentimi

Provimi i vështirë për Sulejmànin dhe pushteti i Tij i madh

Ky grup ajetesh vazhdon tregimin rreth Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe flet për disa ngjarje të tjera që i ndodhën atij; njëkohësisht, këto ajete bëjnë të qartë se njeriu, pavarësisht sa fuqi e kapacitete ka në dorë, në të vërtetë nuk i ka prej vetes së tij, por çdo gjë që ka njeriu, ato i ka vetëm prej All'llahut të Lartësuar. Kjo temë e zhduk atë perden e kapardisjes e të shpërfilljes prej syrit të njeriut dhe e bën njeriun me vëllim kaq të vogël, të ndjejë se ai është matës i Gjithësisë.

Pjesa e parë e ajeteve flet për provimet me të cilat All'llahu i Lartësuar e provoi robin e Tij Sulejmànin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, provim për shkak të lënies së punës me më shumë përparësi; gjithashtu, në këto ajete tregohet se, pas këtij provimi, Sulejmàni iu drejtua All'llahut të Lartësuar me zemër të

nënshtruar, duke i kërkuar falje për fajin që bëri dhe faji i tij ishte se ai kishte lënë pa bërë punën me më shumë përparësi.

Përmbajtja e përmbledhur e këtyre ajeteve, u ka mundësuar endësve të tregimeve të përfytyruara që të endin tregime të trilluara dhe të hedhin akuza kundër këtij Profeti të madh, akuza që nuk mund të thuhen për profetninë dhe që janë në kundërshtim me pozitën e Profetëve, të cilët, siç dihet, janë të ruajtur prej fajeve; veç kësaj, të gjitha akuzat e tyre janë në kundërshtim edhe me logjikën. Në të vërtetë, këto akuza, në vetvete janë një provim për hulumtuesit e shkencave kur'anore. Sikur ne të mjaftoheshim me ato që shtrojnë ajetet e Kur'ànit Famëlartë, pa dyshim që nuk do të kishte mbetur asnjë plasaritje për depërtimin e këtyre miteve e trillimeve.

Ajeti i parë i studimit tonë thotë:

"Ne e sprovuam Sulejmànin dhe e hodhëm në poltronën e tij si një trup (pa jetë) **dhe më pas ai u kthye** (në gjendjen e parë)**."**

Fjala e ajetit *"el kursij"*, do të thotë: kolltuk me këmbë të shkurtra dhe me sa duket, ishte një lloj kolltuku që në atë kohë përdorej prej sundimtarëve. Ishin dy llojesh kolltuqet; lloji i parë ishte me këmbë të shkurtra dhe përdorej në kohët e zakonshme, kurse lloji i dytë, ishte me këmbë më të gjata dhe sundimtarët e përdornin në mbledhjet zyrtare. Në gjuhën arabe, lloji i parë quhet *"el kursij"* – *"kolltuk"*, kurse për llojin e dytë përdoret fjala *"arsh"* – *"fron"*.

Fjala e ajetit *"el xhesed"* do të thotë: *"trup pa shpirt"*, kurse Ràgibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", shpjegon se fjala *"el xhesed"* ka një kuptim shumë më të

kufizuar se kuptimi që ka fjala *"el xhism"* – *"trup"*; fjala *"el xhesed"* përdoret për të treguar trupin e njeriut, por në raste të rralla përdoret për të treguar edhe trupa të tjerë; kurse fjala *"el xhism"* – *"trup"* ka karakter përgjithësues.

Në përgjithësi, prej këtyre ajeteve mësohet se provimi i Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte me anën e një trupi pa jetë që u hodh mbi kolltukun e tij, para syve të tij; ishte diçka që ai nuk e kishte parashikur; veç kësaj, shpresat e tij ishin të lidhura me një send tjetër, por Kur'àni Famëlartë nuk jep hollësira në lidhje me këtë çështje.

Interpretuesit e Kur'ànit dhe dijetarët e shkencës së hadithit, kanë sjellë disa interpretime në lidhje me këtë fushë dhe më i parapëlqyeri e më i qarti është interpretimi vijues:

Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte martuar me shumë gra dhe shpresonte që prej atyre të kishte djem të mirë e trima, që do ta ndihmonin atë në administrimin e punëve të vendit dhe në luftë kundër armiqve. Njëherë po fliste me vete e tha: do të fle me të gjitha gratë e mia, që të kem aq djem sa është numri i grave dhe shpresoj që ata djem do të më ndihmojnë në realizimin e objektivave që kam; por, meqenëse ai nuk pati kujdesin që pas bisedës me veten e vet të thoshte shprehjen *"in shàell'llàh"* - *"me dashjen e All'llahut"*, shprehje që tregon se njeriu në të gjitha punët e në të gjitha gjendjet e tij duhet të mbështetet vetëm në All'llahun e Gjithëfuqishëm, atij i lindi vetëm një djalë i vdekur e i paformuar dhe ishte ky trup pa jetë që u hodh mbi kolltukun e Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Këtu Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u zhyt në mendime dhe ndjeu dhimbje të fortë, për shkak se kishte qenë i

shkujdesur kur, vetëm për një çast, nuk qe i vëmendshëm të mbështetej në All'llahun e Gjithëfuqishëm dhe u mbështet vetëm në fuqinë e tij; por ai menjëherë u kthye te All'llahu i penduar dhe i kërkoi faljen e fajit.

Është edhe një interpretim tjetër, që mund të jetë shtruar pas interpretimit të parë, në të cilin thuhet: All'llahu i Lartësuar e sprovoi Sulejmànin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* me një sëmundje të rëndë dhe nga ajo sëmundje ai u dobësua aq shumë, sa në shtratin e tij, ku ishte shtrirë, dukej si një trup pa jetë. Shprehja **"trup pa shpirt"** është e zakonshme dhe lakohet në të folurën e arabëve kur duan të thonë për njeriun e pafuqishëm e të sëmurë.

Më në fund, Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u kthye i penduar te All'llahu i Lartësuar dhe i kërkoi të Lartit faljen e fajit. Pas këtij pendimi, Krijuesi i Gjithëfuqishëm ia riktheu shëndetin dhe ai u bë siç ishte para se të sëmurej (Këtu, qëllimi me fjalën *"enàbe"*, është në kuptimin: rikthimi i shëndetit dhe shërimi i tij).

Natyrisht që, në këtë interpretim ka problem, sepse shprehja *"el kajnà"* duhet të vinte e shoqëruar me përemrin vetor *"hu"* në fund dhe shprehja do të ishte *"el kajnàhu"*, që do të thotë: *"Ne e hodhëm atë"*, pasi vetëm kështu kjo shprehje do të ishte në përshtatje me interpretimin e sipërm dhe kuptimi do të ishte: Ne e hodhëm Sulejmànin mbi kolltukun e tij si një trup pa jetë; në një kohë që kjo shprehje, në ajetin objekt studimi nuk ka ardhur me këtë formë, prandaj vlerësimi sipas këtij interpretimi, është në kundërshtim me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit

Edhe fjala *"enàbe" – "u kthye"* në këtë interpretim ka ardhur në kuptimin e kthimit të shëndetit dhe të shërimit të tij; por edhe ky interpretim gjithashtu është në kundërshtim me atë që shprehin fjalët e ajetit; por, nëse ne e konsiderojmë se fjala *"enàbe" – "u kthye"* është në kuptimin e pendimit (teube) dhe kthimit te All'llahu, atëherë interpretimit nuk i vjen asnjë dëm, prandaj sendi i vetëm që është në kundërshtim me atë që shprehin fjalët e ajetit, është thjesht heqja e përemrit prej shprehjes "Ne e hodhëm".

Tregimet e këqija, që flasin për humbjen e unazës së Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe gjetja e saj prej një djalli, si dhe ulja e atij djalli mbi fronin e Sulejmànit ashtu siç thuhet në disa libra, nuk përjashtohet që burimi për të këtilla thënie të jetë libri i jehudive "Talmùdi", që është i mbushur me mite e me trillime, që në terminologjinë islame quhen "israilijate", të cilat, në asnjë rast nuk janë në përshtatje me logjikën.

Në të vërtetë, të këtilla tregime janë argument që vërtetojnë degjenerimin moral të mendimeve të thurësve të këtyre lloj tregimesh, prandaj, dijetarët myslimanë, kudo që këto tregime janë përmendur, janë shprehur qartë dhe kanë thënë se janë tregime të rreme dhe janë thjesht stisje; gjithashtu, kanë thënë se pozita e profetnisë dhe e qeverisë hyjnore nuk ka lidhje me unazën dhe All'llahu i Lartësuar nuk ia ka hequr profetninë asnjërit prej Profetëve pasi e kishte ngarkuar me detyrën e profetnisë dhe jo më të dërgonte djallin në fytyrën e një Profeti, që të ulej dyzet ditë në vendin ku ulej Sulejmàni *(Paqja e All'llahut*

qoftë mbi të!) dhe ky djall të gjykonte gjatë atyre ditëve punët që kishin njerëzit në mesin e tyre.[1]

Në të gjitha gjendjet, Kur'àni Famëlartë, me anë të ajetit vijues, e përsërit bisedën në mënyrë të hollësishme rreth çështjes së pendimit (teubes) së Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe pendimi i tij vjen menjëherë pas ajetit të sipërm: **"Ai** (Sulejmàni) **tha: Zoti im, më fal fajin dhe më dhuro një pushtet të atillë që të mos e ketë askush pas meje; vetëm Ti je Dhuruesi më i madh."**.

A shihet kopraci në kërkesën e Sulejmànit? *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*

Interpretuesit e Kur'ànit Famëlartë, kanë përmendur shumë përgjigje për këtë pyetje; shumë prej tyre kanë dhënë përgjigje që nuk përputhen me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit dhe përgjigja, që duket në përshtatje me logjikën më shumë se interpretimet e tjera, është: Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i kërkoi Krijuesit të Gjithëfuqishëm që t'i dhuronte atij një pushtet të shoqëruar me mrekulli të veçanta, me qëllim që pushteti i tij të dallohej prej pushteteve të të tjerëve. Ne dimë se çdo Profet ka një mrekulli të veçantë. Shkopi dhe dora e bardhë ishin mrekulli të Mùsait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Mrekullia e Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte mosdjegia e tij në zjarr, kur ai u flak në mesin e zjarrit. Deveja ishte mrekullia e veçantë për Sàlihun *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Kur'àni

[1] Për më shumë shpjegime që librat e jehudive janë burimi i të këtilla miteve, lexo librin "A'làmul Kur'àn", kapitulli "Sulejmàni në tregimet", f. 392.

Famëlartë është mrekullia e Profetit më të nderuar, Muhammedit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* por edhe pushteti i Sulejmanit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte i shoqëruar me mrekulli hyjnore. All'llahu i Gjithëfuqishëm vuri në dispozicion të tij erën që frynte nga ajo anë që ai dëshironte dhe vetëm një lëvizje e asaj ere ishte e barabartë me largësinë e një rruge që përshkohet për një muaj kohë; gjithashtu, All'llahu i Lartësuar vuri në dispozicion të tij djajtë, çdo djall ndërtues e çdo djall zhytës në ujë, gjithashtu, i Larti i mësoi atij gjuhët e shpezëve dhe i dha atij mundësi të mëdha në Tokë. Në kohën e tij dhe pas tij, njerëzit mësuan se pushteti i tij nuk ishte i ngjashëm me pushtetin e mbretërve të zgjedhur qysh më përpara dhe të mbretërve që e kishin rrëmbyer pushtetin me dhunë.

I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*All'llahu e mëshiroftë vëllanë tim Sulejmàn bin Dàùdin, ai nuk ishte koprac.*".

Fjala e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka dy anë; mohuesit e bënë atë koprac, e akuzuan për të pandershëm dhe thanë në adresë të tij shumë fjalë të këqija; kurse, ana tjetër thotë: ai nuk ishte koprac dhe qëllimi është se fjalët që janë thënë në adresë të tij, ato fjalë i kanë thënë injorantët.[1]

Siç thamë më sipër, ajetet vijues shpjegojnë qartë se All'llahu i Lartësuar e plotësoi kërkesën e Sulejmanit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i dha pushtet, e dalloi me privilegje të

[1] Libri "Ilelu Sheràì'i" vëll. 1, f. 71, cituar prej tefsirit "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 459.

veçanta dhe i dhuroi mirësi të mëdha, të cilat shkurtimisht mund të përmblidhen në pesë pjesë:

1- Vuri në dispozicion të tij erëra shumë të shpejta, ashtu siç njofton ajeti: **"Ne nënshtruam erën që të fryjë me urdhërin e tij** (Sulejmànit) **nga ajo anë që ai dëshiron."**.

Është e natyrshme që pushteti i madh, patjetër ka nevojë për lidhje të shpejta, që i japin mundësi pushtetmbajtësit të ketë nën kontroll të gjitha rajonet e mbretërisë së tij sa më shpejt, në kohë domosdoshmërie dhe pikërisht këtë mirësi, Krijuesi i Gjithëfuqishëm ia dha Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Por qysh u bindeshin erërat urdhërave të tij?

Sa ishte shpejtësia e lëvizjeve të erërave?

Çfarë mjetesh përdorte për hipje Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe njerëzit e tij gjatë kalimit nga njëri vend në një vend tjetër nëpërmjet erërave?

Ç'faktorë i ruanin ata që të mos rrëzoheshin prej uljes e ngritjes së presionit të ajrit dhe prej problemeve të tjera?

Me fjalë të përmbledhura: si ishte kjo ndërmjetësi e fshehtë e me sekrete të padukshme, që ishte vënë në atë kohë në dispozicion të Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*?

Hollësitë në lidhje me këtë pyetje, për ne nuk janë të qarta, por ne dimë se në dispozicion të Profetëve viheshin punët e jashtëzakonshme, që ata të kishin mundësi të kryenin detyrat me të cilat ishin ngarkuar. Po ashtu, ne dimë se të këtilla çështje nuk janë prej çështjeve të zakonshme, por janë çështje të

jashtëzakonshme, janë mrekulli. Gjithashtu, dimë se të këtilla çështje edhe pse janë të jashtëzakonshme, për fuqinë e Krijuesit të Gjithëfuqishëm ato numërohen punë të thjeshta; por sa shumë janë ato çështje për të cilat ne e dimë origjinën dhe në të njëjtën kohë nuk dimë asgjë rreth pjesëve të atyre çështjeve.

Këtu shtrohet pyetja: si mund të përputhet shprehja *"rukhàen"* që do të thotë *"erë e qetë dhe e ngadalshme"*, me shprehjen tjetër *"àsifeten"*, që do të thotë *"erë e fuqishme"*. Shprehja *"àsifeten"* ka ardhur në ajetin 81 të sures "El Enbijà": **"Sulejmànit Ne ia nënshtruan erën e fuqishme, që ajo të lëvizë sipas dëshirës së tij deri në Tokën të cilën Ne e kemi bekuar…"**?

Për këtë pyetje, ka dy përgjigje:

E para: Përshkrimi i erërave me cilësorin *"àsifeten"* – *"erëra të fuqishme"* shpjegon shpejtësinë e lëvizjes së erërave, kurse përshkrimi i erërave me cilësorin *"rukhàen"* – *"e qetë dhe e ngadalshme"* shpjegon lëvizjen e qetë të erërave; domethënë se Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* së bashku me njerëzit e tij, nuk kishin asnjë shqetësim prej shpejtësisë së lëvizjes me atë të erërave dhe nga pikëpamja e shpejtësisë, ai "mjet" është i ngjashëm me mjetet e shpejta të ditëve tona, në të cilat udhëtarit i duket se është duke ndenjur në njërën prej dhomave të shtëpisë së tij, në një kohë kur me anë të këtyre mjeteve ai udhëton me shpejtësi të madhe.

E dyta: Disa intepretues të Kur'ànit Famëlartë, kanë përmendur një përgjigje tjetër për këtë pyetje dhe kanë thënë se këto dy ajete tregojnë për dy lloje erërash, që All'llahu i Lartësuar i vuri në dispozicion të Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*

njëra ishte e fuqishme dhe lëvizte me shpejtësi, kurse tjetra ishte e qetë dhe lëvizte e qetë e ngadalë.

2- Mirësia tjetër që Krijuesi i Gjithëfuqishëm i dha robit të tij Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte vënia në dispozicion të tij e qenieve kryengritëse dhe këto qenie i Larti i kishte nënshtruar për atë që ai të realizonte disa punë që duhej të kryente dhe për këtë çështje, ajeti vijues njofton: **"**(Ne nënshtruam për atë) **edhe djajtë, çdo ndërtues e zhytës** (në ujë)**."**.

Domethënë: njëri grup prej atyre qenieve kundërshtuese punonin në tokë dhe bënin ato ndërtime për të cilat kishte nevojë Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kurse disa të tjerë punonin për atë si zhytës, në ujërat e detit.

Çështja e vënies së djajve në dispozicion të Sueljemànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe kryerja prej djajve e çdo pune për të cilën kishte nevojë ai, nuk ka ardhur vetëm në këtë ajet, por ka ardhur në disa ajete të Kur'ànit Famëlartë, si, për shembull, në ajetin 82 të sures "El Enbijà", ku për këto qenie kundërshtuese është përdorur fjala *"shejàtijne"* – *"djajtë"* kurse fjala *"el xhin'ne"* – *"xhindët"* për ato qenie kundërshtues është përdorur në ajetin 12 të suers "Sebe".

Siç kemi thënë më sipër, xhindët janë qenie të cilat nuk i shohin sytë tanë, por ato janë qenie me mendje, me ndjenja e me fuqi; disa prej xhindëve janë besimtarë dhe disa të tjerë nuk janë besimtarë, por nuk ka asnjë pengesë që xhindët, me urdhërin e All'llahut, të vihen në dispozicion të disa Profetëve, për të realizuar disa punë.

Ka edhe një mundësi tjetër që del nga kuptimi i gjerë që ka fjala "djajtë", pasi në këtë fjalë mund të përfshihen edhe njerëzit kundërshtues të urdhërave të All'llahut të Lartësuar dhe në këtë kuptim fjala "djajtë" është përdorur për njerëzit në ajetin 112 të sures "El En'àm" dhe sipas kësaj renditjeje, All'llahu i Gjithfuqishëm i dha Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* aq fuqi sa edhe djajtë kundërshtues të ishin të nënshtruar ndaj urdhërave të tij.

3- Mirësia e tretë që Krijuesi i Gjithëfuqishëm i dha Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte sundimi i tij mbi një grup elementesh shkatërrues, sepse ndër djajtë ka të atillë që prej atyre nuk vjen asnjë dobi, prandaj Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ndaj këtyre djajve shkatërrues nuk i mbetej rrugë tjetër veçse t'i prangoste e t'i lidhte me zinxhirë, pasi vetëm kështu shoqëria do të ishte e siguruar prej ligësive të atyre djajve, ashtu siç njofton ajeti vijues i grupit të ajeteve tona objekt studimi: **"Dhe të tjerë** (djaj) **të lidhur në pranga."**.

Fjala *"mukarr'rrenijne"*, tregon lidhjen me zinxhirë të duarve, këmbëve, ose edhe të qafave.

Kurse fjala *"esfâd"*, do të thotë: prangat me të cilat lidhen duart e të burgosurve.

Disa kanë thënë se fraza e ajetit **"të lidhur në pranga"**, do të thotë: pranga që lidhin njëherësh dy duart dhe qafën. Ky kuptim, nga ana gjuhësore është shumë i ngjashëm me kuptimin e fjalës *"mukarr'rrenijne"*, që, siç thamë, tregon lidhjen e duarve, këmbëve dhe të qafave.

Ka edhe një opinion të mundshëm që thotë se qëllimi me frazën **"të lidhur në pranga"**, është: të gjitha prangat janë të lidhura me një zinxhir të vetëm. Këtu shtrohet pyetja: kur qëllimi është për djajtë xhindë, ne dimë se ata kanë trup fluid dhe kështu që nuk është e përshtatshme që për këto qenie të përdoret fjala prangosje e lidhja e tyre me zinxhirë.

Në lidhje me këtë pyetje, disa kanë thënë: prangat këtu janë metaforë për ndalimin e atyre djajve që të mos bëjnë asnjë lloj shkatërrimi; por, nëse qëllimi me fjalën djajtë është për njerëzit kundërshtues e kyengritës, atëherë prangat e zinxhirët do të ruajnë kuptimin origjinal që shprehin, sepse përdorimi i këtyre mjeteve, në këtë rast është i mundshëm.

4- Mirësia e katërt që All'llahu i Lartësuar i dha Profetit të Tij Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishin kompetencat e mëdha e të plota që ai t`u shpërndante dhurata atyre që ai dëshironte dhe të mos u jepte atyre që e kërkonte interesi; ashtu siç njofton ajeti: **"Kjo është dhënie nga ana Jonë, kurse ti jep ose nuk jep, nuk ke përgjegjësi."**.

Fraza *"bi gajri hisàb"*, tregon se Krijuesi i Gjithëfuqishëm i dha Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kompetenca të gjera, për të cilat kurrë nuk do të jepte llogari dhe kurrë nuk do të dënohej. Pa dyshim që kjo dhënie e plotë kompetencash, ishte për shkak të drejtësisë që tregonte Sueljmàni në fushën e përdorimit të këtyre kompetencave; ose është në kuptimin: dhënia hyjnore për atë ishte aq me shumicë, sa, pavarësisht nga sasia që ai do të jepte prej asaj, ajo dhënie e All'llahut përsëri do të mbetej e madhe.

Disa interpretues të Kur'ànit, kanë thënë se fraza *"bi gajri hisàb"*, ka të bëjë vetëm me djajtë e lidhur me pranga e me zinxhirë dhe i thotë Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*: Ti ke mundësi të lirosh disa prej atyre të lidhurve, nëse mendon se me lirimin e tyre do të jetë më mirë, por ti mund t'i mbash të tjerët në pranga, nëse mendon se ashtu është më mirë.

Duhet theksuar se ky kuptim për këtë frazë, është krejtësisht i përjashtuar, sepse nuk është në përshtatje me kuptimin që jep fjala *"atàunà"* – *"Kjo është dhënie nga ana Jonë"*.

Mirësia e pestë dhe e fundit që All'llahu i Lartësuar i dha Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishin gradat e larta morale të merituara të cilat e përfshinë atë, ashtu siç e lexojmë në ajetin e fundit të këtij grupi ajetesh: **"Me të vërtetë ai** (Sulejmani) **te Ne është shumë i afërt dhe ka të ardhme të mirë."**.

Në fakt, ky ajet është përgjigje e përshtatshme kundër të gjithë atyre që përdhosin shenjtërinë e Profetëve të mëdhenj të All'llahut të Lartësuar me akuza të rreme dhe me pandehma që ata i marrin prej Teuràtit të tanishëm, që, siç dihet, është i revizionuar; njëkohësisht, ky ajet e pastron Sulejmànin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* prej të këtilla akuzash të gatuara me brumin e gënjeshtrave e të shpifjeve dhe vë në dukje pozitën e lartë që ai ka te Krijuesi i Gjithëfuqishëm, sepse vetë shprehja e ajetit *"husne màbin"*, e përgëzon atë për pozitën e lartë që ai ka pranë All'llahut të Lartësuar; në të njëjtën kohë, kjo shprehje tregon sa pa baza e sa të rreme janë mëtimet e stisura që thuhen në Teuràtin e tanishëm në adresë të tij. Dihet se, mëtimet e Teuràtit të tanishëm shkojnë deri aty, sa të thonë se më në fund Sulejmàni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kaloi në idhujtari kur ai u martua

me një grua që adhuronte idhujt, madje shtojnë se ai filloi të ndërtojë edhe një tempull kushtuar adhurimit të idhujve, por Kur'àni Famëlartë i hedh poshtë të gjitha këto akuza të rreme, mëtime e mite të stisura.

Dy hulumtime

1- Të vërtetat që shpjegon për ne tregimi i Sulejmànit

S'ka dyshim se Kur'àni Famëlartë, me përmendjen e historisë së Profetëve, ka qëllim plotësimin e programit edukues nëpërmjet pasqyrimit të thelbit të të vërtetave të këtyre tregimeve.

Nga tërësia e punëve që përshkruhen në tregimin e Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* rendisim si më poshtë:

a) Drejtimi me dorë të hekurt i punëve të mbretërisë së tij të fuqishme e me mundësi të mëdha materiale, ekonomike e kulturore të shkëlqyera, nuk është në kundërshtim me pozitat morale dhe me vlerat hyjnore e njerëzore, ashtu siç e përmendën këtë mirësi ajetet objekt studimi, në të cilat më parë përmendën mirësitë materiale që i Gjithëfuqishmi i kishte dhënë Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe për këtë, Kur'àni Famëlartë njofton: **"Me të vërtetë ai** (Sulejmani) **te Ne është shumë i afërt dhe ka të ardhme të mirë."**.

Në një hadith të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë fjalën e tij: "*Si mendoni për pushtetin që iu dha Sulejmàn bin Dàùdit? Në të vërtetë, ai pushtet iu shtua atij vetëm për shkak të nënshtrimit të tij të plotë; ai kurrë nuk shikonte lart në Qiell, për shkak të nënshtrimit që kishte ndaj Zotit të tij.*".[1]

b) Për administrimin e mbretërisë së tij me territor aq të gjerë, ai duhet të kishte mjete për të siguruar lidhje të shpejta. Gjithashtu, ai patjetër duhej të përfitonte prej kapaciteteve të ndryshme, me qëllim që t'u priste rrugën forcave diversioniste. Po ashtu, ai interesohej për çështjet e ndërtimeve e të popullimit, njëkohësisht planifikonte të arrinte pasuri, shtimin e fitimeve dhe për nxjerrjen e mirësive e pasurive prej Tokës e prej detit. Ai kishte kujdesin e madh që të emëronte në poste drejtuese njerëzit që me të vërtetë meritonin të ishin drejtues dhe në dispozicion të të cilëve ai kishte vënë të gjitha mundësitë e mundshme. Të gjitha këto, janë të pasqyruara në mënyrë shumë të qartë në tregimin e Sulejmànit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

c) Të përfitonte prej forcave njerëzore deri në kufirin më të madh të mundshëm, madje të përfitonte deri edhe prej djajve, kur ishte e mundur që ata të orientoheshin e të udhëzoheshin në rrugën e drejtë; njëkohësisht, ishte detyra e tij të prangoste e të lidhte me zinxhirë djajtë e tjerë, prej të cilëve nuk mund të përfitohej.

[1] Tefsiri "Rùhul Bejàn", vëll. 8, f. 39.

2- Sulejmàni në Kur'àn dhe në Teuràt

Kur'àni Famëlartë, në ajetet objekt studimi e ka cilësuar Sulejmànin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* njeri të pastër, me vlera të mëdha dhe një udhëheqës e organizator të drejtë.

Në një kohë që Teuràti i sotshëm i revizionuar (All'llahu të na mbrojë nga ato fjalë), e cilëson si një njeri mëkatar, njeri që u nënshtrohet dëshirave të ulta dhe me shumë pika dobësie. E çuditshme në këtë çështje, është se Teuràti i sotshëm, krahas paraqitjes së këtyre përshkrimeve të rreme e të falsifikuara, tregon edhe bisedat intime të Sulejmànit me Zotin e tij, si dhe poezitë e tij fetare dhe fjalët e tij të urta, të cilat në të vërtetë dëshmojnë se ai ishte një burrë i urtë dhe njeri i lirë, por kjo është në kundërthënie të plotë me atë që shikohet në Teuràtin e sotshëm të revizionuar.

Kush dëshiron më shumë informacion në lidhje me këtë çështje, le të lexojë komentin e ajeteve 12-13 të sures "Sebe" të këtij libri, në paragrafin: "Figura e Sulejmànit në Kur'ànin Famëlartë dhe në Teuràtin e sotshëm të revizionuar".

Ajetet: 41 – 44

وَٱذۡكُرۡ عَبۡدَنَآ أَيُّوبَ إِذۡ نَادَىٰ رَبَّهُۥٓ أَنِّي مَسَّنِيَ ٱلشَّيۡطَٰنُ بِنُصۡبٖ وَعَذَابٍ
﴿٤١﴾ ٱرۡكُضۡ بِرِجۡلِكَۖ هَٰذَا مُغۡتَسَلُۢ بَارِدٞ وَشَرَابٞ ﴿٤٢﴾ وَوَهَبۡنَا لَهُۥٓ أَهۡلَهُۥ
وَمِثۡلَهُم مَّعَهُمۡ رَحۡمَةٗ مِّنَّا وَذِكۡرَىٰ لِأُوْلِي ٱلۡأَلۡبَٰبِ ﴿٤٣﴾ وَخُذۡ بِيَدِكَ ضِغۡثٗا
فَٱضۡرِب بِّهِۦ وَلَا تَحۡنَثۡۗ إِنَّا وَجَدۡنَٰهُ صَابِرٗاۚ نِّعۡمَ ٱلۡعَبۡدُۖ إِنَّهُۥٓ أَوَّابٞ ﴿٤٤﴾

"Kujto robin Tonë Ej'jùbin, kur me lutje iu drejtua Zotit të tij: djalli më ka prekur me mundim e me dhimbje."

"Godite (tokën) **me këmbën tënde, ky** (ujë) **është i ftohtë, pastrues dhe i pijshëm."**

"Ne i dhuruam atij familjen edhe aq sa ishin së bashku me ata si mëshirë nga ana Jonë dhe mësim për ata që kanë mendje."

"Merr me dorën tënde një dorë thupra, rrihe (gruan) **me ato dhe mos e thyej betimin; me të vërtetë Ne e gjetëm atë të durueshëm, sa rob i mirë ishte dhe ai kthehej te Zoti."**

Komentimi

Jeta e Ej'jùbit, e mbushur me ngjarje e mësime

Ajetet e përparme flisnin për Sulejmànin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe për fuqinë e madhe që i kishte dhënë atij Krijuesi i Gjithfuqishëm, por këto ajete, në të njëjtën kohë ishin edhe një përgëzim për të Dërguarin e All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* si dhe për myslimanët e Mekës të asaj kohe, që jetonin nën një shtypje shumë të rëndë.

Ajetet objekt i studimit tonë të tanishëm, flasin për Ej'jùbin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!),* këtë Profet të madh, që ishte një model i gjallë i durimit dhe ecjes në rrugën e drejtë. Me këto cilësi të këtij Profeti të nderuar, jo vetëm që u jepej një mësim i mirë myslimanëve të asaj kohe, por u jepet i njëjti mësim edhe myslimmanëve të sotshëm dhe atyre që do të vijnë nesër. Këto ajete u mësojnë myslimanëve si të përballojnë problemet e vështirësitë e jetës dhe u bëjnë thirrje myslimanëve për bashkim e bashkëpunim. Gjithashtu, në këto ajete shpjegohet qartë edhe fundi i lavdërueshëm që kanë durimi dhe të durueshmit.

Ej'jùbi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* është Profeti i tetë, për të cilin në këtë sure (në suren "Sàd") përmenden disa anë të jetës së tij. Në ajetin e parë të këtij grupi ajetesh, i bëhet thirrje të Dërguarit tonë *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* që t'ua kujtojë këtë tregim dhe ngjarjet e këtij tregimi myslimanëve, që edhe ata të bëjnë durim para problemeve të vështira që u dalin përpara dhe kurrë të mos e presin shpresën prej mëshirës së All'llahut të Lartësuar.

Emri Ej'jùb dhe tregimi për këtë Profet të madh, ka ardhur në disa sure të Kur'ànit, si, për shembull, në ajetin 163 të sures "En Nisà" dhe në ajetin 84 të sures "El En'àm", ku emri i tij përmendet krahas emrave të disa Profetëve të tjerë të All'llahut. Këto ajete shpjegojnë dhe vërtetojnë pozitën e profetnisë së tij, në kundërshtim me Teuràtin e sotshëm, që nuk e konsideron Profet, por e konsideron thjesht njërin prej robve bamirës. Teuràti i sotshëm e përmend Ej'jùbin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* si pasanik dhe njofton se familja e tij përbëhej prej shumë vetëve.

Edhe në ajetet 83-84 të sures "El Enbijà", janë paraqitur shkurtimisht anë prej jetës së Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kurse ajetet objekt i studimit tonë, vetëm në katër ajete jeta e tij është shpalosur në mënyrë të hollësishme, më shumë se në çdo sure tjetër.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh thotë: **"Kujto robin Tonë Ej'jùbin, kur me lutje iu drejtua Zotit të tij: djalli më ka prekur me mundim e me dhimbje."**.

Fjala *"nusbun"*, por që lexohet edhe *"nesabun"*, të dyja këto fjalë janë në kuptimin e provës së rëndë dhe të keqes.

Ky ajet bën të qartë pozitën e lartë që kishte Ej'jùbi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* te All'llahu i Lartësuar dhe pozita e tij e lartë në radhë të parë kuptohet prej fjalës së këtij ajeti *"abdenà"* – *"robin Tonë"*; ky ajet, gjithashtu, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë bën shenjë për sprovat e rënda, madje aq të rënda që nuk duroheshin dhe për dhimbjet e rënda e të shumta që e mundonin Ej'jùbin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Në Kur'ànin Famëlartë nuk ka ndonjë shpjegim të hollësishëm për ngjarjet që i ndodhën Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* por, në librat e hadithit dhe të tefsireve, lexojmë hollësi prej tregimit të tij.

Në tefsirin "Nùruth Thekalejn", lexojmë: Ebù Besijr pyeti Imam Sadikun *(Paqja qoftë mbi të!)* se cili ishte shkaku për të keqen me të cilën u sprovua Ej'jùbi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. (Mbase pyetësi ka menduar se Ej'jùbi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u sprovua për shkak të ndonjë faji që mund të kishte bërë). Imami *(Paqja qoftë mbi të!)* iu përgjegj: "*Për një mirësi të madhe që atij i kishte dhënë All'llahu i Gjithëfuqishëm në këtë botë dhe ai për këtë e falënderoi. Në atë kohë, djalli, përveç 'Arshit', nuk mbulohej para askujt dhe kur u ngjit lart në sferat qiellore, aty pa falënderimin e Ej'jùbit (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) për mirësitë që i ishin dhënë dhe djalli e pati zili, prandaj tha: O Zot, Ej'jùbi të falënderon vetëm për mirësitë që Ti i ke dhënë në këtë botë dhe nuk të falënderon për këtë mirësinë e madhe; sikur ta privoje prej mirësive të botës, ai kurrë nuk do të të falënderonte për ndonjë mirësi; më jep mua pushtet mbi pjesën e mirësive që ai ka në këtë botë, që të mësosh se ai kurrë nuk të ka falënderuar Ty për ndonjë mirësi që i ke dhënë.*".

(Krijuesi i Gjithëfuqishëm, me qëllim që të bënte sa më të qartë të gjithë sinqeritetin e Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e bëri atë një model të gjallë për të gjitha botët, se ai e falënderon All'llahun kur gëzon mirësitë e Tij dhe duron kur vihet në sprovë, prandaj i lejoi djallit të ketë pushtet mbi të mirat e kësaj bote që Ai me bujarinë e Tij i kishte dhënë Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Krijuesi i Gjithëfuqishëm me madhështinë e Tij tha: të dhashë pushtet mbi pasurinë e tij dhe mbi fëmijët e tij. Djalli menjëherë veproi dhe shkatërroi të gjithë pasurinë e Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe vrau të gjithë fëmijët e tij. Por Ej'jùbi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e shtoi edhe më shumë falënderimin e lavdërimin për të Gjithëfuqishmin. Përsëri djalli tha: o Zot, më jep pushtet mbi të mbjellat e tij dhe përgjigja qe: të dhashë; djalli menjëherë, me ndihmësit e vet djaj, i dogji të mbjellat e Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* por ai e shtoi edhe më shumë falënderimin e lavdërimin për të Gjithëfuqishmin. Djalli përsëri u lut: o Zot, më jep pushtet mbi bagëtinë e tij dhe menjëherë i vrau të gjitha, por Ej'jùbi përsëri e shtoi falënderimin dhe lavdërimin për të Gjithëfuqishmin. Djalli përsëri u lut: o Zot, më jep pushtet mbi trupin e tij dhe pushteti iu dha, me përjashtim të mendjes e të syve; djalli lëshoi fryrjen e tij dhe Ej'jubi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u mbush me plagë nga koka deri te këmbët dhe kjo gjendje për atë vazhdoi për një kohë të gjatë, përsëri ai vazdoi të lavdërojë e të falënderojë të Gjithëfuqishmin.

(Por ajo që i theu zemrën e që i la plagë të thella në shpirt Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* qe vizita që i bënë atij një grup murgjësh të Beni Israilëve).

Murgjit i thanë: *"O Ej'jùb, sikur të na kishe njoftuar ne për fajin që ke bërë, sepse All'llahu mund të na vdesë në vend nëse do ta pyesim. Me këtë sprovë të rëndë që po kalon ti, nuk është sprovuar asnjë njeri, prandaj këtu ka ndonjë punë që ti e mban të fshehtë. Ej'jùbi (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) tha: Betohem në madhështinë e Zotit tim se*

nuk kam bërë asnjë faj. Sa herë kam ngrënë bukë, së bashku me mua ka ngrënë ose një i varfër ose një jetim.”.[1]

Në të vërtetë, fyerja që i erdhi prej njerëzve të tij, i shkaktoi dhimbje edhe më të forta se çdo gjë që e kishte goditur; megjithëkëtë, Ej’jùbi *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)* nuk e humbi durimin, falënderimin e tij të pastër si uji që zbret prej Qiellit ai nuk e ndoti me ndyrësinë e mosmirënjohjes, por iu drejtua Krijuesit me frazën e ajetit të sipërm: **“…djalli më ka prekur me mundim e me dhimbje.”**. Fakti që ai doli me rezultatin shumë mire në provimin e All’llahut, Mëshirëploti i hapi edhe një herë portat e mëshirës së Tij për robin durimtar e të qëndrueshëm, Ej’jùbin *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)* i ktheu atij të gjitha mirësitë e humbura njërën pas tjetrës, madje i dha edhe më shumë pasuri, më shumë prodhime bujqësore dhe më shumë fëmijë. Kjo ishte që të gjithë të kuptonin përfundimin e mirë të durimit e të falënderimit të All’llahut të Lartësuar kur bëhet edhe në gjendjet më të rënduara.

Disa prej interpretuesve të dëgjuar të Kur’ànit Famëlartë, kanë thënë se pështpështet që djalli lëshonte në zemrën e Ej’jùbit *(Paqja e All’llahut qoftë mbi të!)*, janë në kuptimin e mundimeve e dhimbjeve që djalli i shkaktonte Ej’jùbit. Djalli herë i thoshte atij: Sa shumë u zgjat kjo sëmundja jote, duket se Zoti yt të harroi!

[1] Ky tregim ka ardhur në tefsirin “Nùruth Thekalejni”, cituar prej tefsirit të Ali Ibrahimit; e njëjta përmbajtje ka ardhur edhe në tefsirin e Kurtubij’jit, në tefsirin e Fakhru Ràziut, në tefsirin “Es Sàfij” dhe në tefsire të tjera, me fare pak ndryshim në fjalë.

Herë tjetër i thoshte: Ti vazhdon të falënderosh All'llahun, megjithëse Ai të mori të gjitha mirësitë e shumta që kishe, të mori shëndetin e të bëri të pafuqishëm.

Mundet që ata e kanë përmendur këtë interpretim për shkak se ata e përjashtojnë mundësinë që djalli të ketë pushtet mbi Profetët si Ej'jùbi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* por, me pak përqendrim, gjejmë se pushteti që iu dha djallit mbi atë Profet të madh, në radhë të parë ishte me urdhër prej All'llahut, në radhë të dytë ishte pushtet i kufizuar dhe në radhë të tretë ishte për të vënë në provë atë Profet të madh dhe për të ngrituar lart pozitën e tij, prandaj në këtë çështje nuk del asnjë problem.

Thuhet se koha e dhimbjeve dhe sëmundja e tij vazhdoi shtatë vjet. Në një transmetim tjetër thuhet se vazhdoi 18 vjet dhe gjendja e tij arriti deri aty, sa prej tij u larguan shokët, madje edhe të afërmit, me përjashtim të gruas së tij, e cila qëndroi së bashku me atë dhe me këtë qëndrim ajo shfaqi ndaj tij besnikërinë e saj; një besnikëri të këtillë e vërejmë në disa gra!

Por ajo që e mundoi dhe që i shkaktoi më shumë dhimbje në shpirt Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte dhimbja që i shkaktoi atij sharja që i erdhi atij prej armiqve. Në një transmetim, thuhet se Ej'jùbi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* pasi e shëroi All'llahu i Lartësuar, është pyetur se cila dhimbje kishte qenë më e rëndë për atë? Ai u përgjegj: "Sharja e armiqve.".

Më në fund, Ej'jùbi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* doli shëndoshë e mirë prej provimit hyjnor dhe mëshira hyjnore zbriti mbi atë sapo për atë doli urdhëri: **"Godite** (tokën) **me këmbën tënde, ky** (ujë) **është i ftohtë, larës dhe i pishëm."**.

Fjala e ajetit *"urkud"*, në rrënjën e saja *"rekeda"*, do të thotë: shtypja e tokës me këmbë; herë tjetër kjo fjalë vjen në kuptimin e goditjes me këmbë dhe këtu është në kuptimin e parë.

All'llahu i Lartësuar bëri që burimi i "Zemzemit" të shpërthejë në tokën e thatë e të djegur prej diellit nën këmbët e një foshnjeje gjiri, Ismailit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe përsëri All'llahu i Lartësuar urdhëroi të shpërthejë një burim me ujë të ftohtë për Ej'jùbin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* që ai të pinte prej atij uji dhe të lahej me atë ujë, që të shërohej prej të gjitha sëmundjeve që e kishin prekur, sëmundje të jashtme e të brendshme.

Disa mendojnë se ai burim duhet të ishte burim uji mineral i pishëm dhe me cilësi shëruese për të gjitha sëmundjet. Si do që të ishte, ai ujë ishte vetëm prej butësisë e mëshirës së All'llahut për Profetin e Tij aq të durueshëm e shumë qëndrestar, Ej'jùbin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Fjala *"mugteselun"*, do të thotë *"ujë me të cilin lahesh"*. Disa të tjerë kanë thënë se është në kuptimin e vendit për larje, por kuptimi i parë është më i saktë.

Si do që të jetë, përshkrimi i atij uji me cilësorin "i ftohtë", mund të jetë një shenjë që tregon ndikimet e veçanta që ka uji i ftohtë për shëndetin e trupit. Këtë të vërtetë e ka vërtetuar edhe mjekësia moderne e ditëve tona, duke shtuar se edhe cilësia larëse e ujit plotësohet vetëm nëse ai ujë është i pastër si uji i pijshëm.

Dëshmues për këtë është edhe ajo që ka ardhur në transmetimet islame, në të cilat thuhet: është veprim i përlqyer

(*mustehab*), pirja e një grushti uji para larjes së trupit, prej të njëjtit ujë me të cilin lahesh.[1]

Mirësia e parë dhe më e rëndësishme që iu kthye Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte kthimi i shëndetit e shërimi i tij i plotë, kurse mirësitë e tjera që iu kthyen atij, shpalosen në ajetin vijues: **"Ne i dhuruam atij familjen edhe aq sa ishin së bashku me ata, si mëshirë nga ana Jonë dhe mësim për ata që kanë mendje."**.

Për mënyrën e rikthimit të familjes së tij, janë bërë disa interpretime dhe interpretimi që ka më shumë përhapje, thotë: Ata ishin të vdekur, por All'llahu i Lartësuar i ktheu në jetë edhe një herë tjetër.

Disa të tjerë kanë thënë: ata ishin larguar prej tij dhe ishin shpërndarë gjatë kohës që ai ishte i sëmurë, por All'llahu i mblodhi te ai pas shërimit të tij.

Ka mundësi që ata të gjithë ose disa prej tyre, u sprovuan me lloje të ndryshme sëmundjesh dhe pastaj të gjithë ata i përfshiu mëshira e All'llahut dhe atyre iu rikthye shëndeti, që të mblidheshin edhe një herë rreth Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Fraza e ajetit **"aq sa ishin së bashku me ata"**, tregon pasardhësit e tij dhe shtimin e tyre dyfish; me këtë shtim, u dyfishua numri i fëmijëve të Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

[1] "Uesàilu Shij'ah", vëll. 1, kapitulli 13, pjesa: Adabul Hamam".

Megjithëse këto ajete nuk flasin për rikthimin e pasurisë së Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të gjithë argumentet e bëjnë të qartë se Krijuesi i Gjithëfuqishëm ia ktheu atij pasuritë që kishte pasur, madje i dha edhe më shumë.

Në fundin e ajetit objekt studimi, tërheq vëmendjen fakti se qëllimi i kthimit të mirësive hyjnore Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte i kufizuar prej dy punëve:

E para: "rahmeten min'nà" – "mëshirë nga ana Jonë" mëshirë me karakter të veçantë, individual. Në të vërtetë, ky rikthim i mirësive ishte një shpërblim prej Krijuesit të Gjithëfuqishëm për robin e Tij të durueshëm e shumë të qëndrueshëm Ej'jùbin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

E dyta: Dhënia e një mësimi për të gjithë njerëzit e mençur gjatë gjithë historisë: njerëzit duhet të nxjerrin mësim prej pësimeve të Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* të mos e humbin durimin, por të përballojnë problemet e të gjitha ngjarjet e vështira nëpër të cilat mund të kalojnë dhe kurrë të mos e presin shpresën prej mëshirës së All'llahut, por të shtojnë sa më shumë falënderimin dhe lidhjen e tyre me mëshirën e të Lartit.

Problemi i vetëm që i mbeti për të zgjidhur Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte mënyra si të vepronte për të zbatuar betimin e tij për të rrahur gruan e vet; ai ishte betuar gjatë kohës që ishte i sëmurë se, kur të shërohej, do të rrihte gruan e tij me njëqind rrahje me kamzhik lëkure, ose edhe më pak, për një punë që ajo kishte bërë dhe që ai nuk e kishte miratuar. Por, kur u shërua prej sëmundjes, Ej'jùbi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kishte dëshirë ta falte gruan, ngaqë ai e respektonte dhe e

vlerësonte shumë besnikërinë e saj dhe shërbimet që ajo i kishte bërë atij gjatë kohës së sëmundjes. Mirëpo, çështja e betimit në All'llahun e Lartësuar qëndronte në mes zbatimit të betimit dhe dëshirës së tij për faljen e gruas.

All'llahu i Lartësuar e përfshiu edhe një herë tjetër Ej'jùbin me mëshirën e Tij, kur i dha zgjidhje problemit të pazgjidhshëm për Ej'jùbin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!).* Pjesa e parë e ajetit vijues dhe të fundit të këtij grupi ajetesh, njofton: **"Merr me dorën tënde një dorë thupra, rrihe me ato dhe mos e thyej betimin."**.

Fjala *"digthen"* do të thotë: mbushja e dorës me thupra të holla, të holla si kërcelli i bimës së grurit, ose elbit, apo bimë të tjera të ngjashme.

Në mesin e interpretuesve të Kur'ànit Famëlartë, ka mendime të ndryshme në lidhje me interpretimin e punës që kishte bërë gruaja e Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* punë të cilën burri i saj jo vetëm që nuk e pranonte, por edhe kishte neveri prej asaj pune që kishte bërë gruaja e tij, e quajtur "Lijà", e cila ishte e bija e Ja'kùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Prej Ibni Ab'bàsit, citohet se djalli i doli përpara gruas së Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në formën e tij natyrore dhe i tha asaj: Unë e shëroj burrin tënd me kushtin që pas shërimit ai të thotë se vetëm unë jam shkaku i shërimit të tij dhe për shërimin e tij nuk dua asnjë lloj shpërblimi. Gruaja, që natyrisht ishte shumë e shqetësuar për shkak se sëmundja që e kishtë zënë burrin e saj po vazhdonte prej një kohë shumë të gjatë, e miratoi propozimin e djallit dhe më pas, këtë propozim ajo ia shtroi burrit të saj Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* por ai u lëndua shumë

që gruaja e tij kishte rënë në kurthin e djallit dhe për këtë ai u betua se do ta ndëshkonte gruan e tij.

Disa të tjerë kanë thënë: Ej'jùbi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e çoi gruan e tij për të kryer një punë, por gruaja u kthye me vonesë dhe kjo vonesë e gruas ndikoi që atij t'i rëndohej sëmundja, prandaj ai u betua se do të ndëshkonte gruan e tij.

Si do që të ishte, nga njëra anë gruaja e tij e meritonte ndëshkimin, por, nga ana tjetër, ajo i kishte qëndruar besnike Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe i kishte shërbyer atij gjatë gjithë kohës që ai ishte i sëmurë, prandaj ajo e meritonte të falej.

Në të vërtetë, rrahja e saj me një dorë kërcejsh gruri ose elbi, nuk mund të jetë konfirmim real për zbatimin e betimit të tij, por ai e zbatoi atë "ndëshkim", në radhë të parë për të ruajtur respektin e betimit në emrin e All'llahut dhe në radhë të dytë, që të mos bëhej rrugë thyerja e betimeve dhe ligjeve. Është e qartë se, ky lloj "ndëshkimi", zbatohet vetëm për anën që e meriton faljen, kurse për ata që nuk e meritojnë faljen, askujt nuk i lejohet të bëjë një lëshim të këtillë në zbatimin e ligjit të All'llahut.

Pjesa e fundit e ajetit objekt studimi, është si një presë shtrydhëse e këtij tregimi, nga fillimi deri në fundin e tij dhe në frazën e tij të fundit, ajeti njofton: **"...me të vërtetë Ne e gjetëm atë të durueshëm, sa rob i mirë ishte dhe ai kthehej te Zoti."**.

Është e qartë se lutja e Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* drejtuar Krijuesit të Gjithëfuqishëm për largimin e ngacmimeve të djallit dhe për largimin e sëmundjes së tij, nuk janë në kundërshtim me pozitën e durimit dhe të

qëndrueshmërisë së tij para vështirësive e dhimbjeve të rënda, që vazhduan për shtatë vjet me radhë. Në disa transmetime të tjera, sëmundja e tij zgjati dhjetë vjet me dhimbje, varfëri, gjendje të vështirë. Por ai vazhdimisht e falënderonte All'llahun e Gjithëfuqishëm.

Në këtë ajet, bie në sy se Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i ishin dhënë tri cilësi të atilla, që sikur njëra prej atyre cilësive do t'i jepej në një njeri, patjetër ai do të ishte njeri i plotësuar.

E para: Pozita e robërisë së tij ndaj All'llahut të Lartësuar.

E dyta: Durimi dhe qëndrueshmëria e tij.

E treta: Kthimi i tij i përsëritur te All'llahu.

Hulumtime

1- Mësime të rëndësishme në tregimin e Ej'jùbit

Megjithëse tregimi i këtij Profeti të dalluar për durimin e tij në këtë sure është shtruar në katër ajete, megjithëkëtë, në këto ajete shpjegohen qartë të vërteta shumë të rëndësishme, prej të cilave:

a) Sprovimi nga ana e All'llahut është me përmasa të gjera dhe shumë i rëndë. Ai përfshin edhe Profetët e mëdhenj, duke shtuar se sprovimi i Profetëve është më i rëndë e më i vështirë se i të tjerëve. Natyra e jetës në këtë botë është ndërtuar mbi këtë bazë

dhe pa këtë provim nuk mund të shpërthejnë fuqitë e mundësitë që i Gjithëfuqishmi ka depozituar në njeriun.

b) Lehtësimi pas gjendjes së shtrënguar, është një pikë tjetër që gjendet në ngjarjet e këtij tregimi. Kur mbi njeriun ashpërsohen valët e ngjarjeve e të sprovave dhe e rrethojnë atë nga të gjitha anët, në këtë gjendje detyra e njeriut është të mos dëshpërohet, të mos e humbë shpresën dhe të kuptojë se kjo gjendje për atë është fillimi i hapjes së portës së mëshirës së All'llahut, ashtu siç thotë Prijësi i besimtarëve, Ali bin Ebù Tàlibi *(Paqja qoftë mbi të!)*, në njërën prej thënieve të tij: *"Kur vështirësia arrin fundin, atëherë do të jetë lehtësimi e shpëtimi dhe kur ngushtohet rrethi i provës, atëherë do të jetë gjendja e mirë."*.[1]

c) Rrjedha e ngjarjeve të këtij tregimi, shpjegon qartë e në mënyrën më të mirë, qëllimet e larta të provës e të ngjarjeve të vështira që i ndodhin njeriut në këtë jetë, sepse ndodhja e të tilla gjendjeve të vështira e të rënda në jetën e njeriut, të gjithë njerëzit, përfshirë në fjalën "njeri" edhe Profetët e mëdhenj të All'llahut, numërohet punë e domosdoshme, sepse provimi, siç u shpjegua më sipër, bën që të shpërthejnë fuqitë e brendshme të njeriut, të cilat më në fund e çojnë njeriun drejt plotësimit.

Ndër transmetimet islame, lexojmë një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Njerëzit që kanë kaluar sprovat më të rënda, janë Profetët, pastaj ata që i kanë ndjekur Profetët, më të mirët e të mirët."*.[2]

---

[1] "Nehxhul Belàga", (Thëniet e shkurtra, thënia 351).

[2] "Sefijnetul Bihàr", vëll. 1, f. 105, lënda *"belàun"* – *"sprovë"*.

Në një transmetim tjetër të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Në Xhennet ka një vend të nderuar, të cilin asnjë rob nuk e arrin veçse me provimin."*.[1]

d) Ngjarjet e këtij tregimi janë një mësim rreth durimit, për të gjithë besimtarët kumtues të kumtit; me durim e qëndrueshmëri vjen fitorja në të gjitha fushat, si dhe arritja e pozitës së lavdëruar e të lartë te Krijuesi i Gjithëfuqishëm.

e) Ndodh që provimi i një njeriu, në të njëjtën kohë të jetë provim edhe për shokët e tij e për të gjithë ata që janë rreth tij. Kuptohet se kjo bëhet që të njihet masa e miqësisë dhe dashurisë së tyre ndaj të sprovuarit. Njëkohësisht, me sprovimin e tyre del në shesh edhe besnikëria e tyre ndaj tij. Kur Ej'jùbi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* humbi pasurinë dhe shëndetin, shokët e tij u shpërndanë, madje nuk u mjaftuan që u larguan prej tij, por arritën deri aty, sa të bashkojnë edhe gjuhët e tyre me gjuhët e armiqve të tij në sharjet e në njollosjen e tij. Natyrisht që ata, me këtë veprim nxorën sheshit se si ishin në të vërtetë. Më sipër, pamë se Ej'jùbi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ndjente më shumë dhimbje prej plagëve që i shkaktonin gjuhët e tyre se sa ndjente dhimbjet që i vinin prej sëmundjes që kishte. Janë shumë të njohura vargjet e poezisë:

Mbyllen plagët e shigjetës

Por nuk mbyllen plagët e gjuhës

[1] Burimi i sipërm.

f) Të dashurit e All'llahut nuk janë ata që e përmendin All'llahun kur janë në gjendje të mirë; të dashurit e vërtetë të All'llahut janë ata që e përmendin All'llahun vazhdimisht, kur janë në gjendje të mirë dhe kur janë në gjendje të rënduar; ata e përmendin dhe e falënderojnë All'llahun kur kalojnë nëpër sprova të rënda dhe kur gëzojnë mirësitë e Tij, kur janë sëmurë dhe kur gëzojnë shëndet të plotë, kur janë të varfër dhe kur janë të pasur. Në të vërtetë, ndikimet e jetës materiale nuk lenë në besimin e tyre as edhe gjurmën më të vogël.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, në një bisedë konfidenciale me shokun e tij të ngushtë Hem'màmin, i përshkroi të devotëshmit me më shumë se 100 cilësi dhe në lidhje me njërën prej atyre cilësive, thotë: "*Prej atyre ka që e provojnë veten qoftë kur kalojnë nëpër sprova të rënda, qoftë kur janë në gjendje të mire.*".

g) Ky tregim theksoi edhe një herë të vërtetën se humbja e mundësive materiale, rënia e pësimeve të rënda mbi njeriun dhe kalimi nëpër probleme e në varfëri, nuk do të thotë se ai njeri nuk është i përfshirë në mëshirën e Krijuesit të Gjithëfuqishëm. Gjithashtu, as pasja e mundësive materiale nuk është argument që tregon largimin e njeriut prej All'llahut të Lartësuar. Njeriu ka mundësi të jetë rob shumë i afërt te All'llahu edhe kur ka në zotërim pasuri të mëdha e mundësi të shumta materiale, me kushtin që ai të mos bëhet rob, as i pasurive të veta, as i fëmijëve të tij e as i pozitës që ka dhe nëse të gjitha këto ai i humb, ai nuk e humb durimin për shkak se humbi gjithçka që kishte.

2- Ej'jùbi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* në Kur'àn dhe në Teuràt

Megjithëse Krijuesi i Gjithëfuqishëm, në Kur'ànin Famëlartë e lavdëron shpirtin e madh të këtij Profeti të lartë, nga fillimi i tregimit deri në fundin e tregimit të tij dhe e përshkruan atë si model të durimit dhe qëndrueshmërisë, me keqardhje shikojmë se historia e këtij Profeti të madh, nuk është ruajtur prej duarve të injorantëve dhe prej duarve të armiqve, të cilët e kanë përdhosur tregimin e tij, duke futur në të mite bajate, krejtësisht të papërshtatshëm me pozitën e tij të lartë; megjithëkëtë, ai mbetet i lavdëruar dhe krejtësisht i pastër prej të këtilla njollash të errëta. Prej këtyre miteve është edhe fjala se gjatë sëmundjes, krimbat, herë pas here mbulonin trupin e tij, aq sa trupi i maisej, në atë mënyrë sa banorët e fshatit ku ai banonte, u ndjenë ngushtë dhe e nxorën jashtë fshatit të tyre.

S'ka dyshim që të këtilla transmetime janë të falsifikuara edhe pse mund të gjenden në librat e haditheve e të transmetimeve islame. Kumti që mbajtën Profetët kërkon që Profeti i dërguar me kumt, në çdo kohë, patjetër është larg të këtilla stisjeve. Që njerëzit të mblidhen rreth Profetit dhe të tërhiqen prej fjalës së tij me dëshirë e me dashuri, patjetër në Profetin nuk mund të ketë gjëra që i bëjnë ata të kenë aq shumë neveri, deri sa i bëjnë të largohen prej tij, si, për shembull, sëmundje, apo të meta fizike e morale, sepse të gjitha këto janë në kundërshtim me filozofinë e kumtit të All'llahut. Kur'àni Famëlartë, në lidhje me rëndësinë e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* në ajetin 159 të sures "Àli Imràn", thotë: **"Me mëshirën që të dhuroi**

All'llahu, ti ishe i butë me ata, sikur ti të ishe i vrazhdë e zemërgur me ata, me siguri ata do të largoheshin prej teje…".

Ky ajet tregon se Profeti ka detyrë që prej tij të mos vijë asnjë gjendje e cila i bën ata që e rrethojnë të largohen prej tij; por, në Teuràt ka një pjesë të veçantë në lidhje me Ej'jùbin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* para kapitullit "Mezamijru e Dàùdit"; kjo pjesë e Teuràtit përfshin 42 kapituj dhe çdo kapitull shpjegon tema të ndryshme. Në disa prej këtyre kapitujve, trajtohen punë të këqija e të liga, si, për shembull, në kapitullin e tretë të kësaj pjese thuhet: Ej'jùbi ishte njeri që ankohej shumë, në një kohë që Kur'àni Famëlartë e lavdëron dhe e ngre lart pozitën e durimit e të qëndrueshmërisë së tij.

3- Përshkrimi i Profetëve të mëdhenj me cilësinë "eu'uàb"

Në këtë sure, tre Profetë janë përshkruar me cilësinë "eu'uàb" dhe ata janë: Dàùdi, Sulejmàni dhe Ej'jùbi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*. Gjithashtu, me këtë cilësi, në ajetin 32 të sures "Kàf", janë përshkruar edhe të gjithë banorët e Xhennetit: **"Kjo është premtuar për çdo njeri që kthehet te All'llahu dhe është ruajtës** (i besës së dhënë)**."**.

Shprehja *"eu'uàbun"*, shpjegon qartë se ai ishte në pozitë shumë të lartë dhe kur lexojmë burimet gjuhësore, vërejmë se fjala *"eu'uàbun"*, në rrënjën e saj *"euebe"*, do të thotë: kthim.

Ky kthim, duke pasur në konsideratë se fjala *"eu'uàbun"* është mbiemër në shkallën sipërore, do të thotë: rikthimet e shumta dhe të përsëritura. Gjithashtu tregon se ata që kthehen të

penduar te All'llahu, janë shumë të ndjeshëm ndaj shkaqeve e faktorëve që i largojnë ata prej All'llahut të Lartësuar, siç mund të jenë në shikimin e tyre furnizimi me bollëk dhe mahnitja pas shkëlqimit të gjërave të bukura të kësaj bote, ose ngacminet e vetes dhe cytjet e djallit. Nëse atyre u ndodh të largohen prej All'llahut, qoftë edhe vetëm për një çast, ata me shpejtësi kthehen te All'llahu të penduar; nëse ata janë të shkujdesur dhe nuk e kanë në mendje All'llahun, qoftë edhe për një çast, ata menjëherë e përmendin All'llahun.

Ky kthim mund të jetë në kuptimin e kthimit në bindje të urdhërave të All'llahut dhe qëndrimit larg prej gjërave e punëve që Ai i ka ndaluar; domethënë se urdhërat e All'llahut janë pika referimi dhe mbështetjeje për ata, kudo që të gjenden.

Fjala *"eu'uàbun"*, që ka ardhur në ajetin 10 të sures "Sebe": **"...o male dhe shpezë** (lavdërojeni) **së bashku me atë"**, domethënë: së bashku me Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* merr kuptimin: përsëritje e zërit. Gjithashtu, kjo fjalë shpjegon se urdhërat dolën për malet dhe për shpezët, që të përsërisin zërin së bashku me Dàùdin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Kështu që, fjala *"eu'uàbun"*, ka kuptimin e kujtdo që përsërit urdhërat e All'llahut, madhëron dhe e falënderon All'llahun, emrin e Tij e përsërisin të gjitha qeniet, sipas ligjeve të krijimit të Gjithësisë. Këtu duhet shtuar se njëri prej kuptimeve të fjalës *"eu'uàbun"*, është edhe emri Ej'jùb.

Ajetet: 45 – 48

وَٱذۡكُرۡ عِبَٰدَنَآ إِبۡرَٰهِيمَ وَإِسۡحَٰقَ وَيَعۡقُوبَ أُوْلِي ٱلۡأَيۡدِي وَٱلۡأَبۡصَٰرِ ﴿٤٥﴾ إِنَّآ
أَخۡلَصۡنَٰهُم بِخَالِصَةٖ ذِكۡرَى ٱلدَّارِ ﴿٤٦﴾ وَإِنَّهُمۡ عِندَنَا لَمِنَ ٱلۡمُصۡطَفَيۡنَ
ٱلۡأَخۡيَارِ ﴿٤٧﴾ وَٱذۡكُرۡ إِسۡمَٰعِيلَ وَٱلۡيَسَعَ وَذَا ٱلۡكِفۡلِۖ وَكُلّٞ مِّنَ ٱلۡأَخۡيَارِ
﴿٤٨﴾

“Kujto robtë Tanë Ibrahimin, Is’hàkun dhe Ja’kùbin, që ishin të fortë (në zbatimin e detyrave) **dhe largpamës** (në fe)**.”**

“Ne i pajisëm ata me virtytin e përmendjes së Botës Tjetër.”

“Patjetër që ata te Ne ishin prej të përzgjedhurve më të mire.”

“Kujto Ismàilin, Eljesan e Dhulkiflin; të gjithë janë prej më të mirëve.”

Komentimi

Gjashtë Profetët

Ajetet e përparme trokitën lehtë mbi jetën e Dàùdit dhe pak më gjatë mbi jetën e Sulejmànit, por përsëri trokitën shumë shkurt mbi jetën e Ej'jùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe shpjeguan pikat më të rëndësishme të atij Profeti të madh. Kurse në ajetet objekt i studimit të tanishëm, shpalosen emrat e gjashtë prej Profetëve të All'llahut dhe në mënyrë të shkurtër shpjegohen disa prej cilësive të tyre dalluese, cilësi që në të vërtetë mund të jenë një model i gjallë për çdo njeri.

Tërheq vëmendjen fakti se, në këto ajete, shpalosen gjashtë cilësi të ndryshme për të gjashtë Profetët e lartpërmendur, por çdo cilësi ka një kuptim të veçantë.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh i drejtohet drejtpërdrejt të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe në frazën e tij të parë i thotë: **"Kujto robtë Tanë Ibrahimin, Is'hàkun dhe Ja'kùbin."**.

Pozita e robërisë ndaj All'llahut të Lartësuar është cilësia që i dallon këta Profetë. Siç shihet, këta Profetë, në këtë ajet janë përmendur me cilësinë e "robërisë" në numrin shumës **"robtë Tanë"** dhe nga ky këndvështrim, robëria ndaj All'llahut do të thotë ndjekja pa kushte e vijës së All'llahut; gjithashtu, do të thotë: dorëzim i plotë ndaj vullnetit të All'llahut dhe gatishmëri e plotë për të zbatuar urdhërat e All'llahut në të gjitha gjendjet.

Robëria ndaj All'llahut do të thotë: robi s'ka nevojë për ndonjë tjetër veç Atij. Robi nuk i drejtohet për ndihmë e për ndonjë nevojë askujt tjetër, përveç All'llahut. Robi mendon vetëm në butësinë e në mëshirën e All'llahut. Pikërisht kjo shkallë e robërisë, është maja më e lartë e plotësimit të njeriut dhe nderimi më i madh për njeriun.

Në vijim, ajeti shton: **"...që ishin të fortë** (në zbatimin e detyrave) **dhe largpamës** (në fe)**."**.

Sa shprehje e bukur! Të fortë në zbatimin e detyrave dhe largpamës në punët e fesë!

Fjala *"ejdij"*, është shumësi i fjalës *"jedun"* – *"dorë"* dhe fjala *"ebsàr"* është shumësi i fjalës *"besarun"* – *"shikim në largësi"*.

Për realizimin e qëllimeve të tij, njeriu ka nevojë për dy forca; *e para:* fuqia për të kuptuar specifikimin e punëve dhe *e dyta:* kryerja sa më e mirë e punëve. Me fjalë të tjera, njeriu ka detyrë të përfitojë prej diturisë dhe prej fuqisë që çon drejt qëllimeve të tij.

Krijuesi i Gjithëfuqishëm i ka përshkruar Profetët e Tij me cilësinë e aftësisë për të kuptuar punët dhe fuqinë e largpamjes, si dhe me fuqinë e mjaftueshme për të realizuar punët e veta.

Pa dyshim që Profetët kanë një nivel të lartë diturie për ligjin e fesë së All'llahut, për sekretet e krijimit e për të panjohurat e jetës. Me fjalë të tjera, dituria e Profetëve është e pamundur të kufizohet.

Përshkrimi i Profetëve me cilësinë e vullnetit, vendosmërisë dhe aftësisë për të kryer punën sa më mirë,

vërteton se Profetët nuk janë përtacë, gjithashtu, vërteton se Profetëve nuk u mungojnë as mundësitë e as nuk janë të pafuqishëm. Përkundrazi, Profetët janë njerëz me vullnet të fuqishëm dhe të pajisur me vendosmëri të palëkundur. Profetët janë model për t'u ndjekur prej të gjithë atyre që ecin në rrugën e të Vërtetit. Profetët, përveç pozitës së lartë të robërisë ndaj All'llahut të Lartësuar, janë të armatosur edhe me këto dy armë të fuqishme që u përmendën.

Prej kësaj bisede, rezulton se, në këtë ajet, me fjalën "dorë" dhe "syri" nuk është qëllimi për dorën e për syrin, si organe të trupit të njeriut, që i kanë shumica e njerëzve; megjithëkëtë, ata nuk kanë aftësinë për të kuptuar punët, nuk kanë ndjenjat e mjaftueshme, nuk kanë vendosmëri për të vendosur dhe nuk kanë fuqi për kryer punë të mira. Në të vërtetë, fjalët "dorë" dhe "sy", në këtë ajet janë alegori për të shprehur cilësinë e diturisë dhe për të qenë model për t'u ndjekur.

Në lidhje me rëndësinë e cilësisë së katërt të tyre, Kur'àni Famëlartë thotë: **"Ne i pajisëm ata me virtytin e përmendjes së Botës Tjetër."**.

Po, Profetët kanë dituri për Botën Tjetër, horizonti i shikimit të tyre nuk përfundon te jeta e kësaj bote dhe te kënaqësitë e saj të kufizuara. Profetët vështrojnë edhe prapa jetës së kësaj bote, vështrojnë në Jetën e Përjetshme e në mirësitë e përhershme të asaj Jete, prandaj Profetët punojnë me ngulm, që të arrijnë Botën Tjetër me të gjitha mirësitë e saj.

Bazuar mbi këtë shpjegim, rezulton se me fjalën *"ed'dàr"* – *"shtëpi"* qëllimi është për Botën Tjetër, sepse s'ka shtëpi tjetër përveç asaj shtëpie, por edhe nëse do të gjendet një shtëpi tjetër,

kjo e fundit nuk është gjë tjetër veçse një urë, ose vendkalim, që, në fund të fundit, çon në botën Tjetër.

Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, janë shprehur se qëllimi me fjalën *"ed'dàr"* – *"shtëpi"* është për jetën e kësaj bote dhe shprehja **"përmendja e Botës Tjetër"**, tregon përmendjen e këtyre Profetëve me fjalë të mira në këtë botë, por kjo mundësi interpretimi është krejtësisht e përjashtuar, veçanërisht për faktin se fjala e ajetit *"ed'dàr"*, ka ardhur e pakushtëzuar, kështu që nuk është në përshtatje me kuptimin e fjalës *"dhikra"* – *"përmendje"*.

Të tjerë kanë thënë se me shprehjen **"përmendja e Botës Tjetër"**, qëllimi është përmendja e Profetëve me fjalë të mira në Botën Tjetër, por edhe ky interpretim është krejtësisht i përjashtuar.

Në të gjitha gjendjet, duhet që njeriu herë pas here të mbajë në mendje Botën Tjetër, veçanërisht me rastin e vdekjes së ndonjërit prej shokëve e miqve të tij, ose me rastin e pjesëmarrjes në ceremonitë e varrimit, ose në raste kur mblidhen në rrethet e përmendjes së All'llahut (halekat e ziqrit), por edhe kjo përmendje e All'llahut në të tilla raste, nuk është krejtësisht e pastër, pasi njerëzit edhe në të këtilla raste do të mendojnë për punët e kësaj bote. Kurse robtë e sinqertë të All'llahut kanë një orientim të pastër, të thellë e të vazhdueshëm, në lidhje me Botën Tjetër, e cila gjithmonë u del atyre para syve dhe fjala *"khàlisatin"* - *"virtytin"* e shpreh qartë këtë kuptim.

Cilësia e pestë dhe e gjashtë për ata Profetë vjen në ajetin vijues: **"Patjetër që ata te Ne ishin prej të përzgjedhurve më të mirë."**.

Në të vërtetë, besimi i tyre dhe puna e tyre e mirë ishin shkaku që Krijuesi i Gjithëfuqishëm i përzgjodhi ata në mesin e njerëzve për t'i ngarkuar me misionin e profetnisë dhe mbajtjen e kumtimin e kumtit. Puna e tyre e mirë kishte arritur në atë shkallë, sa ata me të drejtë e merituan të përshkruhen me shprehjen: **"më të mirët";** mendimet e tyre janë të shëndosha, moralet e tyre janë të larta, veprimet e punët e tyre gjatë jetës së tyre janë të pastra dhe ky është shkaku që, disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, kanë nxjerrë përfundim prej kësaj shprehjeje se All'llahu i Lartësuar i ka konsideruar ata Profetë **"më të mirët"** pa asnjë kusht dhe ky është argument që tregon ruajtjen e plotë të Profetëve prej gabimeve, sepse, kur gjithë trupi i njeriut është i mirë, me siguri që ai është edhe i ruajtur prej gabimeve.[1]

Fjala *"indenà"* – *"te Ne"* është e mbushur me kuptime të thella dhe tregon se përzgjedhja e Profetëve dhe konsiderimi i tyre prej më të mirëve, nuk plotësohet vetëm sipas vlerësimit të njerëzve, kur dihet se vlerësimi i njerëzve në shumicën e punëve nuk është pa ndonjë shkujdesje, ose pa ndonjë pikëpamje vetiake dhe plotësohet vetëm pas verifikimit se vlerësuesit janë të aftë për të bërë vlerësim. Natyrisht që vlerësimi i tyre ka lidhje të ngushtë me vlerësimin që ata u bëjnë punëve nga ana e jashtme dhe nga ana e brendshme.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh fliste për tre Profetë të dalluar; ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh flet për tre Profetë të tjerë dhe thotë: **"Kujto Ismàilin, Eljesan e Dhelkiflin; të gjithë janë prej më të mirëve."**.

[1] Tefsiri "El Kebijr", vëll. 26, f. 217.

Çdonjëri prej tyre ishte shembull e model për t'u ndjekur, në durimin, në qëndrimin e drejtë dhe në bindjen ndaj urdhërave të Krijuesit të Gjithëfuqishëm, sidomos Ismaili, i cili ishte plotësisht i gatshëm të flijohej në rrugën e All'llahut dhe për këtë shkak ai thirret "i flijuari i All'llahut". Gjithashtu, Ismaili dha ndihmesën e tij në ndërtimin e Qabesë, së bashku me babanë e tij Ibrahimin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)* dhe vënien e bazave të tubimit të madh që realizohet çdo vit në ritualet e kryerjes së Haxhit.

Ajetet e Kur'ànit Famëlartë, e shpalosin jetën e atyre të mëdhenjve me qëllim që ata të ishin shembull për të Dërguarin e All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe patjetër që të ishin model e shembull prej të cilëve myslimanët të nxjerrin mësim duke lexuar jetën e atyre burrave të mëdhenj. Me këto tregime të Kur'ànit Famëlartë, synohet që ato të orientojnë njeriun dhe të ngjallin në atë frymën e përkushtimit, shpirtin e sakrificës, dashurinë për tjetrin dhe në të njëjtën kohë, cilësitë e larta të këtyre Profetëve shtojnë në njeriun durimin dhe e bëjnë atë të qëndrueshëm para problemeve e ndodhive të vështira e të rënda.

Fraza **"të gjithë janë prej më të mirëve"**, thekson se përshkrimi i këtyre tre Profetëve: Ismail, Eljesa dhe Dhulkifli me shprehjen **"prej më të mirëve"**, përputhet plotësisht me të gjitha cilësitë e larta me të cilat All'llahu i Lartësuar përshkroi tre Profetët e tjerë: Ibrahimin, Is'hàkun dhe Ja'kùbin, të cilët, siç e pamë edhe ata u quajtën "më të mirët" dhe duke pasur parasysh se vetë fjala "të mirët", në këtë jete ka ardhur e pakushtëzuar, kjo fjalë ka kuptime të shumta, që përfshijnë profetninë, Botën Tjetër,

pozitën e robërisë ndaj All'llahut, diturinë dhe fuqinë për të kryer punët e ngarkuara.

Në Kur'ànin Famëlartë, emri Eljesa është përmendur dy herë, në këtë sure (në suren "Sàd") dhe në ajetin 86 të sures "El En'àm". Fjalët e ajeteve të Kur'ànit Famëlartë, tregojnë se Eljesa është prej Profetëve të mëdhenj, madje është prej atyre Profetëve, për të cilët Kur'àni Famëlartë, në ajetin 86 të sures "El En'àm", thotë: **"...të gjithë këta i veçuam mbi njerëzit e tjerë."**.

Disa besojnë se Eljesa është Jusha bin Nùni, i cili është njëri prej Profetëve të njohur të Beni Israilëve.

Ajeti 86 i sures "El En'àm", shpjegon se Eljesa është prej pasardhësve të Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)* por nuk shpjegon se Eljesa ishte apo nuk ishte prej Profetëve të Beni Isailëve.

Në kapitullin "Mbretërit" të Teuràtit, emri Eljesa përmendet me emrin El Jesha bin Shàfàt. Në hebraisht, fjala "El Jesha" do të thotë shpëtuesi, kurse fjala Shàfàt, në këtë gjuhë do të thotë gjykatës.

Disa të tjerë, kanë thënë se Eljesa është Hidri, por s'ka asnjë argument që të vërtetojë këtë thënie.

Disa të tjerë, kanë thënë se Eljesa është Dhulkifli, por kjo fjalë është në kundërshtim të plotë me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit objekt studimi, pasi emri Dhulkifl përmendet i ndarë prej emrit Eljesa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)*.

Në të gjitha gjendjet, Eljesa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* është Profet me pozitë të lartë dhe prej atyre Profetëve, që në

Kur'ànin Famëlartë përmenden për qëndrimet e tyre të drejta dhe kaq sa thamë në lidhje më rëndësinë e këtij Profeti, është e mjaftueshme që njerëzit të frymëzohen prej punës e prej jetës së tij.

Përsa i përket Dhulkiflit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ai njihet si njëri prej Profetëve të All'llahut dhe emri i tij është përmendur në Kur'ànin Famëlartë së bashku me emrat e Profetëve të tjerë në këtë sure (suren "Sàd") dhe në ajetin 85 të sures "El Enbija", ku emri i tij vjen menjëherë pas emrit të Ismailit dhe emrit të Idrisit. Disa besojnë se Dhulkifli është prej Profetëve të Beni Israilëve dhe se është prej bijve të Ja'kùbit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)* gjithashtu, ata thonë se emri i tij i vërtetë është Bishr, Beshijr, ose Sheref; të tjerë mendojnë se Dhulkifli është Hazekili dhe Dhulkifl është epiteti me të cilin thirrej Hazekili.[1]

Fjala *"kifl"* do të thotë pjesa që të takon. Por kjo fjalë ka edhe kuptimin: kujdestari. Në lidhje me emrin Dhulkifl janë bërë disa interpretime, prej të cilave rendisim:

Disa kanë thënë: U quajt Dhulkifl, për shkak se All'llahu i Lartësuar i dha atij si pjesë shumë shpërblime dhe e përfshiu në mëshirën e Tij.

Disa të tjerë, kanë thënë: Ai ishte i përkushtuar në faljen e namazit natën dhe në adhurim, ai agjëronte ditën, ai kurrë nuk zemërohej prej vendimit të All'llahut dhe për të gjitha këto, ai u quajt me këtë emër.

[1] "A'làmul Kur'àn"; tefsiri i Kurtubij'jit; tefsiri "Rùhul Meànij", tefsiri "El Mijzàn", të gjithë këto libra tregojnë një pjesë prej kësaj teme.

Disa të tjerë, kanë thënë: U quajt Dhulkifl, për shkak se ai mori nën kujdesin e tij një grup prej Profetëve të Beni Israilëve dhe i shpëtoi ata prej mbretërve tiranë të kohës së tyre.

Si do që të jetë, informacionet që ne kemi sot në dorë për Profetin e All'llahut Dhulkifl *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* tregojnë se ai ishte i përkushtuar të ecte në rrugën e bindjes ndaj All'llahut të Lartësuar dhe në rrugën e adhurimit të përkushtuar vetëm All'llahut të Lartësuar, si dhe për qëndresën e tij ndaj tiranëve. Gjithashtu, Dhulkifli, me qëndrimet e me punën e tij, është model për ditët tona dhe për ditët që do të vijnë, pavarësisht se largësia e madhe kohore që shtrihet në mes tij e në mes nesh, ka bërë që të mos njohim hollësi të tjera prej gjendjeve të atyre Profetëve.

Ajetet: 49 – 54

هَـٰذَا ذِكْرٌ ۚ وَإِنَّ لِلْمُتَّقِينَ لَحُسْنَ مَـَٔابٍ ﴿٤٩﴾ جَنَّـٰتِ عَدْنٍ مُّفَتَّحَةً لَّهُمُ
ٱلْأَبْوَٰبُ ﴿٥٠﴾ مُتَّكِـِٔينَ فِيهَا يَدْعُونَ فِيهَا بِفَـٰكِهَةٍ كَثِيرَةٍ وَشَرَابٍ ﴿٥١﴾ ۞
وَعِندَهُمْ قَـٰصِرَٰتُ ٱلطَّرْفِ أَتْرَابٌ ﴿٥٢﴾ هَـٰذَا مَا تُوعَدُونَ لِيَوْمِ ٱلْحِسَابِ
﴿٥٣﴾ إِنَّ هَـٰذَا لَرِزْقُنَا مَا لَهُۥ مِن نَّفَادٍ ﴿٥٤﴾

“Kjo është kujtesë dhe për të devotshmit me siguri ka një të ardhme të mirë.” “Xhennetet e Adnit me dyer të hapura për ata.”

“Të mbështetur në ata (kolltukë) **nga ku kërkojnë pemë dhe pije të llojeve të ndryshme.”**

“Pranë tyre janë syulurat të një moshe.”

“Këto janë premtuar për Ditën e Llogaridhënies.”

“Ky është furnizimi Ynë, që s’ka të mbaruar.”

Komentimi

Kjo u është premtuar të devotshmëve

Ajetet e kësaj sureje na kalojnë në një bisedë tjetër, kur fillojnë të bëjnë krahasimin në mes të përkushtuarve dhe kundërshtuesve arrogantë; gjithashtu, në këtë grup ajetesh, shpjegohet se si do të jetë e ardhmja e çdonjërit prej tyre Ditën e Gjykimit. Në përgjithësi, ajetet objekt studimi plotësojnë studimet e bëra në ajetet e përparme.

Në fillim, si përmbledhje e shpjegimit të gjendjes së Profetëve të përparshëm dhe pikave më të ndritura në jetën e tyre, ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, në frazën e tij të parë thotë: **"Kjo është kujtesë…"** .[1]

Po, shpalosja e disa fragmenteve prej historisë mbresëlënëse të atyre katër Profetëve të ndritur, nuk ka qëllim thjesht trajtimin e disa tregimeve; jo, por qëllimi është që njerëzit të kujtohen e të mendojnë rreth mësimeve të atyre Profetëve, ashtu siç theksohet për këtë në fillim të sures: **"Sàd, betohem në Kur'ànin plot me kujtesa."**.

[1] Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, në interpretimin e kësaj shprehjeje kanë thënë se qëllimi është kujtimi me fjalë të bukura i Profetëve të përparshëm.

Me fjalë të tjera, qëllimi është zgjimi i mendimeve, ngritja e nivelit të diturisë, shtimi i fuqisë rezistuese dhe qëndrueshmërisë ndër myslimanët, për të cilët kanë zbritur këto ajete.[1]

Më pas, punët dalin jashtë rrethit të ngushtë të shpjegimit të gjendjeve të veçanta të Profetëve dhe kalojnë në karakterin e përgjithshëm të punës, me qëllim që të shpjegohet sa më qartë e ardhmja e të përkushtuarve, ashtu siç njoftohet për këtë në fjalinë e dytë të ajetit objekt studimi: **"...dhe për të devotshmit me siguri ka një të ardhme të mirë."**.[2]

Pas këtij ajeti të shkurtër, me kuptime të padukshme që shpjegojnë plotësisht gjendjen e të përkushtuarve, në mënyrë fare të përmledhur, Kur'àni Famëlartë, në ndjekje të metodës së tij, domethënë të metodës së fjalëve të pakta e të shkoqitura, në ajetin vijues shpjegohet fitorja që do të arrijnë të përkushtuarit: **"Xhennetet e Adnit me dyer të hapura për ata."**.[3]

Fjala *"xhen'nàtin"*, tregon lulishtet e Xhennetit. Kurse fjala *"adnin"* do të thotë: vend i qëndrueshëm e i stabilizuar. Në rrënjën e saj, fjala *"adnin"*, *"ma'dinun"*, është në kuptimin e vendit

[1] Një grup interpretuesish të Kur'ànit Famëlartë, kanë thënë se fraza **"Kjo është kujtesë"**, tregon se ato që janë thënë në lidhje me rëndësinë e Profetëve, si përmendja me fjalë të mira e me lavdërime, tregon pikërisht këtë, kurse ajetet vijues do të tregojnë gradën e lartë të Profetëve në Botën Tjetër, por ky kuptim përjashtohet, sepse kuptimi që shprehin fjalët e ajetit, nuk është në përshtatje me atë që u tha më sipër.

[2] Fjala *"meàbin"*, do të thotë: kthim, por duke i shtuar kësaj fjale edhe fjalën "të mirë", që është cilësor për fjalën e parë, atëherë kuptimi del qartë: kthim dhe të ardhme të mirë.

[3] Fraza e ajetit **"Xhennetet e Adnit"** është plotësor shpjegues për fjalën "të ardhme".

ku nxirren mineralet e metaleve dhe fjala *"ma'dinun"* përdoret për të treguar një mineral.

Si do që të jetë, kjo shprehje këtu tregon se lulishtet e Xhennetit janë të përhershme.

Kurse fraza e ajetit **"...me dyer të hapura për ata"**, tregon se ata nuk mbahen me të madh, derisa për ata të hapen portat e Xhennetit. Portat e Xhenneteve do të hapen lehtë për të pritur banorët e Xhennetit, sepse Xhenneti është përgatitur për të pritur të devotshmit dhe kur Xhenneti i sheh ata, para tyre hapen portat e Xhennetit dhe ata ftohen të hyjnë në të.

Më pas, në ajetin vijues, shpjegohet qetësia që i rrethon banorët e Xhennetit dhe për këtë ajeti njofton: **"Të mbështetur në ata** (kolltukë) **nga ku kërkojnë pemë dhe pije të llojeve të ndryshme."**.[1] Domethënë: Ata janë të mbështetur në kolltuqet që janë në Xhennet. Gjithashtu, banorët e Xhennetit janë përgëzuar se do të kenë lloje të shumta e të ndryshme frutash e pijesh dhe se, sapo të kërkojnë diçka, ajo që kërkuan menjëherë u vjen pranë.

Këtu shtrohet *pyetja*: A është dikush që i mbart këto fruta e pije dhe ua servir ato banorëve të Xhennetit, apo frutat e pijet vijnë te banorët e Xhennetit pa i mbartur askush?

Përgjigje: Të dyja mundësitë kanë ardhur në tekstin e Kur'ànit.

---

[1] Përemri *"hà"* – *"në atë (Xhennet)"* i bashkëngjitur me parafjalën *"fij"*, u referohet të dyja gjendjeve të "Xhenneteve të Adnit", kurse përshkrimi i frutave me fjalën "shumë", tregon se ato janë të shumëllojshme, njëkohësisht, me këtë cilësim përshkruhen edhe pijet; kurse fjala e ajetit *"mut'teki'ijne"* – *"të mbështetur"* tregon gjendjen e njerëzve të cilëve u referohet përemri "ata" në fjalën *"lehum"* – *"për ata"*.

Fakti që janë theksuar vetëm "frutat" e "pijet", tregon se frutat janë ushqimi më me shumicë për banorët e Xhennetit, megjithëse gjenden edhe lloje të shumta e të ndryshme ushqimesh, që janë përmendur në disa ajete të Kur'ànit Famëlartë, ashtu siç janë edhe në jetën e kësaj bote, ku frutat përbëjnë ushqimin më të mirë e më të shëndetshëm për njeriun.

Fjala "shumë", tregon se ka lloje të ndryshme frutash e lloje të ndryshme pijesh të pastra dhe se të gjitha në Xhennet janë me shumicë, ashtu siç tregohet për këtë në ajetet e Kur'ànit Famëlartë.

Ajetet e Kur'ànit flasin edhe për gratë e mira në Xhennet dhe ajeti vijues njofton:

"Pranë tyre janë syulurat të një moshe.".

Fjala e ajetit *"et'tarfi"*, do të thotë: *"qerpiku i syrit"*; gjithashtu edhe cilësimi i grave të Xhennetit me cilësorin **"syulurat"**, domethënë se ato nuk i hedhin sytë të shikojnë larg, tregon se ato i përqendrojnë shikimet vetëm mbi burrat e vet; njëkohësisht tregon dashurinë që kanë gratë e Xhennetit për burrat e vet dhe se ato mendojnë vetëm për ata. Pa dyshim që këto janë prej cilësive më të mira e më të bukura të grave.

Të tjerë interpretues të Kur'ànit Famëlartë, kanë thënë: gratë e Xhennetit kanë vënë në kokë rrobën islame (khimàr) dhe se kjo rrobë e shton akoma më shumë bukurinë e syrit të gruas.

Nuk ka asnjë ndalues që e pengon që kjo fjalë e ajetit të tregojë të dy kuptimet.

Fjala e ajetit *"etràbun"*, do të thotë: të një moshe dhe kjo është njëra prej cilësive të grave të Xhennetit, pasi mosha e

barabartë e burrit me gruan, shton më shumë dashurinë në mes bashkëshortëve në Xhennet. Ose kjo fjalë tregon se të gjitha gratë banore të Xhennetit do të jenë në një moshë të barabartë.

Ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh, e vë theksin mbi mirësinë e shtatë, që Krijuesi i Gjithëfuqishëm e ka dhënë me shumicë për banorët e Xhennetit, mirësi që ka ardhur edhe në ajetet e përparme dhe për këtë, ajeti vijues njofton: **"Këto janë premtuar për Ditën e Llogaridhënies."**.

Është premtim që kurrë nuk thyhet dhe në të njëjtën kohë, është premtim i atillë që gjallëron veprimtarinë dhe dyfishon përpjekjet, sepse është premtim prej All'llahut, Madhështorit.

Për të theksuar se këto mirësi janë të përjetshme, i Larti njofton me fjalën e Tij: **"Ky është furnizimi Ynë, që s'ka të mbaruar."**.[1]

Ajeti njofton se mirësitë e Xhennetit janë të përhershme e të përjetshme dhe mirësitë e Xhennetit as nuk mbarohen e as nuk zhduken, ashtu siç ndodh në jetën e botës së Tokës; në të kundërt, mirësitë e Xhennetit shtohen gjithmonë prej depozitave të All'llahut dhe gjithmonë depot e All'llahut janë të mbushura pa kufi. Veç kësaj, mirësitë e Xhennetit janë pa asnjë të metë, sepse ky është vullneti i All'llahut të Gjithëfuqishëm.

[1] Fjala e ajetit *"nefâdin"*, do të thotë: *"zhdukje e asgjësim"*.

Ajetet: 55 – 61

هَـٰذَا ۚ وَإِنَّ لِلطَّـٰغِينَ لَشَرَّ مَـَٔابٍ ﴿٥٥﴾ جَهَنَّمَ يَصْلَوْنَهَا فَبِئْسَ ٱلْمِهَادُ ﴿٥٦﴾
هَـٰذَا فَلْيَذُوقُوهُ حَمِيمٌ وَغَسَّاقٌ ﴿٥٧﴾ وَءَاخَرُ مِن شَكْلِهِۦٓ أَزْوَٰجٌ ﴿٥٨﴾ هَـٰذَا
فَوْجٌ مُّقْتَحِمٌ مَّعَكُمْ ۖ لَا مَرْحَبًۢا بِهِمْ ۚ إِنَّهُمْ صَالُوا۟ ٱلنَّارِ ﴿٥٩﴾ قَالُوا۟ بَلْ أَنتُمْ
لَا مَرْحَبًۢا بِكُمْ ۖ أَنتُمْ قَدَّمْتُمُوهُ لَنَا ۖ فَبِئْسَ ٱلْقَرَارُ ﴿٦٠﴾ قَالُوا۟ رَبَّنَا مَن قَدَّمَ
لَنَا هَـٰذَا فَزِدْهُ عَذَابًا ضِعْفًا فِى ٱلنَّارِ ﴿٦١﴾

“Kështu është, për mizorët (jobesimtarët) **ka të ardhme shumë të keqe.”**

“Xhehennemi ku do të digjen, s’ka vendqëndrim më të keq se ai (Xhehennemi)**.”**

“Ky është ujë i valuar e i ndyrë, prej atij (uji) **le të pinë.”**

“Edhe një tjetër (dënim) **në formën e tij dyfish.”**

“Ky grup bashkohet me ju; për ata s’ka mirëseerdhët; ata patjetër do të digjen në zjarr.”

"Ata (që nuk ishin prej parisë) **thanë: jo, për ju** (parinë) **s'ka mirëseerdhët; ju e përgatitët këtë për ne; sa vendqëndrim i keq!"**

"Ata (që nuk ishin prej parisë) **thanë: o Zoti ynë, atij që e përgatiti këtë për ne, shtoji dënimin dyfish në zjarr."**

Komentimi

Ky është fundi i mizorëve:

Ajetet e përparshme shpalosën shtatë mirësi të tjera që Krijuesi i Gjithëfuqishëm ka dhuruar me shumicë për robtë e Tij të përkushtuar, kurse ajetet objekt i studimit tonë, përdorin metodën e krahasimit, ashtu siç përdoret shpesh kjo metodë në Kur'ànin Famëlartë, për të treguar të ardhmen e tmerrshme dhe llojet e dënimeve të dhimbshme që i presin mizorët e kundërshtarët mëkatarë, ashtu siç njofton i Larti me fjalën e Tij: **"Kështu është, për mizorët** (jobesimtarët) **ka të ardhme shumë të keqe."**.

Për të përkushtuarit ka të ardhme më të mirë, kurse për këta mizorë ka të ardhme më të keqe.

Më pas, ajetet e Kur'ànit Famëlartë, nëpërmjet metodës së fjalës së shkurtër, por shumë shpjeguese, njoftojnë: **"Xhehennemi**

ku do të digjen, s'ka vendqëndrim më të keq se ai (Xhehennemi).**"**, domethënë: Xhehennemi është vendi i vuajtjeve të tmerrshme, vendi ku ata do të futen dhe do të digjen në zjarrin e tij, a mund të ketë shtroje më të këqija!?

Duket qartë se shprehja *"jesleunehà"*, është në kuptimin: ata hyjnë në Xhehennem dhe digjen në zjarrin e tij. Me këtë shprehje, qëllimi është që të shpjegohet qartë se askush prej atyre të mos mendojë se ai do ta shohë Xhehennemin prej një distance të largët, ose edhe mund të zërë vend pranë Xhehennemit; në asnjë mënyrë, mohuesi patjetër do të hyjë brenda në Xhehennem. Gjithashtu, askush prej atyre të mos mburret se ai do të hyjë në zjarrin e Xhehennemit dhe pastaj do të familjarizohet me zjarrin. Jo dhe jo, ai do të digjet në zjarrin e Xhehennemit vazhdimisht.

Fjala e ajetit *"mihàd"*, siç kemi thënë edhe më sipër, do të thotë: shtroje e përgatitur për gjumë e për pushim; gjithashtu, kjo fjalë përdoret për të treguar edhe krevatin (djepin) e fëmijës.

Natyrisht që shtrojet janë vend për pushim e qetësi, prandaj duhet të jenë të përshtatshme dhe është vetë njeriu që zgjedh për vete shtroje të përshtatshme, në të gjitha gjendjet që ai mund të ndodhet. Por, si do të jetë gjendja e atyre njerëzve për të cilët është caktur që zjarri i Xhehennemit të jetë shtroje për ata!

Ajeti vijues flet për një lloj tjetër dënimi hyjnor dhe njofton: **"Ky është ujë i valuar e i ndyrë, prej atij** (uji) **le të pinë."**, domethënë: ata patjetër do të pinë ujë të valuar e të ndyrë.

Fjala *"hemijmùn"*, do të thotë se uji i tejnxehur është njëri prej llojeve të pijeve për banorët e Xhehennemit. Kjo shprehje qëndron kundrejt shprehjes "pije e pastër", që u përmend në

ajetet e sipërme, për të treguar cilësinë e pijeve të banorëve të Xhennetit.

Fjala e ajetit *"gas'sàkun"*, në rrënjën e saj *"gasekun"*, do të thotë: shtimi i errësirave të natës. Kurse Ibni Ab'bàsi e ka interpretuar këtë fjalë në kuptimin e pijes shumë të ftohtë, madje aq e ftohtë, sa ftohtësia e asaj pijeje e djeg qiellzën e gojës së njeriut. Por këtu kjo fjalë e ajetit nuk është në këtë kuptim, por është thjesht në kuptimin krahasues me ujin e tejnxehur. Natyrisht që ky krahasim në mes dy llojeve të pijeve, "i tejnxehur" dhe "shumë i ftohtë", është bërë burimi për këto interpretime.

Ragibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit Famëlartë "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", shpjegon se fjala e ajetit *"gas'sàkun"*, do të thotë: qelbi që kullon prej lëkurave dhe prej trupave të banorëve të Xhehennemit.

Patjetër që ngjyra e atij uji duhet të jetë shumë e zezë, deri sa për këtë lloj uji është përdorur fjala *"gas'sàkun"*, sepse ai që digjet në zjarrin e Xhehennemit, prej atij s'mbetet gjë tjetër përveçse një skeleti të djegur dhe një qelbi me ngjyrë të zezë.

Si do që të jetë, prej disa shpjegimeve mësohet se shprehja e ajetit *"gas'sàkun"*, do të thotë: erë e keqe dhe e rëndë, që shqetëson të tjerët.

Disa të tjerë, e kanë interpretuar fjalën *"gas'sàkun"* në kuptimin e një lloj ndëshkimi, për të cilin s'ka dijeni askush përveç All'llahut të Lartësuar, sepse ata që do të dënohen me këtë lloj ndëshkimi, kanë bërë aq mëkate të mëdha e aq shumë padrejtësi, sa vetëm All'llahu ka dijeni për punët e tyre të këqija,

prandaj edhe ndëshkimi i tyre është sekret dhe nuk është bërë i njohur, ashtu siç ka premtuar Krijuesi i Gjithëfuqishëm për të përkushtuarit mirësi të shumta dhe nuk ka njoftuar si janë ato mirësi. Natyrisht edhe ky mosnjoftim është për shkak se të përkushtuarit punët e tyre të mira në këtë botë i bënin pa i marrë vesh askush, ashtu siç njoftohet në ajetin 17 të sures "Es Sexhde": **"Askush nuk ka dijeni për atë kënaqësi** (të shpirtit e të zemrës) **që atyre nuk u është treguar…"**.

Ajetet objekt studimi e vënë theksin edhe një herë tjetër mbi një lloj ndëshkimi të dhimbshëm dhe në ajetin vijues njoftohet se: **"Edhe një tjetër** (dënim) **në formën e tij dyfish"**; domethënë: atje ka edhe një ndëshkim tjetër shtesë.

Fjala e ajetit *"ezvàxhun"*, do të thotë lloje dhe pjesë. Kjo shprehje tregon shkurtimisht për një lloj tjetër ndëshkimi, që nuk ndryshon prej llojeve të ndëshkimeve të mëparshme, por ajetet e Kur'ànit këtu nuk e kanë shprehur me qartësi llojin e atij ndëshkimi, prandaj askush në këtë botë s'ka mundësi ta kuptojë e ta marrë me mend si do të jetë ai ndëshkim.

Në të vërtetë, shprehja *"ezvàxhun"* – *"dyfish"* është vënë kundrejt shprehjes *"fàkihetin kethijretin"* – *"shumë fruta"* që pamë në ajetet e përparme dhe që shprehte lloje të ndryshme mirësish dhe llojet e shumta të frutave në Xhennet dhe nga ky këndvështrim, shprehja *"ezvàxhun"*, ka mundësi të jetë një shembull krahasues me dhimbjen e fortë në Xhehennem, ose me dhimbjet që u vijnë banorëve të Xhehennemit nga të gjitha anët.

Ndëshkimi i fundit për banorët e Xhehennemit është se shokët e tyre në Xhehennem do të jenë ata që flasin vetëm me fjalë

të këqija dhe kur krerët e rrugës së humbjes të futen në zjarr dhe të shikojnë se edhe pasuesit e tyre çohen drejt Xhehennemit, ata do t'i thonë njëri-tjetrit: **"Ky grup bashkohet me ju."**.

Ata u përgjigjen: **"për ata s'ka mirëseerdhët"**.

Pastaj shtojnë: **"ata patjetër do të digjen në zjarr"**.

Fraza **"Ky grup bashkohet me ju"**, u bashkohet ajeteve vijues dhe tregon fjalët që ata shkëmbejnë njëri me tjetrin. Tregon bisedën e krerëve të rrugës së humbjes, sapo shikojnë se edhe pasuesit e tyre po çohen në drejtim të Xhehennemit dhe thonë: Edhe këta do të jenë së bashku me ju.

Disa interpretues të Kur'ànit, kanë thënë se këto fjalë ua thonë engjëjt krerëve të rrugës së humbjes.

Gjithësesi, kuptimi i parë është më shumë në përshtatje me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit.

Fjala e ajetit *"merhaben"* – *"mirëseerdhe"* është përshëndetja me të cilën pritet miku që vjen në shtëpi dhe nga ana gjuhësore është në kuptimin e vendit të gjerë, kurse në këtë ajet është në kuptimin: hyr se vendi është i gjerë dhe i përshtatshëm.

Fjala e ajetit *"muktehimun"*, do të thotë: hyrja në një vend me vështirësi të mëdha e me frikë, por në shumicën e herëve jep kuptimin e hyrjes në një vend pa pasur paraprakisht asnjë informacion e pa ditur asgjë se ku do të hyhet.

Kjo shprehje, tregon se pasuesit e rrugës së humbjes, do të futen në Xhehennemin tmerrues për shkak se hoqën dorë prej studimit e të menduarit dhe ndoqën dëshirat e tyre, si dhe për

shkak se ata ndoqën verbërisht traditën e stërgjyshërve të tyre të përparshëm.

Në të gjitha gjendjet, tingujt e fjalëve të parisë arrijnë në veshët e pasuesve, të cilët zemërohen shumë prej fjalëve të krerëve të rrugës së humbjes, prandaj u kthehen atyre me këto fjalë: **"Ata** (që nuk ishin prej parisë) **thanë: jo, për ju** (parinë) **s'ka mirëseerdhët; ju e përgatitët këtë për ne; sa vendqëndrim i keq."**.

Fraza e fundit e këtij ajeti *"fe bi'sel karàru"* – *"sa vendqëndrim i keq"* është vënë kundrejt frazës: *"xhen'nàti adnin"* – *"lulishtet e Adnit"* që ka ardhur në ajetet e sipërme në lidhje me shpërblimin për të përkushtuarit dhe tregon vështirësitë e mëdha që do të rëndojnë mbi banorët e Xhehennemit. Gjithashtu, tregon se Xhehennemi nuk është për mohuesit një vendqëndrim i përkohshëm, por është vendi ku ata do të qëndrojnë përgjithmonë. Pasuesit e krerëve të rrugës së humbjes, me fjalën e tyre kishin qëllim t'i thoshin parisë: Është fatmirësi që ju dhe idhujtarët e tjerë do të jeni bashkë me ne në këtë vend. Fakti që ju jeni së bashku me ne, është ilaç për zemrat tona (sikur me këto fjalë ata i shajnë krerët e tyre), ose tregon se ata u thonë krerëve të tyre: Krimi që ju keni bërë kundër nesh, është krim shumë i rëndë, prandaj Xhehennemi do të jetë për ju vendqëndrim i përhershëm dhe jo i përkohshëm.

Por pasuesit nuk mjaftohen vetëm me aq sa thanë, sepse krerët e rrugës së humbjes janë shkaku i drejtpërdrejtë që ata mëkatuan e bënë faje, prandaj pasuesit i konsiderojnë krerët e vet se ata janë kriminelët e vërtetë dhe në këtë gjendje i drejtohen Krijuesit të Gjithëfuqishëm me këto fjalë: **"Ata** (që nuk ishin prej

parisë) **thanë: o Zoti ynë, atij që e përgatiti këtë për ne, shtoji dënimin dyfish në zjarr."**.

Ndëshkimin e parë, për shkak se ata, me dashjen e tyre shkuan në rrugën e humbjes dhe ndëshkimin e dytë, për shkak se ata na futën edhe ne në rrugën e humbjes.

Përmbajtja e këtij ajeti, është e ngjashme me përmbajtjen e ajetit 38 të sures "El A'ràf": **"... o Zoti ynë, këta** (paria) **na futën në rrugën e humbjes, prandaj jepu atyre ndëshkim dyfish në zjarr..."**; por plotësimi i këtij, pra ajetit 38 të sures "El A'ràf", njofton se për të dyja palët (pari e pasues) ka ndëshkim dyfish, për shkak se pasuesit ishin veglat ekzekutuese të urdhërave të krerëve të rrugës së humbjes dhe ishin ata që e përgatitën terrenin për përhapjen e imoralitetit e të idhujtarisë.

Po, ky është fundi i kujtdo që lidh miqësi me të shmangurit prej rrugës së drejtë dhe u jep atyre besën se edhe ata do të ecin në rrugën e humbjes e të shmangies dhe nuk do të ndjekin udhëzimin në rrugën e drejtë. Kur mohuesit do të shohin rezultatet e rënda të punëve të tyre, do të mallkojnë njëri-tjetrin dhe do të grinden në mes tyre.

Këtu, tërheq vëmendjen fakti se ajetet ku përmendem mirësitë që All'llahu i Lartësuar i ka dhënë për njerëzit e përkushtuar, shikohet se llojet e mirësive janë më shumë se llojet e dënimeve që shpalosen në ajetet që flasin për tiranët mohues. Në pjesën e parë të ajeteve, rreshtohen shtatë mirësi për të përkushtuarit. Kurse në ajetet e pjesës së dytë, për mohuesit njoftohet vetëm për pesë lloje ndëshkimi dhe ka mundësi që ky është edhe shkaku përse ajetet që flasin për mirësitë kanë ardhur para ajeteve që njoftojnë për ndëshkimet. Me fjalë të tjera, mëshira

e All'llahut të Lartësuar e parakalon zemërimin e Tij, ashtu siç thuhet edhe në vargun: **"Ai, mëshira e të Cilit e ka parakaluar zemërimin e Tij."**.

Ajetet: 62 – 64

وَقَالُواْ مَا لَنَا لَا نَرَىٰ رِجَالاً كُنَّا نَعُدُّهُم مِّنَ ٱلۡأَشۡرَارِ ﴿٦٢﴾ أَتَّخَذۡنَٰهُمۡ سِخۡرِيًّا أَمۡ زَاغَتۡ عَنۡهُمُ ٱلۡأَبۡصَٰرُ ﴿٦٣﴾ إِنَّ ذَٰلِكَ لَحَقّٞ تَخَاصُمُ أَهۡلِ ٱلنَّارِ ﴿٦٤﴾

"Dhe thonë: ç'është kështu që nuk po i shohim ata burrat të cilët ne i konsideronim prej të këqijve?"

"Ne talleshim me ata, mos vallë na janë larguar prej syve?"

"Kjo grindje në mes banorëve të zjarrit është plotësisht e vërtetë."

Komentimi

Grindja në mes banorëve të zjarrit

Në ajetet objekt i studimit tonë, vazhdon shpalosja e polemikës që zhvillohet në mes banorëve të Xhehennemit. Një pjesë prej asaj polemike e pamë edhe në ajetet e përparme, por në këtë grup ajetesh shpalosen grindjet në mes banorëve të Xhehennemit. Në këto ajete, zbulohet sa të hidhëruar e sa të

brengosur janë banorët e Xhehennemit, për shkak të dhimbjeve të forta që ndjejnë e të humbjes së rëndë që pësuan.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, njofton: **"Dhe thonë: ç'është kështu që nuk po i shohim ata burrat të cilët ne i konsideronim prej të këqijve?"**.

Po, kur pasuesit që ndiqnin krerët e rrugës së humbjes, siç ishin Ebù Xheli dhe Ebù Lehebi, do të kërkojnë të gjejnë në zjarrin e Xhehennemit edhe njerëz të tjerë, si Am'màr bin Jàser, Khab'bàbin, Suhajbin, Bilàlin etj. Por, kur nuk i shohin në ndonjë vend në Xhehennem, kthehen e pyesin veten dhe kërkojnë shpjegim prej të tjerëve: More, ku janë ata njerëzit, të cilët ne i konsideronim grup anarkistësh, njerëz të këqij, njerëz që mbjellin ngatërresa e bëjnë shkatërrime në të gjithë vendin, njerëz që punojnë për të prishur sigurinë e qetësinë e shoqërisë dhe të asgjësojnë ato gjëra me të cilat krenoheshin të përparshmit. Me sa duket, akuzat që ne lëshonim kundër atyre, paskan qenë të gabuara.

Dhe ajeti vijues citon fjalën e banorëve të Xhehennemit: **"Ne talleshim me ata; mos vallë na janë larguar prej syve?"**.

Po, po, ne talleshim me ata burra të mëdhenj e me pozitë të lartë, madje thoshim për ata se janë prej njerëzve të këqij; herë tjetër kemi thënë në adresë të tyre fjalë edhe më të ulta se kjo. Ata ne i konsideronim njerëz të urryer, që nuk meritonin as t'i shihnim me sy. Porse tani u bë e qartë se injoranca jonë, mendjemadhësia dhe egoizmi e dëshirat tona, ishin bërë si perde para syve tanë dhe nuk na linin të shihnim të vërtetën. Ne i shanim e i poshtëronim ata që në të vërtetë ishin prej njerëzve që

janë afër All'llahut të Lartësuar dhe tani vendi i tyre është në Xhennet.

Një grup prej interpretuesve të Kur'ànit, ka dhënë një interpretim tjetër për këtë ajet dhe kanë thënë: Çështja e talljes së besimtarëve, tregon gjendjet e mohuesve në këtë botë, kurse fraza **"mos vallë na janë larguar prej syve"**, tregon gjendjen e mohuesve në Xhehennem; ata thoshin: sytë tanë në këtë vend ku jemi, në mes zjarrit e tymit, nuk na mundësojmë t'i shohim ata, por interpretimi i parë është më i saktë.

Këtu, patjetër duhet të tërhiqet vemendja se, ndër shkaqet e moskuptimit të të vërtetave, është mosmarrja me seriozitet e të vërtetave, duke shtuar edhe talljen me të vërtetat. Në një kohë kur duhet patjetër të diskutohet seriozisht për të vërtetat, me qëllim që të arrihet te të vërtetat.

Ajeti i fundit, nxjerr rezultatin e polemikës së zhvilluar në mesin e banorëve të Xhehennemit dhe njofton: **"Kjo grindje në mes banorëve të zjarrit është plotësisht e vërtetë."**.

Banorët e Xhehennemit edhe në këtë botë janë vënë në sprovë me grindje e armiqësi në mes tyre; grindjet e polemikat kanë qenë zotëruese në mesin e tyre; ata çdo ditë grinden e hyjnë në konflikt, sa me njërin, me tjetrin.

Ditën e Kiametit, ditën kur do të dalin sheshit të fshehtat e sekretet që ishin të fshehura në zemrat e njerëzve, atë ditë do të shohësh se si banorët e Xhehennemit do të grinden në mes tyre aty brenda në Xhehennem. Miqtë e djeshëm, në atë ditë janë armiq, pasuesit e të djeshmes, atë ditë janë kundërshtarë, sepse në këtë botën tonë e në Botën Tjetër, do të mbetet e qëndrueshme

vetëm linja e Njëtimit të All'llahut (Teuhidit) dhe pastërtia e besimit.

Meriton të përmendet se banorët e Xhennetit qëndrojnë të mbështetur mbi shtretërit dhe bisedojnë me njëri-tjetrin me fjalë të mbushura me dashuri e miqësi, ashtu siç njoftohet në ajete të ndryshme të Kur'ànit Famëlartë. Kurse banorët e Xhehennemit do t'i gjesh të përjetojnë një gjendje konfliktesh e polemikash. Nga njëra anë kemi mirësinë e madhe dhe nga ana tjetër kemi ndëshkimin e dhimbshëm!

Hulumtim

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë se ai i ka thënë Ebù Besijrit: *"O Ebu Muhammed, ju ju ka përmendur All'llahu me fjalën e Tij kur tregon gjendjen e armiqve tuaj në zjarr:* **"Dhe thonë: ç'është kështu që nuk po i shohim ata burrat të cilët ne i konsideronim prej të këqijve? Ne talleshim me ata; mos vallë na janë larguar prej syve?"**. *Pasha All'llahun, me këtë Ai s'ka pasur qëllim ndonjë tjetër përveç jush. Te banorët e kësaj bote ju u bëtë njerëzit më të këqij, porse ju, pasha All'llahun, ndërsa ju shetisni në Xhennet, kërkoheni në Xhehennem."*.[1]

[1] "Reudatul Kàfij"; cituar prej tefsirit "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 467.

Ajetet: 65 – 70

قُلۡ إِنَّمَآ أَنَا۠ مُنذِرٞۖ وَمَا مِنۡ إِلَٰهٍ إِلَّا ٱللَّهُ ٱلۡوَٰحِدُ ٱلۡقَهَّارُ ﴿٦٥﴾ رَبُّ
ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضِ وَمَا بَيۡنَهُمَا ٱلۡعَزِيزُ ٱلۡغَفَّٰرُ ﴿٦٦﴾ قُلۡ هُوَ نَبَؤٌاْ عَظِيمٌ ﴿٦٧﴾
أَنتُمۡ عَنۡهُ مُعۡرِضُونَ ﴿٦٨﴾ مَا كَانَ لِيَ مِنۡ عِلۡمِۭ بِٱلۡمَلَإِ ٱلۡأَعۡلَىٰٓ إِذۡ يَخۡتَصِمُونَ
﴿٦٩﴾ إِن يُوحَىٰٓ إِلَيَّ إِلَّآ أَنَّمَآ أَنَا۠ نَذِيرٞ مُّبِينٞ ﴿٧٠﴾

"(O Muhammed) **thuaj: unë jam vetëm paralajmërues, s'ka zot tjetër përveç All'llahut, Një, Mposhtësit** (të çdo sendi)."

"Zot i qiejve e i Tokës dhe ç'ka në mes atyre të dyjave, i Plotfuqishmi, Falësi i madh i mëkateve."

"(O Muhammed) **thuaj: ai** (Kur'àni) **është një lajm i madh."**

"Ju atij (Kur'ànit) **i largoheni."**

"Unë nuk dija asgjë për qeniet më të larta (engjëjt) **kur ata debatonin në mes tyre** (rreth Ademit)."

"Mua më shpallet se unë jam vetëm një paralajmërues i hapur."

Komentimi

Unë jam vetëm paralajmërues

Studimet e përparshme, trajtuan çështjen e dënimit të All'llahut që i pret banorët e Xhehennemit. Në studimet e tjera u trajtua çështja e ndëshkimit dhe e dënimit që zbriti mbi popujt idhujtarë të përparshëm. Të gjitha këto ajete të Kur'ànit Famëlartë, kishin karakter paralajmërues e frikësues për idhujtarët, mëkatarët dhe mizorët.

Edhe ky grup ajetesh, ndjek po këtë studim dhe qysh në frazën e parë të ajetit të parë, njoftohet urdhëri i dhënë Profetit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*: **"**(O Muhammed) **thuaj: unë jam vetëm paralajmërues."**.

Por i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* është edhe përgëzues. Në Kur'ànin Famëlartë, janë shprehur të dyja, domethënë: Paralajmërimi dhe përgëzimi. Dihet se përgëzimi është i veçantë për besimtarët, kurse paralajmërimi u drejtohet idhujtarëve dhe atyre që janë të prirur për të bërë ngatërresa e shkatërrime. Në këto ajete, biseda zhvillohet vetëm për grupin e dytë dhe fillohet me paralajmërimin e tyre.

Në frazën e dytë të këtij ajeti, idhujtarët njoftohen: **"...s'ka zot tjetër përveç All'llahut, Një, Mposhtësit** (të çdo sendi)**."**.

Fjala *"el kah'hàru"* – *"Mposhtësi"* në këtë frazë të ajetit është në kuptimin: Askush të mos i mbushë vetes mendjen me butësinë e me mëshirën e All'llahut dhe të mendojë se do të jetë i sigurtë

prej dënimit të All'llahut. Prandaj çdo njeri ka detyrë të ruajë veten që të mos bjerë në moçalin e mohimit dhe të fajeve.

Në ajetin vijues, shtrohen drejtpërdrejt argumentet që vërtetojnë se Krijuesi është Një e i Vetëm (Teuhidi), ashtu siç njofton ajeti: **"Zot i qiejve e i Tokës dhe ç'ka në mes atyre të dyjave, i Plotfuqishmi, Falësi i madh i mëkateve."**.

Në këtë ajet shpalosen tri prej cilësive të Krijuesit të Gjithëfuqishëm dhe çdonjëra prej këtyre cilësive ka ardhur për të vërtetuar një kuptim të veçantë.

Cilësia e parë: All'llahu është Sunduesi i botës së ekzistencës dhe Zotëruesi i kësaj bote, Ai është Rregulluesi i punëve të kësaj bote, Ai dhe vetëm Ai meriton të adhurohet, kurse idhujt s'kanë fuqi të bëjnë asgjë, qoftë edhe një grimcë të vetme.

Cilësia e dytë: Fuqia e All'llahut. Siç dihet, nga ana gjuhësore, fjala *"el azijzu" – "i Fuqishmi"* thuhet për atë që nuk mposhtet dhe që ka mundësi të bëjë çdo gjë; me fjalë të tjera, vetëm All'llahu është i Pamposhturi, të Cilin s'ka mundësi ta mposhtë askush e asgjë.

Ai që zotëron këtë fuqi, si është e mundur që dikush të mendojë se mund të shpëtojë prej fuqisë së Tij?! Dhe si është e mundur të shpëtohet prej ndëshkimit të Tij?!

Cilësia e tretë: "El Gaf'fàru", do të thotë: *"shumë mëshirues";* portat e mëshirës së Tij janë të hapura para të gjithë fajtorëve, prandaj askush të mos mendojë se dy fjalët e këtij ajeti *"el Gaf'fàru" – "Falësi i mëkateve"* dhe *"el azijzu" – "i Fuqishmi"* japin kuptimin e mbylljes së portave të mëshirës e të pendimit (teube) para robve të All'llahut. Shprehja *"el azijzu" – "i Fuqishmi"* ka

ardhur për të shpjeguar frikën, kurse shprehja *"el Gaf'fàru"* – *"Falësi i mëkateve"* ka ardhur për të shpjeguar shpresën; këto dy shprehje tregojnë se nuk mund të jenë të barabarta të dyja gjendjet, gjendja e frikës dhe gjendja e shpresës, sepse barazimi i të dyja gjendjeve çon në mosplotësimin e njeriut, bën që njeriu të sprovohet me mendjemadhësi, shkujdesje dhe të zhytet në vorbullën e dëshpërimit e të humbjes së shpresës.

Me fjalë të tjera, cilësimi i Krijuesit të Gjithëfuqishëm me dy emrat e bukur: *"el azijzu"* – *"i Fuqishmi"* dhe *"el Gaf'fàru"* – *"Falësi i mëkateve"* është një argument tjetër që vërteton se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm, gjithashtu vërteton se vetëm All'llahu meriton adhurimin e bindjen ndaj Tij, duke shtuar se All'llahu është Sunduesi që zotëron fuqinë për të dënuar, por përsëri portat e mëshirës dhe të faljes së mëkateve prej Tij mbeten të hapura për të gjithë.

Në vijim të ajeteve, Krijuesi i Gjithëfuqishëm i flet drejtpërdrejt Profetit më të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* me dy fraza të shkurtëra kuptimplote dhe e urdhëron: **"**(O Muhammed) **thuaj: ai** (Kur'àni) **është një lajm i madh. Ju atij** (Kur'ànit) **i largoheni."**.

Por, ç'është ky lajm për të cilin njofton ajeti dhe që e ka cilësuar se ai lajm është i madh?

A është "lajmi i madh" Kur'àni Famëlartë?

Apo "lajmi i madh" është kumti i Profetit?

Apo "lajmi i madh" është Dita e Kiametit dhe njoftimi si do të jetë e ardhmja e besimtarëve dhe e mohuesve?

Apo "lajmi i madh" është Njëtimi i All'llahut?

Apo "lajmi i madh" janë të gjitha këto së bashku?

Fakti që Kur'àni Famëlartë i përfshin të gjitha këto punë, është po Kur'àni që i bashkon këto punë njëra me tjetrën. Fakti që idhujtarët i largohen këtij "lajmi të madh", tregon se kuptimi i parë është më i përshtatshëm.

Po, ky libër i madh qiellor është lajmi i madh, madhështia e këtij libri është si madhështia e Gjithësisë, sepse ky libër është zbritur prej Krijuesit të kësaj Gjithësie, këtë libër e ka zbritur All'llahu, Krijuesi, Fuqiploti, Falësi i mëkateve, e ka zbritur Ai që është Një e i Vetëm, i Pamposhturi.

Shumë njerëz nuk e pranuan "lajmin e madh" në kohën kur ky lajm i madh zbriti; kishte grupe njerëzish që u tallën dhe e vunë në lojë këtë lajm të madh, të tjerë thanë se është magji dhe një grup i tretë thanë se është poezi; por, nuk kaloi shumë kohë dhe ky "lajm i madh" i zbuloi sekretet e tij, që të ndryshohej rrjedha e historisë njerëzore, që bota të mbetej nën hijen e vet dhe prej këtj lajmi do të dilte një kulturë e madhe ndriçuese në të gjitha fushat. Këtu bie në sy fakti se shpallja për këtë "lajm të madh", erdhi në këtë sure të zbritur në Mekë kur myslimanët e asaj kohe përjetonin gjendjet më të vështira, ishin të pafuqishëm e nuk kishin mundësi për të vepruar, për shkak se ishin pakicë. Prandaj, në atë kohë dukej sikur portat e fitores e të shpëtimit ishin të mbyllura para tyre.

Gjithashtu, duhet theksuar se madhështia e këtij "lajmi të madh" vazhdon të mos jetë e qartë edhe në ditët e sotme për të gjithë botën në përgjithësi dhe në veçanti për myslimanët, por e ardhmja do të bëjë të qartë madhështinë e këtij "lajmi të madh".

Fjala e të Lartit: **"Ju atij** (Kur'ànit) **i largoheni."**, vazhdon të jetë e qartë edhe në ditët e sotme. Largimi i myslimanëve prej

tij, është shkaku që ata nuk e shuajnë dot etjen në këtë burim të ëmbël me mirësi të shumta hyjnore dhe natyrisht ky është edhe shkaku i mospërparimit të tyre dhe që myslimanët nuk përfitojnë prej dritave të tij rrezatuese. Prandaj, myslimanët nuk janë në majat e krenarisë e të nderimit.

Në vijim, ajeti troket në tregimin e krijimit të Ademit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe të pozitës së lartë të njeriut, për të cilin të gjithë engjëjt u urdhëruan të binin në sexhde para tij: **"Unë nuk kisha asnjë dije për qeniet më të larta** (engjëjt) **kur debatonin në mes tyre** (rreth Ademit)**.".**

Unë nuk dija asgjë rreth diskutimeve që zhvilloheshin në mes engjëjve të shtresave të larta dhe engjëjve të Tokës në lidhje me krijimin e njeriut, sepse mua dituria më vjen me rrugën e Revelatës dhe unë di vetëm atë që më është shpallur se unë jam paralajmërues i qartë:

"Mua më shpallet se unë jam vetëm një paralajmërues i hapur.".

Dihet se engjëjt nuk diskutojnë e nuk polemizojnë me Krijuesin e Gjithëfuqishëm, por, kur i Larti i njoftoi se do të bënte një mëkëmbës në Tokë, engjëjt pyetën të habitur: A do të krijosh në Tokë ata që bëjnë shkatërrime e gjakderdhje, por Krijuesi i Gjithëfuqishëm iu përgjegj engjëjve me fjalën e Tij: Unë di atë që ju nuk e dini: **"Kur Zoti yt u tha engjëve: Unë po krijoj** (po caktoj) **në Tokë një mëkëmbës, ata** (engjëjt) **thanë: a do të caktosh atë që bën shkatërrime në Tokë dhe që shkakton gjakderdhje, ndërsa ne të madhërojmë e të lavdërojmë vetëm Ty, Ai** (All'llahu) **tha: Unë di atë që ju nuk e dini."** (Sure "El Bekare", ajeti 30). Një diskutim i këtillë, me gjuhën e alegorisë, është quajtur grindje dhe ky ajet është si parathënie për ajetet

vijues, që flasin për krijimin e Ademit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Disa të tjerë, kanë përmendur edhe një mundësi tjetër në lidhje me kuptimin e frazës së ajetit të fundit të ajeteve objekt studimi **"qeniet më të larta** (engjëjt)**"** dhe kanë thënë se kjo frazë ka një kuptim shumë të gjerë, sa përfshin deri edhe djallin, sepse, në kohën para krijimit të Ademit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* djalli ishte në grupin e engjëjve, por, si rezultat i kundërshtimit të vullnetit të Krijuesit, djalli u përzu përgjithmonë prej mëshirës së All'llahut.

Në librat e shij'ave dhe të Ehli Synetit, kanë ardhur transmetime të shumta në lidhje me interpretimin e frazës së ajetit **"qeniet më të larta** (engjëjt)**"** dhe në njërin prej këtyre transmetimeve, lexojmë se i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* pyeti njërin prej sahabëve të tij: "*A e di ti përse diskutuan engjëjt e sferave të larta?"* Ai tha: "*Patjetër që jo*". Atëherë *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* tha: "*Diskutuan në lidhje me shlyerësit e fajeve e të detyrimeve dhe për gradat; shlyerësit e fajeve e detyrimeve janë: marrja abdes në formën e duhur edhe në të ftohtin e mëngjesit, vajtja në xhami për të faluar namaz me xhemat dhe pritja e namazit të radhës pas faljes së namazit të vaktit. Kurse gradat janë: përshëndetja me selam, dhënia ushqim të tjerëve dhe falja namaz natën, kur njerëzit janë në gjumë.*".[1]

Natyrisht që, në këtë transmetim, nuk thuhet se ky transmetim është i ngjashëm me interpretimin që u përmend më sipër, megjithëse disa shprehje të transmetimit janë të ngjashme

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", fundi i ajeteve objekt studimi; "Bihàrul Enuàr", vëll. 18, f. 375; ky transmetim ka ardhur edhe në tefsirin "Ed Durr'rrul Menthùr", përcjellë me pak ndryshime në fjalë prej një grupi të madh sahabësh të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e beikimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*.

me shprehjet e ajetit. Si do që të jetë, prej këtij transmetimi, me fjalën *"jekhtesimùne"* – *"grinden në mes tyre, diskutojnë në mes tyre, polemizojnë në mes tyre"* mësohet se qëllimi është: engjëjt studiuan dhe diskutuan dhe jo se polemizuan. Engjëjt studiuan dhe diskutuan rreth punëve të njeriut, diskutuan për punët që do të ishin shlyerëse për fajet e tyre dhe për punët që do të shtojnë gradat e njeriut e do të lartësojnë personalitetin e tij. Ka mundësi që diskutimi i engjëjve të ishte rreth disa punëve që numërohen si burim i këtyre virtyteve e mirësive, ose të ishte në lidhje me përcaktimin e një kufiri e të një peshoreje për vlerësimin e gradave, që do të ishin rezultat i zbatimi të atyre punëve nga ana e njeriut. Në këtë mënyrë, transmetimi është një interpretim i tretë për këtë ajet dhe si interpretim është në përshtatje me fjalët e ajetit në disa anë, por nuk është në përshtatje me ajetet vijuese. Gjithashtu, ka mundësi që diskutimi e studimi i engjëjve ka qenë për punë të tjera, që s'kanë lidhje me ajetin.

Është me vlerë të përmendet se, fjala e Profetit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) "unë nuk kam dijeni"*, do të thotë: Unë këto nuk i dija nga vetja ime, diturinë unë nuk e kam prej vetes sime, dituria mua më zbritet me rrugën e Revelatës.

Ajetet: 71 – 83

إِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَٰٓئِكَةِ إِنِّي خَٰلِقُۢ بَشَرًا مِّن طِينٍ ﴿٧١﴾ فَإِذَا سَوَّيْتُهُۥ وَنَفَخْتُ
فِيهِ مِن رُّوحِي فَقَعُواْ لَهُۥ سَٰجِدِينَ ﴿٧٢﴾ فَسَجَدَ ٱلْمَلَٰٓئِكَةُ كُلُّهُمْ
أَجْمَعُونَ ﴿٧٣﴾ إِلَّآ إِبْلِيسَ ٱسْتَكْبَرَ وَكَانَ مِنَ ٱلْكَٰفِرِينَ ﴿٧٤﴾ قَالَ يَٰٓإِبْلِيسُ
مَا مَنَعَكَ أَن تَسْجُدَ لِمَا خَلَقْتُ بِيَدَيَّ ۖ أَسْتَكْبَرْتَ أَمْ كُنتَ مِنَ ٱلْعَالِينَ
﴿٧٥﴾ قَالَ أَنَا۠ خَيْرٌ مِّنْهُ ۖ خَلَقْتَنِي مِن نَّارٍ وَخَلَقْتَهُۥ مِن طِينٍ ﴿٧٦﴾ قَالَ
فَٱخْرُجْ مِنْهَا فَإِنَّكَ رَجِيمٌ ﴿٧٧﴾ وَإِنَّ عَلَيْكَ لَعْنَتِيٓ إِلَىٰ يَوْمِ ٱلدِّينِ ﴿٧٨﴾
قَالَ رَبِّ فَأَنظِرْنِيٓ إِلَىٰ يَوْمِ يُبْعَثُونَ ﴿٧٩﴾ قَالَ فَإِنَّكَ مِنَ ٱلْمُنظَرِينَ ﴿٨٠﴾
إِلَىٰ يَوْمِ ٱلْوَقْتِ ٱلْمَعْلُومِ ﴿٨١﴾ قَالَ فَبِعِزَّتِكَ لَأُغْوِيَنَّهُمْ أَجْمَعِينَ ﴿٨٢﴾ إِلَّا
عِبَادَكَ مِنْهُمُ ٱلْمُخْلَصِينَ ﴿٨٣﴾

"Kur Zoti yt u tha engjëjve: Unë po krijoj një njeri prej baltës."

"Dhe kur e përsosa i dhashë atij shpirt nga ana Ime, atëherë ata (engjëjt) **menjëherë ranë në sexhde para tij."**

“Të gjithë engjëjt pa përjashtim ranë në sexhde.”

“Përveç Iblijsit (djallit) **që tregoi mendjemadhësi dhe kështu u bë prej mohuesve.”**

“Ai (All’llahu) **tha: o Iblijs, ç’të pengoi që nuk i bëre sexhde atij që Unë Vetë e krijova? E kishe nga mendjemadhësia, apo je prej atyre që e mbajnë veten të lartë?”**

“Ai (Iblijsi, djalli) **tha: unë jam më i mirë se ai; mua më krijove prej zjarrit, kurse atë e krijove prej baltës.”**

“Ai (All’llahu) **urdhëroi: dil prej tij** (Xhennetit) **dhe je i përzënë** (prej mëshirës Sime).”

“Mallkimi Im do të ndjekë ty nga pas deri Ditën e Gjykimit.”

“Ai (Iblijsi, djalli) **tha: o Zoti im, më jep afat** (lermë të jetoj) **deri Ditën e Ringjalljes.”**

“Ai (All’llahu) **tha: po, je prej atyre që u është dhënë afati.”**

“Deri në Ditën e kohës së caktuar.”

“Ai (Iblijsi, djalli) **tha: betohem në madhërinë Tënde, të gjithë ata do t’i shmang prej rrugës së drejtë.”**

“Përveç atyre që janë prej robve Tuaj të sinqertë.”

Komentimi

Mendjemadhësia e djallit dhe përzënia e tij prej mëshirës së All'llahut

Siç thamë më sipër, këto ajete janë një shpjegim për polemikën e engjëjve të shtresave të larta e Iblijsit (djallit), njëkohësisht janë një studim në lidhje me krijimin e Ademit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe në përgjithësi, qëllimi me këto ajete është që të shpjegohen qartë dy çështjet e mëposhtme:

E para: Kujtesë për njeriun në lidhje me vlerën e ekzistencës së tij, bërjen sexhde të engjëjve për babanë e parë të njeriut, Ademit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)***.** Atëherë, si është e mundur për njeriun, të cilin Krijuesi i Gjithëfuqishëm e nderoi kaq shumë, të bjerë rob i kurtheve të djallit dhe i dëshirave të veta? Qysh e harron njeriu vlerën e vetes së tij dhe shkon e u bën sexhde idhujve, që ai i ka punuar me duart e veta, prej guri ose prej druri?!

Dihet se njëra prej metodave ndikuese në edukimin e njeriut, është njohja e personalitetit të tij. Me fjalë më të qarta: Qëllimi është që t'u kujtohet njerëzve personaliteti i tyre i lartë dhe vlera e ekzistencës së tyre. Nëse njerëzit e mbajnë në mendje këtë fakt, ata patjetër do të ndjejnë se poshtërimi e përbuzja nuk janë gjëra që i nderojnë njerëzit, prandaj, spontanisht, njerëzit me mendje në kokë qëndrojnë sa më larg nga këto dy punë.

E dyta: Kokëfortësia e djallit, mendjemadhësia dhe smira e tij. Të gjitha këto u bënë shkak që djalli të rrëzohej prej pozitës

shumë të lartë që kishte dhe bënë që ai të zhytej përgjithmonë në llumin e mallkimit. Ky shembull, mund të jetë një kumtesë për çdo kryeneç mendjemadh, që ai të nxjerrë mësim dhe të heqë dorë prej praktikave djallëzore.

E treta: Bërja e njohur njerëzve e armikut të tyre më të madh, djallit, i cili u betua se do të shmangë të gjithë njerëzit prej udhëzimit të Rrugës së Drejtë, prandaj të gjithë njerëzit kanë detyrë të ruhen prej djallit dhe të qëndrojnë sa më larg kurtheve që djalli kurdis.

Të gjitha këto, janë plotësim i studimeve të përparme dhe ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, u kujton njerëzve njoftimin që All'llahu i Lartësuar u bëri engjëjve se Ai do të krijonte një njeri prej baltës: **"Kur Zoti yt u tha engjëjve: Unë po krijoj një njeri prej baltës."**.

Me qëllim që askush të mos mendojë se origjina e krijimit të njeriut është vetëm balta, ajeti vijues njofton: **"Dhe kur e përsosa, i dhashë atij shpirt nga ana Ime, atëherë ata** (engjëjt) **menjëherë ranë në sexhde para tij."**.

Me këtë mënyrë, përfundoi procesi i krijimit të njeriut, domethënë se krijimi i njeriut ndodhi pas përzierjes së shpirtit prej All'llahut të Lartësuar me baltën dhe kështu në botë u krijua një qenie e çuditshme, që më përpara nuk ishte, madje mbi këtë qenie nuk ishte vënë asnjë kufizim, sepse Krijuesi i Gjithëfuqishëm kishte depozituar në atë mundësira të jashtëzakonshme, që do ta bënin njeriun të meritueshëm për të qenë mëkëmbës i All'llahut në Tokë. Veç kësaj, ajeti vijues njofton se të gjithë engjëjt u urdhëruan të bëjnë sexhde për njeriun,

menjëherë sapo u plotësua procesi i krijimit të tij: **"Të gjithë engjëjt pa përjashtim ranë në sexhde."**.

Por Iblijsi (djalli), ishte i vetmi që nuk pranoi të bëjë sexhde për Ademin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Djalli kundërshtoi, thjesht nga mendjemadhësia që kishte; veç kësaj, djalli kishte karakter kundërshtues e tiran. Këto vese të ulta ishin shkak që djalli u ul prej pozitës së lartë që gëzonte dhe hyri në radhën e mohuesve, ashtu siç njofton ajeti vijues:

"Përveç Iblijsit (djallit) **që tregoi mendjemadhësi dhe kështu u bë prej mohuesve."**.

Po, mendjemadhësia e mbajtja e vetes i madh, janë sprovat më të këqija me të cilat mund të sprovohet njeriu. Këto dy vese bëhen si perde e trashë para syve të njeriut dhe nuk e lënë atë të shohë e të kuptojë të vërtetat. Gjithashtu, duhet shtuar se këto dy vese të ulta e çojnë njeriun në rebelim e në kundërshtim të urdhërave të All'llahut dhe për rrjedhojë, jo vetëm që e nxjerrin njeriun prej radhëve të besimtarëve të bindur ndaj urdhërave të All'llahut të Lartësuar, por e fusin në radhët e mohuesve kryengritës e mizorë. Këto dy vese të ulta e fusin njeriun në rreshtin që kryeson djalli, madje vetë djalli qëndron në krye të atij rreshti.

Pas këtij kundërshtimi, Krijuesi i Gjithëfuqishëm e merr në pyetje Iblijsin (djallin) dhe i thotë: **"Ai** (All'llahu) **tha: o Iblijs, ç'të pengoi që nuk i bëre sexhde atij që Unë Vetë e krijova?"**. Vetëkuptohet që fjala e ajetit *"bijedej'je"* – *"me duart e mia"* pa tjetër nuk është në kuptim e duarve si organe të trupit, sepse Krijuesi i Gjithëfuqishëm është i dëlirë nga të gjitha format e trupit e të formësimit dhe këtu fjala "dorë" është alegori, që shpreh fuqinë.

Natyrisht, është njeriu ai që përdor duart e veta për të treguar fuqinë e tij dhe për të realizuar punët që duhet të bëjë. Edhe në bisedat e përditshme, shpesh herë e përdorim fjalën "dorë" në kuptimin e mësipërm, për shembull, kur themi: filan vend e ka në dorë ky grup, apo një grup tjetër, ose kur themi: filan xhami e ka në dorë filani; herë tjetër themi: i kisha duart e shkurtra, ose dora jote është e mbushur. Në të gjitha këto raste, qëllimi me fjalën "dorë", nuk është për dorën si organ i trupit të njeriut, por është alegori për të shprehur fuqinë, pushtetin dhe mundësinë për të kryer punë.

Njeriu, të gjitha punët e tij të rëndësishme i realizon duke përdorur të dyja duart. Shprehja "me duart", e përmendur në këtë ajet, është shprehje alegorike, që tregon interesimin e veçantë të Krijuesit të Gjithëfuqishëm për procesin e krijimit të njeriut.

Pjesa e dytë e ajetit objekt studimi, shton se All'llahu i Lartësuar e pyeti djallin: **"E kishe nga mendjemadhësia, apo je prej atyre që e mbajnë veten të lartë?"**. Domethënë: Ti nuk bëre sexhde nga mendjemadhësia, apo e konsiderove veten aq të lartë e të fuqishëm, sa nuk mund të urdhëroheshe të bëje sexhde?!

Pa dyshim që askush s'ka mundësi të mëtojë se fuqia e pozita që ai ka është më e madhe se të bëjë sexhde në zbatim të urdhërit të All'llahut, ose të bëjë sexhde për Ademin me urdhër të All'llahut, sido që të ketë menduar djalli, mendjemadhësia mbetet mendjemadhësi.

Disa interpretues të Kur'ànit, kanë thënë se fjala *"àlijn"*, këtu është në kuptimin e njerëzve që vazhdimisht ecin duke u ngrefosur me mendjemadhësi dhe sipas këtij interpretimi, ajeti

është në kuptimin: mos vallë ti tani u tregove mendjemadh, apo gjithmonë ke qenë mendjemadh?!

Gjithësesi, interpretimi i parë është më shumë në përshtatje me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit.

Iblijsi (djalli), nga që i pëlqente shumë vetja, zgjodhi rrugën e mendjemadhësisë, sepse ai besonte se ishte aq i lartë, sa nuk mund të urdhërohej të bënte sexhde, prandaj, gjatë shpjegimit të shkaqeve që e bënë djallin të kundërshtonte urdhërin e Krijuesit të Gjithëfuqishëm, djalli u përgjegj me arrogancë: **"Ai** (Iblijsi, djalli) **tha: unë jam më i mirë se ai; mua më krijove prej zjarrit, kurse atë e krijove prej baltës."**.

Iblijsi (djalli) e shpjegoi kundërshtimin e urdhërit të All'llahut për t'i bërë sexhde Ademit, me mëtimin e përparësive që ai besonte se i kishte:

E para: unë jam krijuar prej zjarrit, kurse ai u krijua prej baltës; kjo e vërtetë është shprehur në Kur'ànin Famëlartë edhe në ajetet 14-15 të sures "Err Rrahmàn": **"Ai** (All'llahu) **e krijoi njeriun nga balta e tharë dhe e pjekur. Ai** (All'llahu) **i krijoi xhindët nga flaka** (pa tym) **e zjarrit."**.

E dyta: I krijuari prej zjarrit është më i mirë se i krijuari prej baltës, sepse zjarri është më i nderuar se balta.

E treta: Askush nuk ka të drejtë të urdhërojë një krijesë që t'i bëjë sexhde një krijese më të ulët se krijesa e urdhëruar.

Gabimi i Iblijsit (djallit), qëndronte në dy përparësitë e fundit, që ai besonte se i kishte dhe gabimi i tij shtrihej në disa anë:

E para: Në të vërtetë Ademi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* nuk ishte vetëm baltë, por në atë u fut shpirti prej All'llahut dhe ky është shkaku që njeriu konsiderohet i madh, ndryshe, ku është balta ndaj gjithë kësaj krenarie, përgatitjeje e plotësimi?

E dyta: Dheu nuk është më i ulët se zjarri. Në të vërtetë, dheu është shumë më i lartë e shumë më i mirë se zjarri, sepse e gjithë jeta bazën e ka në dheun: bimët e të gjitha qeniet e gjalla, ushqimin e tyre dhe burim të jetës kanë dheun. Të gjitha metalet e çmuara janë të fshehura në mesin e dheut. Me urdhër të All'llahut, dheu është burimi i të gjitha llojeve të begative; kurse zjarri, pavarësisht nga rëndësia e madhe që ka, mund të bëhet edhe mjet rreziksjellës e shkatërrues; por më e rëndësishme është se, të gjitha lëndët me të cilat ndizet zjarri, të gjitha përfitohen prej dheut, si drutë, qymyri e nafta, të gjitha këto lëndë merren prej dheut të Tokës.

E treta: Çështja ka të bëjë me bindjen ndaj urdhërave të All'llahut të Lartësuar dhe me zbatimin e urdhërave të Tij, sepse All'llahu është Krijuesi ynë dhe ne jemi rob të Tij, prandaj kemi detyrë të zbatojmë urdhërat e Tij.

Sikur të shikojmë me kujdes në argumentet e Iblijsit (djallit), do të shikojmë një mohim të çuditshëm: Iblijsi (djalli), me fjalën e tij kishte qëllim të mohonte sundimin e All'llahut dhe të pakësonte rëndësinë e urdhërave të Tij (All'llahu na ruajt nga ky mendim). Është e qartë se ky qëndrim i turpshëm prej Iblijsit (djallit), është një argument që vërteton injorancën e tij të plotë. Sikur djalli të kishte pohuar se mosbërja e sexhdes nga ana e tij ishte se ashtu qe dëshira e tij, ose nga mendjemadhësia e tij dhe nga që ai e mbante veten për më të lartë, apo sikur djalli të kishte

dhënë justifikime të ngjashme, patjetër që puna për djallin do të ishte shumë më e lehtë, sepse, në rastin e pohimit, do të vendosej se ai kreu vetëm një faj, por fjalët e tij për të përligjur kundërshtimin e tij, e shtynë djallin të mohojë jo vetëm sundimin dhe urdhërin e Krijuesit të Gjithëfuqishëm, por edhe diturinë e Tij. E gjitha kjo, e bën të qartë rrëzimin e djallit në shkallën më të ulët të mohimit e të degradimit.

I krijuari para Krijuesit të tij e humb pavarësinë, sepse çdo gjë që zotëron i krijuari e ka vetëm prej Krijuesit të tij; por gjuha me të cilën foli Iblijsi (djalli), shpjegon qartë se ai kishte qëllim të tregonte se edhe ai kishte një pavarësi e sundim kundrejt sundimit të All'llahut. Patjetër që edhe ky qëllim i djallit është një burim tjetër prej burimeve të mohimit.

Mund të thuhet se, shkaqet që e shmangën djallin nga udhëzimi në Rrugën e Drejtë, e kanë origjinën te krekosja, mendjemadhësia, injoranca e smira. Të gjitha këto vese shumë të këqija, u mblodhën së bashku dhe e rrëzuan atë prej majës së lartë ku ishte qysh prej shumë vitesh në shoqëri të engjëjve, madje ai ishte edhe mësues i engjëjve. Të gjitha këto e rrëzuan djallin nga maja e krenarisë dhe e ulën atë në shkallën më të ulët të llumit. Nuk ka vese më të këqija se këto që u thanë, kudo që ato të shfaqen!

Prijësi i besimtarëve, Imam Ali ibn Ebù Tàlib *(Paqja qoftë mbi të!)*, në njërën prej hytbeve të tij që gjenden në "Nehxhul Belàga", ka thënë: "*Nxirrni mësim prej asaj që All'llahu i bëri Iblijsit (djallit), kur e uli në shkallën më të ulët punën e tij të gjatë dhe mundin që ai kishte derdhur; për gjashtëmijë vjet, djalli kishte qenë rob i bindur i All'llahut, por vetëm për mendjemadhësinë e një ore të vetme…pas*

djallit kush do të ishte ai që do të kundërshtonte All'llahun me një kundërshtim të ngjashëm?".[1]

Po, puna për ndërtimin e një pallati të madh mund të vazhdojë disa vjet, kurse procesi për shkatërrimin e atij pallati nuk do të vazhdonte më shumë se disa çaste, si rezultat i shpërthimit të një bombe të fuqishme.

Për të gjitha këto vese, u bë e detyrueshme që ajo qenie e keqe të nxirrej jashtë radhëve të qenieve të larta, të nxirrej jashtë radhëve të botës së engjëjve të lartë, prandaj Krijuesi i Gjithëfuqishëm i flet djallit drejtpërdrejt: **"Ai** (All'llahu) **urdhëroi: dil prej tij** (Xhennetit) **dhe je i përzënë** (prej mëshirës Sime)**."**.

Përemri *"hà" – "saj"* në shprehjen *"minhà" – "prej tij"* që është në frazën e ajetit **"dil prej tij",** (në të vërtetë përemri *"hà" – "saj"* është i gjinisë femërore, për shkak se edhe Xhenneti, në gjuhën arabe është në gjininë femërore), prandaj, qëllimi me frazën **"dil prej tij",** mund të jetë: "dil prej radhëve të engjëjve", ose "dil prej botëve të larta", ose "dil prej Xhennetit", ose "dil prej mëshirës së All'llahut".

Po, patjetër ai i keq duhej nxjerrë prej andej, sepse ai vend është vendi i qenieve të pastra dhe të afërta te Krijuesi i Gjithësisë dhe nuk mund të jetë vend për fajtorët, për mëkatarët e zemërzinjtë.

Fjala e ajetit *"rexhijmun",* në rrënjën e saj *"rexheme",* do të thotë: *"e qëlloi me gurë"* dhe përzënia e djallit ka ardhur me këtë

[1] "Nehxhul Belàga", hytbeja 192 (hytbeja "El Kàsiah").

fjalë, për shkak se përzënia e tij prej atij vendi të nderuar, ishte bërë e detyrueshme.

Në ajetin vijues, Krijuesi i Gjithëfuqishëm e njofton djallin: **"Mallkimi Im do të ndjekë ty nga pas deri Ditën e Gjykimit."**, domethënë: Ti je nxjerrë jashtë e je përzënë prej mëshirës Sime përgjithmonë.

Është shumë e rëndësishme për njeriun që kur shikon rezultatin mjerues të punëve të tij të këqija, detyra e tij parësore është që të zgjohet prej gjumit të shkujdesjes dhe të mendojë rreth mënyrës së përmirësimit të atij gabimi, sepse s'ka gjë më të rrezikshme se sa kur njeriu ka hipur mbi vrundujt e mendjemadhësisë dhe vazhdon të ecë në drejtim të greminës ku e çojnë dëshirat. Nga mendjemadhësia njeriu çdo çast largohet gjithnjë e më shumë prej Rrugës së Drejtë dhe kjo është e ardhmja e mjeruar që arriti Iblijsi (djalli).

Në gjendje mendjemadhësie, smira shndërrohet në armiqësi të egër, madje shumë të egër, ashtu siç njofton Kur'àni në ajetin vijues: **"Ai** (Iblijsi, djalli) **tha: o Zoti im, më jep afat** (lermë të jetoj) **deri Ditën e Ringjalljes."**.

Ky ajet e bën të qartë se djalli kërkoi prej All'llahut të Lartësuar që Ai ta shtynte kohën e fundit për atë; vallë a e bëri djalli këtë kërkesë për të zbrazur vrundujt e smirës e të pendohej për ato që kishte bërë më parë, apo ai e kërkoi shtyrjen e afatit për të përmirësuar mëkatin e tij shumë të keq?

Jo dhe jo, djalli i kërkoi Krijuesit të Gjithëfuqishëm që ta linte të jetonte deri Ditën e Ringjalljes, me qëllim që të hakmerrej me pasardhësit e Ademit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe që t'i

shtyjë ata të shkojnë në rrugën e humbjes, megjithëse djalli e di mirë se çuarja e çdo njeriu në rrugën e humbjes do t'i shtojë atij fajin dhe mbi atë do të rëndojë një barrë e re mëkatesh, që do ta fundosin atë edhe më shumë në llumin e moçalit të mohimit e të mëkateve dhe të gjitha këto, për shkak të mendjemadhësisë, kryeneçësisë e smirës. Sa shumë vështirësi të mëdha i dalin njeriut prej këtyre veseve të ulta!

Në të vërtetë, djalli kishte qëllim që të vazhdonte të mashtronte pasardhësit e Ademit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* deri edhe në rastin më të fundit që do të kishte, sepse Ditën e Gjykimit s'ka më detyrime për njeriun dhe s'ka më kuptim për cytjet e djallit e për mashtrimet e tij, duke shtuar këtu se djalli i kërkoi All'llahut që ta linte gjallë deri Ditën e Kiametit, megjithëse të gjitha qeniet e kësaj bote patjetër do të vdesin në atë ditë.

Këtu shfaqet madhështia e vullnetit të All'llahut të Lartësuar, që ne do ta vërtetojmë me argument: All'llahu i Lartësuar iu përgjegj Iblijsit (djallit), por ishte një përgjigje e kushtëzuar dhe nuk ishte përgjigje pa kushte, ashtu siç e shpjegon qartë ajeti vijues:

"Ai (All'llahu) **tha: po, je prej atyre që u është dhënë afati."**.

Por jo deri Ditën e Ringjalljes, ditën kur do të ringjallen të gjitha krijesat, por ty do të të jepet afat deri në një kohë të caktuar, ashtu siç e lexojmë në ajetin vijues: **"Deri në Ditën e kohës së caktuar."**.

Në lidhje me interpretimin e frazës **"Ditën e kohës së caktuar"**, interpretuesit e Kur'ànit Famëlartë kanë dhënë

mendime të ndryshme; disa kanë thënë se **"Dita e kohës së caktuar"** është dita e fundit e kësaj bote, sepse në atë ditë do të vdesin të gjitha qeniet e gjalla dhe do të mbetet vetëm All'llahu i Lartësuar, ashtu siç njofton ajeti 88 i sures "El Kasas": **"...gjitha qeniet do të vdesin, me përjashtim të Qenies së lartë..."**; me këtë frazë i është dhënë përgjigje një pjese prej kërkesave të Iblijsit (djallit).

Disa të tjerë, kanë thënë se **"Dita e kohës së caktuar"** është Dita e Kiametit, por kjo mundësi nuk është në përshtatje me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit objekt studimi, të cilat shpjegojnë qartë se, Krijuesi i Gjithëfuqishëm nuk iu përgjegj të gjitha kërkesave të djallit. Gjithashtu, kjo mundësi nuk është në përshtatje as me ajetet e tjera të Kur'ànit Famëlartë që flasin për vdekjen e të gjitha qenieve të gjalla ditën e fundit të kësaj bote.

Disa të tjerë, kanë thënë se ky ajet mund të bëjë shenjë për një kohë që nuk e di askush, përveç All'llahut të Lartësuar.

Në të gjitha rastet, interpretimi i parë mbetet interpretimi më i përshtatshëm. Në një transmetim që gjendet në tefsirin "El Burhàn", i cituar prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë se Iblijsi (djalli) do të vdesë në mes fryrjes së parë dhe fryrjes së dytë të "Sùrit".[1]

Këtu, Iblijsi (djalli) e nxjerr në shesh qëllimin e kërkesës së tij për të jetuar gjithmonë deri në një kohë të caktuar, kur tha: **"Ai** (Iblijsi, djalli) **tha: betohem në madhërinë Tënde, të gjithë ata do t'i shmang prej Rrugës së Drejtë."**.

[1] Tefsiri "El Burhàn", vëll. 2, f. 342.

Betimi në madhërinë e All'llahut prej djallit ka qëllim fuqinë dhe mundësinë, kurse përforcimet e njëpasnjëshme në këtë ajet, sipas rregullave të gjuhës arabe (nga njëra anë betimi, nga një anë tjetër përforcimi i fjalës *"agvijen nehum"* me germën *"n"* të dubluar dhe nga një anë e tretë fjala *"exhmeijne"* – *"të gjithë"*) shpjegojnë qartë se djalli ishte shumë i vendosur që të bënte përpara në punën e tij dhe se deri në fundin e jetës së tij do të mbetej plotësisht i vendosur të përmbushte detyrën që kishte marrë përsipër për të mashtruar pasardhësit e Ademit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Djalli, pas betimit të tij, ishte shumë i kujdesshëm ndaj realitetit se do të kishte grupe prej robve të sinqertë të All'llahut, të cilët ai nuk kishte mundësi t'i fitonte për veten e tij dhe t'i fuste ata brenda zonës së tij të ndikimit; prandaj djalli, duke pohuar këtë pamundësi të tij për të fituar robtë e sinqertë të All'llahut tha: **"Përveç atyre që janë prej robve Tuaj të sinqertë."**.

Ata që ecin në rrugën e njohjes e të adhurimit për Ty me pastërti të plotë zemre e me sinqeritet, Ti u ke bërë atyre thirrje që të drejtohen vetëm Ty, Ti ata i pastrove për veten Tënde, Ti i fute ata në zonën e sigurisë Tënde. Ja, ky është grupi i vetëm që unë nuk mund të arrij te ata, kurse për të tjerët, unë kam mundësi që t'i bëj të bien në rrjetën time.

Hamendësimi i djallit ishte i drejtë, pasi ai ngriti pengesa për çdo individ prej pasardhësve të Ademit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* me përjashtim të njerëzve të sinqertë, të cilët u shpëtuan kurtheve të djallit, ashtu siç theksohet në Kur'ànin Famëlartë në ajetin 20 të sures "Sebe": **"Në të vërtetë, djalli e realizoi**

mendimin e tij ndaj atyre, prandaj ata e dëgjuan atë, përveç një grupi besimtarësh.".

Dy hulumtime

1- Filozofia e ekzistencës së djallit

Shumë çështje të rëndësishme shtrohen në lidhje me ajetet e këtij grupi ajetesh, ndër të cilat: çështja e krijimit të djallit, shkaku që engjëjt i bënë sexhde Ademit dhe shkaku i vlerësimit të Ademit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* mbi engjëjt, dhënia e fuqisë për djallin që të vërë nën sundimin e tij cilin të mundë prej njerëzve, rezultati i mendjemadhësisë e i mbajtjes së vetes për të lartë, cili është qëllimi me dheun dhe me shpirtin prej All'llahut, çështja e krijimit të Ademit, krijimi i tij i pavarur kundrejt supozimit të plotësimit të llojeve, si dhe çështje të tjera të kësaj kategorie, pastaj trajtimi i të gjitha këtyre çështjeve në mënyrë të hollësishme, ashtu siç ka ardhur në ajetin 34 të sures "El Bekare", në ajetin 26 të sures "El Hixhr" dhe në ajetin 11 të sures "El A'ràf".

I kthehemi edhe një herë çështjes së parë, çështjes së filozofisë së krijimit të djallit. Shumë janë ata që pyesin: Kur qëllimi i krijimit të njeriut është që ai të arrijë plotësimin dhe lumturinë nëpëmjet rrugës së adhurimit të tij për All'llahun e Lartësuar, cilat janë shkaqet për ekzistencën e djallit, që është një qenie shkatërruese dhe që punon kundër plotësimit të njeriut? Në

të njëjtën kohë, djalli është një qenie që dallohet për zgjuarsi, është shumë mashtrues dhe nxit armiqësi e urrejtje. Sikur ne të mendojmë pak, shumë shpejt do të kuptojmë se ekzistenca e këtij armiku është një element që ndihmon për të shtyrë përpara plotësimin e njeriut dhe përparimin e tij.

Të mos shkojmë larg, fuqia për qëndresë është ajo që e shtyn njeriun të ecë gjithmonë përpara kundër armikut dhe kjo fuqi te njeriu shtohet nga dita në ditë.

Komandantët dhe ushtarët e stërvitur e të fuqishëm, janë njerëzit që i luftojnë armiqtë me ashpërsi në betejat e mëdha.

Politikan me përvojë është ai që, në kohë krizash të forta politike, ka mundësi të sfidojë armiqtë e fuqishëm dhe të triumfojë mbi ata.

Kampionët e mëdhej në sportin e mundjes janë ata që paraqiten më të fuqishëm e më të ashpër; atëherë nuk përbën asnjë çudi që, robtë e mëdhenj të All'llahut, në luftën e tyre të vazhdueshme kundër djallit, bëhen më të fortë, ditë pas dite.

Shkencëtarët e ditëve tona, në lidhje me ekzistencën e mikrobeve, thonë, nëse nuk do të ekzistonin këto mikrobe, pa dyshim që trupi i njeriut do të ishte i pafuqishëm dhe pa ndjenja, pa ekzistencën e mikrobeve ka mundësi që zhvillimi i njeriut të ndalojë me shpejtësi dhe trupi i tij nuk do të ishte më i gjatë se tetëdhjetë centimetra dhe të gjithë njerëzit do të kishin formën e trupave të vegjël; por është dueli i trupit të njeriut me mikrobet sulmues, që i jep njeriut fuqinë që ai të rritet.

Kështu është edhe gjendja në raport me shpirtin e njeriut në luftën e tij kundër djallit dhe kundër dëshirave të vetë njeriut.

Kjo nuk do të thotë se djalli është i detyruar të mashtrojë robtë e All'llahut, sepse edhe djalli, si të gjitha qeniet e tjera, ishte i pastër në fillim të krijimit të tij, por shmangia e tij prej udhëzimit të rrugës së drejtë, degradimi e brengosja me të cilat ai u sprovua, në të vërtetë ishin me dëshirën e me vullnetin e tij dhe Krijuesi i Gjithëfuqishëm nuk e krijoi Iblijsin (djallin) qysh ditën e parë djall, por ishte vetë Iblijsi (djalli) që kishte dëshirë të ishte djall. Në të njëjtën kohë, praktikat e tij djallëzore, në mënyrë absolute nuk sjellin asnjë dëm mbi robtë e sinqertë të All'llahut, në të kundërt, mashtrimet e djallit mund të jenë shkallë nëpër të cilat ata ngjiten drejt lartësimit të tyre.

Pyetje: Përse u miratua kërkesa e djallit që ai të mbetej gjallë dhe përse djalli nuk u asgjësua qysh në atë çast?

Përgjigje: Përgjigjja për këtë pyetje shërben ajo që u tha më sipër, ose thënë me fjalë të tjera:

Bota e Tokës është sheshi i sprovave e i provimit (provimi është mjeti për edukimin dhe për plotësimin e njeriut), por, siç dihet, sprova nuk mund të ketë nëse nuk ka një përballje me një armik të egër dhe pa u përballur me lloje të ndryshme vështirësish e problemesh.

Natyrisht që këtu nuk ka djall, por janë ngasjet e dëshirave ato që e vënë njeriun në vorbullën e provës, megjithëse nxehtësia e kësaj vorbulle shtohet me praninë e djallit, sepse djalli, në këtë gjendje është faktori i jashtëm ndikues mbi njeriun, kurse ngasjet e dëshirave të tij, do të jenë faktori i brendshëm.

2- Zjarri i egoizmit e i mendjemadhësisë e djeg kapitalin e ekzistencës

Prej punëve shumë të ndjeshme që tërheqin vëmendjen në përzënien e Iblijsit (djallit) prej mëshirës së All'llahut, është jehona e ndikimit të dy faktorëve që e sundonin atë: egoizmi dhe mendjemadhësia për uljen poshtë të njeriut e brengosjen e tij. Madje këta dy faktorë mundësojnë të thuhet se janë prej faktorëve më të rëndësishëm e më të rrezikshëm për shmangien prej udhëzimit në rrugën e drejtë. Madje këta dy faktorë u bënë shkak që, brenda një çasti të vetëm, të shkatërrohet një adhurim gjashtëmijëvjeçar. Gjithashtu, këta dy faktorë ishin shkaku për uljen poshtë të një qenieje që ishte në radhën e engjëjve të mëdhenj të Qiellit, madje shkaktuan uljen e asaj qenieje në shkallët më ulta të të keqes, aq sa ajo qenie meritoi përjetësisht mallkimin e All'llahut.

Egoizmi e mendjemadhësia nuk e lënë njeriun të shikojë të vërtetën; egoizmi është burimi për cmirën, cmira është burimi për armiqësi e urrejtje, armiqësia e urrejtja janë shkak për gjakderdhje dhe për kryerjen e krimeve.

Egoizmi e shtyn njeriun të vazhdojë të bëjë gabime, por, në të njëjtën kohë, është faktor veprues për zgjimin e njeriut prej gjumit të shkujdesjes.

Egoizmi e mllefi heqin rastin për të bërë teube dhe të realizuar përmirësimin e personalitetit të njeriut; egoizmi e mllefi mbyllin para njeriut portën e shpëtimit. Në fund të fundit, çdo gjë

që mund të thuhet rreth rrezikut të këtyre veseve të këqija e të urryera, përsëri numërohet se është pak.

Sa e bukur është fjala e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Armiku i All'llahut është drejtuesi i fanatikëve dhe i pari i mendjemëdhenjve, i cili vuri themelet e fanatizmit, ai e kundërshtoi All'llahun në fuqinë e imponimit, u vesh me rrobën e madhështisë, hoqi maskën e nënshtrimit e të përuljes. A nuk e shihni sa shumë e zvogëloi All'llahu mendjemadhësinë e tij? A nuk e shihni se All'llahu, me lartësinë e Tij, e uli poshtë atë? Në këtë botë, All'llahu e bëri djallin të përzënë dhe në Botën Tjetër për djallin Ai ka përgatitur zjarrin e Xhehennemit."*.[1]

[1] "Nehxhul Belàga", hytbeja 192, (hytbeja "El Kàsiah").

Ajetet: 84 – 88

قَالَ فَٱلۡحَقُّ وَٱلۡحَقَّ أَقُولُ ﴿٨٤﴾ لَأَمۡلَأَنَّ جَهَنَّمَ مِنكَ وَمِمَّن تَبِعَكَ مِنۡهُمۡ
أَجۡمَعِينَ ﴿٨٥﴾ قُلۡ مَآ أَسۡـَٔلُكُمۡ عَلَيۡهِ مِنۡ أَجۡرٖ وَمَآ أَنَا۠ مِنَ ٱلۡمُتَكَلِّفِينَ ﴿٨٦﴾ إِنۡ
هُوَ إِلَّا ذِكۡرٞ لِّلۡعَٰلَمِينَ ﴿٨٧﴾ وَلَتَعۡلَمُنَّ نَبَأَهُۥ بَعۡدَ حِينِۭ ﴿٨٨﴾

"Ai (All'llahu) **tha: betohem në të vërtetën, Unë them vetëm të vërtetën."**

"Patjetër që do të mbush Xhehennemin me ty (djallin) **dhe me të gjithë ata që të ndjekin ty."**

"(O Muhammed) **'Thuaj: unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim dhe as nuk jam prej atyre që bëjnë trillime.'"**

"Ky (Kur'àni) **është vetëm këshillë për botët."**

"Pas një kohe, ju patjetër do ta njihni të vërtetën e tij."

Komentimi

Biseda e fundit në lidhje me Iblijsin (djallin)

Ajetet tona objekt studimi, janë ajetet e fundit të sures "Sàd" dhe në të vërtetë, studimet e ndryshme që trajtojnë ajetet e fundit të kësaj sureje, janë thelbi i të gjithë përmbajtjes së kësaj sureje.

Në fillim, në përgjigje të kërcënimeve të Iblijsit (djallit) për të mashtruar të gjithë njerëzit, me përjashtim të besimtarëve të sinqertë, Krijuesi i Gjithëfuqishëm përgjigjet me fjalën e Tij: **"Ai** (All'llahu) **tha: betohem në të vërtetën, Unë them vetëm të vërtetën"**;[1] dhe se: **"Patjetër që do të mbush Xhehennemin me ty** (djallin) **dhe me të gjithë ata që të ndjekin ty."**.

Ajo që është thënë në fillim të sures e deri këtu, është e vërteta, ajo që u tha në lidhje me gjendjet e Profetëve të mëdhenj në këtë sure për shkak të luftërave që ata bënë në rrugën e All'llahut, është e vërtetë. Biseda e zhvilluar në këtë sure rreth Ditës së Kiametit dhe ndëshkimit të dhimbshëm që i pret mohuesit mizorë, si dhe mirësitë e mëdha e të shumta që do të japë Krijuesi i Gjithëfuqishëm për banorët e Xhennetit, të gjitha këto janë të vërteta. Edhe fundi i sures është i vërtetë dhe

[1] Brendia e kësaj fjalie përmban disa opsione: fjala *"el hak'ku"* – *"e vërteta"* nga ana e sintaksës së gjuhës arabe mund të jetë kryefjalë dhe konsiderohet kallzues i hequr për kryefjalën. Gjithashtu edhe fjala *"ekùlu"* mund të jetë kallzues për frazën **"Unë them vetëm të vërtetën"**. Ka edhe një opsion tjetër, që thotë se fjala *"el hak'ku"* – *"e vërteta"* është kallzues për një kryefjalë të hequr dhe vlerësimi i ajetit, sipas këtij opsioni, do të ishte: **"kjo është e vërteta"** ose **"Unë jam i Vërteti"**.

All'llahu i Lartësuar, duke u betuar në të vërtetën, thotë të vërtetën se Ai shumë shpejt do të mbushë Xhehennemin me djallin e me ata që ndjekin djallin dhe kjo është një përgjigje e formës së prerë kundër fjalës së Iblijsit (djallit) se do të mashtrojë të gjithë njerëzit. Me këtë ajet të nderuar, Krijuesi i Gjithëfuqishëm shpjegoi qartë detyrimin për të gjithë njerëzit.

Në të gjitha gjendjet, këto dy fjali kanë shumë përforcime, herë theksojnë çështjen e të vërtetës dhe betohen për atë; gjithashtu, shprehja *"le emlen'ne"* ka ardhur e shoqëruar me germën përforcuese *"n'n"* të dubluar dhe me shprehjen *"exhmeijne"* – *"të gjithë"* në fakt është një përforcim i ri për të gjithë fjalinë dhe me këto përforcime ajeti thotë qartë: Askush të mos dyshojë ose të ngurrojë në lidhje me çështjen se nuk ka asnjë rrugë shpëtimi për djallin e për ata që ndjekin djallin dhe se ata do të vazhdojnë të ecin në rrugën e bërjes së gabimeve, megjithëse e dinë se ajo është rruga që çon në Xhehennem.

Në fundin e këtij studimi, Krijuesi i Gjithëfuqishëm e vë theksin mbi katër punë, të shprehura me disa fraza të shkurtra shumë të qarta.

Në frazën e parë, thotë: **"**(O Muhammed) **'Thuaj: unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim.'"**.

Me këtë fjalë, Profeti më i nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* u vuri kufi pretekseve të atyre që kërkonin të justifikoheshin dhe e bëri të qartë se ai kishte qëllim vetëm shpëtimin e lumturinë e Njerëzimit. Ai nuk kërkonte prej tyre as shpërblim material e as shpërblim moral, nuk kërkonte as që t'ia dinin për të mirë e as që ta falënderonin, me thirrjen e tij ai

nuk kërkonte as pozitë e as të bëhej sundimtar; ai u thoshte atyre qartë: shpërblimin unë e kam të garantuar te All'llahu. Kjo e vërtetë është përmendur edhe në ajete të tjera të Kur'ànit Famëlartë, si, për shembull, në ajetin 47 të sures "Sebe", ku lexojmë: **"…shpërblimi im është vetëm prej All'llahut…"**.

Në frazën e dytë, thotë: Unë nuk jam prej atyre që bëjnë trillime, fjala ime është e mbështetur mbi argumente dhe në logjikën, në fjalën time s'ka asnjë trillim e asnjë stisje, shprehjet e mia janë të qarta, në fjalët e mia s'ka asgjë të errët, s'ka veshje ose fjalë që i vijnë çështjes rreth e rrotull dhe fraza e fundit e ajetit njofton: **"nuk jam prej atyre që bëjnë trillime"**.

Në realitet, fraza e parë trajton cilësitë e thirrësit në udhëzimin në Rrugën e Drejtë; kurse fraza e dytë trajton rrugët e thirrjes dhe përmbajtjen e saj.

Fraza e tretë, shpjegon qëllimin kryesor të kësaj thirrjeje të madhe që del prej zbritjes së këtij libri qiellor dhe ajeti njofton: **"Ky** (Kur'àni) **është vetëm këshillë për botët."**.

Po, është e rëndësishme që ky libër të zgjojë njerëzit prej gjumit të shkujdesjes dhe t'i bëjë ata që të thellohen në mendimet mbi fjalët e këtij libri, sepse rruga është e qartë, shenjat e asaj rruge janë të dukshme, natyra e pastër e krijimit në brendësi të njeriut është një shtytës i fuqishëm që e çon njeriun drejt rrugës së Njëtimit të All'llahut e përkushtimit, por, më e rëndësishme këtu, është ndërgjegjësimi. Ky është kumti i Profetëve dhe i librave të tyre qiellorë.

Fraza **"Ky** (Kur'àni) **është vetëm këshillë për botët"**, ka ardhur disa herë në Kur'ànin Famëlartë dhe në të gjitha herët

shpjegon përmbajtjen e thirrjes së Profetëve, me të gjitha etapat nëpër të cilat ka kaluar thirrja e tyre; gjithashtu, shpjegohet qartë se thirrja e Profetëve është në përshtatje me natyrën e pastër të krijimit, me të cilën na ka krijuar i Gjithëfuqishmi. Të dy elementet që përbëjnë qëllimin kryesor të thirrjes, domethënë zgjimi i njerëzve prej shkujdesjes dhe thellimi në mendim, ecin përpara krah për krah.

Në frazën e katërt dhe të fundit, All'llahu i Lartësuar kërcënon kundërshtarët me një frazë të shkurtër, por të mbushur me kuptime të shumta: **"Pas një kohe, ju patjetër do ta njihni të vërtetën e tij."**.

Me këtë ajet, i Larti u thotë mohuesve: Ju mund të mos e merrni këtë fjalë seriozisht, megjithëkëtë do të vazhdoni të ecni si njerëz të respektuar, por shumë shpejt për ju do të bëhet e qartë e vërteta e fjalës Sime. Fjala Ime në këtë botë do të vërtetohet në fushat e betejave islame kundër mohimit dhe në fushat e punës shoqërore e intelektuale, do të vërtetohet edhe në Botën Tjetër, nëpërmjet ndëshkimit të dhimbshëm të All'llahut, ndëshkim të cilin do ta provojnë mohuesit. Në përmbledhje të kësaj, rezulton se goditja hyjnore është përgatitur që të bjerë mbi mendjemëdhenjtë mizorë.

Hulumtim

Cili është trilluesi?

Në ajetet e mësipërme, lexuam se njëra prej punëve me të cilën krenohet i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* është se ai nuk ishte trillues. Në transmetimet islame, ka shumë studime që sqarojnë shenjat e stisësit dhe të atij që hiqet ashtu si nuk është.

Në një hadith të cituar në librin "Xheuàmiul xhevàmiu", lexojmë se i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Stisësi, trilluesi, ka tri shenja: Ngatërrohet me atë që është sipër tij, jep atë që nuk e ka dhe flet për punë që nuk i di.*".[1]

Në librin "El Khusàl", ka ardhur një transmetim i ngjashëm prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* në lidhje me porositë që Lukmàni i la djalit të tij.

Në një hadith tjetër të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë këshillat e tij për Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Trilluesi ka tri shenja: Serviloset kur vjen, qorton atë që nuk është i pranishëm dhe ka neveri prej pësimit.*".[2]

Nga tërësia e këtyre transmetimeve, bëhet shumë e qartë se trilluesit kanë dalë jashtë rrugës së vërtetë, kanë dalë jashtë drejtësisë, kanë dalë jashtë fjalës së drejtë dhe besnikërisë. Ata

[1] "Xheuàmiul Xheuàmi'i", cituar prej tefsirit "El Mijzàn", vëll. 17, f.243.
[2] Tefsiri "Nùruth Thakalejn", vëll. 4, f. 474.

nuk i shohin të vërtetat që kanë para syve dhe ngatërrohen me mitet e me iluzionet, merren me punë për të cilat s'kanë asnjë lloj dije dhe ndërhyjnë në punë që s'kanë të bëjnë me ta. Ata kanë anën e jashtme dhe anën e brendshme, prania e mosprania e tyre janë në kundërshtim njëra me tjetrën, ata e lodhin dhe e mundojnë shumë veten, megjithëkëtë ata s'korrin gjë tjetër përveç shpresave të parealizuara dhe humbjes, kurse të përkushtuarit, punëmirët dhe ata që janë të pastër, janë krejtësisht të dëlirë nga vese të këtij lloji.

FUNDI I SURES "SÀD"

Sure "Ez Zumer"

zbritur në Mekë, numri i ajeteve 75

Përmbajtja e sures "Ez Zumer"

Kjo sure ka zbritur në Mekën e nderuar dhe për këtë shkak edhe në këtë sure, si në të gjitha suret e zbritura në Mekë, trajtohen çështje që kanë të bëjnë me Njëtimin e All'llahut (Teuhidin), Ringjalljen, rëndësinë e madhe të Kur'ànit Famëlartë dhe me pozitën e profetnisë së Profetit të Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*.

Periudha kohore që kaluan myslimanët e parë në Mekë, ishte periudha e ndërtimit të besimit, prandaj suret e zbritura në Mekë përmbajnë studimet më ndikuese në fushën e besimit dhe ishin një bazë e fuqishme, e mbushur me urtësi, por ndikimet e fuqishme të këtyre sureve dolën në dritë me tërë shkëlqimin e tyre mahnitës në Medine, gjatë luftërave me armiqtë e Islamit dhe pengesave që vinin hipokritët para pranimit të sistemit islam. Nëse duam të njihemi me sekretin e triumfit të shpejtë të myslimanëve në Medine, patjetër duhet të lexojmë mësimet mbresëlënëse që përmbajnë suret e zbritura në Mekën e nderuar.

Kjo sure e Kur'ànit Famëlartë përbëhet prej disa pjesëve të rëndësishme:

1- Kjo sure cek çështjen e thirrjes për të besuar në Njëtimin e All'llahut, në besimin që vetëm All'llahu është Krijuesi, vetëm All'llahu është Zotëruesi dhe adhurimi i takon vetëm All'llahut. Gjithashtu, kjo sure hedh dritë të plotë në çështjen e pastërtisë së adhurimit kushtuar vetëm për All'llahun e Lartësuar. Ajetet e kësaj sureje që flasin për adhurim kushtuar vetëm për All'llahun e Lartësuar, janë shumë ndikuese, tërheqin zemrat e njerëzve dhe i

shtyjnë zemrat që të jenë sa më të pastra e sa më të sinqerta në adhurimin kushtuar All'llahut të Gjithëfuqishëm.

2- Çështje të tjera shumë të rëndësishme, që përmenden në disa ajete të kësaj sureje, prej fillimit e deri në fund të saj, janë çështjet e ringjalljes pas vdekjes, gjykatës së madhe hyjnore, shpërblimit e dënimit, dhomat e bukura të Xhennetit dhe zgavrat e zjarrit në Xhehennem. Gjithashtu, në këto ajete trajtohet çështja e frikës prej Ditës së Kiametit dhe prej daljes në shesh të rezultateve të punëve të njerëzve Ditën e Gjykimit të madh, ditën kur punët e njerëzve do të jenë të formësuara në atë kuadër të madh. Po ashtu, ajetet e kësaj sureje tregojnë se sa të nxira do të jenë atë ditë fytyrat e gënjeshtarëve, të cilët stisën gënjeshtra për All'llahun e Lartësuar. Në këtë pjesë të ajeteve, tregohet se mohuesit do të përçohen si bagëtia në drejtim të zjarrit të Xhehennemit, ku mohuesit do të vihen para qortimit të engjëjve të ngarkuar me zbatimin e ndëshkimit hyjnor. Gjithashtu, në këto ajete flitet edhe për ftesën që u bëhet banorëve të Xhennetit për të hyrë në Xhennet dhe për urimet e shumta që u drejtojnë atyre engjëjt e mëshirës. Të gjitha këto punë, kanë si bosht rrotullimi të përbashkët çështjen e ringjalljes pas vdekjes dhe janë të ndërthurura me çështjet që kanë lidhje me Njëtimin e All'llahut, madje janë aq të ndërthurura njëra me tjetrën, sa duket sikur formojnë një endje të vetme.

3- Në një pjesë tjetër jo të madhe të ajeteve të kësaj sureje, trajtohet rëndësia shumë e madhe e Kur'anit Famëlartë dhe ata flasin në mënyrën më të bukur për Kur'anin dhe për ndikimin e fuqishëm që lënë ajetet e Kur'anit në zemrat e në shpirtrat.

4- Në një pjesë tjetër të ajeteve të kësaj sureje, shpjegohet qartë si qe e ardhmja e popujve të përparshëm dhe ndëshkimi i dhimbshëm i All'llahut që ra mbi ata popuj, për shkak se ata i përgënjeshtruan argumentet e All'llahut të Lartësuar.

5- Në pjesën e fundit të ajeteve të kësaj sureje, flitet për çështjen e pendimit (et teube) dhe tregohet se portat e pendimit janë të hapura për cilindo që ka dëshirë të kthehet në Rrugën e All'llahut. Ajetet e kësaj pjese janë ajetet me më shumë ndikim në fushën e pendimit, aq sa mund të thuhet se ajetet e kësaj pjese japin përgëzimin dhe përmbajmë njoftime të gëzueshme të atilla, që nuk mund të gjenden si ato në ajetet e tjera të Kur'anit Famëlartë.

Kjo sure e nderuar e Kur'nit Famëlartë, njihet me emrin "sure 'Ez Zumer'" dhe ky emër është marrë prej ajeteve 71 dhe 73 të kësaj sureje, në të cilat ka ardhur fjala "Ez Zumer". Gjithashtu, kjo sure njihet edhe me emrin sure "El Guruf", emër që është marrë prej ajetit 20 të kësaj sureje, por ky emërtim nuk është i përhapur.

Mirësia e sures "Ez Zumer"

Transmetimet islame shpjegojnë qartë mirësinë e leximit të kësaj sureje. Në një hadith të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Kush e lexon suren "Ez Zumer", All'llahu nuk ia pret atij shpresën dhe atij i jepen shpërblimet e atyre që e kanë frikë All'llahun e Lartësuar."*.[1]

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë se ai ka thënë: *"Kush lexon suren "Ez Zumer", atë All'llahu e nderon në këtë botë e në Botën Tjetër, e fuqizon atë pa pasuri e pa mbështetjen e fisit, bën që atë ta dojë kushdo që e sheh dhe zjarri i Xhehennemit e ka të ndaluar të djegë tupin e tij."*.[2]

Krahasimi i mirësive të leximit të sures "Ez Zumer" me përmbajtjen e saj në fushën e frikës ndaj All'llahut, shpresës në mëshirën e Tij, adhurimit të sinqertë dhe dorëzimit pa asnjë kusht para All'llahut të Lartësuar, e bën të qartë se këto shpërblime në të vërtetë i jepen atij që e ka bërë leximin e kësaj sureje si një parathënie për të menduar sa më thellë dhe një parathënie për besimin e për punën e tij.

Me fjalë të tjera: Përmbajtja e kësaj sureje depërton në thellësi të shpirtit të lexuesit dhe lartësohet mbi të gjitha dukuritë e jetës shoqërore dhe individuale. Natyrisht që individë të këtillë e meritojnë këtë shpërblim të madh dhe këtë mëshirë kaq të gjerë.

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", fillimi i sures "Ez Zumer".

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn"; libri "Thevàbul A'màl" dhe tefsiri "Nùruth Thekalejn".

Ajetet: 1 - 3

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

تَنزِيلُ ٱلۡكِتَٰبِ مِنَ ٱللَّهِ ٱلۡعَزِيزِ ٱلۡحَكِيمِ ﴿١﴾ إِنَّآ أَنزَلۡنَآ إِلَيۡكَ ٱلۡكِتَٰبَ بِٱلۡحَقِّ فَٱعۡبُدِ ٱللَّهَ مُخۡلِصٗا لَّهُ ٱلدِّينَ ﴿٢﴾ أَلَا لِلَّهِ ٱلدِّينُ ٱلۡخَالِصُۚ وَٱلَّذِينَ ٱتَّخَذُواْ مِن دُونِهِۦٓ أَوۡلِيَآءَ مَا نَعۡبُدُهُمۡ إِلَّا لِيُقَرِّبُونَآ إِلَى ٱللَّهِ زُلۡفَىٰٓ إِنَّ ٱللَّهَ يَحۡكُمُ بَيۡنَهُمۡ فِي مَا هُمۡ فِيهِ يَخۡتَلِفُونَۗ إِنَّ ٱللَّهَ لَا يَهۡدِي مَنۡ هُوَ كَٰذِبٞ كَفَّارٞ ﴿٣﴾

Bismil'làhirr Rrahmànirr Rrahim

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

"Libri është zbritur prej All'llahut, të Gjithëfuqishmit, të Urtit."

"Ne të zbritëm ty (o Muhammed) **librin me të vërtetën, prandaj ti adhuroje All'llahun me sinqeritet në adhurimin që bën për Atë."**

"Bëni kujdes! Adhurimi i sinqertë bëhet vetëm për All'llahun; kurse ata që në vend të Tij adhurojnë miq të tjerë (thonë)**: ne nuk i adhurojmë ata për ndonjë gjë tjetër vetëm që të na afrojnë te All'llahu; pa dyshim, All'llahu do të gjykojë në mes tyre për çështjet rreth të cilave ata kishin kundërshtime; dhe All'llahu nuk udhëzon në Rrugën e Drejtë atë që është gënjeshtar e mohues."**

Komentimi

Je i urdhëruar të bësh adhurim të sinqertë

Kjo sure fillon me dy ajete, që flasin për zbritjen e Kur'ànit Famëlartë; ajeti i parë njofton se All'llahu i Lartësuar është Ai që e zbriti Kur'ànin, kurse ajeti i dytë shpjegon përmbajtjen dhe qëllimet e Kur'ànit Famëlartë.

Në fillim, ajeti njofton: **"Libri është zbritur prej All'llahut, të Gjithëfuqishmit, të Urtit."**.

Natyrisht që çdo libër njihet nëpërmjet autorit të tij ose të Atij që e ka zbritur atë libër. Kur ne arrijmë të kuptojmë se ky Libër i madh qiellor është i frymëzuar prej diturisë së All'llahut, të Fuqishmit, të Urtit, se ky libër është zbritur prej të Gjithëfuqishmit, e kemi të qartë se asgjë nuk mund të qëndrojë para fuqisë së Tij absolute dhe se për diturinë e të Cilit asnjë punë nuk mbetet e panjohur. Atëherë ne ndërgjegjësohemi se

përmbajtja e këtij libri është e vërtetë dhe i gjithë ky libër është urtësi, dritë e udhëzim në Rrugën e Drejtë.

Kur, në fillim të sureve të Kur'ànit Famëlartë, vijnë të këtilla shprehje, ato i udhëzojnë besimtarët në të vërtetën, sepse çdo gjë që gjendet në Kur'ànin Famëlartë, është fjalë e All'llahut dhe nuk është fjalë e të Dërguarit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* pavarësisht se edhe fjala e tij gjithashtu është fjalë e arritur dhe e mbushur me urtësi.

Më pas, në këtë sure shpalosen përmbajtja e këtij libri qiellor dhe qëllimet e tij dhe ajeti i parë i këtij grupi ajetesh njofton në frazën e tij të parë: **"Ne të zbritëm ty** (o Muhammed) **librin me të vërtetën…"**.

Në këtë libër s'ka asgjë tjetër përveç të vërtetës dhe për këtë shkak, këtë libër e ndjekin vetëm ata që kërkojnë të vërtetën, e ndjekin ata që studiojnë të vërtetën dhe ata që merren me studimet rreth përmbajtjes së këtij Libri Famëlartë. Nga ky shpjegim, rezulton se qëllimi i zbritjes së Kur'ànit është që të saktësojë dhënien e një feje të pastër për Njerëzimin, ashtu siç njoftohet në frazën e dytë të ajetit: **"…prandaj ti adhuroje All'llahun me sinqeritet në adhurimin që bën për Atë."**.

Në këtë frazë të ajetit, qëllimi me fjalën *"ed'dijne"*, është adhurimi kushtuar vetëm për All'llahun e Lartësuar, sepse fraza para kësaj fjale *"fe' budil'làhe"* – **"prandaj ti adhuroje All'llahun"** është urdhër për të adhuruar vetëm All'llahun, prandaj edhe fraza vijuese **"me sinqeritet në adhurimin që bën për Atë"**, shpjegon se adhurimi patjetër duhet të jetë i pastër e i sinqertë,

vetëm për All'llahun e Lartësuar dhe largim i plotë prej çdo forme idhujtarie e hipokrizie.

Në të gjitha gjendjet, fjala *"ed'dijne"*, ka një kuptim shumë të gjerë dhe fakti që kjo fjalë ka ardhur e pakushtëzuar, i jep kësaj fjale një përmasë të atillë që përfshin adhurimet dhe punët e tjera, duke shtuar edhe punët që kanë lidhje me besimin. Thënë ndryshe, fjala *"ed'dijne"* e këtij ajeti, përfshin të gjitha punët materiale e morale të njeriut, prandaj robtë e All'llahut kanë detyrë të jenë të pastër e të sinqertë, gjatë gjithë jetës së tyre, ndaj All'llahut të Lartësuar. Gjithashtu, ata kanë detyrë të mbajnë të pastër mjedisin e tyre të punës dhe rrethin e bisedave të tyre, prej çdo gjëje që bie ndesh me urdhërat e All'llahut. Duhet që njeriu vazhdimisht duhet të mbajë në mendje All'llahun dhe të ketë dashuri të madhe për All'llahun e Lartësuar. Robtë e All'llahut duhet të flasin për All'llahun, të punojnë për hir të All'llahut dhe gjithmonë kanë detyrë të ecin në rrugën në të cilën fitohet kënaqësia e All'llahut. Ky është sinqeriteti në fe e në adhurim.

Nuk ka asnjë shkak e asnjë argument të qartë që të kufizojë kuptimin e këtij ajeti në fjalën e dëshmisë: **"esh'hedu en le il'àhe il'lell'llàh" – "Dëshmoj me fjalë dhe pohoj me zemër se nuk ka zot tjetër përveç All'llahut"**, ose që kuptimi i kësaj fjalë të kufizohet vetëm në adhurimin për All'llahun dhe në bindjen e plotë ndaj All'llahut.

Ajeti i tretë i këtij grupi ajetesh, thekson edhe një herë çështjen e adhurimit të sinqertë dhe në frazën e tij të parë, njofton: **"Bëni kujdes! Adhurimi i sinqertë bëhet vetëm për All'llahun."**. Kjo frazë e ajetit, ka dy kuptime:

Kuptimi i parë: Krijuesi Fuqiplotë pranon vetëm adhurimin e sinqertë, pranon vetëm dorëzimin e plotë ndaj Tij, pa asnjë kusht; Ai nuk pranon punën në të cilën ka hipokrizi ose idhujtari. Gjithashtu, Ai nuk pranon as përzierjen e ligjeve të All'llahut me ligjet e vëna prej njerëzve.

Kuptimi i dytë: Feja dhe legjislacioni i pastër duhet të merren vetëm prej librit të All'llahut të Lartësuar, sepse mendimet e njeriut janë të mangëta dhe në mendimet e njeriut gjithmonë ka gabime e iluzione.

Por, duke parë në fundin e ajetit të përparshëm, rezulton se kuptimi i parë është më i drejtë, sepse ata i kryejnë me sinqeritet detyrimet që u kërkohen të kryejnë. Prandaj, nga ky këndvështrim, ata janë robtë e All'llahut dhe ky është sinqeriteti për të cilin flitet në ajetin në fjalë. Për këtë, mbetet detyrë të tregohet kujdes i veçantë për kryerjen e adhurimit me sinqeritet.

Ka edhe një argument tjetër që vërteton këtë thënie dhe ky është hadithi i ardhur prej të Dërguarit të All'llahut (Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) në të cilin lexojmë se një burrë i tha të Dërguarit të All'llahut: *"Ne i japim pasuritë tona në kërkim të përmendjes, për këtë, a ka për ne shpërblim?"* I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* tha: "Jo". Burri përsëri tha: *"O i Dërguar i All'llahut, ne japim në kërkim të shpërblimit dhe të përmendjes, a ka shpërblim për ne?"* I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* tha: *"All'llahu i Lartësuar pranon vetëm atë që është dhënë e është bërë me pastërti të plotë, vetëm për hir të Tij dhe*

pastaj lexoi ajetin: **"Bëni kujdes! Adhurimi i sinqertë bëhet vetëm për All'llahun."**.[1]

Patjetër që, ky ajet, në fakt është një deduksion për ajetin para këtij ajeti, në të cilin thuhej: **"prandaj ti adhuroje All'llahun me sinqeritet, në adhurimin që bën për Atë"** kurse në këtë ajet, thuhet: **"Bëni kujdes! Adhurimi i sinqertë bëhet vetëm për All'llahun."**.

Çështja e adhurimit të pastër e të sinqertë vetëm për All'llahun e Lartësuar, është trajtuar në shumë ajete të Kur'ànit Famëlartë dhe në shumë hadithe e transmetime islame, madje fillimi i ajetit objekt studimi me fjalën *"elà"*, që në gjuhën arabe përdoret si parafjalë, për të tërhequr vëmendjen, në kuptimin: Dëgjoni me vëmendje, bëni kujdes. Ky është një argument tjetër që vërteton rëndësinë e çështjes së sinqeritetit në adhurimin kushtuar vetëm për All'llahun e Lartësuar.

Në vijim, ajeti zhvlerëson logjikën mjerane të idhujtarëve, të cilët, për shkak se lanë rrugën e adhurimit të pastër e të sinqertë vetëm për All'llahun e Lartësuar, ranë në rrugën e idhujtarisë dhe u shmangën prej udhëzimit për në Rrugën e Drejtë dhe ajeti njofton për logjikën e kotë të idhujtarëve: **"Kurse ata që, në vend të Tij, adhurojnë miq të tjerë** (thonë)**: ne nuk i adhurojmë ata për ndonjë gjë tjetër vetëm që të na afrojnë te All'llahu; pa dyshim, All'llahu do të gjykojë në mes tyre për çështjet rreth të cilave ata kishin kundërshtime."**.[2] Këtu bëhet e qartë për të

[1] Tefsiri "Rùhul Meànij", vëll. 23, f. 212, fundi i ajeteve në fjalë.

[2] Është e qartë se, në ajetin e lartpërmendur, fraza **"ne nuk i adhurojmë ata"**, është fjali vlerësuese dhe kuptimi i saj është: "ata thonë ne nuk i adhurojmë ata".

gjithë, sa të shprishura ishin mendimet e punët e atyre idhujtarëve dhe sa pa vlerë ishin besimet e tyre të kota.

Për idhujtarët, ky ajet është një kërcënin i formës së prerë. Ai njofton se Krijuesi Fuqiplotë do të gjykojë mes tyre në Ditën e Kiametit. Në atë Ditë do të zbulohen të gjitha veshjet dhe do të dalin sheshit të vërtetat. Në atë Ditë ata do të marrin dënimin për punët e ndaluara që kanë bërë. Përveç kësaj ata do të diskriminohen para të gjithëve, në sheshin e Gjykatës së Madhe.

Logjika e adhuruesve të idhujve, këtu është shumë e qartë. Njëri prej shkaqeve të adhurimit të idhujve është se një grup prej tyre mëtonte se All'llahu i Lartësuar është shumë i lartë që të përfshihet në kuptimin e njerëzve, qoftë me mendje, qoftë me pandehma, qoftë me ndjenja. Ata thoshin se All'llahu është krejtësisht i pastër që të jetë objekt adhurimi i drejtpërdrejtë, prandaj është detyrim që të afrohemi te All'llahu me ndërmjetësimin e krijesave më të afërme te Ai dhe se All'llahu, rregullimin e çështjeve të botës e ka lënë në dorën e atyre që janë afër Tij, prandaj ne i adhurojmë idhujt në vend të All'llahut. Duke adhuruar idhujt ne duam të afrohemi te All'llahu, gjithashtu, dëshirojmë që idhujt të ndërmjetësojnë për ne te All'llahu dhe të na afrojnë sa më pranë Tij dhe këta të afërm janë engjëjt, xhindët dhe njerëzit punëmirë.

Kur idhujtarët e ndjenë se e kishin të pamundur të arrinin te të shenjtët, gdhendën shtatore, që, sipas mendimit të tyre, përfaqësonin shenjtorët dhe kështu ata filluan të adhurojnë idhujt; veç kësaj, ata thoshin se nuk ka asnjë dallim në mes shtatoreve dhe atyre shenjtorëve dhe se në mes idhujve e shenjtorëve ka një

lloj uniteti, prandaj ata bënë qëllim adhurimin e idhujve dhe i konsideruan idhujt zota.

Në këndvështrimin e tyre, zotat e tyre janë të krijuar prej All'llahut. Ai i ka afruar ata pranë Vetes dhe i ka ngarkuar me detyrën e rregullimit të punëve të Botës. Idhujtarët mendonin në mënyrë të gabuar kur thoshin për Krijuesin e Gjithësisë: "Ai është Zoti i zotave" dhe se Ai është Krijuesi i botës së ekzistencës. Ishte gjë e rrallë të gjendej dikush prej mesit të idhujtarëve që të thoshte se idhujt e punuar prej druri ose prej guri, madje edhe zotat e tyre të përfytyruar, domethënë engjëjt, xhindët e të ngjashëm me ata, janë krijuesit e botës së ekzistencës.[1]

Natyrisht që për adhurimin e idhujve ka edhe shkaqe të tjera, si, për shembull, respekti shumë i madh që ata kishin në disa raste për Profetët e për njerëzit e mirë dhe këtë respekt ndaj tyre ata e shprehnin duke respektuar shtatoret që kishin ngritur për t'i kujtuar ata burra të nderuar. Por, pas vdekjes së atyre burrave të mirë e të mëdhenj dhe me kalimin e kohës, shtatoret që ata vetë i kishin gdhendur, në mendjen e tyre morën një karakter të pavarur, derisa respekti për të mirët u kthye në adhurim kushtuar shtatoreve. Ky është edhe shkaku që Islami e ka ndaluar rreptësisht punimin e shtatoreve.

Në librat e historisë, thuhet se arabët e kohës së injorancës, para Islamit, e respektonin shumë Qabenë e nderuar. Gjithashtu, ata respektonin shumë edhe tokën e Mekës së nderuar, prandaj, kur udhëtonin prej një vendi në një vend tjetër, merrnin prej kësaj toke copa të vogla guri, që t'i kishin si hajmali dhe ato copa guri ata i rrethonin me një respekt shumë të madh, derisa respekti për

[1] Tefsiri "El Mijzàn", vëll. 17, f. 247, me disa ndryshime.

ato copa guri u shndërrua në shenjtërim dhe më pas filluan t'i adhurojnë ato.

Në tregimin e Amr bin Lehà, thuhet se Amri, në njërin prej udhëtimeve të tij për në vendet e Shamit, vuri re se në ato vende njerëzit adhuronin idhujt dhe gjatë kthimit në Hixhaz, ai mori me vete një idhull prej vendeve të Shamit; kështu, qysh nga ajo kohë filloi edhe në Hixhaz adhurimi i idhujve. Natyrisht që ky tregim nuk është në kundërshtim me atë që u tha më sipër, pasi ky tregim shpjegon disa rrënjë të adhurimit të idhujve dhe tregon se edhe banorët e Shamit kishin arritur deri në adhurimin e idhujve për shkak të veprimeve të tyre të njëjta me veprimet e arabëve të asaj kohe. Ose ata mund të kenë arritur në adhurimin e idhujve nga praktikimi i veprimeve të afërme me adhurimin e idhujve.

Adhurimi i idhujve, në çdo formë që të bëhet, nuk është gjë tjetër veçse iluzion e mit, që s'ka asgjë të vërtetë dhe që ka dalë prej mendjeve të dobëta e të pafuqishme, por që i shmangu njerëzit prej rrugës kryesore e origjinale për të njohur All'llahun e Lartësuar.

Kur'àni Famëlartë, thekson në mënyrë të veçantë se njeriu ka mundësi të arrijë tek All'llahu pa asnjë ndërmjetësim, se njeriu ka mundësi të bisedojë në intimitet me All'llahun e Lartësuar dhe të kërkojë prej Tij plotësimin e nevojave që ka. Gjithashtu, njeriu ka mundësi të kërkojë prej All'llahut faljen e fajeve e të mëkateve që ai bën, pa ndërmjetës dhe të parashtrojë para All'llahut pendimin e tij për punët e padenja që ai ka bërë. Të gjitha këto punë, janë nën pushtetin e fuqisë së All'llahut dhe sure "El Hamd" - sure "El Fàtiha" - e shpjegojnë qartë këtë të vërtetë. Myslimani, duke e lexuar këtë sure vazhdimisht, në të gjitha

namazet e tij ditore, është vazhdimisht në lidhje të drejtpërdrejtë me Krijuesin Fuqiplotë. Gjithashtu, myslimani, duke lexuar suren "Fàtiha", kërkon prej All'llahut plotësimin e nevojave vetiake, pa asnjë ndërmjetës.

Rrugët e kërkimit të faljes së mëkateve dhe parashtrimit të pendimit, si dhe kërkimi i ndihmës prej Krijuesit Fuqiplotë, ka ardhur në shumë lutje (dua) të njohura dhe me shumë ndikim. Të gjitha këto, shpjegojnë qartë se Islami nuk pranon se duhet të ketë ndërmjetës në mes njeriut e në mes All'llahut të Lartësuar, për të gjitha kërkesat që njeriu i drejton Krijuesit Fuqiplotë, duke shtuar se drejtimi nga All'llahu dhe kërkimi i ndihmës vetëm prej Tij, është e vërteta e besimit se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm, madje në Islam, çështja e ekzistencës së ndërmjetësimit me "miqtë e All'llahut", është e kushtëzuar me lejimin e Krijuesit Fuqiplotë dhe ndërmjetësimi do të jetë vetëm me lejen e Tij; por dhe ky lejim rithekson çështjen e Njëtimit të All'llahut të Lartësuar.

Është detyrë që lidhja me All'llahun e Lartësuar të jetë e këtillë, sepse i Gjithëfuqishmi është më afër nesh se çdo gjë tjetër, ashtu siç njofton për këtë vetë Kur'àni Famëlartë: **"...Ne jemi më afër tij** (njeriut) **se damari i qafës së tij"** (sure "Kàf", ajeti 16) dhe **"dhe dijeni se All'llahu ndërhyn në mes njeriut e zemrës së tij..."** (sure "El Enfàl", ajeti 24).

Ja, kështu, Krijuesi Fuqiplotë nuk është larg prej nesh dhe as ne nuk jemi larg prej Tij, prandaj s'ka nevojë për një ndërmjetës në mes njeriut e All'llahut të Lartësuar. Në të vërtetë, All'llahu është më afër nesh se çdo gjë tjetër, All'llahu i Lartësuar vazhdimisht është pranë nesh, në të gjitha vendet, Ai është deri në thellësi të zemrave tona.

Në përputhje me këtë që u shpjegua, adhurimi i ndërmjetësve, engjëj, xhind ose të ngjashëm me të parët, ose adhurimi i shtatoreve të punuara prej guri ose prej druri, është punë krejtësisht e pavlefshme, duke shtuar se adhurimi i idhujve numërohet mosmirënjohje për mirësitë e All'llahut, sepse vetëm Ai që dhuron mirësitë, meriton të adhurohet dhe jo ata trupa të vdekur, ose ata që për veten e tyre kanë nevojë të ndihmohen edhe për gjërat më të vogla, që nga maja e kokës deri në tabanin e këmbëve, prandaj Kur'àni Famëlartë, në fundin e ajetit objekt studimi, thotë: **"All'llahu nuk udhëzon në Rrugën e Drejtë atë që është gënjeshtar e mohues."**.

Gënjeshtarin dhe mohuesin e mirësive, All'llahu i Lartësuar nuk e udhëzon në rrugën e të vërtetës, as në këtë botë e as në Botën Tjetër. Kjo, sepse ai vetë e ka zënë rrugën e udhëzimit me të dyja duart e tij, në një kohë kur Krijuesi Fuqiplotë ka shpallur qartë se udhëzimin për në Rrugën e Drejtë e meriton vetëm njeriu që është i gatshëm të mirëpresë e të pranojë udhëzimin e All'llahut. Prandaj, All'llahu i Lartësuar asnjëherë nuk e derdh udhëzimin e Tij mbi ata që e kanë vrarë gatishmërinë që gjendet në zemrat e tyre.

Hulumtim

Dallimi në mes fjalëve *"tenzijl"* dhe *"inzàl"*

Në ajetin e parë ka ardhur shprehja: *"tenzijlul kitàbi"* dhe në ajetin e dytë ka ardhur shprehja *"in'à enzelnà ilejkel kitàbe"*. Atëherë, cili është dallimi në mes fjalës *"tenzijl"* dhe fjalës *"inzàl"*? Dhe cili është qëllimi me ndryshimin në mes dy shprehjeve në këto dy ajete?

Librat e gjuhës shpjegojnë se fjala *"tenzijl"* – *"zbret"* do të thotë: zbritja e një sendi pjesë-pjesë, në një kohë që fjala *"inzàl"* përfshin zbritjen graduale të një sendi dhe zbritjen e njëhershme të tij.[1]

Disa kanë thënë se çdonjëra prej këtyre dy fjalëve ka një kuptim të veçantë dhe se fjala *"tenzijl"* do të thotë zbritja e sendit pjesë-pjesë, jo në një kohë, kurse fjala *"inzàl"* do të thotë: zbritja e sendit njëherësh, në një kohë të vetme.[2]

Ndryshimi në mes këtyre dy shprehjeve, ka të bëjë me faktin se Kur'àni Famëlartë është zbritur me dy mënyra:

Mënyra e parë: ka zbritur i gjithi njëherësh, në zemrën e Muhammedit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen*

[1] "Mufredàtu el Fadhil Kur'àn" i autorit Ràgib El Isfehànij, lënda *"nezele"*, dallimi në mes dy fjalëve *"tenzijl"* dhe *"inzàl"* në përshkrimin e Kur'ànit dhe të engjëjve; fjala *"tenzijl"* ka kuptimin e zbritjes pjesë-pjesë, kohë pas kohe, kurse fjala *"inzàl"* ka kuptimin e zbritjes në përgjithësi dhe të plotë.

[2] Ky ndryshim ka ardhur në tefsirin "El Kebijr", cituar prej të tjerëve.

e tij!) "Natën e Kadrit", në muajin Ramazan, ashtu siç njofton i Larti në ajetin 1 të sures "El Kadr": **"Ne e zbritëm atë** (Kur'ànin) **në natën e Kadrit."** dhe në ajetin 3 të sures "Ed Dukhàn": **"Ne e zbritëm atë** (Kur'ànin) **në një natë të bekuar."** dhe në ajetin 185 të sures "El Bekare": **"Muaji i Ramazanit, në të cilin** (filloi) **zbritja e Kur'ànit."**.

Në të gjitha këto ajete, për "zbritjen" është përdorur fjala *"inzàl"*, çka tregon se Kur'àni është zbritur i gjithi njëherësh.

Mënyra e dytë: ka edhe një zbritje tjetër, që është plotësuar në mënyrë graduale dhe që ka vazhduar 23 vjet, domethënë aq sa është edhe periudha kohore e profetsisë së të Dërguarit më të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* pas çdo ngjarjeje e pas çdo problemi ka zbritur një ajet, ose më shumë që ishte në përshtatje me ngjarjen e që u jepte zgjidhje problemeve. Me këtë rrugë zbritjeje të Kur'ànit Famëlartë, Krijuesi Fuqiplotë i lartësonte myslimanët nga njëra etapë në një etapë të re, derisa u realizua plotësimi i tyre moral, në besim e në fushën shoqërore, ashtu siç njoftohet për këtë në ajetin 106 të sure "El Isrà": **"Kur'ànin Ne e ndamë pjesë-pjesë, që ti t'ua lexosh njerëzve dalëngadalë;** (prandaj) **Ne e zbritëm atë në mënyrë graduale."**.

Këtu tërheq vëmendjen fakti se dy fjalët *"tenzijl"* dhe *"inzàl"*, disa herë vijnë në të njëjtin ajet, për të shprehur të dy qëllimet, ashtu siç ka ardhur në ajetin 20 të sures "Muhammed": **"Ata që besuan, thanë: përse nuk zbret një sure** (që të na e bëjë luftën detyrim) **por kur surja zbriti e qartë dhe në të përmendej lufta, ata me zemra të sëmura ti i sheh të vështrojnë me një shikim si të ishin në agoninë e vdekjes."**.

Myslimanët e asaj kohe, herë pas here kërkonin të zbritej një sure e Kur'ànit në mënyrë graduale, që ata të asimilonin përmbajtjen e ajeteve të asaj sureje sa më mirë. Por, në disa raste, ishte e domosdoshme që surja të zbriste e gjitha njëherësh, sidomos suret që trajtojnë çështjet e luftës në rrugën e All'llahut (xhihàd), për faktin se zbritja e sureve të këtilla në mënyrë graduale, do të çonte në shfrytëzimin e saj në mënyrë të keqe prej hipokritëve (munafikëve), të cilët rrinin në përgjim të rasteve që të lëshonin helmin e tyre. Në raste të këtilla, siç thamë më sipër, surja zbriste e gjitha njëherësh dhe kjo është gjëja e fundit që ne mund të themi në lidhje me dallimin në mes dy shprehjeve *"tenzijl"* e *"inzàl"* dhe në përputhje të plotë me këto që u thanë në studimin tonë, rezulton se Kur'àni Famëlartë është zbritur në formën e tij të plotë me të dyja mënyrat.

Megjithëkëtë, mbeten edhe disa gjëra të përveçme për të interpretuar dhe për të shpjeguar dallimin në mes dy fjalëve të lartpërmendura, ashtu siç thuhet edhe në ajetin 32 të sures "El Furkàn": **"Ata që nuk besuan, thanë: përse atij** (Muhammedit) **Kur'àni nuk i është zbritur i gjithi njëherësh? Kështu** (e zbritëm pjesë-pjesë) **që me atë të forcojmë zemrën tënde, prandaj Ne e sollëm atë** (kohë pas kohe) **ajet pas ajeti."**.

Patjetër që, prej të dyja fjalëve *"tenzijl"* dhe *"inzàl"*, ka dobi dhe ndikime të veçanta, për të cilat do të flitet në vendet përkatëse.[1]

[1] Në lidhje me zbritjen e Kur'ànit në mënyrë graduale, kohë pas kohe, kemi vënë studim gjatë komentit të ajetit 34 të sures "El Furkàn.

Ajetet: 4 – 5

لَّوۡ أَرَادَ ٱللَّهُ أَن يَتَّخِذَ وَلَدٗا لَّٱصۡطَفَىٰ مِمَّا يَخۡلُقُ مَا يَشَآءُۚ سُبۡحَٰنَهُۥۖ هُوَ ٱللَّهُ ٱلۡوَٰحِدُ ٱلۡقَهَّارُ ۝٤ خَلَقَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضَ بِٱلۡحَقِّۖ يُكَوِّرُ ٱلَّيۡلَ عَلَى ٱلنَّهَارِ وَيُكَوِّرُ ٱلنَّهَارَ عَلَى ٱلَّيۡلِۖ وَسَخَّرَ ٱلشَّمۡسَ وَٱلۡقَمَرَۖ كُلّٞ يَجۡرِي لِأَجَلٖ مُّسَمّٗىۗ أَلَا هُوَ ٱلۡعَزِيزُ ٱلۡغَفَّٰرُ ۝٥

"Sikur të kishte dashur All'llahu të kishte fëmijë, do të kishte zgjedhur atë që dëshironte prej atyre që Ai Vetë i krijoi; Ai është i dëlirë nga të këtilla gjëra, Ai është All'llahu, i Vetmi, Mposhtësi i çdo sendi."

"Ai krijoi qiejt e Tokën me të vërtetën; Ai natën ia mbështjell ditës dhe ditën ia mbështjell natës (bën që të vijnë njëra pas tjetrës)**; Ai i nënshtroi Diellin dhe Hënën, secili lëviz deri në një afat të caktuar; dëgjoni, Ai është i Gjithëfuqishmi, Mëkatfalësi."**

Komentimi

All'llahu s'ka nevojë të ketë fëmijë

Idhujtarët, jo vetëm që i konsideronin idhujt ndërmjetësues për ata te All'llahu, ashtu siç u shpjegua në ajetet e përparme, por ata besonin se disa krijesa, si engjëjt, janë vajzat e All'llahut dhe ajeti i parë prej ajeteve në fjalë i përgjigjet këtij besimi absurd dhe këtij përfytyrimi shumë të keq me fjalët: **"Sikur të kishte dashur All'llahu të kishte fëmijë, do të kishte zgjedhur atë që dëshironte prej atyre që Ai Vetë i krijoi; Ai është i dëlirë nga të këtilla gjëra, Ai është All'llahu, i Vetmi, Mposhtësi i çdo sendi."**.

Interpretuesit e Kur'ànit, kanë përmendur mendime të ndryshme në lidhje me interpretimin e këtij ajeti:

Disa kanë thënë: Qëllimi me këtë ajet është që të bëhet e qartë se, sikur All'llahu i Lartësuar të kishte dashur të kishte një fëmijë për Veten e Tij, përse sipas jush Ai zgjodhi vajzat, për të cilat ju o idhujtarë thoni se ato s'kanë asnjë vlerë dhe përse All'llahu nuk zgjodhi të kishte djem? Në të vërtetë, ky arsyetim është njëri prej llojeve të deduksionit që shkon në përputhje të plotë me mendësinë e palës që ke përballë dhe bën që të kuptohet qartë se fjala e tyre s'ka asgjë të përbashkët me të vërtetën.

Të tjerë kanë thënë: Qëllimi me këtë ajet është: të bëhet e qartë se, sikur All'llahu të kishte dashur të zgjidhte një fëmijë për Veten e Tij, patjetër Ai do të kishte krijuar qenie të tjera më të virtytshme e më të larta se engjëjt.

Është detyrë të theksohet se, te Krijuesi Fuqiplotë, pozita e femrës nuk është më e vogël se pozita e mashkullit. Gjithashtu, është detyrë të theksohet se engjëjt, ose Isài *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!),* për të cilët disa të shmangur thonë se janë fëmijë të All'llahut, janë vetëm krijesa shumë të nderuara te All'llahu i Lartësuar. Atëherë rezulton se asnjëri prej dy interpretimeve të përmendura më sipër, nuk është i përshtatshëm.

Fjala më e mirë është që të thuhet: Ajeti ka qëllim të shpjegojë se, në të vërtetë, djali kërkohet ose për të ndihmuar ose për të qetësuar shpirtin dhe sikur tani të hamendsojmë se All'llahu i Lartësuar kishte nevojë për fëmijë, patjetër që do të kishte zgjedhur atë që Ai dëshironte prej krijesave të Tij më të nderuara, por Ai kurrë nuk ka pasur e nuk ka fëmijë.

Ai është i Vetëm, për Atë s'ka të ngjashëm, Ai është Mposhtësi e Ngadhënjyesi mbi të gjitha sendet, Ai është i Përparshmi, i Përjetshmi, Ai s'ka nevojë për ndihmën e askujt, Ai nuk ndihet i vetmuar nga që është Një e i Vetëm dhe qenia e Tij i Vetëm nuk e shmang Atë prej rrugës së dashurisë për krijesat e Tij, Ai është i dëlirë e tepër i lartë që të ketë fëmijë të lindur prej Tij, ose fëmijë të zgjedhur.

Veç kësaj që u tha, injorantët e asaj kohe, herë thoshin se engjëjt janë vajzat e All'llahut, herë tjetër thoshin se ka lidhje në mes Krijuesit Fuqiplotë dhe në mes xhindëve, herë tjetër thoshin se Mesijhu, ose Uzejri, janë djem të All'llahut. Ata nuk dinin shumë prej të vërtetave të qarta, por edhe nëse qëllimi i tyre ishte fëmija i vërtetë, atëherë:

Së pari: Krijuesi Fuqiplotë duhej të ishte trup.

Së dyti: Konstrukti përbëhet prej pjesëve dhe fëmija është pjesë e shkëputur prej babait të tij.

Së treti: Për All'llahun do të ekzistonte një i ngjashëm, sepse fëmijët gjithmonë ngjajnë me prindërit.

Së katërti: All'llahu duhet të kishte grua, por i Gjithëfuqishmi është i dëlirë e i pastër dhe tepër i lartë për të këtilla punë.

Nëse qëllimi do të ishte për fëmijë të zgjedhur, domethënë për fëmijë të adaptuar, kjo ndodh ose për të plotësuar nevojat e adaptuesit që fëmija i adaptuar ta ndihmojë adaptuesin fizikisht, ose që adaptuesi të kënaqet shpirtërisht, por All'llahu, i Fuqishmi, Mposhtësi, s'ka nevojë për të këtilla punë; veç kësaj edhe cilësimi i All'llahut të Lartësuar me emrat e bukur "Një i Vetëm" dhe "Mposhtësi", është një përgjigje e shkurtër për të gjitha hamendësimet e kësaj natyre.

Në të gjitha gjendjet, parafjala *"leu"*, e cila zakonisht përdoret për të treguar kushtin e pamundur, tregon se, të gjitha këto hamendsime janë thjesht pamundësi, qoftë hamendsimi se Krijuesi zgjedh një fëmijë për Vete, qoftë hamendsimi se All'llahu ka nevojë të ketë fëmijë. Në të vërtetë, Krijuesi i Gjithëfuqsihëm nuk ka nevojë për ato që thonë injorantët se All'llahu ka fëmijë, pasi edhe vetë krijesat e zgjedhura kanë nevojë për All'llahun.

Për të saktësuar të vërtetën se All'llahu i Lartësuar nuk ka nevojë për krijesat e Tij dhe për të shpjeguar argumentet që vërtetojnë se All'llahu është Një e i Vetëm (Teuhid), Krijuesi Fuqiplotë, në fillimin e ajetit vijues, njofton: **"Ai krijoi qiejt e Tokën me të vërtetën."**.

Fakti që këto punë janë të vërteta, është një argument që vërteton se prapa krijesave të All'llahut, ka një qëllim madhor, që konsiston në plotësimin e krijesave dhe në krye të gjitha krijesave qëndron njeriu, plotësimi i të cilit nuk merr fund as pas ringjalljes.

Pas paraqitjes së këtij krijimi të madh, ajeti i nderuar tregon anë të ndryshme të këtij rregullimi të mahnitshëm dhe të ndryshimeve që ndodhin sipas llogaritjeve të përpikta e shumë të hollësishme, por edhe sistemet sunduese të këtyre krijesave, gjithashtu janë të përpikta e shumë të hollësishme, ashtu siç njofton për këtë fraza vijuese e ajetit: **"Ai natën ia mbështjell ditës dhe ditën ia mbështjell natës** (bën që të vijnë njëra pas tjetrës)**."**.

Sa shprehje e bukur! Sikur njeriu të qëndronte në një zonë jashtë globit të Tokës dhe të shikonte lëvizjen e Tokës rreth vetes, do të shihte se nata e dita i vijnë rrotull formës së rrumbullakët të Tokës në mënyrë të sistemuar. Gjithashtu, do të shihte se errësira e natës do të sundonte në një anë të ditës dhe nga ana përballë ai do të shihte se drita e ditës sundon me lëvizje të vazhdueshme mbi errësirën e natës.

Fjala *"jukeu'uiru"*, do të thotë: Send i rrumbullakët ose send i lakuar. Gjuhëtarët e konsiderojnë çallmën mbi kokë model të rrotullimit rrethor dhe kjo shprehje e bukur kur'anore zbulon disa sekrete. Por shumica e interpretuesve të Kur'ànit, si rezultat i mosnjohjes së faktit se Toka është e rrumbullakët, kanë përmendur tema të tjera, që nuk janë në përshtatje me kuptimin që shpreh fjala *"jukeu'uiru"*. Prej këtij ajeti, për ne del fare e qartë se Toka është e rrumbullakët, se Toka rrotullohet rreth vetes dhe se, për shkak të këtij rrotullimi, Tokën gjithmonë e rrethojnë dy

shirita, njëri prej atyre dy shiritave është e zeza e natës dhe tjetri është e bardha e ditës. Veç kësaj, këto dy shirita nuk janë të qëndrueshëm, pasi, nga njëra anë shiriti i zi mbulon shiritin e bardhë, nga ana tjetër shiriti i bardhë mbulon shiritin e zi dhe kjo ndodh gjatë rrotullimit të Tokës rreth vetes.

Si do që të jetë, Kur'àni Famëlartë shpjegon qartë dukurinë e natës e të ditës (drita errësira). Këtë dukuri, Kur'àni Famëlartë e shpjegon në disa ajete dhe çdonjëri prej këtyre ajeteve tregon një pikë të caktuar. Në Kur'àn, thuhet: **"Ai** (All'llahu) **e zgjat natën në pjesë të ditës dhe e zgjat ditën në pjesë të natës"** (sure "Fàtir", ajeti 13).

Këtu biseda bëhet për depërtimin e natës në ditën dhe për depërtimin e ditës në natën dhe kuptohet që kjo dukuri plotësohet me ngadalë e me qetësi.

Herë tjetër, Kur'àni Famëlartë, në lidhje me këtë dukuri të natyrës thotë: **"Ai e mbulon ditën me natën."**.[1] Këtu ajeti e përngjason natën me perden e errët që ulet mbi dritën e ditës dhe e mbulon atë.

Në vijim, ajeti kalon në një anë tjetër të këtij rregullimi e sistemi të hollësishëm që rregullon punët e botës dhe për këtë ajeti njofton: **"Ai i nënshtroi Diellin dhe Hënën, secili lëviz deri në një afat të caktuar."**.

Në lëvizjen e Diellit nuk dallohet se Dielli rrotullohet rreth vetes, ose që Dielli lëviz së bashku me planetet e tjerë të sistemit diellor në drejtim të një pike të caktuar, në drejtim të yllësisë "Vega". Veç kësaj, kjo lëvizje e Diellit bëhet pa asnjë defekt dhe

[1] Sure "El A'ràf", ajeti 54.

sipas një sistemi të veçantë e të llogaritur deri në imtësitë më të vogla. Gjithashtu, edhe në lëvizjen e Hënës nuk ka asnjë defekt, as në lëvizjen e saj rreth Tokës e as në rrotullimin e saj rreth vetes. Të gjitha janë të nënshtruara ndaj ligjeve të Krijuesit dhe të gjitha lëvizin në përputhje me këto ligje, duke shtuar se kjo lëvizje do të vazhdojë në përputhje me këto ligje deri në ditën e fundit të afatit të caktuar për ata trupa qiellorë.

Ka edhe një mundësi tjetër interpretimi, në lidhje me frazën e ajetit **"Ai i nënshtroi Diellin e Hënën"**, domethënë: I nënshtroi ata për njeriun, ashtu siç shpjegohet në ajetin 33 të sures "Ibràhim": **"Ai për ju nënshtroi Diellin e Hënën vazhdimisht"**; por, nëse shikojmë në fjalinë e përparme dhe në fjalinë vijuese të këtij ajeti, duke shtuar se në ajetin objekt studimi mungon shprehja *"lekum"* – *"për ju"* interpretimi i lartpërmendur, në disa gjëra bëhet shumë i largët.

Fundi i këtij ajeti është një kërcënim dhe një shpresë për idhujtarët, kur njofton: **"...dëgjoni, Ai është i Gjithëfuqishmi, Mëkatfalësi."**. Ajeti flet qartë e thotë se: Fuqisë absolute të All'llahut të Lartësuar, asnjë fajtor e asnjë idhujtar nuk ka mundësi as t'i largohet dot dhe as të shpëtojë dot prej ndëshkimit të Tij. Por, meqenëse All'llahu është Falësi i madh i mëkateve, Ai i mbulon të metat e fajet e atyre që pendohen dhe kërkojnë prej Tij faljen e fajit e të gabimit; pikërisht këta të penduar, All'llahu i fut nën hijen e mëshirës së Tij.

Fjala *"Gaf'fàr"*, në gjuhën arabe është mbiemër cilësor në shkallën sipërore dhe në rrënjën e saj *"gufràn"*, do të thotë: Veshja e njeriut me një send që e ruan atë prej ndotjes dhe kur kjo fjalë përdoret në lidhje me Krijuesin Fuqiplotë, merr kuptimin e

mbulimit të fajeve e të metave të robve të Tij të penduar dhe për shkak të pendimit, Ai i ruan ata prej dënimit të Tij. Po, All'llahu është i Gjithëfuqishmi, Ai i fal shumë fajet e gabimet e robve të Vet. All'llahu edhe pse është Mposhtësi i çdo sendi, mëshira e Tij dhe falja e mëkateve prej Tij është në pikën më të lartë. Qëllimi me përmendjen e këtyre dy cilësive të larta të All'llahut të Lartësuar: "i Gjithëfuqishmi" e "Mëkatfalësi", në fundin e këtij ajeti, në të vërtetë krijon një gjendje frike dhe shprese te robtë, pasi këto dy cilësi të larta janë dy faktorë kryesorë që qëndrojnë prapa çdo lëvizjeje drejt plotësimit.

Ajetet: 6 – 7

خَلَقَكُم مِّن نَّفْسٍ وَٰحِدَةٍ ثُمَّ جَعَلَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَأَنزَلَ لَكُم مِّنَ ٱلْأَنْعَٰمِ ثَمَٰنِيَةَ أَزْوَٰجٍ ۚ يَخْلُقُكُمْ فِى بُطُونِ أُمَّهَٰتِكُمْ خَلْقًا مِّنۢ بَعْدِ خَلْقٍ فِى ظُلُمَٰتٍ ثَلَٰثٍ ۚ ذَٰلِكُمُ ٱللَّهُ رَبُّكُمْ لَهُ ٱلْمُلْكُ ۖ لَآ إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ ۖ فَأَنَّىٰ تُصْرَفُونَ ﴿٦﴾ إِن تَكْفُرُوا۟ فَإِنَّ ٱللَّهَ غَنِىٌّ عَنكُمْ ۖ وَلَا يَرْضَىٰ لِعِبَادِهِ ٱلْكُفْرَ ۖ وَإِن تَشْكُرُوا۟ يَرْضَهُ لَكُمْ ۗ وَلَا تَزِرُ وَازِرَةٌ وِزْرَ أُخْرَىٰ ۗ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّكُم مَّرْجِعُكُمْ فَيُنَبِّئُكُم بِمَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ ۚ إِنَّهُۥ عَلِيمٌۢ بِذَاتِ ٱلصُّدُورِ ﴿٧﴾

“Ai ju krijoi ju prej një njeriu, pastaj prej tij Ai krijoi palën (çiftin) **e tij; Ai për ju krijoi tetë çifte kafshësh; Ai ju krijoi ju në barqet e nënave tuaja, krijim pas krijimi, në tri errësira; ky është All’llahu, Zoti juaj; pushteti është vetëm për Atë; nuk ka zot tjetër përveç Atij, atëherë qysh i shmangeni** (adhurimit për Atë)**?”**

“Nëse ju mohoni, All’llahu s’ka nevojë për ju, megjithëkëtë, Ai nuk është i kënaqur që robtë e Tij mohojnë; nëse ju falënderoni, Ai për këtë është i kënaqur me ju; askush nuk do të mbajë barrën e mëkateve të tjetrit, pastaj ju do të ktheheni te

Zoti juaj dhe Ai do t'ju njoftojë për ato që ju keni punuar; pa dyshim vetëm Ai ka dijeni se çfarë gjendet në zemrat."

Komentimi

Të gjithë janë krijuar prej një njeriu të vetëm

Ajetet e Kur'ànit Famëlartë shpalosin edhe një herë tjetër madhështinë e krijimit të All'llahut dhe në të njëjtën kohë, njoftojnë se All'llahu i Lartësuar ka krijuar për të mirën e njeriut lloje të ndryshme kafshësh shtëpiake.

Në fillim, ajeti flet për krijimin e njeriut dhe njofton: **"Ai ju krijoi ju prej një njeriu, pastaj prej tij Ai krijoi palën** (çiftin) **e tij."**.

All'llahu i krijoi të gjithë njerëzit prej një njeriu të vetëm dhe ajeti, me frazën "njeriu të vetëm" tregon krijimin e Ademit, babait të Njerëzimit; domethënë se të gjithë njerëzit, me llojet e krijimit të tyre, me moralet e tyre, me karakteret e tyre, me përgatitjet e tyre dhe me shijet e tyre të ndryshme, origjina e të gjithëve shkon tek Ademi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Fraza: **"pastaj prej tij Ai krijoi palën** (çiftin) **e tij"**, tregon se All'llahu i Lartësuar në fillim krijoi Ademin dhe pastaj krijoi Havanë, me baltën që kishte mbetur prej krijimit të Ademit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!)*.

Mbi këtë bazë, procesi i krijimit të Havasë u plotësua pas krijimit të Ademit dhe para krijimit të bijve të Ademit.

Fjala *"thum'me"* – *"pastaj"* nuk vjen gjithmonë për të treguar kohën e pastajme, por ndodh që vjen edhe për të treguar vonesën e shpjegimit. Për shembull, thuhet: Pashë atë çka punova sot dhe pastaj pashë atë që kisha punuar dje, në një kohë që puna e djeshme kishte përfunduar para punës së sotme, por qëllimi është që të tregohet se shikimi u bë pas punës së sotme.

Disa interpretues të Kur'ànit, e kanë konsideruar ajetin e lartpërmendur me (botën e shpërndarjes) dhe krijimin e bijve të Ademit, pas krijimit të Ademit dhe para krijimit të Havasë, në formën e shpirtrave, por ky interpretin është i gabuar. Çështjen e "botës së shpërndarjes" ne e kemi shpjeguar në komentin e ajetit 172 të sures "El A'ràf".

Vlen të përmendet se gruaja e Ademit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* nuk është krijuar prej ndonjë pjese të Ademit, por, ashtu siç thuhet në transmetimet islame, në të vërtetë ajo është krijuar prej asaj që mbeti prej baltës së Ademit, kurse transmetimet që thonë se ajo u krijua prej brinjës së krahut të majtë të Ademit, është fjalë e gabuar dhe e marrë prej disa transmetimeve të stisuara, që në terminologjinë e shkencës së hadithit, quhen izraelizma. Transmetimi i sipërm është në përputhje të plotë me atë që thuhet në pjesën e dytë "Zanafilla", të Teuratit të revizionuar, por duhet shtuar se është transmetim në kundërshtim me realitetin e me logjikën. Në transmetime të këtilla, thuhet se u mor njëra brinjë e Ademit dhe prej asaj brinje u krijua Havaja, prandaj burrat kanë një brinjë më pak në anën e majtë, në një kohë që ne dimë se s'ka asnjë dallim në mes numrit

të brinjëve të gruas e të burrit. Vetëkuptohet që këto të ashtuquajtura transmetime, nuk janë më shumë se mite.

Në vijim, ajeti e kalon bisedën në çështjen e krijimit të katër llojeve kafshësh shtëpiake, të cilat i sigurojnë njeriut gjërat e domosdoshme për jetën; prej këtyre kafshëve njeriu merr lëkurën për të punuar veshjet, merr qumështin dhe mishin për t'u ushqyer. Me lëkurët e me leshin që merr prej kafshëve njeriu punon sende të domosdoshme për jetën e tij. Gjithashtu, njeriu i përdor kafshët si mjete për të udhëtuar vetë dhe për transportimin e peshave të rënda, ashtu siç njofton pjesa vijues e ajetit: **"Ai për ju krijoi tetë çifte kafshësh."**. Qëllimi me frazën (tetë çifte), është mashkulli e femra e devesë, lopës, dhënve dhe dhive, por dihet se fjala *"zeuxh"* – *"çift"* përdoret për të treguar mashkullin dhe femrën, prandaj edhe numri i çifteve është tetë (për këtë shkak në fillim të ajetit objekt studimi është përdorur fjala *"zeuxh"* – *"çift"* për të treguar Havanë).

Fraza *"enzele lekum"* – *"Ai zbriti për ju"* që flet për këto katër lloje kafshësh shtëpiake, siç kemi shpjeguar edhe më sipër - fjala *"inzàl"* nuk do të thotë vetëm zbritja e sendit prej një vendi të lartë, por në të tilla raste është në kuptimin e uljes së pozitës dhe kafshët shtëpiake, që janë prej mirësive të mëdha, u zbritën prej një pozite shumë të lartë në një pozitë shumë të ulët.

Në lidhje me fjalën *"inzàl"*, ka edhe një mundësi tjetër interpretimi, pasi kjo fjalë, në rrënjën e saja *"nezele"*, do të thotë: Mikpritja e mikut që të vjen në shtëpi, ose qerasja e parë që i serviret mikut. Në kuptimin e mikpritjes, fjala *"nezele"* ka ardhur edhe në ajetin 198 të sures "Àli Imràn", në lidhje me banorët e

Xhennetit, për të cilët i Larti njofton me fjalën e Tij: **"Ajo është mikpritje nga ana e All'llahut."**.

Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, në lidhje me katër llojet e kafshëve shtëpiake, kanë thënë: Pavarësisht se ato nuk kanë zbritur në Tokë prej ndonjë vendi më të lartë, dihet se parakushtet e bollshme për kërkesat e jetës e të rritjes së këtyre kafshëve, janë pikat e shiut dhe rrezet e diellit dhe janë pikërisht këto që zbresin në Tokë nga lart poshtë.

Për këtë frazë të ajetit, ka edhe një interpretim të katërt, që thotë se të gjitha qeniet, në fillim gjendeshin në "depozitat" e diturisë e të fuqisë së Krijuesit Fuqiplotë, domethënë gjendeshin në atë që quhet dituria e padukshme (ilmul gajb) dhe më pas, prej të padukshmes u mbartën në botën e dukshme, prandaj, për këtë shprehje, është përdorur fjala *"inzàl"*, ashtu siç thuhet për këtë në ajetin 21 të sures "El Hixhr": **"S'ka asnjë send që të mos e këtë burimin te Ne, porse Ne atë e japim vetëm me masë të caktuar."**.[1]

Gjithësesi, interpretimi i parë është më shumë në përshtatje me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit se sa interpretimet e tjera, megjithëse në mes këtyre interpretimeve s'ka asnjë kundërthënie, madje është e mundur që kuptimi i të gjitha këtyre interpretimeve të derdhet në një kuptim të vetëm.

Në një transmetim të ardhur prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë se ai, në lidhje me komentin e këtij ajeti, ka thënë: *"Zbritja e Tij, është krijimi i Tij"*,

[1] Tefsiri "El Mijzàn" dhe tefsiri "Rùhul Meànij", fundi i ajeteve objekt studimi.

domethënë: zbritja e këtyre tetë çifteve prej kafshëve do të thotë: ato janë krijuar prej All'llahut.

Duket qartë se ky transmetim mbështet interpretimin e parë, sepse vetëm i Gjithëfuqishmi është Krijuesi i të gjitha krijesave dhe vetëm për Atë është pozita më e lartë.

Megjithëse në ditët e sotme, prej këtyre kafshëve të përmendura në këtë ajet mund të përfitohet në një masë shumë të vogël në proceset e transportit dhe mbartjes së peshave të rënda, ato vazhdojnë të kenë një rëndësi shumë të madhe dhe nevoja për këto kafshë shtohet e zgjerohet nga dita në ditë; këto kafshë, sot japin pjesën më të madhe të prodhimeve ushqimore për njeriun, si qumështin e mishin, duke shtuar edhe leshin e lëkurët, që janë përdorur në të kaluarën dhe vazhdojnë të përdoren në industrinë e veshjeve e në punimin e prodhimeve të tjera për të cilat ka nevojë njeriu, madje, mbarështrimi i këtyre llojeve kafshësh shtëpiake, në shtetet e mëdha të botës së sotme është bërë njëri prej burimeve financiare të rëndësishme.

Në vijim, ajeti kalon një një etapë tjetër të krijesave të All'llahut, kalon në procesin e rritjes së fetusit dhe për këtë ajeti njofton: **"Ai ju krijoi ju në barqet e nënave tuaja, krijim pas krijimi, në tri errësira."**.

Është e qartë se fraza **"krijim pas krijimi"**, do të thotë krijimi i përsëritur e i vazhdueshëm dhe jo krijimi vetëm në dy etapa.

Fjala e ajetit *"jekhlukukum"* – *"Ai ju krijoi ju"* është folje e kohës së tashme -ardhshme dhe si e këtillë jep kuptimin e vazhdimësisë, kurse këtu, kjo fjalë kaq e shkurtër ka kuptime të

thella, që tregojnë ndryshimet e mahnitshme dhe format e ndryshme që merr fetusi gjatë etapave të ndryshme të ekzistencës së tij në barkun e nënës dhe sipas fjalës që thonë shkencëtarët e fushës së embriologjisë, procesi i krijimit e i zhvillimit të fetusit në barkun e nënës, konsiderohet prej krijimeve më të mahnitshme e më të imta të Krijuesit Fuqiplotë, prandaj rrallë herë vërejmë që gjuhët e studiuesve të këtyre çështjeve të mos lakojnë fjalë falënderimi e lavdërimi për Krijuesin e Lartësuar.

Shprehja *"dhulmàtin thelàthin" – "tri errësira"* tregon errësirën e barkut të nënës, errësirën e mitrës dhe errësirën e cipës (placentës) që mbështjell fetusin. Në fakt, këto janë tri mbulesa të trasha që e mbështjellin fetusin.

Në ditët e sotme, fotografët kanë nevojë për dritë të fuqishme që të fotografojnë, kurse Krijuesi Fuqiplotë e planifikon dhe e konfiguron njeriun në këto errësira në mënyrën më të çuditshme e në forma të mahnitshme, që habisin mendjet. Ai e furnizon fetusin me shkaqet që mundësojnë jetesën në një vend ku askush s'ka mundësi të çojë aty furnizim për fetusin, në një kohë që ushqimi për fetusin, në këtë etapë të ekzistencës së tij, është domosdoshmëri që ai të rritet e të zhvillohet.

Imam Hyseni *(Paqja qoftë mbi të!)*, zotëria i dëshmorëve, në njërën prej lutjeve të tij të njohura, me emrin "lutja e Arefes", lutje që konsiderohet kurs studimor i lartë e i plotë në fushën e Njëtimit të All'llahut (Teuhidit), kur përmend mirësitë e mëdha që i ka dhënë All'llahu i Lartësuar, thotë: *"Ti më krijove mua prej një spermatozoidi që lëshohet, pastaj më vendose në tri errësira në mesin e mishit, lëkurës e gjakut, Ti nuk bëre që unë të shoh krijimin tim, Ti*

nuk bëre që ndonjë punë të jetë në dorën time dhe më pas Ti më nxore në këtë botë njeri të plotë.".[1]

Shtojmë se ne kemi trokitur mbi punët e mahnitshme të krijimit të fetusit dhe etapave të zhvillimit të tij edhe në fundin e ajetit 6 të sures "Àli Imràn", si dhe në fundin e ajetit 5 të sures "El Haxhxh".

Dhe në fundin e ajetit objekt studimi, pas përmendjes së tri kurseve të veçanta që tregojnë Njëtimin e All'llahut në lidhje me krijimin e njeriut, kafshëve shtëpiake dhe etapat e zhvillimit e të rritjes së fetusit, Krijuesi Fuqiplotë njofton: **"Ky është All'llahu, Zoti juaj; pushteti është vetëm për Atë; nuk ka zot tjetër përveç Atij, atëherë qysh i shmangeni** (adhurimit për Atë)**?"**.

Herë-herë, njeriu arrin të shohë këto shenja të mëdha që tregojnë Njëtimin e All'llahut në fushën e krijimit, madje arrin të jetë edhe dëshmitar i realizimit të këtyre punëve. Në vijim, i Gjithëfuqishmi bën shenjë për Qenien e Tij të shenjtëruar dhe thotë: **"Ky është All'llahu, Zoti juaj."**. Pa dyshim, nëse do të kishte një sy që vështron në thellësi të punëve, kjo do t'i mundësonte atij të shikonte edhe përtej këtyre shenjave. Syri, si organ i trupit, sheh shenjat dhe gjurmët, kurse syri i zemrës sheh Krijuesin e shenjave e të gjurmëve.

Dy shprehjet *"rab'bukum"* – **"Zoti juaj"** dhe *"lehul mulku"* – **"pushteti është vetëm për Atë"** në të vërtetë argumentojnë se qenia Zot, Sundues e Rregullues, reduktohet vetëm në Qenien e Pastër të shenjtëruar të All'llahut, i Cili këtë të vërtetë e bën fare të qartë dhe në mënyrën më të bukur, në frazën *"là ilàhe il'là hu ue"* –

[1] "Lutja e Arefatit", marrë prej librit "Misbàhu Zàii" i autorit Ibni Tàùs.

"nuk ka zot tjetër përveç Atij" dhe me qenë se vetëm Ai është Krijuesi, Sunduesi, Gjykuesi e Rregulluesi i gjithë botës së ekzistencës, atëherë çfarë roli kanë të tjerët, përveç Atij, në këtë botë, që të meritojnë të adhurohen?!

Këtu ajeti i flet me zë të lartë grupit të të shkujdesurve dhe atyre që janë në gjumë, duke u thënë: **"atëherë qysh i shmangeni** (adhurimit për Atë)**?"**; domethënë: qysh shkuat në rrugën e humbjes dhe u shmangët nga rruga e Njëtimit të All'llahut, nga rruga se vetëm All'llahu është Zoti Një e i Vetëm?![1]

Pas përmendjes së këtyre mirësive të mëdha që Krijuesi Fuqiplotë u ka dhënë robve të Tij, ajeti vijues trajton çështjen e falënderimit, mosmirënjohjes e të mohimit të mirësive dhe diskuton anë të ndryshme të kësaj çështjeje. Në fillim, ajeti njofton: **"Nëse ju mohoni, All'llahu s'ka nevojë për ju."**. Domethënë: Nëse ju tregoheni bukëshkelës, ose falënderoni, rezultatet e falënderimit ose të mosmirënjohjes do të jenë ose për të mirën tuaj ose në dëmin tuaj, sepse All'llahu s'ka nevojë për ju, as kur ju e falënderoni e as kur ju i mohoni mirësitë e Tij.

Në vijim, ajeti shton se, ngaqë All'llahu i Lartësuar nuk ka nevojë për ju dhe se Ai s'ka probleme që duhet të plotësojë me ndihmën tuaj, ky fakt nuk duhet të jetë pengesë që ju të mos e falënderoni All'llahun, por të qëndroni sa më larg mohimit, sepse detyrimi për të falënderuar, në të vërtetë është zemërgjerësi e mëshirë hyjnore, ashtu siç njofton i Larti me fjalën e Tij në vijim të ajetit: **"Megjithëkëtë, Ai nuk është i kënaqur që robtë e Tij të**

[1] Këtu tërheq vëmendjen se fjala e ajetit *"en'nà"*, herë vjen në kuptimin *"ku"* dhe herë vjen në kuptimin *"qysh, si"*.

mohojnë. Nëse ju falënderoni, Ai për këtë është i kënaqur me ju.".[1]

Pas shpalosjes së këtyre dy pikave, ajeti troket në pikën e tretë, pikë e cila e ngarkon individin me përgjegjësi në punët e tij, sepse kuptimi i çështjes së ngarkimit me detyrime nuk plotësohet pa përgjegjësinë vetiake dhe për këtë i Larti njofton: **"Askush nuk do të mbajë barrën e mëkateve të tjetrit."**.

Dhe është pikërisht kështu, ndryshe ngarkimi i njeriut me detyra nuk ka asnjë kuptim, nëse në Botën Tjetër nuk do të ketë dënim e shpërblim dhe ajeti në vijim e vë theksin mbi etapën e katërt, mbi çështjen e Ringjalljes dhe njofton: **"Pastaj ju do të ktheheni te Zoti juaj dhe Ai do t'ju njoftojë për ato që ju kini punuar."**.

Por edhe çështja e llogaridhënies dhe e dënimit, kurrë nuk mund të plotësohet nëse nuk ka informacion e dituri të plota për punët e fshehta të njeriut dhe për këtë ajeti njofton: **"Pa dyshim vetëm Ai ka dijeni se çfarë gjendet në zemra."**.

---

[1] Sipas mënyrës së njohur të leximit të Kur'ànit Famëlartë, në fjalën **"يَرْضَهُ"** *"jerdahu"*, përemri **"هُ"** *"hu"* në fund të fjalës lexohet me zanoren "u", pa e nxjerrë të plotë zanoren "u" të përemrit, sepse, në origjinë, kjo fjalë është **"يَرْضَاهُ"** *"jerdàhu"*, por *elifi* zgjatës i shtuar pas germës *"da"*, ka rënë, për shkak të rregullit të zgjedhimit të foljes dhe është bërë **"يَرْضَهُ"** *"jerdahu"*; në këtë fjalë, përemri *"hu"* i referohet falënderimit, megjithëse fjala "falënderim" në këtë shprehje nuk ka ardhur në formën e saj të qartë, por folja kushtore që është para kësaj fjale **"وَإِنْ تَشْكُرُوا"** *"ue in teshkurù"* – *"nëse ju falënderoni"* tregon qartë se përemri *"hu"* i referohet falënderimit, ashtu siç është gjendja e përemrit *"hu ue"* edhe në ajetin 8 të sures "El Màide": **"إِعْدِلُوا هُوَ أَقْرَبُ لِلتَّقْوَى"** **"Mbani drejtësi, sepse ajo është më afër devotshmërisë",** ku përemri **"هُوَ"** *"hu ue"* i referohet drejtësisë.

Ja kështu, nëpërmjet fjalive të shkurtra, shpalosen filozofia dhe veçoritë e ngarkimit të njeriut me detyrime e me përgjegjësi; gjithashtu, në këtë formë bëhet e qartë edhe çështja e dënimit dhe e shpërblimit. Ky ajet është një përgjigje e formës së prerë për ata që ndjekin rrugën e xheberijve (*medh'hebi xheberij*), rrugë që për fat të keq ka gjetur përhapje në disa grupime islame, në një kohë që ajeti i nderuar flet qartë: **"Ai nuk është i kënaqur që robtë e Tij të mohojnë."**.

Ky ajet është një argument që shpjegon shumë qartë se vullneti për të mohuar nuk u është imponuar mohuesve (ashtu siç thonë pasuesit e medh'hebit xheberij), sepse është jashtë logjikës që njeriu të bëjë një punë me të cilën ai vetë nuk është i kënaqur. Atëherë, si mund të jetë vullneti e dëshira e All'llahut e ndarë prej kënaqësisë së Tij? Fanatikët e medh'hebit xheberij shkaktojnë çudi kur mundohen të mbulojnë këtë frazë kaq të qartë nëpërmjet reduktimit të kuptimit të fjalës së ajetit objekt studimi *"el ibàd"* – *"robtë"* domethënë njerëzit, vetëm në besimtarët, ose në ata që janë të ruajtur prej mëkateve, në një kohë që kjo fjalë e ajetit të nderuar ka një kuptim të pakushtëzuar dhe në mënyrë fare të qartë, përfshin të gjithë njerëzit. Patjetër, Krijuesi Fuqiplotë nuk është i kënaqur me mohimin, qoftë edhe vetëm të njërit prej robve të Tij. Në të kundërt, Ai është i kënaqur me falënderimin e me mirënjohjen që shprehin robtë e Tij, pa përjashtuar asnjërin prej tyre.[1]

Këtu, tërheq vëmëndjen fakti se baza e ngarkimit me punë të çdo njeriu, si dhe e ngarkimit të tij me përgjegjësi për punët që

[1] Në fundin e ajetit 20 të sures "Ibràhim", kemi vënë një studim të hollësishëm në lidhje me rëndësinë e madhe të filozofisë së falënderimit dhe rreth kuptimit të vërtetë të falënderimit e të përmasave të tij.

njeriu bën, numërohet prej bazave ligjore e logjike të pranuara në të gjitha fetë qiellore.[1]

Natyrisht që, herë-herë ndodh që njeriu të jetë pjesëmarrës në fajet e në mëkatet e të tjerëve dhe kjo ndodh kur njeriu ka dijeni ose jep ndihmesën e tij, së bashku me të tjerët, për të përgatitur veprimet paraprake që mundësojnë kryrjen e fajit, ose merr pjesë në përgatitjen e bazave e të terrenit për kryerjen e një pune të ndaluar, si, për shembull, ata që stisin gjoja risi, por që në të vërtetë risitë që ata stisin janë shkarje në rrugën e humbjes dhe në këtë gjendje, faji i çdo individi që bën punë të ndaluara, natyrisht që do të bjerë mbi shkaktarin kryesor, por pa i pakësuar asgjë prej këtij faji as njeriut që e bëri këtë faj.[2]

[1] Në lidhje me këtë çështje, ka një studim në fundin e ajetit 15, të sures "El Isrà".
[2] Në lidhje me këtë çështje, ka një studim në fundin e ajetit 64 të sures "El En'àm".

Ajetet: 8 – 9

۞ وَإِذَا مَسَّ ٱلۡإِنسَٰنَ ضُرّٞ دَعَا رَبَّهُۥ مُنِيبًا إِلَيۡهِ ثُمَّ إِذَا خَوَّلَهُۥ نِعۡمَةٗ مِّنۡهُ نَسِيَ مَا كَانَ يَدۡعُوٓاْ إِلَيۡهِ مِن قَبۡلُ وَجَعَلَ لِلَّهِ أَندَادٗا لِّيُضِلَّ عَن سَبِيلِهِۦۚ قُلۡ تَمَتَّعۡ بِكُفۡرِكَ قَلِيلًاۖ إِنَّكَ مِنۡ أَصۡحَٰبِ ٱلنَّارِ ٨ أَمَّنۡ هُوَ قَٰنِتٌ ءَانَآءَ ٱلَّيۡلِ سَاجِدٗا وَقَآئِمٗا يَحۡذَرُ ٱلۡأٓخِرَةَ وَيَرۡجُواْ رَحۡمَةَ رَبِّهِۦۗ قُلۡ هَلۡ يَسۡتَوِي ٱلَّذِينَ يَعۡلَمُونَ وَٱلَّذِينَ لَا يَعۡلَمُونَۗ إِنَّمَا يَتَذَكَّرُ أُوْلُواْ ٱلۡأَلۡبَٰبِ ٩

“Kur njeriu pëson ndonjë dëm, ai i lutet Zotit të vet dhe kërkon ndihmë vetëm prej Tij dhe kur Ai e ndërron dëmin nga ana e Tij me ndonjë të mirë (i largon të keqen ose dëmin)**, ai harron që më parë i lutej Atij dhe i përshkruan All’llahut shokë, për të larguar** (njerëzit) **prej Rrugës së Tij; thuaj: kënaqu për pak kohë me mohimin tënd se ti pa dyshim je prej banorëve të zjarrit.”**

“(Vallë mohuesi e ka gjendjen më të mirë) **apo ai që e kalon natën në adhurim duke bërë sexhde e duke qëndruar më këmbë, i ruhet** (dënimit) **në Botën Tjetër dhe shpreson shumë në mëshirën e Zotit të vet? Thuaj: a janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë? Po, vetëm të mençurit marrin mësim.”**

Komentimi

A janë të barabartë dijetarët me ata që nuk dinë?

Ajetet e përparme, shpalosën fakte e argumente që vërtetojnë se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm dhe diturinë e Krijuesit Fuqiplotë dhe këtë argumentim e bëjnë nëpërmjet vënies së theksit mbi dukuritë e mëdha që shihen në horizontet e në vetë njerëzit. Kurse ajetet objekt i studimit të tanishëm, në fillim tregojnë se njeriu lind me besimin se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm (Teuhid) dhe shpjegojnë qartë se dituria që arrin njeriu me anë të mendjes e me anë të kuptimit, ose me anë të leximit në lidhje me punët e krijimit, kjo dituri që ai fiton, në të vërtetë gjendet në vetë qenien e tij, në saje të vetë natyrës së krijimit të njeriut dhe se kjo dituri e njeriut del në shesh gjatë problemeve, vështirësive e ngjarjeve që rëndojnë mbi njeriun. Por njeriu harron shumë dhe për këtë sprovohet me shkujdesje e me mendjemadhësi, sapo për atë të qetësohen e të largohen furtunat e vështirësive, ashtu siç njofton ajeti i nderuar: **"Kur njeriu pëson ndonjë dëm, ai i lutet Zotit të vet dhe kërkon ndihmë vetëm prej Tij"**, i penduar prej fajeve e prej shkujdesjes së tij.

Kur All'llahu i Lartësuar i jep njeriut mirësi, njeriu i harron problemet e sprovat që kaloi më përpara dhe për të cilat ai i ishte lutur All'llahut të Lartësuar që t'ia largonte ato, ashtu siç njofton për këtë ajeti i nderuar: **"Dhe kur Ai i jep nga ana e Tij ndonjë të**

mirë (i largon të keqen ose dëmin) **ai harron që më parë i lutej Atij.”**.[1]

Kur njeriu i bën All’llahut shok e të ngjashëm dhe i adhuron ata të ngjashmit, madje nuk mjaftohet që i adhuron ato që sajoi për All’llahun, por punon që të shmangë prej adhurimit të All’llahut edhe të tjerët, ashtu siç e lexojmë në vijimin e këtij ajeti të nderuar: **“Dhe i përshkruan All’llahut shokë, për të larguar** (njerëzit) **prej Rrugës së Tij.”**.

Këtu, qëllimi me fjalën *“el insàn”* – *“njeriu”* janë njerëzit e zakonshëm, që nuk janë edukuar me rrezatimet e dritave të mësimeve të Profetëve. Natyrisht që në këtë fjalë nuk hyjnë besimtarët, të cilët e përmendin All’llahun kur janë në gjendje të mirë dhe kur janë në gjendje të vështirë, pasi besimtarët gjithmonë kërkojnë ndihmën e bujarinë e Tij.

Qëllimi me fjalën e ajetit *“durr’rrun”,* këtu është në kuptimin e çdo sprove ose dëmi që e prek njeriun në trup ose në shpirt.

---

[1] Në mesin e interpretuesve të Kur’ànit Famëlartë, ka mendime të ndryshme në lidhje me kuptimin që jep fjala *“mà”* – **“atë që”** në frazën: **“ai e harron që më parë i lutej Atij”**. Disa kanë thënë se këtu fjala *“mà”* është lidhëse dhe tregon (dëmin) dhe fakti që është kuptimi më i drejtë, i është dhënë përparësi mbi kuptimet e tjera; disa të tjerë gjithashtu kanë thënë se fjala *“mà”* është lidhëse dhe qëllimi me këtë fjalë është All’llahu i Lartësuar; një grup tjetër kanë thënë se fjala *“mà”* në këtë frazë të ajetit është rrënjë, në kuptimin e thirrjes dhe shikimit me kujdesin e duhur në ajetin 12 të sures “Jùnus": **“Kur njeriun e godet ndonjë dëm, ai na lutet Ne i shtrirë, ulur ose më këmbë dhe kur Ne e largojmë të keqen prej tij, ai vazhdon sikur të mos na ishte lutur fare për dëmin që kishte pësuar”**, bëhet fare e qartë se ky ajet është dëshmues që vërteton saktësinë e kuptimit të parë.

Fjala *"khau'uelehù"* - në rrënjën e saj *"khauilun"*, do të thotë kontroll i vazhdueshëm për një send dhe kontrolli është orientimi i veçantë që jepet për t'u shpenzuar dhe këtu është përdorur pikërisht në kuptimin e dhënies, dhuratës.

Të tjerë kanë thënë se fjala *"khauelun"*, do të thotë shërbëtor dhe fjala e ajetit *"khau'uelehù"* do të thotë: Shërbëtori që i dhuroi zotërisë së tij. Më pas, kjo fjalë është përdorur për të treguar të gjitha llojet e dhurimit të mirësive me shumicë.[1]

Në përgjithësi, kjo fjali, përveç dhënies e dhurimit, pasqyron kujdesin e veçantë të Krijuesit Fuqiplotë për robin e Tij.

Fraza *"munijben ilejhi"* domethënë se njeriu në çdo situatë të vështirë heq dorë nga mendjemadhësia dhe shkujdesja e tij, i hedh pas shpine të gjitha ato që e pengonin që të afrohej te All'llahu dhe kthehet te Ai. Nga kuptimi që vjen prej fjalës "*el inabetu*", përftohet se parimi, qëllimi e dëshira e njeriut, është All'llahu i Lartësuar.

Fjala *"endàdun"*, që është shumës i fjalës *"nid'dun"*, do të thotë: i ngjashëm si qenie e në origjinalitet.

Fjala *"xheale"* – *"bëri"* shpjegon qartë se përfytyrimet e iluzionet e njeriut "fabrikojnë" një të ngjashëm me All'llahun e Lartësuar, punë që është e pamundur të përputhet me realitetin.

Fraza **"për të larguar** (njerëzit) **prej Rrugës së Tij"**, shpjegon qartë se mendjemëdhenjtë që shkanë në rrugën e humbjes, nuk u kënaqën me faktin që vetë ranë në rrugën e

[1] Lexo në fjalorin "Lisànul Arab"; në fjalorin "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn" dhe në tefsirin "Rùhul Meànij".

humbjes, por i vënë qëllim vetes që edhe të tjerët t'i tërheqin nëpër humnerat e rrugës së humbjes, rrugës së vënies shok e ortak All'llahut të Lartësuar.

Në të gjitha gjendjet, ajetet e Kur'ànit Famëlartë, disa herë e kanë vënë theksin mbi marrëdhënien në mes të vërtetës që njeriu lind me besimin se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm (Et Teuhijdul Fitrij) dhe ngjarjeve të vështira që i ndodhin njeriut gjatë jetës. Gjithashtu, në ajetet e Kur'ànit Famëlartë, paqyrohet trazimi i brendshëm te njeriu mendjemadh, i cili struket të gjejë strehim te All'llahu i Lartësuar dhe beson me sinqeritet vetëm në Atë kur bie në vështirësi dhe kalon gjendje të rënduara. Por, kur gjendja e tij qetësohet e përmirësohet, ai e harron All'llahun dhe kthehet në mendjemadhësinë e në kryeneçësinë e tij, e lë udhëzimin në Rrugën e Drejtë dhe rikthehet në rrugën e vënies shok All'llahut të Lartësuar.

Sa shumë shembuj ka me të këtillë individë me shumë ngjyra dhe sa pak janë individët që bëjnë kthesë e ndryshojnë kur shohin se, prej Krijuesit Fuqiplotë, i vijnë mirësi të mëdha dhe gëzojnë ndihmën e qetësinë të dhuruara prej Tij.

Dihet se, kur mbi sipërfaqen e ujit kalon edhe një fllad i lehtë, ai ujë trazohet, kurse oqeani i qetë nuk ndikohet as prej furtunave të fuqishme, prandaj edhe është quajtur "oqeani i qetë".

Fundi i ajetit objekt studimi u flet individëve të këtillë me një gjuhë të mbushur me kërcënim, me një gjuhë të vendosur e të prerë: **"Thuaj: kënaqu për pak kohë me mohimin tënd, se ti pa dyshim je prej banorëve të zjarrit."**.

Por, a mund të ketë për njeriun të ardhme më të mirë se kjo?

Ajeti vijues përdor metodën krahasuese, metodë të cilën Kur'àni Famëlartë e përdor që t'i bëjë të tjerët të kuptojnë çështje të ndryshme, kur thotë se individë të këtillë janë njerëz me merita e me vlera dhe për këtë njofton: **"**(Vallë mohuesi e ka gjendjen më të mirë) **apo ai që e kalon natën në adhurim duke bërë sexhde e duke qëndruar më këmbë, i ruhet** (dënimit) **në Botën Tjetër dhe shpreson shumë në mëshirën e Zotit të vet?"**.

Ku është ai njeriu idhujtar, njeriu që i vë shok All'llahut të Lartësuar, ku është ai njeriu i shkujdesur e me shumë ngjyra, njeriu që ka rënë në rrugën e humbjes dhe që punon të fusë edhe të tjerët në rrugën e humbjes, kundrejt njeriut me zemër të pastër e të ndërgjegjësuar, zemra e të cilit shkëlqen prej dritës, njeriut që e adhuron All'llahun Fuqiplotë duke rënë në sexhde në mesin e natës, atëherë kur të tjerët janë duke fjetur. Ky njeri i lutet Zotit të tij, i frikësuar dhe duke shpresuar?!

Njerëz të këtillë edhe kur janë në gjendje të mirë, nuk e konsiderojnë veten të siguruar prej ndëshkimit e dënimit. Por as në gjendje sprovash, këta njerëz nuk e presin shpresën prej mëshirës së All'llahut të Lartësuar, por, gjithmonë, këta dy faktorë e shoqërojnë qenien e tyre gjatë lëvizjes së vazhdueshme me mbrojtje prej të Dashurit të zemrave të tyre.

Fjala *"kànitun"*, në rrënjën e saj *"kunùt"*, do të thotë: Shoqërimi i bindjes me frikë e me nënshtrim.

Fjala *"ànàe"*, do të thotë një orë ose një pjesë e caktuar kohe.

Kjo fjalë thekson orët e natës, sepse pikërisht në këto orë të natës, zemra është më shumë e gatshme dhe në këto orë pakësohet mundësia më shumë se në orët e tjera që zemra të ndotet prej formave të hipokrizisë.

Ajeti i nderuar ka vënë në plan të parë sexhden para qëndrimit më këmbë, për faktin se sexhdja është shkalla më e lartë e adhurimit, kurse mëshira pa kushte dhe moskushtëzimi i mëshirës me Botën e Ardhshme, është një argument që vërteton gjerësinë e mëshirës hyjnore, e cila shtrihet jo vetëm në jetën e kësaj bote, por edhe në jetën e Botës së Ardhshme.

Në një transmetim të ardhur në librin "Ilelu Sheràiu" dhe në librin "El Kàfij", cituar prej Imam Bàkirit *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë se, kur ka interpretuar frazën e ajetit: **"apo ai që e kalon natën në adhurim"**, ka thënë: "*Ky është namazi i vullnetshëm i falur natën.*".[1]

Është e qartë se ky interpretim, si shumë interpretime të tjera të bëra për ajete të ndryshme të Kur'ànit Famëlartë, në të vërtetë tregon vendet ku vërtetohet më qartë kuptimi i ajetit, megjithëkëtë, kuptimi i ajetit nuk mund të reduktohet vetëm në namazin e natës.

Plotësimi i ajetit i flet të Dërguarit më të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* me frazën: **"Thuaj: a janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë?"**.

Patjetër që ata nuk janë të barabartë, por: **"Po, vetëm të mençurit marrin mësim."**.

---

[1] "Ilelu Sheràiu" dhe "Usùlul Kàfij", cituar prej tefsirit "Nùruth Thekalejni", vëll. 4, f. 479.

Pa dyshim, pyetja e bërë në frazën e përparme është pyetje përgjithësuese dhe si e këtillë, krahasimi në këtë pyetje bëhet në mes atyre që dinë dhe atyre që nuk dinë, domethënë: Mes dijetarëve dhe injorantëve, sepse, para kësaj pyetjeje, këtu është shtruar edhe pyetja tjetër krahasuese: A janë të barabartë idhujtarët me besimtarët, të cilët e gjallërojnë natën me adhurim, kurse pyetja e dytë e thekson edhe më shumë çështjen se a e dinë ata se idhujtarët kokëngjeshur nuk janë të barabartë me besimtarët e pastër, a mund të jenë të barabartë me besimtarët ata që nuk e dinë këtë të vërtetë?

Fakti që kjo frazë e ajetit fillon me një pyetje mohuese, shpjegon njërën prej formulave bazë të Islamit, shpjegon lartësinë dhe pozitën e diturisë e të dijetarëve kundrejt injorancës e injorantëve, për më shumë, kjo mosbarazi është përmendur në mënyrë të pakushtëzuar, prandaj është e natyrshme që, këto dy grupe, nuk janë të barabartë as te Krijuesi Fuqiplotë e as te njerëzit me logjikë. Të dy grupet nuk mund të qëndrojnë në të njëjtën radhë, as në këtë botë e as në Botën Tjetër, sepse ata janë krejtësisht të ndryshëm, nga jashtë e nga brenda.

Hulumtim

Këto dy ajete, në brendinë e tyre kanë mençuri dhe pika shumë të rëndësishme

1- Në ajetin e parë u përmend filozofia e ngjarjeve të hidhura e të vështira, u zbuluan perdet e mendjemadhësisë e të shkujdesjes prej zemrave dhe u trajtua shndërrimi i dritës së besimit në një pishtar ndriçues. Gjithashtu, u trajtua edhe çështja e kthimit te All'llahu Fuqiplotë. Në të njëjtën kohë, ajeti u jep përgjigje atyre që mendojnë e besojnë se ndodhitë e vështira në jetë, janë një mangësi në çështjen e sistemit të krijimit dhe në drejtësinë e Krijuesit Fuqiplotë.

2- Ajeti i dytë i këtij grupi ajetesh, fillon me thirrjen për punë e për ndërtimin e njeriut dhe përfundon me diturinë e me njohjen, sepse ai që nuk lëviz në nivelin e ndërtimit të vetes së tij, në zemrën e atij njeriu nuk rrezatojnë dritat e diturisë dhe si rregull bazë, nuk është e mundur ndarja e diturisë prej ndërtimit të vetes.

3- Fraza e ajetit: **"ai që e kalon natën në adhurim"**, fjala *"kànitun"* në këtë frazë, sipas rregullave të sintaksës së gjuhës arabe, këtu ka ardhur në formën e emrit veprues, kurse fjala *"el lejl"* – *"natë"* ka ardhur e pakushtëzuar, prandaj, në kuptimin e saj tregon vazhdimin e adhurimit e të nënshtrimit të atyre njerëzve ndaj All'llahut të Lartësuar dhe thekson se puna jo e vazhdueshme është shumë e dobët.

4- Puna në emergjencë e lindur prej sprovave, e lidh njeriun me Krijuesin e tij, por kjo lidhje nuk mund të jetë kriter për të vërtetuar nëse lidhja nuk vazhdon edhe pas qetësimit të stuhisë së sprovave që kaluan mbi atë njeri. Në këtë kuptim, ajetet objekt studimi e bëjnë njeriun të zgjohet prej gjumit të shkujdesjes kur njeriu kalon gjendje të vështira, por ai rikthehet në shkujdesjen e tij të mëparshme, sapo furtunat që ranë mbi atë të kalojnë dhe ai përsëri i bashkëngjitet grupit të injorantëve. Ndërsa dijetarë të vërtetë janë vetëm njerëzit të cilët, pavarësisht nga gjendjet nëpër të cilat kalojnë, i drejtohen me lutje për ndihmë vetëm All'llahut të Lartësuar.

5- Tërheq vëmendjen fakti se, fundi i ajetit të fundit thotë: Dallimin në mes injorantit dhe dijetarit nuk e kupton askush, përveç atyre që janë të mençur, sepse injoranti nuk e kupton vlerën e diturisë. Në të vërtetë, çdo etapë prej etapave të diturisë, është një parathënie për etapën pasardhëse.

6- Në këtë ajet dhe në ajetet e tjera, fjala "dituri" nuk do të thotë njohja e një grumbull termash, ose njohja e lidhjes materiale në mes sendeve. Jo, qëllimi me fjalën "dituri" është njohja e veçantë që i bën thirrje njeriut të jetë i bindur ndaj Krijuesit Fuqiplotë, të ketë frikë prej gjykatës së Tij dhe të mos e presë shpresën prej mëshirës së Tij. Ja, kjo është e verteta e diturisë. Kur dituritë e kësaj bote çojnë aty ku thamë, ato gjithashtu janë dituri, ndryshe ato bëhen shkak për shkujdesje, padrejtësi, mendjemadhësi dhe për të mbjellë shkatërrime e ngatërresa në Tokë. gjithashtu, me të këtilla dituri nuk arrihet gjë tjetër përveç "thashethemeve", sepse me të këtilla dituri nuk arrihet të arsyetohet "si e qysh".

7- Në kundërshtim të plotë me atë që besojnë injorantët, të cilët e konsiderojnë fenë opium, gjëja më e rëndësishme në thirrjen e Profetëve është kërkimi i diturisë. Profetët e kanë deklaruar hapur armiqësinë e tyre ndaj injorancës, kudo që ajo të shfaqet e kudo që të gjendet. Këtu duhet shtuar se Kur'àni Famëlartë ka shfrytëzuar raste të shumta, që të bëjë sa më të qartë çështjen e diturisë së mirëfilltë. Gjithashtu, edhe hadithet e Profetit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* si dhe transmetimet e ndryshme islame, flasin qartë se nuk ka send më të mirë e më të vlefshëm se dituria.

Në një hadith të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë se ai ka thënë: *"Nuk mund të ketë të mirë, nëse ajo nuk vjen prej dy burrave: prej një dijetari të bindur ndaj All'llahut, ose prej një dëgjuesi të ndërgjegjshëm."*.[1]

Edhe në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: *"Dijetarët janë trashëgimtarët e Profetëve, në një kohë që Profetët nuk kanë lënë trashëgimi as para argjendi e as para floriri, por ata kanë lënë trashëgim fjalët e tyre dhe kush merr diçka prej fjalëve të tyre, ai ka marrë një pjesë trashëgimie shumë të madhe, prandaj shiheni punën tuaj, prej kujt e merrni diturinë; ndër ne të Ehli Bejtit, në çdo gjë që vjen më pas, ka një të drejtë i cili refuzon shmangien e mendjemëdhenjve dhe mëtimin e të gabuarve dhe nuk pranon interpretimin e injorantëve."*.[2]

[1] "Usùlul Kàfij", vëll. 1, kapitulli: "cilësia dhe mirësia e diturisë".
[2] Burimi i sipërm.

Ajetet: 10 - 16

قُلۡ يَٰعِبَادِ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ ٱتَّقُواْ رَبَّكُمۡۚ لِلَّذِينَ أَحۡسَنُواْ فِي هَٰذِهِ ٱلدُّنۡيَا
حَسَنَةٞۗ وَأَرۡضُ ٱللَّهِ وَٰسِعَةٌۗ إِنَّمَا يُوَفَّى ٱلصَّٰبِرُونَ أَجۡرَهُم بِغَيۡرِ حِسَابٖ ١٠
قُلۡ إِنِّيٓ أُمِرۡتُ أَنۡ أَعۡبُدَ ٱللَّهَ مُخۡلِصٗا لَّهُ ٱلدِّينَ ١١ وَأُمِرۡتُ لِأَنۡ أَكُونَ أَوَّلَ
ٱلۡمُسۡلِمِينَ ١٢ قُلۡ إِنِّيٓ أَخَافُ إِنۡ عَصَيۡتُ رَبِّي عَذَابَ يَوۡمٍ عَظِيمٖ ١٣ قُلِ
ٱللَّهَ أَعۡبُدُ مُخۡلِصٗا لَّهُۥ دِينِي ١٤ فَٱعۡبُدُواْ مَا شِئۡتُم مِّن دُونِهِۦۗ قُلۡ إِنَّ
ٱلۡخَٰسِرِينَ ٱلَّذِينَ خَسِرُوٓاْ أَنفُسَهُمۡ وَأَهۡلِيهِمۡ يَوۡمَ ٱلۡقِيَٰمَةِۗ أَلَا ذَٰلِكَ هُوَ
ٱلۡخُسۡرَانُ ٱلۡمُبِينُ ١٥ لَهُم مِّن فَوۡقِهِمۡ ظُلَلٞ مِّنَ ٱلنَّارِ وَمِن تَحۡتِهِمۡ ظُلَلٞۚ
ذَٰلِكَ يُخَوِّفُ ٱللَّهُ بِهِۦ عِبَادَهُۥۚ يَٰعِبَادِ فَٱتَّقُونِ ١٦

"Thuaj: O ju robtë e Mi që keni besuar, kijeni frikë Zotin tuaj; për ata që bënë punë të mira në këtë botë, ka të mirë dhe toka e All'llahut është shumë e gjerë, pa dyshim që të durueshmëve u jepet shpërblimi pa masë."

“Thuaj: Unë jam urdhëruar të adhuroj vetëm All’llahun dhe të jem i sinqertë në adhurimin ndaj Tij.”

“Dhe jam urdhëruar të jem myslimani i parë.”

“Thuaj: unë kam frikë dënimin e një Dite të madhe, nëse kundërshtoj Zotin tim.”

“Thuaj: Adhuroj vetëm All’llahun dhe adhurimin tim të sinqertë e bëj vetëm për Atë.”

“Dhe ju adhuroni cilin të dëshironi përveç Atij. Thuaj: Të humbur Ditën e Kiametit janë ata që e kanë humbur veten dhe familjen e vet; bëni kujdes, kjo është humbja e mirëfilltë .”

“Sipër tyre do të ketë vrunduj zjarri; edhe poshtë tyre do të ketë shtroje zjarri; me këtë i frikëson All’llahu robtë e Vet: O robtë e Mi, kijeni frikë dënimin Tim.”

Komentimi

Linjat kryesore të prograneve të robve të sinqertë

Në plotësim të asaj që u tha në studimet e ajeteve të përparme, në të cilat, siç e pamë, bëhej krahasimi në mes idhujtarëve mendjemëdhenj dhe në mes besimtarëve të bindur ndaj All’llahut, si dhe krahasimi në mes dijetarëve e në mes injorantëve, në këtë grup ajetesh trajtohen linjat kryesore të

programeve e robve të sinqertë të All'llahut dhe kjo realizohet nëpërmjet shtatë programeve, që kanë ardhur në disa ajete, madje, disa ajete fillojnë me urdhërin *"kul"* – *"thuaj"*.

Ajeti i parë i flet Profetit të Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* për frikën ndaj All'llahut dhe ajeti njofton: **"Thuaj: O ju robtë e Mi që kini besuar, kijeni frikë Zotin tuaj."**.[1]

Po, frika ndaj All'llahut, ky është muri që u pret rrugën e mëkateve dhe e bën njeriun të ndjejë përgjegjësinë e detyrimeve që ka ndaj Krijuesit të Lartësuar. Ky është *programi i parë* për robtë e All'llahut besimtarë të sinqertë. Frika ndaj All'llahut është mburoja që e ruan njeriun prej dënimit në zjarr, është faktori kryesor që nuk e lë njeriun të shmanget nga Rruga e Drejtë. Frika ndaj All'llahut është furnizimi më i madh për besimtarin që do të ekspozojë në "tregun" e Ditës së Kiametit. Frika ndaj All'llahut është peshorja e personalitetit dhe dinjitetit të njeriut te Krijuesi Fuqiplotë.

Programi i dytë është i veçantë për njeriun dhe për punën e mirë në këtë botë, sepse kjo botë është vendi ku punohet. Ajeti i nxit njerëzit të bëjnë punë të mira e bamirësi dhe kjo nxitje realizohet nëpërmjet shpjegimit të rezultateve të kësaj pune, ashtu siç njofton vijimi i ajetit të nderuar: **"...për ata që bënë punë të mira në këtë botë, ka të mirë."**.[2]

---

[1] Kuptohet që shprehja *"jà ibàdi"* – **"O robtë e Mi"** është fjalë e drejtuar prej All'llahut të Lartësuar edhe pse bashkëbiseduesi është i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe qëllimi këtu është: komunikoju atyre fjalën Time.

[2] Shumica e interpretuesve të Kur'ànit, kanë thënë se fraza **"në këtë jetë"** i referohet fjalës fjalës *"ahsenù"* – **"bënë punë të mira"** dhe bazuar mbi këtë

Po, e mira në këtë botë, qoftë kjo e mirë fjalë ose punë, ose dhënie e një mendimi, ose kujtimi i ndonjë diçkaje të të afërmit, mikut e shokut, ose edhe e një të panjohuri, kjo e mirë çon në arritjen e një shpërblimi shumë të madh në këtë botë dhe në Botën Tjetër, sepse shpërblimi për të mirën është vetëm me mirësi.

Realisht, frika ndaj All'llahut është faktor që spraps bërjen e punës së keqe, kurse e mira është element përmirësues. Të dyja përfshihen në nocionin e "heqjes dorë prej fajeve" (terkudh dhenb) dhe "kryerjes së punëve të urdhëruara dhe e punëve të lavdërueshme" (edàul feràidi uel mustehab'bàt).

Programi i tretë, bën thirrje për t'u larguar prej vendeve idhujtare e mohuese, prej vendeve të ndotura me ndyrësinë e fajeve e mëkateve dhe për këtë, All'llahu Fuqiplotë njofton me fjalën e Tij: **"…dhe toka e All'llahut është shumë e gjerë."**.

Ky ajet, në të vëretë është një përgjigje ndaj njerëzve me vullnet të dobët, që paraqisnin lloje të ndryshme justifikimesh kur thoshin: ishim të pafuqishëm për të kryer dispozitat e All'llahut, sepse ne ishim në tokën e Mekës, tokë që ishte nën sundimin e idhujtarëve. Por Kur'àni Famëlartë u përgjigjet atyre se toka e All'llahut nuk është vetëm Meka. Nëse ju nuk kishit mundësi të plotësonit detyrimet tuaja fetare në Mekë, Medineja nuk është larg, madje e gjithë Toka është e All'llahut të Gjithëfuqishëm. Prandaj, braktisni vendet e ndotura me ndyrësinë e idhujtarisë, mohimit e padrejtësisë, Sepse në një tokë të këtillë ju e keni të

---

shpjegim, rezulton që fjala *"hasenetun"* – **"të mirë"** si fjalë e pakushtëzuar, përfshin çdo të mirë në këtë botë e në Botën Tjetër, gjithnjë duke pasur parasysh se, sipas rregullave të sintaksës së gjuhës arabe, përdorimi i dyzanorëshit *"un"* në vende të këtilla, bëhet për t'i dhënë fjalës karakter krenarie e madhështie dhe shpjegon sa i madh është shpërblimi i të mirës.

pamundur të plotësoni në liri detyrimet tuaja ndaj All'llahut të Lartësuar.

Çështja e emigrimit është njëra prej çështjeve që ka luajtur rol themelor në fillimet e Islamit, kur, në saje të emigrimit, u arrit të triumfojë qeveria islame. Emigrimi ka një rëndësi shumë të madhe në të gjitha kohërat, sepse emigrimi, nga njëra anë shpëton një grup besimtarësh që të mos i dorëzohen presionit të mjedisit që i rrethon, nga ana tjetër emigrimi është një faktor ndihmues për të përhapur Islamin në pika të ndryshme të Botës.

Kur'àni Famëlartë, në ajetin 97 të sures "En Nisà" njofton: **"Kur engjëjt u marrin shpirtin atyre që ishin mizorë të vetvetes, u thonë: si e kishit punën? Ata thonë: Ishim të pafuqishëm në Tokë dhe engjëjt u thonë atyre: a nuk ishte e gjerë Toka e All'llahut dhe ju të emigronit në të; vendi i të këtillëve është Xhehennemi dhe ah sa vend i keq është ai!"**.

Këtu shpjegohet qartë se, besimtari që jeton në një vend nën presionin e shtypjes për shkak të besimit në All'llahun e Lartësuar, ai duhet të përfitojë nga mundësia dhe të emigrojë, për të ruajtur fenë e All'llahut, ndryshe ai nuk mund të justifikohet para All'llahut të Lartësuar.

Në lidhje me rëndësinë e madhe që ka emigrimi në Islam dhe në lidhje me përmasat e emigrimit, kemi vënë studime të hollësishme në komentin e ajetit 100 të sures "En Nisà" dhe në komentin e ajetitn 72 të sures "El Enfàl".

Natyrisht që emigrimi shoqërohet me probleme të shumta, që prekin anë të ndryshme të jetës, prandaj *programi i katërt* ka lidhje me durimin dhe qëndrimin e drejtë, ashtu siç thotë i Larti

në fjalën e Tij: **"...pa dyshim që të durueshmëve u jepet shpërblimi pa masë."**.[1]

Fjala e ajetit *"juvef'fâ"*, në rrënjën e saj *"vefâ"*, do të thotë: dhënia e të drejtës së plotë, kurse fraza *"bi gajri hisàb"* shpjegon se të durueshmit do të kenë te All'llahu i Lartësuar shpërblimin më të mirë e më të madh, madje nuk gjendet ndonjë punë tjetër që shpërblimi për atë punë të arrijë masën e shpërblimit që ka durimi dhe qëndrimi i drejtë.

Dëshmues për këtë shpërblim, është hadithi i dëgjuar i përcjellë prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!)*, në të cilin lexojmë se i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Kur të shpërndahet libri i punëve dhe kur të vendosen peshoret, për të sprovuarit as nuk do të vihet peshore e as nuk do t'u jepet libri i punëve."* dhe pastaj lexoi ajetin: **"...pa dyshim që të durueshmëve u jepet shpërblimi pa masë."**.[2]

Disa kanë thënë se ky ajet është i veçantë për emigrimin e parë të myslimanëve, për emigrimin që bënë një grup i madh myslimanësh në Abisini, nën kryesinë e Xhafer bin Ebù Tàlibit *(Paqja qoftë mbi të!)*. Por, siç kemi thënë shpesh herë, shkaqet e zbritjes së ajeteve shpjegojnë qartë kuptimin e ajetit dhe kuptimi i ajetit nuk mund të kufizohet vetëm në një ngjarje.

---

[1] Fraza e ajetit *"bi gajri hisàb"* – *"pa masë"* mund të ketë lidhje me fjalën *"juvef'fâ"* – *"shpërblim"* ose kjo fjalë është plotësor gjendjeje për fjalën *"exhrehum"* – *"shpërblimi i tyre"* por mundësia e parë është më e drejtë.

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 8, f. 492, fundi i ajeteve objekt studimi. I njëjti kuptim, me fare pak ndryshim, ka ardhur edhe në tefsirin e Kurtubij'jit, cituar prej Imam Hysejnit *(Paqja qoftë mbi të!)*, prej gjyshit të tij, të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*.

Në *programin e pestë,* vjen urdhëri për besimin e sinqertë se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm dhe se në këtë besim s'ka asgjë prej ferrave e gjembave të idhujtarisë. Në këtë ajet, gjuha e përdorur është pak më ndryshe, pasi në këtë ajet, fjala vihet në gojën e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*, i cili flet për detyrat dhe për përgjegjësitë e tij dhe ajeti e urdhëron atë: **"Thuaj: Unë jam urdhëruar të adhuroj vetëm All'llahun dhe të jem i sinqertë në adhurimin ndaj Tij."**.

Pastaj shton: **"Dhe jam urdhëruar të jem myslimani i parë."**. Ky është *programi i gjashtë,* në të cilin Profeti më i nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* pohon se ai është myslimani i parë ndër të gjithë njerëzit, është njeriu i parë i dorëzuar me bindje të plotë ndaj urdhërave të Krijuesit Fuqiplotë.

Kurse në *programin e shtatë* e të fundit, trajtohet çështja e frikës prej dënimit të Krijuesit Fuqiplotë Ditën e Kiametit dhe për këtë, i Larti e urdhëron Profetin e Tij të thotë: **"Thuaj: unë kam frikë dënimin e një Dite të madhe, nëse kundërshtoj Zotin tim."**.

Nëse shikojmë me kujdes në këto ajete, për ne bëhet e qartë se, i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* është vetëm një rob prej robve të All'llahut; ajeti e bën të qartë se edhe ai është i urdhëruar të adhurojë All'llahun me sinqeritet, sepse edhe ai e ka frikë dënimin e All'llahut. Gjithashtu, ajeti njofton se ai është i ngarkuar me detyrimin për bindje ndaj urdhërave hyjnore dhe se detyrimet e tij janë shumë

më të rënda e shumë më të mëdha se detyrimet e njerëzve të tjerë, prandaj patjetër ai është më i mirë e më i lartë se të tjerët.

I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* kurrë nuk ka mëtuar se është Zoti, ai kurrë s'ka hedhur asnjë hap jashtë rrugës së robërisë ndaj All'llahut, në të kundërt, ai krenohet e mburret me pozitën e robërisë ndaj All'llahut të Lartësuar dhe për këtë shkak ai është modeli e shembulli më i mirë që duhet ndjekur. Asnjëherë nuk e ka ndarë veten e tij prej të tjerëve dhe ky fakt është një argument që vërteton madhështinë e drejtësinë e tij. Ai nuk është si mëtuesit gënjeshtarë, të cilët u bënin thirrje njerëzve t'i adhuronin ata dhe që e konsideronin veten njeriu më i lartë ndër të gjithë njerëzit dhe se ata ishin gatuar prej një brumi shumë më të çmueshëm e shumë më të mirë se brumi me të cilin u gatuan njerëzit e tjerë. Madje, ata gënjeshtarë, disa herë u bënin thirrje pasuesve të tyre që çdo vit të jepnin kontributet e tyre në para floriri ose argjendi, sipas mundësisë.

Kurse i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* thotë: unë nuk jam si ata sundimtarët prepotentë që kanë hipur mbi qafat e njerëzve dhe që i ngarkojnë njerëzit me disa detyrime, kurse veten e tyre e konsiderojnë se janë sipër detyrimeve të caktuara prej tyre. Në të vërtetë, ky fakt njofton për një temë edukative shumë të rëndësishme: Çdo njeri, qoftë njeri i zakonshëm ose udhëheqës, ka detyrim të jetë i pari në zbatimin e detyrimeve që rëndojnë mbi atë sipas programit të tij. Patjetër ai duhet të jetë i pari që beson në legjislacionin me të cilin ai ka ardhur dhe i pari që beson në rrugën që ai kumton. Patjetër ai duhet të besojë në këtë legjislacion e në këtë rrugë, më shumë se ata që punojnë shumë,

pasi vetëm kështu do të besojnë njerëzit në drejtësinë e fjalës së tij dhe do ta marrin atë si modelin e shembullin më të mirë, që duhet ta ndjekin në të gjitha punët e tyre. Këtu bëhet e qartë se i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* nuk ishte myslimani i parë nga ana e kohës, por ai ishte myslimani i parë nga të gjitha anët: Nga ana e besimit, sinqeritetit, punës, sakrificës, luftës në Rrugën e All'llahut, në zbatimin e detyrave dhe në qëndrueshmërinë ndaj të gjitha problemeve. Historia e jetës së të Dërguarit të Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* e përforcon këtë të vërtetë në mënyrën më të mirë.

Në ajetet e mësipërme u plotësua paraqitja e shtatë programeve, që ishin: frika ndaj All'llahut, puna e mirë, emigrimi, durimi, sinqeriteti, dorëzimi dhe frika.

Për faktin që çështja e sinqeritetit në adhurim ka veçoritë e saj kundrejt shkaqeve të ndryshme të vënies shok All'llahut në adhurim, ajetet vijuese trokasin edhe një herë mbi çështjen e adhurimit të sinqertë kushtuar vetëm për All'llahun e Lartësuar dhe ajeti vijues, me të njëjtën gjuhë si në ajetet e përparme, urdhëron përsëri Profetin e Tij: **"Thuaj: adhuroj vetëm All'llahun dhe adhurimin tim të sinqertë e bëj vetëm për All'llahun."**.[1]

[1] Vënia e emrit të All'llahut në radhë të parë, sipas rregullave të sintaksës së gjuhës arabe, në këtë ajet është kundrinor për fjalën *"a'budu"* – *"unë adhuroj"* dhe njofton se adhurimi bëhet vetëm për All'llahun, kurse fraza e ajetit **"adhurimin tim të sinqertë e bëj vetëm për All'llahun"**, gjithnjë sipas rregullave të gjuhës arabe, këtu është plotësor gjendjeje, prandaj përforcon kuptimin se adhurimi bëhet vetëm për All'llahun e Lartësuar.

Kurse ju adhuroni çka të doni përveç All'llahut dhe ajeti vijues në fjalinë e tij të parë njofton: **"Dhe ju adhuroni cilin të dëshironi përveç Atij."**.

Në fjalinë vijuese, ajeti e urdhëron të Dërguarin e All'llahut të thotë: **"Të humbur Ditën e Kiametit janë ata që e kanë humbur veten dhe familjen e vet."**; për shkak se ata nuk i shfrytëzuan fuqitë dhe jetët e tyre, nuk njoftuan as familjet e as fëmijët e vet që t'i shpëtonin, për më tepër ata nuk u kthyen të penduar të kërkojnë ndihmën e mbrojtjen e All'llahut të Lartësuar dhe në fjalinë e fundit, ajeti njofton: **"Bëni kujdes, kjo është humbja e mirëfilltë."**.

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve tona objekt studimi, përshkruan njërën prej formave të humbjes së mirëfilltë, kur thotë: **"Sipër tyre do të ketë vrunduj zjarri; edhe poshtë tyre do të ketë shtroje zjarri."**.

Në këtë fjali, ajeti njofton se ata janë të rrethuar prej flakëve të zjarrit dhe a mund të ketë për ata gjendje më të rëndë se kjo? A mund të ketë këtu për ata ndëshkim më të ashpër se ky?

Fjala *"dhulelun"*, është shumësi i fjalës *"dhul'letun"* dhe do të thotë: Mbulesa që shtrihet nga ana e sipërme dhe sipas këtij kuptimi, kjo fjalë është përdorur për të treguar edhe shtrojen prej zjarri për banorët e Xhehennemit. Gjithashtu, fjala *"dhulelun"* tregon gjerësinë e kuptimit të kësaj fjale.

Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, kanë thënë se banorët e zjarrit rrotullohen në mesin e flakëve të zjarrit të Xhehennemit, të rrethuar prej shtresave të zjarrit sipër kokave e nga poshtë këmbëve të tyre. Një kuptim të ngjashëm e lexojmë

edhe në ajetin 55 të sures "El Ankebùt": **"Ditën kur ata i mbulon dënimi i zjarrit, sipër tyre e poshtë këmbëve të tyre dhe u thonë: shijoni punët që keni bërë."**.

Në të vërtetë, ky është një formësim edhe për gjendjen e tyre në jetën e kësaj bote, pasi injoranca, mohimi e padrejtësia, kanë rrethuar qenien e tyre nga të gjitha anët dhe në vijim ajeti shton, duke i këshilluar mohuesit:**"Me këtë i frikëson All'llahu robtë e Vet: O robtë e Mi, kijeni frikë dënimin Tim."**.

Në këtë frazë të ajetit, bie në sy fakti se fjala *"ibad"* – *"robtë"* vjen e puqur me emrin e të Gjithëfuqishmit disa herë me radhë dhe kjo mënyrë renditjeje e fjalëve shpjegon qartë kërcënimin që u bën Krijuesi robve të Tij me ndëshkimin e ashpër. Por, në të vërtetë, ky kërcënin tregon dashamirësinë e mëshirën e Krijuesit Fuqiplotë për robtë e Tij. Me këtë kërcënim, All'llahu i paralajmëron robtë e Tij të bëjnë kujdes që të mos vihen në të këtilla sprova, ndryshe i pret një e ardhme kaq e shëmtuar. Gjithashtu, nuk del nevoja të thuhet se me fjalën *"ibad"* – *"robtë"* qëllimi është vetëm për besimtarët, pasi, në të vërtetë, kjo fjalë përfshin të gjithë njerëzit dhe nga ky këndvështrim, askush nuk është i sigurtë prej ndëshkimit të All'llahut.

Hulumtime

1- E vërteta e humbjes

Ragibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", mendon se fjala e ajetit *"el khusrànu"*, do të thotë: humbja e të gjithë kapitalit, ose e një pjese të tij. Disa herë kjo fjalë përdoret për njeriun, për shembull, kur thuhet: "filani humbi", herë tjetër përdoret për të treguar punën e humbur, për shembull, kur thuhet: "pësoi humbje tregtia e tij".

Herë tjetër, fjala *"khusràn"* – *"humbje"* përdoret për të treguar humbjen e pasurisë së dukshme, siç mund të jetë malli ose autoriteti. Herë tjetër përdoret në rastin e humbjes së pasurisë morale, si humbja e shëndetit, mendjes, besimit dhe shpërblimit. Pikërisht këtë lloj humbjeje, Krijuesi Fuqiplotë e ka emërtuar me termin: *"el khusrànul mubijnu"* – *"humbja e mirëfilltë"* dhe sa herë që Krijuesi Fuqiplotë përmend në Kur'ànin Famëlartë fjalën "humbje", gjithmonë me këtë fjalë qëllimi është kuptimi i dytë, si dhe kuptimi i humbjes së pasurisë materiale të kësaj bote, apo humbjet në punët e tregtisë.[1]

Kur'àni Famëlartë e ka përngjasuar njeriun me tregtinë e të pasurve, që futen në tregjet e tregtisë botërore me kapitale shumë të mëdha dhe ku disa prej tyre marrin fitime të shumta, kurse disa të tjerë pësojnë humbje të rëndë.

Shumë ajete të Kur'ànit Famëlartë, kanë të këtilla shprehje e përngjasime për të shpjeguar qartë të vërtetën se, shpëtimi prej

[1] "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn" e Ragibit, lënda *"khasire"* – *"humbje, pakësim"*.

ndëshkimit hyjnor nuk vjen duke ndenjur ulur për të pritur njërin apo tjetrin, por rruga e vetme për të shpëtuar është që të përfitohet prej pasurisë, të derdhet mund e djersë dhe të punohet shumë në këtë tregti të madhe, sepse çdo send jepet kundrejt një çmimi dhe nuk jepet duke ndenjur pa punë e me justifikime!

Disa kanë shtruar pyetjen: Cilat janë shkaqet që humbja e idhujtarëve dhe e fajtorëve është përshkruar me termin: "humbje e mirëfilltë?

Dhe përgjigja për këtë pyetje është:

E para: Sepse ata shitën pasurinë më të vlefshme që kishin, shitën jetën, mendjen, mendësinë dhe ndjenjat njerëzore, pa asnjë kundërvlerë.

E dyta: Sikur ata të kishin shitur këtë pasuri jo me ndëshkimin e dënimin, patjetër që do të ishte diçka më e lehtë, por puna nuk qe e këtillë, sepse ata, me humbjen e kësaj pasurie të madhe, përgatitën për veten e vet një ndëshkim të dhimbshëm e shumë të rëndë.

E treta: Kjo humbje është e pamundur të kompensohet, me asnjë çmim dhe pikërisht kjo është "humbja e mirëfilltë".

2- Cili është qëllimi me frazën e ajetit *"Dhe ju adhuroni cilin të dëshironi"*

Fraza *"fa'budù mà shi'tum"* - **"Dhe ju adhuroni cilin të dëshironi"** ka ardhur në formën e një urdhëri kërcënues. Kjo metodë, në Kur'ànin Famëlartë përdoret kur te njeriu jobesimtar e fajtor nuk ndikon më asnjë këshillë dhe e fundit fjalë që mund t'i thuhet një njeriu të këtillë është: bëj si të duash. Por ama prite edhe ndëshkimin, domethënë: Ti ke arritur deri në atë shkallë, sa nuk meriton as të të jepet ndonjë këshillë, prandaj e ardhmja që të pret dhe ilaçi për ty është vetëm ndëshkimi i dhimbshëm.

Cilët janë familja

Ajetet e lartpërmendura thonë se të humburit nuk humbën vetëm veten e tyre, por humbën edhe familjet e tyre.

Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, kanë thënë se fjala e ajetit *"ehlun"* – *"familje"* janë pasuesit e njeriut dhe ata që veprojnë sipas rrugës e programit të tij.

Të tjerë interpretues, e kanë shpjeguar këtë fjalë me gratë bukuroshe të Xhennetit, të cilat i humbën idhujtarët e kriminelët.

Të tjerë kanë thënë se "familje" janë njerëzit e familjes dhe të afërmit në këtë botë.

Duke parë me kujdes kuptimin orgjinal të kësaj fjale, rezulton që kuptimi i fundit të jetë më i përshtatshëm se të gjitha kuptimet e tjera, sepse mohuesi, Ditën e Kiametit do të humbë familjen e tij, kur atë do ta ndajnë prej familjes nëse ata janë

besimtarë, por nëse edhe pjesëtarët e familjes së tij janë idhujtarë, ai jo vetëm që nuk do të ketë prej atyre ndonjë dobi, por ata do të jenë shkak për t'i shtuar ndëshkimin e dhimbshëm.

Ajetet: 17 – 20

وَٱلَّذِينَ ٱجۡتَنَبُواْ ٱلطَّٰغُوتَ أَن يَعۡبُدُوهَا وَأَنَابُوٓاْ إِلَى ٱللَّهِ لَهُمُ ٱلۡبُشۡرَىٰۚ فَبَشِّرۡ
عِبَادِ ١٧ ٱلَّذِينَ يَسۡتَمِعُونَ ٱلۡقَوۡلَ فَيَتَّبِعُونَ أَحۡسَنَهُۥٓۚ أُوْلَٰٓئِكَ ٱلَّذِينَ
هَدَىٰهُمُ ٱللَّهُۖ وَأُوْلَٰٓئِكَ هُمۡ أُوْلُواْ ٱلۡأَلۡبَٰبِ ١٨ أَفَمَنۡ حَقَّ عَلَيۡهِ كَلِمَةُ
ٱلۡعَذَابِ أَفَأَنتَ تُنقِذُ مَن فِي ٱلنَّارِ ١٩ لَٰكِنِ ٱلَّذِينَ ٱتَّقَوۡاْ رَبَّهُمۡ لَهُمۡ غُرَفٞ
مِّن فَوۡقِهَا غُرَفٞ مَّبۡنِيَّةٞ تَجۡرِي مِن تَحۡتِهَا ٱلۡأَنۡهَٰرُۖ وَعۡدَ ٱللَّهِۖ لَا يُخۡلِفُ ٱللَّهُ
ٱلۡمِيعَادَ ٢٠

“Për ata që iu larguan adhurimit të idhujve dhe u kthyen te All’llahu, ka përgëzim dhe ti përgëzoji robtë e Mi.”

“Të cilët e dëgjojnë fjalën dhe punojnë më të mirën; të këtillë janë ata që All’llahu i ka udhëzuar në Rrugën e Drejtë dhe të këtillë janë të mençurit.”

“Dhe për atë që është vërtetuar vendimi për ndëshkim, a ti do të shpëtosh atë që është në zjarr?”

“Kurse për ata që kishin frikë Zotin e tyre, do të ketë dhoma të ndërtuara njëra mbi tjetrën, nën të cilat rrjedhin lumenj; ky

është premtimi i All'llahut dhe All'llahu nuk e thyen premtimin."

Komentimi

Robtë e vërtetë të All'llahut

Në këto ajete, Kur'àni Famëlartë përdor edhe një herë metodën e krahasimit dhe bën krahasimin në mes robve të vërtetë të All'llahut dhe në mes idhujtarëve kokëngjeshur, për të cilët s'ka të ardhme tjetër, përveç zjarrit të Xhehennemit, ashtu siç njofton i Larti me fjalën e Tij: **"Për ata që iu larguan adhurimit të idhujve dhe u kthyen te All'llahu, ka përgëzim."**.

Meqenëse fjala *"el bushrà"* – *"përgëzim"* në këtë ajet ka ardhur e pakushtëzuar, përfshin të gjitha llojet e përgëzimit me mirësitë hyjnore materiale e morale. Ky përgëzim, në kuptimin e tij të gjerë, është i veçantë vetëm për ata që iu larguan adhurimit të idhujve dhe në saje të besimit të tyre e me punën e tyre të mirë, u përkushtuan në adhurimin vetëm për All'llahun e Lartësuar.

Fjala *"tàgùt"*, në rrënjën e saj *"tug'jàn"*, do të thotë: Agresion e tejkalim i kufijve, prandaj kjo fjalë përdoret për çdo agresor dhe për të treguar çdo të adhuruar tjetër përveç All'llahut,

si djalli dhe sundimtarët tiranë. (Kjo fjalë, në gjuhën arabe përdoret në numrin njëjës dhe në numrin shumës.)[1]

Shprehja **"ata që iu larguan adhurimit të idhujve"**, në kuptimin e saj më të gjerë, do të thotë: Largim prej të gjitha formave të vënies shok All'llahut (shirk), adhurimit të idhujve, dëshirave e djallit dhe largimit prej nënshtrimit e dorëzimit para sundimtarëve arrogantë e tiranë.

Ndërsa shprehja **"u kthyen te All'llahu"**, bashkon në vetvete frikën ndaj All'llahut, përkorshmërinë në jetë dhe besimin; pikërisht njerëz të këtillë meritojnë përgëzimin.

Duhet theksuar se, adhurim i idhujve nuk do të thotë përulja e adhurimi i idhujve me krye në tokë, por përfshin çdo lloj bindjeje e adhurimi ndaj idhujve, shtatore ose njeri qoftë i adhuruari, ashtu siç thuhet në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Kush i bindet një tirani, ai e ka adhuruar atë."*.[2]

Në vijim, ajeti jep përkufizimin e robve të veçantë të All'llahut dhe thotë: **"Ti përgëzoji robtë**[3] **e Mi. Të cilët e**

---

[1] Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, ndër të cilët edhe Zemahsheriu, autori i tefsirit "El Kesh'shàf", mendojnë se, në origjinë, fjala "طَاغُوت" - *"tàgùt"* është "طَغُوت" - *"tagùt"* dhe më pas, germa e fundit është vënë para germës së dytë dhe është bërë "طُوغُوت" - *"tùgùt"* dhe pas zëvendësimit të germës "و" - *"u"* me germën *elif* - "ا" - *"a"* u bë "طَاغُوت" - *"tàgùt"*. Autori i tefsirit "El Kesh'shàf", argumentet për origjinën e kësaj fjale i ka marrë prej disa burimesh. (Tefsiri "El Kesh'shàf", vëll. 4, f. 120).

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 8, f. 493, fundi i ajeteve objekt studimi.

[3] Fjala e ajetit "عِبَادِ" - *"ibàdi"* – **"robtë e Mi"** në origjinë ka qenë "عِبَادِي" - *"ibàdi"* dhe është hequr germa "ي" - *"j"*, e cila është zëvendësuar me zanoren *"i"*.

dëgjojnë fjalën dhe punojnë më të mirën; të këtillë janë ata që All'llahu i ka udhëzuar në Rrugën e Drejtë dhe të këtillë janë të mençurit.".

Këto dy ajete janë të barazvlershëm me një bazë islame. Më sipër kemi shpjeguar se ndër myslimanët ekziston liria e mendimit dhe liria e zgjedhjes në punët e ndryshme.

Në fillim, ajeti thotë **"ti përgëzoji robërit e Mi"**, pastaj kalon në përkufizimin e atyre robve të afërm te All'llahu dhe njofton se ata janë njerëz që nuk dëgjojnë një fjalë pa ditur karakteristikat e veçanta dalluese të atij që e thotë atë fjalë. Pastaj shpjegon se robtë e All'llahut zgjedhin fjalën më të mirë, në saje të fuqisë së mendjes e të kuptimit dhe se në punët e tyre s'ka asnjë lloj fanatizmi, në mendimet e në këshillat që japin s'ka as kufizim e as ngurtësi. Ata studiojnë të vërtetën dhe kanë shumë etje për të vërtetën. Ata, kudo që e gjejnë të vërtetën, e presin atë me zemër të hapur, që të shuajnë etjen në burimin e pastër të të vërtetës dhe pinë në atë burim pa asnjë ngurrim, deri sa ngopen.

Robtë e All'llahut, kur e kërkojnë të vërtetën, nuk kanë nevojë vetëm për fjalë të mira; jo, ata përzgjedhin më të mirën prej më të mirave dhe më të bukurën prej më të bukurave dhe thelbi i punës, ata aspirojnë të arrijnë më të mirën, më të lartën. Këto janë shenjat dalluese të myslimanit të vërtetë, të myslimanit besimtar, që nxiton pas të vërtetës.

Kurse, për qëllimin me shprehjen *"el kaule"* – *"fjala"* në frazën *"jestemiùne el kaule"* – **"të cilët e dëgjojnë fjalën"** interpretuesit e Kur'ànit kanë dhënë disa mendime për shpjegimin e kësaj fjale.

Disa kanë thënë se qëllimi me shprehjen *"el kaule" – "fjalën"* është Kur'àni që përmban urdhërat për bindje, për gjërat e lejuara dhe për parapëlqimin e më të mirës, domethënë përmban urdhërat për kryerjen e adhurimeve dhe për bindje ndaj Krijuesit Fuqiplotë.

Të tjerë kanë thënë se shprehja *"el kaule"*, do të thotë në përgjithësi urdhërat hyjnorë të përmendur dhe jo të përmendur në Kur'ànin Famëlartë.

Por, për këto dy interpretimet e fundit s'ka asnjë argument, megjithëse fjala *"el kaule"* përfshin çdo fjalë e çdo bisedë dhe besimtarët e përshkruar më sipër zgjedhin prej të gjitha fjalëve e bisedave atë që është më e mirë, atë që është më e bukura, me qëllim që ta praktikojnë në punët e tyre më të mirën.

Në këtë çështje, është me shumë kuptim fakti se Kur'àni Famëlartë, në ajetin objekt studimi, njerëzit që All'llahu i ka udhëzuar në Rrugën e Drejtë, i rreshton në grupin e atyre që dëgjojnë "fjalën" dhe ndjekin më të mirën e fjalëve. Gjithashtu, Kur'àni Famëlartë, në këtë ajet edhe të mençurit ia ka bashkëngjitur grupit që dëgjojnë "fjalën", por kjo tregon se edhe individët e këtij grupi janë të përfshirë në udhëzimin e dukshëm e të padukshëm të Rrugës së Drejtë. Këta njerëz, udhëzimi i dukshëm i ka përfshirë me rrugën e mendjes e të kuptuarit, kurse udhëzimi i brendshëm i ka përfshirë ata me rrugën e dritës hyjnore dhe me ndihmën e padukshme. Këta dy faktorë, janë një krenari e madhe për mendimtarët e lirë që studiojnë të vërtetën.

I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* kishte aq shumë dëshirë të udhëzonte në

rrugën e besimit idhujtarët që kishin rënë në rrugën e humbjes, ndjente shumë dhimbje nga që ata ishin shmangur dhe nuk dëgjonin me vëmendje të vërtetat. Prandaj, ajeti vijues i këtij grupi ajetesh, synon të kënaqë e të gëzojë Profetin *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe pasi i shpjegoi atij qartë të vërtetën se kjo bota jonë është bota e lirisë së zgjedhjes, por është edhe vendi ku njerëzit vihen përballë provimit, prandaj, në fundin e kësaj pune, një grup njerëzish patjetër do të hyjnë në Xhehennem, prandaj ajeti i thotë: **"Dhe për atë që është vërtetuar vendimi për ndëshkim, a ti do të shpëtosh atë që është në zjarr?"**.[1]

Një kuptim i ngjashëm me fjalinë e ajetit: **"për atë që është vërtetuar vendimi për ndëshkim"**, ka ardhur edhe në ajete të tjera të Kur'ànit Famëlartë, si, për shembull, në ajetin 85 të sures "Sàd", që flet për djajtë dhe për ata që ndjekin djajtë: **"Patjetër do të mbush Xhehennemin me ty dhe me të gjithë ata që të ndjekin ty."**.

Është e qartë se, ndëshkimi i domosdoshëm i këtij grupi nuk ka karakter imponues, sepse ata do të ndëshkohen për shkak të punëve të tyre të këqija që kanë bërë dhe për shkak se ata vazhduan të ushtrojnë padrejtësi, të bëjnë faje e të përhapin ngatërresa. Gjithashtu, ajeti bën të qartë se në thellësitë e zemrave të tyre ishte shuar besimi e mendimi, prandaj ata nuk mund të ishin asgjë më shumë se një pjesë prej Xhehennemit.

[1] Në të vërtetë, ajeti, në brendinë e tij ka një fjali të hequr dhe për këtë tregon fjalia që vjen pas kësaj dhe kuptimi i fjalisë do të ishte: (A ti do ta shpëtosh atë?) dhe vlerësimi i fjalisë, për shkak se është afër me fjalinë vijuese, do të ishte: (Dhe për atë që është vërtetuar vendimi për ndëshkim, a ti do të shpëtosh atë që është në zjarr?). Disa të tjerë kanë thënë se vlerësimi i ajetit do të ishte: (Për atë që është vërtetuar vendimi për ndëshkim, a do të shpëtojë ai prej tij?).

Këtu është e qartë se fjala e të Lartit **"A ti do të shpëtosh atë që është në zjarr?"**, tregon se ata janë prej banorëve të Xhehennemit.Prandaj, as i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!),* që është dërguar mëshirë për të gjitha botët, nuk ka mundësi t'i shpëtojë ata prej ndëshkimit, sepse vetë ata kanë prerë të gjitha rrugët e komunikimit me All'llahun e Lartësuar dhe nuk kanë lënë asnjë rrugë për shpëtimin e tyre.

Për të ngjallur gëzim në zemrën e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe për të shtuar shpresën në zemrat e besimtarëve, në fjalinë e parë të ajetit të fundit të këtij grupi, njoftohet: **"Kurse për ata që kishin frikë Zotin e tyre, do të ketë dhoma të ndërtuara njëra mbi tjetrën."**.

Kur banorët e Xhehennemit janë në mes të flakëve të zjarrit, ashtu siç njoftonte ajeti i përparshëm: **"Sipër tyre do të ketë vrunduj zjarri; edhe poshtë tyre do të ketë shtroje zjarri"**, banorët e Xhennetit janë në dhoma të ndërtuara njëra mbi tjetrën dhe në pallate të ndërtuar mbi pallate të tjerë; kopshtet me trandafila, lumenjtë e lulishtet që shihen nga sipër atyre dhomave, e shtojnë edhe më shumë kënaqësinë e gëzimin te banorët e Xhennetit.

Fjala e ajetit *"gurafun"* – *"dhoma"* është shumësi i fjalës *"gurfetun"* – *"dhomë"* por është edhe në kuptimin e marrjes së sendit me dorë, prandaj kjo fjalë thuhet për atë që e merr ujin për të pirë me dorën e tij, merr një grusht ujë. Më pas, kjo fjalë është përdorur për të treguar katet e sipërme të shtëpive të banimit.

Ajeti, gjithashtu, njofton se dhomat e banorëve të Xhennetit janë në vende të bukura dhe poshtë dhomave rrjedhin lumenj: **"nën të cilat rrjedhin lumenj"**. Sigurisht, ky është premtimi i All'llahut: **"Ky është premtimi i All'llahut dhe All'llahu nuk e thyen premtimin."**.[1]

Hulumtime

1- Logjika e lirisë së mendimit në Islam

Shumë prej drejtuesve të shkollave pozitiviste, i këshillojnë pasuesit e vet të mos lexojnë e të mos diskutojnë materialet dhe opinionet e shkollave të tjera pozitiviste, sepse ata kanë frikë se mendimet e të tjerëve do të jenë argument më i fuqishëm se argumenti i tyre i dobët, çka do të çonte në humbjen e pasuesve.

Kurse Islami, siç e pamë në ajetet e lartpërmendura, në këtë fushë ndjek politikën e dyerve të hapura. Në këndvështrimin e Islamit, studiuesit janë robtë e vërtetë të All'llahut, prandaj ata s'kanë frikë të dëgjojnë mendimet e të tjerëve. Veç kësaj, ata nuk e marrin një send pa kushte dhe nuk mirëpresin çdo gjë që e shikojnë të dyshimtë.

[1] Zamakhsheriu, në tefsirin e tij "El Kesh'shàf", thotë se shprehja e ajetit *"ua'dell'llàhi"* – *"premtimi i All'llahut"* ka ardhur si kundrinor i drejtë për përforcim, sepse shprehja *"lehum gurufun"* – *"për ata ka dhoma"* do të thotë: (All'llahu u ka premtuar atyre dhoma).

Islami i përgëzon ata që e dëgjojnë fjalën dhe marrin më të mirën e saj, sepse ata jo vetëm që nuk mjaftohen të zgjedhin më të mirën dhe të lënë të keqen, por edhe ndër të mirat, ata zgjedhin fjalën e mendimin më të mirë.

Islami qorton rëndë injorantët që zënë veshët e tyre me gishtat e duarve ose mbulojnë kokat me rrobat e veta sa herë që dëgjojnë zërin e të vërtetës, ashtu siç ka ardhur në fjalën e Nùhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kur u ankua para Krijuesit Fuqiplotë për sjelljen e popullit të tij: **"Sa herë që u bëja atyre thirrje të kërkonin prej Teje faljen e mëkateve, ata zinin veshët me gishta, mbulonin kokat me rrobat e tyre dhe vazhdonin në të tyren me një mendjemadhësi të shtuar."**.[1]

Si bazë, doktrina me logjikë të fuqishme nuk ka frikë se ç'thonë të tjerët dhe nuk ka frikë të shtrojë edhe opinionet e doktrinave të tjera, sepse ajo është më e fuqishme dhe janë të tjerat ato që duhet të kenë frikë prej asaj që është më e fuqishme.

Ky ajet u shpjegon atyre që ndjekin çdo fjalë që u thuhet pa u menduar dhe nuk ndalojnë që të shikojnë sa e vërtetë është ajo që u thuhet, ata nuk marrin mundimin as të vërtetojnë e as të studiojnë në atë që u thuhet, qoftë edhe aq pak sa ç'bëjnë bagëtia kur zgjedhin të hanë ushqimin më të mirë nëpër kullotat. Këtë kategori njerëzish, ky ajet i ka vënë jashtë radhëve të njerëzve të "mençur", të cilët All'llahu i Lartësuar i "ka udhëzuar në Rrugën e Vërtetë". Kjo kategori njerëzish të udhëzuar, kanë dy cilësi të veçanta: Nuk janë sprovuar as me dorëzimin pa asnjë kusht para çdo fjale që dëgjojnë e as me fanatizmin e verbër të injorancës për të këmbëngulur në të gabuarën.

[1] Sure "Nùh", ajeti 7.

2- Përgjigje disa pyetjeve

Nën dritën e studimit të sipërm, mund të shtrohen disa pyetje, ndër të cilat:

1- Përse Islami ndalon blerjen dhe shitjen e librave të rrugës së gabuar?

2- Përse Islami e ka ndaluar që Kur'àni t'u jepet mohuesve?

3- Si është e mundur për një njeri që ka njohuri rreth një çështjeje, që ai të dallojë e të zgjedhë fjalën, ose punën, ose sendin më të mirë dhe ky kuptim a nuk e bën të domosdoshëm shkëmbimin e mendimeve?

Përgjigja për pyetjen e parë është e qartë: Në ajetet e lartpërmendura ka fjalë prej të cilave shpresohet udhëzimi në Rrugën e Drejtë në çdo kohë, por, kur pas studimit e pas verifikimit bëhet e qartë se libri i filan autori është libër që çon në rrugën e gabuar, patjetër që ky lloj libri duhet ndaluar dhe Islami nuk mund të lejojë që njerëzit të ecin në një rrugë që është vërtetuar se është rrugë e shtrembër. Natyrisht, derisa puna nuk është vërtetuar për asnjë njeri, domethënë derisa njeriu është në gjendjen kur studion doktrina të tjera, për të pranuar fenë më të drejtë, s'ka asnjë problem që të lexojë libra të këtillë, por, pasi të vërtetohet se përmbajtja e atij libri është helmuese, bëhet detyrë që ai libër të hiqet nga qarkullimi.

Në lidhje me pyetjen e dytë, përse nuk lejohet dhënia e Kur'ànit jomyslimanit, shpjegojmë se është e ndaluar nëse jomyslimani ka qëllim të fyejë e të grisë Kur'ànin, por, kur

vërtetohet se një mohues mendon seriozisht të studiojë rreth Islamit nëpërmjet Kur'ànit, për të arritur qëllimin që i ka vënë vetes për të mësuar të vërtetën, në këtë rast dhënia e Kur'ànit një mohuesi nuk konsiderohet punë e ndaluar, madje është detyrë që atij t'i jepet Kur'àni. Është e qartë se, kur dijetarët kanë ndaluar dhënien e Ku'ànit jomyslimanit, nuk kanë pasur qëllim këtë kuptim.

Në lidhje me pyetjen e tretë, duhet pasur kujdes se, në shumë raste, një njeri s'ka mundësi të bëjë një punë prej punëve, por kur atë punë e bëjnë të tjerët, ai ka mundësi të bëjë dallimin në mes asaj që është realizuar mirë dhe asaj që nuk është realizuar mirë në atë punë.

Për shembull, një njeri s'ka njohuri në lidhje me mjeshtërinë e ndërtimit, madje ai nuk është në gjendje të vendosë mirë as dy tulla njëra mbi tjetrën, por ky njeri ka mundësi të dallojë ndërtimin e mirë e me shije, prej ndërtimit të keq e joharmonik; gjithashtu, shumë njerëz nuk janë poetë, por ata kanë mundësi të vlerësojnë poezitë e poetëve të mëdhenj dhe i dallojnë ato prej vargjeve të kota që mund të thurin disa vargëzues të rëndomtë, ashtu siç ka edhe njerëz që nuk janë sportistë, por ata kanë mundësi të jenë gjyqtarë sportivë dhe të përzgjedhin sportistin më të mirë.

3- Modele prej transmetimeve islame që theksojnë lirinë e mendimit

Në disa transmetime islame që kanë ardhur në lidhje me interpretimin e ajeteve objekt studimi, është edhe transmetimi i

ardhur prej Imamit Mùsà bin Xhafer *(Paqja qoftë mbi të!)*, i cili, duke biseduar me shokun e tij Hishàm bin El Hakem, i tha: "*O Hishàm, All'llahu Fuqiplotë i ka përgëzuar njerëzit e mençur dhe ata që e kuptojnë fjalën e të Lartit:* **"Ti përgëzoji robtë e Mi. Të cilët e dëgjojnë fjalën dhe punojnë më të mirën prej atyre."**.[1]

Në një transmetim tjetër të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, në kuadrin e interpretimit të ajetit të mësipërm, lexojmë se ai ka thënë: "*Ai është burri që dëgjon bisedën dhe e tregon atë ashtu siç e ka dëgjuar, pa shtuar e pa pakësur asgjë.*".[2]

Në "Nehxhul Belaga ", në pjesën e fjalëve të shkurtra, prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë fjalën e tij: "*Urtësia është ideali i besimtarit, prandaj merre urtësinë qoftë edhe prej hipokritëve.*".[3]

4- Shkaku i zbritjes

Interpretuesit e Kur'ànit Famëlartë kanë përmendur disa mendime në lidhje me shkakun e zbritjes së këtyre ajeteve, ndër të cilët ajetin: **"Për ata që iu larguan adhurimit të idhujve"**, si dhe të ajetit vijues dhe kanë thënë se këto ajete kanë zbritur në lidhje me tre njerëz, të cilët, në kohën e injorancës para Islamit, nuk iu dorëzuan demagogjisë së idhujtarëve të Mekës dhe thoshin: **"là ilàhe il'lell'llàh" –** "*S'ka zot tjetër përveç All'llahut*", dhe këta tre

[1] "Usùlul Kàfij", vëll. 1, "Kitàbul akl".
[2] Tefsiri "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 482.
[3] "Nehxhul Belàga", fjalët e shkurtra, fjala 80.

njerëz ishin: Selmàn Fàrisiu, Ebù Dherr El Gaf'fàriu dhe Zejd bin Amr.[1]

Në disa transmetime, ka ardhur emri Seijd bin Zejd në vend të emrit Zejd bin Amr.[2]

Në disa transmetime të tjera, thuhet se ajeti **"Dhe për atë që është vërtetuar vendimi për ndëshkim"**, ka zbritur në lidhje me Ebù Xhehlin e të ngjashmit me atë.[3]

Nuk përjashtohet mundësia që këto transmetime të tregojnë vendet ku kuptimi i atyre ajeteve vërtetohet në mënyrë të qartë dhe njerëzit e përmendur të mos jenë prej shkaqeve të zbritjes së këtyre ajeteve.

[1] Tefsiri i Kurtubij'jit dhe tefsiri "Mexhmaul Bejàn", fundi i ajeteve objekt studimi.
[2] Tefsiri "Ed Durr'rrul Menthùr", cituar prej tefsirit "El Mijzàn", vëll. 17, f. 267.
[3] Këtë fjalë e ka thënë autori i tefsirit "Rùhul Meànij", marrë prej të tjerëve.

Ajetet: 21 – 22

أَلَمۡ تَرَ أَنَّ ٱللَّهَ أَنزَلَ مِنَ ٱلسَّمَآءِ مَآءٗ فَسَلَكَهُۥ يَنَٰبِيعَ فِي ٱلۡأَرۡضِ ثُمَّ
تُخۡرِجُ بِهِۦ زَرۡعٗا مُّخۡتَلِفًا أَلۡوَٰنُهُۥ ثُمَّ يَهِيجُ فَتَرَىٰهُ مُصۡفَرّٗا ثُمَّ يَجۡعَلُهُۥ حُطَٰمًاۚ
إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَذِكۡرَىٰ لِأُوْلِي ٱلۡأَلۡبَٰبِ ٢١ أَفَمَن شَرَحَ ٱللَّهُ صَدۡرَهُۥ
لِلۡإِسۡلَٰمِ فَهُوَ عَلَىٰ نُورٖ مِّن رَّبِّهِۦۚ فَوَيۡلٞ لِّلۡقَٰسِيَةِ قُلُوبُهُم مِّن ذِكۡرِ ٱللَّهِۚ
أُوْلَٰٓئِكَ فِي ضَلَٰلٖ مُّبِينٍ ٢٢

"A nuk e sheh se All'llahu zbret prej Qiellit ujë dhe e shpërndan atë në Tokë nëpër burime; pastaj me atë bën që të mbijnë bimë me ngjyra të ndryshme, pastaj (bima) **thahet dhe ti e sheh atë të zverdhur, pastaj bën që ajo** (bima) **të rrëzohet përdhe; pa dyshim që në këtë ka argument për të mençurit."**

"Atij që All'llahu ia ka hapur zemrën të pranojë Islamin, ai është në një dritë prej Zotit të vet dhe mjerim i madh për ata zemërngurtët që nuk e përmendin All'llahun; të këtillë janë në një humbje të qartë."

Komentimi

Mbi një anije prej drite!!

Në këtë grup ajetesh, Kur'àni Famëlartë, me qëllim që të plotësojë studimet që trajtojnë çështjen e mohimit e të besimit që u trajtua në ajetet e përparme, shpalos edhe një herë argumente që vërtetojnë se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm (Teuhid) dhe ringjalljen pas vdekjes. Në ajetet objekt studimi, shpjegohet madhështia e cilësisë së Krijuesit Fuqiplotë si Rregullues i gjithë sistemit të universit. Këtë të vërtetë, ajeti e thekson me shembullin e zbritjes së ujit (shiut) prej Qiellit dhe shpjegon se me këtë ujë rriten bimët me ngjyra të ndryshme, megjithëse u ujitën me ujin pa ngjyrë. Më pas, ajeti shpjegon rritjen e bimëve derisa zhvillimi i bimës arrin fundin dhe me këtë rast ajeti ia drejton fjalën Profetit më të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* duke pasur në konsideratë se ai është shembulli që duhet të ndjekin të gjithë besimtarët, prandaj i drejtohet atij me fjalët e ajetit të parë të këtij grupi ajetesh: **"A nuk e sheh se All'llahu zbret prej Qiellit ujë dhe e shpërndan atë në tokë nëpër burime?"**.[1]

Pikat e shiut janë ato që i japin gjallëri jetës. Uji i shiut që bie, thithet prej shtresës së parë të Tokës dhe kur uji depërton në thellësi të kësaj shtrese, qëndron në një shtresë tjetër të Tokës, nëpër të cilën uji s'ka mundësi të depërtojë dhe kështu ky ujë

[1] Fjala *"jenàbii'a"* është shumësi i fjalës *"jenbù'un"* – *"burim uji"*. Lexo tefsirin "Nùruth Thakalejn: vëll. 23, f. 256 dhe tefsirin "Rùhul Bejàn", vëll. 8, f. 83.

kthehet edhe një herë mbi sipërfaqen e Tokës, në formë burimesh e pusesh.

Fjala"*selekehù"*, do të thotë: Depërtimi i ujit të shirave në brendësi të kores së Tokës. Vetë kjo fjalë tregon qartë dhe shkurt atë që thamë më sipër në lidhje me depozitimin e ujit të shiut në tokë.

Fjala *"jenàbii'a"*, është shumësi i fjalës *"jenbù'un"* – *"burim uji"* në rrënjën e saj *"nebea"*, do të thotë: shpërthimi me vrull i ujit prej brendësisë së tokës. Sikur Toka të përbëhej vetëm prej një shtrese, nuk do të kishte aftësinë për të thithur ujin që bie mbi tokë dhe për rrjedhojë, ujërat e shirave shumë shpejt do të derdheshin nëpër detrat, pa pasur mundësi të depozitoheshin në brendësi të kores së Tokës. Kuptohet që, në një gjendje të këtillë, nuk do të kishte as burime uji e as puse. Gjithashtu, sikur korja e Tokës të përbëhej prej një shtrese të vetme, me aftësi të plotë thithëse, në këtë gjendje ujërat e shirave do të futeshin në thellësi të Tokës dhe do të ishte e pamundur që uji të dilte në formë burimesh, ose të nxirrej në sipërfaqen e Tokës prej puseve. Sistemi i kores së Tokës i përbërë me dy shtresa ndryshme, njëra me mundësi për të lejuar depërtimin e ujit dhe tjetra për të mos lejuar depërtimin e ujit dhe e gjitha kjo në përputhje të plotë me llogaritje të veçanta, shpjegojnë qartë fuqinë e Krijuesit të Lartësuar.

Është fakt që, korja e Tokës, herë-herë është me shumë shtresa. Disa shtresa lejojnë depërtimin e ujit dhe disa shtresa të tjera nuk e lejojnë ujin të depërtojë. Përveç kësaj, këto shtresa janë të sistemuara njëra mbi tjetrën dhe kështu mundësojnë që, prej

këtyre shtresave të Tokës, të përfitohet gjatë procesve të shpimit të puseve sipërfaqësore, gjysmë të thella dhe të thella.

Në vijim, ajeti shton: **"pastaj me atë bën që të mbijnë bimë me ngjyra të ndryshme"**, domethënë të llojeve të ndryshme.

Lloje të ndryshme drithërash, si gruri, elbi, orizi e misri, kanë forma të ndryshme dhe ngjyra të jashtme të ndryshme: të blertë të mbyllur, të blertë të hapur, disa bimë janë me gjethe të gjera e të mëdha, disa bimë të tjera janë me gjethe të holla e të vogla.

Këtu duhet theksuar se fjala e ajetit *"zer'an"* – *"të mbjella"* thuhet për bimët me kërcell të hollë, kurse për bimët me kërcell të fortë (trung), në gjuhën arabe përdoret fjala *"shexherun"* – *"pemë"*. Në të vërtetë, fjala *"zer'an"* ka shumë kuptime dhe përfshin edhe bimët natyrore që nuk mund të përdoren për ushqim, përfshin llojet e ndryshme të luleve, bimët vajore e bimët medicinale. Ndodh që, në të njëjtën degë, madje edhe në të njëjtën lule, të shohim disa ngjyra të bukura shumë tërheqëse; këto lule kaq të bukura e madhërojnë Krijuesin Fuqiplotë me gjuhën e heshtur me të cilën janë krijuar.

Më pas, ajeti kalon në një fazë tjetër të jetës së këtyre bimëve dhe thotë: **"...pastaj** (bima) **thahet dhe ti e sheh atë të zverdhur."**.[1] Mbi atë bimë fryjnë erëra nga të gjitha anët për ta

[1] Fjala *"jehijxhu"*, në rrënjën e saj *"hejxhàn"*, nga ana gjuhësore ka dy kuptime: kuptimi i parë është tharja e bimës dhe zverdhja e saj dhe kuptimi i dytë është lëvizje e trazim; ka mundësi që të dy kuptimet të kthehen në një origjinë të vetme, sepse bimët, kur thahen, janë të gatshme të ndahen, të shpërndahen, të lëvizin dhe të trazohen.

shkulur prej vendit ku është, për shkak se i është dobësuar kërcelli dhe i Larti shpjegon: **"...pastaj bën që ajo** (bima) **të rrëzohet përdhe."**.

Po, në këtë dukuri të bimësisë, ka një kujtesë për njerëzit e mençur e për dijetarët: **"Pa dyshim që në këtë ka argument për të mençurit."**.

Kjo dukuri i kujton njeriut sistemin e hollësishëm e madhështor që ka vënë Krijuesi Fuqiplotë në botën e ekzistencës. Gjithashtu, i kujton njeriut mbarimin e jetës dhe shuarjen e pishtarit të saj. I kujton edhe çështjen e Ringjalljes e të rikthimit të të vdekurve në jetë. Megjithëse ky përngjasim ka lidhje me botën bimore, përsëri i tërheq njeriut vëmendjen dhe i thotë se e njëjta gjë, me pak ndryshime, përsëritet edhe me jetën e tij, por baza është e njëjtë: fillon me lindjen dhe në mënyrë graduale arrin në moshën e veprimtarisë e të rinisë, pastaj vjen vyshkja e pleqëria e thellë dhe në fund vjen vdekja.

Si plotësim i këtij mësimi të madh në fushën e Njëtimit të All'llahut (Teuhidit) dhe të Ringjalljes, ajetet kalojnë në krahasimin në mes besimtarëve dhe në mes mohuesve, me qëllim që të bëhet e qartë se Kur'àni Famëlartë dhe Shpallja hyjnore, janë si pikat e shiut që bien mbi tokë dhe ashtu siç është toka e gatshme të përfitojë prej pikave të shiut; gjithashtu edhe zemrat janë të gatshme të ndërtojnë vetveten me ndihmën e mëshirës e të butësisë së All'llahut të Lartësuar. Kur zemrat përfitojnë prej argumenteve të All'llahut Fuqiplotë, ashtu siç njofton fjala e të Lartit: **"Atij që All'llahu ia ka hapur zemrën të pranojë Islamin,**

ai është në një dritë prej Zotit të vet.",[1] patjetër që nuk është si zemërguri që nuk udhëzohet me dritën e Tij!

Përsa u përket atyre që i kanë zemrat të ngurta, në ata nuk ndikojnë as këshilla, as kërcënimi, as përgëzimi, as ajetet aq mbresëlënëse të Kur'ànit. Shiu i Shpalljes së All'llahut, si element i jetës, nuk rrit tek ata frutat e frikës ndaj All'llahut dhe të virtytit. Me fjalë të shkurtëra, mund të thuhet se ata janë si bimët në të cilat s'ka njomësi, s'ka gjethe, s'ka fruta, s'ka as hije.

Po, ata: **"të këtillë janë në një humbje të qartë"**.

Fjala e ajetit *"el kàsijeti"*, në rrënjën e saj *"kasvetun"*, do të thotë: *ashpërsi, fortësi* dhe *ngurtësi*, prandaj kjo fjalë përdoret për të treguar cilësinë e fortësisë për gurët e fortë; gjithashtu, kjo fjalë thuhet edhe për zemrat që nuk shfaqin asnjë shenjë përgjigjeje ndaj dritës së të vërtetës e të udhëzimit në Rrugën e Drejtë. Zemrat e ngurta nuk zbuten e nuk dorëzohen para të vërtetës e para udhëzimit në Rrugën e Drejtë, zemrat e ngurta nuk lejojnë që në ato të depërtojë drita e të vërtetës dhe e udhëzimit në Rrugën e Drejtë.

Në të gjitha gjendjet, kjo shprehje ka ardhur kundrejt shprehjes "hapje e zemrave" dhe shprehjes "gjerësi e shpirtit"; në të vërtetë, shprehjet "gjerësi" e "hapje" janë alegori që shprehin gatishmërinë për të pranuar të vërtetat. Rruga dhe shtëpia e madhe, kanë mundësi të nxënë shumë njerëz. Kështu është edhe

[1] Ky ajet, në brendësi ka një fjali të hequr, që bëhet e qartë prej fjalisë vijuese dhe në vlerësimin e përgjithshëm ajeti bëhet në kuptimin: (atij që All'llahu i ka hapur zemrën të pranojë Islamin, ai është në dritën e Zotit të vet, kurse zemërguri nuk udhëzohet me ndonjë dritë).

me zemrat e gjera e me shpirtin e hapur, ata kanë gatishmërinë të pranojnë më shumë të vërteta.

Në njërin prej transmetimeve, lexojmë se Ibni Mes'ùdi, tregon se, i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* në lidhje me interpretimin e ajetit: **"Atij që All'llahu ia ka hapur zemrën të pranojë Islamin, ai është në një dritë prej Zotit të vet."**, ka thënë: *"Kur drita hyn në zemër, ajo zemër hapet e zgjerohet."*.

Ibni Mes'ùdi vazhdon: Pastaj ne thamë: *"O i Dërguar i All'llahut, cilat janë shenjat e hapjes së zemrave?"* Ai tha: *"Kthimi në shtëpinë e përjetësisë, strehimi në shtëpinë e mashtrimit dhe gatishmëria për të vdekur para se vdekja të vijë."*.[1]

Kurse Ali Ibrahimi, në tefsirin e tij, thotë se fraza e ajetit **"Atij që All'llahu ia ka hapur zemrën të pranojë Islamin"**, ka zbritur në lidhje me Prijësin e besimtarëve Ali bin Ebù Tàlibin *(Paqja qoftë mbi të!)*. Gjithashtu, në libra të tjerë tefsiresh, thuhet se fraza e ajetit **"por mjerim i madh për ata zemërngurtët"**, ka zbritur në lidhje me Ebù Xhehlin dhe bijtë e tij.[2]

Është e qartë se shkaqet e zbritjes për të cilat flasin këto transmetime, në të vërtetë duhen parë nga ana e përputhjes së kuptimit të përgjithshëm në njerëzit përkatës.

Në frazën e ajetit **"ai është në një dritë prej Zotit të vet"**, tërheq vëmendjen fakti se drita e ndriçimi këtu janë përngjasuar me një anije, mbi të cilën kanë hipur besimtarët, anija ecën me

[1] Tefsiri i Kurtubij'jit, vëll. 8, f. 5691; në interpretimin e sures "Ez Zumer", fundi i ajeteve objekt studimi. Ky hadith është cituar me ndryshime në dy pjesë prej librit "Reudatul Uàidhijne".
[2] Tefsiri "Es Sàfij", fundi i ajeteve objekt studimi.

shpejtësi të çuditshme dhe ndjek një rrugë të qartë në të gjitha anët e Botës.

Hulumtim

Faktorët e hapjes së zemrave dhe ngurtësimit të zemrave

Njerëzit nuk janë të një tipi të vetëm, nga ana e pranimit të së vërtetës dhe e kuptimit të punëve. Disa kanë mundësi ta kuptojnë të vërtetën qoftë edhe thjesht me një shenjë të vetme, ose me një frazë të shkurtër dhe kjo do të thotë se edhe vetëm një kujtesë mjafton për t'i ndërgjegjësuar ata menjëherë, ose vetëm një këshillë ka fuqi të shkaktojë zëra në shpirtrat e tyre, në një kohë që te disa të tjerë nuk kanë ndikim as fjalët më të arritura, as argumentet më të qartë e as shprehjet më mbresëlënëse. Është e qartë se kjo çështje nuk është as punë e lehtë e as punë e thjeshtë.

Shumë ajete kur'anore e trajtojnë këtë çështje, në të cilën disa njerëz përshkruhen si njerëz me "zemra të hapura" e me "shpirtra të gjerë", kurse disa të tjerë përshkruhen si njerëz me "zemra të ngushta", ashtu siç ka ardhur në ajetin 125 të sures "El En'àm": **"Atë që All'llahu dëshiron ta udhëzojë në Rrugën e Drejtë, ia hap zemrën** (për të pranuar Islamin)**, kurse atë që dëshiron ta lërë në rrugën e humbjes, atij ia ngushton zemrën sikur të ngjitej në lartësitë…"**.

Kjo çështje bëhet shumë e qartë e në mënyrë të plotë kur studiohen gjendjet e ndryshme të njerëzve, atëherë do të vërejmë se disa i kanë zemrat të hapura e aq të gjera dhe të afta për të përvetësuar çdo sasi të vërtetash. Ndërkohë që disa të tjerë janë e kundërta, zemrat e tyre janë të ngushta, mendimet e tyre janë të kufizuara, aq sa disa herë s'kanë mundësi të përvetësojnë asnjë të vërtetë, sikur mendjet e tyre të ishin të rrethuara me mure çeliku, që nuk mund të çahen. Natyrisht që për secilin grup, ka edhe shkaqet përkatëse që i kanë çuar në këtë gjendje.

Studimi i vazhdueshëm, takimet me dijetarët, me të urtët, me njerëzit e mirë, ndërtimi i vetvetes, edukimi i shpirtit, largimi prej mëkateve, në mënyrë të veçantë largimi prej ushqimeve haram dhe përmendja e All'llahut vazhdimisht, të gjitha këto janë shkaqe dhe faktorë që ndikojnë në hapjen e zemrës. Kurse injoranca, faji, mëkati, mllefi, polemikat e kota, hipokrizia, ndenjja me njerëz të ligj, me mëkatarët, me kriminelët, me jobesimtarët, me ata që janë bërë skllevër të kësaj bote dhe skllevër të dëshirave të tyre, këta janë faktorë që çojnë në ngushtimin e kraharorit e në ngurtësimin e zemrës.

Kur Kur'àni Famëlartë thotë:

"Atij që All'llahu dëshiron ta udhëzojë në Rrugën e Drejtë, ia hap zemrën (për të pranuar Islamin), **kurse atij që dëshiron ta lërë në rrugën e humbjes, atij ia ngushton zemrën…"**, në fakt ajeti tregon mungesën e vullnetit dhe nuk është arbitrarisht pa argumente, por është dukuri e cila qysh në fillim buron prej thellësive të qenies njerëzore.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë se ai ka thënë: *"All'llahu Fuqiplotë i tha Mùsait me*

Revelatë: O Mùsà, mos u gëzo me pasurinë e shumtë dhe në të gjitha gjendjet mos hiq dorë nga përmendja Ime, sepse pasuria e shumtë bën që të harrohen mëkatet dhe lënia e përmendjes Sime ashpërson zemrat.”.[1]

Në një transmetim të ardhur prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë fjalën e tij: *“Lotët thahen vetëm prej ashpërsisë së zemrës dhe zemrat i ashpërsojnë vetëm mëkatet.”*.[2]

Në një transmetim të tretë, lexojmë fjalët që i Gjithëfuqishmi i tha Mùsàit *(Paqja e All’llahut qoftër mbi të!)*: *“O Mùsà, mos e zgjat shpresën tënde në këtë botë, ndryshe të ashpërsohet zemra dhe atij që i ashpërsohet zemra, ai është larg Meje.”*.[3]

Në një transmetim tjetër të ardhur prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *“Dy bashkudhëtarë janë prej djallit dhe dy bashkudhëtarë janë prej engjëllit. Dy bashkudhëtarët e engjëllit janë butësia dhe të kuptuarit, kurse dy shoqëruesit prej djallit janë harresa dhe ashpërsia.”*.[4]

Në të gjitha gjendjet, ai që dëshiron zgjerimin e zemrës dhe asgjësimin e ashpërsisë prej zemrës së tij, ashtu siç ka premtuar për këtë i Dërguari më i nderuar *(Paqja e bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* duhet të gërryeje faqen e jashtme të zemrës së tij prej ndryshkut të fajeve e mëkateve dhe të pastrojë shpirtin e tij prej dëshirave të veta e prej cytjeve të djallit, të ketë gatishmërinë për të pranuar të Dashurin dhe të derdhë lot nga frika prej All’llahut e prej dashurisë për Atë. Të gjitha këto, kanë

[1] “Bihàrul Enuàr”, vëll. 7, f. 23.
[2] “Usùlul Kàfij”, vëll. 2, f. 2, kapitulli: “Ashpërsia”; paragrafi 23.
[3] Burimi i sipërm; paragrafi 24.
[4] Burimi i siëprm, paragrafi 3.

një ndikim të mahnitshëm e të pashoq për zbutjen e zemrës dhe për shpirtmadhësinë. Nga ana e kundërt qëndron ngurtësimi i syrit, që është njëra prej shenjave të zemërgurësisë.

Ajetet: 23 – 26

ٱللَّهُ نَزَّلَ أَحۡسَنَ ٱلۡحَدِيثِ كِتَٰبٗا مُّتَشَٰبِهٗا مَّثَانِيَ تَقۡشَعِرُّ مِنۡهُ جُلُودُ ٱلَّذِينَ يَخۡشَوۡنَ رَبَّهُمۡ ثُمَّ تَلِينُ جُلُودُهُمۡ وَقُلُوبُهُمۡ إِلَىٰ ذِكۡرِ ٱللَّهِۚ ذَٰلِكَ هُدَى ٱللَّهِ يَهۡدِي بِهِۦ مَن يَشَآءُۚ وَمَن يُضۡلِلِ ٱللَّهُ فَمَا لَهُۥ مِنۡ هَادٍ ٢٣ أَفَمَن يَتَّقِي بِوَجۡهِهِۦ سُوٓءَ ٱلۡعَذَابِ يَوۡمَ ٱلۡقِيَٰمَةِۚ وَقِيلَ لِلظَّٰلِمِينَ ذُوقُواْ مَا كُنتُمۡ تَكۡسِبُونَ ٢٤ كَذَّبَ ٱلَّذِينَ مِن قَبۡلِهِمۡ فَأَتَىٰهُمُ ٱلۡعَذَابُ مِنۡ حَيۡثُ لَا يَشۡعُرُونَ ٢٥ فَأَذَاقَهُمُ ٱللَّهُ ٱلۡخِزۡيَ فِي ٱلۡحَيَوٰةِ ٱلدُّنۡيَاۖ وَلَعَذَابُ ٱلۡأٓخِرَةِ أَكۡبَرُۚ لَوۡ كَانُواْ يَعۡلَمُونَ ٢٦

“All’llahu zbriti fjalën më të bukur, libër me fjalë të përshtatshme të përsëritura, prej tij rrënqethen lëkurët e atyre që e kanë frikë Zotin e tyre dhe pastaj lëkurët e zemrat e tyre zbuten duke përmendur All’llahun; ky (libër) **është udhëzimi i All’llahut në Rrugën e Drejtë, me këtë All’llahu udhëzon në Rrugën e Drejtë atë që dëshiron, kurse atë që All’llahu e ka lënë në rrugën e humbjes, për atë s’ka udhëzues.”**

"A është ai që i ruhet me fytyrën e tij të keqes së ndëshkimit të Ditës së Kiametit, kur mohuesve do t'u thuhet: shijoni punët që keni bërë?"

"Përgënjeshtruan edhe ata që jetuan para atyre dhe ndëshkimi u erdhi andej kah nuk e mendonin."

"All'llahu bëri që ata të përjetojnë turpërimin në jetën e kësaj bote, por ndëshkimi i Botës Tjetër është shumë më i madh, sikur ata ta dinin!"

Shkaku i zbritjes

Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, sipas përcjelljes së Ibni Mes'ùdit, kanë cituar se një grup sahabësh ishin të shqetësuar dhe po bënin zhurmë, prandaj iu drejtuan të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe i thanë: *"Na thuaj një fjalë që të heqë këtë brengë prej shpirtrave tanë dhe këtë shqetësim prej zemrave tona."*. Atëherë zbriti ajeti i parë prej këtij grup ajetesh, në të cilin Kur'àni Famëlartë cilësohet me frazën "fjala më e bukur".[1]

[1] Shkaku i zbritjes së këtyre ajeteve me fare pak ndryshim në fjalë, ka ardhur gjatë interpretimit të ajeteve objekt studimi edhe në tefsirin, "El Kesh'shàf", vëll. 4, f. 123; në tefsirin e Kurtubij'jit; në tefsirin "Rùhul Meànij", në tefsirin "Rùhul Xhinàn" dhe në tefsire të tjerë.

Komentimi

Ajetet e përparme flisnin për robtëri e All'llahut që dëgjonin fjalën më të mirë dhe bënin më të mirën prej asaj që dëgjonin. Gjithashtu, në ajetet e përparme u trajtua edhe çështja e zemrës së hapur e të gjerë, zemrës së gatshme për të pranuar të vërtetën.

Në ajetet objekt i studimit të tanishëm, vazhdon biseda rreth kësaj çështjeje dhe kjo bëhet me qëllim që të plotësohen studimet e mëparshme rreth Njëtimit të All'llahut (All'llahu është Zoti Një e i Vetëm), Ringjalljes dhe përmenden disa argumente që vërtetojnë profetninë, ashtu siç njofton ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, në fjalinë e tij të parë: **"All'llahu zbriti fjalën më të bukur."**.

Më pas, shpalosen cilësitë e veçanta të Kur'ànit Famëlartë dhe shpjegohen cilësitë më të rëndësishme të Kur'ànit, nëpërmjet shpjegimit të tri cilësive të tij:

Cilësia e parë e tij e veçantë e Kur'ànit është: **"libër me fjalë të përshtatshme të përsëritura"**.

Qëllimi me fjalën *"muteshàbih"* këtu është fjala e përshtatshme, fjalë në të cilën s'ka kundërthënie, fjalë të ngjashme njëra me tjetrën, fjalë në të cilat s'ka kundërshtime. Çdo ajet në këtë libër është më i mirë se tjetri dhe është i ngjashëm nga ana e butësisë, bukurisë dhe thellësisë në kuptim.

Pa dyshim që shprehjet e këtij libri janë e kundërta e shprehjeve që lakon njeriu, të cilat, sado të arritura të jenë si

shprehje, kurrë nuk mund të jenë pa gabime e pa kundërshtime njëra me tjetrën, sidomos kur fusha e këtyre shprehjeve njerëzore zgjerohet dhe merr përmasa të gjera. Në këtë gjendje, vërehet se disa shprehje njerëzore janë në lartësinë më të madhe nga ana gjuhësore dhe e retorikës, disa të tjera janë të zakonshme, natyrore. Studimi i fjalëve të poetëve e të prozatorëve të mirënjohur në poezitë e në prozat e tyre, është dëshmuesi më i mirë për këtë çështje.

Kurse fjala e All'llahut të Lartësuar nuk është kështu; në fjalën e All'llahut, ne shohim një harmoni të jashtëzakonshme dhe një përshtatshmëri që nuk mund të ketë një të dytë, as në kuptim, as nga ana gjuhësore e as si retorikë dhe është kjo cilësi që i bën ajetet e Kur'ànit që të vendosin e të dëshmojnë se Kur'àni nuk është fjalë njerëzish.

Cilësia e tij e dytë e veçantë, është: "*methànije*", domethënë se fjalët e Kur'ànit përsëriten.

Fjala "*methànije*", gjithashtu thekson përsëritjen e studimeve të ndryshme në tregimet e në këshillat e Kur'ànit, por njeriu nuk lodhet prej kësaj përsëritjeje. Në të vërtetë ndodh e kundërta, njeriu e lexon Kur'ànin me kënaqësi gjithnjë e më të shtuar. Natyrisht që kjo vjen prej bazave të rrjedhshmërisë së gjuhës dhe fjalës së qartë, aq sa njeriu disa herë ka dëshirë në përsëritjen në forma të ndryshme e me mënyra të shumëllojshme. Natyrisht që kjo dëshirë shpreh qëllimin e njeriut kur atij i duhet të theksojë një punë, ose të tërheqë vëmendjen te ajo punë dhe te ndikimi që ka ajo punë. Vetëkuptohet që, nga kjo mënyrë përsëritjeje, lexuesi e dëgjuesi as nuk lodhet e as nuk mërzitet.

Veç kësaj, çështjet e përsëritura në Kur'ànin Famëlartë shpjegojnë njëra-tjetrën dhe nëpërmjet rrugës së përsëritjes, bëhen të qarta shumë prej shprehjeve të tij që njerëzit nuk i kuptojnë me lehtësi.

Disa të tjerë, përsëritjen e kuptimit të ajeteve të Kur'ànit e konsiderojnë shkak që ai mbetet gjithmonë i freskët nga që lexohet vazhdimisht.

Të tjerë e kanë konsideruar përsëritjen shenjë që tregon zbritjen e Kur'ànit në mënyrë graduale. Më sipër, kemi shpjeguar se Kur'àni Famëlartë ka zbritur i gjithi njëherësh në zemrën e të Dërguarit më të nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe kjo zbritje, siç dihet, ka ndodhur "Natën e Kadrit"; më pas Kur'àni ka zbritur në mënyrë graduale dhe kjo zbritje e tij ka vazhduar 23 vjet.

Gjithashtu, me fjalën përsëritje, qëllimi mund të jetë edhe përshtatshmëria e Kur'ànit Famëlartë në çdo kohë, si dhe zbulimi i disa punëve të panjohura për të cilat njofton Kur'àni Famëlartë.

Interpretimi i parë është më në përshtatje me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit në krahasim me interpretimet e tjera, megjithëse s'ka asnjë pengesë që këto interpretime të mblidhen së bashku, madje të gjitha mund të jenë të sakta.[1]

[1] Zamakhsheriu, në tefsirin e tij "El Kesh'shàf", shpjegon se fjala e ajetit *"methànije"* – *"përsëritet"* ka mundësi të jetë shumës i fjalës *"muthen'nà"* në masën e fjalës *"musal'là"*, që do të thotë *"i përsëritur"*, por mund të jetë edhe shumës i fjalës *"methnà"*, në masën *"mebnà"*, që do të thotë dyfishim në kuptimin e përsëritjes. Tefsiri "El Kesh'shàf", vëll. 4, f. 123.

Cilësia e tretë e veçantë e tij, është: *"teksheirr'rru minhul xhulùdu" – "prej tij rrënqethen lëkurët"*.

Kjo cilësi e veçantë e Kur'ànit, del në dukje në çështjen e ndikimit të fuqishëm e të jashtëzakonshëm që ka Kur'àni në thellësi të shpirtrave, ashtu siç njofton vetë ajeti, në fjalinë e tij të dytë:

"Prej tij rrënqethen lëkurët e atyre që e kanë frikë Zotin e tyre dhe pastaj lëkurët e zemrat e tyre zbuten duke përmendur All'llahun.".

Në të vërtetë, ky ajet është një përshkrim shumë i bukur i formësimit të ndikimit të mahnitshëm që lënë ajetet e Kur'ànit në thellësitë e zemrave. Në fillim ato ngjallin një lloj frike, frikë që është baza për ndërgjegjësim e për të filluar lëvizjen, frikë që e bën njeriun të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tij të ndryshme dhe pastaj vjen periudha e qetësisë dhe e pranimit të argumenteve të All'llahut, të shoqëruara me qetësinë e me stabilitetin.

Kjo gjendje e shkallëzuar, shpjegon qartë etapat e ndryshme të "rrugës për te All'llahu" dhe që kuptohen me lehtësi. Zemrat rrënqetheshin menjëherë sapo dëgjonin ajetet e Kur'ànit, që janë ajete që njoftojnë kërcënim e paralajmërim për t'u ruajtur kur i zbriteshin të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* por, më pas, zemrat e njerëzve qetësoheshin, sapo dëgjonin ajetet e Kur'ànit që flasin për mëshirën.

Të menduarit rreth Qenies së All'llahut të Lartësuar, rreth faktit se All'llahu është i përjetshëm dhe nuk është i kufizuar, të gjitha këto ka mundësi të lindin në njeriun një gjendje frike në

lidhje me mënyrën e njohjes së All'llahut, kurse studimi i shenjave dhe i ndikimit të argumenteve të Qenies së Shenjtëruar, që shihen në horizontet e në vetë njerëzit, të gjitha këto i japin njeriut një lloj pushimi e qetësie.[1]

Historia islame është e mbushur me dëshmi të shumta, që vërtetojnë ndikimin e mahnitshëm të Kur'ànit në zemrat e besimtarëve, madje edhe në zemrat e atyre jobesimtarëve zemrat e të cilëve kanë gatishmërinë të pranojnë besimin. Në fakt, tërheqja e ndikimi i jashtëzakonshëm i Kur'ànit, është një argument i qartë, që vërteton se Kur'àni Famëlartë ka zbritur prej Qiellit me anë të Revelatës.

Në një transmetim të përcjellë prej Esmasë, thuhet se sahabët e Profetit *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* kur dëgjonin të këndohej Kur'àn, ashtu siç i përshkruan ata All'llahu i Lartësuar, atyre u rridhnin lot prej syve e u rrënqethej lëkura.[2]

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, e ka përshkruar këtë gjendje në mënyrën më të bukur në hytbenë e tij të veçantë që flet për ata që kanë frikë All'llahun (mut'tekijn) dhe

---

[1] Në lidhje me fjalën e ajetit "*teksheirr'rru*" – "*rrënqethet*" në rrënjën e saj "*kash'arijretun*" – "*rrënqethje*"gjuhëtarët e interpretuesit e Kur'ànit Famëlartë kanë përmendur kuptime të ndryshme dhe disi të përafërta. Disa kanë thënë se kjo fjalë është në kuptimin e mbledhjes së lëkurës së trupit kur njeriu bie në gjendje frike të madhe. Disa të tjerë kanë thënë se është në kuptimin e tronditjes së fuqishme që pëson njeriu në gjendje frike; të tjerë kanë thënë se është në kuptimin e ngritjes përpjetë të qimeve të trupit në gjendje frike. Në të vërtetë, secila prej gjendjeve të përmendura, vjen si pasojë e gjendjes tjetër.

[2] Tefsiri i Kutubij'jit, vëll. 8, f. 5693. Në lidhje me ndikimin e thellë e të jashtëzakonshëm të ajeteve të Kur'ànit, kemi cituar transmetime të ndryshme në fundin e ajetit 92 të sures "Àli Imràn".

thotë: *"Gjatë natës, këmbët e tyre janë në rresht, duke lexuar ajetet e Kur'anit, që ata i këndojnë sipas rregullave të veçanta të leximit të Kur'ànit. Me Kur'ànin ata hidhërojnë shpirtrat e tyre dhe me Kur'ànin ata gjejnë ilaçin për sëmundjen e tyre. Kur ata lexojnë një ajet që flet për dashurinë ndaj All'llahut, ata shpresojnë të gjejnë mbështetje, shpirtrat e tyre hapen drejt asaj dashurie, sikur e kanë atë dashuri para syve të tyre. Kur ata lexojnë një ajet në të cilin ka frikësim, ata e dëgjojnë atë ajet me veshët e zemrave të tyre dhe u duket se në thellësi të veshëve të tyre dëgjojnë zhurmën që lëshojnë flakët e zjarrit të Xhehennemit."*.[1]

Pas përmendjes së këtyre cilësive të veçanta të Kur'ànit, All'llahu i Lartësuar, në vijim të këtij ajeti njofton: **"Ky** (libër) **është udhëzimi i All'llahut në Rrugën e Drejtë, me këtë All'llahu udhëzon në Rrugën e Drejtë atë që dëshiron."**.

Pa dyshim që Kur'àni ka zbritur për të udhëzuar në Rrugën e Drejtë të gjithë njerëzit, por prej dritës së Kur'ànit Famëlartë, përfitojnë vetëm ata që e kanë frikë All'llahun dhe që kërkojnë të drejtën e të vërtetën. Kurse ata që i kanë vënë vetes qëllim të mbyllin të gjitha dritaret e zemrave të tyre para dritës së Kur'ànit Famëlartë, si dhe ata, shpirtrat e të cilëve i sundojnë errësirat e fanatizmit, mllefi e kokëfortësia, nuk mund të përfitojnë prej dritës së Kur'ànit. Në të kundërt, ata, për shkak të kokëfortësisë e të armiqësisë së tyre, zhyten gjithnjë e më shumë në rrugën e humbjes, ashtu siç njoftohet në frazën e fundit të këtij ajeti: **"Kurse atë që All'llahu e ka lënë në rrugën e humbjes, për atë s'ka udhëzues."**.

Kjo është ajo rruga e humbjes që njeriu e shtron me duart e veta, i vë bazamentin dhe e përsos bazën e kësaj rruge të humbjes

[1] "Nehxhul Belàga", hytbeja193.

me punët e tij të këqija e me punët e tij të gabuara, prandaj, rruga e humbjes ku ai ka rënë, nuk është aspak në kundërshtim me vullnetin e njeriut e me lirinë e tij për të zgjedhur.

Ajeti vijues bën krahasimin në mes një grupi idhujtarësh kriminelë dhe në mes besimtarëve, gjendjen e të cilëve ajeti e ka shpalosur edhe më parë, por me qëllim që e vërteta të jetë sa më e qartë në këtë krahasim, ajeti njofton: **"A është ai që i ruhet me fytyrën e tij të keqes së ndëshkimit të Ditës së Kiametit?"**,[1] si ai që është i sigurtë se në atë Ditë atë kurrë nuk do ta prekë zjarri i Xhehennemit?!

Në këtë çështje, patjetër duhet pasur në qendër të vëmendjes fjala e të Lartit: **"Ai që i ruhet me fytyrën e tij të keqes së ndëshkimit të Ditës së Kiametit…"**. Dihet që fytyra është pjesa më e nderuar e trupit të njeriut, sepse në fytyrë janë dy sytë, goja e dy veshët, janë organet e shqisave më të rëndësishme të njeriut. Patjetër që specifikimi i njeriut bëhet vetëm me fytyrën e tij dhe të karakteristikave të veçanta që gjenden në fytyrë. Kur njeriu e ndjen se para tij gjendet një rrezik që do të prekë atë, ai menjëherë mbulon me duart e veta fytyrën, që të jenë si mburojë para atij rreziku.

Por gjendja e jobesimtarëve në Xhehennem në atë Ditë, i detyron ata të përdorin fytyrën e tyre si mjet mbrojtës, sepse duart e këmbët e tyre janë të lidhura me zinxhirë, ashtu siç njoftohet në ajetin 8 të sures "Jàsijn": **"Në qafat e tyre Ne kemi varur pranga, që u arrijnë deri te nofullat, prandaj ata mbesin me kokat lart.".**

[1] Në këtë frazë, ka një shprehje të hequr dhe vlerësimi i kuptimit është: "Ai që me fytyrën e tij i ruhet të keqes së ndëshkimit të Ditës së Kiametit, a është si ai që është i sigurtë se atë nuk do ta prekë zjarri?".

Disa interpretues të Kur'ànit, kanë thënë se banorët e Xhehennemt do të flaken në zjarr me fytyrë përmbysur dhe kështu fytyra e tyre do të jetë pjesa e parë e tupit që do të digjet në zjarrin e Xhehennemit, ashtu siç njoftohet në ajetin 90 të sures "En Neml": **"Dhe kush vjen me punë të këqija, ai do të hidhet në zjarr me fytyrë përmbysur."**.

Të tjerë kanë thënë se kjo frazë e ajetit është alegori, që shpreh pamundësinë e banorëve të Xhehennemit për të mbrojtur veten përballë zjarrit të Xhehennemit.

Këta tre interpretime nuk janë në kundërshtim njëri me tjetrin, madje të gjithë së bashku japin kuptimin e plotë të ajetit.

Në fundin e ajetit njoftohet: **"...kur mohuesve do t'u thuhet: shijoni punët që keni bërë."**.

Po, engjëjt e ngarkuar me zbatimin e ndëshkimit janë ata që ua bëjnë atyre të qartë këtë të vërtetë të hidhur e shumë të dhimbshme, kur u thonë banorëve të Xhehennemit: Punët tuaja do të jenë së bashku me ju dhe me ato do të ndëshkoheni. Patjetër që ky njoftim, për ata është një ndëshkim tjetër shpirtëror.

Këtu tërheq vëmendjen fakti se, në këtë frazë, atyre nuk u thuhet: "shijojeni dënimin e punëve që keni bërë", por u thuhet: **"shijoni punët që keni bërë"**. Pa dyshim që edhe kjo është një dëshmi tjetër që vërteton formësimin e punëve Ditën e Kiametit.

Ajo që është thënë deri këtu në lidhje me ndëshkimin e banorëve të Xhehennemit, është vetëm një shenjë e vogël për ndëshkimin e tyre të dhimbshëm Ditën e Kiametit, pasi ajeti vijues njofton edhe për ndëshkimin e mohuesve në jetën e kësaj

bote, prandaj askujt të mos i shkojë në mendje se do të jetojë në siguri në këtë botë, ashtu siç njofton i Larti në ajetin vijues:

"Përgënjeshtruan edhe ata që jetuan para atyre, por ndëshkimi u erdhi andej kah nuk e mendonin.".

Njeriu nuk ndjen shumë dhimbje prej goditjes që ai e parashikon, por ai ndjen dhimbje të shumta e të forta kur goditja i vjen nga ajo anë që ai nuk e parashikon. Në këtë gjendje, atij i duket sikur goditja i erdhi prej shokëve të tij më të afërm, ose atij i bashkëngjitet një ndëshkim prej punëve të kësaj bote dhe që ai e ka dashur aq shumë atë punë, si, për shembull, mundet që ndëshkimi i vjen prej ujit, që, siç dihet, është baza e jetës së njeriut, ose i vjen prej një flladi të lehtë, që në të vërtetë është burimi i veprimtarisë së tij, ose i vjen prej tokës së qetë, e cila është vendi ku ai banon në qetësi dhe ku ndihet i siguruar.

Pa dyshim që zbritja e ndëshkimit hyjnor me anë të këtyre rrugëve, është ndëshkim shumë i dhimbshëm, siç ishte ndëshkimi që goditi popullin e Nùhut, Themudit, Adit, popullin e Lùtit, Faraonin, Kàrùnin e të ngjashëm me ata. Të gjithë ata u goditën me ndëshkimin e dhimbshëm, atëherë kur asnjëri prej atyre nuk e parashikonte se do të ndëshkohej me njërën prej rrugëve të lartpërmendura.

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve objekt studimi, bën të qartë se ndëshkimi i tyre në jetën e kësaj bote nuk reduktohet vetëm në ndëshkimin trupor, por ndëshkimi i tyre përfshin edhe dënime

shpirtërore, ashtu siç njofton i Larti në fjalën e Tij: **"All'llahu bëri që ata të përjetojnë turpërimin në jetën e kësaj bote."**.[1]

Po, nëse njeriu, në jetën e kësaj bote, goditet me ndonjë pësim të rëndë dhe pastaj ai del prej asaj gjendjeje të rëndë me kokën lart, duke ruajtur freskinë e fytyrës së tij, kjo gjendje nuk është as turp e as dëshpërim për njeriun, por turpërimi e dëshpërimi i vërtetë për njeriun është kur e lë këtë botë i urryer e i poshtëruar, kur në jetën e kësaj bote ai ishte i diskreditуar dhe s'kishte fytyrë të dilte para të tjerëve, por: **"...por ndëshkimi i Botës Tjetër është shumë më i madh, sikur ata ta dinin!"**.

Fjala e ajetit *"ekberu"* – *"më i madh"* është alegori që shpreh dënimin më të fortë e më të ashpër.

Hulumtim

Në lidhje me ajetet objekt studimi, kanë ardhur transmetime që formësojnë para nesh përmasa më të gjera nga ato që kuptojmë prej fjalëve të ajetit.

Ab'basi, xhaxhai i Profetit, ka përcjellë një hadith prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* në të cilin thuhet: *"Kur lëkura e robit rrënqethet prej frikës ndaj All'llahut, prej atij bien mëkatet ashtu siç bien gjethet prej*

[1] Fjala e ajetit *"khizjun"* do të thotë: poshtërim e fyerje, gjithashtu do të thotë edhe diskreditim (Lexo fjalorin "Lisànul arab").

pemës së njomë.”.[1] Eshtë e qartë se njeriu që e ka frikë All’llahun dhe ndikohet nga kjo frikë deri në atë shkallë sa patjetër do të arrijë në gjendjen që të bëjë teube dhe të kthehet krejtësisht në rrugën e All’llahut të Lartësuar, një person i këtillë shpresohet se do të meritojë faljen e All’llahut dhe faljen e mëkateve që ka bërë.

Prej Esmasë është përcjellë se, kur është pyetur për sahabët e të Dërguarit të All’llahut *(Paqja e bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ajo tha: *“Sahabët e Profetit, kur atyre u lexohej Kur’àn, atyre - ashtu siç i ka cilësuar All’llahu i Lartësuar - u rridhnin lotë prej syve e u rrënqethej lëkura e trupit.”*.

Transmetuesi ka shtuar: Kam pyetur Esmanë: A ka ndër ne ndonjë që i mbyllen sytë ose që e humb ndërgjegjen kur dëgjon ajetet e Kur’ànit Famëlartë? Esmaja tha: *“Eùdhu bil’làhi teàlà minesh shejtàni” – “i kërkoj All’llahut të Lartësuar të më mbrojë prej djallit“*, domethënë: ato punë janë prej djallit[2].

Në të vërtetë, ky hadith është një përgjigje për ata që mblidhen në grupe dhe aty lexojnë disa ajete të Kur’ànit e disa fjalë ziqri, pastaj ngrihen e bëjnë disa lëvizje, të cilat mëtojnë se i bëjnë nga mallëngjimi e gëzimi. Gjatë lëvizjeve, ata lëshojnë disa britma dhe hiqen sikur u bie të fikët. Ka mundësi që disa prej tyre me të vërtetë mund të kalojnë në gjendje të fikti. Por, për të këtilla punë, askush nuk ka përcjellë që t’i kenë bërë sahabët e të Dërguarit të All’llahut *(Paqja e bekimi i All’llahut qofshin mbi të e mbi*

[1] Tefsiri “Mexhmaul Bejàn”, fundi i ajeteve objekt studimi. Këtë transmetim e ka përcjellë edhe Ebul Futùh Er Rràzij dhe Kurtubij’ji, me pak ndryshime në fjalë.

[2] Këtë hadith e ka sjellë El Alùsij’ji në tefsirin “Rùhul Meànij”, vëll. 23, f. 235. Gjithashtu e kanë sjellë edhe disa interpretues të Kur’ànit gjatë interpretimit të këtij ajeti.

familjen e tij!). Prandaj të këtilla punë janë thjesht prej punëve të sajuara prej sufive.

Natyrisht, njeriu në disa raste edhe mund të tronditet aq shumë sa i bie të fikët nga frika që ai ka prej Krijuesit Fuqiplotë, por kjo gjendje është krejtësisht ndryshe nga praktikat e sufive, të cilët mblidhen në grupe për të bërë ziqër (halekat e ziqrit), që u përmendën më sipër.

Ajetet: 27 – 31

وَلَقَدۡ ضَرَبۡنَا لِلنَّاسِ فِي هَٰذَا ٱلۡقُرۡءَانِ مِن كُلِّ مَثَلٖ لَّعَلَّهُمۡ يَتَذَكَّرُونَ ﴿٢٧﴾ قُرۡءَانًا عَرَبِيًّا غَيۡرَ ذِي عِوَجٖ لَّعَلَّهُمۡ يَتَّقُونَ ﴿٢٨﴾ ضَرَبَ ٱللَّهُ مَثَلٗا رَّجُلٗا فِيهِ شُرَكَآءُ مُتَشَٰكِسُونَ وَرَجُلٗا سَلَمٗا لِّرَجُلٍ هَلۡ يَسۡتَوِيَانِ مَثَلٗاۚ ٱلۡحَمۡدُ لِلَّهِۚ بَلۡ أَكۡثَرُهُمۡ لَا يَعۡلَمُونَ ﴿٢٩﴾ إِنَّكَ مَيِّتٞ وَإِنَّهُم مَّيِّتُونَ ﴿٣٠﴾ ثُمَّ إِنَّكُمۡ يَوۡمَ ٱلۡقِيَٰمَةِ عِندَ رَبِّكُمۡ تَخۡتَصِمُونَ ﴿٣١﴾

“Në këtë Kur’àn Ne u kemi sjellë njerëzve shembuj për gjithçka të nevojshme, me qëllim që ata të kujtohen.”

“Kur’àn shpjegues, në të cilin s’ka asnjë parregullsi që ata të ruhen.”

“All’llahu solli shembull një skllav, që ishte pronë e disa ortakëve që s’kishin marrëveshje në mes tyre, solli (shembull) **edhe një skllav që ishte pronë e vetëm një njeriu; a janë këta të dy të barabartë; falënderimi e lavdërimi janë vetëm për All’llahun, por shumica e tyre nuk e dine.”**

“Ti patjetër do të vdesësh; edhe ata patjetër do të vdesin.”

"Pastaj, Ditën e Kiametit, ju do të grindeni njëri me tjetrin para Zotit tuaj."

Komentimi

Kur'àni, në atë s'ka parregullsi

Ajetet objekt studimi flasin për cilësitë e veçanta të Kur'ànit Famëlartë dhe plotësojnë studimet e mëparshme në këtë fushë.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, në fjalinë e tij të parë flet për çështjen e përmbajtjes gjithëpërfshirëse të Kur'ànit dhe për këtë ajeti i nderuar njofton: **"Në këtë Kur'àn Ne u kemi sjellë njerëzve shembuj për gjithçka të nevojshme."**.

Në Kur'àn shpjegohen tregimet e frikshme rreth punëve të tiranëve e rebelëve, flitet për përfundimet e mjerueshme të mëkateve, gjithashtu flitet për këshillat, për sekretet e krijimit, flitet për dispozita e për ligje të qëndrueshme. Me fjalë të tjera, në Kur'àn, nëpërmjet shembujve është shpjeguar qartë çdo gjë e domosdoshme për udhëzimin e njeriut në Rrugën e Drejtë dhe që njerëzit të heqin dorë prej rrugës së humbjes e të futen në Rrugën e Drejtë, ashtu siç njofton ajeti në fjalinë e tij të dytë: **"...me qëllim që ata të kujtohen."**.

Duhet theksuar se, në gjuhën arabe, fjala *"el methelu"*, është në kuptimin e fjalës që formëson të vërtetën, ose që cilëson një send, ose përngjason një send me një send tjetër. Kjo fjalë përfshin

të gjitha të vërtetat e të gjitha temat e Kur'ànit dhe shpjegon se shprehjet e Kur'ànit janë gjithëpërfshirëse.

Ajeti vijues troket mbi një cilësi tjetër të Kur'ànit dhe në fjalinë e tij të parë njofton:

"Kur'àn arabisht, në të cilin s'ka asnjë parregullsi.".[1]

Në të vërtetë, në këtë frazë të ajetit, janë përmendur tri cilësi të Kur'ànit:

Cilësia e parë: Fjala *"Kur'ànen"* tregon të vërtetën se ajetet e nderuara të Kur'ànit Famëlartë do të vazhdojnë të lexohen gjithmonë, gjatë faljes së namazeve dhe jashtë kohës së faljes së namazeve, do të lexohen në vetmi dhe në prani të njerëzve të tjerë. Kur'àni Famëlartë është lexuar gjatë gjithë historisë së Islamit dhe do të vazhdojë të lexohet deri Ditën e Kiametit, me të njëjtën renditje. Ajetet e Kur'ànit gjithmonë do të mbeten dritë e udhëzimit ndriçues.

Cilësia e dytë: Është rrjedhshmëria, ëmbëlsia dhe forca tëheqëse e kësaj fjale të All'llahut që në këtë ajet është përshkruar me fjalën *"arabij'jen"*, sepse njëri prej kuptimeve të kësaj fjale është: shpjegues i qartë e fjalë e rrjedhshme dhe këtu kjo fjalë është në këtë kuptim.

[1] Në analizën sintaksore, fjala e të Lartit *"Kur'ànen arebij'jen"* në gjuhën arabe është plotësor gjendjeje për fjalën *"el Kur'àn"*, që u përmend më sipër, por, me qenë se fjala *"Kur'ànen"* këtu ka ardhur në rasën kallzore, nuk përmban karakterin cilësues, prandaj disa kanë thënë se kjo fjalë është parathënie për gjendjen e tij *"arebij'jen"*. Disa të tjerë kanë thënë se *"arebij'jen"* është në kuptimin *"që lexohet"* dhe jep kuptimin e cilësimit; të tjerë kanë thënë se kjo fjalë është folje kalimtare lavdërimi për vlerësimin e një pune.

Cilësia e tretë: Në Kur'àn s'ka parregullsi; ajetet e Kur'ànit janë në harmoni njëri me tjetrin, shprehjet e Kur'ànit janë të qarta dhe shpjegojnë njëra-tjetrën.[1]

Shumë prej gjuhëtarëve dhe autorëve të tefsireve të Kur'ànit, kanë thënë se fjala e ajetit *"iuixhind"*, do të thotë shmangie morale, kurse në rastin kur kjo fjalë lexohet *"iuexhun"*, është në kuptimin e deformimeve e shtrembërimeve që shihen me sy, prandaj është gjë e rrallë që fjala e parë të përdoret për të shprehur deformimet e shtrembërimet që shihen me sy, ashtu siç ka ardhur në ajetin 107 të sures "Tà Hà: **"Në atë nuk shihet as ultësirë e as lartësi"**, prandaj, disa interpretues të Kur'ànit, e kanë konsideruar këtë fjalë shumë përgjithësuese.[2]

Në të gjitha gjendjet, qëllimi i zbritjes së Kur'ànit me të gjitha cilësitë që u përmendën, është ajo që thuhet në fundin e këtij ajeti: **"që ata të ruhen"**.

Tërheq vëmendjen fakti se ajeti i përparshëm përfundoi me frazën: **"që ata të kujtohen"**, kurse ky ajet përfundon me frazën: **"që ata të ruhen"**, sepse ruajtja gjithmonë është parathënia për frikën ndaj All'llahut dhe frika ndaj All'llahut është fruti i pemës "kujtohen".

Në ajetin vijues, Kur'àni Famëlartë sjell një shembull, me qëllim që me anë të atij shembulli të përshkruajë të ardhmen e atij që beson se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm (muveh'hid) dhe të

[1] Fjala e ajetit *"iuexhin"* – *"parregullsi"* ka ardhur e pashquar, në kuadrin e një fjalie mohore dhe kështu jep kuptimin e mohores në përgjithësi, për shkak se në Kur'àn s'ka asnjë parregullsi, asnjë shtrembërim e asnjë shmangie.

[2] Lexo fjalorin e fjalëve të Kur'ànit "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn" të Ragibit, fjalorin "Lisànul areb" dhe librat e tefsireve të Kur'ànit.

atij që i vë shok All'llahut në adhurim (mushrik) dhe këtë e bën në kuadrin e një shembulli shumë të bukur, ashtu siç njofton ajeti vijues në fjalinë e tij të parë: **"All'llahu solli shembull një skllav që ishte pronë e disa ortakëve që s'kishin marrëveshje në mes tyre."**.[1]

Pra, kemi një skllav që është pronë e disa vetëve dhe çdonjëri prej atyre e urdhëron skllavin të bëjë një punë të caktuar; njëri e urdhëron: bëj këtë punë, kurse tjetri e ndalon të bëjë punën që u urdhërua të bëjë, për rrjedhojë skllavi ka mbetur në mes tyre si një leshko që s'kupton se çfarë i thuhet e nuk di çfarë të bëjë, nuk di urdhërin e cilit të zbatojë, sepse janë dy urdhëra në kundërshtim njëri me tjerin dhe skllavi nuk di cilin prej padronëve të tij duhet të kënaqë?

Veç kësaj, kur skllavi kërkon prej ndonjërit prej pronarëve të tij gjërat e nevojshme të jetës, ai i thotë: shko e kërkoja atij tjetrit dhe ky tjetri i thotë shko e kërkoja atij të parit, kështu skllavi mbetet i privuar në nevojë, i pafuqishëm dhe duket si idiot; përballë këtij skllavi qëndron skllavi tjetër, që është në pronësi vetëm të një njeriu: **"...edhe një skllav që ishte pronë e vetëm një njeriu."**.

Puna e këtij pronari është e qartë, urdhëri i tij është i njohur, prandaj për zbatimin e urdhërit të tij, zbatuesi as nuk ngurron e as nuk është në mëdyshje, sepse në urdhërin e tij s'ka kundërshtim dhe kështu skllavi jeton me shpirt të qetë, hapat i hedh të sigurtë, sepse punon nën kujdesin e një njeriu që e

[1] Fjala *"muteshàkisùne"*, në rrënjën e saj *"shekàsetun"*, do të thotë: moral i keq, konflikt e grindje, prandaj në gjuhën arabe i thuhet *"muteshàkis"* njeriut që konfliktohet e grindet me kryeneçësi e me moral të keq.

mbështet atë në çdo gjë, në çdo punë e në çdo vend. Vallë, a mund të jenë të barabartë këta dy burra dhe ajeti në vijim shtron pyetjen: **"A janë këta të dy të barabartë?"**.

Ky shembull flet për idhujtarin dhe për atë që beson se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm (muveh'hid). Idhujtari jeton në mes të kundërthënieve e të fjalëve që janë në kundërshtim njëra me tjetrën, çdo ditë zemra e tij është e lidhur me një të adhuruar të ri, prandaj, në jetën e idhujtarit s'ka as siguri e as një rrugë të qartë në të cilën ai të ecë. Kurse ata që besojnë se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm, janë të dashuruar vetëm me All'llahun dhe me asnjë tjetër. Në të gjitha gjendjet, ata kërkojnë strehim vetëm nën hijen e butësisë së All'llahut, sytë e tyre nuk shikojnë asnjë tjetër përveç All'llahut Fuqiplotë, prandaj rruga që ata ndjekin e programi që ata zbatojnë, janë të qartë, gjithashtu e qartë është edhe e ardhmja dhe fundi i tyre.

Në një transmetim të ardhur prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: *"Unë jam ai burri, skllavi i të Dërguarit të All'llahut."*.[1]

Dhe në një transmetim tjetër, të ardhur gjithashtu prej Prijësit të besimtarëve, thuhet: *"Burri skllav i vërtetë i burrit, është Aliu dhe pasuesit e tij."*.[2]

Në fundin e këtij ajeti, i Larti thotë: **"Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për All'llahun."**; falënderimi e lavdërimi i takojnë vetëm All'llahut, i Cili, duke sjellë shembuj të këtillë, ju

[1] Transmetimin e ka cituar El Hàkim Ebul Kàsim El Haskànij, në librin "Shevàhidu Tenzijl".

[2] Transmetimin e ka cituar El Ajashij'ji në tefsirin e tij, marrë prej tefsirit "Mexhmaul Bejàn", fundi i ajeteve objekt studimi.

udhëzon ju në rrugën më të mirë dhe vë në dorën tuaj argumentet më të qartë për të dalluar të vërtetën prej të gabuarës. Krijuesi Fuqiplotë u bën thirrje të gjithëve për besim të pastër e të sinqertë, sepse nën hijen e besimit të pastër e të sinqertë, All'llahu është Zoti Një e i Vetëm, gjendet qetësia e gëzimi. A ka mirësi më të madhe se kjo, a ka ndonjë punë tjetër që me të drejtë meriton falënderimin e lavdërimin më shumë se kjo mirësi kaq e madhe?

Por shumica e atyre nuk e dinë, megjithëse ka kaq shumë argumente të ndritshëm që tregojnë qartë se dashuria e tepëruar për këtë botë dhe ndjekja e dëshirave të ulta shtypëse, i bën ata të dalin jashtë rrugës së vërtetë, ashtu siç njofton i Larti në frazën e fundit të këtij ajeti: **"...por shumica e tyre nuk e dine."**.

Në plotësim të studimit të ajeteve të përparme në lidhje me Njëtimin e All'llahut (Teuhidin) dhe idhujtarinë (shirkun), ajeti vijues njofton se rezultatet e idhujtarisë dhe të Njëtimit të All'llahut do të dalin të formësuara Ditën e Kiametit, në fushën e Gjykatës së madhe.

Ky ajet fillon me vdekjen, që është porta e Ditës së Kiametit dhe u shpjegon qartë të gjithë njerëzve, se ligji i vdekjes është i përgjithshëm dhe se ky ligj i përfshin të gjithë, pa asnjë përjashtim: **"Ti patjetër do të vdesësh; patjetër edhe ata do të vdesin."**.[1]

[1] Ajeti **"Ti patjetër je i vdekur; edhe ata patjetër janë të vdekur"**, sipas rregullave të gramatikës e të sintaksës së gjuhës arabe, në dukje jep kuptimin e vdekjes në kohën e tanishme dhe nga ky këndvështrim, ky ajet është në kuptimin e kohës së tanishme realisht të realizuar; gjithashtu, fjala **"vdekur"**, herë vjen në kohën e tanishme-ardhshme dhe herë tjetër vjen në kohën e kaluar.

Po, vdekja përfshin të gjithë njerëzit dhe asnjë njeri nuk përjashtohet prej vdekjes, sepse vdekja është rruga nëpër të cilën do të kalojnë të gjithë në fundin e cakut të mbarimit të rrotullimit.

Disa interpretues të Kur'ànit Famëlartë, kanë thënë se armiqtë e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* rrinin në pritje të vdekjes së tij dhe në të njëjtën kohë ata ishin shumë të gëzuar që edhe i Dërguari i All'llahut më në fund do të vdiste, prandaj Kur'àni Famëlartë u përgjigjet atyre duke u thënë: Nëse vdes i Dërguari i All'llahut, ju a do të jetoni përgjithmonë? Këtë kuptim e lexojmë tekstualisht edhe në ajetin 34 të sures "El Enbijà": **"Në se ti vdes, a do të jenë ata të përjetshëm?"**.

Më pas, studimi në këtë ajet kalon në Gjykatën e Ditës së Kiametit, ditën kur njerëzit do të gjykohen në mes tyre në fushëm e madhe të asaj gjykate, për të cilën ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh, njofton: **"Pastaj, Ditën e Kiametit ju do të grindeni njëri me tjetrin para Zotit tuaj."**.

Fjala e ajetit "*tekhtesimùne*", në rrënjën e saj "*ikhtisàm*", do të thotë zënie, konflikt e polemikë në mes dy vetëve, ose në mes dy grupeve; gjatë grindjes, secili njeri ose grup përpiqet të hedhë poshtë fjalën e tjetrit. Ndodh që njëra palë ka të drejtë dhe pala tjetër mbron të pavërtetën, por ndodh që të dyja palët të mbrojnë të gabuarën, të pavërtetën, ashtu siç do të jetë grindja me fjalë në mes banorëve të zjarrit. Në lidhje me këtë grindje, në mesin e interpretuesve të Kur'ànit Famëlartë ka mendime të ndryshme, nëse kjo dispozitë është apo nuk është e përgjithshme.

Disa kanë thënë se kjo polemikë do të jetë në mes myslimanëve e mohuesve.

Të tjerë kanë thënë: kjo polemikë do të ndodhë në mes vetë myslimanëve dhe në një transmetim të ardhur prej Ebù Said El Khjuderij, lexojmë se ai ka thënë: S'ka asnjë ndër ne që të mendojë se grindja do të ndodhë në mes ne myslimanëve, sepse ne themi: si mund të grindemi ne, kur besojmë në të njejtin Zot, kemi të njëjtin Profet dhe kemi të njëjtën fe? Por, kur ndodhi beteja e "Sif'fijnit" dhe grindja në mes dy palëve u ashpërsua në kulm, rezultoi të ishin dy myslimanë, njëri ishte mysliman i vërtetë dhe tjetri mëtonte se ishte mysliman, derisa ngritën shpatat kundër njëri-tjetrit. Prandaj ne themi se ky ajet, na përfshin edhe ne myslimanët.[1]

Por ajetet vijues shpjegojnë qartë se grindja do të ndodhë në mes Profetëve e besimtarëve me idhujtarët e përgënjeshtruesit.

Kur vdiq i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* u ngrit Omer bin Khat'tàbi dhe tha: Disa prej hipokritëve filluan të gënjejnë dhe të thonë duke u betuar në All'llahun, se vdiq i Dërguari i All'llahut. Jo, ai ka shkuar te Zoti i tij, ashtu siç shkoi Mùsà bin Imràni, i cili, pasi mungoi në mesin e popullit të tij për dyzetë net, u kthye përsëri te ata pasi ata thanë se ai kishte vdekur. Betohem në All'llahun që i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* patjetër do të kthehet, ashtu siç u kthye Mùsài. Prandaj t'u priten duart e këmbët atyre që thonë se vdiq i Dërguari i All'llahut.

Përcjellësi i këtij transmetimi vijon: Kur ky lajm arriti te Ebù Bekri, ai u nis në drejtim të xhamisë. Aty gjeti Omerin që po u fliste njerëzve, por ai nuk e ktheu kokën të shohë asnjë njeri,

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 8, f. 497.

derisa hyri te i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* në shtëpinë e Àishes, ku i Dërguari i All'llahut ishte i shtrirë në një anë të shtëpisë, i mbuluar me një gunë. Ebù Bekri u afrua dhe zbuloi fytyrën e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*. Pastaj përcjellësi njofton se Ebù Bekri tha: O Omer, thirri mendjes dhe hesht, por ai vazhdoi të flasë, atëherë Ebù Bekri lexoi ajetin: **"Muhammedi s'është tjetër vetëm se një i Dërguar…"** (Sure "Àli Imràn", ajeti 144).

Përcjellësi i transmetimit thotë: Pasha All'llahun, njerëzit sikur e mësuan që ky ajet nuk kishte zbritur, derisa atë e lexoi Ebù Bekri dhe pastaj Omeri tha: Pasha All'llahun, pasi dëgjova Ebù Bekrin që e lexoi ajetin, u çudita aq shumë sa rashë për tokë nga që nuk më mbanin këmbët.[1]

[1] "Sijretu Ibni Hish'shàm" vëll. 4, f. 305 dhe f. 306, marrë i gjithi prej Ibni Ethijrit, vëll. 2, f. 323 dhe f. 324 me fare pak përmbledhje.

Përmbajtja

Ajetet: 28 – 32……5
Komentimi....6
Shkujdesje e përhershme....6
Ajetet: 33 – 36……12
Komentimi……13
Argumente të tjerë……..……..13
Ajetet: 37 – 40……...22
Komentimi……23
Hulumtime……31
1- Lëvizja rrotulluese dhe lëvizja e gjatë e Diellit……...….31
2- Dy shprehjet "texhrij" - "ecën" dhe "sabiku" - "parakalon"…….34
3- Sistemi i dritës dhe errësirës në jetën e njerëzve…….35
Ajetet: 41 - 44 ……...38
Komentimi…….……39
Lëvizja e anijeve në detra, është një argument hyjnor……39
Ajetet: 45 – 47……44
Komentimi……45
Kundërshtimi i të gjitha argumenteve të All'llahut……45
Ajetet: 48 – 53……53
Komentimi……54
Britma e Ringjalljes……...54
Ajetet: 54 – 58……63
Komentimi……64
Banorët e Xhennetit përjetojnë gëzim……64
Hulumtim……...…70
Llojet e "selamit" që marrin banorët e Xhennetit……70

Ajetet: 59 – 62……72
Komentimi……73
Përse adhuruat djallin?.....73
Ajetet: 63 – 68……79
Komentimi……80
Dita kur heshtin gojët dhe dëshmojnë gjymtyrët……80
Ajetet: 69 – 70……89
Komentimi……89
Ai nuk është poet, por është paralajmërues!.....89
Hulumtim……95
Jeta dhe vdekja e zemrave……...95
Ajetet: 71 – 76……99
Komentimi……...100
Dobitë që ka njeriu prej kafshëve……100
Hulumtim……108
Ajetet: 77 – 79……..110
Shkaku i zbritjes……..110
Komentimi……..…….111
Ajeti: 80……117
Komentimi……...117
Dy hulumtime…….....122
1- Përse dru i gjelbër?.....122
2- Dallimi në mes fjalës "el vukùdu" dhe fjalës "el vekùdu"……..123
Ajetet: 81 – 83……..125
Komentimi……...125
Vetëm All'llahu është Sunduesi e Gjykuesi mbi të gjitha sendet…125
Hulumtime……..132
1- Besimi në Ringjalljen është çështje e lidhur me natyrën e krijimit të njeriut……..132
2- Ndikimi i besimit në Ringjalljen mbi jetën e njerëzve……...136
3- Argumentet logjike që vërtetojnë Ringjalljen……140
4- Kur'àni dhe çështja e Ringjalljes……...…146

5- Ringjallja trupore……150
6- Xhenneti dhe zjarri…….153
Sure Es Sàffàt.....156
Përmbajtja e sures "Es Sàffàt"……...157
Mirësia e leximit të sures "Es Sàffàt"……..159
Ajetet: 1 – 5……..161
Komentimi……...161
Engjëjt janë të gatshën të zbatojnë detyrat……..161
Ajetet: 6 – 10……172
Komentimi……...173
Ruajtja e Qiellit prej depërtimit të djajve……173
Ajetet: 11 – 15……..181
Komentimi……...182
Ata që kurrë nuk e pranojnë të vërtetën……182
Dy hulumtime…….184
Ajetet: 16 – 23……..186
Komentimi……..…….187
A do të ngjallemi përsëri?.....187
Ajetet: 24 – 32……196
Komentimi……...197
Dialogu në mes parisë dhe masës që ishin në rrugën e humbjes…197
Hulumtim……204
Paria dhe pasuesit e tyre janë në rrugën e humbjes……..204
Ajetet: 33 – 40……..206
Komentimi……...207
E ardhmja e krerëve të rrugës së humbjes dhe e pasuesve të tyre..207
Hulumtim……....212
Ajetet: 41 – 49……..215
Komentimi……...216
Mirësitë e dhuratat për banorët e Xhennetit……..216
Hulumtim……224

Shikim i përgjithshëm mbi ato që kanë ardhur në ajetet e sipërme……...224
Ajetet: 50 – 61……..226
Komentimi……...227
Studim mbi shokun e keq……227
Hulumtime……..……232
1- Komunikimi në mes banorëve të Xhennetit dhe banorëve të Xhehennemit……..…232
2- Për cilët njerëz kanë zbritur këto ajete?.....233
3- Arritja e këtyre mirësive kërkon prej nesh vendosmëri……...235
Ajetet: 62 – 70……..236
Komentimi……..237
Lloje prej ndëshkimit të dhimbshëm për banorët e Xhehennemit..237
Ajetet: 71 – 74……..245
Komentimi……..245
Popujt e kaluar që ishin në rrugën e humbjes……245
Ajetet: 75 – 82……249
Komentimi……...250
Pjesë prej tregimit të Nùhut (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)…….250
Hulumtim……256
A janë prej pasardhësve të Nùhut njerëzit që gjenden në Tokë?....256
Ajetet: 83 – 94……259
Komentimi……..260
Plani i zgjuar i Ibrahimit për shkatërrimin e idhujve…….....260
Dy Hulumtime……...272
1- A e përdorin Profetët aludimin?.....272
2- Ibrahimi dhe zemra e pastër……275
Ajetet: 95 – 100……277
Komentimi……...278
Prishja e planeve të idhujtarëve……...278
Dy hulumtime……285
1- Krijuesi i çdo sendi……....285
2- Emigrimi i Ibrahimit (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)……287

Ajetet: 101 – 110……289
Komentimi……..….290
Ibrahimi në vendin e flijimit…….290
Hulumtime…….…….303
1- Cili është i flijuari i All'llahut (dhebijhull'llàh)?.....303
2- A ishte urdhëruar Ibrahimi të therte të birin?.....306
3- Si ka mundësi që ëndrra e Ibrahimit të jetë argument?.....308
4- Shpirti i madh i Ibrahimit nuk ndikohej prej pështpëritjeve të djallit……...309
5- Filozofia e tekbireve që merren në Minà……....312
6- Haxhi është adhurim shumë i rëndësishëm për ndërtimin e njeriut……..313
Ajetet: 111 – 113……..……318
Komentimi……...319
Ibrahimi, robi besimtar……..……319
Ajetet: 114 – 122……..324
Komentimi……...325
Mirësitë që u dha All'llahu Mùsait e Hàrùnit……325
Ajetet: 123 – 132…….....331
Komentimi……...332
Profeti Iljàs dhe ballafaqimi i tij me idhujtarët……...332
Dy hulumtime…….338
1- Cili është Iljasi?.....338
2- Cili është Il Jàsini?.....340
Ajetet: 133 – 138……343
Komentimi……..344
Shkatërrimi i popullit të Lùtit …….344
Ajetet: 139 – 148……..349
Komentimi……...350
Junusi në enën e nxehtë të provimit……350
Hulumtime……..364
1- Paraqitje e shkurtër e jetës së Jùnusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*...364

2- Si mbeti gjallë Jùnusi në barkun e peshkut?.....367
3- Mësime të mëdha në tregime të shkurtra……..369
4- Përgjigje për një pyetje……..371
5- Shorti dhe ligjshmëria e shortit në Islam……....372
Ajetet: 149 – 160……374
Komentimi……...375
Akuza të këqija……...375
Ajetet: 161 – 170……..384
Komentimi……...385
Mëtime të rreme……385
Ajetet: 171 – 177……..392
Komentimi……...393
Partia e All'llahut është triumfuese……393
Ajetet: 178 – 182……..402
Komentimi……...403
Largohu prej atyre……403
Hulumtim……..…407
Të menduarit rreth fundit të çdo pune……..……407
Sure Sàd.....410
Përmbajtja e sures "Sàd"……...411
Mirësia e leximit të sures "Sàd"……...413
Ajetet: 1 – 3……414
Shkaqet e zritjes……..…415
Komentimi……..416
Koha për shpëtim mbaroi……..415
Ajetet: 4 – 7……423
Shkaqet e zbritjes……...424
Komentimi……..…426
A mund të pranohet vetëm një Zot në vend të gjithë atyre zotave?.....426
Hulumtim……433
Frika nga e reja……433

Ajetet: 8 – 11……435
Komentimi……...436
Ushtria e shpartalluar……436
Ajetet: 12 – 16……443
Komentimi……..444
Për ata mjafton një britmë e vetme……444
Ajetet: 12 – 16……448
Komentimi……...449
Për ata mjafton një britmë e vetme……449
Ajetet: 17 – 20……453
Komentimi……...…454
Mësim prej Dàùdit……454
Hulumtim……461
Dhjetë cilësitë e Dàùdit (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)……461
Ajetet: 21 – 25……464
Komentimi……...465
Dàùdi dhe provimi i madh……...465
Hulumtime……472
1- Si është e vërteta e ngjarjeve në tregimin e Dàùdit?.....472
2- Teuràti dhe tregimet në lidhje me Dàùdin……474
3- Transmetimet islame dhe tregimi i Dàùdit (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)……480
Mendimet e interpretuesve të Kur'ànit……...484
Ajetet: 26 – 29……488
Komentimi……...489
Gjyko me drejtësi dhe mos ndiq dëshirat……...489
Dy hulumtime……...……..499
1- Devotshmëria përballë mëkateve……...…499
Ajetet: 30 – 33……501
Komentimi……..502
Sulejmàni (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) inspekton forcat e tij luftarake……502

Ajetet: 34 – 40……512
Komentimi……..….513
Provimi i vështirë për Sulejmànin dhe pushteti i Tij i madh……...513
A shihet kopraci në kërkesën e Sulejmànit? (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)……....518
Dy hulumtime…….526
1- Të vërtetat që shpjegon për ne tregimi i Sulejmànit…….526
2- Sulejmàni në Kur'àn dhe në Teuràt…….528
Ajetet: 41 – 44……529
Komentimi……...530
Jeta e Ej'jùbit, e mbushur me ngjarje e mësime……..…530
Hulumtime……..……541
1- Mësime të rëndësishme në tregimin e Ej'jùbit……..541
2- Ej'jùbi (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) në Kur'àn dhe në Teuràt……..545
3- Përshkrimi i Profetëve të mëdhenj me cilësinë "eu'uàb"…….546
Ajetet: 45 – 48……548
Komentimi……...549
Gjashtë Profetët……..549
Ajetet: 49 – 54……558
Komentimi……...559
Kjo u është premtuar të devotshmëve…….559
Ajetet: 55 – 61……564
Komentimi……..565
Ky është fundi i mizorëve:……....565
Ajetet: 62 – 64……573
Komentimi……..573
Grindja në mes banorëve të zjarrit……...…573
Hulumtim……..……..576
Ajetet: 65 – 70……577
Komentimi…….…….578
Unë jam vetëm paralajmërues……..578

Ajetet: 71 – 83……585
Komentimi……...587
Mendjemadhësia e djallit dhe përzënia e tij prej mëshirës së All'llahut……...587
Dy hulumtime……..……..599
1- Filozofia e ekzistencës së djallit……..….599
2- Zjarri i egoizmit e i mendjemadhësisë e djeg kapitalin e ekzistencës…….602
Ajetet: 84 – 88……604
Komentimi……..……605
Biseda e fundit në lidhje me Iblijsin (djallin)……..605
Hulumtim……609
Cili është trilluesi?.....609
Sure "Ez Zumer".....611
Përmbajtja e sures "Ez Zumer"……612
Mirësia e sures "Ez Zumer"……615
Ajetet: 1 – 3……616
Komentimi……..617
Je i urdhëruar të bësh adhurim të sinqertë……617
Hulumtim……...627
Dallimi në mes fjalëve "tenzijl" dhe "inzàl"……....627
Ajetet: 4 – 5……630
Komentimi……..631
All'llahu s'ka nevojë të ketë fëmijë……631
Ajetet: 6 – 7……638
Komentimi……..639
Të gjithë janë krijuar prej një njeriu të vetëm……639
Ajetet: 8 – 9……650
Komentimi……...…651
A janë të barabartë dijetarët me ata që nuk dinë?.....651
Hulumtim……658

Këto dy ajete, në brendinë e tyre kanë mençuri dhe pika shumë të rëndësishme……...658
Ajetet: 10 – 16……..661
Komentimi……..662
Linjat kryesore të prograneve të robve të sinqertë……662
Hulumtime……..……....672
1- E vërteta e humbjes……...672
2- Cili është qëllimi me frazën e ajetit "Dhe ju adhuroni cilin të dëshironi"……...…674
Cilët janë familja…….674
Ajetet: 17 – 20……....…676
Komentimi……...…677
Robtë e vërtetë të All'llahut……..677
Hulumtime……..683
1- Logjika e lirisë së mendimit në Islam…….....683
2- Përgjigje disa pyetjeve……...685
3- Modele prej transmetimeve islame që theksojnë lirinë e mendimit……687
4- Shkaku i zbritjes…….687
Ajetet: 21 – 22……..689
Komentimi……...690
Mbi një anije prej drite!!.....690
Hulumtim……696
Faktorët e hapjes së zemrave dhe ngurtësimit të zemrave……..…696
Ajetet: 23 – 26……..700
Shkaku i zbritjes……..…...701
Komentimi……...…702
Hulumtim……....711
Ajetet: 27 – 31……714
Komentimi……..715
Kur'àni, në atë s'ka parregullsi……715

ألأمثل فى تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازى

الجزء الثالث و العشرون

تيرانا: 2019

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب الله المنزل (جزء بیست و سه)

نویسنده: فقیه مفسّر حضرت آیة الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلّه)

ترجمه به زبان آلبانی: حاجی سلیم اصطفی (ره)

زیر نظر: وُلْنَتْ مِرْيَا

ویرایش: ویکتور شارا

تصحیح ادبی: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2019